REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia Kongresi i Lushnjes 9001, Lushnje, Shqipëri.Tel: +35535222214 / +3553522 2139,
e-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com, web : www.bashkialushnje.gov.al

DOKUMENTI

I RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR

TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM TË TERRITORIT TË BASHKISË

Përgatitur nga:

Arta Alla, Eksperte mjedisi dhe zhvillimi rural

Rodion Gjoka, Inxhinier mjedisi

Xhesika Hoxha, Inxhiniere mjedisi

Kristi Bashmili, Menaxhim mjedisi urban

Prof. Sherif Lushaj, Ekspert i bujqësisë e mjedisit, Çertifikatë me Vendimin nr. 6, Nr. 006Regj

Rudina Toto, Eksperte e planifikimit mjedisor, Çertifikatë me Vendimin nr. 12, Nr. 246 Regj

Silvi Jano, Ekspert i planifikimit të peizazhit

Ani Shtylla, Ekspert i GIS dhe planifikimit

Renisa Muka, Iris Hyka dhe Ada Lushi, Ekspertë të përpunimit grafik

Fiona Imami , Ekspertë të planifikimit të territorit

Tabela e Përmbajtjes

Parathënie **11**
Përmbledhje Jo-Teknike: **13**
1 Hyrje **13**
2 Qëllimi i dokumentit të VSM-së për Bashkinë Lushnje. **13**
2.1 Objektivat Mjedisore të VSM-së dhe ndikimet e mundshme 13
3 Metodologjia për hartimin e VSM-së **14**
3.1 Procesi 14
3.2 Kuadri ligjor 16
3.3 Grumbullimi i informacionit dhe analizat e kryera 16
3.4 Format e vlerësimit 17
4 Analizë e përgjithshme mjedisore e Bashkisë Lushnje. **18**
4.1 Kushtet gjeomorfologjike të territorit 18
4.2 Analiza gjeologo-inxhinierike 22
4.3 Ajri 23
4.4 Pyjet dhe kullotat 24
4.5 Peizazhi 24
4.6 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës 25
4.7 Biodiversiteti 26
4.8 Përdorimi i tokës 27
4.9 Toka Bujqësore dhe bujqësia 27
4.10 Furnizimi me ujë 28
4.11 Ujërat e ndotura 28
4.12 Mbetjet e ngurta 29
4.13 Ndyshimet Klimatike dhe rreziqet 29
4.14 Zonat e nxehta mjedisore dhe aktiviteti industrial 30
5 Vlerësimi i ndikimit në mjedis të propozimeve të PPV-së **32**
6 Masa për zbutjen e ndikimeve mjedisore të propozimeve të PPV-së. **35**
1. Qëllimi i dokumentit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Bashkisë Lushnje. **38**
1.1 Objektivat Mjedisore të VSM-së dhe ndikimet e mundshme **38**
2. Metodologjia për hartimin e VSM-së **42**
2.1 Procesi **42**
2.2 Kuadri ligjor **44**
2.3 Grumbullimi i informacionit dhe analizat e kryera **48**
2.4 Format e vlerësimit **54**
3. Përmbledhje e Planit të Përgjithshëm Vendor **59**
3.1 Vizioni dhe Objektivat strategjike **59**
3.2 Plani i Zhvillimit të Territorit **62**
3.2.1 Plani i propozimeve territoriale 62
3.2.2 Shërbimet dhe infrastrukturat publike 87
3.2.3 Hapat për zbatimin e PPV-së 97
4. Analiza mjedisore e territorit të Bashkisë Lushnje **101**
4.1 Analizë e përgjithshme e territorit **101**
4.1.1 Kushtet gjeomorfologjike të territorit 101
4.1.2 Rreziku gjeologjik 109
4.2 Metabolizmi i territorit **119**
4.3 Burimet ujore dhe basenet **131**
4.3.1 Burimet sipërfaqësore 131

4.3.2 Burimet ujore nëtokësore 151
4.4 Ajri 164
4.5 Pyjet, peizazhi, zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti 174
4.5.1 Pyjet dhe kullotat 174
4.5.2 Peizazhi 178
4.5.3 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës 185
4.5.4 Biodiversiteti 192
4.6 Toka 204
4.6.1 Përdorimi i tokës 204
4.6.2 Toka Bujqësore dhe bujqësia 205
4.7 Shërbimet publike 213
4.7.1 Furnizimi me ujë 213
4.7.2 Ujërat e ndotura 220
4.7.3 Mbetjet e ngurta 222
4.8 Ndyshimet Klimatike dhe rreziqet 231
4.9 Trashëgimia historike dhe kulturore 238
4.10 Zonat e nxehta mjedisore dhe aktiviteti industrial 239
5. Vlerësimi mjedisor i ndikimit të PPV-së 247
5.1 Detyrimet ligjore e institucionale 247
5.2 Vlerësimi i planit të zhvillimit të territorit 256
5.2.1 Procesi i vlerësimit 256
5.2.2 Vlerësimi i ndikimit në mjedis i propozimeve të Planit territorial 261
5.2.3 Vlerësimi i përputhshmërisë së propozimeve të PPV 265
5.2.4 Vlerësimi i projekteve të veçanta të PPV-së 272
5.2.5 Ndikimi i përgjithshëm i Planit sipas OM-ve 278
5.3 Përmbledhje e vlerësimit të propozimeve të PPV-së 282
6. Masat për mbrojtjen e mjedisit 287
6.1 Masa për parandalimin/zbutjen e ndikimeve mjedisore të propozimeve të PPV-së 287
6.2 Masa për mbrojtjen e burimeve ujore në Bashkinë Lushnje 288
6.2.1 Masa për mbrojtjen e burimeve ujore sipërfaqësore 288
6.2.2 Masa për mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore (akuiferët) 292
6.3 Masa për mbrojtjen e peizazhit, biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura 298
6.3.1 Masa për mbrojtjen e peizazhit 298
6.3.2 Masa për mbrojtjen e biodiversiteti 302
6.3.3 Masa për menaxhimin e Zonave të Mbrojtura 304
6.4 Masa për mbrojtjen e cilësisë së ajrit 305
6.5.1 Masat për mbrojtjen e tokës/territorit 308
6.5.2 Masa për mbrojtjen e tokës bujqësore 315
6.7 Masa për rihabilitimin e zonave të nxehta mjedisore 319
7. Plani i veprimit për zbatimin e masave mbrojtëse mjedisore 322
7.1 Plani i veprimit: monitorimi, treguesit e vlerësimit e institucionet e monitorimit 322
7.2 Çështje institucionale, ligjore dhe instrumente që lidhen me monitorimin e mjedisit 329
Shtojca 1: Lista e Institucioneve/Bashkëpunëtorëve të kontaktuar. 334
Shtojca 2: Përmbledhje Dëgjesave me Publikun në kuadër të VSM-së 336
Shënime dhe referenca 346

Lista e Figurave

Figura 1. Procesi i hartimit dhe miratimit të VSM-së për PPV-në. 15
Figura 2. Harta e relievit dhe e hidrografisë së bashkisë së Lushnjes 19
Figura 3. Analiza e mbivendosjes së hidrogjeologjisë dhe hidrografisë. 20
Figura 4. Harta e tipologjive të peizazhit dhe fondi pyjor. 24
Figura 5. Procesi i hartimit e miratimit të VSM-së për PPV-në e Bashkisë së Lushnjes. 42
Figura 6. Nivelet e zhvillimit, Bashkia Lushnje 61
Figura 7. Karakteri i vendbanimeve, Bashkia Lushnje 61
Figura 8. Qendra e re e qytetit dhe Stacioni Multimodal, Lushnje 63
Figura 9. Ballkoni i Lushnjes - Kodra e qytetit 64
Figura 10. Transformimet strategjike në Kodrën e Lushnjes 65
Figura 11. Bulevardi rekreativ i përroit të Lushnjes 66
Figura 12. Bulevardi rekreativ i përroit të Lushnjes 66
Figura 13. Bulevardi rekreativ i përroit të Lushnjes 68
Figura 14. Shpërndarja e zonave kryesore ekonomike në Bashkinë Lushnje 69
Figura 15. Transformimet strategjike në Liqenin e Kasharaj, Bashkia Lushnje 70
Figura 16. Tranformimet strategjike të ndërtesave ish-industriale, Plug-Lushnje 71
Figura 17. Rruga e shërbimit përgjatë autostradës Lushnje – Fier 72
Figura 18. Skema e mënyrave të ndërhyrjes në territor, Bashkia Lushnje 76
Figura 19. Harta e zonave, Bashkia Lushnje 86
Figura 20. Harta e sistemit të furnizimit me ujë dhe propozimeve, Bashkia Lushnje. 91
Figura 21. Harta e sistemit të kanlaizimeve dhe propozimeve të reja, Bashkia Lushnje 94
Figura 22. Fazimi sipas ndërhyrjeve në njësitë strukturore 97
Figura 23. Fazimi sipas ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të propozuar 98
Figura 24. Pozicioni gjeografik i Bashkisë Lushnje nërajon 102
Figura 25. Harta e pjerrësive në përqindje e Bashkisë së Lushnjes 103
Figura 26. Harta e relievit dhe e hidrografisë së bashkisë së Lushnjes 103
Figura 27. Harta klimatike e bashkisë së Lushnjes 104
Figura 28. Analiza e mbivendosjes së hidrogjeologjisë dhe hidrografisë në Lushnje. 105
Figura 29. Tokat e kripura në Plug (në ha) sipas numrit të parcelave 106
Figura 30. Elementët e fortë në territorin e bashkisë së Lushnjes 109
Figura 31. Zonimi gjeoteknik i Shqipërisë dhe i Lushnjes 110
Figura 32. Rrëshqitjet në Bashkinë Lushnje 111
Figura 33. Erozioni në Bashkinë Lushnje 113
Figura 34. Punimi i tokës me zhveshje të sipërfaqes 114
Figura 35. Rreziqet gjeologjike në Qytetin e Lushnjes (rrëshqitjet dhe përmbytjet) 117
Figura 36. Pasojat e përmbytjes së Ultësirës Perëndimore. 118
Figura 37. Pasojat e përmbytjes së Ultësirës Perëndimore. 118
Figura 38. Fluksi i energjisë në rajon 120
Figura 39. Fluksi i Ujit në Rajon 121
Figura 40. Bilanci i energjisë për bashkinë e Lushnjes 123
Figura 41. Harta e ujërave sipërfaqësore të bashkisë së Lushnjes 124
Figura 42. Fluksi i ushqimit, bashkia Lushnje 126
Figura 43. Prodhimet bujqësore (në kton) në bashkinë Lushnje, 2014 127
Figura 44. Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në kton) në nivel qarku. 128
Figura 45. Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në kton) në nivel qarku. 128
Figura 46. Prodhimet blegtorale në vitin 2014 (në kton). 129
Figura 47. Fluksi i mbetjeve në bashkinë Lushnje 130
Figura 48. Burimet Ujore Lushnje 131
Figura 49. Profilet e monitorimit të gjendjes së lumenjve në Basenin e L. Seman 134
Figura 50. Thellimi i shtratit të Semanit e Osumit për shkak të erozionit fundor 134
Figura 51. HEC-et në Pellgun e Lumit Seman 137
Figura 52. Erozioni në brigjet e Lumit Seman 140
Figura 53. Harta e marrjes së kampioneve për vlerësim në lumin Seman 141

Figura 54. pH dhe Përçueshmëria elektrike në Basenin e Semanit 142
Figura 55. Vlerat e NBO5 dhe Oksigjenit të tretur në Basenin e Semanit 142
Figura 56. Lënda e ngurtë e tretur dhe pezull në Basenin e Semanit 143
Figura 57. Nitratet, nitritet dhe amoniaku në Basenin e Semanit 143
Figura 58. Bakteria Koliform në Basenin e Semanit 144
Figura 59. Metalet e rënda në Basenin e Semanit 144
Figura 60. Ndryshimet të hapësirës së përdorur nga vend-depozitimi gjatë 2005-2010 150
Figura 61. Akuiferët në Bashkinë Lushnje 152
Figura 62. Qarku Fier - Sipërfaqja e Akuiferëve sipas llojit (në %) 152
Figura 63. Puset e ujësjellësit të Bashkisë Lushnje 157
Figura 64. Vendburimi Patos-Marinëz (kufinjtë sipas zonës së kontratës) 159
Figura 65. Zonat me shpim horizontal (majtas) dhe teknologjia e përmbytjes me polimer dhe ujë djathtas (Water and Polymer Flooding) 162
Figura 66. Sasia e CO2 që shkarkohet në ajër për çdo litër benzinë e naftë 166
Figura 67. Numri i makinave në Shqipëri për 1,000 banorë ndër vite 166
Figura 68. Nr i pasagjerëve dhe tonazhi i mallrave të transportuara me tren në vënd 167
Figura 69. Numri i mostrave të lëndës djegëse të analizuara 168
Figura 70. Përmbajtja e squfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %) 169
Figura 71. Numri i makinave (në %) që shkarkojnë CO e HC mbi vlerat e lejuara në ajër, sipas vitit të prodhimit. 169
Figura 72. Fondi pyjor sipas llojit 174
Figura 73. Harta e fondit pyjor 175
Figura 74. Harta e tipologjive të Peizazhit (Fashat) 178
Figura 75. Harta e tipologjive të peizazhit dhe fondipyjor 179
Figura 76. Harta peizazhistike dhe rrugët 180
Figura 77. Zonë ripariane e zhveshur nga bimësia si pasojë e zhvillimit të bujqësisë. 181
Figura 78. Rrip i gjelbër me bimësi të ulët përgjatë një kanali vaditës 181
Figura 79. Harta e Elementeve Peizazhistike 182
Figura 80. Harta e rrezikut ndaj elementeve peizazhistike 184
Figura 81. Zonat e mbrojtura në Bashkinë Lushnje 188
Figura 82. Selvitë e Manastirit dhe Dushkajat 189
Figura 83. Rrapi i Zonjës 189
Figura 84. Burimi termominerar Karbunarë 190
Figura 85. Burimet termominerale të Karbunarës 190
Figura 86. Burimet termominerale të Karbunarës 191
Figura 87. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në shkallë vendi 193
Figura 88. Sistemet e territorit, Bashkia Lushnje 204
Figura 89. Kulturat kryesore bujqësore në Bashkinë e Lushnjes (në ha) 206
Figura 90. Tokat e kripura në Plug (në ha) sipas numrit të parcelave 208
Figura 91. Përdorim konfliktual i tokës 209
Figura 92. Gjurma e projektit TAP në territorin e Bashkisë 210
Figura 93. Skema e furnizmit me ujë nga U.K. Lushnje 214
Figura 94. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në bashkinë e Lushnjes dhe qytet. 220
Figura 95. Ndryshimet të sipërfaqes së venddepozitimit në harkun kohor 2005-2010 224
Figura 96. Foto nga vend-depozitimi i mbetjeve Lushnje 225
Figura 97. Sasia e mbetjeve inerte e prodhuar në Lushnje në vite 226
Figura 98. Trajtimi i mbetjeve në Spitalin “Ihsan Çabej” Lushnje 227
Figura 99. Skenarët e parashikimit të rritjes së temperaturës 233
Figura 100. Rëndësia Kombëtare në territor, Bashkia Lushnje 239
Figura 101. Zona e ish-Uzina e Plasmasit dhe depozitimet e mbetjeve te plasmasit Plug 241
Figura 102. Ndryshime të hapësirës së përdorur nga vend-depozitimi gjatë 2005-2010 241
Figura 103. Zonat me shpim horizontal (majtas) dhe teknologjia e përmbytjes me polimer dhe ujë (djathtas: Water and Polymer Flooding) 244
Figura 104. Habitati i Pelikanit Kaçurrel (Pelecanus crispus) 304

Figura 105. kultivimi i kodrave me drejtim përreth kodrave..... 316
Figura 106. Foto nga dëgjesa e parë me publikun. 338
Figura 107: Lista e pjesmarrësve në dëgjesën e parë publike, VSM Bashkia Lushnje. 339
Figura 108. Foto nga dëgjesa publike VSM – Bashkia Lushnje 344
Figura 109. Foto nga dëgjesa e dytë publike mbi VSM-në Bashkia Lushnje. 345
Figura 110. Foto nga dëgjesa e dytë publike mbi VSM-në Bashkia Lushnje. 345

Lista e Tabelave

Tabela 1. Përputhshmëria përfundimtare e Planit me Objektivat Mjedisorë..... 33
Tabela 2. Përputhshmëria përfundimtare e Planit me Objektivat Mjedisorë..... 34
Tabela 3. Përmbledhje e kuadrit Ligjor per mbrojtjen e mjedisit..... 45
Tabela 4. Formati i inventarit paraprak të informacionit për VSM-në..... 49
Tabela 5. Kriteret e vlerësimit të ndikimit, peshat dhe pikët..... 56
Tabela 6. Simbolika e vlerësimit të ndikimit në mjedis 56
Tabela 7. Paraqitja përfundimtare e vlerësimit..... 57
Tabela 8. Vlerësimi i përputhshmërisë mes objektivave të Planit dhe të VSM-së..... 58
Tabela 9. Vlerat e përdorura për përputhshmërisë e objektivave të Planit me VSM. 58
Tabela 10. Fazimi i projekteve strategjike, Bashkia Lushnje..... 98
Tabela 11. Rrëshqitjet e dherave në Bashkinë Lushnje në vitet e fundit..... 112
Tabela 12. Vlerësim teorik për nivelin e erozionit në tokat bujqësore të Shqipërisë 114
Tabela 13. Përmbytjet në territorin e Bashkisë Lushnje në 10 vitet e fundit..... 115
Tabela 14. Rreziqet gjeologjike në Qytetin e Lushnjes (rrëshqitjet dhe përmbytjet)..... 116
Tabela 15. Energjia e shpenzuar për ngrohje, Lushnje..... 122
Tabela 16. Popullsia banuese, Shqipëri..... 122
Tabela 17. Bilanci i energjisë elektrike, Lushnje 122
Tabela 18. Tipi energjisë përdorur në ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale në Lushnje 123
Tabela 19. Fluksi i ushqimit, prodhimet bujqësore dhe blegtorale në Lushnje..... 125
Tabela 20. Prodhimi dhe konsumi në bashkinë Lushnje..... 126
Tabela 21. Vendndodhja e profileve të monitorimit..... 133
Tabela 22. Erozioni fundor ndër vite në lumenjtë Osum dhe Seman..... 134
Tabela 23. HEC-et në Basenin e Lumit Seman..... 135
Tabela 24. HEC-et në Lumin Devoll..... 138
Tabela 25. Pikat e monitorimit..... 140
Tabela 26. Lista e aktiviteteve që prodhojnë mbetje industriale në Bashkinë Lushnje..... 148
Tabela 27. Bilanci i gjelbërimit publik në Bashkinë Lushnje 164
Tabela 28. Rezultatet e monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse në Shqipëri..... 168
Tabela 29. Aktivitetet që shkarkojnë ndotje në ajër në territorin e Bashkisë Lushnje sipas lejeve që disponojnë..... 170
Tabela 30. Shpërndarja e fondit pyjor e kullosor sipas NJA-ve në Bashkinë Lushnje..... 174
Tabela 31. Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave 185
Tabela 32. Zonat e mbrojtura në Bashkinë Lushnje..... 187
Tabela 33. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në Shqipëri..... 193
Tabela 34. Numri i specieve të rrezikuara të florës e faunës në Shqipëri dhe Lushnje..... 194
Tabela 35. Speciet ne rrezik zhdukjeje të faunës në Bashkinë Lushnje 196
Tabela 36. Speciet ne rrezik zhdukjeje të florës në Bashkinë Lushnje 202
Tabela 37. Shpërndarja në përqindje e sistemeve të territorit, Bashkia Lushnje..... 205
Tabela 38. Sipërfaqja e tokës së punuar dhe prodhimtaria në Lushnje 205
Tabela 39. Ndarja e bashkive sipas sektorit ekonomik dhe pjerrësisë së relievit..... 206
Tabela 40. Vlerësim teorik për nivelin e erozionit në tokat bujqësore të Shqipërisë. 207
Tabela 41. Rritja e numrit të fermave të pluguara me traktor 211
Tabela 42. Numri i fermave që përdorurin plehra kimike në vend 211
Tabela 43. Prurja mesatare e burimeve të ujit në Bashkinë e Lushnjes 213
Tabela 44. Të dhëna mbi situatën e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm në Lushnje..... 214
Tabela 45. Shërbimi i furnizimit me ujë për Nja-të dhe fshatrat në Bashkinë Lushnje..... 215

Tabela 46. Pusshpimet në Bashkinë e Lushnjes 216
Tabela 47. Zonat e shërbyera nga UK Lushnje 219
Tabela 48. Gjendja e tubacioneve të rrjetit të furnizimit me ujë 220
Tabela 49. Projeksion: Sasia e mbetjeve urbane të prodhuara në Bashkinë Lushnje dhe në rang vendi. 222
Tabela 50. Aktivitetet Industriale që krijojnë mbetje 228
Tabela 51. Skenaret e parashikimit të rritjes së temperatures (*Referuar Tem. Mes. 1990*) ... 232
Tabela 52. Numri i fenomeneve ekstreme të parashikuara deri në vitin 2100 në rajonet bregdetare në vend 233
Tabela 53. Numri i ditëve me fenomene ekstreme të motit në vit: Parashikime 234
Tabela 54. Parashikimet e ndryshimit të regjimit të reshjeve (në %) për periudha të ndryshme në lidhje me vitin 1990 234
Tabela 55. Rezervat e llogaritura të naftës dhe gazit në Lushnje 243
Tabela 56. Detyrimet ligjore e institucionale 247
Tabela 57. Objektivat mjedisorë dhe numrat e tyre 257
Tabela 58. Pesha specifike e elementëve/kritereve të vlerësimit 258
Tabela 59. Shembull: Pikët e grumbulluara nga 6 elementët/kriteret e për OM1 (Ajër) 258
Tabela 60. Vlerësimi sasior, konvencional e cilësor i ndikimit në mjedis 259
Tabela 61. Konvertimi i pikëve të ndikimit të projektit në pikë përputhshmërie 259
Tabela 62. Përputhshmëria e shprehur në vlera numerike dhe vlerësimi përkatës. 260
Tabela 63. Shembull i vlerësimit të përputhshmërisë së OP-ve me OM-të 260
Tabela 64. Objektivat e programet e Planit 261
Tabela 65. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të O.1: Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor 262
Tabela 66. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të O.2: Zhvillimi i eko-turizmit 263
Tabela 67. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i O.3: Zhvillimi i planifikuar e kontrrolli i territorit 264
Tabela 68. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të O.4: Mbrojtja e burimeve natyrore 265
Tabela 69. Përputhshmëra e objektivave mjedisore me projektet strategjike 266
Tabela 70. Përputhshmëria e objektivave dhe progameve të planit me OM-të 271
Tabela 71. Përputhshmëria e objektivave (në %) 271
Tabela 72. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i projektit 272
Tabela 73. Përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore 273
Tabela 74.Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i Pr.7 274
Tabela 75. Përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore 274
Tabela 76.Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i projektit 276
Tabela 77. Përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore 277
Tabela 78.Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i projekteve 277
Tabela 79. Përputhshmëria e projekteve me objektivat mjedisore 278
Tabela 80. Përputhshmëria përfundimtare e Planit me Objektivat Mjedisorë. 284
Tabela 81. Përputhshmëria përfundimtare e Planit me Objektivat Mjedisorë. 285
Tabela 82. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e cilësisë së ujit 292
Tabela 83. Projektet e planifikuara në PPV që synojnë përmirësimin e peizazhit 301
Tabela 84. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e biodiversitetit 304
Tabela 85. Shkalla e mbrojtjes dhe domethënia (veprimtaritë e ndaluara) 305
Tabela 86. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e cilësisë së ajrit 308
Tabela 87. Masat kundër rrëshqitjeve dhe përmbytjeve 311
Tabela 88. Rreziqet gjeologjike në Zonën Rurale të Lushnjës (rrëshqitjet dhe përmbytjet)dhe masat që duhen marrë 312
Tabela 89. Projektet e planifikuara në PPV për mbrojtjen e tokës 317
Tabela 90. Projektet e planifikuara në PPV për shtimin e zonave pyjore 319
Tabela 91. Projektet e planifikuara në PPV për rehabilitimin e vatrave të nxehta mjedisore 320
Tabela 92. Programi i monitorimit të mjedisit gjatë zbatimit të projekteve të PPV-së 324
Tabela 93. Rekomandime për përmirësimin e monitorimit mjedisor 333
Tabela 94. Lista e institucioneve dhe takimeve të kryera 334

Lista e Shkurtimeve:

AKM	Agjencia Kombetare e Mjedisit
AKPT	Agjencia Kombetare e Planifikimit të Territorit
ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
BB	Banka Boterore
BE	Bashkimi Evropian
BMA	Bimet medicinale dhe aromatike
BTEX	Benzen, Toluen, Etilbenzen dhe Ksilol
ERE	Enti Rregullator i Energjise
GHG	Shkarkimet e gazeve sere
GHG	Shkarkimet e gazeve sere
HCFC	Hidrogjen flourklorkarbonet
IAP	Gazesjellesi Joniano-Adriatik
IEA	Zona me Rendesi Ekologjike
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Nderkombetare per Migrimin
IPA	Instrumenti per Asistencen e Para-Anetaresimit
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujerave të Ndotur
KE	Komisioni Evropian
KEE	Keshilli Ekonomik Evropian
KfW	Banka Gjermane per Zhvillim
KKT	Keshilli Kombetar i Territorit
KM	Keshilli i Ministrave
LAeq	Niveli i zhurmave urbane
METE	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes
MM	Ministria e Mjedisit
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
NBSAP	Strategjia Kombetare e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit
NBSAP	Strategjia Kombetare e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit
NMVOC	Perberes organike të paqendrueshem pa-metan
OBSH	Organizata Boterore e Shendetesise
OM	Objektiv Mjedisor
OP	Objektiv i Planit
PBB	Prodhimi i Brendshem Bruto
PCB/PCT	Bifenile të poliklorinuara / Trifenile të poliklorinuara
PLGP	Projekti i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore
PINS B	Plani i Integruar Ndersektorial per Bregdetin
PKIE	Plani Kombetar per Integrimin Evropian
PKPZM	Programi Kombetar i Punes per Zonat e Mbrojtura
PPV	Plani i Pwrgjithshwm Vendor
PPK	Plani i Pergjithshem Kombetar
PT	Planifikim I Territorit
SEIZP	Sistemi Europian i Informacionit per Zjarret ne Pyjet
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikes
SKMIU	Strategjia Kombetare per Menaxhimin e Integruar të Ujerave
SKMM	Strategjia Kombetare per Menaxhimin e Mbetjeve
SKZHI	Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrim 2014-2020

SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
TAP	Tubacioni Trans-Adriatik
TMD	Teknikat me të mira të disponueshme
UBT	Universiteti Bujqesor i Tiranes
NJA	Njësi Administrative
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara per Zhvillim
UNECE	United Nations Economic Commission for Europe
UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara per Mjedisin
UNESCO	Organizata per Edukim, Shkence dhe Kulture e Kombeve të Bashkuara
UNFCCC	Konventa Kuader e Kombeve të Bashkuara per Ndryshimet Klimatike
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VKM	Vendim i Keshillit të Ministrave
VNM	Vleresim i Ndikimit ne Mjedis
VOC	Perberes organike të paqendrueshem
VSM	Vleresimi Strategjik Mjedisor

Parathënie

Hartimi i raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) është ndërrmarrë në kuadër të hartimit të planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të territorit të Bashkisë Lushnje. Hartimi i këtij dokumenti është zhvilluar paralelisht me procesin e hartimit të PPV-së, sikurse përcaktohet në Ligjin nr. 91/2013, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor". Hartimi i PPV-së dhe VSM-së ka nisur në tetor të vitit 2015, pas vendimit të Këshillit Bashkiak për të miratuar Nismën e Hartimit të PPV-së dhe me përfundimin e reformës administrativo-territoriale përmes krijimit të bashkive të reja.

Në raportin e VSM-s janë analizuar përbërësit mjedisorë dhe janë marrë parasysh të gjitha ndikimet e mundshme, që propozimet e PPV-së mund të kenë në mjedis. Rëndësi e veçantë i është kushtuar dhënies së rekomandimeve e masave për prandalimin apo zbutjen e ndikimeve të mundshme në mjedis nga këto propozime dhe për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në territorin e bashkisë.

Në zbatim të ligjeve në fuqi, gjatë procesit të hartimit të këtij raporti janë kryer konsultime të vazhdueshme më specialistë dhe institucione vendore e qendrore, si dhe me grupe të interesit. Përgjatë procesit të hartimit të VSM-së janë zbatuar të gjitha kërkesat që burojnë nga Ligji nr. 91/2013, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" dhe aktet nënligjore të tij, mbi mënyrën e vlerësimit, përfshirjen dhe njoftimin e institucioneve të linjës (mjedisit) nga autoriteti propozues, institucioneve të tjera, forumit qytetar të krijuar në kuadër të PPV-së dhe të publikut të gjerë. Janë kryer tre raunde të dëgjesave dhe konsultimit publik, nga të cilat dy kanë qenë të dedikuara për VSM-në, në përputhje me VKM Nr. 219, datë 11.3.2015 "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor".

Raporti i VSM-së ka synuar të sigurojë masa për mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit të PPV-së. Pavarësisht këtij koordinimi mes PPV-së dhe analizave mjedisore, disa nga propozimet e Planit kanë mundshmëri të pasojave negative në mjedis, për shkak të natyrës dhe të nivelit ekzistues të teknologjisë. Për të shmangur apo minimizuar këto pasoja, VSM-ja propozon masat përkatëse dhe një plan hapash për zbatim.

Në përfundim të hatimit të VSM-së, grupi i punës shpreh mirënjohjen për të gjitha institucionet dhe individët, që ishin pjesë e pandashme e procesit, duke dhënë ekspertizë, këshilla, të dhëna, komente dhe mbështetje praktike mbi mbarëvajtjen dhe realizimin me sukses të këtij raporti.

Ky proces nuk do të ishte realizuar në mënyrë të suksesshme pa rolin e rëndësishëm dhe drejtimin aktiv nga vetë Kryetari i Bashkisë Lushnje, Z. Fatos Tushe.

Informacioni i përdorur për hartimin e këtij dokumenti është bërë i mundur falë kontributit të të gjitha drejtorive të Bashkisë Lushnje, Institucioneve të tjera dhe punës së grupit në terren.

Grupi i punës:

Arta Alla, Rodion Gjoka, Rudina Toto, Xhesika Hoxha, Kristi Bashmili, Sherif Lushaj, Silvi Jano, Renisa Muka, Ani Shtylla, Ada Lushi, Iris Hyka, Fiona Imami dhe Zenel Bajrami. Mimoza Haxhia, Teuta Korershi, Gentian Nushi, Fatma Hoxha, Sami Tabaku.

Institucione bashkëpunuese: Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe AdMZ, Agjencia Rajonale e Mjedisit-Fier, Forumi qytetar, Bankers Petroleum, AlbPetrol, Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Shoqëria Civilie, NGO, Shërbimi Gjeologjik Shqipëtar, Instituti Gjeoshkencës Energjisë Mjedisit dhe Ujërave, Ministria Bujqësisë, AZHBR, etj.

Përmbledhje Jo-Teknike:

1 Hyrje

Hartimi i raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) është ndërrmarrë në kuadër të hartimit të planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të territorit të Bashkisë Lushnje. Hartimi i këtij dokumenti është zhvilluar paralelisht me procesin e hartimit të PPV-së, sikurse përcaktohet në Ligjin nr. 91/2013, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor". Hartimi i PPV-së dhe VSM-së ka nisur në tetor të vitit 2015, pas vendimit të Këshilit Bashkiak për të miratuar Nismën e Hartimit të PPV-së dhe me përfundimin e reformës administrativo-territoriale përmes krijimit të bashkive të reja.

Raporti i VSM-së ka synuar të sigurojë masa për mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit të PPV-së. Pavarësisht këtij koordinimi mes PPV-së dhe analizave mjedisore, disa nga propozimet e Planit kanë mundshmëri të pasojave negative në mjedis, për shkak të natyrës dhe të nivelit ekzistues të teknologjisë. Për të shmangur apo minimizuar këto pasoja, VSM-ja propozon masat përkatëse dhe një plan hapash për zbatim.

Në raportin e VSM-s janë analizuar të gjithë përbërësit mjedisorë dhe janë marrë parasysh të gjitha ndikimet e mundshme, që propozimet e PPV-së mund të kenë në mjedis. Rëndësi e veçantë i është kushtuar dhënies së rekomandimeve e masave për prandalimin apo zbutjen e ndikimeve të mundshme në mjedis nga këto propozime.

2 Qëllimi i dokumentit të VSM-së për Bashkinë Lushnje.

Qëllimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Bashkisë Lushnje reflekton drejtpërdrejt qëllimin e ligjit nr. 91/2013, datë 28.02.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor", sipas nenit 1 të tij, konkretisht: *të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis*.

2.1 Objektivat Mjedisore të VSM-së dhe ndikimet e mundshme

Mbi bazën e qëllimit të VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë Planit, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së. Edhe objektivat mjedisore qëndrojnë po njëlloj për PPV-në. Për më tepër, këto objektiva janë ndërtuar në përputhje me politikat e strategjitë mjedisore kombëtare, me Planin Kombëtar të Territorit (dokumenti i VSM-së), si dhe me qëndrimet e sektorëve përkatës (që preken nga objektivat). Për çdo objektiv janë listuar ndikimet e mundshme të PPV-së në mjedis, nëse objektivi nuk realizohet, pra nëse nuk merren masat zbutëse, eleminuese apo parandaluese të dëmit mjedisor.

- *Objektivi Mjedisor 1 (OM1) – Ajri:* Përmbushja e objektivave afatmesme për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, sipas kufijve maksimalë e normave të lejuara nga Bashkimi Europian.
- *Objektivi Mjedisor 2 (OM2) – Uji:* Zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin e bashkisë, mbi burimet dhe trupat ujorë sipërfaqësorë e nëntokësorë, përfshirë ujin e pijshëm, ujërat bregdetare dhe brigjet.
- *Objektivi Mjedisor 3 (OM3) – Toka:* Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe burimeve natyrore të lidhura drejtpërdrejtë me të.
- *Objektivi Mjedisor 4 (OM4) – Biodiversiteti:* Mbrojtja dhe manaxhimi i

qëndrueshëm i biodiversitetit në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, shërbimeve të tyre dhe garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të mjedisit.

- *Objektivi Mjedisor 5 (OM5) – Pyjet:* Konservimi, shtimi dhe manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të ekosistemit, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike dhe ofrimit të një burimi të qëndrueshëm jetese për banorët e zonave rurale.
- *Objektivi Mjedisor 6 (OM6) – Peizazhi dhe Ekosistemet:* Konservimi dhe manaxhimi inteligjent i peizazhit, si matricë bazë për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të ekosistemeve.
- *Objektivi Mjedisor 7 (OM7) – Ndryshimet klimatike:* Realizimi i masave dhe infrastrukturës për të mos kontribuar në ndryshimet klimatike dhe efektin serë, si dhe për të parandaluar, apo zbutur efektet negative nga ndryshimet klimatike, në përmbushje edhe të angazhimeve përkatëse kombëtare.
- *Objektivi Mjedisor 8 (OM8) – Trashëgimia kulturore:* Konservimi e restaurimi për jetëgjatësi i objekteve dhe zonave historike e të trashëgimisë kulturore e arkeologjike.
- *Objektivi Mjedisor 9 (OM9) – Cilësia e jetës:* Garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore.


3 Metodologjia për hartimin e VSM-së

3.1 Procesi

Detyrimi për hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lushnje përcaktohet nga ligji nr. 91/2013, datë 28.02.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor". Sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, procesit të vlerësimit strategjik mjedisor i nënshtrohen planet kombëtare e vendore të planifikimit të territorit urban e rural, përfshirë dhe mbrojtjen e peizazhit, të përdorimit të tokës, të cilat vendosin kuadrin për miratimin, në të ardhmen, të projekteve të listuara në shtojcat 1 e 2 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"[1]. Sipas ligjit, në nenin 7 të tij përcaktohen edhe hapat nëpër të cilat duhet të kalojë procesi i hartimit dhe miratimit të VSM-së. Këto hapa, bashkë me metodologjinë teknike, janë përmbledhur në figurën e mëposhtme.

Në kontekstin më të gjerë, Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces sistematik, që parashikon e vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të planit të përgjithshëm vendor të bashkisë, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrën e duhur që në fazat më të hershme të vendimmarrjes për instrumentin e planifikimit.

Figura 1. Procesi i hartimit dhe miratimit të VSM-së për PPV-në.



Burimi: Ligji nr. 91/2013 dhe VKM nr. 219, datë 11.03/2015; Përpunoi: Co-PLAN, 2016

Po ashtu, qartësia mbi detyrimin për hartimin e VSM-së për PPV-në e bashkisë, vjen edhe nga VKM-ja nr. 507, datë 10.6.2015, "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor".

Grupi i punës për hartimin e PPV-së dhe VSM-së i ndoqën fazat e procesit si më poshtë:

a) Njoftimi i Ministrisë së Mjedisit nga Bashkia është kryer në periudhën shtator-tetor të vitit 2015.

b) Konsultimi me grupet e interesit për çështjet që trajtohen në raportin e VSM-së, është realizuar nëpërmjet 5+2 takimeve publike dhe përmes takimeve individuale, sipas rastit.

c) Hartimi i raportit paraprak u realizua gjatë periudhës nëntor 2015 – maj 2016. Konsultimet në lidhje me këtë raport paraqiten më lart dhe mbyllen me takimin e katërt publik, të dedikuar për VSM-në.

ç) Hartimi i raportit përfundimtar të vlerësimit strategjik mjedisor është realizuar në periudhën qershor – shtator 2016..

d) Shqyrtimi i propozimit dhe deklarata e Ministrit realizohet me dorëzimin e materialit përfundimtar tek autoritetet përgjegjëse.

dh) Vendimi i autoritetit miratues vjen pas shqyrtimit të materialit.

e) Monitorimi dhe raportimi i pasojave në mjedis të planit është një proces në vazhdim, i cili do të realizohet nga Bashkia dhe institucionet përgjegjëse për mjedisin, në

përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Planin e Veprimeve, pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

3.2 Kuadri ligjor

- Kuadri ligjor i VSM-së

Kuadri ligjor shqiptar i VSM-së përafrohet plotësisht me kuadrin ligjor ndërkombëtar. Më poshtë praqitet një përmbledhje e shkurtër e këtij kuadri i cili përfshin Ligjin Nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" dhe dy vendime të Këshillit të Ministrave që e kanë plotësuar atë në vitet e fundit.

Ligj Nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, nëpërmjet përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Ligji përcakton institucionet përgjegjëse dhe procedurat sipas të cilave kryhet vlerësimi strategjik mjedisor. Krahas procedurave, Ligji përcakton planet dhe programet që i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor ku përfshihet edhe hartimi i planeve vendore të planifikimit të territorit. Ky ligj është përafruar plotësisht me Direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara".

Në dy vitet e fundit, ligji i mësipërm është plotësuar nga dy VKM-të si vijojnë:

- *VKM-ja Nr. 507, datë 10.06.2015* "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"
- *VKM Nr. 219, datë 11.03.2015* "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"

Protokolli i VSM-së, Konventa Espoo-s (UNECE 1991): Në këtë kontekst, vlen të theksohet edhe rëndësia e Protokollit të VSM-së i hartuar dhe miratuar në Konventën e Espoo-s (UNECE 1991) i cili përcakton detyrimet e palëve për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të aktiviteteve të caktuara që në fazën e hershme të planifikimit të tyre. Ky dokument konsiderohet si një nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtrojnë kushtet e vlerësimeve strategjike.

3.3 Grumbullimi i informacionit dhe analizat e kryera

Për të kryer analizat mjedisore në kuadër të PPV-së dhe VSM-së janë mbledhur një sërë informacionesh, burimi i të cilave janë institucionet publike, studimet dhe raportet e ndryshme të hartuar nga profesionistë të fushës dhe matjet e drejtpërdrejta e vëzhgimet vizuale. Hapi i parë i këtij procesi ishte krijimi i formatit të inventarit të të dhënave që nevojiteshin dhe metodologjisë për grumbullimin e tyre.

Hapi i dytë ishte procesi i studimit (*desk review*) të materialeve (dokumente e raporte) ekzistuese dhe të dhënave e informacioneve që burojnë prej tyre. Informacionet e grumbulluara në këtë mënyrë, të kombinuara me faktet e dokumentuara gjatë vëzhgimit vizual, përbënë bazën parësore për plotësimin e inventarit mjedisor paraprak dhe hartimin e raportit fillestar të analizës mjedisore.

Hapi i tretë ishte realizimi i vëzhgimit të parë vizual për burimet dhe vlerat mjedisore në të gjithë territorin e Bashkisë. Për këtë qëllim u përgatitën harta itineraresh dhe

gjatë vëzhgimit vizual u mbajtën shënim informacionet, si dhe u dokumentua realiteti përmes fotografive.

Hapi i katërt ishte realizimi i takimeve me të gjitha institucionet, të cilave iu dërguan letra zyrtare, me qëllim marrjen e informacioni dhe konsultimit shkencor e profesional mbi temat përkatëse. Lista e institucioneve të kontaktuara jepet e detajuar në Shtojcën 1 të këtij dokumenti. Burimet kryesore publike të informacionit kanë qenë: Bashkia me të gjitha departamentet e saj, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura Fier, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Ministria e Bujqësisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, INSTAT-i, biznesi, Agjencia e Basenit Ujor të Semanit, Agjencia Kombëtare e Territorit, etj.

Në vijim (hapi i pestë) grupi i punës, ndërmori realizimin e analizave të ujërave të lumit Seman që përshkon Bashkinë Lushnje. Këto analiza u realizuan në një kontekst më të gjerë sa segmenti i lumit Seman në territorin e Bashkisë Lushnje, dhe u shtrinë në një sipërfaqe të konsiderueshme të pellgut të Semanit (Osum, Devoll, Seman, Gjanicë) dhe të Shkumbinit. Për këtë qëllim u morën kampione të ujërave në pika të caktuara të lumenjve. Pikat u përcaktuan mbi bazën e njohurisë për aktivitetin njerëzor e urban përgjatë lumenjve. Përmes këtyre analizave u realizua një përditësim të dhënash, dhe një këndvështrim i pavarur mbi gjendjen e ujërave. Për më tepër, këto analiza përfshinë edhe metalet e rënda, për të cilat mungon informacioni nga burimet publike.

3.4 Format e vlerësimit

Vlerësimi mjedisor është kryer për programet dhe projektet e PPV-së, të cilat u hartuan fillimisht në strategji, u rishikuan në planin e zhvillimit dhe u plotësuan më tej edhe gjatë hartimit të Planit të Investimeve Kapitale. Vlerësimi i tyre për ndikimin në mjedis bëhet në mënyrë cilësore dhe sipas rastit, edhe sasiore. Kriteret që përdoren për vlerësim bazohen në Shtojcën 1 të ligjit 91/2013, ku përcaktohen disa kritere ndihmëse për vlerësimin, si më poshtë:

1. **Cilësia e përbërësve të mjedisit** në zonën e ndikimit të mundshëm të planit apo programit të propozuar dhe **problemeve mjedisore ekzistuese** në këtë zonë.

2. **Ndikimet negative mjedisore që mund të rezultojnë** nga zbatimi i planit ose programit, duke konsideruar:

   a. **mundësinë e shfaqjes** së ndikimeve negative,

   b. **kohëzgjatjen** dhe **natyrën** e tyre;

   c. **mundësinë e riaftësimit** të gjendjes së mjedisit, si pasojë e ndaljes së ndikimeve negative në të (**kthyeshmëria ose pakthyeshmëria** e ndikimit në mjedis);

   d. **natyrën kumulative** të dikimeve;

   e. **natyrën ndërkufitare** të ndikimeve;

   f. **madhësinë dhe shtrirjen hapësinore** të ndikimeve negative;

   g. **pasojat e dëmshme** të tij në mjedis, për shkak të cilësive mjedisore ekzistuese.

3. Shkalla në të cilën plani ose programi mund të ketë **ndikim në zonat e mbrojtura, peizazh** apo **trashëgiminë kulturore e arkeologjike** të mbrojtur me ligj.

4. Shkalla e **përputhjes ose jo të planit** apo programit të propozuar **me objektivat kombëtarë e vendorë të mbrojtjes së mjedisit** dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në vend."

4 Analizë e përgjithshme mjedisore e Bashkisë Lushnje.

4.1 Kushtet gjeomorfologjike të territorit

- Pozicioni Gjeografik

Bashkia Lushnje bën pjesë në qarkun Fier dhe ka si qendër të saj qytetin e Lushnjes. Ajo kufizohet në veri me Bashkinë e Rrogozhinës, në verilindje me bashkinë e Peqinit, në lindje me bashkinë e Belshit, në juglindje me Bashkinë Ura Vajgurore, në jug me bashkinë e Roskovecit, në jugperëndim me bashkinë e Fierit dhe në perëndim me bashkinë e Divjakës. Bashkia ka një sipërfaqe prej 372.72 km² dhe ka në përbërje të saj 11 njësi administrative, të cilat janë: Lushnje, Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Golem, Dushk, Karbunarë, Ballakat, Fier-Shegan, Kolonjë dhe Krutje. Bashkia Lushnje ka një popullsi prej 84,921 banorë.

Nga pikëpamja e infrastrukturave rrugore të sotme, bashkia Lushnje vazhdon të mbajë një pozicion mjaft të favorshëm gjeografik dhe strategjik si për shkak të pozicionimit ndërmjet dy pikave më të rëndësishme portuale (Vlora dhe Durrësi), ashtu edhe për arsye se në këtë territor kalojnë Korridori VIII dhe Korridori i Kaltër, të cilët, së bashku me Korridorin Durrës-Nish, përbëjnë korridoret më të rëndësishme të Shqipërisë.


Me infrastrukturën ekzistuese qyteti i Lushnjes ka këto distanca nga pika kryesore në Shqipëri:

- 80 km nga aeroporti i Rinasit,
- 83 km nga Tirana,
- 49 km nga porti i Durrësit,
- 29.3 km nga qyteti i Fierit,
- 66 km nga porti i Vlorës,
- 66 km nga qyteti i Elbasanit,
- 40.5 km nga qyteti i Beratit.

- Relievi

Terreni i bashkisë Lushnje është kryesisht fushor, me kodra që shkojnë deri në 200 m lartësi mbi nivelin e detit në zonën verilindore dhe në zonën e Kolonjës. Zona fushore ka lëvizje të lartësisë nga 2.5 deri në 52 m mbi nivelin e detit dhe njihet për prodhimtarinë e madhe bujqësore. Kjo zonë bën pjesë në fushën e Myzeqesë dhe njihet për numrin e madh të serrave dhe rrjetin e pasur me kanale vaditëse. Fusha e Muzeqesë është ndër fushat më të mëdha në Republikën e Shqipërisë dhe në të njëjtën kohë ka edhe prodhimtarinë më të madhe. Emri i saj mendohet se vjen nga familja sundimtare e zonës, familja Muzakaj, e cila ka luajtur rol të rëndësishëm në historinë e vendit.

Figura 2. Harta e relievit dhe e hidrografisë së bashkisë së Lushnjes



Burimi: ASIG, 2015, Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

- Klima

Klima në këtë bashki, sipas klasifikimit Köppen-Geiger[2], i përket Csa[3] dhe njihet në përgjithësi me termin klimë mesdhetare. Tiparet karakteristike të kësaj klime janë: dimër i butë me reshje dhe verë e ngrohtë e thatë. Prania e trupave ujorë në këtë bashki sjell edhe zbutjen e klimës gjatë verës, kur lagështia e ajrit mund të jetë më e lartë. Ky efekt është edhe më i dallueshëm në zonat urbane, ku prezenca e një trupi ujor (lumë, liqen etj.) mundëson krijimin e një mikroklime me temperatura më të ulëta në krahasim me pjesën tjetër urbane.

Bashkia Lushnje ka rreth 2,500- 2,700 orë diell në vit[4]. Temperatura mesatare luhatet nga 15-16ºc. Në përgjithësi, nuk ka erëra me shpejtësi të madhe. Zona lindore e Bashkisë ka erëra me shpejtësi 1.5-2.0 m/s, ndërsa pjesa perëndimore ka erëra më të shpejta të cilat arrijnë shpejtësinë 2.6-3.0 m/s. Pjesa qendrore e Bashkisë ka erëra me shpejtësi 2.1- 2.5 m/s [5]. Reshjet janë të çrregullta në këtë bashki dhe variojnë mesatarisht nga 750-1,250 mm[6]në vit.


- Hidrografia

Territori i bashkisë Lushnje kufizohet nga rrjedhat e dy lumenjve kryesorë. Në veri të territorit kemi kalimin e lumit Shkumbin, ndërsa në juglindje, në kufirin me bashkitë Roskovec dhe Ura Vajgurore, kemi rrjedhën e lumit Seman. Përveç lumenjve kemi edhe disa rezervuare dhe liqene, si: rezervuari i Thanës, liqeni i Kasharajt, liqeni i Lushnjes. Ia vlen, gjithashtu, të përmendim edhe kanalet vaditëse, të cilat shtrihen përgjatë pjesës fushore. Ndër këto kanale mund të përmendim tri më të rëndësishmet, të cilat dalin nga rezervuari i Thanës: kanalin Emisar, kanalin përgjatë Semanit, si dhe kanalin që shkon drejt veriut përmes qytetit të Lushnjes. Për më tepër, në qytetin e Lushnjes kemi edhe rrjedhën e përroit të Lushnjes, i cili buron nga liqeni i Kasharajt. Ky përrua ka luajtur rol edhe si element i fortë i qytetit të Lushnjes, duke ndikuar në zhvillimin territorial të tij.

- Ujërat nëntokësore (Akuiferët**)**

Sipas hartës hidrogjeologjike të qarkut Fier[7], sipërfaqja më e madhe e territorit të bashkisë Lushnje është jo akuifer [8], shkëmbinj të cilët janë pa porozitetin e mjaftueshëm ndërkokrrizor apo çarje. Në përgjithësi, tek këto shkëmbinj mungojnë burimet ujore për furnizimin lokal me ujë të pijshëm. Zona jo akuifere e bashkisë përbëhet kryesisht nga: shkëmbinj të shkrifët sedimentarë të llojit argjilë, alevrolite, rërë; shkëmbinj kompakt sedimentarë të tipit alevrolite dhe argjilë e rrallë ranore, si edhe flish. Këta shkëmbinj janë më të përhapur në zonën jugore dhe pjesërisht në zonën qendrore të bashkisë. Në zonën perëndimore të bashkisë, kryesisht në zonën kodrinore, kemi akuifere me porozitet poro-çarje dhe ujëpërcjellshmëri mesatare- të ulët, si edhe me ujëpërcjellshmëri të ulët – shumë të ulët.

Figura 3. Analiza e mbivendosjes së hidrogjeologjisë dhe hidrografisë.



Burimi: SHGJSH; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Zonat me akuifere me porozitet poro-çarje dhe ujëpërcjellshmëri mesatare- të ulët përdoren për furnizim me ujë të pijshëm të komuniteteve të vogla. Shfrytëzimi i rezervave të këtyre akuifereve është në masën 60%. Deri në thellësi 300m ujërat nëntokësore janë të ëmbla, me fortësi mesatare deri të madhe, kurse më në thellësi ato kalojnë në të kripura.

- Boniteti i tokave

Bashkia e Lushnjes mbetet furnizuesi kryesor i vendit dhe i eksportit me produkte bujqësore. Me kategorinë e bujqësisë, mbizotëruese në përdorimin e tokës me 77 % të territorit të bashkisë, tokat bujqësore të Lushnjes karakterizohen nga cilësia e lartë e dheut dhe prodhueshmëria e lartë.

Pavarsisht mungesës së një informacioni të saktë mbi kategorinë e tokës sipas klasës së bonitetit të tokave (sipërfaqet), në bashkinë Lushnjes mbizotërojnë tokat me bonitet të lartë të kategorisë I-IV.

Megjithatë, sipërfaqe të ndryshme të tokës në bashkinë Lushnje janë ***toka të kripura***, moçalore ose aluvionale. Vetëm në fshatin Plug në Nja-në Golem, për shembull, sipërfaqja e tokave të kripura arrin në 12.17 ha. Kjo sipërfaqe do të ishte shumë herë

më e madhe në rast se do të gjendeshin të dhënat rreth tokave të kripura në rang bashkie

- Analiza e burimeve natyrore

Gjeomonumentet janë zona natyrore që paraqesin interes të veçantë përsa i përket mënyrës si janë krijuar, rrallësisë, vlerave historiko- kulturore ose funksionit të tyre si pika interesi. Për nga rëndësia, gjeomonumentet ndahen në[9]:

- Gjeomonumente me vlera ndërkombëtare
- Gjeomonumente me vlera kombëtare
- Gjeomonumente me vlera rajonale

Në Bashkinë e Lushnjes ndodhen dy gjeomonumente. Gjeomonument me rëndësi kombëtare është Prerja në Ardenicë, i cili është një pus (shpim) strukturor në skajin verior të monoklinalit Patos-Marinzë-Ardenicë, paksa në jug të Manastirit të Ardenicës, në formacionet mollasike të Ultësirës Pranë- Adriatike. Prerja e përshkuar nga ky pus strukturor 6,700 m i thellë është: 0-1,040 m pliocen; 1,040-3,480 m tortonian-mesinian; 2,480-4,330 m brudigalian-akuitanian; 4,330-5,670 m flishi i oligocenit dhe 5,670-6,700 m tortonian. Pusi ka vlera shkencore gjeologjike.

Gjithashtu, në këtë bashki kemi edhe gjeomonumentin me vlera rajonale të Burimit Termal të Karbunarës. Ai ndodhet në pjesën lindore të fshatit Karbunarë, në lartësinë 50 m mbi nivelin e detit dhe rreth 10 m mbi shtratin e përroit që vjen nga Karbunara e Vogël. Ka 4-5 burime në rrëzën e shpatit jugor të një kodrine të vogël, por dy janë më të rëndësishmet. Uji ka përmbajtje gazi sulfhidrik dhe era e tij ndihet dhjetëra metra larg burimeve. Banorët kanë krijuar dy gropa me diametër rreth 6 m dhe thellësi 30 cm, ku futen për kurimin e sëmundjeve të lëkurës. Efekti i ujit është më i madh nëse e lyen trupin me baltën që gjendet brenda pellgut[10].

- Elementet e forta në territor

Territori përbëhet nga shumë pjesë të ndryshme të cilat ushtrojnë ndikim te njëri-tjetri. Pjesët apo elementet të cilat ndikojnë më shumë, apo kanë veçori më spikatëse mund të konsiderohen si elemente të forta në territor. Këto elemente mund të ndikojnë në formimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të vendbanimeve. Ato mund të shfaqen në forma apo situata që favorizojnë, por edhe kundërshtojnë/ pengojnë zhvillimin, duke realizuar kështu ndikimin e tyre në territor. Shtrirja e tyre fizike dhe ndikimi i tyre në territor mund të jetë pikësor/qendror, por edhe sipërfaqësor në formën e fashave të ndikimit. Elemente të tilla mund të jenë natyrore, por edhe artificialisht të krijuara nga njeriu. Bashkia e Lushnjes ka shumë elemente si natyrore, ashtu edhe artificiale, të cilat paraqesin potenciale në territor.

Elementet e forta natyrore në bashki kanë të bëjnë me topografinë dhe pasuritë e shumta ujore që ka kjo bashki. Ndër më kryesoret janë:

1. Fusha e Myzeqesë, e njohur në të gjithë Shqipërinë si zona më pjellore, mund të jetë edhe elementi më i rëndësishëm qytet-formues për shkak të vetive të mira për rritjen e produkteve bujqësore.
2. Zona kodrinore që shtrihet në verilindje të bashkisë, ku majat më të larta janë M. e Shkujkës (282 m) dhe M e Murtasajit (298 m). Zona kodrinore është element i fortë, pasi ka ndikuar në shtrirjen e vendbanimeve, por edhe sepse ka

zona pyjore të paprekura, të cilat paraqesin potencial për zhvillim të mëtejshëm.

3. Pasuria ujore përbën një element me rëndësi për lehtësimin e zhvillimit të vendbanimeve. Këtu kemi disa elemente që spikasin, si: rezervuari i Thanës, lumi Seman, kanali Emisar, përroi i Lushnjes, liqeni i Kasharaj. Të gjitha këto pasuri ujore kanë ndikim të vazdueshëm në territor duke tërhequr vazhdimisht aktivitetin njerëzor.
4. Monumentet natyrore janë elemente të forta pikësore, të cilat paraqesin potencial për zhvillim të mëtejshëm. Të tilla janë: burimi termal në Karbunarë, Dushkajat dhe Selvitë në Manastirin e Ardenicës.

Elementet artificiale janë po aq të rëndësishme në mënyrën e ndikimit në territor, sa edhe elementet natyrore. Ato janë krijuar nga veprimtaria njerëzore dhe mbartin edhe pjesën e identitetit kulturor dhe historik të zonës. Ndër to përmendim:

1. Monumenti Manastiri i Ardenicës. Vlerat e tij nuk janë vetëm arkitektonike apo fetare, por gjithashtu tregojnë për vazhdimësinë e jetës në territor, si edhe për rëndësinë historike dhe zhvillimin e hershëm të bashkisë Lushnje.
2. Zona ekonomike në zonën Lushnje- Karbunarë. Këtu kemi alokimin e industrive më të rëndësishme në bashki, por pozicioni i favorshëm ndërmjet Lushnjes dhe Karbunarës gjithashtu lejon shtimin e industrive të tjera në të ardhmen. Më parë në këtë zonë ndodhej ish-fabrika e plastmasit dhe ajo e tullave, por me zhvillimin e bujqësisë në bashki pritet të zhvillohen industritë e lehta që fokusohen kryesisht në përpunimin e ushqimeve.
3. Stacioni i trenit në Lushnje përbën një element me shumë rëndësi, pasi pozicioni i tij është i favorshëm duke u bërë një pol i rëndësishëm i transportit. Ai mbledh gjithë flukset e ndryshme të transportit dhe mund të zhvillohet në një stacion multi-modal sipas standardeve. Megjithatë, vendndodhja e tij mund të paraqesë edhe problem, pasi mund të shkaktojë izolimin e zonave urbane në pjesën perëndimore të Lushnjes, që janë më së shumti zona banimi të ndërtuara rishtaz me karakter urban/bujqësor.
4. Tregu në Fier-Shegan dhe tregu në Lushnje përbëjnë pika me potencial zhvillimi për shkak të zhvillimit bujqësor dhe kalimit të flukseve tregtare në këto zona.
5. Serrat janë një element i përhapur në të gjithë territorin e bashkisë Lushnje. Kemi rreth 2,610 serra diellore me një sipërfaqe prej 363 ha, duke regjistruar kështu numrin më të madh të serrave në vend në rang bashkie. Aktiviteti prodhues i tyre lidhet kryesisht me kultivimin e domateve dhe perimeve dhe një pjesë e madhe me kultivimin e luleshtrydheve, të cilat, për nga pikëpamja e eksportit, kanë edhe kërkesën më të lartë.

4.2 Analiza gjeologo-inxhinierike

Relievi i larmishëm i vendit tonë me njësi fushore, kodrinore dhe malore krijon një peizazh natyror tërheqës dhe njëkohësisht, edhe të prirur ndaj rreziqeve natyrore për vetë përbërjen e tij. Si rezultat, në varësi të relievit, territori në vend dallohet për nivele të ndryshme qëndrueshmërie. Përveç një sipërfaqeje të qëndrueshme e cila zë rreth 10% të territorit kombëtar, pjesa tjetër e tokës është e paqëndrueshme. Kjo e

fundit shprehet nëpërmjet formave të ndryshme që SHGJSH-ja i ka klasifikuar si më poshtë[11]:

1. *Rënie shkëmbinjsh* (kryesisht në zona malore (në Alpeve) dhe shpate gëlqerorë të zbuluara
2. *Shembje* (kryesisht në zonat malore)
3. *Rrëshqitje me rrokullisje* (në shpate me shkëmbinj rreshporë ose molasë deltinore dhe shpatet prej konglomerati me pjerrësi > 45˚ si dhe shpateve me drejtim të kundërt).
4. *Rrëshqitje me zhvendosje* (prek shkëmbinjtë e fortë gëlqerorë ose shtresa rreshpore)
5. *Rrjedhje, sidomos ato sipërfaqësore, në trajtën e laharëve* (në zonat malore të Shqipërisë me reshje vjetore 200 mm, luginat me përrenj me pjerrësi të madhe (Elbasan, Përmet, Korcë etj.)

Duke u bazuar në karakteristikat e territorit lidhur me fenomenet e rrezikut gjeomorfologjik, SHGJSH-ja ka përcaktuar zonimin gjeoteknik të Shqipërisë, sipas të cilit territori i vendit tonë ndahet në tre zona të qëndrueshmërisë natyrore[12]:

- *Terrene të qëndrueshme,* që mbulojnë 56.6% të vendit, gjenden kryesisht në zona me shkëmbinj magmatikë efuzivë dhe intruzivë, gëlqerorë të epokave të ndryshme, dolomite, brecke dhe konglomerate me cimentin karbonatik, shkëmbinj metamorfikë dhe rreshpe. Brenda zonës njihen fenomenet e shkëputjes së blloqeve, rrëshqitjes e rrokullisje dhe/ose zhvendosjes.
- *Terrene relativisht të qëndrueshme*, që mbulojnë rreth 33.6% të territorit, gjenden kryesisht në zona me përbërje shkëmbore konglomeratikë të suitës Luma, efuzivë sedimentarë, shkëmbinjve rreshporë, shkëmbinjëve evaporitë dhe molasave të konglomerateve ranore. Këto zona dallohen për rrëshqitje, ose rënie të tavaneve në zgavrat e nëndheshme.
- *Terrene të paqëndrueshme,* që zënë rrreth 9.8% të sipërfaqes së vendit, janë terrene me përbërje të ndryshme shistesh, molasash e konglomeratësh ranore. Dallohen për rrëshqitjet rrokullisëse dhe me zhvendosje, si dhe për rrjedhjet e tokës.

4.3 Ajri

Ndotja e ajrit mbetet problem serioz në Shqipëri për shkak të rritjes së theksuar të numrit të makinave, numrit të mjeteve të vjetra të transportit, rritjes së trafikut në zonat urbane dhe ritmeve të shpejta të urbanizimit[13]. Ky i fundit ka çuar në një zhvillim me ritme tejet të shpejta edhe të sektorit të ndërtimeve dhe përkeqësimit të kushteve të rrugëve brenda zonave urbane.

Të dhënat rreth cilësisë së ajrit në Qytetin e Lushnjes mungojnë. Megjithatë, për arsyet e mësipërme, mendohet se të paktën në qytet, në afërsi të zonave me fluks trafiku të lartë, cilësia e ajrit ndryshon (përkeqësohet) nga ajo e zonave rurale, ku cilësia e ajrit është e mirë. Edhe pse nuk njihet përmbajtja e gazrave ndotës në ajër, është e mundur të arrihet një vlerësim i përafërt i rreziqeve që i shkaktohen shëndetit të njeriut nëpërmjet ndotjes së ajrit nga disa sektorë, veçanërisht ai i transportit.

Marrë si reference të dhënat nga Raporti i Gjendjes në Mjedis për Shqipërinë dhe veçanërisht RGJM-Fier 2015 të cilat tregojnë se ka tejkalim të normave të elementëve

ndotës në ajër, mund të themi se faktor në këtë situatë, krahas shkarkimeve në atmosferë nga industritë, mjetet e transportit publik dhe privat si dhe nga ndërhyrjet infrastrukturore, është edhe mungesa e gjelbërimit dhe hapsirave për rekreacion të cilat kryejnë, ndër të tjera, edhe funksionin e filtrimit të ajrit të ndotur dhe prodhimin e sasive të vogla të O_2 me rëndësi në cilësinë e ajrit në qëndrat urbane.

4.4 Pyjet dhe kullotat

Në vitin 206, fondi pyjor dhe kullosor kaloi në pronësi të Bashkisë Elbasan, me përjashtim të sipërfaqes së fondit pyjor e kullosor që është pjesë e territorit të zonave të mbrojtura (VKM nr. 433, datë 8/6/2016 "Për transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë").

Sot, Bashkia Lushnje ka në pronësi të saj 485.62ha sipërfaqe pyjore, 99.50ha tokë djerr dhe 198.50ha sipërfaqe me bimë pyjore. Sipërfaqe të konsiderueshmë zënë tokat improduktive dhe ato djerr, përkatësisht 5,094.48ha dhe 139,46ha.


Sipas të dhënave për shpërndarjen e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në territorin e NJA-ve të Bashkisë Lushnje, dallohet qartë që NJA-të me sipërfaqe më të madhë të fondit pyjor janë Karbunara e cila ka një sipërfaqe prej 153.57 ha dhe Golem me 96ha e ndjekur nga NJA-të Hysgjokaj, Ballagat dhe Allkaj. Duke analizuar me kujdes të dhënat vihet re që zona djerr me sipërfaqën më të madhe ndodhet në NJA-të Karbunarë dhe Ballagat (51.5 dhe 48 ha).

4.5 Peizazhi

Peizazhi është gjithçka që duket në territor mbi sipërfaqen e tokës dhe mund të studiohet në drejtimin estetik dhe dejtimin funksional që lidhet me shërbimet e ekosistemit. Të dyja këto drejtime janë të lidhura ngushtë me njëra-tjerën dhe në fakt, aspekti funksional ndikon atë estetik. Në territorin e Bashkisë Lushnje peizazhi ndahet në pesë fasha (tipologji) kryesore: ***urbane, industriale, rurale, natyrore*** dhe ***ujore.***

Krijimi i fashave peizazhistike në territorin e Bashkisë lidhet ngushtë me formacionet territoriale, hidrogjeologjinë dhe hidrografinë, si dhe pjerrësitë e terrenit. Megjithëse këta komponentë kanë tipologji të ndryshme nga njeri-tjetri dhe gjenden në zona të ndryshme të territorit, parë në shkallë peizazhi ata përbëjnë një të vetëm, duke ofruar shumëllojshmëri peizazhistike brenda kufirit bashkiak.

Figura 4. Harta e tipologjive të peizazhit dhe fondi pyjor.



Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Lushnje, Përpunoi Co-PLAN, 2016

Në këtë larmishmëri peizazhistike dallohet ***fasha natyrore,*** e cila është edhe fasha më e ndërlikuar në matricën peizazhistike. Kjo fashë karakterizohet nga sipërfaqe pyjore, fusha të hapura, korridore të gjelbëra apo ujore, zona tampon, zona ripariane, zemra e habitatit, ngastra, si dhe mozaikë. Po në këtë fashë përfshihet edhe sipërfaqja më e madhe e fondit pyjor dhe zonat e mbrojtura natyrore brenda territorit të Bashkisë. Gjithashtu lehtësisht e dallueshme është edhe ***fasha rurale*** e cila karakterizohet nga toka bujqësore, toka të hapura të pozicionuara në mënyrë "informale", grupime pemësh/shkurresh, pemë të mbjella në rresht (vijë tampon) të cilat herë duken të mbjella nga njeriu e herë vetvetiu nga natyra, trupa ujorë (lumenj, kanale, rezervuare, etj.).

Ndonëse një fashë komplekse dhe me diversitet të larmishëm biologjik, për shkak të zhvillimit njerëzor në tërësi dhe bujqësor në veçanti, fasha natyrore shfaqet e fragmentuar në tërësinë e vet.

Tipologji tjetër peizazh-krijuese në Bashkinë Lushnje është ***fasha/njolla urbane*** ku peizazhi shpaloset në zona banimi dhe shërbimesh me një karakter ***formal***. Këtu, peizazhi karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore, pemë apo grupime pemësh zbukuruese, parqe si dhe zona tampon.

Peizazhi industrial shfaqet i pa ndashëm nga fasha urbane, me përjashtim të pjesës qëndrore të territorit, specifikisht në Njësinë Administrative Lushnje(Sipërfaqe të vogla ish-industriale). Ky peizazh ka po ashtu karakter "***formal",*** ndonëse bimësia është më e rallë. Po ashtu, në krasitjen e paraqitjen e tyre i përkushtohet rëndësi dekorimit, më tepër se sa funksionit dhe shërbimit mjedisor. Si në rastin e pemëve në peizazhin urban, edhe këtu ato preferohen të jenë vendase dhe me kurorë të gjerë për të hijëzuar hapësira parkimi, apo publike.

Fasha e fundit është ajo e ***sipërfaqeve ujore***, e cila karakterizohet nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë, duke përfshirë lumenjtë, rezervuaret, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale. Peizazhi ujor dominohet nga lumi Seman, Shkumbin e degët e tyre dhe rezervuarët në të gjithë territorin e Bashkisë.

4.6 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese të cilat manaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore[14].

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ofrojnë. Këto zona mbrohen me ligj[15] dhe zënë rreth 16%[16] të territorit të vendit.

Një territor i caktuar duhet të plotësojë të paktën një nga këto kritere:[17] i) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve, ii) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve, iii) të ketë përfaqësueshmëri, iv) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit, v) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet, vi) të ketë vlera shkencore; vii) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme, viii) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike, ix) të mos rrezikohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore, dhe x) të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

- Zonat e mbrojtura në territorin e Bashkisë Lushnje

Territori i Bashkisë Lushnje shtrihet në reliev kryesisht fushor me kodra të buta deri në *250 mmnd* dhe ka një klimë tipike mesdhetare, me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër të butë e me reshje.[18] Në territorin e Bashkisë, krahas bimëve të kultivuara, të cilat zënë përqindje të lartë, ka një numër të madh llojesh të faunës dhe florës. Brenda territorit të bashkisë ndodhen 5 monumente natyrore të mbrojtura, të cilat do të trajtohen gjerësisht në vijim.

Për sa i përket manaxhimit të monumenteve të natyrës, në territorin e Bashkisë Lushnje nuk ka të përcaktuar punonjës të AdZM-së Fier që merren me manaxhimin dhe monitorimin e tyre.[19] Në shkallë rrethi, në Lushnje janë 3 specialistë manaxhimi dhe 7 roje mjedisore, kryesisht në Parkun kombëtar Divjakë – Karavasta. Aktualisht nuk ka një plan manaxhimi për monumentet e natyrës, edhe pse vazhdimisht kryhet monitorimi i gjendjes së tyre dhe merren masa për përmirësimin dhe mbrojtjen e cilësisë së tyre. Duhet shtuar se edhe Bashkia e Lushnjes ka përgjegjësi për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit në territorin e saj. Prandaj lind nevoja që në të ardhmen, Bashkia të bashkëpunojë me AdZM-në Fier për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.[20]

4.7 Biodiversiteti

Sipas Ligjit nr. 9587/2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit", me biodiversitet ose larmi biologjike nënkuptojmë shumëllojshmërinë e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë[21]. Ky term përfshin shumëllojshmërinë brenda dhe ndërmjet llojeve dhe shumëllojshmërinë e ekosistemeve.

Shqipëria është një vend i vogël. Megjithatë, ajo dallohet për larmi të peizazheve dhe larmi biologjike[22], duke u radhitur në vendet e Europës që shquhen për biodiversitet të lartë. Pjesa e Ultësirës Perëndimore është më e rëndësishme nga pikëpamja e biodiversitetit dhe larmishmërisë së tij, e cila shtrihet përgjatë zonës bregdetare nga qyteti i Vlorës në jug e deri tek liqeni i Shkodrës në veri. Përveç faktit që kjo është një zonë bregdetare, Ultësira përshkohet nga lumenjtë kryesorë të vendit të cilët rrjedhin nga lindja në perëndim. Vija bregdetare arrin gjatësinë 476km.[23] Zona veriore e vendit ka një reliev malor, ku karakterizohet nga diversitet i formacioneve shkëmborë, që nga koha e Paleozoikut. Klima në Shqipëri përbëhet nga katër zona klimatike dhe 13 nënzona, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në biodiversitetin e pasur që ka vendi.[24]

Shqipëria ka një shumëllojshmëri të ekosistemeve dhe habitateve. Në territorin e vendit gjenden ekosistemet detare, zonat bregdetare, lumenjtë, liqenet, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyjet halorë dhe fletore, kullotat alpine dhe subalpine, si dhe ekosistemet e larta malore. Larmia e ekosistemeve dhe habitateve në Shqipëri mundëson një larmi të lartë të llojeve të kafshëve dhe të bimëve që rriten në to. Në Shqipëri gjenden rreth ***7,233 taksone bimore***[25] (bashkë me fiernat, likenet, kërpudhat, myshqet dhe algat) dhe ***5,438 lloje kafshësh***[26] (përfshirë shpendë gjitarët, zvarranikët, insektet, peshqit, etj.). Pyjet zënë rreth 33% të territorit, ose 1,041,000 ha, ndërsa *kullotat* zënë rreth 15% të sipërfaqes së territorit (400,000 ha). Pyjet dhe kullotat kanë një larmi të llojeve dhe komuniteteve shtazore dhe atyre bimore.[27] Pyjet e larta strehojnë kryesisht gjitarët e mëdhenj si ujku, rrëqebulli, ariu, dhia e egër, si dhe shpendë të ndryshëm të cilët janë të lidhur me jetesën në pyjet e virgjëra. *Liqenet*

e mëdha të vendit dhe lagunat bregdetare janë vendbanimet më të rëndësishme për shpendët, veçanërisht për dimërimin e atyre migratorë. Në këto hapësira, prej vitesh numërohen rreth 70 lloje shpendësh uji, të cilët përbëjnë një popullsi që arrin deri në 180,000 individë gjatë dimrit.[28] Shqipëria është edhe një kryqëzim i rrugëve të rëndësishme për shpendët migratore dhe insektet.[29]

- Biodiversiteti në Bashkinë Lushnje

Bashkia Lushnje ndodhet në Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 372.72 km^2. Relievi është kryesisht fushor me zona të kufizuara kodrinore të pozicionuara në verilindje të bashkisë në lartësi 200-240 mbi nivelin e detit. Sistemi natyror në Bashkinë Lushnje që shërben si habitat për biodiversitetin zë 1/10 e sipërfaqes totale të kësaj Bashkie. Sistemet natyrore shtrihen kryesisht në lindje, në pjesën kodrinore të saj. Bashkia ka një sipërfaqe pyjore në pronësi me rreth 822.62 ha, e cila shërben si habitati kryesor për biodiversitetin.

Në Bashkinë Lushnje, numri i specieve floristike dhe faunistike që rriten në territor nuk njihet. Megjithatë, njihet me përafërsi numri i specieve të rrezikuara. Sipas Librit të Kuq të florës së Shqipërisë, në territorin e Bashkisë gjenden 55 specie të rrezikuara dhe i përkasin kryesisht familjes së fluturave dhe shpendëve. Ndër to dallohen Asteri Shqiptar *(Aster Albanicus)* dhe Salepi Shqiptar *(Orchis Albanica* që janë individë shumë të rrallë. Kryesisht, rreziku i humbjes së specieve vjen si rrjedhojë e aktiviteteve antropogjene ,gjë që ka çuar në humbjen e habitateve.

4.8 Përdorimi i tokës[30]

Nga dixhitalizimi i kryer në kuadër të përgatitjes së PPV-së,[31] kategoria mbizotëruese e përdorimit të tokës është ajo ***bujqësore*** e cila zë rreth 77 % të territorit të bashkisë, ose 289 km^2.

Zë i rëndësishëm në këtë analizë janë ***zonat natyrore*** me një sipërfaqe prej 43.7 km^2. Këto zona shtrihen përgjatë zonës kodrinore të Bashkisë Lushnje, në pjesën veriperëndimore të saj dhe karakterizohen nga zona me shkurre të dendura.

Kategoria ***banim*** renditet e katërta për nga sipërfaqja totale që zë në territor, me vetëm rreth 22 km^2, përfshirë këtu dhe kategoritë e përziera. Karakteristikë e zonave të banuara për Bashkinë Lushnje është shpërndarja e tyre në territor, kryesisht në zonën rurale, ku shpeshherë kanë fragmentarizuar tokën bujqësore. Gjendja duket më e konsoliduar në zonat urbane, ku dhe dendësia e banimit është më e lartë.

Zonat e ***shërbimit, argëtimit*** dhe ***institucionet*** gjenden përgjithësisht në qytetin e Lushnjes, në pjesën qendrore të tij, pranë arterieve kryesore të rrugëve. Objektet arsimore dhe shëndetësore janë shpërndarë thuajse në çdo zonë të banuar të bashkisë, duke ofruar në të njëjtën kohë një mbulim të mirë me këto shërbime[32].

4.9 Toka Bujqësore dhe bujqësia

Territori i Bashkisë së Lushnjes është pjesë e ultësirës së Myzeqesë dhe ka rreth 289 km^2 tokë bujqësore.[3] Toka bujqësore[33] shfrytëzohet për prodhimin e drithërave, kryesisht grurë, misër dhe tërshërë, prodhimin e perimeve, patateve, fasuleve dhe foragjerëve, së bashku me drurët frutorë (pemët, ullinjtë, agrumet dhe vreshtat). Për nga sipërfaqja, në Bashki, foragjeret, gruri dhe ullinjtë zënë sipërfaqen më të madhe të territorit me përkatësisht 1,747 ha, 580 ha dhe 506 ha.

Në Bashkinë e Lushnjes banorët merren edhe me rritjen e gjësë së gjallë kryesisht lopë, dele dhe dhi. Për nga numri, lopët zënë vendin e parë me 1,005 krerë, të ndjekura nga dhitë me 450 krerë dhe delet me 430 krerë.

Bujqësia është mjaft e rëndësishme për pothuajse të gjithë territorin me përjashtim të zonës urbane (qytetit). Sipas klasifikimit të Censusit 2011, Bashkia e Lushnjes ka qytetin e Lushnjes si qendër rajonale, 6 njësi administrative (Nja) bujqësore fushore (Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Karbunarë, Ballagat) dhe 4 njësi administrative kodrinore (Golem, Dushk, Ballagat Hysgjokaj, Fiershegan)[34]të cilat mbajnë peshën kryesore të zhvillimit të bujqësisë në zonën e bashkisë.

Tokat bujqësore të Lushnjes karakterizohen nga cilësia e lartë e dheut dhe prodhueshmëria e lartë. Këtë e tregon edhe boniteti i tokave. Pothuajse të gjitha tokat e bashkisë bëjnë pjesë në kategorinë I-III me përjashtim të tokave të fshatrave Kupas e Mollas tokat të cilat klasifikohen si të kategorisë IV.[35] Produktet më të kultivuara janë perimet dhe frutat, të cilat kultivohen kryesisht në pjesën jug-perëndimore. Zona verilindore zihet kryesisht nga ullishtat dhe vreshtat. Bashkia e Lushnjes mbart edhe numrin më të madh të serave bujqësore në vende të shtrira në të gjithë territorin e bashkisë dhe kategorizohen si pjesë e përdorimit bujqësor të tokës.

4.10 Furnizimi me ujë

Aktualisht, sektori i furnizimit me ujë dhe i kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane operon nëpërmjet shoqërisë aksionere rajonale UK Lushnje sh.a., e cila ofron shërbimin në bashkinë Lushnje dhe Nja-të Kolonjë, Allkaj, Fier-Shegan, Bubullimë, Dushk dhe Krutje. Kjo ndërmarrje është duke ndjekur procesin e tranzicionit të sektorit sipas reformës territoriale, ku më parë shërbimi ofrohej nga dy shoqëri simotra UK Lushnje sh.a dhe UK Lushnje Fshat, e megjithatë Nja-të Karbunarë, Ballagat, Hysgjokaj e Golem konsideroheshin si "zona të bardha" në të cilat sistemi i furnizimit me ujë për konsum publik administrohet nga stafi i ish-komunës, ose kemi mungesë të infrastrukturës.

Bashkia Lushnje siguron furnizimin e popullatës me ujë për konsum publik nga akuiferi i Lushnjes, ku rreth 12km në veriperëndim të qytetit ndodhen 7 pusshpime të ujit të pijshëm, të cilat pompojnë ujin nga një thellësi prej 25m nëpërmjet pompave zhytëse. Nga këto stacione pompimi (St.P) vetëm 6 janë aktualisht në gjendje pune që nga rehabilitimi i fundit i realizuar në 2009 nga KfW-ja. Kapaciteti i këtyre pompave vlerësohet se është 750m^3/orë[36]. Klorinimi ndodh në këtë St.P, i cili injektohet direkt në rrjetin e transmetimit.

Një burim tjetër i cili furnizon bashkinë Lushnje është edhe ujëmbledhësi i Çermës, i pozicionuar 15km në veriperëndim të qytetit. Ky akuifer shfrytëzohet nëpërmjet 5 puseve të thella rreth 50m e, megjithëse një St.P relativisht i ri, i ndërtuar në 1990, gjendja e tij paraqitet mjaft e amortizuar, ku edhe cilësia e ujit të prodhuar mendohet të jetë e ndikuar nga kjo gjendje.

4.11 Ujërat e ndotura

Shërbimi i grumbullimit dhe kanalizimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet vetëm në qytetin e Lushnjes dhe thuajse aspak në Nja-të e saj. Shërbimi i orfuar është në nivele të pakënaqshme, kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar si pasojë e vjetërsisë së tij, si edhe konstruksionittë tubove material betoni ku lidhja midis seksioneve është kryer me llaç. Ky sistem është i kombinuar dhe mbledh si shkarkimet e ujërave të ndotura, ashtu

edhe ujërat e larta. Nuk ofrohet asnjë nivel trajtimi i këtyre ujërave dhe shkarkimet ndodhin mbi trupat ujorë sipërfaqësorë më të afërt.

Kompozimi i këtij sistemi për grumbullimin e ujërave të ndotura urbane është i tillë që njëkohësisht ai grumbullon ujërat e larta, si edhe shkarkimete ndryshme e të pakontrolluara që ndodhin në kolektorë, apo kanalet e hapura dedikuar këtij sistemi.

Zonat urbane: Sot, bashkia Lushnje mbulon me shërbimin e kanalizimit të ujërave të ndotura vetëm një pjesë të popullsisë së qytetit të Lushnjes, por nuk disponohet një shifër përmbledhëse e saktë si pasojë e mungesës së dixhitalizimit të rrjetit të kanalizimeve në këtë bashki.

Zonat rurale: Në zonën rurale tëbashkisë Lushnje nuk ekziston ndonjë sistem i organizuar inxhinierik për mbledhjen dhe largimin e ujërave të ndotura.

4.12 Mbetjet e ngurta

Bashkia e Lushnje ofron shërbimin e manaxhimit të mbetjeve të ngurta për 86%[37] të popullsisë së Bashkisë Lushnje (Nj.A Allkaj, Bubullimë, Krutje). Me manaxhim të mbetjeve nënkuptohet grumbullimi i mbetjeve të ngurta nga pikat e grumbullimit të mbetjeve të shpërndara në funksion të dendësisë së popullatës dhe të aktiviteteve private e shtetërore dhe, transportimi i tyre drejt vend-depozitimit si edhe stokimi i tyre përfundimtar.

Shërbimi i manaxhimit të mbetjeve nuk ofrohet rregullisht në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Lushnje. Shërbimi i mbetjeve në qytetin e Lushnjes ofrohet në rreth 86 % të territorit të saj, në të cilin janë shpërndarë 296 kontenierë, nga kompania private "Leal", e kontraktuar nga Bashkia Lushnje me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.19 Dt. 09/03/201610 Nj.A për 10 muaj. Firma private kryen grumbullimin dhe transportin e mbetjeve për në vend-depozitimin e qytetit, që ndodhet në Lagjen "18 Tetori", shumë pranë zonave të banuara dhe rrugës kombëtare Lushnje-Fier. Ky vend-depozitim është jashtë kushteve higjieno-sanitare dhe i tejmbushur me mbetje. Bashkia Lushnje ka hartuar një plan të manaxhimit të mbetjeve, ku po rishikohet dhe një herë mundësia e ngritjes së një landfilli dhe e sistemimit të pikave të grumbullimit. Sa i përket aspektit financiar, për ofrimin e këtij shërbimi Bashkia Lushnje aplikon tarifën e pastrimit, e cila mblidhet së bashku me taksat e tjera vendore.

4.13 Ndyshimet Klimatike dhe rreziqet

Në vendet e Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, pasojat e ndryshimeve klimatike do të shprehen në forma të ndryshme si:

- rritja e temperaturës me 1.7 – 3.5^{o}C deri në vitin 2100,
- ulja e sasisë së reshjeve dhe ndryshimi i regjimit të tyre (-3.84 deri në -18.13% deri në vitin 2100)[38].

Këto fenomene parashikohet të kenë pasoja të theksuara në zhvillimin e rajonit sepse kanë mundësi të shkaktojnë ngritjen e nivelit të detit duke krijuar erozion detar, përmbytje, pakësim të ujërave nëpër lumenj e liqene gjatë vitit dhe përmbytje në periudha të caktuara për shkak të shtimit të reshjeve me intensitet të lartë, të ndryshimeve në stinën e kultivimit në bujqësi, ndryshimeve të habitateve, paksimit të numrit dhe llojeve të specieve, shtimit të llojeve të huaja invazive së bashku me rritjen e sëmundjeve infektive.[39]

Gjithashtu, probleme të shumta do të hasen në komunitetet lokale dhe ato rajonale që varen nga shërbimet që ofron ekosistemi, uji i pijshëm, karburanti, materialet për ndërtim dhe të korrat, të gjitha së bashku do të kenë një ndikim të madh në mbajtjen e kushteve optimale të jetesës. Është fakt i rëndësishëm që disa rajone të Europës Juglindore shtrihen në fushën e Europës që është zonë më e ndjeshme nga ndryshimet klimatike. Ndër pasojat më të theksuara të ndryshimeve klimatike, që parashikohet të ndodhin në rajon, renditen më poshtë:[40]

- mungesa e ujit të pastër për shkak të uljes të sasisë së reshjeve dhe rritjes së temperaturave.
- në zonat malore ku rritja e temperatures do të shkaktojë shkrirjen e shpejtë të akujve dhe debores parashikohet fryrja e rrjedhave të lumit dhe ndikimet zinxhir që rrjedhin.
- zonat bregdetare do të përballen me pasojat që vijnë nga rritja e nivelit të detit kombinuar me rritjen e rrezikut nga fenomene klimatike si stuhitë apo reshjet intensive.

4.14 Zonat e nxehta mjedisore dhe aktiviteti industrial

Kryesisht, në Republikën e Shqipërisë ndotjet më të mëdha janë trashëguar nga aktiviteti industrial i cili u zhvillua gjatë dekadave kur vendi udhëhiqej nga politikat e sistemit komunist. Të gjitha industritë e asaj kohe gjeneruan mjaftueshëm mbetje të cilat qëndruan të stokuara në nivele primitive të sigurisë teknike. Në vitin 1990, industria kontribuonte në më shumë se 37% të GDP-së në vënd. Ky indikator u ul në 12% në vitet 1999 ku edhe sot karakterizohet nga ulje-ngritje të cilat janë kryesisht produkt i politikave të paqëndrueshme të miratuara e të shfuqizuara në vendin tonë.

Problematikat lidhur me këto zona filluan të evidentoheshin me shkatërrimin e këtyre industrive dhe lënien pa mirëmbajtje e kontroll të këtyre depozitave të kimikateve dhe elementëve ndotës në mjedis, me afrimin e zonës urbane me ato industriale, gjithashtu edhe me papërgjegjshmërinë e individit, që e komplikuan mjaftueshëm situatën e këtyre vatrave.

Konkretisht në Bashkinë Lushnje industria ka qënë mjaft aktive kohë më parë, e fokusuar në sektorin e prodhimit dhe përpunimit të plasmasës, e magazinimit të pesticideve të përdorura gjerësisht në bujqësi etj. Në Lushnje janë evidentuar tre pika të nxehta lidhur me rrezikun potencial që shfaqin mbetjet industriale, ku në ish-qendrën sanitare janë trajtuar rreth 40 ton mbetje pesticide të skaduara, ndërsa një sasi tjetër pesticidesh mbetet e stokuar në magazinat bujqësore si edhe rreth 1,700 ose 250 ton kimikate toksike gjenden në ish-fabrikën e plastikës.[41]

- Ish-Uzina e Plasmasit
- Magazinat e mbetjeve të industrisë së plasmasës - Plug
- Vend-depozitimi i mbetjeve urbane – Bashkia Lushnje
- Kanalet kullues e vaditës dhe trupat ujorë sipërfaqësorë

Zonat Urbane: Bashkia Lushnje mbulon me shërbimin e kanalizimit të ujërave të ndotura vetëm një pjesë të popullsisë së qytetit të Lushnjes, por nuk disponohet një shifër përmbledhëse e saktë si pasojë e mungesës së dixhitalizimit të rrjetit të kanalizimeve në këtë Bashki.

Zonat Rurale: Në zonën rurale të Bashkisë Lushnje nuk ekziston ndonjë sistem i organizuar inxhinierik i mbledhjes dhe largimit të ujërave te ndotura.

Uëjrat e ndotura të çdo shtëpie largohen në gropa individuale në oborret e shtëpive të cilat nuk respektojnë standardet tekniko-sanitare të gropave septike me ose pa filtrim. Në mjaft raste largimi i tyre bëhet edhe në kanale të hapura kulluese që kalojne pranë shtëpive të tyre e që gjithashtu janë në kundërshtim me respektimin e kushteve sanitare te largimit te tyre.

Shkarkimi dhe trajtimi i këtyre ujërave, si edhe i ujërave industriale është problemi më i madh sanitar që mund të paraqitet sot në Bashkinë Lushnje, për arsye se të gjithë kolektorët i shkarkojnë ujërat e ndotura të patrajtuara në sipërfaqe ujore sipërfaqësore.[42]

- Industria e nxjerrjes të naftës:
- Industria e përpunimit dhe magazinimit të naftës në Lushnje:

5 Vlerësimi i ndikimit në mjedis të propozimeve të PPV-së

Projektet e propozuara në Planin e Bashkisë Lushnje janë hartuar duke patur parasysh njëkohësisht gjendjen e mjedisit në territorin e Bashkisë dhe problematikat e ndryshme që kanë të bëjnë me shërbimet që Bashkia i ofron qytetarëve të saj. Projektet synojnë arritjen e katër objektivave specifike të Planit që janë:

1. Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor
2. Zhvillimi i eko-turizmit
3. Zhvillimi i planifikuar i territorit
4. Mbrojtja e burimeve natyrore

Zbatimi i projekteve së bashku me projektet që parashikohen në Planet e Detajuara Vendore pritet të ketë ndikim konkret në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe gjendjes së mjedisit. Ndërkohë, ndikimi i tyre gjatë fazës së zbatimit mund të shkaktojë përkeqësimin e përkohshëm të gjendjes mjedisore të Bashkisë Lushnje.

Duke qenë se projektet mbulojnë fusha të ndryshme, ata janë të ndryshëm për nga lloji dhe ndikimi që ata kanë në mjedis. Me qëllimin përcaktimin e ndikimeve të mundshme të projekteve në mjedis gjatë fazës së zbatimit dhe në një periudhë kohore afatgjatë, si dhe përcaktimin e natyrës së ndikimeve dhe masave zbutëse, u bë vlerësimi i ndikimit në mjedis të projekteve të Planit të Bashkisë Lushnje. Vlerësimi i ndikimit në vetvete është kryer në nivel projekti, objektivi specifik dhe Plani.

Në bazë të analizës së ndikimit, rezultoi se projektet do të kenë kryesisht ndikim të ulët në mjedis, me disa përjashtime për projekte specifike. Konkretisht, në nivel objektivi të planit, rezultatet paraqiten si më poshtë:

a. Projektet e *O.1: Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor:* nga 17 projektet e këtij objektivi, projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë ndikim të ulët në objektivat mjedisorë ajër, ujë, pyje dhe klimë. Ndikimi është mesatar në tokë, biodiversitet dhe peizazh, ndërsa ndikimi është i papërfillshëm në klimë, kulturë, shëndet dhe socio-ekonomi.

b. *Projektet e O.2: Zhvillimi i eko-turizmit:* nga 5 projekte të përfshira në këtë objektiv, rezulton se projektet do të kenë ndikim ulët në përbërësit e mjedisit si ajër, ujë, tokë, pyje dhe peizazh, ndërsa në biodiversitet ndikimi është mesatar. Projektet do të kenë ndikim pothuajse të papërfillshëm në klimë, shëndet dhe socio-ekonomi.

c. *Projektet e O.3: Zhvillimi i planifikuar e kontrolli i territorit:* nga analiza rezulton se të 10 projektet e përfshira në këtë objektiv të Planit do të kenë ndikim të ulët në ajër, ujë dhe tokë, ndërsa në biodiversitet, pyje dhe peizazh ndikimi do të jetë mesatar. Në përbërësit e klimës, kulturës, shëndetit dhe socio-ekonomisë, ndikimi ka rezultuar pothuajse i papërfillshëm.

d. *Projektet e O.4: Mbrojtja e burimeve natyrore:* nga një total prej 12 projektesh, rezulton se ndikimi i projekteve është i ulët në ajër, ujë tokë dhe në pyjë, ndërsa në biodiversitet dhe socio-ekonomi ndikimi do të jetë mesatar. Përjashtim bëjnë përbërësit e klimës, kulturës dhe shëndetit.

Vlerësimi numerik (sasior) i ndikimit në mjedis është bërë duke patur parasysh se gjatë zbatimit të projekteve do të merren masat teknike për zbutjen e ndikimit, pra në skenarin kur realizohen ndërhyrje mjedisore përmirësuese.

Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit të ndikimit, është vlerësuar edhe përputhshmëria ndërmjet objektivave, programeve e projekteve të Planit të Bashkisë Lushnje me objektivat e VSM-së. Duke qenë se projektet formojnë programe dhe programet formojnë objektiva, vlerësimi është kryer fillimisht në nivel projekti dhe ka përfunduar në nivel objektivash. Për vlerësimin e përputhshmërisë janë paraqitur 5 nivele të cilat janë:

1. Objektivat/ programet/ projektet përputhen plotësisht me OM-të: Ky rast merr vlerësim maksimal të barabartë me 3. Ka raste që projekte të caktuara mund të mos kenë përputhje të plotë, por marrja e masave mjedisore i bën të përputhshëm.
2. Objektivat/ programet/ projektet përputhen pjesërisht me OM-të: Përputhja është e pjesshme edhe pse zbatohen masa mjedisore, pra realizohet me kushte.
3. Lidhja/ përputhshmëria është e zbehtë: Përputhshmëria është e dobët, edhe pse realizohen masat mjedisore. Kjo nënkupton që ndikimi neutralizohet pjesërisht, ose minimalisht.
4. Nuk ka lidhje (përputhshmëria neutrale): Objektivat, programet, projektet nuk tregojnë përputhje në pamje të parë, por as përplasje. Pra nuk nuk kanë ndikim negativ të ndërsjellë e veçanërisht ato të planit në objektivat e VSM-së.
5. Objektivat/ programet/ projektet nuk përputhen me OM-të: janë në kundërshtim të plotë, pavarësisht masave zbutëse që mund të merren.

Rezultatet e analizës së përputhshmërisë në nivel Plani të Bashkisë Lushnje janë paraqitur më poshtë:

Tabela 1. Përputhshmëria përfundimtare e Planit me Objektivat Mjedisorë.

Bashkia LUSHNJE: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	Vlerësimi mesatar
	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Cilësia e jetës	
Përputhshmëria Totale e Projekteve	2,09	2,06	1,94	1,59	2,27	2,40	2,63	2,96	3,00	2,33

Përgatitit: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Bashkia Lushnje, nga procesi i vlerësimit të Përputhshmërisë, ka rezultuar se Plani ka përputhshmëri të pjesshme me objektivat mjedisorë. Ky tregues mund të interpretohet në mënyrë të përmbledhur duke theksuar se ndikimet në mjedis nga zbatimi i programeve dhe projekteve të PPV-së do të jenë konkrete dhe të matshme. Këto ndikime janë referuar në seksionin e mësipërm (5.2.1) dhe në bazë të tyre janë hartuar masa shoqëruese (referuar në seksionin 6) të cilat nëse respektohen nga zbatuesit dhe monitorohen me përpikmëri nga institucionet përgjegjëse (të referuara në seksionin 5.1), mund të zbutin ndikimin në mjedis në nivele më të ulta edhe pse nuk mund ta eleminojnë fenomenin plotësisht.

Duke iu referuar tabelës përmbledhëse të Përputhshmërisë në nivel PPV-je, është vlerësuar se Objektivi Mjedisor i Biodiversitetit është në kufinjtë e kategorizimit me

përputhshmëri të zbehtë. Për këtë arsye, edhe masat e referuara për këtë element nevojitet që të trajtohen me rreptësi.

Plani është vlerësuar të ketë përputhshmëri mesatare për OM-të ajër, ujë ,tokë, pyje dhe peizazh, ku ndikimet në tokë janë vlerësuar të jenë konkrete dhe për këtë arsye nevojitet që të hartohen masa specifike për zbutjen e ndikimit dhe të rrespektohen gjatë fazës së zbatimit të projekteve. Problematikat me këto dy objektiva janë shumë të prekshme ende pa filluar zbatimi i planit ndaj edhe projektet e reflektuara synojnë rehabilitimin e zonave të dëmtuara si dhe shtrëngimin e rregullave për moscënimin e mëtejshëm të territoreve natyrore dhë përmirësimin e gjendjes së tyre.

Klima, kultura dhe cilësia e jetës janë tre përbërës mbi të cilët është punuar veçanërisht për të krijuar një harmoni natyrore dhe përmirësim të vlerave qoftë natyrore, të shëndetit publik dhe trashegimisë kulturore e historike duke identifikuar vlerat thebësore dhe identitetin e kësaj Bashkie.

Në tabelën e mëposhtme reflektohen Projektet e Planit të PPV-së të shpërndara në % në bazë të niveleve të përputhshmërisë që ato kanë ndaj Objektivave Mjedisorë.

Tabela 2. Përputhshmëria përfundimtare e Planit me Objektivat Mjedisorë.

Bashkia LUSHNJE: Përputhshmëria					
Objektivat Mjedisore / Objektivat e Programet e Planit	% e OM me PL/Projekt	% e OM me PP/projekt	% e OM me PZ/projekt	% e OM me PN/projekt	% e OM me PG/projekt
Perputhshmeria Totale e Projekteve	45,7%	42,5%	11,2%	0,0%	0,6%

Përgatitit: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Përgjithësisht, shumica e përputhshmërive në nivel mesatar dhe të ulët lidhet më tepër me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka veçori të theksuara nga ana natyrore, kulturore dhe peizazhi që mund të ndikohen ndjeshëm nga zhvillimet e infrastrukturës, veçanërisht nga projektet me shtrirje të gjere sipërfaqësore dhe sektorë të ndryshëm si energji, ujë, etj.

Nga rezultatet e mësipërme rezulton se:

1. Në total, nga 44 projekte të PPV-së, 45.7% e tyre kanë <u>përputhshmëri të lartë</u> me objektivat mjedisorë. Pra, ndikimi që këto projekte do të kenë në mjedis do të jetë i papërfillshëm dhe në disa raste ato janë hartuar si një domosdoshmëri e rehabilitimit të gjendjes mjedisore për Bashkinë Lushnje.
2. Rreth 42.5% e fondit të projekteve kan <u>përputhshmëri mesatare</u>, çka nënkupton se ndikimi i tyre do të jetë i ulët dhe mund të zbutet ndjeshëm me marrjen e masave të parashikuara në legjislacionin shqiptar (masat përcaktohen gjatë hartimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis) gjatë fazës së zbatimit. Monitorimi i këtyre masave është element kyç në ruajtjen e nivelit të përputhshmërisë edhe gjatë fazës së operimit të këtyre projekteve.
3. Vetëm 11.2% e projekte nga 44 që janë propozuar në Planin e Bashkisë Lushnje kanë <u>përputhshmëri të zbehtë</u>. Në këtë rast qoftë respektimi qoftë monitorimi i përpiktë i masave shtrënguese mjedisore nuk do të sillte neutralizim të plotë të ndikimeve, por thjeshtë do të kufizohej me zbutjen e ndikimit të projekteve tek objektivat mjedisorë.

4. Projektet e vlerësuara me përputhshmëri neutrale kanë të bëjnë kryesisht me hartime planesh, studime, investime dhe ngritje kapacitetesh njerëzore. Pra projekte dhe ndërhyrje të cilat mbartin një ndikim mjedisor me peshë fare të vogël krahasuar me ndërhyrjet fizike. Ndaj edhe vlerësimi i tyre është faktorizuar si neutral. Në PPV-në e Bashkisë Lushnje nuk ka asnjë plan me ndikim neutral.
5. Nuk ka asnjë projekt, nga i gjithë fondi me pëputhshmëri negative me Objektivat Mjedisorë. Megjithatë, Plani përfshin edhe projekte që parashikojnë ndërhyrje të fuqishme fizike në territor. Si rrjedhojë, ndikimi i tyre në përbërës specifikë të mjedisit si ajër, ujë, zhurma, etj. parashikohet të jetë mjaft shqetësues dhe në disa raste me ndikim shkatërrues.

Ndikimet që rrjedhin nga ky Plan i Përgjithshëm Vendor janë vlerësuar kryesisht të kenë intensitet të ulët dhe në disa raste rehabilitues e të domosdoshëm për të sistemuar dhe përmirësuar cilësinë e jetës dhe të mjedisit në Bashkinë Lushnje.

Ndikimet pozitive afatgjatë identifikohen kryesisht në përmirësimin e cilësisës së jetës dhe nivelit kulturor të shoqërisë. Kjo si rezultat i përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike të parashikuara në këtë PPV. Ndikimi që paraqitet në fushën e ndryshimeve klimatike do të jetë relativisht i ulët ku si kontribues kryesor do vazhdojë të mbetet industria dhe sektori i bujqësisë.

Ndikimet pozitive në popullatë dhe pasuri materiale do të vijnë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës rrugore dhe të shërbimeve në përgjithësi, gjë që do të çojë në përmirësimin e lëvizjes së banorëve brenda dhe jashtë Bashkisë duke shkurtuar kohën e udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

6 Masa për zbutjen e ndikimeve mjedisore të propozimeve të PPV-së.

Ndikimi, edhe pse në shkallë të ndryshme, do të jetë kryesisht në tokë, burime ujore, pyje, ajër, biodiversitet, etj. Ndikimi parashikohet të jetë specifik për çdo projekt më vete.

Marrja e masave për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të një projekti dhe në rastin tonë të projekteve të PPV-së së bashkisë është kompetencë e një numri të caktuar institutesh publike dhe e zhvilluesit të projektit. Institutet publike sigurohen që për çdo projekt, zhvilluesit e projekteve parashikojnë dëmtimet e mundshme të mjedisit gjatë fazës së zbatimit dhe, përpara fillimit të zbatimiti të projektit, marrin masat teknike të nevojshme për parandalimin dhe zbutjen e tyre. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet zbatimit të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i cili përcakton kushtet e zbatimit të një projekti në rrespekt me mjedisin.

Sipas Ligjit nr. 10440, projektet, përpara zbatimit do t'i nënshtrohen "procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis" ose "procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis" sipas Ligjit nr. 10440, datë 7.7. 2011. Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre. Sipas nenit 4 të të njëjtit ligji, vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e

ndikimit në mjedis të projektit. *Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin vlerësimin e ndikimit të projektit gjatë fazës së zbatimit dhe gjithashtu dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin* e zonës në gjendjen e mëparshme, funksionimin normal edhe mundësinë për aksidente. Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, edhe propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Masat kryesore janë adresuar për:

- Masa për mbrojtjen e burimeve ujore të Bashkisë Lushnje.
- Masa për mbrojtjen e tokës.
- Masa për mbrojtjen e biodiversitetit, pyjeve dhe peisazhit
- Masa për mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe gjenerimit të zhurmave
- Masa për mbrojtjen e shëndetit publik
- Masa ndaj veprimtarive industriale
- Masa për rehabilitimin e zonave të ndotura etj.

Një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të një projekti luan edhe autoriteti i planifikimit ose autoritete të tjera përgjegjëse për liçencimin e veprimtarive (zbatimin e projekteve). Ligji nr. 10440 i kërkon autoriteteve në fjalë që, përpara vendimit për dhënien e lejes së zhvillimit apo liçencës përkatëse për një projekt të propozuar, të sigurohet që projekti t'i jetë nënshtruar kërkesave të këtij ligji dhe, në varësi të projektit, të jetë pajisur me vendim apo deklaratë. Vendimi apo deklarata për projektin e propozuar është i vlefshëm për aq kohë sa është e vlefshme dhe leja e zhvillimit/licenca përkatëse për projektin (Neni 20 i Ligjit nr. 10440).

Mbas marrjes së lejes për zbatimin e projektit, zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë (Neni 20 i Ligjit nr. 10440).

Një vëmendje të veçantë si objekt mbrojtjeje i kushtohet zonave të mbrojtura ose zonave veçanarisht të mbrojtura (neni 21 i Ligjit nr. 10440). Në këtë rast, dispozitat e ligjit nr. 10440 zbatohen edhe në rastet kur veprimtaria e propozuar nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë apo nuk është e nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që, veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera, mund të shkaktojë efekte të rëndësishme mbi atë zonë.

Kur AKM-ja apo ministria, në përfundim të procedurës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti, shprehet se veprimtaria e propozuar, veçmas apo në bashkëveprim me veprimtari ose plane dhe projekte të tjera, të realizuara apo të propozuara, mund të ketë ndikim negativ të rëndësishëm mbi integritetin e një zone veçanërisht të mbrojtur, atëherë autoriteti përgjegjës që mbulon fushën e projektit, nuk lejon zhvillimin e tij. Bëjnë përjashtim vetëm rastet kur i) nuk ka zgjidhje tjetër alternative; ii) veprimtaria e propozuar duhet të zbatohet për arsye urgjente të interesave madhorë të publikut, përfshirë edhe ata me natyrë shoqërore apo ekonomike (arsye urgjente të interesave madhorë të publikut që merren në konsideratë, kur zona veçanërisht e mbrojtur përmban lloje habitatesh natyrore prioritare dhe/ose specie prioritare, janë vetëm ato që kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut apo sigurinë e publikut, ose që sjellin ndikime të rëndësishme pozitive për

mjedisin); iii) duhen marrë të gjitha masat kompensuese për të siguruar zbatimin e kërkesave të “Natyra 2000”.

Si përfundim, mund të thuhet se masat për mbrojtjen e mjedisit gjatë fazës së zbatimit të projekteve të PPV-së përcaktohen në VNM-të përkatëse të çdo projekti. Rolin kryesor të mbrojtjes së mjedisit në këtë rast e luajnë Ministria e Mjedisit me institucionet vartëse që miratojnë VNM-të e projekteve, autoriteti i planifikimit ose autoritete të tjera përgjegjëse për liçencimin e veprimtarive të cilat kërkojnë që projekti të jetë pajisur me vendim apo deklaratë mjedisore, zhvilluesit e projekteve të cilët përcaktojnë masat që merren gjatë fazës së zbatimit dhe autoritetet inspektuese gjatë fazës së zbatimit. Një rol tejet të veçantë dhe të rëndësishëm pritet që të luhet nga publiku në fazën e hartimit të VSM-ve dhe për ndërgjegjësimin e qeverisë lokale (bashkisë) për rëndësinë e respektimit të ligjit nr. 10440 gjatë fazës së zbatimit të projekteve të PPV-së dhe në të ardhmen.

1. Qëllimi i dokumentit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Bashkisë Lushnje.

Qëllimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Bashkisë Lushnje reflekton drejtpërdrejt qëllimin e ligjit nr. 91/2013, datë 28.02.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor", sipas nenit 1 të tij, konkretisht: *të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis*.

1.1 Objektivat Mjedisore të VSM-së dhe ndikimet e mundshme

Mbi bazën e qëllimit të VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë Planit, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së. Edhe objektivat mjedisore qëndrojnë po njëlloj për PPV-në. Për më tepër, këto objektiva janë ndërtuar në përputhje me politikat e strategjitë mjedisore kombëtare, me Planin Kombëtar të Territorit (dokumenti i VSM-së), si dhe me qëndrimet e sektorëve përkatës (që preken nga objektivat). Për çdo objektiv janë listuar ndikimet e mundshme të PPV-së në mjedis, nëse objektivi nuk realizohet, pra nëse nuk merren masat zbutëse, eleminuese apo parandaluese të dëmit mjedisor.

Objektivi Mjedisor 1 (OM1) – Ajri: Përmbushja e objektivave afatmesme për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, sipas kufijve maksimalë e normave të lejuara nga Bashkimi Europian.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

i) çlirim i ndotësve në ajër, si pasojë e aktivitetit njerëzor (industri, transport, djegie e mbetjeve, ndërtim, etj.), me ndikim negativ në ekosistem dhe shëndetin e njeriut dhe përtej vlerave të lejuara. Në fokus janë sasitë e shkarkuara dhe numri i ditëve kur tejkalohen vlerat, si dhe burimet përkatëse;

ii) dëmtim i objekteve historike e monumenteve të kulturës (p.sh. nga shiu acid, PM-të etj.);

iii) depozitim i ndotësve në ujë dhe tokë, ç'ka luan rolin e përcjellësit të efekteve negative tek njerëzit dhe biodiversiteti;

iv) ndotje nga niveli i zhurmave (përgjithësisht nga aktiviteti njerëzor);

v) përforcim i efektit serë dhe i skenareve negative të ndryshimeve klimatike.

Objektivi Mjedisor 2 (OM2) – Uji: Zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin e bashkisë, mbi burimet dhe trupat ujorë sipërfaqësorë e nëntokësorë, përfshirë ujin e pijshëm, ujërat bregdetare dhe brigjet.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

i) ndotje e ujërave nga aktiviteti njerëzor (bujqësi, turizëm, industri, transport, energjitikë, urbanizim, shkarkim mbetjesh të patrajtuara etj.), e për pasojë e tokës dhe produkteve bujqësore, si dhe efektet negative në shëndetin e njeriut dhe në biodiversitet;

ii) ndikim i drejtpërdrejtë negativ në cilësinë e ujit të pijshëm, përmes prekjes së akuiferëve dhe burimeve për popullsinë;

iii) ndotje e ujërave për aktivitet argëtues e për pasojë edhe dëmtimi i ekonomisë së turizmit;

iv) përmbytje dhe erozion detar dhe i brigjeve ujore;

v) kripëzimi i tokave, veçanërisht në bregdet, për shkak të prishjes së ekuilibrit mes ujërave të ëmbla dhe të kripura përgjatë vijës bregdetare.

Objektivi Mjedisor 3 (OM3) – Toka: Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe burimeve natyrore të lidhura drejtpërdrejtë me të.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

i) fragmentim i tokës bujqësore, konvertimi i saj në përdorime të tjera dhe humbja e tokës;

ii) ndotje e tokës bujqësore nga kimikatet në bujqësi, aktiviteti urban dhe mbetjet (urbane, industriale, inerte, spitalore, të lëngshme, e të rrezikshme), aktiviteti industrial e faktorë të tjerë;

iii) përdorim i tokës për ferma të prodhimit të energjive të rinovueshme dhe infrastruktura të tjera;

iv) rritje e rrezikut të përmbytjeve, rrëshqitjeve, shembjeve, erozioni, si dhe rreziqe të tjera gjeologjike e natyrore të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor;

v) degradim i tokës.

Objektivi Mjedisor 4 (OM4) – Biodiversiteti: Mbrojtja dhe manaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, shërbimeve të tyre dhe garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të mjedisit.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

i) fragmentim, ndarje, barriera dhe humbje/dëmtim i habitateve;

ii) dëmtim i zonave të mbrojtura natyrore, apo atyre që kanë status të veçantë ruajtjeje;

iii) humbje apo rrezikim i specieve;

iv) ndërhyrje në liNjat e migrimit të kafshëve/shpendëve;

v) zhurma shqetësuese për llojet e popullatat;

vi) ndotje e ekosistemit dhe dëmtimi i shërbimeve të tij në funksion të biodiversitetit;

vii) rrezatime nga aktiviteti urban.

Objektivi Mjedisor 5 (OM5) – Pyjet: Konservimi, shtimi dhe manaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetëripërtëritëse të ekosistemit, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike dhe ofrimit të një burimi të qëndrueshëm jetese për banorët e zonave rurale.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

i) fragmentim, humbje dhe dëmtim i pyjeve;

ii) humbje të specieve të veçanta, të rralla apo të mbrojtura;

iii) dëmtim i korridoreve natyrore;

iv) pakësim i lëndës së parë në funksion të ekonomisë;

v) dëmtim i strukturës sociale-ekonomike të zonës rurale;

vi) rritje e efektit serë dhe efekteve të tjera negative me pasojë ndryshime klimatike.

Objektivi Mjedisor 6 (OM6) – Peizazhi dhe Ekosistemet: Konservimi dhe manaxhimi inteligjent i peizazhit, si matricë bazë për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të ekosistemeve.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

i) fragmentim i peizazhit dhe elementeve të matricës;

ii) dëmtim i siluetave vizuale, estetike;

iii) dëmtim i habitatit dhe humbja e shërbimeve të ekosistemit përkatës të çdo elementi të matricës peizazhistike;

iv) rritje e rrezikut të përmbytjeve, rrëshqitjeve, shembjeve, erozionit, dhe rreziqeve të tjera gjeologjike e natyrore të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor;

v) dëmtim i ekonomive agrare e rurale.

Objektivi Mjedisor 7 (OM7) – Ndryshimet klimatike: Realizimi i masave dhe infrastrukturës për të mos kontribuar në ndryshimet klimatike dhe efektin serë, si dhe për të parandaluar, apo zbutur efektet negative nga ndryshimet klimatike, në përmbushje edhe të angazhimeve përkatëse kombëtare.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

i) rritje e temperaturave dhe çrregullimi i treguesve të motit, duke përkeqësuar jo vetëm shëndetin njerëzor dhe kushtet e jetesës (me të cilat është përshtatur organizmi njerëzor dhe i specieve të tjera), por edhe prodhimtarinë në sektorë të ndryshëm (bujqësi, energji, turizëm etj.);

ii) pakësim i burimeve ujore, dhe për pasojë mungesë në furnizimin e popullsisë dhe vaditjen e tokës bujqësore. Kjo mund të çojë edhe në tjetërsime të ekosistemeve dhe shkretëtirëzim;

iii) rritje e rrezikut të përmbytjeve, përparimit të detit drejt tokës, kripëzimit të tokave dhe ujërave të ëmbla, rrëshqitjeve, shembjeve, erozionit, si dhe rreziqe të tjera gjeologjike e natyrore;

iv) probleme social-ekonomike, që lidhen me zhvendosjen e popullsisë dhe aktivitetit ekonomik, përfshirë mungesën e punësimit, ndarjet dhe konfliktet sociale në kohë krize;

v) humbje në biodiversitet dhe dëmtim të ekosistemeve dhe shërbimeve përkatëse;

vi) nxjerrje jashtë shfrytëzimit të infrastrukturës aktuale për prodhimin e energjisë përmes burimeve hidrike;

vii) kosto financiare e ekonomike për të përballuar krizën do të jenë shumë të larta.

Objektivi Mjedisor 8 (OM8) – Trashëgimia kulturore: Konservimi e restaurimi për jetëgjatësi i objekteve dhe zonave historike e të trashëgimisë kulturore e arkeologjike.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

i) dëmtim i materialeve të përdorura në objektet përkatëse, si pasojë e shkarkimeve të ndotësve në ajër dhe ujë;

ii) humbje e trashëgimisë si pasojë e aktivitetit njerëzor dhe kryesisht urban e

industrial, përfshirë infrastrukturat;

iv) rritje e rrezikut të përmbytjeve, rrëshqitjeve, shembjeve, e rreziqe të tjera gjeologjike e natyrore të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor.

Objektivi Mjedisor 9 (OM9) – Cilësia e jetës: Garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore.

Ndikime të mundshme, nëse nuk merren masa:

i) dëmtim i shëndetit dhe pasojat sociale përkatëse;

ii) dëmtim i vlerave dhe burimeve ekonomike, qofshin natyrore apo të krijuara nga njeriu;

iii) ulje e sigurisë së jetës dhe aksidentet;

iv) rënie e ndërgjegjësimit të banorëve mbi dëmin që shkakton në mjedis aktiviteti njerëzor dhe mbetjet e krijuara në qytete.

Të gjitha ndikimet e mësipërme janë të mundshme të ndodhin, nëse territori i Bashkisë së Lushnjes nuk do të planifikohet në mënyrë të integruar e gjithëpërfshirëse, sikundër edhe nëse për një pjesë të propozimeve të planit (të shpjeguara në vijim) nuk do të merren masat e duhura mjedisore.


2. Metodologjia për hartimin e VSM-së

2.1 Procesi

Detyrimi për hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lushnje përcaktohet nga ligji nr. 91/2013, datë 28.02.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor". Sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, procesit të vlerësimit strategjik mjedisor i nënshtrohen planet kombëtare e vendore të planifikimit të territorit urban e rural, përfshirë dhe mbrojtjen e peizazhit, të përdorimit të tokës, të cilat vendosin kuadrin për miratimin, në të ardhmen, të projekteve të listuara në shtojcat 1 e 2 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis"[43]. Sipas ligjit, në nenin 7 të tij përcaktohen edhe hapat nëpër të cilat duhet të kalojë procesi i hartimit dhe miratimit të VSM-së. Këto hapa, bashkë me metodologjinë teknike, janë përmbledhur në figurën e mëposhtme.

Në kontekstin më të gjerë, Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces sistematik, që parashikon e vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të planit të përgjithshëm vendor të bashkisë, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrën e duhur që në fazat më të hershme të vendimmarrjes për instrumentin e planifikimit.

Figura 5. Procesi i hartimit e miratimit të VSM-së për PPV-në e Bashkisë së Lushnjes.



Burimi: Ligji nr. 91/2013 dhe VKM nr. 219, datë 11.03/2015; Përpunoi: Co-PLAN, 2016

Po ashtu, qartësia mbi detyrimin për hartimin e VSM-së për PPV-në e bashkisë, vjen edhe nga VKM-ja nr. 507, datë 10.6.2015, "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor".

Grupi i punës për hartimin e PPV-së dhe VSM-së i ndoqën fazat e procesit si më poshtë:

a) Njoftimi i Ministrisë së Mjedisit nga Bashkia është kryer në periudhën shtator-tetor të vitit 2015. Procesi për krijimin e bazës së të dhënave të PPV-së nisi në Mars 2015, por

ligjërisht, momenti i nisjes së punës për hartimin e planit përkon me krijimin e bashkive të reja pas zgjedhjeve vendore të qershorit 2015 dhe në përmbushje të reformës administrativo-territoriale. Për rrjedhojë, në shtator-tetor 2015, Bashkia mori nismën për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar dhe me VKM nr. 671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit". Si pjesë e marrjes së nismës:

- U hartua dokumenti i nismës në përputhje me kërkesat ligjore,
- U ngrit forumi qytetar për PPV-në, sipas VKM nr. 671,
- U realizua një takim publik – forumi i parë qytetar për marrjen e nismës, si pjesë e të cilit u njoftua procesi për hartimin e planit, detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve pjesëmarrëse, përfshirë forumin e qytetarëve, dhe produket e lidhura me PPV-në, përfshirë VSM-në si detyrim ligjor dhe nevojë reale për të trajtuar çështjet e mjedisit në planifikim,
- U njoftua marrja e nismës dhe nisja e VSM-së ne Regjistër dhe në mjetet e komunikimit elektronik që përdor Bashkia,
- U njoftua Ministria e Mjedisit për nisjen e procesit të PPV-së e për rrjedhojë VSM-së,
- U realizua miratimi i nismës për PPV-në në Këshillin Bashkiak.

b) Konsultimi me grupet e interesit për çështjet që trajtohen në raportin e VSM-së, është realizuar nëpërmjet 5+2 takimeve publike dhe përmes takimeve individuale, sipas rastit.

- Takimi i parë publik përkon me takimin për nismën e PPV-së.
- Takimi i dytë publik përkon me takimin për analizat e PPV-së, ku një prej analizave të disktuara në takim publik ishte ajo mjedisore (me të gjithë përbërësit mjedisorë sipas raportit, përfshirë metabolizmin e territorit).
- Takimi i tretë publik përkon me takimin për konsultimin e strategjisë së zhvillimit të territorit, në të cilin u diskutua edhe për dimensionin mjedisor të propozimeve të strategjisë.
- Takimi i katërt publik u realizua specifikisht vetëm për diskutimin e raportit paraprak të VSM-së.
- Takimi i pestë publik përkon me konsultimin mbi propozimet për infrastrukturat dhe shërbimet publike në kuadër të PPV-së, duke i vlerësuar propozimet jo vetëm nga pikëpamjet teknike, ekonomike, sociale e territoriale, por edhe mjedisore e të peizazhit.
- Takimi i gjashtë publik përkon me konsultimin mbi përdorimin e tokës dhe intensitetin e zhvillimit, ku sërish propozimet dhe diskutimi mbi to realizohen edhe mbi bazën e kriterit mjedisor.
- Takimi i shtatë publik u realizua specifikisht vetëm për diskutimin e raportit përfundimtar të VSM-së.
- Përveç sa më sipër, në Bashkinë e Lushnjes u realizuan edhe dy takime publike me banorët e grupet e interesit në zonën rurale të fushës dhe në zonën rurale të kodrës, për të diskutuar mbi propozimet për tokën bujqësore dhe për zonën natyrore (kodrat dhe pyjet).

Në takimet publike në të cilat VSM-ja është diskutuar së bashku me PPV-në,

pjesëmarrja ka qënë e gjerë dhe ka përfshirë, jo vetëm institucione e grupe interesi që lidhen me mjedisin, por edhe forumin qytetar të plotë, si edhe banorë e pronarë që kanë marrë pjesë në mënyrë spontane në takim.

Në takimet publike të posaçme vetëm për VSM-të, pjesëmarrja ka qenë më e specializuar në drejtim të mjedisit, duke përfshirë përfaqësues të forumit qytetar, agjencitë rajonale për mjedisin, ujërat, tokën bujqësore, ish-drejtoritë pyjore (specialistët përkatës), biznese, të cilat kanë ndikim në mjedis, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve, OJF-të mjedisore etj. Në mënyrë më të detajuar, informacioni për pjesëmarrjen në takime publike dhe institucionet apo organizatat e kontaktuara e të konsultuara gjendet në Shtojcën 1 të dokumentit të VSM-së.

c) Hartimi i raportit paraprak u realizua gjatë periudhës nëntor 2015 – maj 2016. Konsultimet në lidhje me këtë raport paraqiten më lart dhe mbyllen me takimin e katërt publik, të dedikuar për VSM-në. Gjatë kësaj faze është kryer grumbullimi i pjesës më të madhe të informacionit. Megjithatë, si rezultat i takimit të katërt publik (i VSM-së), shumë nga institucionet e përfshira (pjesëmarrëse në takim) reflektuan mbi informacionet e dhëna deri në atë moment apo të disponuara nga grupi i punës dhe dorëzuan në Bashki një sërë informacionesh të reja apo të përditësuara. Ky veprim ndikoi pozitivisht në rifreskimin e informacionit dhe të analizës.

ç) Hartimi i raportit përfundimtar të vlerësimit strategjik mjedisor është realizuar në periudhën qershor – shtator 2016. Takimet publike për këtë fazë të punës paraqiten më sipër dhe mbyllen me takimin e shtatë publik, i dedikuar për VSM-në. Edhe gjatë kësaj periudhe pati disa momente të marrjes/shkëmbimit të informacionit me burime specifike, por puna u përqendrua kryesisht në realizimin e vlerësimit mjedisor të PPV-së dhe në hartimin e masave përkatëse mjedisore.

d) Shqyrtimi i propozimit dhe deklarata e Ministrit realizohet me dorëzimin e materialit përfundimtar tek autoritetet përgjegjëse.

dh) Vendimi i autoritetit miratues vjen pas shqyrtimit të materialit.

e) Monitorimi dhe raportimi i pasojave në mjedis të planit është një proces në vazhdim, i cili do të realizohet nga Bashkia dhe institucionet përgjegjëse për mjedisin, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Planin e Veprimeve, pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

2.2 Kuadri ligjor

- Kuadri ligjor i VSM-së

Kuadri ligjor shqiptar i VSM-së përafrohet plotësisht me kuadrin ligjor ndërkombëtar. Më poshtë praqitet një përmbledhje e shkurtër e këtij kuadri i cili përfshin Ligjin Nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" dhe dy vendime të Këshillit të Ministrave që e kanë plotësuar atë në vitet e fundit.

Ligj Nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, nëpërmjet përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Ligji përcakton institucionet përgjegjëse dhe procedurat sipas të cilave kryhet vlerësimi strategjik mjedisor. Krahas procedurave, Ligji përcakton planet dhe programet që i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor ku përfshihet edhe hartimi i planeve vendore të planifikimit të territorit. Ky ligj është përafruar plotësisht me Direktivën

2001/42/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara".

Në dy vitet e fundit, ligji i mësipërm është plotësuar nga dy VKM-të si vijojnë:

- **VKM-ja Nr. 507, datë 10.06.2015** "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"
- **VKM Nr. 219, datë 11.03.2015** "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"

Protokolli i VSM-së, Konventa Espoo-s (UNECE 1991): Në këtë kontekst, vlen të theksohet edhe rëndësia e Protokollit të VSM-së i hartuar dhe miratuar në Konventën e Espoo-s (UNECE 1991) i cili përcakton detyrimet e palëve për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të aktiviteteve të caktuara që në fazën e hershme të planifikimit të tyre. Ky dokument konsiderohet si një nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtrojnë kushtet e vlerësimeve strategjike.

- Kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit

Për hartimin e VSM-së në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm të Territorit për Bashkinë Lushnje është i rëndësishëm edhe kuadri ligjor për mbrojtjen e mjedisit. Ky kuadër përfshin kryesisht ligjet kryesore përkatëse të përbërësve të mjedisit, të përcaktur në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit: uji, toka, ajri, pyjet, kullotat, biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura. Këto ligje shërbejnë si bazë për analizimin e gjendjes në mjedis në territorin e Bashkisë dhe përcaktimin e masave që duhen marrë në të ardhmen nga Bashkia Lushnjë për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të projekteve të Planit të Përgjithshëm Vendor edhe në vitet në vazhdim.

Tabela 3. Përmbledhje e kuadrit Ligjor per mbrojtjen e mjedisit

Fushat / Përbërësit e mjedisit	**Ligjet**
Mbrojtja e Mjedisit	Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";
	VKM Nr. 1189 Datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit";
	VKM Nr. 47, Datë 29.01.2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të Agjencive Rajonale të Mjedisit";
	VKM Nr. 46, Datë 29.01.2014 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave".
Vetëqeverisja Vendore	Ligj Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
Burimet Ujore	Ligj Nr. 156/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. **111/2012** "Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"
	VKM Nr. 273 datë 07.05.2004 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Ujit";
	VKM Nr. 945, datë 09.10.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit";
	VKM Nr. 939, datë 09.10.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave";

	VKM Nr. 954, datë 16.10.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës”;
	VKM Nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”;
	Ligji Nr. 111/2015 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”;
	VKM Nr.342, datë 04.05.2016 “Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre”;
	VKM Nr. 268, datë 06.04.2016 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Ujit".
Toka dhe Bujqësia	Ligji Nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën (i ndryshuar)”;
	Ligji Nr. 130/2014 Për disa shtesa dhe një ndryshim në ligjin Nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”;
	Ligji Nr. 131/2014 Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin Nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore”;
	VKM Nr.121, datë 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga DAMT-et në qarqe dhe ZMMT në komuna dhe/ose Bashki”
	VKM Nr. 410, datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”
	Udhëzim Nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”;
	Vendim Nr. 143, datë 24.2.2016 Për disa ndryshime në vendimin Nr. 460, datë 22.05.2013, “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”;
	VKM Nr. 283, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”.
Ajri	Ligji Nr.162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis”;
	VKM Nr. 594, datë 10.09.2014 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Cilësinë e Ajrit të Mjedisit”;
	VKM Nr. 352, datë 29.04.2015 “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”.
Biodiversiteti (flora dhe fauna)	Ligji Nr 68/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. **9587**, Datë 20.07.**2006**, “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit”;
	Ligji Nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”; Ligj Nr. 41/2013 “Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për Mbrojtjen e Faunës së Egër";
	VKM Nr.84, datë 27.01.2009 “Për caktimin e kritereve për ngritjen e rrjetit të inventarizimit dhe të monitorimit të biodiversitetit”;
	Ligji Nr 68/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. **9587**, Datë 20.07.**2006**, “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit”;
	Ligji Nr. 61/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”.
Pyjet dhe Kullotat	Ligji Nr 48/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9385, datë 04.05.**2005** “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar”;
	Ligji Nr 49/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. **9693**, datë 19.03.**2007** “Për Fondin Kullosor”;

	Vendim Nr.436, datë 8.6.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor";
	VKM Nr. 215, datë 16.03.2016 "Për krijimin e task-forcës "Roja e Gjelbërt" për marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim të pyjeve publike e private";
	VKM Nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/ bashkive";
	Udhëzim Nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjordhe kullosor publik".
Mbetjet	Ligji Nr 156/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve";
	Ligji Nr. 8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave";
	Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit";
	Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
	VKM Nr. 333, datë 26.01.2011 "Për Administrimin e vend-depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane";
	Ligji Nr. 34/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin e ujërave të ndotura";
	VKM Nr. 798, datë 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore";
	Vendim Nr. 178, datë 06.03.2012 "Për incinerimin e mbetjeve";
	VKM Nr. 452, datë 11.07.2012 "Për landfillet e mbetjeve";
	Vendim (Projekt) Nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim";
	VKM Nr. 608, datë 17.09.2014 "Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre";
	UDHËZIM Nr. 1738, datë 12.03.2015 "Mbi kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane";
	VKM Nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për manaxhimin e mbetjeve inerte";
	VKM Nr. 843, datë 14.10.2015 "Për mbylljen e ndërmarrjes së furnizimit industri-miniera dhe krijimin e qendrës së grumbullimit dhe trajtimit të kimikateve të rrezikshme".
Zhurmat	Ligji Nr 39/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis";
	VKM Nr. 587, datë 07.07.2010 "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike".
Ndryshimet Klimatike	Protokolli i Kiotos i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike;
	Ligji Nr. 9334, datë 16.12.2004 "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike";

	Ligji Nr.10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" (Direktiva 2008/1/EU e ndotjes industriale).
Hidrokarburet	Ligji Nr. 19/2015 Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin Nr. 7746, Datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)" ;
	Ligji Nr. 71/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin, tregtimin e naftës , gazit e nënprodukteve të tyre"
	Ligji Nr. 143/2014 Për një ndryshim në ligjin Nr. 9876, datë 14.02.2008 "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport" (i ndryshuar);
	Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit";
	Urdhër Nr. 101, datë 17.4.2015 Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin Nr. 83, datë 10.02.2012 "Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure";
	VKM Nr. 781, datë 14.11.2012 "Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor";
	VKM Nr. 19, datë 14.01.2015 "Për procedurat dhe kushtet për dhënien, transferimin dhe përsëritjen e licencës së koncesionit për rafineri për kryerjen e veprimtarisë së përpunimit të naftës bruto për prodhimin e nënprodukteve të saj"
	Ligji Nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".
Shërbimet Publike	Ligji Nr 45/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 7643 datë 02.12.1992 "Për shëndetin publik dhe inspektoriatin sanitar shtetëror" i ndryshuar;
	Ligji Nr.9915, datë 12.5.2008 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8102 /1999 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura";
	Ligji Nr 34/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura";
	Ligji Nr. 37/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet e Republikës së Shqipërisë";
	VKM Nr. 145 datë 26.02.1998 "Për miratimin e rregullores higjieniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm";
	Ligji Nr.9860, datë 21.1.2008 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.8518, datë 30.07.1999 "Për ujitjen dhe kullimin";
	VKM 1340/2009 "Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e sherbimit të ujesjellës-kalizimeve";
	Ligji Nr 45/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10138 datë 11.05.2009 "Për shëndetin publik";
	Ligji Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Përpunoi: Co-PLAN, 2016

2.3 Grumbullimi i informacionit dhe analizat e kryera

Për të kryer analizat mjedisore në kuadër të PPV-së dhe VSM-së janë mbledhur një sërë informacionesh, burimi i të cilave janë institucionet publike, studimet dhe raportet e ndryshme të hartuar nga profesionistë të fushës dhe matjet e drejtpërdrejta e vëzhgimet vizuale. Hapi i parë i këtij procesi ishte krijimi i formatit të inventarit të të dhënave që nevojiteshin dhe metodologjisë për grumbullimin e tyre. Sa më poshtë paraqitet lista e treguesve paraprakë që u konsideruan për inventarin e informacionit.

Mbi bazën e kësaj liste u përpiluan letrat zyrtare, të cilat Bashkia ua nisi institucioneve dhe organizatave përkatëse, me të cilat ndoqi në vijim procesin për të siguruar këto të dhëna.

Tabela 4. Formati i inventarit paraprak të informacionit për VSM-në

Nr.	Fusha	Komente
1	**Industri**	Çështjet e mjedisit: përfshirë në seksionet e ajrit, ujit, tokës e mbetjeve më poshtë.
1.1	Lloji i industrisë (sipas funksioneve, nënkategorive të përdorimi të tokës)	Bashkitë dhe Përdorimi i Tokës
2	**Energji**	
2.1	Energjia e konsumuar për banor (kwh/banor)	Ministria e Ekonomisë
2.2	Nr. i HEC-eve në zonë	Të ndërtuar dhe të pritshëm
2.3	Kapaciteti i prodhimit/ HEC	
2.4	Totali i energjisë së prodhuar në zonë	
2.5	Totali i energjisë së prodhuar	
2.6	Sasia e energjisë prodhuar nga burime të rinovueshme	
3	**Turizmi**	
3.1	Lloji i turizmit (detar, gjuetie, etj)	
3.2	% e vizitorëve të pranishëm jashtë stinës së turizmit	
3.3	Sipas llojit, efekti e turizmit ne florë, faunë, ose zona të mbrojtura)	
3.4	% e tokës bujqësore e përdorur për ndërtime/infrastrukturë në fushën e turizmit	
3.5	Njerëz që udhëtojnë për në qytet	Numër ose % / ditë
3.6	Numri i shtretërve (hotelier)	
3.7	Numri i hoteleve	
3.8	% e të punësuarve në turizëm	
3.9	Netë për person në vit	
4	**Bujqësia**	
4.1	Sasia në ha e tokës bujqësore	
4.2	Sasia në ha e tokës bujqësore me cilësi të lartë	Boniteti
4.3	Sasia në ha e tokës bujqësore të humbur (shndërruar në zonë banimi/ industriale/ etj.) gjatë 10 viteve të fundit.	Nga hartat
4.4	% e bujqësisë familjare *versus* bujqësisë industriale	Studime, organizata fermerësh dhe *vëzhgim*
4.5	Sasia në ha e tokave bujqësore me vlerë jo shumë të lartë, ose toka pa vlerë bujqësore (jo prodhuese, ose shpate kodrash etj., që zakonisht njerëzit i braktisin).	Boniteti
4.6	Numri/sasia e zonave të mbrojtura në tokë bujqësore	Nga hartat e zonave te mbrojtura zyrtare
4.7	Numri i zonave të mbrojtura në tokë private	Nga hartat e zonave te mbrojtura zyrtare
4.8	Sasia/lloji i plehrave kimike të përdorura në bujqësi	Raportet e mjedisit ne nivel baseni ujor
4.9	Lloji i rasteve të ndotjeve të raportuara nga bujqësia (pesticide, pleh kimik etj.)	Raportet e mjedisit ne nivel baseni ujor dhe *vëzhgim*
4.10	Mënyra/sasia e plehut të prodhuar nga kafshët për fermë (nëse ky është rasti)	
4.11	Metoda e kultivimit të tokës (intensive-industriale, biologjike, e ndërmjetme etj)	
4.12	Sipërfaqe e sipërfaqeve të përmbytshme/ përmbytura	Nga harta dhe *vëzhgim*
5	**Blegtoria**	

5.1	% e tokës e përdorur si kullotë	
5.2	Sipërfaqe e pyjeve dhe kullotave	Instat në nivel qarku, FAO.
5.3	Numri/lloji i gjedheve	Zyra rajonale veterinare
5.4	Lloji i fermave (intensive etj.)	Zyra rajonale veterinare
5.5	Numri i rracave të rralla, vendore	Zyra rajonale veterinare
6	**Peshkimi**	
6.1	Të dhëna rreth biodiversitetit në burimet ujore	Ministria, Raportet e monitorimit të mjedisit
6.2	Të dhëna rreth sasisë së peshkuar	Ministria, Raportet e monitorimit të mjedisit
6.3	Të dhëna rreth kapacitit bartës	Ministria, Raportet e monitorimit të mjedisit
7	**Transporti**	
7.1	Numri/% e qytetarëve që përdorin transport privat	*Ndikimi në përdorim toke, peizazh, biodiversitet, ndotje ajri/zhurma, siguri rrugore*
7.2	Numri/% e qytetarëve që përdorin transport publik	
7.3	Ndotësit e shkarkuar në ajër nga përdorimi i automjeteve	Shih seksionin e ajrit
7.4	Zonat me ndotje akustike (sip sipas decibel)	
8	**Rrugët**	
8.1	% e sipërfaqes së rrugëve në raport me sipërfaqen totale të tokës bujqësore	
8.2	% e tokës bujqësore/ pyjeve/ ligatinave/ habitateve/etj. të humbur për ndërtim rrugësh	Harta, pas 1990, krahaso me topografiket
8.3	% e rrugëve kryesore në qendra të banuara (për të parë nivelin e zhurmës)	
8.4	Distanca rrugësh sipas kategorive nga zonat e mbrojtura natyrore dhe monumente kulture	Në hartë
8.5	Sasia ne km e rrugëve që ndërpresin breza të gjelbër, korridore te gjelbra, korridore shpendësh/kafshësh?	
8.6	Sasia ne km e rrugëve që izolojnë (ndajnë) zona të banuara/habitate të ndryshme	
9	**Furnizimi me ujë**	
9.1	% e Gjatësisë së lumenjve që konsiderohet të kenë ujë të një cilësie të mirë (të pijshëm)	
9.2	% Gjatësia e lumenjve që konsiderohet të kenë ujë të një cilësie të dobët	
9.3	Sipërfaqe ujore jo lumore me uje te pijshem (sip dhe % ndaj totalit)	
9.4	Numri i zonave me ujëra të përdorshme për plazh/banjo	
10	**Ujërat e Të ndotura**	
10.1	Kapaciteti total i përpunimit të ujërave të të ndotura	
10.2	Numri i impianteve të pastrimit të ujërave të të ndotura në funksion	
10.3	% e popullsisë e lidhur me sistemin e ujërave të të ndotura	
10.4	% e aktiviteteve industriale lidhur me sistemin e ujërave të të ndotura	
10.5	Numri i shtëpive të palidhura me sistemin e ujërave të të ndotura	
11	**Mbetjet e ngurta urbane**	
11.1	Volumi total i mbeturinave të grumbulluara nga Bashkia/qyteti	
11.2	Volumi i mbeturinave të prodhuara për banor/qytet-ose-fshat	
11.3	% e mbeturinave të depozituara në *landfill*/ vendgrumbullim	

11.4	% e mbeturinave të ricikluara	
11.5	% e mbeturinave të djegura me inceneritor	
11.6	% e mbeturinave të kompostuara	
11.7	Kapaciteti i impianteve të pranishme në territor për trajtimin e mbeturinave të ricikluara	
11.8	Kapaciteti i inceneritoreve/teknologjive te tjera në territor për djegien e mbeturinave	
11.9	Kapaciteti i landfilleve	
11.10	Numri i vendgrumbullimeve	
12	**Mbetjet spitalore**	
12.1	Sasia e mbetjeve spitalore	
12.2	% e trajtimit të mbetjeve spitalore	
12.3	% e mbetjeve të përziera me mbetjet e tjera	
12.4	% e mbetjeve të ricikluara	
13	**Mbetjet industriale, toksike dhe të dëmshme**	
13.1	Sasia totale e mbetjeve të prodhuara	
13.4	Kapaciteti i landfilleve për grumbullimin e këtyre lloj mbetjesh	
13.5	% e këtyre mbetjeve e eksportuar	
13.6	% e mbetjeve të trajtuara në vend	
14	**Mbetje të tjera**	
15	**Toka**	
15.1	Sasia në ha e tokës sipas përdorimit: urbane/rurale, e braktisur (industriale, minerale etj.), bujqësore, pyje, zona të rëndësisë së veçantë, sipërfaqe ujore, etj.	Sipas kategorive bazë të përdorimit të tokës
15.2	Sasia në ha e tokës bujqësore me cilësi të lartë	Boniteti
15.3	Sasia në ha e zonave të gjelbra përreth qendrave urbane	Si tek infrastruktura
15.4	Sasia në ha e tokave të braktisura (pa përkujdesje)	Koordinim me tokat bujqësore dhe natyrore
15.5	Sasia në ha e tokave të ndotura	
15.6	Sasia në ha e hapësirave natyrore	Koordinim me nënkategoritë e përdorimit të tokës
15.7	% e tokës bujqësore të mbrojtur me ligj	Boniteti (Kat. I-IV)
15.8	Sasia e tokës/të dhëna humbur nga erozioni/shembjet e tokës sipas llojeve	
16	**Uji**	
16.1	Cilësia e ujit të lumenjve dhe burimeve nëntokësore, duke përfshirë edhe ujin e pijshëm	Raportet e gjendjes se mjedisit dhe *vëzhgim*
16.2	Cilësia e ujit sipërfaqësor	Raportet e gjendjes se mjedisit dhe *vëzhgim*
16.3	Sasia e ujit nëntokësor	
16.4	Sipërfaqja e përgjithshme e tokës nën ujitje	
16.5	Sasia e përgjithshme e ujërave në rezervuare	
16.6	Numri i impianteve për trajtimin e ujit të përdorshëm	
16.7	Sasia e ujit të nxjerrë nga nëntoka për ta pirë	
16.7	Numri i shtëpive të lidhura me sistemin e furnizimit me ujë	
16.8	Numri i shtëpive të palidhura me sistemin e furnizimit me ujë	
16.9	Sasia e ujit që është trajtuar në impiante me qëllim për ta pirë	
16.10	Sedimentet dhe aluvionet	
16.1	Të dhëna rreth trupave ujorë ku është shfaqur	

1	fenomeni i Eutrofikimit	
16.12	Llojet e ndotësve të pranishëm në ujë nga aktivitete urbane (bizneset e riparimit te makinave, industria)	
16.13	Numri dhe sipërfaqja e ligatinave dhe gjendja e tyre (në nivel uji)	
16.14	% e sasisë së ujit të ndotur të trajtuar në raport më sasinë totale	
17	**Biodiversiteti**	
17.1	Numri/lloji i specieve	
17.2	Numri dhe llojet e habitateve dhe funksionet	
17.3	Numri i specieve në zhdukje/shfrytëzim të tepruar jashtë kapacitetit bartës	
17.4	Numri i habitateve në zhdukje, degradim, copëtim, ndryshim/shfrytëzim të tepruar	
17.5	Sasia në ha e sipërfaqes së habitateve natyrore të mbrojtura me ligj	
17.6	Numri i specieve invazive	
17.7	Specie, familje, gjini, ndarë sipas habitateve (ujore, tokësore, moçalore, lumore, detare, etj.)	
17.8	Vlera të rralla (pasuri e vendit që duhen ruajtur), zona të mbrojtura	
17.9	Vlera të veçanta që mendohet të shfrytëzohen per zhvillimin e vendit/turizem	
17.10	Statusi i specieve (të kërcënuara globalisht, të mbijetuara nga marrëveshje ndërkombëtare, të zhdukura, të rrezikuara, të kërcënuara, të rralla, të prekshme, të panjohura etj.)	
17.10	Numri i biokorridoreve, vendndodhja dhe roli i tyre	
18	**Pyjet**	
18.1	Sasia në ha e sipërfaqeve të pyjeve, pozicioni	Disa ndërthuren me biodiversitetin
18.2	Sasia në ha e sipërfaqeve të shpyllëzuara	
18.3	Lloji i drunorëve, pemtarisë sipas zonave/habitateve	
18.4	Llojet e specieve të humbura për për shkak të shpyllëzimit	
18.5	Numri i specieve të veçanta, sasia në copë dhe shpërndarja,	
18.6	Numri i specieve me vlerë të rrallë ekologjike ose tregtare/ekonomike	
18.7	Numri i zjarreve në pyje gjatë viteve të fundit (trendi)	
19	**Ajri**	Gazrat e përfshira në ligjin për mbrojtjen e ajrit
19.1	Sasia e ndotësve të shkarkuar në atmosferë nga industritë/aktivitete të tjera/trasporti/ndërtimet	SO2, *oksid nitrik* (N2O), *lëndë të grimcuara* (hi, pluhur)
19.2	Sasia e lëndëve djegëse fosile të djegura	*Plumbi* (Pb), pb, O3, *benzen, monoksid karboni* (CO)
19.3	Numri i ditëve që ozoni (O3) kalon vlerat e lejuara prej 120 µg/m3	*dioksid karboni* (CO2), *klorofluorokarbonet* (CFCs), *perfluorokarbonet* (PFCs)
19.4	Numri i ditëve që NO2 kalon vlerat e lejuara me ligj prej 200 µg/m3	*Kadmiumi* (Cd), *Arseniku* (As), *Nikeli* (Ni), *Mërkuri* (Hg), *Radoni* (Rn)
19.5	Numri i ditëve grimcat e imëta PM10 kalojnë kufijtë e lejuar me ligj prej 50 µg/m3	
19.6	Numri i ditëve grimcat e imëta PM2.5 kalojnë kufijtë e lejuar prej 50 µg/m3	
19.7	Përqëndrimet e akumuluara të ozonit që kalojnë 70 µg/m3	

19.8	Përqendrimet mesatare vjetore të NO2 (µg/m3)	
19.9	Përqëndrimet mesatare vjetore të PM10 (µg/m3)	
19.9	Numri i banorëve që jetojnë në zona me nivel zhurme >65 dB(A) gjatë ditës	
19.10	Numri i banorëve që jetojnë në zona me nivel zhurme >55 dB(A) gjatë natës	
19.11	Numri i banorëve që jetojnë në zona me nivel zhurme > 65dB(A) gjatë ditës	
19.12	Numri i banorëve që jetojnë në zona me nivel zhurme > 55dB(A) gjatë natës	
19.13	Numri i banorëve që jetojnë në zona me nivel zhurme (nga trafiku ajror) >65 dB(A) gjatë ditës	
19.14	Numri i banorëve që jetojnë në zona me nivel zhurme nga trafiku ajror >55 dB(A) gjatë natës	
20	**Ndryshimet klimatike**	
20.1	Të dhëna rreth ndryshimit te temperatures në përgjithësi	
20.2	Të dhëna rreth sasisë së reshjeve në vite	Mujore, vjetore, ekstremet, Instituti i Meteorologjisë
20.3	Të dhëna rreth shkrirjes së akujve	
20.4	Të dhëna rreth ngritjes së nivelit të detit (stuhitë, erozion bregdetar/ujor, kripëzim tokash)	
20.5	Të dhëna rreth përmbytjeve, stuhive dhe erërave të forta	Sipërfaqe, vitet përkatëse,
20.6	Të dhëna rreth thatësirës (ulja e sasisë/cilësisë së ujit, sa herë)	
20.7	Të dhëna rreth shembjeve të dheut	
20.8	Temperaturat mesatare vjetore, stinore, ekstremet	
20.9	Sasia e përdorur e energjisë nga fokarburante fosile/energji e rinovueshme në raport me totalin e energjisë	
20.10	Sasia e gazrave serë (CO_2; N_2O; CH_4; O_3) të shkarkuar në atmosferë	
20.11	Sasia e energjisë së përfituar nga masat për rritjen e efiçencës energjitike	
21	**Ndotja dhe dëmi mjedisor sipas llojeve**	
22	**Efektet e ndryshimeve klimatike**	
23	**Peizazhi**	Sipas ligjit për zonat e mbrojtura dhe komponentë të tjerë.

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Hapi i dytë ishte procesi i studimit (*desk review*) të materialeve (dokumente e raporte) ekzistuese dhe të dhënave e informacioneve që burojnë prej tyre. Informacionet e grumbulluara në këtë mënyrë, të kombinuara me faktet e dokumentuara gjatë vëzhgimit vizual, përbënë bazën parësore për plotësimin e inventarit mjedisor paraprak dhe hartimin e raportit fillestar të analizës mjedisore.

Hapi i tretë ishte realizimi i vëzhgimit të parë vizual për burimet dhe vlerat mjedisore në të gjithë territorin e Bashkisë. Për këtë qëllim u përgatitën harta itineraresh dhe gjatë vëzhgimit vizual u mbajtën shënim informacionet, si dhe u dokumentua realiteti përmes fotografive.

Hapi i katërt ishte realizimi i takimeve me të gjitha institucionet, të cilave iu dërguan letra zyrtare, me qëllim marrjen e informacioni dhe konsultimit shkencor e profesional mbi temat përkatëse. Lista e institucioneve të kontaktuara jepet e detajuar në Shtojcën 1 të këtij dokumenti. Burimet kryesore publike të informacionit kanë qenë: Bashkia me të gjitha departamentet e saj, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Administrata e Zonave të Mbrojtura Fier, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Ministria e Bujqësisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, INSTAT-i, biznesi, Agjencia e Basenit Ujor të Semanit, Agjencia Kombëtare e Territorit, etj.

Në vijim (hapi i pestë) grupi i punës, ndërmori realizimin e analizave të ujërave të lumit Seman që përshkon Bashkinë Lushnje. Këto analiza u realizuan në një kontekst më të gjerë sa segmenti i lumit Seman në territorin e Bashkisë Lushnje, dhe u shtrinë në një sipërfaqe të konsiderueshme të pellgut të Semanit (Osum, Devoll, Seman, Gjanicë) dhe të Shkumbinit. Për këtë qëllim u morën kampione të ujërave në pika të caktuara të lumenjve. Pikat u përcaktuan mbi bazën e njohurisë për aktivitetin njerëzor e urban përgjatë lumenjve. Përmes këtyre analizave u realizua një përditësim të dhënash, dhe një këndvështrim i pavarur mbi gjendjen e ujërave. Për më tepër, këto analiza përfshinë edhe metalet e rënda, për të cilat mungon informacioni nga burimet publike.

Si kërkesë ligjore nga VKM-ja nr. 671, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", u realizua edhe analiza e metabolizmit të territorit. Kjo është një analizë mjedisore e cila vlerëson flukset që përshkojnë (hyjnë, procesohen dhe dalin) një territor të caktuar dhe më konkretisht: ujin, energjinë, ushqimin (produktet bujqësore e blegtorale) dhe mbeturinat. Analiza synon të përcaktojë efiçencën e përdorimit të këtyre fluksve në territor, dhe mbetjet që flukset lënë në të. Ka po ashtu për qëllim të lidhë territorin si objekt i planifikimit me burimet mjedisore dhe përdorimin e tyre.

Analiza të tjera të realizuara janë të formës sasiore dhe cilësore, mbi bazën e shifrave dhe fakteve të siguruara. I gjithë informacioni (i mundshëm) është hedhur dhe përpunuar në GIS (sistemet gjeografike të informacionit) dhe analizën me mbivendosje të shtresave (*overlay analysis*). Për shembull, informacioni sasior, cilësor dhe hartografik i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar mbi vlerësimin e gjeorreziqeve në Shqipëri në nivel qarku (Qarku i Fierit) është studiuar dhe vendosur si bazë për shumë harta të tjera tematike. Mbivendosja e shtresave të informacionit, synon të nxjerrë në pah zonat apo hapësirat ku rreziku mjedisor është më i lartë.

Po ashtu është realizuar analiza e fondit pyjor, duke përdorur të dhënat e burimeve zyrtare (përfshirë hartat) dhe imazhet në foto ajrore dhe duke krahasuar ndryshimet e ndodhura në kohë. Është realizuar harta e sistemit të kullimit dhe vaditjes, apo harta e problemeve mjedisore, e pikave të nxehta dhe ndotëse, etj. Është realizuar edhe analiza e peizazhit, ku fillimisht është hartografuar matrica natyrore dhe, më pas, në të janë evidentuar të gjitha sipërfaqet sipas tipologjive peizazhformuese. Harta të tjera janë ato të shërbimeve publike (furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura), etj.

2.4 Format e vlerësimit

Vlerësimi mjedisor është kryer për programet dhe projektet e PPV-së, të cilat u hartuan fillimisht në strategji, u rishikuan në planin e zhvillimit dhe u plotësuan më tej edhe gjatë hartimit të Planit të Investimeve Kapitale. Vlerësimi i tyre për ndikimin në mjedis bëhet në mënyrë cilësore dhe sipas rastit, edhe sasiore. Kriteret që përdoren

për vlerësim bazohen në Shtojcën 1 të ligjit 91/2013, ku përcaktohen disa kritere ndihmëse për vlerësimin, si më poshtë:

1. **Cilësia e përbërësve të mjedisit** në zonën e ndikimit të mundshëm të planit apo programit të propozuar dhe **problemeve mjedisore ekzistuese** në këtë zonë.

2. **Ndikimet negative mjedisore që mund të rezultojnë** nga zbatimi i planit ose programit, duke konsideruar:

h. **mundësinë e shfaqjes** së ndikimeve negative,

i. **kohëzgjatjen** dhe **natyrën** e tyre;

j. **mundësinë e riaftësimit** të gjendjes së mjedisit, si pasojë e ndaljes së ndikimeve negative në të (**kthyeshmëria ose pakthyeshmëria** e ndikimit në mjedis);

k. **natyrën kumulative** të dikimeve;

l. **natyrën ndërkufitare** të ndikimeve;

m. **madhësinë dhe shtrirjen hapësinore** të ndikimeve negative;

n. **pasojat e dëmshme** të tij në mjedis, për shkak të cilësive mjedisore ekzistuese.

3. Shkalla në të cilën plani ose programi mund të ketë **ndikim në zonat e mbrojtura, peizazh** apo **trashëgiminë kulturore e arkeologjike** të mbrojtur me ligj.

4. Shkalla e **përputhjes ose jo të planit** apo programit të propozuar **me objektivat kombëtarë e vendorë të mbrojtjes së mjedisit** dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm në vend."

Nga kriteret e pikës 2/e, natyra ndërkufitare e zhvillimeve nuk është e aplikueshme për Bashkinë e Lushnjes, për shkak të pozicionimit të saj gjeografik.

Për të realizuar vlerësimin e ndikimit të projekteve në objektivat mjedisore (përbërësit e mjedisit) sipas kritereve të mësipërme, është krijuar Tabela 5. Kriteret e mësipërme janë përdorur me pesha në vlerësim, sipas tabelës së mëposhtme. Pesha më e madhe i është dhënë natyrës së ndikimit, zonës/grupit të prekur (madhësia) dhe faktit nëse ka dëme apo jo në mjedis. Vlerësimi për çdo kriter bëhet me ***0 (keq), 10 (i mirë)*** dhe një vlerësim ***të ndërmjetëm*** i cili merr pikë nga ***0.1 deri në 9.9***. Kur pikët shumëzohen me peshën përkatëse, ato japin vlerën numerike të vlerësimit të ndikimit të projektit në përbërësin përkatës mjedisor, që përkon edhe me Objektivin Mjedisor të VSM-së.

Pra, në parim, sa më tepër pikë merren në vlerësim, aq më i vogël është ndikimi negativ në mjedis. Kjo vlen si në nivel kriteri, ashtu edhe në nivel vlerësimi total për një projekt të planit. Kjo do të thotë se ***vlerësimi total i ndikimit në mjedis sipas kësaj tabele, për një propozim të caktuar të PPV-së, lëviz nga 0 (shumë negativ ose me ndikim të shumë të lartë negativ) në 10 pikë (shumë pozitiv ose pa ndikim negativ).***

Tabela 5. Kriteret e vlerësimit të ndikimit, peshat dhe pikët

Pesha %	**Kriteri i vlerësimit**	**Shpërndarja e pikëve të vlerësimit**		
10%	1. Mundësia e shfaqjes	PO	JO	E pasigurt
	Pikët	*0.1*	*10*	*1-9.9*
20%	2. Kohëzgjatja	E menjëhershme & qëndrueshme	E vogël, e papërfillshme	Afatshkurtër, ose afatgjatë
	Pikët	*0.1*	*10*	*1-9.9*
20%	3. Natyra e ndikimit	Shkatërron habitatin	Neutrale	Dëmton shërbime të caktuara të ekosistemit
	Pikët	*0.1*	*10*	*1-9.9*
10%	4. Mundësia e riaftësimit të ndikimit	Kthim i plotë	Nuk ka kthim të ndikimit	E pjesshme
	Pikët	*0.1*	*10*	*1-9.9*
20%	5. Natyra kumulative	PO	JO	E pasigurt
	Pikët	*0.1*	*10*	*1-9.9*
20%	6. Madhësia/Shtrirja	Sipërfaqe e madhe & populsi	Pikësore, e kufizuar dhe jo populsi	E ndërmjetme
	Pikët	*0.1*	*10*	*1-9.9*

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Duke qenë se vlerësimi, pavarësisht metodologjisë numerike/sasiore (*multi-criteria analysis*) të zgjedhur, mbart edhe peshë subjektive, vlerësuesit shprehen edhe në tekst, pra në mënyrë cilësore e jo vetëm saiore, për ndikimin në mjedis të çdo projekti. Teksti përshkruan ndikimin e mundshëm, nëse nuk merret asnjë masë mjedisore, pra në skenarin 0 të ndërhyrjeve mjedisore. Anash tekstit vendoset masa e marrë zbutëse. ***Vlerësimi numerik (sasior) tregon ndikimin në mjedis në rastin kur parashikohet marrja e masave zbutëse, pra në skenarin kur realizohen ndërhyrje mjedisore përmirësuese***.

Në varësi të pikëve që grumbullon secili propozim, jepet vlerësimi final sipas tabelës (matricës) së vlerësimit të ndikimit në mjedis të paraqitur në vijim. Për këtë qëllim pikët shndërrohen në sheNja konvencionale, që e bëjnë tabelën lehtësisht të lexueshme. Konvertimi kryhet sipas këtij rregulli:

Tabela 6. Simbolika e vlerësimit të ndikimit në mjedis

Pikët e Vlerësimit	**Simbolika e matrices së vlerësimit dhe kuptimi përkatës**	
0.1 – 3 pikë	↓	Ndikimi i lartë/shumë i lartë (shkatërrues mbi shëndetin dhe mjedisin)
3.1 – 6 pikë	→	Ndikim mesatar (pa garanci për shëndetin dhe mjedisin, pamvarësisht nga masat zbutëse)
6.1 – 8.5 pikë	↗	Ndikimi i ulët (në rast se masat zbutëse dhe parandaluese rrespektohen)
8.6 – 10 pikë	↑	Ndikimi i papërfillshëm (nëse zbatohen masat, dhe nuk cënohet ekuilibri natyror)
Vlerësimi i pa aplikueshëm	○	Ndikim neutral ose pa ndikim (ndikime të mundshme janë të përkohshme, afatshkurtra dhe mjedisi vetripërtërihet pa ndërhyrje)

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Tabela përfundimtare e vlerësimit do të ketë formatin në vijim dhe në qelizat e vlerësimit do të hidhen simbolet e mësipërme sipas pikëve vlerësuese.

Tabela 7. Paraqitja përfundimtare e vlerësimit

Bashkia LUSHNJE: Ndikimi										
Objektivat Mjedisore	OM 1	OM 2	OM 3	OM4	OM 5	OM6	OM 7	OM8	OM9	
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiv-ersiteti	Pyjet	Peizazh	Klima	Kultura	Shëndet	Social-ekonomik
O1: Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor										
Pr1:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr2:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr3:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr4:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
O2: Zhvillimi i [eko]turizmit										
Pr1:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr2:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr3:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr4:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
O3: Zhvillimi i planifikuar e kontrolli i territorit										
Pr1:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr2:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr3:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr4:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
O4: Mbrojtja e burimeve natyrore										
Pr1:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr2:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr3:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Pr4:	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Vlerësimi tjetër që kryhet, nisur nga Shtojca I e ligjit 91/2013, është ai i përputhshmërisë ndërmjet objektivave, programeve e projekteve të Planit dhe objektivave të VSM-së. Duke qenë se projektet formojnë programe dhe programet formojnë objektiva, vlerësimi nis nga projektet dhe përfundon tek objektivat. Tabela 8 paraqet formatin e vlerësimit të përputhshmërisë, ndërsa Tabela 9 paraqet vlerat numerike të cilat përdoren për të kryer vlerësimin, sipas kategorive/niveleve të përputhshmërisë. Janë paraqitur 5 nivele të përputhshmërisë:

1. *Objektivat/ programet/ projektet përputhen plotësisht me OM-të:* Ky rast merr vlerësim maksimal të barabartë me 3. Ka raste që projekte të caktuara mund të mos kenë përputhje të plotë, por marrja e masave mjedisore i bën të përputhshëm.
2. *Objektivat/ programet/ projektet përputhen pjesërisht me OM-të:* Përputhja është e pjesshme edhe pse zbatohen masa mjedisore, pra realizohet me kushte.
3. *Lidhja/ përputhshmëria është e zbehtë:* Përputhshmëria është e dobët, edhe pse realizohen masat mjedisore. Kjo nënkupton që impakti neutralizohet pjesërisht, ose minimalisht.
4. *Nuk ka lidhje (përputhshmëria neutrale):* Objektivat, programet, projektet nuk tregojnë përputhje në pamje të parë, por as përplasje. Pra nuk nuk kanë ndikim negativ të ndërsjellë e veçanërisht ato të planit në objektivat e VSM.
5. *Objektivat/ programet/ projektet nuk përputhen me OM-të:* janë në kundërshtim të plotë, pavarësisht masave zbutëse që mund të merren.

Tabela 8. Vlerësimi i përputhshmërisë mes objektivave të Planit dhe të VSM-së

Objektivat Mjedisore	OM 1	OM 2	OM3	OM 4	OM 5	OM 6	OM 7	OM 8	OM 9	Vlerësimi mesatar
Objektiva, Programe, Projekte të PPV-së										
O1:										
O1P1:										
Pr1:										
O1P2:										
Pr1:										
O2:										
O2P1:										
Pr1										

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Tabela 9. Vlerat e përdorura për përputhshmërisë e objektivave të Planit me VSM.

Niveli i përputhshmërisë	Vlerësimi numerik	Vlerësimi mesatar
1. Objektivat/ programet/ projektet përputhen plotësisht me OM-të	3	2.51 – 3.00
2. Objektivat/ programet/ projektet përputhen pjesërisht me OM-të	2	1.50 – 2.49
3. Lidhja/ përputhshmëria është e zbehtë	1	0.01 – 1.49
4. Nuk ka lidhje (përputhshmëria neutrale)	0	0.00
5. Objektivat/ programet/ projektet nuk përputhen me OM-të	-1	Negativ

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Një tjetër element përputhshmërie, që do të verifikohet, është edhe sasia (e matur në %) e objektivave mjedisore për të cilat çdo projekt ka:

- Përputhshmëri të lartë (PL)
- Përputhshmëri të pjesshme (PP)
- Përputhshmëri të zbehtë (PZ)
- Përputhshmëri neutrale (PN)
- Mungon përputhshmëria (PG).

Pra, kështu matim jo vetëm përputhshmërinë e çdo projekti me të gjitha objektivat njëherësh, por edhe kuptojmë, për çdo projekt, se në cilat OM dhe në sa prej tyre (e matur në % ndaj totalit prej 9 OM-ve) arrihet, ose cënohet përputhshmëria e lartë.

3. Përmbledhje e Planit të Përgjithshëm Vendor

3.1 Vizioni dhe Objektivat strategjike

Vizioni i zhvillimit të territorit për bashkinë e Lushnjes është hartuar në mënyrë organike, si rezultat i gjetjeve të analizës së përgjithshme të territorit, diskutimeve me qytetarët, takimeve me grupet e interesit dhe reflektimeve të grupit të punës gjatë studimit të kontekstit rajonal në të cilin ndodhet bashkia. Po ashtu, vizioni i Lushnjes bazohet në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe të Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit. Mbi këto baza, pjesëmarrësit në këto diskutime, nën drejtimin e grupit të punës, kanë rënë dakord për formulimin e vizionit strategjik që do të udhëheqë zhvillimin e bashkisë së Lushnjes gjatë 15 viteve të ardhshme, si më poshtë:

Bashkia e Lushnjes do ta orientojë të ardhmen e saj mbi konceptet e rritjes së ekuilibruar dhe të qëndrueshme. Bashkia do të synojë forcimin e rolit ekonomik të saj në rajon, si qendra e zhvillimit bujqësor dhe blegtoral. Zhvillimi i këtij sektori do të bëhet përmes promovimit të teknikave të prodhimit të produkteve organike dhe cilësore, etiketimit dhe marketimit të tyre, duke synuar rritjen e prezencës së tyre në tregjet vendase dhe ato të huaja. Zhvillimi i ekonomisë bujqësore do të bëhet në mënyrë të qëndrueshme, duke u kujdesur për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe burimet e tjera natyrore me qëllim garantimin e mirëqenies sociale të qytetarëve ekzistues dhe brezave të ardhshëm. Profili ekonomik i bashkisë do të plotësohet me promovimin e ekoturizmit si potencial i pashfrytëzuar në territoret me peizazhe të bashkisë së madhe të Lushnjes.

Në vizionin e kësaj bashkie, rëndësi të veçantë ka mirëqenia sociale dhe rritja intelektuale si shtylla kryesore që garanton zhvillim të qëndrueshëm. Për këtë arsye, zbutja e pabarazive sociale dhe përmirësimi i infrastrukturave dhe shërbimeve publike në të gjithë territorin e bashkisë do të jetë prioritet.

Në një lexim më të thelluar të territorit të Lushnjes do të mund të dallojmë elementet qytet/fshat formues si më poshtë:

1. Bashkia e Lushnjes përshkohet nga fasha më e madhe e tokës bujqësore në qarkun e Fierit dhe jo vetëm, e cila mbart edhe potencialin më të madh ekonomik bujqësor të kësaj bashkie.
2. Kjo fashë kufizohet nga 2 breza të rëndësishëm kodrinorë, të cilët mbartin vlera të larta peizazhistike për bashkinë Lushnje. Brezi kodrinor i Ardenicës (Kolonjës) ka potencialin e të qenit zona agro-turistike më e rëndësishme në bashkinë Lushnje, së cilës, krahas vlerave natyrore dhe peizazhit çlodhës, i shtohen edhe elemente të trashëgimisë kulturore si Manastiri i Shën Mërisë, Ardenicë dhe monumenti i natyrës Dushkaja e Ardenicës. Në lindje të Lushnjes shtrihet brezi kodrinor Fier-Shegan – Dushk. Ky brez, përveçse është kufizues deri diku i zhvillimeve informale dhe të pakontrolluara urbane, ka zhvilluar ndër vite edhe sektorin e vreshtarisë dhe ullishteve, duke i sjellë një vlerë të shtuar bashkisë Lushnje nga pikëpamja agro-kulturore.
3. Të dyja këto sisteme të rëndësishme territoriale ndërpriten në mënyrë horizontale nga rrjedha të rëndësishme ujore, nga të cilat evidentojmë (nga veriu në jug): lumin Shkumbin në kufirin më verior të bashkisë së madhe


Lushnje; përroin e Lushnjes, i cili rrjedh nga liqeni i Kasharajt dhe zgjatet deri në Kolonjë dhe është një nga elementet më të forta të qytetit; emisari kryesor, i cili përshkon tokat pjellore të Lushnjes nga lindja në perëndim; si dhe lumi i Semanit në kufirin më jugor, i cili përbën edhe një nga fashat më të rëndësishme natyrore dhe bujqësore të bashkisë Lushnje.

4. Sigurisht që elementet ujore të sipërpërmendura janë bërë edhe faktori më i rëndësishëm qytet/fshat formues ku, veç përqendrimit të madh të vendbanimeve në qytetin e Lushnjes, dallojmë edhe një fashë tjetër të rëndësishme vendbanimesh përgjatë emisarit kryesor të bashkisë Lushnje.

Nga sa u përmend mësipër, në bashkinë Lushnje do të mund të lexojmë 3 nivele, të cilat përcaktojnë edhe mënyrën e zhvillimit të ardhshëm të kësaj bashkie:


1. Niveli urban, i cili nis me Dushkun në veri dhe përfundon me Fier-Sheganin në jug, përgjatë aksit kryesor Lushnje-Berat. Plani i Përgjithshëm Vendor parashikon densifikimin e këtyre qendrave (Dushk – Lushnje – Karbunarë – Fier-Shegan) jo vetëm nga pikëpamja e vendbanimeve, por edhe nga ajo e shërbimeve dhe nyjeve të rëndësishme infrastrukturore.
2. Niveli rural shtrihet përgjatë fashës Emisar, ku është edhe përqendrimi më i madh i fshatrave bujqësore të Lushnjes (sikurse edhe vendndodhja e 4 njësive administrative). Plani parashikon kufizimin e shpërhapjes së vendbanimeve përgjatë kësaj fashe, duke mos kompromentuar tokën bujqësore, si dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe shtimin e akseve të gjelbra të lëvizjes për t'i dhënë një karakter ruralo-peizazhistik tëgjithë fashës së emisarit. Vendbanimet përgjatë këtij niveli karakterizohen nga dendësi e ulët dhe lartësi deri në 3 kate dhe oborre të brendshme.
3. Niveli i tretë është ai natyror, i cili përbëhet nga fasha e lumit Seman dhe rripi i tokave bujqësore përgjatë tij. Plani parashikon rehabilitimin e fashës ripariane përgjatë lumit Seman, ndërtimin e një rruge peizazhistike (mbi gjurmë ekzistuese) përgjatë gjithë rrjedhës së Semanit, si dhe konservimin në maksimum dhe nxitjen e bujqësisë në rripin e tokës bujqësore përgjatë kësaj fashe.

Figura 6. Nivelet e zhvillimit, Bashkia Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Figura 7. Karakteri i vendbanimeve, Bashkia Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

3.2 Plani i Zhvillimit të Territorit

3.2.1 Plani i propozimeve territoriale

Në bashkinë e Lushnjes, në mbështetje të vizionit të strategjisë së territorit dhe të analizave të thelluara të tipologjive, strehimit dhe nevojës për rigjenerim, propozohen dy kolona zhvillimi: i) transformimet strategjike dhe ii) platforma e ndërhyrjeve në territor. Këto kolona zhvillimi janë zemra e planit të zhvillimit të territorit dhe në vijim ato zbërthehen edhe në planin e infrastrukturave, planin e përdorimit të tokës, njësitë strukturore me treguesit e tyre e, së fundmi, në sistemet e territorit. Edhe instrumentet e drejtimit të zhvillimit, pra instrumentet financiare të zhvillimit të tokës (në vijim), propozohen të tilla që të mundësojnë zbatimin e këtyre kolonave të zhvillimit.

Transformimet strategjike pasqyrojnë vizionin e zhvillimit strategjik të bashkisë. Në vijim të tij, ato synojnë të vendosin në territor nyje apo atraktorë zhvillimi që do të gjenerojnë presion transformues pozitiv e njëkohësisht do të rritin cilësinë e hapësirës dhe shërbimeve në të ardhmen. Këto transformime kanë efekt katalitik për të tjera transformime pozitive dhe përbëjnë në thelb sfidën madhore që duhet të përballojë Bashkia për t`i dhënë një frymëmarrje të re territorit të saj.Transformimet strategjike janë identifikuar në mënyrë përfundimtare gjatë procesit të diskutimit dhe finalizimit të infrastrukturës rrugore dhe përdorimit të tokës.

Nga pikëpamja metodologjike, grupi i punës, pas përfundimit të hartimit tëvizionit të strategjisë së territorit, u thellua më tej në identifikimin e elementeve të forta të territorit dhe zonave të tyre të përkatësisë, përmes të cilave u gjeneruan fasha funksionale, qendërsi e zona me prioritet zhvillimi. Bazuar në faktin se në cilat territore duam të shtrijmë zonat e ndërtuara dhe për cilat qëllime u përcaktua rrjeti i infrastrukturës rrugore, ky rrjet lidh dhe/ose përshkon fashat, qendërsitë e zonat me prioritet zhvillimi. Pikërisht brenda këtyre hapësirave gjeneratore janë përcaktur edhe nyje infrastrukturore të rëndësishme dhe projekte transformuese, të cilat i quajmë transformime strategjike të territorit.

- **Transformimet strategjike** për bashkinë e Lushnjes janë:

1. Qendra e re e qytetit dhe stacioni multimodal: Kjo do të jetë një hapësirë shumëfunksionale, me intensitet të lartë ndërtimi dhe hapësirë publike të bollshme rreth ndërtesave (shërbime, tregti, banim, qendër biznesi, qendër kulturore e kinema) që ofron tematika për çdo moshë e përdorues. Në zemër të qendrës së re do të jetë stacioni multimodal për transportin publik (urban, ndërurban, ndërqytetës, tren/tram, biçikleta e taksi). Traseja aktuale e hekurudhës do të integrohet në mënyrë të tillë brenda zonës së re që të mos e ndajë atë, pra të mos funksinojnë si një barrierë. Kjo shkon në funksion të idesë se pjesa perëndimore e qytetit është shtrirja e re dhe e ardhshme e tij, ndaj traseja e shinave nuk mund të luajë rol ndarës apo të kufirit final. Për ta lehtësuar më tej këtë ndërhyrje, stacioni i mallrave do të spostohet në afërsi të zonës ekonomike të qytetit të Lushnjes (ish-Fabrika e Plastmasit)**,** duke lehtësuar në këtë mënyrë transportimin e mallrave përtej territorit të bashkisë.

Figura 8. Qendra e re e qytetit dhe Stacioni Multimodal, Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

2. Kodra e Kasharajt - Ballkoni i Lushnjes: Ky projekt nënkupton rigjenerimine zonës së banimit duke evidentuar vlerat e vendbanimit të vjetër, duke respektuar relievin kodrinor dhe në të njëjtën kohë duke krijuar hapësirë të mjaftueshme për infrastrukturën e lëvizjes. Kjo hapësirë nevojitet jo vetëm për të lehtësuar qarkullimin ditor e rritur aksesin dhe depërtueshmërinë në zonë, por edhe për të mundësuar që mjetet e urgjencës (shëndetësore apo të mbrojtjes nga zjarri) të ofrojnë ndihmën e tyre në kohë dhe me cilësi.Dikur kodra kishte një karakter thuajse tërësisht natyror, me ullishta dhe pemëtore, disa grupe të vogla shtëpish të vendosura me kujdes në peizazh dhe pa e shqetësuar atë.Oborret e gjelbra dhe madhësia e banesave krijonin një shkrirje shumë të mirë të elementit urban me atë natyror.Nga çdo pikë e kodrës mund të shihet jo vetëm qyteti, por e gjithë fusha bujqësore, kodra simotër e Ardenicës e, pse jo,edhe deti i Divjakës në ditë me qiell të pastër.

Gjatë 20 viteve të fundit kodra është tjetërsuar, duke humbur karakterin natyror në një pjesë të konsiderueshme të saj si pasojë e ndërtimeve për qëllime banimi. Ndërtimet janë banesa individuale 2-3 kate, me përjashtim të ndërtesave shumëfamiljare mbi 7 kate në rrugën mbrapa bashkisë. Banesat janë ndërtuar në mungesë të planifikimit dhe, për rrjedhojë, rrjeti rrugor nuk i ka paraprirë ndërtimit të tyre. Për pasojë, rrjeti rrugor është krijuar nga vetë njerëzit si një hapësirë lëvizjeje, por jo një rrjet i mirëfilltë infrastrukturor, dhe nuk plotëson asnjë kusht teknik, si: gjerësia (3-5 metra), shtresat konstruktive të rrugës (shtrat natyror, rrugë e pashtruar dhe me gropa), distanca e ndërtesave (vija e ndërtimit në anë të rrugës), ndriçimi publik (mungon) etj. Pjerrësia e kodrës ndikon edhe në pjerrësinë e rrugës, duke vështirësuar më tej përdorimin e saj për shkak edhe të hapësirës së pamjaftueshme për kthesat.


Studimi gjeologjik, gjeologo-inxhinierik dhe i rreziqeve gjeologjike përcaktojnë edhe përshtatshmërinë për të ndërtuar në zonën kodrinore të qytetit të Lushnjes. Sipas SHGJSH-së[44], zona kodrinore, në tërësinë e saj (me përjashtim të një pjese të vogël mbi bashkinë), përfshihet në zonën II – me shkëmbinj mesatarë dhe sektorin b – me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik. “Ndërtimet që bëhen në këtë

sektor për momentin janë të pacënuara, por që në të ardhmen, si rezultat i prishjes së ekuilibrit të shpatit apo avancimit të zonave nën erozion, pjesë të këtij sektori mund të konsiderohen si me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik. Studimet gjeologo – inxhinierike që kryhen për ndërtimet e këtij sektori, përveç vlerësimit të parametrave gjeoteknikë të shtresave të tokës, duhet të japin të dhëna të plota për fenomenet e rrezikut gjeologjik që mund t'i kërcënojnë këto ndërtime, si dhe të rekomandojnë edhe masat mbrojtëse përkatëse, me qëllim eliminimin apo mosaktivizimin e fenomeneve të rrezikut." (SHGJSH, 2014).Nisur nga hartat e SHGJSH-së në disa sektorë të vegjël të kodrës, në pjesën më të sipërme të saj (ku aktualisht janë ullishtat) vërehet edhe fenomeni i rrëshqitjes.

Duke pasur parasysh se në kodër janë kryer aktualisht shumë ndërtime dhe kryesisht informale, atëherë ekuilibri i shpatit mund të jetë tashmë i prekur dhe siguria e ndërtimeve aktuale nuk është e siguruar. Në këtë këndvështrim, çdo kërkesë për ndërtime të reja, pavarësisht funksionit, do të duhej jo vetëm të shoqërohej me një studim të hollësishëm gjeologo-inxhinierik, sipas rekomandimit të SHGJSH-së, por edhe t`i hapë rrugë studimit tërësor të qëndrueshmërisë së zonës në kushtet e ndërtimit të pakontrolluar. Në studimet e kryera para viteve `90-të, zona përcaktohej si e përshtatshme për të ndërtuar banesa individuale me lartësi jo më tepër se trikate. Gjithsesi, kjo do të mund të kryhej vetëm pas studimit të hollësishëm gjeologo-inxhinierik, si edhe me një plan urban, i cili do tëpërcaktonte shtrirjen e hapësirës publike dhe rrjetin rrugor dhe do të garantonte sigurinë e infrastrukturës e njëkohësisht të ndërtimeve. Sërish i kthehemi situatës ekzistuese kundërtimet aktuale janë realizuar në mungesë të studimit tërësor të kodrës, në kundërshtim me rekomandimin.

Duke patur parasysh se kodra aktualisht strehon banorë, ka një pozicion strategjik në qytet dhe përbën vlerë për të, bashkia liston si ndërhyrje strategjike studimin urban dhe gjeologo-inxhinierik të saj, përfshirë rrezikun gjeologjik (në shkallë të përshtatshme për caktimin e përshtatshmërisë së ndërtimit në nivel parcele). Ky studim mund të realizohet përmes punës së ndërthurur të inxhinierëve me planifikuesit dhe arkitektët dhe idetë e dizajnit mund të gjenerohen në konkurs publik.Projekti duhet të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me banorët dhe pronarët e tokave në zonë dhe inxhinierët duhet të realizojnë studimin e hollësishëm të përshtatshmërisë për ndërtim.

Figura 9. Ballkoni i Lushnjes - Kodra e qytetit



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN, 2016

Në parim, zona do të ruajë karakterin e saj organik, duke respektuar pjerrësinë e terrenit dhe duke e kthyer në tiparin e saj identifikues ndaj pjesës tjetër të qytetit. Gjelbërimi dhe natyra duhet të rikthehen në kodër.Në fakt, ullishta në pjesën e sipërme të saj duhet të depërtojë në zonën e ndërtuar përmes mbjelljes së ullinjve në oborre dhe, aty ku do të jetë e mundur, përgjatë rrjetit rrugor.Propozohet një rrugë e sipërme gjatësore peizazhistike përgjatë ullishtësdhe përbri brezit më të lartë të ndërtimeve aktuale. Kjo rrugë do të kufizojë shtrirjen e ndërtimeve në kodër. Duke qenë me kapacitet të kufizuar, ajo nuk fton për ndërtim, madje do të vendosen rregulla të rrepta për të mos ndërtuar sipër saj. Ndërtesat ekzistuese mbi rrugën peizazhistike nuk prishen, por integrohen me peizazhin ndërtimor/natyror të kodrës. Në to nuk lejohet të ndërtohet më tej.

Disa rrugë që nisin nga qendra dhe pjesa fushore dhe përshkojnë tërthor kodrën për të përfunduar në itinerarin peizazhistik i japin banorëve të kodrës frymëmarrje dhe lidhshmërinë e munguar deri më sot me qytetin. Këto rrugë kanë dy korsi dhe trotuare, në disa raste edhe korsi të dedikuar për biçikleta, të cilat vazhdojnë përgjatë gjithë gjatësisë së kësaj rruge peizazhistike. Lidhjet mes tyre do të realizohen duke respektuar izohipset e kodrës dhe hapësirën mes banesave për të ulur në maksimum kostot e shpronësimit apo të çdo instrumenti tjetër financiar që mund të përdoret. Në parim, të gjitha akset rrugore të propozuara në PPV për kodrën respektojnë itineraret ekzistuese, duke krijuar lidhje aty ku ato mungojnë. Një rrugë, e cila nis nga sheshi qendror i bashkisë, shfrytëzon itinerarin ekzistues në kodër e kalon afër banesave të vjetra të saj, do të marrë karakter historik duke ruajtur përmasat ekzistuese, duke u pajisur me ndriçim publik, duke u shtruar me kalldrëm dhe duke u përdorur si rrugë kryesisht këmbësore e me qarkullim të kufizuar të automjeteve (vetëm për banorët e rrugicës). Kjo rrugë është pjesë e sistemit këmbësor të hapësirës publike të krijuar nga bashkia e që nis në sheshin para saj dhe ngjitet drejt kodrës.

Zgjidhjet e tjera të sistemit rrugor dhe ndërtimeve mund dhe do të kryhen vetëm mbi bazën e studimit të hollësishëm urban, arkitektonik e inxhinierik të përcaktur më sipër, si dhe përmes PDV-së. Në parim, kodra nuk lejon ndërtime më të larta se 3 kate, por sigurisht vetëm nëse njëstudim gjeologo-inxhinierik i hollësishëm e konfirmon këtë. Në përfundim, plotësimi i kodrës me një sistem rrugor funksional synon, midis të tjerash, edhe të lehtësojë qarkullimin e përgjithshëm në qytet, i cili aktualisht është ngadalësuar edhe si pasojë e krijimit të sheshit këmbësor para bashkisë.

Figura 10. Transformimet strategjike në Kodrën e Lushnjes



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

3. Bulevardi rekreativ ipërroit: Përroi i Lushnjes është një nga elementet më të rëndësishmete qytetit të Lushnjes. Ringjallja e potencialit të tij rekreativ është padyshim një vlerë e shtuar për qytetin e Lushnjes. Rigjenerimi i zonës së përroit të qytetit, zonë kjo e cila përfshin jo vetëm trupin ujor, por zgjerohet deri minimumi 20


m (zona buferike e trupave ujor), do të përbëjë dhe korridorin më të rëndësishëm të gjelbër për qytetin. Plani parashikon çlirimin e kësaj hapësire, sot shpesh të zënë nga ndërtesa, nëpërmjet zgjerimit të hapësirës së gjelbër, ndërtimin e zonave ripariane aty ku janë dëmtuar, mbjelljen e bimëve dekorative të cilat ndryshojnë ngjyrën e qytetit, si dhe hapjen e hapësirave të vogla në formën e parqeve natyrale. Bulevardi i Përroit kufizohet nga të dyja anët me rrugë të cilat e përshkojnë atë në të gjithë gjatësinë. Rrugët janë përgjithësisht me dy korsi automjetesh, të cilat i shërbejnë jo vetëm banorëve ekzistues, por parashikohet të përballojnë edhe rritjen e ardhshme të fluksit të lëvizjes. Në të dyja anët e lumit rrugët janë të pajisura me korsi biçikletash dhe trotuare të gjera për këmbësorët, të cilat lidhen më tej edhe me itineraret peizazhistike të bashkisë Lushnje.

Figura 11. Bulevardi rekreativ i përroit të Lushnjes



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Figura 12. Bulevardi rekreativ i përroit të Lushnjes




Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

4. Hyrja e qytetit: Qyteti i Lushnjes, tashmë qendra e një Bashkie dhjetëfish më të madhe, është dhe gjenaratori më i madh i dinamikave sociale dhe ekonomike në bashkinë e madhe të Lushnjes. Projekti për hyrjen veriore të qytetit parashikon jo vetëm ndërhyrjet nga pikëpamja e dizajnit, por dhe rikonceptimin e të gjithë zonës veriore të këtij qyteti.Nga pikëpamja e funksionalitetit, zonat në hyrje janë përgjithësisht të një karakteri ekonomik dhe ofrojnë shërbime. Pikërisht në këtë hyrje do të jetë i pozicionuar edhe terminali i autobusëve dhe taksive (ndërqytetëse dhe rrethqytetëse). Kjo nyje favorizohet nga pozicionimi strategjik krahas infrastrukturave kryesore të cilat krijojnë jo vetëm daljen e shpejtë në rrugën nacionale drejt kryeqytetit, por dhe dalje të shpejtë në rrethrrotullimin e Plugut dhe hyrjes për në by-passin e Lushnjes.

5. Hapësira sportive: Plani i Përgjithshëm Vendor, për të mbështetur edhe frymën e lartë sportive që bashkia e Lushnjes ka (jo vetëm në qytet), parashikon ndërmarrjen e disa projekteve për ndërtimin apo përmirësimin e hapësirave sportive në të gjithë territorin. Rehabilitimi i stadiumit “Roza Haxhiu” në Lushnje dhe pajisja e tij me të gjitha elementet e domosdoshme (siç është ndriçimi i cili përkohësisht mungon) do ta kthejnë këtë pikë në qendrën më të madhe sportive të kësaj bashkie.Nga ana tjetër, hapja e 2 hapësirave të reja sportive në qytet rrit më tej kapacitetin për shfrytëzimin e hapësirave sportive nga të gjithë banorët.Hapësira të tjera sportive janë parashikuar edhe në njësitë administrative të Kolonjës, Krutjes Fier-Sheganit dhe Ballagatit.

6. Lëvizja e gjelbër: Bashkia Lushnje regjistron numrin më të madh të përdoruesve të biçikletave në të gjithë rrethin, ku 72.8% e popullsisë preferojnë të udhëtojnë me biçikleta krahas mjeteve të tjera të transportit[45]. Për të mbështetur dhe promovuar më tej këtë mënyrë të udhëtuari, sikurse dhe për të nxjerrë më tepër në pah potencialet natyrore që ka bashkia e Lushnjes, PPV-ja parashikon zgjerimin e rrjetit të gjelbër jo vetëm në rrugët e qytetit, por në të gjithë bashkinë. Ky rrjet i gjelbër (rrugët peizazhistike/vernakolare) karakterizohet kryesisht nga itinerare biçikletash dhe shtigje këmbësorësh dhe hera-herës edhe rrugë me një korsi për automjetet.Ai synon të lidhë të gjitha pikat e rëndësishme natyrore të bashkisë duke nisur me itinerarin nga liqeni i Kasharajt, përgjatë rrjedhës në përroin e Lushnjes, dhe përfundon në Manastirin e Ardenicës. Itinerare të tjera janë: itinerari i gjelbër përgjatë emisarit kryesor në pjesën fushore të bashkisë, i cili ka pikënisje zonën rekreative të rezervuarit të Thanës; itineraret dhe rrugët përgjatë Ballkonit të Lushnjes (kodra e Kasharajt); shtigjet përgjatë liqeneve të Hysgjokajt e Ballagatit etj.

Figura 13. Bulevardi rekreativ i përroit të Lushnjes




Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

7. Rrjeti i zonave të dedikuara ekonomike: Mbështjetja e aktivitetit bujqësor, si promotori kryesor i ekonomisë në bashkinë Lushnje, është objektivi kryesor i vizionit të zhvillimit të territorit të bashkisë Lushnje. Për të mbështetur këtë zhvillim, PPV-ja ka parashikuar një rrjet zonash të dedikuara ekonomike.

Zona ekonomike e Plugut vë në përdorim infrastrukturat ekzistuese dhe ish-ndërtesat industriale, të cilat i nënshtrohen pastrimit dhe rehabilitimit mjedisor për t'u kthyer në një nga pikat më të rëndësishme të përpunimit të produkteve bujqësore/industrial të bashkisë.Zona ekonomike e ish-Fabrikës së Plastmasit ka kapacitetin të akomodojë një numër të madh biznesesh dhe industrish, kryesisht ato të lehta përpunuese.Kjo zonë shfaqet mjaft e favorizuar për shkak të afërsisë me rrethrrotullimin e Beratit, i cili krijon lidhjen e shpejtë me pjesën fushore të bashkisë Lushnje.

Parku logjistik pozicionohet në afërsi të zonës ekonomike të Plastmasit dhe ka për qëllim magazinimin dhe transferimin e prodhimeve lushnjare përtej territoreve të bashkisë, pse jo edhe më gjerë në rajon.

Figura 14. Shpërndarja e zonave kryesore ekonomike në Bashkinë Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Rehabilitimi i tregut dhe ndërtimi i zonës frigoriferike në hyrje të qytetit të Lushnjes janë pjesë e rëndësishme e rrjetit të zonave ekonomike të bashkisë. Si një nga pikat kryesore të grumbullimit të produkteve bujqësore, kjo pikë, së bashku me pika të tjera të ngjashme më të vogla në njësitë administrative të Krutjes, Fier-Sheganit dhe Allkajt, favorizojnë klimën ekonomike bujqësore të bashkisë dhe promovojnë konsumimin e produkteve vendase.

Pjesë e këtij rrjeti janë sigurisht edhe nyjet e rëndësishme ekonomike/bujqësore si ajo e Sheshpushimit të Shoferit, e cila synon të akomodojë biznese të cilat operojnë në fushën e bujqësisë, si: fabrika të përpunimit të qumështit, fabrika të paketimit të produkteve bujqësore etj.

8. Peizazh për një ekosistem të vetëripërtëritshëm: Krijimi i bazës për një ekosistem të vetëripërtëritshëm është çelësi i jetëgjatësisë së zhvillimit në bashki, sidomos në paraprirje të skenareve të ndryshimeve klimatike. Ndërtimi i një matrice natyrore të integruar dhe të lidhur në të gjithë territorin e bashkisë, pavarësisht karakterit të tij, është një ndër transformimet madhore që parashikon Bashkia Lushnje. Ky peizazh zhvillohet fuqishëm në zonën natyrore e kodrinore të Karbunarës, Dushkut, Hysgjokajt, Ballagatit dhe të Kolonjës e Ardenicës, depërton në zonën urbane përmes korridoreve të gjelbra dhe atyre ujore, vijon po përmes korridoreve e ishujve natyrorë në tokë bujqësore dhe kulmon në zonat ripariane të përrenjve, të emisarit dhe mbi të gjitha të lumit Seman në pjesën më jugore të bashkisë Lushnje. Në zonën kodrinore propozohet lidhja e peizazheve të fragmentuara me pyje natyrore, ndërsa për lumenjtë duhet të rikrijohet zona ripariane, që në mjaft raste është eliminuar në funksion të rritjes së tokës bujqësore.Mirëpo, kjo ka ndikuar në dëmtimin e brigjeve dhe erozionin e tyre, shtimin e sedimenteve dhe dëmtimine tokës bujqësore të krijuar në ish-zonën ripariane.Po kështu, ka ndikuar edhe në derdhjen e drejtpërdrejtë të sasive të mëdha të kimikateve (*nutrients*) nga toka bujqësore në lumë e, për pasojë, në akuifer.Në tokë bujqësore rripat e vegjetacioni buferik (ndaj humbjes së nutrientëve) mund të krijohen përgjatë përrenjve natyrorë (që, nëse janë tharë, mund të rigjallërohen, ose mund të veprojnë si grumbullues të ujërave në kohë shirash të rrëmbyeshëm).Po ashtu, mund

të krijohen breza/rripa buferikë me vegjetacion edhe në toka ku nuk ka elemente ujore natyrore.Këto luajnë rolin e tarracimeve që sërish kapin nutrientët (nitrate e fosfate) dhe ulin ndjeshëm sasinë që aktualisht depërton në ujërat nëntokësore.

Figura 15. Transformimet strategjike në Liqenin e Kasharaj, Bashkia Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

9. Fasha emisar: Projekti strategjik i fashës emisar ka për qëllim rivitalizimin e qendrave të vendbanimeve të zonës fushore të bashkisë, të cilat lidhen përmes elementit qytet-formues të kanalit ujor të emisarit. Ky projekt ka parasysh krijimin e një rrjeti hapësirash publike, duke i kthyer ato në pikat kryesore të shkëmbimit social të banorëve të këtyre zonave. Kjo hapësirë synon të krijojë një qendërsi të re për zonën fushore të Lushnjes.Banorët e zonës rurale nuk kanë hapësira socializimi, përveçse disa qendra të vjetra (kryesisht në qendrën e komunës përkatëse) të frekuentuara kryesisht nga burrat. Qendërsia e re publike e sociale synon të sjellë frekuentues të grupmoshave e gjinive të ndryshme nga e gjithë zona rurale, të cilët, aktualisht, ose shkojnë deri në Lushnje për të marrë këtë lloj shërbimi, ose thjesht nuk frekuentojnë asnjë hapësirë publike. Fasha emisar ka shtrirje gjatësore të vendosur në të dyja anët e emisarit (kanalit) kryesor, është e plotësuar me vegjetacion, rrugë për biçikleta, sheshe të vogla, ndonjë kafene, kënde lojrash për fëmijë, çiltira për piknik dhe rrugica të vogla me lule që të çojnë drejt grupeve të shtëpive të fshatrave përgjatë saj.Kjo fashë nis nga rezervuari i Thanës, nga i cili kanali ka dhe rrjedhën e tij, vazhdon në një seri fshatrash dhe qendrash të njësive administrative si Kocaj, Fier-Shegan, Biçakaj i Vjetër, Lifaj i Ri dhe Lifaj i Vjetër, Krutje e sipërme, Zhym, Bishqethëm e përfundon në fshatin Shakuj.

10. Qendërsitë e shërbimeve komunitare: Rigjenerimi i qendrave të njësive administrative, sikurse është përmendur më sipër, nuk synon vetëm kthimin e këtyre zonave në hapësira publike të suksesshme dhe të aksesueshme. PPV-ja synon që nëpërmjet rigjenerimit të tyre të plotësojë të gjitha njësitë administrative me shërbimet bazike për një cilësi jetese më të mirë për banorët e çdo njësie të Lushnjes. Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturave të shkollave, kopshteve dhe çerdheve duke zgjeruar hapësirat për mësim, duke i pajisur me kopshte të brendshme, laboratorë, palestra etj. është një nga ndërhyrjet kryesore të cilat do të ndodhin në qendërsitë e shërbimeve komunitare. Ky projekt gjithashtu synon kthimin e ndërtesave të ish-komunave në hapësira për krjimin e qendrave kulturore dhe rinore, qendrave për të moshuar etj.

Figura 16. Tranformimet strategjike të ndërtesave ish-industriale, Plug-Lushnje




Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

11. Infrastrukturë e re për një mjedis të shëndetshëm: Në mbështetje të vizionit dhe objektivave strategjikë të Bashkisë Lushnje për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm për të gjithë qytetarët, PPV parashikon ngritjen e një sërë infrastrukturash të manaxhimit të mbetjeve. Pikësëpari në bashkinë Lushnje parashikohen të operojnë dy stacione transferimi të mbetjeve të ngurta. Këto dy stacione projektohen me kapacitetet e përshtatshme për të përballuar fluksin e mbetjeve nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Lushnje. Shpërndarja e tyre do të bëhët në mënyrë të tillë që të eliminojë kostot e transferimit nga çdo njësi administrative. Në mbështetje të bujqësisë, por dhe si një nga iniciativat më të mira për të mbështetur riciklimin në Bashkinë Lushnje, PPV propozin ngritjen e Impiantit të Kompostimit të Mbetjeve.Ky impiant parashikohet të pozicionohet në zonën e ish-gurores në fshatin Murriz-Peqin, në njësinë administrative të Karbunarës me një rreze 5 km nga qyteti i Lushnjes. Impianti I Kompostimit, jo vetëm do të kontribuojë ndjeshëm në rritjen e nivelit të riciklimit në bashki, por do të sigurojë gjithashtu edhe prodhim energjia nga vetë procesi I kompostimit. PPV gjithashtu propozon dhe ngritjen e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura, të pozicionuar në afërsi të autostradës (në kahyn perëndimor) mbi toka të kripura, pa kompromentuar në këtë mënyrë konvertimin e tokës bujqësore në truall.

12. Akses për çdo familje e çdo biznes: Me qëllim krijimin e aksesit më të shpejtë dhe më të sigurt për çdo familje dhe biznes, PPV-ja parashikon krijimin e rrugës së shërbimit përgjatë autostradës Lushnje-Fier. Për të shmangur çdo kompromentim të tokës bujqësore, ky aks shtrihet në rrugët ekzistuese bujqësore krah autostradës. Nëpërmjet mbikalimeve të parashikuara nga ARRSH-ja mbi aksin e autostradës dhe me propozimin e disa mbikalimeve të tjera të nevojshme rruga e shërbimit lehtëson komunikimin e banorëve të cilëve u duhet të punojnë tokat bujqësore në perëndim të bashkisë Lushnje (pas autostradës), sikurse dhe lehtëson komunikimin mes bizneseve dhe industrive përpunuese dhe fshatarëve të cilët kanë nevojë të shesin produktet e tyre bujqësore.

Figura 17. Rruga e shërbimit përgjatë autostradës Lushnje – Fier



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

- **Platforma e ndërhyrjeve në territor**

Ndërsa transformimet strategjike të territorit kanë rëndësi dhe efekt katalitik, janë zonat e tjera të territorit ato në të cilat banorët kryejnë aktivitetin e tyre të përditshëm dhe jetojnë.Në përgjithësi, këto janë zonat e banimit, të cilat sigurisht akomodojnë edhe një sërë shërbimesh dhe aktivitetesh institucionale e tregtare, përveç banesave.Veç zonave të banimit janë edhe territoret bujqësore e natyrore, parimi i zhvillimit të të cilave është ruajtja, rehabilitimi dhe përdorimi që mundëson vetëripërtëritje e që i bën ato të qëndrueshme.Plani i zhvillimit të territorit ofron një platformë të mënyrës se si duhet të ndërhyhet në këto zona në të ardhmen për të siguruar jetëgjatësinë e qëndrueshmërinë e tyre, përkrah cilësisë.

Nga pikëpamja metodologjike, mënyrat e ndërhyrjeve bazohen në: tipologjinë hapësinore e ndërtimore që kanë aktualisht territoret dhe vendbanimet e ndryshme në bashki; analizën e strehimit, cilësisë së ndërtesave dhe në projeksionet e popullsisë; kapacitetin mbajtës që kanë zonat e ndryshme sipas propozimeve për infrastrukturën; treguesit ekzistues të zhvillimit (intensitet, koeficientët e shfrytëzimit të tokës për ndërtim, hapësirë publike e rrugë, dendësitë); hartën e fragmentimit të tokës bujqësore; analizën e peizazhit natyror dhe fragmentimin e tij; interesat e bashkisë e të komunitetit për të intensifikuar zhvillimin e zonave të banimit në të ardhmen.

Si rrjedhojë e sa më sipër, strategjikisht, platforma e bashkisë për mënyrat e ndërhyrjeve në territor bazohet në këto masa:

1) Rritjen e rivlerësimin e hapësirës publike jo vetëm në qendrat e qytetit e të vendbanimeve, por edhe në zonat e banimit apo të aktiviteteve të tjera. Kjo hapësirë në disa raste përcaktohet në hartë/territor se ku do të ndodhet, siç mund të jenë, për shembull,transformimet strategjike dhe infrastruktura madhore, e në raste të tjera jepet përmes treguesit Kshp (koeficienti i shfrytëzimit të tokës për hapësirë publike). Gjithashtu, propozimet për ndërtime të shkollave, kopshteve, çerdheve, qendrave shëndetësore, qendrave kulturore e sociale janë në funksion të rritjes së hapësirës publike.

2) Plotësimin me rrjet rrugor të niveleve të ndryshme të të gjitha zonave të banuara dhe me aktivitet njerëzor në bashki dhe ristrukturimin e infrastrukturës publike kudo që është e nevojshme për të rritur aksesin, depërtueshmërinë, cilësinë e hapësirës dhe shërbimit dhe lidhshmërinë.

3) Ripërtëritjen e zonave që kanë humbur funksionin apo cilësinë, sikundër edhe rikonceptimin e zonave që kanë premisa për të qenë funksionalisht të arrira, por nuk kanë cilësi të strukturave dhe të hapësirës.

4) Konsolidimin dhe/ose mbushjen e dendësimin e zonave që kanë një karakter e tipologji të caktuar, të cilat ia vlejnë të ruhen, ose është efikase që të ruhenkur nevojitet të përmirësohet infrastruktura dhe hapësira publike.

5) Zhvillimin dhe rizhvillimin me intensitete të larta të zonave ku ka presion zhvillimi, përqendrim të popullsisë dhe aktiviteteve ekonomike dhe ku propozohet të krijohet hapësirë publike, ndërkohë që zona është e ndërtuar dhe shpronësimi nuk është një zgjidhje efiçiente apo e drejtë.

6) Rehabilitimin mjedisor dhe, sipas rastit, historik të zonave kryesisht natyrore (por jo vetëm) me qëllim nxjerrjen në pah të vlerave, vënien e tyre në funksion të komunitetit, rritjen e cilësisë së hapësirës dhe, mbi të gjitha, ruajtjen e funksioneve të ekosistemit.

7) Konservimin e konsolidimin e tokës bujqësore dhe ekosistemeve natyrore duke marrë edhe masa për përmirësimin e rigjallërimin e tyre sipas nevojës.

8) Krijimin e një sistemi urbano-bujqësor-natyror i cili funksionon mbi bazën e parimeve të integrimit, plotësueshmërisë, funksionalitetit, vetëripërtëritjes dhe qëndrueshmërisë.Këtë e garanton përmes krijimit të shumë-qendërsive (rrjeti policentrik) dhe ofrimit të mundësisë për të shpërndarë në mënyrë të drejtë fuqinë ekonomike dhe aktivitetin ekonomik në të gjithë territorin.

Në funksion të këtyre masave, platforma e ndërhyrjeve të territorit në bashki përmban sa më poshtë (detajet e ndërhyrjeve jepen në seksionin e njësive strukturore):

- Konsolidim të zonës qendrore aktuale dhe krijim të një qendërsie të re që është ajo e stacionit multimodal, aty ku aktualisht ndodhet sot stacioni i trenit. Krijimi i qendërsisë së re nënkupton rizhvillimin dhe ripërtëritjen e një zone më të madhe se sa vetë stacioni aktual, të rrethuar nga rrugë ekzistuese, të cilat plani i fuqizon. Qendërsia e re ndodhet përballë asaj ekzistuese dhe lidhen së bashku nga rruga. Zona kufizohet nga përroi i Lushnjes dhe rruga “Sabri Kosturi”. Në të do të krijohet stacioni multimodal që do të akomodojë të gjitha format e lëvizjes në bashki.
- Zona ekzistuese ekonomike dhe e banimit do të rizhvillohet tërësisht duke i lënë vendin një hapësire shumëfunksionale me ndërtime tregtare, shërbimesh, qendra biznesi, banimi, qendër kulture e kinema, hapësirë publike të hapur dhe të gjelbër me sheshe e kënde lojrash për fëmijë të një shkalle të pranueshme për sipërfaqen e zonës. Duke qenë se zona aktualisht përshkohet (ndahet në mes) nga hekurudha, do të gjenden zgjidhjet e duhura inxhinierike e arkitektonike për ta eleminuar si barrierë, ndërkohë që funksionimi i hekurudhës nuk do të ndërpritet. Pavarësisht perspektivës së hekurudhës në të ardhmen, hapësira e saj mund të ripërdoret për transport publik dhe kjo do të planifikohet që në këtë fazë të projektit të

qendërsisë së re. Zgjidhjet mund të jenë me kalim nëntokësor ose ajror, por pa shqetësuar kompleksin e ri të qendrës.


- Projekti për qendrën e re duhet të kalojë në disa faza: konkursi i ideve arkitektonike e të dizajnit urban; studimi i ujërave; studimi inxhinierik; realizimi i PDV-së për trajtimin e marrëdhënieve të pronësisë dhe realizimin e instrumenteve financiare të zhvillimit.Zona ka pronësi private në një pjesë të mirë të saj dhe do të duhet të gjenden formulat e duhura të kompensimit të drejtë, mundësisht jo përmes shpronësimit.
- Ristrukturimi, konsolidimi i karakterit pa dendësim dhe rikonceptimin e kodrës. Kodra paraqet vlera nga ana natyrore dhe pozicionimi i saj në qytet, por është ndërtuar shumë dhe pa planifikim, ndërkohë që territori i saj ka qëndrueshmëri mesatare. Për pasojë, ndërtime të reja, veç ristrukturimit të infrastrukturës dhe rikonceptimit të hapësirës publike, nuk janë të rekomandueshme deri në një studim të hollësishëm gjeologo-inxhinierik. Në çdo rast, edhe për pozicionin e saj, edhe për vlerën në siluetën urbane të qytetit, kodra nuk mund të ketë ndërtime më të larta se 3 kate.
- Zhvillimi e rizhvillimi i zonave ekonomike në hyrje e dalje të qytetit, në disa raste edhe me ndërhyrje të rehabilitimit mjedisor (ish-Fabrika e Plastmasit për shembull). Këto janë hapësira ekzistuese tashmë jashtë funksionit ose të lira (tokë bujqësore), por në hyrje të qytetit e pjesërisht me pronësi publike.
- Përzierje e mënyrave të ndërhyrjeve si rikonceptimi, ristrukturimi, rizhvillimi e, në disa raste, intensifikimi e konsolidimi në zonat e banimit në pjesën fushore të qytetit. Këtu përfshihet zona urbane ekzistuese e Lushnjes midis Bashkisë dhe stacionit aktual të trenit, e cila në veri kufizohet nga përroi i Lushnjes. Meqenëse janë zona të formuara në karakter, aty nuk parashikohet rizhvillim tërësor, por sipas rastit – pra në njësi strukturore të caktuara, ku intensitetet aktuale janë shumë të ulëta dhe mund të rriten duke densifikuar zonën e, njëkohësisht, duke krijuar hapësirë publike cilësore për qytetin. Megjithatë, të gjitha këto zona, pavarësisht mënyrës dominuese të ndërhyrjes, kanë nevojë për ristrukturim të infrastrukturës publike. Në mjaft raste nevojitet rikonceptimii hapësirës publike dhe dizajnit urban pa ndërhyrë në funksionin themelor (banim), por duke e përmirësuar atë dhe plotësuar zonën me shërbime. Aty ku karakteri është më i fortë, atëherë ai konsolidohet ose përmes rikonceptimit, ose përmes intensifikimit e mbushjes urbane. Pjesë e kësaj ndërhyrjeje është edhe rigjenerimi i zonës së stadiumit “Roza Haxhiu”, ku, përveç ndërhyrjeve rigjeneruese në këtë stadium, parashikohet edhe ndërtimi i fushave të reja të sportit për të plotësuar nevojat që ka stadiumi i ardhshëm i qytetit.
- Mbushja urbane dhe ristrukturimin e, në disa raste, rigjenerimin ose rikonceptimin në zonën e banimit përtej stacionit të trenit, në perëndim, në pjesën fushore të qytetit, ndërtuar informalisht në tokë bujqësore. Këto zona përbëjnë zgjerimin perspektiv të qytetit. Toka bujqësore tashmë është humbur, ndërsa densiteti është ende i ulët dhe lejon për shfrytëzim efiçient të hapësirës. Për këtë qëllim propozohet mbushje urbane. Megjithatë, në disa raste, në këto zona ka miks përdorimesh dhe cilësia e strukturave nuk është e mirë, ndaj rigjenerimi është një mënyrë më e përshtatshme ndërhyrjeje, duke lejuar edhe mbushje urbane të planifikuar. Këto raste kanë përgjithësisht nevojë për PDV, ndërsa aty ku mjafton vetëm mbushja mund të vijohet edhe pa PDV. E megjithatë, në çdo rast, bashkia

do të përgatisë së paku plane konceptuale të shtrirjes së infrastrukturës publike, pasi zona nuk është e pajisur mjaftueshëm me rrugë dhe hapësirë publike.

- Në këtë zonë kalon edhe përroi i Lushnjes, i cili, nga një barrierë fizike aktualisht për zonën dhe lidhjen e saj me qytetin, mund të kthehet në elementin më tërheqës për zonën, duke ofruar hapësirë publike, vegjetacion, rrugën kryesore që përshkon zonën, shëtitore dhe disa hapësira të vogla sociale e kënde lojrash për fëmijë. Në këtë mënyrë, përmes një projekti madhor ripërtëritës dhe rehabilitues nga ana mjedisore, përroi sjell elementin ujor në zonë si integruesin e saj dhe objektin kyç të rritjes së cilësisë së zonës.
- Ristrukturim, mbushje e rikonceptim nëpër qendrat e banuara të fshatrave sipas kufijve të vjetër, përfshirë edhe zgjerimet që ata kanë marrë në kufi. Përmendim fshatra e qendra si Dushku, Allkaj, Krutje, Fier-Shegan, Bubullime, Kolonje, Golem, Hysgjokaj e Ballagat e Karbunarë, të cilët kanë nevojë të konsolidohen dhe të plotësohen me hapësirë publike cilësore e shërbime, në mënyrë që të tërheqin banorët për të ndërtuar banesat e tyre në këto zona të vogla urbane, në vend që të synojnë të fragmentojnë më tej tokën bujqësore. Në të gjitha rastet nevojiten ndërhyrje infrastrukturore përmirësuese dhe plotësuese.
- Ripërtëritje të qendrave të disa fshatrave kryesore që janë edhe qendra të njësive administrative, me qëllim ofrimin e shërbimeve të reja dhe rritjen cilësore të hapësirës publike. Përmendim këtu Krutjen, Allkajn, Bubullimën, Dushkun, Golemin dhe Hysgjokajn.
- Ristrukturim dhe mbushje në zonat e ndërtuara e të krijuara rishtazi që shtrihen përgjatë rrugëve kryesore dhe kanë fragmentuar tokën bujqësore në mbi 30%. Në këto zona është humbur toka bujqësore në rreth 1/3 ose më tepër të parcelës bujqësore (e kufizuar nga infrastruktura tretësore e kullimit dhe vaditjes) dhe qëllimi është që të mos lejohet depërtimi i mëtejshëm i ndërtimit në tokën bujqësore në kufi të pjesës së ndërtuar, edhe pse mund të jenë pjesë e të njëjtës parcelë bujqësore. Do të promovohet mbushja e tyre dhe mundësisht ndarja e tokës për qëllime zhvillimi që banorët e zonave më të thella të synojnë të ndërtojnë në këto hapësira, sikurse dhe në qendra fshatrash dhe jo në fermën e tyre.
- Konservim të tokës bujqësore e natyrore e ngrirje të ndërtimeve në këto zona, si edhe atyre të rrezikuara gjeologjikisht, plus zhvendosje në raste ekstreme. Pavarësisht se një VKM e Ministrisë së Bujqësisë lejon ndërtime për qëllime të aktivitetit bujqësor në tokë bujqësore, plani synon të konservojë në maksimum tokën bujësore. Kështu, për shembull,bëhet promovimi që ndërtimi i stallave dhe i magazinave të produktit bujqësor, apo i ndërtimeve të tjera bujqësore me themele, përveç serrave të lëvizshme, të mos kryhet në toka bujqësore ku fragmentimi është në nivelet 1% ose më pak të parcelës bujqësore, sipas hartës së fragmentimit të tokës bujqësore. Këto toka përbëjnë pjesën më të madhe të tokës bujqësore dhe duhet të ruhen të paprekura nga zhvillime të tjera. Me të njëjtën logjikë veprohet për tokat natyrore, pyjet e kullotat, ku jo vetëm nuk lejohen ndërtime, por ka programe për shtimin e sipërfaqes pyjore dhe zbutjen e fragmentimit peizazhistik të habitatit.
- Ndërtim të rrugëve të reja, pavarësisht nivelit/hierarkisë, me qëllim jo thjesht lehtësimin e trafikut, por edhe lidhjen e të gjitha qendrave e vendbanimeve me njëra-tjetrën dhe krijimin e aksesit për banorët dhe bizneset. Në këtë këndvështrim, propozohet edhe krijimi i një itinerari shërbimi në të dyja anët e autostradës në

mënyrë të tillë që bizneset e femerët anash saj të mund të depërtojnë në zonën bujqësore (prej nga marrin lëndën e parë), të kapin tregun në Lushnje dhe të kalojnë të pashqetësuar në anën tjetër të autostradës (që sot vepron si barrierë fizike e ekonomike). Ky itinerar përdor rrugët ekzistuese bujqësore dhe realizon një zgjerim të lehtë të tyre për arsye qarkullimi, pa hapur akse të reja në tokë bujqësore e duke evituar kështu konvertimin e tokës bujqësore në urbane.

Figura 18. Skema e mënyrave të ndërhyrjes në territor, Bashkia Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

- **Objektivat strategjikë – Programet – Projektet:**

Në përmbushje të këtij vizioni të zhvillimit të territorit të bashkisë Lushnje, janë hartuar 4 objektiva strategjikë, të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjikë të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik, të cilët mund të detajohen dhe përmirësohen gjatë punës që Bashkia do të kryejë për zbatimin e kësaj strategjie.

Objektivi strategjik 1: *Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë/blegtorisë dhe agropërpunimit si sektor kryesor i ekonomisë dhe punësimit*

Mbështetja e këtij sektori mundëson kthimin e bashkisë Lushnje në një qendër rajonale për zhvillimin bujqësor dhe blegtoral. Kjo nënkupton që bashkia jo vetëm do të synojë shfrytëzimin e potencialeve natyrore që ka në territorin e saj administrativ për zhvillimin e këtij sektori, por do të synojë të krijojë pole me infrastruktura mbështetëse të bujqësisë dhe blegtorisë që t'i shërbejnë edhe bashkive fqinje. Këto infrastruktura përfshijnë qendra grumbullimi dhe magazinimi, pika përpunimi të produkteve bujqësore/blegtorale, tregje rajonale etj. Në përmbushje të këtij objektivi janë hartuar programet strategjike të mëposhtme:

Programi strategjik O1P1: Përmirësimi i cilësisë së produkteve bujqësore përmes shërbimit të agronomisë nëpër fshatra me qëllim nxitjen e zhvillimit bujqësor të qëndrueshëm dhe arritjen e standardeve nëpër fshatra

- Hapja e qendrave të informimit bujqësor pranë 11 njësive administrative të bashkisë Lushnje

Programi strategjik O1P2: Nxitja e konsolidimit të fermave bujqësore përmes skemave mbështetëse vendore dhe qendrore

Programi strategjik O1P3: Shtimi i pikave të grumbullimit përmes skemave të PPP-së

- Ngritja e qendrës së grumbullimit me kapanone frigoriferike pranë tregut të shitjes me shumicë të fruta-perimeve, Lushnje

- Ngritja e një qendre grumbullimi në Hysgjokaj
- Rehabilitimi i magazinave ish-industriale në njësinë administrative Golem dhe kthimi i tyre në pika magazinimi

Programi strategjik O1P4: Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e rrjetit të kullimit dhe ujitjes

- Sistemimi i stacionit të pompave ujitëse në Bitaj dhe Ardenicë
- Pastrimi i kanaleve të para dhe të dyta nga mbetjet dhe aluvionet e grumbulluara në 11 njësitë administrative
- Ndërtimi i sistemit të ujitjes në liNjat e Krutjes dhe Tërbufit

Programi strategjik O1P5: Nxitja e përdorimit të energjisë diellore në sektorin bujqësor përmes skemave mbështetëse qendrore dhe vendore

- Ndërtimi i Centralit të Energjisë Diellore në parcelat me tokë të kripur në fshatin Plug

Programi strategjik O1P6: Rritja e numrit të tregjeve në bashki përmes krijimit të tregjeve rajonale dhe vendore

- Zgjerimi i sipërfaqes dhe kapacitetit magazinues të tregut të fruta-perimeve në Lushnje
- Ndërtimi i tregut të produkteve bujqësore në Fier-Shegan dhe Krutje
- Rehabilitimi i tregjeve të fruta-perimeve në të gjitha njësitë administrative të bashkisë

Programi strategjik O1P7: Konsolidimi i industrisë së agropërpunimit përmes krijimit të polit të industrisë përpunuese në afërsi të infrastrukturave rrugore dhe hekurudhore

- Rehabilitimi dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale të bashkisë në të cilin përfshihen: zona ekonomike e ish-Fabrikës së Plastmasit, zona ish-industriale në fshatin Plug, zona ekonomike e ish-Fabrikës së Dyshekëve.
- Ngritja e qendrës logjistike të mallrave pranë zonës ekonomike të ish-Fabrikës së Plastmasit

Programi strategjik O1P8: Kualifikimi i forcës punëtore të sektorit bujqësor

Programi strategjik O1P9: Marketimi i produkteve bujqësore të rajonit brenda dhe jashtë vendit

Objektivi strategjik 2: *Mbështetja e sektorit të ekoturizmit si sektor mbështetës dhe plotësues i bujqësisë*

Bashkia Lushnje përfshin në territorin administrativ të saj një sërë asetesh kulturore dhe historike. Përveç kësaj, vlerat peizazhistike dhe prodhimet bio që karakterizojnë fermat e bashkisë janë një potencial ende i pashfrytëzuar për zhvillimin e ekoturizmit. Në funksion të zbatimit të këtij objektivi strategjik janë hartuar katër programe strategjike, secila me projektet përkatëse sipas Planit të Veprimit.

Programi strategjik O2P1: Hartimi i itinerareve turistike përmes identifikimit, inventarizimit dhe hartëzimit të burimeve natyrore dhe historiko/kulturore dhe lidhjes së tyre me itineraret rajonale

- Rikonstruktimi i rrugëve peizazhistike vernakolare dhe pajisja me siNjalistikën dhe ndriçimin rrugor të domosdoshëm në të gjithë territorin e bashkisë Lushnje.

Programi strategjik O2P2: Promovimi i itinerareve turistike përmes krijimit të partneriteteve me operatorë aktivë në sektorin e ekoturizmit

- Hartimi dhe marketimi i paketave turistike për promovimin e turizmit në bashkëpunim me aktorë privatë dhe NGO

Programi strategjik O2P3: Mbështetja me infrastrukturë të gjelbër e korridoreve me interes turistik dhe peizazheve

- Rikonstruksioni i rrugës historiko-kulturore të Manastirit të Ardenicës dhe pajisja me korsinë e dedikuar të biçikletave
- Pajisja e rrugëve urbane kryesore dhe dytësore me korsi të dedikuar për biçikleta në të gjithë territorin e bashkisë Lushnje

Programi strategjik O2P4: Mbështetje e ngritjes së eko-fermave turistike për promovimin e vlerave gastronomike dhe të peizazheve të bashkisë

- Nxitja e zhvillimit të eko-fermave turistike në njësitë administrative të Hysgjokajt dhe Ballagatit

Objektivi strategjik 3: *Kontrolli i zhvillimit të territorit nëpërmjet harmonizimit të nevojave të banorëve ekzistues dhe të planifikuar*

Zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale e synuar të arrihet përmes dy objektivave të sipërcituar rrezikohet të pengohet ose ngadalësohet nëse nuk shoqërohet me politika dhe instrumente për orientimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit. Në përmbushje të këtij objektivi janë hartuar programet strategjike të mëposhtme:

Programi strategjik O3P1: Hartimi dhe zbatimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës në funksion të mbrojtjes së tokës bujqësore, krijimit të hapësirave cilësore urbane dhe orientimit të rritjes urbane drejt Lushnjes, Fier-Sheganit dhe Dushkut

- Ndërtimi i parkut periferik të qytetit të Lushnjes
- Kthimi i ndërtesave të ish-komunave në qendra multifunksionale për të rinjtë, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara
- Ndërtimi i parqeve, këndeve të lojrave dhe lulishteve në njësitë administrative të Kolonjës, Krutjes, Fier-Sheganit, Dushkut, Hysgjokaj

Programi strategjik O3P2: Lehtësimi i aksesit të njësive administrative të Bashkisë përmes përmirësimit të infrastrukturës rrugore lidhëse mes njësive administrative, qendrës së bashkisë dhe njësive fqinje

- Rikonstruksioni dhe zgjerimi i të gjithë infrastrukturës rrugore sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor, duke përmirësuar cilësinë e ndriçimit rrugor dhe pajisjen me pemë në të dyja anët e rrugëve
- Ndërtimi i stacionit multimodal në qendër të qytetit të Lushnjes
- Ndërtimi i terminalit të autobusëve ndër dhe rreth-qytetës në hyrje të qytetit të Lushnjes

Programi strategjik O3P3: Shtrirja e rrjeteve inxhinierike nëntokësore (KUZ, KUB dhe ujësjellës) në të gjithë qendrat urbane të konsoliduara, si dhe furnizimi me energji elektrike

- Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në tokat e kripura pranë by-pass-it të Lushnjes
- Ndërtimi i pompave të ujit për përmirësimin e sistemit të ujësjellësit

Programi strategjik O3P4: Rijetësimi i qendrave të njësive administrative

- Rikonstruksioni i ndërtesave të shkollave dhe arsimit parashkollor në 11 njësitë administrative të bashkisë Lushnje
- Ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore në fshatin Shegas dhe Allprenaj

Objektivi strategjik 4: *Mbrojtja e burimeve natyrore si baza për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve*

Përmes këtij objektivi Bashkia synon të mbrojë asetet natyrore si baza për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenies sociale të saj, si dhe me qëllim krijimin e një mjedisi të shëndetshëm për qytetarët e bashkisë dhe vizitorët. Me qëllim përmbushjen e këtij objektivi strategjik janë hartuar programet e mëposhtme:

Programi strategjik O4P1: Rehabilitimi i fashës ripariane të lumit Seman në bashkëpunim me bashkitë e tjera që preken nga baseni i këtij lumi

- Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së lumit Seman
- Rehabilitimi i përroit të Lushnjes

Programi strategjik O4P2: Mbrojtje e akuifereve nga ndotja urbane dhe bujqësore

- Krijimi i korridoreve vegjetative në tokën bujqësore

Programi strategjik 04P3: Ngritja e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta duke nxitur ndarjen e riciklimin dhe duke ofruar infrastrukturë për trajtimin e tyre

- Rehabilitimi i fushës së mbetjeve dhe kthimi i saj në zonë të gjelbër
- Ndërtimi i impiantit të kompostimit të mbetjeve në fshatin Murriz-Peqin
- Ndërtimi i stacionit të transferimit të mbetjeve në tokat e kripura në Plug

Programi strategjik O4P4: Marrja e masave për pastrimin e vatrave të nxehta mjedisore dhe për uljen e ndikimit të aktiviteteve industriale në mjedisin e Bashkisë Lushnje

- Pastrimi i tri vatrave të nxehta mjedisore në qytetin e Lushnjes

Programi strategjik O4P5: Marrja e masave për mbrojtjen nga erozioni i kodrave të Lushnjes

- Rehabilitimi i kodrës së Lushnjes nëpërmjet metodës së ripyllëzimit

Programi strategjik O4P6: Bashkëpunim me bashkitë fqinje për marrjen e masave për mbrojtjen nga erozioni detar që mund të ndikojë tek tokat bujqësore të Myzeqesë

Programi strategjik O4P7: Rijetëzimi i strukturave arsimore dhe plotësimi i nevojave me struktura të reja për ciklin e ulët, të mesëm dhe arsimin profesional për të gjithë territorin

- Rikonstruksioni i shkollave dhe i ambienteve të arsimit parashkollor

Programi strategjik O4P8: Fuqizimi i infrastrukturës shëndetësore

- Përmirësimi i infrastrukturës fizike të spitalit dhe maternitetit të Lushnjes

Programi strategjik O4P9: Rijetësimi i aktivitetit kulturor, social e rekreativ për të gjitha grupmoshat dhe grupet e interesit në bashkinë e Lushnjes

- Ndërtimi i Pallatit të Sportit në Lushnje, në afërsi të stadiumit 'Roza Haxhiu"
- Ndërtimi i fushave të sportit në njësitë administrative Kolonjë, Krutje, Fier-Shegan

*Sistemet e territorit dhe përdorimi i tokës:*Për të siguruar e përmbushur vizionin e zhvillimit dhe realizimin e objektivave të përcaktuar në "Strategjinë e zhvillimit të territorit të bashkisë Lushnje", Plani i Përgjithshëm Vendor i bashkisë Lushnje përcakton kategoritë dhe nënkategoritë bazë të përdorimit të propozuar të tokës për çdo njësi strukturore. Për sa i përket përdorimit të tokës, vetë objektivat e programet/projektet përkatëse synojnë ruajtjen e tokës bujqësore si potencialin kryesor të zhvillimit ekonomik të kësaj bashkie, krijimin e kushteve të përshtatshme të banimit duke harmonizuar nevojat e banorëve aktual dhe të pritshëm të kësaj Bashkie, si dhe zbutjen e pabarazive sociale nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturave dhe shërbimeve publike. Në lidhje me përdorimin e tokës, parimet kryesore janë:

i) Promovimi i përzierjes së funksioneve (miksi) dhe shmangia e zonave monofunksionale të pastra brenda qytetit dhe vendbanimeve në tërësi. Miksi është i nevojshëm jo vetëm për t`i bërë lagjet sa më të jetueshme e të pasura me shërbime, por edhe për të rritur nivelin e sigurisë, e cila do të cënohej në kushtet e ndarjeve sociale për shkak të përdorimeve monofunksionale. Miksi i përshtatet edhe dinamikave të tregut të tokës, duke lehtësuar kështu zhvillimin dhe qarkullimin e kapitalit.Miksi gjithashtu zbut dominimet e monofunksionalitetit të banimit.Dominime të tilla rrezikojnë t`u japin vendbanimeve karakterin e një "fjetoreje", dhe kjo është fatale në proceset qytetformuese. Planet, Bashkia, zhvilluesit dhe qytetarët duhet të përpiqen vazhdimisht që të sjellin energji të reja nëpër lagjet e banimit për të rritur nivelin e "jetueshmërisë së hapësirës".

ii) Plani kujdeset gjithashtu që të shmangë vendosjen e përdorimeve të papërputhshme afër njëri-tjetrit e, nëse kjo është e pamundur të shmanget, atëherë propozohen masa mbrojtëse. Masa të tilla si distancat apo brezat mbrojtës paraqiten në rregulloren e PPV-së, në seksionin e përdorimeve të ndaluara dhe të kushtëzuara. Kur përdorimet janë tërësisht të papërputhshme, dhe sigurisht kanë nevojë për sipërfaqe të konsiderueshme, ato vendosen në zona specifike dhe larg atyre të banimit. Ky është rasti për disa nga zonat ekonomike.

iii) Kur përdorimet nuk janë banim, por u përkasin kategorive të tjera, zakonisht ato tentojnë të jenë monofunksionale në natyrë, ose të përfshijnë funksione shumë të ngjashme. Të tilla raste janë infrastrukturat madhore, zonat bujqësore, parqet dhe pyjet, zonat ripariane, zonat ekonomike etj. Plani garanton që këto zona të zhvillohen të pashqetësuara, por edhe të mos shqetësojnë përdorimet e tjera përreth, përfshirë ato të banimit. Kjo realizohet përmes masave mjedisore, brezave dhe distancave mbrojtëse e pyllëzimeve.

iv) Respektimi i rëndësisë kombëtare në territor dhe i të gjitha kushtëzimeve sektoriale është parimi kyç që ka drejtuar mënyrën se si janë bërë të gjitha propozimet e PPV-së. Disa nga këto kushtëzime qëmund të përmendim janë: ligji nr.9358 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" – kufizimet në konvertimin e fondit pyjor (aktualisht legjislacion i ri në proces); ligji nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" – përcaktimi i brigjeve të trupave ujorë (5m – 20m dhe 100m -200m) dhe veprimtaritë e lejuara në brigje; "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" – 60 m brezi mbrojtës nga autostrada dhe distancat në zona urbane; VKM-janr. 671 "Për miratimin e rregullores së planifikimit" – standarde dhe tregues të planifikimit për shkolla, kopshte, qendra shëndetësore, breza mbrojtës, distanca të mbrojtjes, lartësitë, intensitetet etj.; ligji nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar – kufizimet në konvertimin e tokave bujqësore në truall; ligji nr.8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", i ndryshuar – kufizimet në konvertimin e tokave bujqësore në truall; VKM-ja nr. 410, datë 27.06.2012, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës" dhe VKM-janr. 283, datë 1.4.2015, "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale në tokë bujqësore" – kufizimet në konvertimin e tokave bujqësore në truall; ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar – kufizimet në zonat e mbrojtura dhe zonat buferike të tyre etj. Ilustrime të mënyrave se si këto kushtëzime ndikojnë në territor paraqiten në hartën e rëndësisë kombëtare të përgatitur me hartimin e Strategjisë së Territorit.

Në mënyrë të përgjithshme, propozimet në lidhje me përdorimin e tokës përshkruhen si më poshtë:

Kategoria bazë "banim" (A): Duke u bazuar në projeksionet dhe skenarët e rritjes së ardhshme të popullsisë në Bashkinë Lushnje dhe duke u mbështetur në analizën e nevojës për strehim, është përllogaritur sipërfaqja e nevojshme për të mbuluar kërkesat e parashikuara për strehim në 15 vitet e ardhshme. Duke iu referuar këtyre gjetjeve, analiza parashikon rritjen e popullsisë dhe nevojën për shtim të sipërfaqes së ndërtimit për qëllime arsimi. Megjithatë, për shkak të potencialit të madh të tokës bujqësore, nivelit të lartë të fragmentimit të saj dhe kushtëzimeve ligjore për konvertimin e saj në tokë truall, PPV-ja parashikon zgjerimin e sipërfaqes së kësaj kategorie pak ose aspak nënjësitë administrative fushore (Bubullime, Krutje, Allkaj, Fier-Shegan, Kolonje etj), duke u fokusuar më tepër në konsolidimin e zhvillimeve ekzistuese dhe pjesërisht në mbushjen e njësive strukturore. Po ashtu, PPV-ja parashikon zgjerimin e sipërfaqes së banimit në pjesën perëndimore të qytetit deri në kufi me *bypass*-in e kësaj bashkie (zhvillimi parashikohet të ndodhë në tri faza të ndryshme). Mbi këto rekomandime plani përcakton njësitë strukturore të cilat do tëpërmbushin nevojën për strehim në njësitë ku parashikohet dendësimi fillimisht nëpërmjet intensifikimit e mbushjes urbane dhe,më pas,nëpërmjet hapjes së zonave të reja të banimit nëpërmjet konvertimit të tokës (në fazën e tretë).

Njësitë e kësaj kategorie bazë propozohen pranë infrastrukturave rrugore ekzistuese, të cilat do t'i nënshtrohen ristrukturimit, dhe pranë akseve të reja të propozuara infrastrukturore. Nga kjo pikëpamje, për të efiçentuar ofrimin e shërbimeve dhe për të kontrolluar zhvillimin, plani parashikon zgjerimin e qytetit fillimisht përgjatë akseve horizontale dhe, më pas, mbushjen e hapësirave ndërmjet tyre, nëpërmjet ristrukturimit të mëtejshëm të infrastrukturave rrugore dhe nëntokësore.

Krahas sa u tha më sipër, Plani i Përgjithshëm Vendor parashikon zhvendosjen e disa njësive të banimit (në njësinë administrative Ballagat). Për shkak të vendosjes së tyre në terren të vështirë kodrinor, këto njësi nuk arrijnë të mbulohen nga shërbimet bazë që ofron Bashkia Lushnje[46]. Sa i përket njësive strukturore të cilat i nënshtrohen "ngrirjes", ato përbëhen kryesisht nga parcela që aktualisht përdoren për qëllime banimi. Pjesa më e madhe e tyre janë të vendosura në zonën bujqësore ku parashikohet konservimi strikt i këtyre tokave, përgjatë përroit të Lushnjes, në zonën ripariane tëlumit Seman në jug të Bashkisë, si dhe në afërsi të palejuar të infrastrukturës rrugore, hekurudhore, kanaleve kulluese dhe vaditëse etj., duke mos respektuar rregullat e distancave minimale ndaj tyre. Në këto raste, zhvillimi nuk propozohet të prishet (përveç rasteve të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë për komunitetin që banon në këto zona), por ndalohet të ndërmerret çdo lloj aktiviteti me karakter ndërtimor. Në perspektivën afatgjatë, me amortizimin e strukturave ekzistuese, këta banorë do të mund të zhvendosen në zonat ku lejohet zhvillimi me qëllim banimi.

Disa nga njësitë strukturore të kategorisë"banim" (A), kryesisht ato të fshatrave të njësive administrative dhe një pjesë e qytetit, do të jenë të përbëra edhe nga sipërfaqe të kategorisë"shërbime", të natyrës që shërbejnë zonave të banuara.

Kategoria bazë "industri dhe ekonomi" (IE): Kjo kategori përdorimi parashikohet të vendoset dhe konsolidohet nëdy pika kyçe në qytetin e Lushnjes: në zonën ekonomike pranë rrethrrotullimit të ish-Fabrikës së Plastmasit dhe në zonën ekonomike pranë varrezave të qytetit të Lushnjes. Për shkak të natyrës bujqësore tëbashkisë Lushnje, zonat industriale dhe ekonomike i përkasin kryesisht nënkategorisë sëindustrive të lehta përpunuese dhe industrisëushqimore.Ky përdorim shfaqet i përzier me kategorinë"shërbime" për t'i pasuruar këto zona me funksione në shërbim të njëri-tjetrit. Për shkak të afërsisë së këtyre dy zonave me njësi të kategorisë "banim", marrja e masave mjedisore dhe rikrijimi i brezave mbrojtës (zonave buferike rreth tyre) është kusht i padiskutueshëm për zhvillimin e tyre.

Njësi të tjera të kësaj kategorie shfaqen në mënyrë pikësore edhe përgjatë autostradës Tiranë – Fier dhe përgjatëby-pass-it të qytetit. Në perspektivën afatgjatë, ky aks do të marrë trajtën e autostradës së mirëfilltëme krijimin e barrierave mbrojtëse, duke kufizuar hyrje-daljet e rastësishme pranë bizneseve/industrive që ushtrojnë aktivitetin aktualisht. Në këtë kuadër, njësitë strukturore të kësaj natyre nuk parashikohet të prishen, por nuk do të lejohet të zhvillohen (shtrihen në sipërfaqe) duke kompromentuar konservimin e tokave bujqësore që shtrihen përgjatë këtij aksi. Në raste specifike, ato do të mbështeten nga akse ndihmëse shërbimi dhe, në perspektivën afatgjatë, zhvillimi i tyre do të orientohet në zonat e specifikuara industriale të përmendura më sipër, të cilat janë planifikuar të mbulojnë kapacitetin e ardhshëm industrial tëbashkisë Lushnje.

Kategoria bazë "bujqësi" (B): Ruajtja dhe konservimi në masën më të gjerë të kësaj kategorie është prioritet i Bashkisë Lushnje gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Për këtë arsye, në disa raste është propozuar ngrirja e zhvillimeve të shpërhapura në tokë bujqësore të cilat nuk janë në funksion të bujqësisë. Në njësitë e parashikuara me përdorim toke të kategorisë bazë "bujqësi" nuk janë vendosur koefiçentë specific zhvillimi, por siç jepet edhe në rregulloren e zhvillimit, do të lejohet ndërtimi i objekteve me qëllim bujësor, siç parashikohet nëligjin për bujqësinë dhe planifikimit. Konvertime të mundshme të tokës bujqësore do të bëhen vetëm në njësitë të cilat kanë presion zhvillimi dhe parashikojnë akomodimin e popullsisë së

ardhshme (tokat bujqësore deri tek by-pass-i) dhe konvertime në kategoritë bazë“infrastrukturë” (IN) në rastet kur parashikohen zgjerime të infrastrukturave ekzistuese apo propozimeve të akseve të reja infrastrukturore. Ndërtimet për qëllime dhe në funksion të aktivitetit bujqësor që mund të ndërtohen në tokë bujqësore, përveç rasteve kur kjo Rregullore parashikon ndryshe, janë:

- stallat për mbarështimin e kafshëve dhe objektet ndihmëse funksionale, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në, depo silazhi, hangar, silos, ambiente për përpunimin e ushqimeve, sallë mjeljeje, padoqe, plehrishte, depozita uji;
- serrat me themele të vazhduara të cilat janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën;
- objektet ndihmëse funksionale të serrave, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen në, magazina për standardizimin e prodhimit dhe mbajtjen e pajisjeve, imputeve;
- objektet për tharjen dhe trajtimin paraprak të nevojshëm të produkteve në kultura, të tilla si bimët medicinale etj.;
- objektet për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë dhe ato frigoriferike;
- objekte për përpunimin e produkteve primare, bujqësore dhe blegtorale;
- thertoret;
- të tjera që mund të lejojë legjislacioni në fuqi.

Kategoria bazë “shërbime” (S): Ky përdorim parashikohet të sistemohet në aksin qendror të qytetit të Lushnjes, kryesisht i përzier me kategorinë bazë “banim” (A) dhe, në raste specifike, me kategorinë bazë “institucione” (IS). Në të dyja këto raste funksionet e lejuara përjashtojnë funksionet të cilat shkaktojnë ndotje akustike apo përdorime të tjera të papërputhshme me banimin, duke u kufizuar kryesisht në funksione tregtare, zyra dhe profesione të lira dhe argëtim.

Pjesa tjetër e njësive tëkategorisëbazë“shërbime” (S) do të akomodohet brenda ose pranë njësive tëkategorisëbazë“industri dhe ekonomi”, duke u kthyer në plotësuese të tyre, siç është shprehur edhe më sipër.

Kategoria bazë “përdorime tëveçanta” (V): Në këto kategori do të bëjnë pjesë të gjitha ato njësi të cilat në përdorimin ekzistues të tokës i përkasin nënkategorisë “varreza”. Për secilën nga këto njësi, PPV-ja parashikon rehabilitimin e hapësirave për varreza dhe krijimin e brezave mbrojtës të tyre.

Kategoria bazë “ujëra” (U): Kjo kategori përfshin të gjitha sipërfaqet ujore të bashkisë Lushnje të cilat janë: rezervuari i Thanës, liqeni i Kasharajt, liqeni i Hysgjokajt, liqeni i Ballagatit, përroi i Lushnjes, si një nga fashat më të rëndësishme rekreative të qytetit të Lushnjes, lumi i Semanit, emisari kryesor etj. Në rastet kur kjo kategori është e dëmtuar do të parashikohet pastrimi i tyre dhe rindërtimi i zonave ripariane (përgjatë Semanit) në zonat ku ajo është zhdukur apo dëmtuar krejtësisht si pasojë e përmbytjes. Për njësitë e tjera strukturore, kategoria bazë e të cilave është “ujëra”, parashikohet trajtimi peizazhistik i tyre (në fazën e pare përroi i Lushnj”s) dhe kthimi i tyre në zona rekreative dhe çlodhëse për banorët e kësaj Bashkie.

Kategoria bazë “natyrore” (N): Njësitë strukturore të kësaj kategorie shtrihen përgjithësisht në zonën kodrinore të Bashkisë ku janë të përqendruara thuajse të gjitha

sipërfaqet pyjore të Bashkisë Lushnje. Për shkak të aktivitetit të lartë bujqësor edhe në zonat kodrinore sipërfaqet pyjore janë fragmentuar shpesh nga ato bujqësoret, duke shkëputur korridoret natyrore të tyre. PPV-ja parashikon rehabilitimin e të gjitha njësive të cilat i përkasin kategorisëbazë "natyrore", si dhe shtrimin e sipërfaqeve të tyre në rastet kur kemi ndërprerje të habitateve.

Kategoria bazë "trashëgimi dhe monumente kulture" (M): Megjithëse LushNja nuk është e pasur me monumente kulture krahasuar me qarkun e Fierit, në të cilin bën pjesë, në këtëbashki dallojmëdy njësi të kategorisë bazë"trashëgimi": Manastirin e Ardenicës dhe shtëpinë-muze të Kongresit të Lushnjes. Në të dyja këto raste parashikohet konservimi strikt i tyre dhe restaurimi në rast nevoje për ta mbajtur gjallë këtë trashëgimi. Monumentet e tjera natyrore/kulturore, të cilat janë pikësore, janë integruar brendakategorisëbazë"banim" (A) dhe ruajtja dhe konservimi i tyre parashikohet në masën më maksimale.

Kategoria bazë "institucione" (IS): Plani i Përgjithshëm Vendor nuk parashikon ndryshime në këtë kategori bazë për sa kohë nuk propozohen vendosje të institucioneve të reja administrative në këtë bashki. Megjithatë për të shmangur amortizimin dhe degradimin e mëtejshëm të këtyre strukturave, parashikohet vënia e tyre në përdorim. Një pjesë e hapësirave t ëish ndërtesave të komunave, do të shndërrohet në krijimin e shtëpive për të moshuarit, klubeve rinore, qendrave multifunksionale për fëmijët e tjerë.

Kategoria bazë "aktivitete sociale dhe rekreative" (AR): Sipërfaqja e kësaj kategorie pritet të rritet ndjeshëm në Bashkinë Lushnje, kjo jo vetëm si pasojë e propozimeve të planit për hapjen e hapësirave të reja të gjelbra, por dhe si nevojë për hapësira të lira për popullsinëe ardhshme të Bashkisë. Shpërndarja e tyre parashikohet në të gjithë territorin e Lushnjes. Në njësitë administrative të cilat shtrihen përgjatë tokës bujqësore këto hapësira do të bëhen të mundura kryesisht në qendrat e njësive të cilat parashikohet t'i nënshtrohen rigjenerimit. Në qytetin e Lushnjes këto sipërfaqe janë parashikuar përgjatë përroit të Lushnjes, në zonën e ish-depozitimit të mbetjeve (e cila do t'i nënshtrohet pastrimit dhe rehabilitimit), brenda lagjeve të banuara etj. Në varësi të vendndodhjes dhe madhësisë, këto hapësira janë konceptuar si parqe/sheshe urbane, fusha sporti, lulishte dhe kënde lojrash.

Shpërndarja e hapësirave të gjelbra sipas çdo njësie administrative tregohet sinë tabelën më poshtë, duke siguruar përmbushjen e standardit prej 6.5 m2/banor sipërfaqe parqesh publike.

Kategoria bazë "arsim"(AS): Duke iu referuar analizës së periferialitetit dhe hartës së mbulimit me rreze të shërbimit arsimor nëbashkinë Lushnje, pothuaj të gjitha njësitë administrative shfaqen të avantazhuara, duke reflektuar një mbulim të mirë deri shumë të mirë me këtë shërbim. Megjithatë, siç sugjerohet edhe në seksionin e rekomandimeve të planit, parashikohet përmirësimi i cilësisë fizike të shkollave dhe kopshteve (kryesisht në njësitë administrative) dhe zgjerimi i oborreve të shkollave dhe kopshteve të cilat nuk përmbushin standardet e "Rregullores së planifikimit".

Kategoria bazë "shëndetësi" (SH): PPV-ja parashikon shtimin e kësaj kategorie kryesisht në njësitë administrative Hysgjokaj, Ballagat, Kolonjë dhe Golem, ku qendrat shëndetësore ose mungojnë, ose nuk përmbushin aspak standardet për ofrimin e shërbimit. Për çdo njësi të kësaj kategorie bazë parashikohet rigjenerimi i strukturave të degraduara shëndetësore, zgjerimi i sipërfaqeve të tyre dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit.

Kategoria bazë "infrastrukturë" (IN): Edhe në këtë rast, sikurse në rastin e kategorisë bazë "banim", sipërfaqet e propozuara të përdorimit të tokës pritet të rriten. Kjo kategori përfshin të gjitha zgjerimet e mundshme në rrjetin rrugor të mundshëm,duke përfshirë këtu edhe hapjen e akseve të reja për të akomoduar parkimin publik apo rritjen e mundshme si pasojë e parashikimit të ndërtimit të akseve të reja infrastrukturore, të cilat shoqërohen me konvertime (shpesh të pjesshme) të sipërfaqes bujqësore.

Plani iPërgjithshëm Vendor parashikon, gjithashtu, edhe shtimin e kësaj kategorie me qëllim akomodimin e impiantit të trajtimit tëujërave të të ndotura dhe stacionit të transferimit tëmbetjeve tëngurta në tokat e kripëzuara tëbashkisë Lushnje (Plug), duke mos cënuar konvertimet në tokën bujqësore, si dhe konvertimin e gurores sëfshatit Murriz-Peqin në pikën e kompostimit dhe trajtimit të mbetjeve për bashkinë Lushnje. Po ashtu, këto struktura do të rriten për të sistemuar struktura të tjera të nevojshme të rrjeteve të shpërndarjes elektrike dhe telekomunikacionit sipas planeve që do të hartohen nga palët përgjegjëse, në koordinim të plotë me parashikimet e këtij plani.

Si rezultat i transformimeve që ndodhin në lidhje me përdorimin e tokës ndryshon edhe harta e sistemeve territoriale. Ndryshimet e sistemeve janë të ndryshme dhe janë subjekt i legjislacionit përkatës që të mund të realizohen. Plani i propozon ato për të arritur qëllimet e zhvillimit social-ekonomik dhe të mbrojtjes mjedisore në territor. Transformimet kryesore në nivel sistemi territorial ndodhin për shkak të infrastrukturave që propozohen të shtohen, e veçanërisht rrugët, stacioni multimodal dhe stacionet e transferimit. Gjithashtu, në Lushnje parashikohet që një territor bujqësor të transformohet në park natyror periferik, pra në sistem natyror.

Njësitë strukturore të territorit: Ndarja në zona në Bashkinë Lushnje është bërë duke ruajtur kufijtë e njësive administrative, ku secila nga këto njësi administrative është cilësuar një zonë më vete: Zona D – Dushk; Zona G- Golem; Zona H – Hysgjokaj; Zona Ba – Ballagat; Zona Lu – Lushnje; Zona K – Karbunarë; Zona Kr- Krutje; Zona Kl – Kolonjë; Zona A – Allkaj; Zona F- Fier-Shegan; Zona Bu – Bubullimë.

Figura 19. Harta e zonave, Bashkia Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Bashkia Lushnje është ndarë në 1,453 njësi strukturore. Metodologjia për ndarjen e njësive strukturore është mbështetur në përcaktimet ligjore të rregullores së planifikimit të miratuar me VKM nr.671 në vitin 2015. Kushtet dhe rregullat e zhvillimit për çdo njësi strukturore janë përcaktuar në "Rregulloren e planifikimit të PPV-së". Pjesë e kësaj rregulloreje është edhe përcaktimi i zonave të cilat do të zhvillohen përmes Planeve të Detajuara Vendore (PDV). Kriteret për përzgjedhjen e zonave për PDV janë përcaktuar në rregulloren e planifikimit të miratuar me VKM nr.671 në vitin 2015. Llojet e ndërhyrjeve në territor janë përcaktuar për secilën njësi strukturore dhe në mjaft njësi gjenden më shumë se një ndërhyrje. Llojet e ndërhyrjeve bazohen në përcaktimet e ligjit të planifikimit dhe të rregullores së planifikimit (VKM nr. 671), por i përmbushin dhe i tejkalojnë këto përcaktime për t`iu përshtatur sa më tepër kontekstit. Sa i përket nevojës së ardhme për strehim, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Lushnje, parashikon një rritje të intensitetev të ndërtimit, në zonat e urbanizuara, ku sëbashku me vënien në dispozicion të stokut të madh të banesave do të arrinë të përmbushin kërkesat për strehim.

Bashkia zbaton sipas rastit transferimin e së drejtës për zhvillim për disa nga njësitë strukturore të përcaktuara në hartën e njësive strukturore dhe në shtojcën 1 të rregullores sëplanifikimit të territorit, bashkangjitur PPV-së. Bashkia zbaton TDZH-në në përputhje me rregulloren e zhvillimit të territorit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe rregullat që përmban rregullorja e Planit. Bashkia publikon

procesin dhe vendimmarrjen e saj duke realizuar kështu transparencën për publikun. Bashkia Lushnje parashikon zbatimin e këtij instrumenti në njësitë strukturore, ku me qëllim konservimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, e drejta e zhvillimit transferohet nëdisa zona marrëse me përdorim të propozuar të tokës banim, dhe ku intensiteti i propozuar lejon shtesa në sipërfaqen e ndërtimit.

Intensiteti i ndërtimit me kushte zbatohet në disa nga njësitë strukturore sipas shtojcës 1 të kësaj rregulloreje, në përputhje me përcaktimet e rregullores së zhvillimit të territorit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe rregullat e Planit. Qëllimi i Bashkisë është të garantojë shërbime si: strehimi social, sheshe dhe hapësira publike, parkim publik, kënde lojrash, kopshte e çerdhe, përmirësime të infrastrukturës rrugore, etj. Programet që harton bashkia për zbatimin e intensitetit të ndërtimit me kushte duhet të përmbajnë: Përcaktimin dhe publikimin e përfitimit publik si dhe platformën e komunikimit dhe të transparencës publike.

3.2.2 Shërbimet dhe infrastrukturat publike

Në mbështetje të propozimeve për rrjetin infrastrukturor rrugor të Bashkisë Lushnje, PPV-ja parashikon edhe ndërtimin e një sërë kalimesh në nivel (nënkalime apo mbikalime) kryesisht përgjatë autostradës Lushnje-Fier. Me anë të ndërtimit të këtyre mbikalimeve në zonat e përcaktuara nga ARRSH-ja dhe jo vetëm, PPV-ja synon lehtësimin e lëvizjeve të qytetarëve kryesisht nga vendbanimet e tyre drejttokave bujqësore në perëndim të autostradës. Ndërtimi i këtyre mbikalimeve rrit, gjithashtu, sigurinë e lëvizjes në territor dhe përmirëson aksesin drejt tokave bujqësore në të gjithë territorin.

Një nga ndërhyrjet madhore të parashikuara nga PPV-ja, siç është shpjeguar edhe më herët në këtë dokument, është edhe ndërtimi i rrugës së shërbimit mbi akset ekzistuese bujqesore në tëdy krahët e autostradës Lushnje-Fier. Kjo rrugë shërbimi, lehtëson transportin e kompanive të biznesit dhe industrive drejt tokave bujqësore nga ku merret edhe lënda e parë, faciliton procesin e shpërndarjes së produkteve bujqësore nga fshatarët drejt pikave të grumbullimit dhe lidh në një rrjet të sigurt të gjithë këta aktorë. Rruga e shërbimit krijon gjithashtu lidhje të drejtpërdrejta me akset lidhëse tëbashkisë Lushnje, të cilat janë projektuar në mënyrë të tillëqë të rrisin aksesin mes qytetit të Lushnjes dhe të gjitha njësive administrative.

Rrugët që propozon Plani për lëvizjen në territor janë si në vijim:

Rruget Vernakolare/ Peizazhistike: Bashkia Lushnje, përshkohet nga një rrjet i dendur i kanaleve kulluese dhe të vaditjes, të cilat i shtojnë kësaj Bashkie vlerat peizazhistike.Në mbështetje të këtyre vlerave, rrugët peizazhistike/vernakolare, krijojnë një rrjet të rëndësishëm i cili përshkon të gjithë Bashkinë. Për shkak të funksionit specifik që ka secila prej tyre dhe ndryshimet e terrenit këto rrugë janë perceptuar në 4 lloje kryesore:

a. Këto rrugë kanë përgjithësisht 1 korsi automjetesh (nje gjeresi max 3 m); një korsi biçikletash; dhe trotuar në të dyja anët. Rruga vernakolare më e rëndësishme e bashkisë Lushnje është rruga përgjatë Emisarit Kryesor të Myzeqesë, duke u kthyer kështu në aksin më të rëndësishëm peizazhistik të fshatrave kryesor të Lushnjes.

b. Plani i Përgjithshëm Vendor, parashikon forcimin dhe hapjen e akseve të reja peizazhistike edhe përgjatë zonave kodrinore të Lushnjes. Me qëllim mbrojtjen në mënyrë striktë të zonave të ullishteve, pyllit të Kasharaj,

rezervuareve (në Hysgjokaj dhe Ballagat) etj. rrugët peizazhistike/vernakolare parashikohet të jenë përgjithësisht ***"shtigje"*** për ecje të shoqëruara me korsi biçikletash *(ekzistuese).*

c. Rruga peizazhistike P3, shtrihet në pjesën më jugore të Bashkisë Lushnje, dhe ndjek rrjedhën e Lumit Seman përgjatë gjithë shtrirjes së tij. Rruga përgjatë Semanit parashikohet të ketë 2 korsi automjetesh (një për cdo sens drejtimi), shoqërohet nga 2 korsi bicikletash dhe ëaterfront (pedonale) në anë të Semanit. *Gjurma e kësaj rruge është përgjithësisht ekzistuese, por gjerësia aktuale nuk përmbush parametrat e funksionit që synohet ti jepet kësaj rruge.*

d. Aksi i katërt peizazhistikt, nis nga liqeni i Kasharaj në pjesën Veri-Lindore të Bashkisë Lushnje, dhe vazhdon nga të dyja anët e përroit të Lushnjes. Nga varrezat e qytetit deri në ndërprerje të këtij aksi me Bypassin e Lushnjes ky aks, ka një karakter disi më urban. Ky segment përbëhet nga 2 korsi automjetesh (1 për çdo sens lëvizje), 1 korsi biçiklete dhe trotuar në të dyja anët e rrugës. E njëjta prerje rruge vlen për të dyja anët e rrugës përgjatë këtij përroi. Pas ndërprerjes me Bypassin e Lushnjes, kjo rrugë merr një karakter më rural, për shkak të shtrirjes në tokë bujqësore. I gjithë ky segment deri në pikën e përfundimit të tij në Kolonjë, e më pas në Manastirin e Ardenicës, ka një prerje rruge me 1 korsi për automjete, 1 korsi biciklete dhe trotuar nga krahu i përroit.

Akset Lidhëse: Akset Lidhëse të Bashkisë Lushnje synojnë lidhjen mes qendrave kryesore të banuara me qytetin e Lushnjes dhe me njëra-tjetrën. Akset lidhëse përbëhen nga dy korsi automjetesh, 1 korsi biciklete dhe trotuar në të dyja anët. Pjesa më e madhe e këtij aksi është ekzistues, megjithëse në segmente të ndryshme ai ka nevojë të plotësohet (përgjithësisht në tokën bujqësore) dhe sigurisht të zgjerohet me rreth 2 fish të sipërfaqes ekzistuese.

Rruget Bujqesore: Rrugët "Bujqësore" shtrihen në pjesën më të madhe të tyre në zonën fushore të Bashkisë Lushnje. Për arsye të shtrirjes së këtyre rrugëve si në zonat e urbanizuara rurale (fshatra/qendra fshati) ashtu dhe përgjatë tokave bujqësore, do ti kategorizonim në 3 lloje kryesore.

a. Bujqësore fshati kryesore – janë rrugët kryesore të cilat lidhin ***akset lidhëse*** me qendrat e fshatit. Ato kanë përgjithësisht 2 korsi automjetesh; një kah parkimi dhe trotuar në të dyja krahët

b. Bujqësore fshati dytësore përbëhen nga i gjithë rrjeti infrastrukturor brenda zonave urbane të fshatrave. Karakterizohet nga rrugë me 1 korsi (3,5 m)

Rrugët urbane kryesore: Për nga rëndësia e tyre, rruget urbane kryesore do ti shohim të ndara në dy kategori kryesore. Këto rrugë kanë përgjithësisht 2 korsi për automjete, trotuar në të dyja krahët dhe korsi për bicikletat. Megjithatë jo të gjitha akset kanë të njëjtat karakteristika kjo për shkak se kjo tipologji rruge shihet e ndryshme në segmente të ndryshme të Bashkisë Lushnje.

a. Urbanet Kryesore (1) konsiderohen të gjitha rrugët që formojnë rrjetin brenda qytetit të Lushnjes. Për shkak të dendësisë së banimit, përqëndrimit të administratës dhe shërbimeve këto rrugë janë përgjithësisht me dy korsi, korsi bicikletash, dhe trotuar në të dyja krahët e rrugës)

Urbane Kryesore (2) janë rrugët të cilat Lidhin qytetin e Lushnjes me qendrat e tjera fqinje. Ne kete kategori futen: Rruga Lushnje (nga rrethrrotullimi i plasmasit) – Bert/Kucove; Rruga Lushnje – Belsh dhe Rruga Kuçovë-Divjakë (e cila kalon përmes tokës bujqësore). Aktualisht këto rrugë kanë një gjerësi rreth 8m, për të cilat parashikohet zgjerimi me rreth 4 m.

Transporti publik ndërqytetas luan një rol të rëndësishëm në mënyrën e lëvizjes (bashkëveprimit) së Bashkive me njëra-tjetrën. Ky lloj transporti është kompetencë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Në kuadër të reformës administrative të vitit 2014 lindi nevoja për një konceptim të ri të transportit publik ndërqytetës në nivel bashkie dhe jo vetëm në nivel qarku që ishte më parë. Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës, në zbatim të ligjit nr. 10/2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, publikon rrjetin e liNjave ndërqytetëse, stacionet e qëndrimit dhe oraret për secilën linjë, që do të fillojë të zbatohet më 1 janar 2017. Kërkesë e rëndësishme është që bashkitë të përcaktojnë vendndodhjen e terminaleve të autobusëve, në zbatim të nenit 21/1 të ligjit nr. 10/2016. E domosdoshme është, gjithashtu, që shoqëritë që do të licensohen të rinovojnë 20 % të flotës së tyre të autobusëve gjatë vitit të parë licencës.

Në muajin maj të këtij viti u prezantuan liNjat e reja të transportit ndërqytetas në nivel qarku, si dhe në nivel Bashkie. Sipas propozimeve të bëra nga Ministria e Transporti dhe e Infrastrukturës, Bashkia Lushnje pritet të ketë lidhje të rëndësishme kryesisht me Bashkitë e Divjakës, Tiranës, dhe Fierit. Metodologjia e kësaj analize është bërë me anë të numrit të orareve në të cilat lëviz çdo linjë në ditë. Duke u bazuar në këtë kriter, nga muaji janar pritet që në linjën Lushnje-Fier të ketë6 orare nisjeje në ditë. Kjo tregon rëndësinë që kanë këto dy Bashki për njëra-tjetrën përsa i përket lëvizshmërisë. Bashkia e Lushnjes pritet të ketë lidhje të shpeshta edhe me Bashkitë e Tiranës dhe të Divjakës, respektivisht nga 4 orare për secilën linjë.

Duke u bazuar tek analizat e transportit rrugor, është propozuar rrjeti i transportit publik rrethqytetës, i cili është kompetencë e Bashkisë Lushnje. LiNjat e reja janë konceptuar që të kalojnë kryesisht në akset kryesore lidhëse nacionale në disa pjesë dhe në akset kryesore të propozuara, në mënyrë që të mbulohet pjesa më e madhe e territorit. Në pjesën lindore të Bashkisë propozohet të krijohen 2 unaza të cilat do të bëjnë të mundur mbulimin e kësaj zone me transport publik, të cilat do të mbulojnë një gjatësi prej 37 km linear. Në këtë pjesë propozohet edhe liNja Lushnje - Karbunarë e Poshtme – Murriz.

Përsa i përket pjesës jugore të Bashkisë, fluksi kryesor i lëvizjes do të kalojë në rrugën nacionale që lidh Lushnjen me Vashkinë e Fierit, ku do të kalojnë 3 liNja të transportit publik, të cilat do të mbulojnë një pjesë të rëndësishme në jug të bashkisë. LiNjat që propozohen për këtë pjesë janë:

- Lushnje – Bubullimë
- Bubullimë– Karbunarë
- Lushnje-Krutje- Allkaj- Fier-Shegan- Lushnje
- Lushnje- Kolonjë

Hartimi i këtyre liNjave do të bëjë të mundur që banorët që jetojnë në ish-njësitë administrative të kenë akses midis vendbanimeve, si dhe me shërbimet që ndodhen në

qytet. Transporti publik i propozuar do të shtrihet në një gjatësi prej 127 km linear, në mënyrë që të ketë akses pjesa më e madhe e territorit.

Furnizimi me ujë dhe ujërat e ndotura:

Në këtë seksion do të trajtohen rekomandime të përgjithshme në lidhje me nevojat për rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës e cila siguron shërbimin e furnizimit me ujë për konsum publik dhe kanalizimet e ujrave të ndotura urbane.

- **Infrastruktura e Furnizimit me Ujë**

Problemet kryesore të sektorit lidhen me menaxhimin e sistemit të furnizimit, ku zgjidhja e propozuar konsiston në instalimin e matësve individualë për çdo lidhje konsumatore. Faktor tjetër në përmirësimin e sektorit është eleminimi i të gjitha lidhjeve të paligjshme dhe të parregjistruara, kombinuar kjo me masa konkrete dhe ndërgjegjësim të popullatës mbi detyrimet financiare karshi ofrimit të këtij shërbimi.

Ngritja e një sistemi monitorimi, ku matës gjeneralë instalohen nga tubacioni kryesor të furnizimit, në dalje të rezervuarëve dhe në nënzonat e shërbimit. Kjo do t'i ofroj Ndërmarjes së Ujësjellës Kanalizime Lushnje mundësinë për të kuptuar dhe gjurmuar zonat ku uji humbet apo shpërdorohet si edhe për të adresuar përgjegjësitë.

Theksojmë se masa kryesore që duhet të ndërmarrë Bashkia Lushnje, duhet të jetë sigurimi i linjave magjistrale, të cilat dërgojnë ujin nga pusshpimet/burimet drejt rezervuarëve e më pas drejt konsumatorëve. Në mënyrë kategorike në këto segmente nuk duhet të ketë asnjë lidhje shërbimi për klientë e konsumatorë të vegjël (*përjashtojmë rastet kur do të projektohen degëzime të cilat do të shoqërohen me projektin teknik dhe llogaritjet e detajuara hidraulike për të mos ndikuar në presionin e përgjithshëm të nevojshëm për të dërguar ujin në qëndrat kryesore të banimit*). Një objketiv tepër i rëndësishëm për ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Lushnje do të jetë ulja e humbjeve në masën e përgjithshme prej 25%, kjo mund të arrihet duke implementuar masat e sipërpëmëndura dhe si masë ndikon drejtpërdrejt në plotësimin e nevojave për një numër më të madh konsumatorësh.

Në total Bashkia Lushnje ka 21 zona të përcaktuara për furnizimin me ujë për konsum publik. Këto zona ndonëse mund të mbulojnë të gjithë shtrirjen administrative të Bashkisë, kanë mangësi lidhur me mbulimin e plotë të popullatës me shërbimin e furnizimit me ujë. Nga vrojtimi në terren dhe analizat teknike të të dhënave, në tabelën e mëposhtme konstatohet se Lushnje Qytet si edhe NjA-të Allkaj, Ballagat, Bubullimë, Dushk, Fier-Shegan, Golem, Hysgjokaj, Karbunarë, Kolonjë dhe Krutje kanë si burime edhe sisteme të pamjaftueshëm për furnizimin me ujë për konsum publik. Kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së infrastrukturës, e kombinuar edhe me disponueshmërinë ndaj burimeve ekzistuese.

Prandaj, në bazë të kërkesës për ujë, sfida në lidhje me furnizimin e zonave te planifikimit urban në Bashkinë e re dhe të zgjeruar të Lushnjes duket se ka nevojë qoftë për burime të tjera uji, njëherësh edhe për ndërhyrje mbi shtimin e sistemeve dhe mirë-menaxhimin atyre ekzistues.


Rezervuarët e ujit për konsum publik parashtrojnë një problem tjetër të përbashkët, problem i cili lidhet me mbrojtjen higjeno-sanitare tw tyre. Konkretisht, të gjithë rezervuarët, krahas shpëlarjes së rregullt 2 herë në muaj duhet t'i nënshtrohen edhe mbrojtjes higjeno santitare të udhëhequr nga Inspektoriati Shëndetit Publik sëbashku me Ndërmarrjen UK Lushnje, ku nëpërmjet analizave dhe dezinfektimit këto

rezervuarë të trajtohen dhe të çertifikohen rregullisht mbi statusin e tyre higjeno-sanitar. Në mënyrë të ngjashme duhet vepruar edhe me zonat e mbrojtjes Higjeno-Sanitare për të gjithë sistemet të cilat shfrytëzojnë pusshpime për furnizimin me ujë të pijshëm. Përkatësisht në një rreze prej 25m nga pusshpimi çdo aktivitet është i ndaluar dhe kjo do të quhet zona e mbrojtjes së rreptë. Më pas deri në një rreze prej 200m do të ndalohet aktiviteti ndërtues dhe ai bujqësor për të eleminuar në këtë mënyrë infiltrime me potencial ndotjete të akuiferit nën shfrytëzim.

Në mënyrë të ngjashme me analizën e mësipërmeme për burimet e ujit të pijshëm, rezulton se volumet e stokimit të ujit për NjA Golem janë mëse të mjaftueshme, ndërkohë që problematike shfaqet situata në pjesën tjetër të Bashkisë, pra në NjA-të Lushnje Qytet si edhe NjA-të Allkaj, Ballagat, Bubullimë, Dushk, Fier-Shegan, Hysgjokaj, Karbunarë, Kolonjë dhe Krutje ku kërkohet një rivlerësim për volumet e nevojshme të cilat duhet të shtohen në secilën zonë.

Sipas "Master-Planit Kombëtar te Furnizimit me Ujë, Largimit dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotur", që u miratua nga Këshilli Kombëtar i Ujit në dhjetor te vitit 2015, u bë e mundur të identifikohen projekte të veçanta që do t'u duhet të përmbushin nevojat e për furnizim me ujë në zonën e planifikimit të Bashkisë Lushnje megjithatë NjA-të Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Golem, Karbunarë, Ballagat, Fier-Shegan dhe Krutje nuk janë përfshirë në këtë studim ndaj kërkojnë prioritet në planifikimet që do të realizohen për këtë sektor. Mbetet detyrë e Bashkisë dhe NUK-Lushnje të studiojë situatën dhe të përpilojë kërkesat e duhura për përfshirjen e këtyre zonave në nismat e reja të hartimit të projekteve zhvillimore e infrastrukturore.

Figura 20. Harta e sistemit të furnizimit me ujë dhe propozimeve, Bashkia Lushnje.



Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016.

- **Infrastruktura e Kanalizimeve të Ujrave të Ndotura Urbane**

Sot, mbi 55% e popullsisë në qytetin Lushnjes është e lidhur me sistemin e grumbullimit të ujrave të ndotura urbane. Vërehet se një numër i konsiderueshëm i tubacioneve te kanalizimeve kanë pjerrësi të pamjaftueshme për grumbullimin dhe sidomos transportimin e duhur të ujërave të ndotur duke shkaktuar njëherësh sedimentim të ujërave të ndotur. Në rast të kushteve klimatike me shira me intensitet të konsiderueshëm, këto sedimente shkarkojnë direkt në lumë. Aktualisht sistemi i kanalizimeve funksionon mirë, pavarësisht dëmtimeve dhe pjerrësisë se pamjaftueshme të shumë tubacioneve.

Infiltrimi nëntokësor i ujërave të ndotur në zonën urbane ashtu edhe në zonën rurale përtej unazës jugore të qytetit paraqet rrezik serioz për ndotjen e ujërave nëntokësore. Në vijim të kësaj, kanalet e hapura përbëjnë një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin e banoreve te këtyre zonave, godinat e banimit i kane ndërtuar pikërisht ne këto zona. Situata aktuale të kanalizimeve të Bashkisë Lushnje (në zonën e qytetit) mund të përmirësohet vetëm me anë të ndërhyrjeve themelore e shume serioze të sistemit.

Sistemi i kanalizimit te ujërave ndotur në Lushnje përbehet pjesërisht nga rrjete të kombinuara (*ujërat e kanalizimeve janë bashkë me ujërat e shiut*) dhe në disa pjesë të qytetit nga rrjete të ndara (*ujerat e kanalizimeve janë veç nga ujerat e shiut*) ku të gjitha kanalet shkarkojnë direkt në përrenjt e kanalet e hapura vaditëse më të afërta. Sistemi është në gjendje jo të mirë, veçanërisht në ato zona ku ekzistojnë tubacione të papërfunduara si dhe aty ku për shkak të bllokimit, kanalizimet janë hapur me rrjedhje të lirë duke krijuar kështu shkarkimin e ujerave te ndotur ne sipërfaqe dhe ne disa raste duke krijuar edhe pellgje llumi shumë pranë vëndbanimeve.

Zonat e Bashkisë Lushnje të cilat nuk janë te lidhura me sistemin e kanalizimit zakonisht përdoronin gropat septike për depozitimin e ujërave te ndotura. Efekti trajtues i këtyre gropave është shume i kufizuar. Ne gropat septike një pjese e ujerave te ndotur infiltrohet duke depërtuar deri tek niveli i ujerave nëntokësore, niveli ky qe arrihet lehte përafërsisht ne thellësi 4 deri ne 5m nën nivelin e tokës sidomos në sezonin me lagështirë të konsiderueshme. Një pjese tjetër e ujerave te ndotura shkarkohen ne kanale te hapura. Kjo ka ndikuar dhe vazhdon të jetë problematikë e theksuar për dëmtimin e cilësisë së tokave bujqësore të Bashkisë.

Duhet parashikuar një inspektim CCTV[47] i cili do të pasqyrojë gjendjen aktuale të rrjetit ekzistues të kanalizimeve. Vetëm duke krahasuar kushtet e sistemit ekzistues të kanalizimit të qytetit, mund të themi se ky sistem ka nevojë thjesht për riparim apo për rindërtimin e tij nga e para. Ne rekomandojmë që të merret në studim edhe mundësia për të rindërtuar sistemin nga e para duke qënë se kostot e ndërhyrjeve për rehabilitim mund të jenë shpesh edhe më të mëdha se realizimi i një sistemi të ri. Si rezultat i relievit fushor që ka kjo Bashki, problem mbetet bllokimi nga mbetjet e ngurta të cilat shpesh bllokojnë seksionet e kryqëzimit të tubacioneve dhe në zonat e grykëderdhjeve ekzistuese.

Një nga rezultatet e masave të propozuara për zgjerimin e shërbimit në të gjithë zonat e banuara të Bashkisë Lushnje do të jetë edhe ulja e ndjeshme e numrit të gropave septike. Për rrjedhojë, kjo masë do të sjellë përmirësimin e tokës, rritjen e cilësisë se ujërave nëntokësore dhe uljen e sëmundjeve të shkaktuara si rezultat i mungesës së higjienës. Për më tepër, sistemi i ri i kanalizimeve i ndarë nga sistemi i grumbullimit të ujrave të larta do të parandalojë përmbytjet në zonat urbane dhe ato rurale si edhe

do të sjell përfitime ekonomike nëse sistemi do të parashikojë rezervuarë për grumbullimin e ujrave të larta dhe përdorimin e tyre për qëllime sekondare.

Bashkia Lushnje do të ndërtojë një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura, i cili ti shërbej pjesës më të madhe të popullsisë në qendrën urbane të Bashkisë si edhe NjA-ve të saj. Propozimi ynë synon që Impianti i Trajtimit të Ujrave të Ndotura Urbane për Bashkinë Lushnje të realizojë grumbullimin masiv të ujrave të ndotura drejt një impianti të përbashkët dhe të ndërtohet pikërisht aty ku është parashikuar.

Sipërfaqja e kësaj zone (*pranë fshatit Plug*) të propozuar për ndërtimin e impiantit është relativisht e vogël gjithashtu edhe pozicionimi gjeografik bie ndesh me dy elementë thelbësor (*distanca nga zona e banuar dhe distanca nga trupi ujor natyror*) nevojitet që mbi këtë propozim të hartohet një plan i detajuar i veprimit ku të merren në konsideratë masa specifike për mbrojtjen nga shkarkimet aksidentale mbi trupin ujor, trajtimin e llumit aktiv si edhe për zbutjen e ndotjes aromatike në ajër duke pozicionuar impjantin në varësi të trëndafilit të erës si edhe uljen e efektit të ndotjes vizuale nëpërmjet krijimit të zonës buferike mbrojtëse e të veshur me vegjetacion të dëndur e të lartë.

Sigurisht do duhet të parashikohen edhe stacione të ngritjes mekanike pasi relievi nuk favorizon rrjedhje me gravitet të të gjitha zonave të Bashkisë Lushnje.

Impiantet e trajtimit i klasifikojmë kryesisht sipas nivelit të trajtimit që ofron teknologjia e instaluar.

Impianti i Trajtimi Primar: Ndryshe i quajtur si trajtim mekanik, realizon diferencimin dhe largimin e mbetjeve të ngurta të cilat pluskojnë dhe ato të cilat kanë dekantuar në fund të pondit. Kjo teknologji largon edhe llumin e formuar nga dekantimi. Megjithëse është një teknologji e cila bazohet në trajtimin mekanik, shpesh për të përshpejtuar proçesin e sedimentimit përdoren edhe kimikate.

Impiantet Mekanike reduktojnë nivelin e NBO-së[48] në ujrat e ndotura në masën 20-30% dhe diferencojnë 50-60% të mbetjeve të ngurta në këto ujra. Kjo teknike trajtimi në përgjithësi përdoret si fazë fillestare e trajtimit të ujrave ku më pas mund të investohet për rritjen e efikasitet të trajtimit të ujrave me anë të metodave më të specializuara.

Impianti Trajtimi Dytësor (sekondar): Këto tipe impiantesh ofrojnë trajtim bilogjik të ujrave të ndotura urbane. Konkretisht ato arrijnë që nëpërmjet mikroorganizmave të konsumojinë të të gjithë lëndën organike (ndotëse) të tretur në këto ujra. Ky proçes biologjik i shoqëruar edhe me pondet e dekantimit realizon largimin e më tepër se 85% të mbetjeve inorganike ndërkohë që reduktimi i NBO-së do të realizohen nëpërmjet proçeseve me llum aktiv, sistemet ligatinore, filtra me pikim apo teknikave më bashkëkohore të cilat realizojnë shpërbërjen e lëndës ndotëse organike.


Impianti i Trajtimit Terciar: Në këto impiante krahas përfshirjes së dy sistemeve të mësipërme kemi integrimin e proçeseve kimike të specializuara dhe të mbyllura në të cilën realizohet pastrimi i ujrave të ndotura urbane duke larguar më tepër se 99% të masës ndotëse. Teknologjia e përdorur në këto impiante është mjaft e shtrenjtë qoftë për fazën e instalimit si edhe të mirmbajtjes së tyre, sidomos impiantet të cilat trajtojnë fosforin dhe azotin e tretur.

Vlen të theksohet se për dy tipet e fundit të impianteve, kostot e ndërtimit si edhe ato operimit janë relativisht të larta. Ndikimi në zbutjen konkrete të kostove mund të

adresohet tek kostot operacionale ku në rast se sasia e përgjithshme e ujrave të ndotura që do të hyj në trajtim do të reduktohet rrjedhimisht ndikimi do të shfaqet edhe në koston e përgjithshme të trajtimit. Ndaj propozojmë që sistemi i grumbullimit të ujrave të ndotura urbane medoemos të diferencohet nga grumbullimi i ujrave të larta në mënyrë që sasia totale që do të dërgohet në impiant të reduktohet për tu reflektuar kështu edhe në kostot finale. Gjithashtu ky propozim ofron edhe përfitime të tjera duke konsideruar se ujrat e larta (të shiut) mund të depozitohen dhe të përdoren për qëllime dytësore të Bashkisë Lushnje (larje, vaditje, zjarrfikse etj.)

Propozimi konkret për Bashkinë Lushnje do të ishte që të synohet ndërtimi i një Impianti Trajtimi Dytësor, pra një teknologji trajtimi me llum aktiv. Të synohet që pjesa më e madhe e NjA të dërgojnë ujrat e ndotura në një impiant të përbashkët dhe në rast se nga studimet e detajuar kjo mundësi nuk është e favorshme për shkak të kostove ekonomike atherë referuar propozimeve në Masterplanin Kombëtrar i Furnizimit me Ujë dhe Trjatimit të Ujrave të ndotura si edhe nga propozimet konkrete referuar nga ValueADD të përdoren pozicionet e parashikaura në dokumentin e tyre.

Figura 21. Harta e sistemit të kanlaizimeve dhe propozimeve të reja, Bashkia Lushnje



Burimi: PLGP/USAID dhe ValuADD 2016.

Ndriçimi i mjediseve publike:


Në Bashkinë e Lushnjes kemi rreth 72 km rrjet të shtruar në 92 akse rrugore me 1661 shtylla dhe 1725 ndriçues, ku 43 km e këtij rrjeti rrugor të ndriçuar gjendet në qytetin e Lushnjes. Gjithashtu, në qytetin e Lushnjes janë të ndriçuara edhe 11 sheshe urbane dhe 6 lulishte. Duke iu referuar gjetjeve të analizave, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Lushnje propozon pajisjen me ndriçim publik: të gjithë akseve lidhëse që

përshkojnë Bashkinë Lushnje; stadiumit “Roza Haxhiu” në qytetin e Lushnjes;fushave të sportit pranë stadiumit të qytetit;fashës së përroit të Lushnjes, në të dyja anët pedonale të saj;unazës perëndimore ku parashikohet shtrirja e qytetit; qendrave të të gjitha njësive administrative, përfshirë dhe sheshet qendrore të tyre. Veç të tjerash, plani parashikon edhe përmirësimin e cilësisë ekzistuese të këtij shërbimi (në ato akse ku ekziston) deri në masën 90 %.

- **Mbetjet e ngurta**

Shërbimi i menaxhimit të integruar të mbetjeve në bashkinë Lushnje do të shtrijë infrastrukturën e tij në të gjithë territorin dhe të nisë me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve që në pikat e grumbullimit. Propozohet që të hartohet një përditësim i planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve për bashkinë Lushnje, plan i cili do të konsistojë në: Vlerësimin e sasisë totale dhe të mercologjisë së mbetjeve; zbatimin e skemave të reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit të mbetjeve, si dhe vlerësimin e potencialit të riciklimit me synim riciklimin e 50% të mbetjeve të riciklueshme; organizimin e shërbimeve dhe operacioneve të menaxhimit të mbetjeve për mbulimin e të gjithë Nja-ve të Bashkisë Lushnje për një periudhë 15-20 vjeçare; rehabilitimin dhe ristrukturimin e venddepozitimeve ekzistuese; ndërtimin e një landfill-i rajonal, si edhe mundësinë e ndërtimit të një incerneratori për asgjësimin e plotë të mbetjeve; të gjitha të shoqëruara me projektin teknik dhe vlerësimin përkatës mjedisor. Të përfshihen gjithnjë 2 ose më tepër alternativa ku përzgjedhja të bëhet nisur nga parimi “Opsioni më i mirë i zbatueshëm mjedisor” OZM; ofrimin e shërbimit të riciklimit dhe rikuperimit të mbetjeve; sistemet e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve; trajtimin e mbetjeve; organizimin e landfill-it; trajtimin e mbetjeve inerte & të rrezikshme; mirëmbajtjen.

Paraqitja e mëposhtme indikon situatën ekzistuese si edhe propozimet për këtë sektor.



Parashikohet që afati maksimal për ndërtimin e landfill-eve, venddepozitimeve dhe pikave të transferimit për mbetjet inerte dhe ato të rrezikshme (jo urbane) të jetë fundi i vitit 2020, i cili përkon edhe me afatin e vendosur për mbylljen dhe rehabilitimin e të gjithë venddepozitimeve jashtë kushteve teknike dhe çdo kriteri higjieno-sanitar. Ndërhyrje e menjëhershme nevojitet të parashikohet për rehabilitimin e venddepozitimit të mbetjeve në zonën e lagjes "18 Tetori" në Lushnje. Fillimisht, duhet hartuar një plan & projekt i detajuar inxhinierik për parandalimin e shkarkimeve të shllameve, emetimeve të gazta dhe të vetë mbetjeve të ngurta mbi trupin ujor gjatë rehabilitimit të venddepozitimit. Duke vlerësuar distancat e largëta mes Nja-ve Bubullimë, Dushk, Ballagat & Kolonjë dh Nja-së Karbunarë, ku mendohet të ndërtohet *landfilli*-i, propozohet që të ndërtohen të paktën tri stacione transferimi të mbetjeve urbane. Zonat potenciale që janë marrë si alternativa për ndërtimin e *landfill*-it janë:

a) Zona kadastrale 2745, Bashkia Lushnje, NjA Karbunarë:Kjo zonë e përcaktuar nuk ndodhet mbi akuiferin e Lushnje-Fierit, por duke vlerësuar paraprakisht topografinë e zonës, nevojitet që të projektohet një sistem për drenimin e ujërave të larta, i cili duhet të shmangë shkarkimet e mundshme në këtë landfill.

b) Zona kadastrale 2999, Bashkia Lushnje: Pozicioni i kësaj fushe nuk ndodhet mbi akuiferin e lumit të Lushnjes, megjithëse ndodhet në kufi me të. Gjithashtu, edhe lidhur me distancat me zonat më të afërta të banuara, nuk përbën problem, pasi komuniteti i fshatit më të afërm Savra është rreth 2.4km larg nga ky pozicion i propozuar.

Propozohet që njësoj si me iniciativën e *landfill*-it të kompostimit në Murriz-Peqin të operohet edhe me vendgrumbullimin e mbetjeve inerte e të rrezikshme, pra Bashkia Lushnje të ndërtojë infrastrukturën e nevojshme që do të presë këto lloj mbetjesh. Një mundësi mbetet edhe përdorimi i hapësirave të shpatit të gërryer në fshatin Karbunarë e Vogël si stacion për grumbullimin e këtyre mbetjeve dhe trajtimin e tyre deri në asimilim.

Nevojitet që të gjitha pikat e paligjshme të depozitimit të mbetjeve urbane (*dhe jo vetëm*) t'i nënshtrohen një fushate për mbylljen dhe rehabilitimin e zonave që ato kanë zënë. Duke qenë se mbetjet mund të kthehen në burim fitimi, propozojmë që të përfshihen skema me cikël të mbyllur të menaxhimit të mbetjeve.

Infrastrukturat sociale: Duke iu referuar analizave të periferialitetit, Bashkia Lushnje shfaqet mjaft mirë e mbuluar, sa i përket infrastrukturave sociale, veçanërisht shkollave, kopshteve dhe çerdheve. Megjithatë, pavarësisht mbulimit të mirë, kapacitetet e këtyre megastrukturave janë të vogla krahasuar me nevojat në rritje që do të ketë Bashkia e Lushnjes. Në këtë kuadër, PPV-ja parashikon zgjerimin e ambienteve të studimit në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në të gjitha njësitë administrative, nga të cilat më problematiket shfaqen ato të Hysgjokajt dhe Ballagat. Krahas shtimit të ambienteve të studimit, në infrastrukturat arsimore parashikohet edhe shtimi i sipërfaqeve të oborreve të brendshme, si dhe i ambienteve të tjera ndihmëse si laboratorë apo palestra.

Infrastrukturat shëndetësore, nga ana tjetër, shfaqen më problematike. Një pjesë e tyre, pavarësisht se ndërtesat ekzistojnë, nuk funksionojnë prej kohësh. Plani parashikon rehabilitimin e të gjithë qendrave shëndetësore dhe ambulancave në njësitë administrative të Lushnjes, sikurse dhe ndërtimin e qendrave të reja shëndetësore në fshatin Shegas dhe Allprenaj.

Pjesës së rrjetit të infrastrukturave sociale i bashkangjitet edhe hapja e qendrave kulturore për të rinjtë, e qendrave multifunksionale dhe e ambjenteve për të moshuarit. Për të mbështetur hapjen e këtyre qendrave është menduar të vihen në përdorim ambientet e ish-komunave në çdo njësi administrative, si dhe dhe të rivitalizohen magazinat e vjetra të cilat sot ndodhen jashtë funksionit.

Ndërtimi i parkut periferik të qytetit të Lushnjes është gjithashtu një nga ndërhyrjet madhore të bashkisë Lushnje. I pozicionuar në pjesën veriperëndimore të qytetit të Lushnjes dhe i kufizuar nga by-pass-i i Lushnjes dhe zona e vilave me dendësi të ulët, parku periferik i qytetit kthehet në një hapësirë rekreative dhe çlodhëse për të gjitha grupmoshat. Ky park është parashikuar të ndërtohet në tokat e lira bujqësore të cilat nevojitet të konvertohen.


Rrjetit të hapësirave të gjelbra i shtohen, gjithashtu, parqet publike artificiale të njësisë administrative Kolonjë, Krutje Allkaj dhe Fier-Shegan, fushat sportive pranë stadiumit të Lushnjes, hapësirat sportive private në të gjitha njësitë administrative (të tipit kalçeto), si dhe parqet natyrore të kodrës së Lushnjes, parku i rezervuarit të Thanës dhe i liqenit të Kasharajt. Pjesë e rrjetit të hapësirave publike të cilat do t'i nënshtrohen rehabilitimit janë edhe pyjet e zonës kodrinore të Lushnjes, si dhe trupat ujorë të liqeneve të Ballagatit dhe Hysgjokajt, të cilët krijojnë një lidhje mjaft të mirë edhe me potencialet e Bashkisë fqinje të Belshit.

Rehabilitimi i përroit të Lushnjes dhe krijimi i xhepave të pushimit përgjatë rrjedhës së tij janë ndoshta elementi më tërheqës për qytetin e Lushnjes. Një ndërhyrje e ngjashme parashikohet edhe përgjatë rrjedhës së emisarit kryesor të Myzeqesë, në zonën fushore të bashkisë Lushnje.

Të gjitha këto hapësira lidhen nëpërmjet rrugëve peizazhistike vernakolare që përshkojnë bashkinë në të gjithë territorin e saj dhe synojnë që, veç karakterit të fortë bujqësor që kjo Bashki ka, të nxjerrin në pah edhe potencialet e shumta natyrore.


3.2.3 Hapat për zbatimin e PPV-së

Figura 22. Fazimi sipas ndërhyrjeve në njësitë strukturore



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Figura 23. Fazimi sipas ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të propozuar



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Tabela 10. Fazimi i projekteve strategjike, Bashkia Lushnje

Objektivat mjedisorë	**Faza 1: 0-3 vjet**	**Faza 2: 3-5 vjet**	**Faza 3: >5 vite**
Objektivat e programet e planit			
O1: Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor			
Pr1: Hapja e qendrave të informimit bujqësor pranë 11 njësive administrative të bashkisë Lushnje			
O1P2: Nxitja e konsolidimit të fermave bujqësore përmes skemave mbështetëse vendore dhe qendrore			
Pr3: Ngritja e qendrës së grumbullimit me kapanone frigoriferike pranë tregut të shitjes me shumicë të fruta-perimeve, Lushnje			
Pr4: Ngritja e një qendre grumbullimi në Hysgjokaj			
Pr5: Rehabilitimi i magazinave ish-industriale në njësinë administrative Golem dhe kthimi i tyre në pika magazinimi			
Pr6: Sistemimi i stacionit të pompave ujitëse në Bitaj dhe Ardenicë			
Pr7: Pastrimi i kanaleve të para dhe të dyta nga mbetjet dhe aluvionet e grumbulluara në 11 njësitë administrative			
Pr8: Ndërtimi i sistemit të ujitjes në liNjat e Krutjes dhe Tërbufit			
Pr9: Ndërtimi i centralit të energjisë diellore në parcelat me tokë të kripur në fshatin Plug			
Pr10: Zgjerimi i sipërfaqes dhe kapacitetit magazinues të tregut të fruta-perimeve në Lushnje			
Pr11: Ndërtimi i tregut të produkteve bujqësore në Fier-Shegan dhe Krutje			
Pr12: Rehabilitimi i tregjeve të fruta-perimeve në të gjitha njësitë administrative të bashkisë			

Pr13: Rehabilitimi i dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale në zonën ekonomike të Plastmasit			
Pr14: Rehabilitimi i dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale të bashkisë në të cilin përfshihen: zona ish-industriale në fshatin Plug, zona ekonomike e ish-Fabrikës së Dyshekëve			
Pr15: Ngritja e qendrës logjistike të mallrave pranë zonës ekonomike të Plastmasit			
O2: Zhvillimi i [eko]turizmit			
Pr1: Rikonstruksioni i rrugëve peizazhistike vernakolare dhe pajisja me siNjalistikën dhe ndriçimin rrugor të domosdoshëm në të gjithë territorin e bashkisë Lushnje			
Pr2: Hartimi dhe marketimi i paketave turistike për promovimin e turizmit në bashkëpunim me aktorë privatë dhe NGO			
Pr3: Rikonstruksioni i rrugës historiko-kulturore të Manastirit të Ardenicës dhe pajisja me korsinë e dedikuar të biçikletave			
Pr4: Pajisja e rrugëve urbane kryesore dhe dytësore me korsi të dedikuar për biçikleta në të gjithë territorin e bashkisë Lushnje			
Pr5: Nxitja e zhvillimit të eko-fermave turistike në njësitë administrative të Hysgjokajt dhe Ballagatit			
O3: Zhvillimi i planifikuar e kontrolli i territorit			
Pr1: Ndërtimi i parkut periferik të qytetit të Lushnjes dhe parku i Kasharajt			
Pr2: Kthimi i ndërtesave të ish-komunave në qendra multifunksionale për të rinjtë, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara			
Pr3: Ndërtimi i parqeve, këndeve të lojrave dhe lulishteve në njësitë administrative të Kolonjës, Krutjes, Fier-Sheganit, Dushkut, Hysgjokajt			
Pr4: Rikonstruksioni dhe zgjerimi i të gjithë infrastrukturës rrugore sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor, duke përmirësuar cilësinë e ndriçimit rrugor dhe pajisjen me pemë në të dyja anët e rrugëve			
Pr5: Ndërtimi i stacionit multimodal në qendër të qytetit të Lushnjes dhe zhvillimi i zonës përreth			
Pr6: Ndërtimi i terminalit të autobusëve ndër dhe rreth- qytetës në hyrje të qytetit të Lushnjes			
Pr7: Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në tokat e kripura pranë by-pass-it të Lushnjes			
Pr8: Ndërtimi i pompave të ujit për përmirësimin e sistemit të ujësjellësit			
Pr9: Rikonstruksioni i ndërtesave të shkollave dhe arsimit parashkollor në 11 njësitë administrative të bashkisë Lushnje			
Pr10: Ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore në fshatin Shegas dhe Allprenaj			
O4: Mbrojtja e burimeve natyrore			
Pr1: Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së lumit Seman			
Pr2: Rehabilitimi i përroit të Lushnjes			
Pr3: Krijimi i korridoreve vegjetative në tokën bujqësore			
Pr4: Rehabilitimi i fushës së mbetjeve dhe kthimi i saj në zonë të gjelbër			
Pr5: Ndërtimi i impiantit të kompostimit të mbetjeve në fshatin Murriz-Peqin			
Pr6: Ndërtimi i stacionit të transferimit të mbetjeve në tokat e kripura në Plug			

Pr7: Pastrimi i tri vatrave të nxehta mjedisore në qytetin e Lushnjes			
Pr8: Rehabilitimi i kodrës së Lushnjes nëpërmjet metodës së ripyllëzimit dhe ristrukturimit infrastrukturor për rritje të qëndrueshmërisë e sigurisë			
Pr9: Rikonstruksioni i shkollave dhe i mjediseve të arsimit parashkollor			
Pr10: Përmirësimi i infrastrukturës fizike të spitalit dhe maternitetit të Lushnjes			
Pr11: Ndërtimi i Pallatit të Sportit në Lushnje, në afërsi të stadiumit 'Roza Haxhiu"			
Pr12: Ndërtimi i fushave të sportit në njësitë administrative Kolonjë, Krutje, Fier-Shegan			

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

4. Analiza mjedisore e territorit të Bashkisë Lushnje

4.1 Analizë e përgjithshme e territorit

4.1.1 Kushtet gjeomorfologjike të territorit

- **Pozicioni Gjeografik**

Bashkia Lushnje bën pjesë në qarkun Fier dhe ka si qendër të saj qytetin e Lushnjes. Ajo kufizohet në veri me Bashkinë e Rrogozhinës, në verilindje me bashkinë e Peqinit, në lindje me bashkinë e Belshit, në juglindje me Bashkinë Ura Vajgurore, në jug me bashkinë e Roskovecit, në jugperëndim me bashkinë e Fierit dhe në perëndim me bashkinë e Divjakës. Bashkia ka një sipërfaqe prej 372.72 km² dhe ka në përbërje të saj 11 njësi administrative, të cilat janë: Lushnje, Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Golem, Dushk, Karbunarë, Ballakat, Fier-Shegan, Kolonjë dhe Krutje. Bashkia Lushnje ka një popullsi prej 84,921 banorë.

Historikisht, pozita gjeografike e ka favorizuar bashkinë Lushnje, pasi që në antikitet kemi praninë e rrugëve antike në territor. Rruga mëme rëndësi është segmenti jugor i rrugës Egnatia, e cila lidhte Apolloninë me Manastirin e Shën Ardenicës e më tej vazhdonte drejt Skampit. Gjithashtu, në territor kalonin edhe rrugë të tjera antike si rruga që lidhte Manastirin e Ardenicës me Bylisin.

Nga pikëpamja e infrastrukturave rrugore të sotme, bashkia Lushnje vazhdon të mbajë një pozicion mjaft të favorshëm gjeografik dhe strategjik si për shkak të pozicionimit ndërmjet dy pikave më të rëndësishme portuale (Vlora dhe Durrësi), ashtu edhe për arsye se në këtë territor kalojnë Korridori VIII dhe Korridori i Kaltër, të cilët, së bashku me Korridorin Durrës-Nish, përbëjnë korridoret më të rëndësishme të Shqipërisë. Sa i përket infrastrukturës rrugore, në bashkinë e Lushnjes kalojnë edhe rrugët shtetërore SH4 dhe SH72:

- Rruga Shtetërore 4 fillon në Durrës dhe përfundon në Kakavijë, duke kaluar në Lushnje Fier dhe Levan, ku më pas merr drejtimin për në Gjirokastër. Në vazhdim të këtij itinerari nis Route 853, e cila përfundon në Janinë.
- Rruga Shtetërore 72 është vazhdimi i rrugës së vjetër që fillon në Lushnje, kalon në Berat dhe vazhdon deri në Çorovodë.


Me infrastrukturën ekzistuese qyteti i Lushnjes ka këto distanca nga pika kryesore në Shqipëri:

- 80 km nga aeroporti i Rinasit
- 83 km nga Tirana,
- 49 km nga porti i Durrësit,
- 29.3 km nga qyteti i Fierit,
- 66 km nga porti i Vlorës,
- 66 km nga qyteti i Elbasanit,
- 40.5 km nga qyteti i Beratit.

Gjithashtu, në Bashkinë e Lushnjes kemi edhe kalimin e hekurudhës. Stacioni hekurudhor i Lushnjes ka shërbyer tradicionalisht për transportimin e pasagjerëve dhe mallrave drejt Tiranës, Fierit dhe Vlorës. Sot kjo hekurudhë i shërben më pak se 1%

të popullsisë për shkak të gjendjes së keqe të saj dhe kushteve të papërshtatshme të transportit të mallrave.

Figura 24. Pozicioni gjeografik i Bashkisë Lushnje nërajon




Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

- **Relievi**

Terreni i bashkisë Lushnje është kryesisht fushor, me kodra që shkojnë deri në 200 m lartësi mbi nivelin e detit në zonën verilindore dhe në zonën e Kolonjës. Zona fushore ka lëvizje të lartësisë nga 2.5 deri në 52 m mbi nivelin e detit dhe njihet për prodhimtarinë e madhe bujqësore. Kjo zonë bën pjesë në fushën e Myzeqesë dhe njihet për numrin e madh të serrave dhe rrjetin e pasur me kanale vaditëse. Fusha e Muzeqesë është ndër fushat më të mëdha në Republikën e Shqipërisë dhe në të njëjtën kohë ka edhe prodhimtarinë më të madhe. Emri i saj mendohet se vjen nga familja sundimtare e zonës, familja Muzakaj, e cila ka luajtur rol të rëndësishëm në historinë e vendit.


Niveli i pjerrësive në bashkinë e Lushnjes varion nga 1.3 deri në 87%. Zona fushore, që përbën edhe sipërfaqen më të madhe të bashkisë, karakterizohet nga një pjerrësi e ulët që varion nga 1.3 deri në9.7%. Zonat e buta kodrinore kanë pjerrësi më të vogël që shkon deri në 27%. Megjithatë, në territorin e bashkisë hasim edhe pjerrësi mbi 30%, por kjo më shumë haset në zonat e majave të kodrave dhe kurrizeve kodrinore.

Figura 25. Harta e pjerrësive në përqindje e Bashkisë së Lushnjes



Burimi: ASIG, 2015 Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Figura 26. Harta e relievit dhe e hidrografisë së bashkisë së Lushnjes



Burimi: ASIG, 2015, Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016


- **Klima**

Klima në këtë bashki, sipas klasifikimit Köppen-Geiger[49], i përket Csa[50] dhe njihet në përgjithësi me termin klimë mesdhetare. Tiparet karakteristike të kësaj klime janë: dimër i butë me reshje dhe verë e ngrohtë e thatë. Prania e trupave ujorë në këtë bashki sjell edhe zbutjen e klimës gjatë verës, kur lagështia e ajrit mund të jetë më e

lartë. Ky efekt është edhe më i dallueshëm në zonat urbane, ku prezenca e një trupi ujor (lumë, liqen etj.) mundëson krijimin e një mikroklime me temperatura më të ulëta në krahasim me pjesën tjetër urbane.

Bashkia Lushnje ka rreth 2,500- 2,700 orë diell në vit[51]. Temperatura mesatare luhatet nga 15-16ºc. Në përgjithësi, nuk ka erëra me shpejtësi të madhe. Zona lindore e Bashkisë ka erëra me shpejtësi 1.5-2.0 m/s, ndërsa pjesa perëndimore ka erëra më të shpejta të cilat arrijnë shpejtësinë 2.6-3.0 m/s. Pjesa qendrore e Bashkisë ka erëra me shpejtësi 2.1- 2.5 m/s [52]. Reshjet janë të çrregullta në këtë bashki dhe variojnë mesatarisht nga 750-1,250 mm[53]në vit.

Figura 27. Harta klimatike e bashkisë së Lushnjes



Burimi: AKBN[54]; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

- **Hidrografia**

Territori i bashkisë Lushnje kufizohet nga rrjedhat e dy lumenjve kryesorë. Në veri të territorit kemi kalimin e lumit Shkumbin, ndërsa në juglindje, në kufirin me bashkitë Roskovec dhe Ura Vajgurore, kemi rrjedhën e lumit Seman. Përveç lumenjve kemi edhe disa rezervuare dhe liqene, si: rezervuari i Thanës, liqeni i Kasharajt, liqeni i Lushnjes. Ia vlen, gjithashtu, të përmendim edhe kanalet vaditëse, të cilat shtrihen përgjatë pjesës fushore. Ndër këto kanale mund të përmendim tri më të rëndësishmet, të cilat dalin nga rezervuari i Thanës: kanalin Emisar, kanalin përgjatë Semanit, si dhe kanalin që shkon drejt veriut përmes qytetit të Lushnjes. Për më tepër, në qytetin e Lushnjes kemi edhe rrjedhën e përroit të Lushnjes, i cili buron nga liqeni i Kasharajt. Ky përrua ka luajtur rol edhe si element i fortë i qytetit të Lushnjes, duke ndikuar në zhvillimin territorial të tij.


Pavarësisht pasurive të shumta ujore që kemi në këtë Bashki, shfrytëzimi i tyre, ndonjëherë i bërë pa kritere, ka sjellë disa probleme. Problemet më të shumta i kemi

në zonën jugore, ku ky shfrytëzim i ujërave mund të çojë në aktivizimin e ujërave me mineralizim të lartë. Kjo situatë duhet vlerësuar e studiuar në mënyrë shkencore.

- **Ujërat nëntokësore (Akuiferët)**

Sipas hartës hidrogjeologjike të qarkut Fier[55], sipërfaqja më e madhe e territorit të bashkisë Lushnje është jo akuifer[56], shkëmbinj të cilët janë pa porozitetin e mjaftueshëm ndërkokrrizor apo çarje. Në përgjithësi, tek këto shkëmbinj mungojnë burimet ujore për furnizimin lokal me ujë të pijshëm. Zona jo akuifere e bashkisë përbëhet kryesisht nga: shkëmbinj të shkrifët sedimentarë të llojit argjilë, alevrolite, rërë; shkëmbinj kompakt sedimentarë të tipit alevrolite dhe argjilë e rrallë ranore, si edhe flish. Këta shkëmbinj janë më të përhapur në zonën jugore dhe pjesërisht në zonën qendrore të bashkisë. Në zonën perëndimore të bashkisë, kryesisht në zonën kodrinore, kemi akuifere me porozitet poro-çarje dhe ujëpërcjellshmëri mesatare- të ulët, si edhe me ujëpërcjellshmëri të ulët – shumë të ulët.

Figura 28. Analiza e mbivendosjes së hidrogjeologjisë dhe hidrografisë në Lushnje.



Burimi: SHGJSH; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Zonat me akuifere me porozitet poro-çarje dhe ujëpërcjellshmëri mesatare- të ulët përdoren për furnizim me ujë të pijshëm të komuniteteve të vogla. Shfrytëzimi i rezervave të këtyre akuifereve është në masën 60%. Deri në thellësi 300 m ujërat nëntokësore janë të ëmbla, me fortësi mesatare deri të madhe, kursemë në thellësi ato kalojnë në të kripura. Kjo zonë përfshin vendbanimet e Karbunarës së Sipërme, Hajdarajt, Mollasit dhe Jetës së Re. Shkëmbinjtë e zonës janë shkëmbinj kompakt sedimentarë të tipit argjilor, ranor dhe konglomerat.

Akuiferet me porozitet poro-çarje me ujëpërcjellshmëri të ulët – shumë të ulët gjenden në zonën verilindore të bashkisë Lushnje. Këtu kemi vendbanimet e Gramshit, Dushkut, Gjuzajt, Ballagatit dhe Hysgjokajt. Gjithashtu, ky lloj akuiferi gjendet edhe në kodrat e Kolonjës (Ardenicë). Litologjia e kësaj zone përbëhet nga shkëmbinj të shkrifët sedimentarë të tipit ranor, zhavorr dhe argjilor.

Gjithashtu, në bashkinë Lushnje kemi edhe akuifere me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri shumë të lartë- të lartë. Këto akuifere janë kryesisht një shtresore dhe kanë lidhje të mira hidraulike me ujërat sipërfaqësore. Në afërsi të zonës së

ushqimit akuiferet janë me sipërfaqe të lirë, kurse në drejtim të rrjedhës ato kalojnë me presion. Akuiferet janë të pasura me resurse ujore nëntokësore dhe shërbejnë për furnizimin me ujë të pijshëm të bashkive Fier e Lushnje dhe të disa njësive administrative. Ujërat nëntokësore shfrytëzohen me shpime, prurjet e të cilave variojnë nga 5 në 50 l/s. Vetitë fiziko-kimike të tyre janë në përgjithësi të mira: të ëmbël dhe me fortësi të ulët në zonat ku shfrytëzohen. Duke shkuar në drejtimin jugor, cilësia e ujërave të akuiferit të Lushnjes prishet, kurse mineralizimi dhe fortësia rriten. Akuiferet janë të ndjeshëm ndaj futjes së ujit të kripur në akuiferin e Vjosës, ujërave me cilësi të keqe të zonës jugore të akuiferit të Lushnjes, si edhe ndaj ndotjes njerëzore. Zona përbëhet nga shkëmbinj të shkrifët sedimentarë të tipit ranor, zhavorr dhe argjilor.

Në zonën jugore të Bashkisë së Lushnjes kemi edhe akuifere me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri mesatare- të ulët. Kjo zonë nuk është shumë e madhe dhe gjendet afër vendbanimit Imsht. Shkëmbinjtë në këtë zonë janë shkëmbinj të shkrifët sedimentarë të tipit argjilor, avrolit dhe ranor.


- **Boniteti i tokave**

Bashkia e Lushnjes mbetet furnizuesi kryesor i vendit dhe i eksportit me produkte bujqësore. Me kategorinë e bujqësisë, mbizotëruese në përdorimin e tokës me 77 % të territorit të bashkisë, tokat bujqësore të Lushnjes karakterizohen nga cilësia e lartë e dheut dhe prodhueshmëria e lartë.

Pavarsisht mungesës së një informacioni të saktë mbi kategorinë e tokës sipas klasës së bonitetit të tokave (sipërfaqet), në bashkinë Lushnjes mbizotërojnë tokat me bonitet të lartë të kategorisë I-IV.

Megjithatë, sipërfaqe të ndryshme të tokës në bashkinë Lushnje janë ***toka të kripura***, moçalore ose aluvionale. Vetëm në fshatin Plug në Nja-në Golem, për shembull, sipërfaqja e tokave të kripura arrin në 12.17 ha. Kjo sipërfaqe do të ishte shumë herë më e madhe në rast se do të gjendeshin të dhënat rreth tokave të kripura në rang bashkie

Figura 29. Tokat e kripura në Plug (në ha) sipas numrit të parcelave



Burimi: Njësia Administrative Golem, 2015

- **Analiza e burimeve natyrore**

Gjeomonumentet janë zona natyrore që paraqesin interes të veçantë përsa i përket mënyrës si janë krijuar, rrallësisë, vlerave historiko- kulturore ose funksionit të tyre si pika interesi. Për nga rëndësia, gjeomonumentet ndahen në[57]:

- Gjeomonumente me vlera ndërkombëtare
- Gjeomonumente me vlera kombëtare
- Gjeomonumente me vlera rajonale

Në Bashkinë e Lushnjes ndodhen dy gjeomonumente. Gjeomonument me rëndësi kombëtare është Prerja në Ardenicë, i cili është një pus (shpim) strukturor në skajin verior të monoklinalit Patos-Marinzë-Ardenicë, paksa në jug të Manastirit të Ardenicës, në formacionet mollasike të Ultësirës Pranë- Adriatike. Prerja e përshkuar nga ky pus strukturor 6,700 m i thellë është: 0-1,040 m pliocen; 1,040-3,480 m tortonian-mesinian; 2,480-4,330 m brudigalian-akuitanian; 4,330-5,670 m flishi i oligocenit dhe 5,670-6,700 m tortonian. Pusi ka vlera shkencore gjeologjike.

Gjithashtu, në këtë bashki kemi edhe gjeomonumentin me vlera rajonale të Burimit Termal të Karbunarës. Ai ndodhet në pjesën lindore të fshatit Karbunarë, në lartësinë 50 m mbi nivelin e detit dhe rreth 10 m mbi shtratin e përroit që vjen nga Karbunara e Vogël. Ka 4-5 burime në rrëzën e shpatit jugor të një kodrine të vogël, por dy janë më të rëndësishmet. Uji ka përmbajtje gazi sulfhidrik dhe era e tij ndihet dhjetëra metra larg burimeve. Banorët kanë krijuar dy gropa me diametër rreth 6 m dhe thellësi 30 cm, ku futen për kurimin e sëmundjeve të lëkurës. Efekti i ujit është më i madh nëse e lyen trupin me baltën që gjendet brenda pellgut[58].

- **Elementet e forta në territor**

Territori përbëhet nga shumë pjesë të ndryshme të cilat ushtrojnë ndikim te njëri-tjetri. Pjesët apo elementet të cilat ndikojnë më shumë, apo kanë veçori më spikatëse mund të konsiderohen si elemente të forta në territor. Këto elemente mund të ndikojnë në formimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të vendbanimeve. Ato mund të shfaqen në forma apo situata që favorizojnë, por edhe kundërshtojnë/ pengojnë zhvillimin, duke realizuar kështu ndikimin e tyre në territor. Shtrirja e tyre fizike dhe ndikimi i tyre në territor mund të jetë pikësor/qendror, por edhe sipërfaqësor në formën e fashave të ndikimit. Elemente të tilla mund të jenë natyrore, por edhe artificialisht të krijuara nga njeriu. Bashkia e Lushnjes ka shumë elemente si natyrore, ashtu edhe artificiale, të cilat paraqesin potenciale në territor.

Elementet e forta natyrore në bashki kanë të bëjnë me topografinë dhe pasuritë e shumta ujore që ka kjo bashki. Ndër më kryesoret janë:

4 Fusha e Myzeqesë, e njohur në të gjithë Shqipërinë si zona më pjellore, mund të jetë edhe elementi më i rëndësishëm qytet-formues për shkak të vetive të mira për rritjen e produkteve bujqësore.

5 Zona kodrinore që shtrihet në verilindje të bashkisë, ku majat më të larta janë M. e Shkujkës (282 m) dhe M e Murtasajit (298 m). Zona kodrinore është element i fortë, pasi ka ndikuar në shtrirjen e vendbanimeve, por edhe sepse ka zona pyjore të paprekura, të cilat paraqesin potencial për zhvillim të mëtejshëm.

6 Pasuria ujore përbën një element me rëndësi për lehtësimin e zhvillimit të vendbanimeve. Këtu kemi disa elemente që spikasin, si: rezervuari i Thanës, lumi Seman, kanali Emisar, përroi i Lushnjes, liqeni i Kasharaj. Të gjitha këto pasuri ujore kanë ndikim të vazdueshëm në territor duke tërhequr vazhdimisht aktivitetin njerëzor.

7 Monumentet natyrore janë elemente të forta pikësore, të cilat paraqesin potencial për zhvillim të mëtejshëm. Të tilla janë: burimi termal në Karbunarë, Dushkajat dhe Selvitë në Manastirin e Ardenicës.

Elementet artificiale janë po aq të rëndësishme në mënyrën e ndikimit në territor, sa edhe elementet natyrore. Ato janë krijuar nga veprimtaria njerëzore dhe mbartin edhe pjesën e identitetit kulturor dhe historik të zonës. Ndër to përmendim:

6. Monumenti Manastiri i Ardenicës. Vlerat e tij nuk janë vetëm arkitektonike apo fetare, por gjithashtu tregojnë për vazhdimësinë e jetës në territor, si edhe për rëndësinë historike dhe zhvillimin e hershëm të bashkisë Lushnje.
7. Zona ekonomike në zonën Lushnje- Karbunarë. Këtu kemi alokimin e industrive më të rëndësishme në bashki, por pozicioni i favorshëm ndërmjet Lushnjes dhe Karbunarës gjithashtu lejon shtimin e industrive të tjera në të ardhmen. Më parë në këtë zonë ndodhej ish-fabrika e plastmasit dhe ajo e tullave, por me zhvillimin e bujqësisë në bashki pritet të zhvillohen industritë e lehta që fokusohen kryesisht në përpunimin e ushqimeve.
8. Stacioni i trenit në Lushnje përbën një element me shumë rëndësi, pasi pozicioni i tij është i favorshëm duke u bërë një pol i rëndësishëm i transportit. Ai mbledh gjithë flukset e ndryshme të transportit dhe mund të zhvillohet në një stacion multi-modal sipas standardeve. Megjithatë, vendndodhja e tij mund të paraqesë edhe problem, pasi mund të shkaktojë izolimin e zonave urbane në pjesën perëndimore të Lushnjes, që janë më së shumti zona banimi të ndërtuara rishtaz me karakter urban/bujqësor.
9. Tregu në Fier-Shegan dhe tregu në Lushnje përbëjnë pika me potencial zhvillimi për shkak të zhvillimit bujqësor dhe kalimit të flukseve tregtare në këto zona.
10. Serrat janë një element i përhapur në të gjithë territorin e bashkisë Lushnje. Kemi rreth 2,610 serra diellore me një sipërfaqe prej 363 ha, duke regjistruar kështu numrin më të madh të serrave në vend në rang bashkie. Aktiviteti prodhues i tyre lidhet kryesisht me kultivimin e domateve dhe perimeve dhe një pjesë e madhe me kultivimin e luleshtrydheve, të cilat, për nga pikëpamja e eksportit, kanë edhe kërkesën më të lartë. Duke pasur parasysh shtrirjen e tyre të madhe në territor, si dhe prirjen e bashkisë drejt bujqësisë, serrat janë një element i fortë pasi përforcojnë elementet e tjera, duke rritur edhe potencialet për prodhime më të mëdha.

Figura 30. Elementët e fortë në territorin e bashkisë së Lushnjes



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

4.1.2 Rreziku gjeologjik

- **Analiza gjeologo-inxhinierike**


Relievi i larmishëm i vendit tonë me njësi fushore, kodrinore dhe malore krijon një peizazh natyror tërheqës dhe njëkohësisht, edhe të prirur ndaj rreziqeve natyrore për vetë përbërjen e tij. Si rezultat, në varësi të relievit, territori në vend dallohet për nivele të ndryshme qëndrueshmërie. Përveç një sipërfaqeje të qëndrueshme e cila zë rreth 10% të territorit kombëtar, pjesa tjetër e tokës është e paqëndrueshme. Kjo e fundit shprehet nëpërmjet formave të ndryshme që SHGJSH-ja i ka klasifikuar si më poshtë[59]:

6. *Rënie shkëmbinjsh* (kryesisht në zona malore (në Alpeve) dhe shpate gëlqerorë të zbuluara
7. *Shembje* (kryesisht në zonat malore)
8. *Rrëshqitje me rrokullisje* (në shpate me shkëmbinj rreshporë ose molasë deltinore dhe shpatet prej konglomerati me pjerrësi > 45˚ si dhe shpateve me drejtim të kundërt).
9. *Rrëshqitje me zhvendosje* (prek shkëmbinjtë e fortë gëlqerorë ose shtresa rreshpore)
10. *Rrjedhje, sidomos ato sipërfaqësore, në trajtën e laharëve* (në zonat malore të Shqipërisë me reshje vjetore 200 mm, luginat me përrenj me pjerrësi të madhe (Elbasan, Përmet, Korcë etj.)

Duke u bazuar në karakteristikat e territorit lidhur me fenomenet e rrezikut gjeomorfologjik, SHGJSH-ja ka përcaktuar zonimin gjeoteknik të Shqipërisë, sipas të cilit territori i vendit tonë ndahet në tre zona të qëndrueshmërisë natyrore (figura 31)[60]:

- *Terrene të qëndrueshme*, që mbulojnë 56.6% të vendit, gjenden kryesisht në zona me shkëmbinj magmatikë efuzivë dhe intruzivë, gëlqerorë të epokave të ndryshme, dolomite, brecke dhe konglomerate me cimentin karbonatik, shkëmbinj metamorfikë dhe rreshpe. Brenda zonës njihen fenomenet e shkëputjes së blloqeve, rrëshqitjes e rrokullisje dhe/ose zhvendosjes.
- *Terrene relativisht të qëndrueshme*, që mbulojnë rreth 33.6% të territorit, gjenden kryesisht në zona me përbërje shkëmbore konglomeratikë të suitës Luma, efuzivë sedimentarë, shkëmbinjve rreshporë, shkëmbinjëve evaporitë dhe molasave të konglomerateve ranore. Këto zona dallohen për rrëshqitje, ose rënie të tavaneve në zgavrat e nëndheshme.
- *Terrene të paqëndrueshme*, që zënë rrreth 9.8% të sipërfaqes së vendit, janë terrene me përbërje të ndryshme shistesh, molasash e konglomeratësh ranore. Dallohen për rrëshqitjet rrokullisëse dhe me zhvendosje, si dhe për rrjedhjet e tokës.

Figura 31. Zonimi gjeoteknik i Shqipërisë dhe i Lushnjes




Burimi : Shërbimi Gjeologjik Shqipëtar[61]; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Nga leximi i hartës së zonimit gjeoteknik të Shqipërisë, në Bashkinë Lushnje, në terren mbizotërojnë kryesisht tokat relativisht të qëndrueshme, të lidhura dhe të paqëndrueshme. Këto të fundit përqëndrohen në zonën e Dushkut.

- **Rrëshqitja/Rrëzimi i gurëve/Rrëshqitja e dherave**

Rrëshqitjet e dheut janë një fenomen i kufizuar në zona të caktuara në Qarkun Fier dhe në të cilin bën pjesë Bashkia Lushnje.

Figura 32. Rrëshqitjet në Bashkinë Lushnje



Burimi: SHGJSH, 2014; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Në përgjithësi, ky fenomen është më tepër i përhapur në formacionet argjilore dhe me pjerrësi të dukshme. Përveç zonave me pjerrësi të lartë, fenomeni i rrëshqitjes është përhapur edhe në zonat me shpate që preken pak nga dielli, si dhe në fund të shpateve, nëpër të cilat kalojnë lumenj, ose përrenj të ndryshëm duke i gërryer ato.

Për sa i përket vendndodhjes, rrëshqitjet janë përqëndruar kryesisht në rajonet kodrinore në zonën verilindore të bashkisë, në Nja-të Ballagat, Golem, Hysgjokaj dhe Karbunarë.

Shkaqet kryesore të rrëshqitjeve[62] përfshijnë faktorë natyrorë gjeologjikë (ndërtimi gjeologji-klitologjia, pjerrësia e shpatit mbi 5-20°, struktura, tektonika, zona ose shpate që nuk rrihen nga dielli ku lagështira e vazhdueshme ka shkaktuar rrëshqitje. etj) dhe faktorë të jashtëm (përmbajtja e lartë e ujërave nëntokësore, rreshjet e dendura të shiut, ndërhyrjet e njeriut me ndërtime të ndryshme etj.). Kohët e fundit, rrëshqitjet janë theksuar për shkak të shpyllëzimeve të shumta. Shpeshherë, tokat pyjore janë shndërruar në bujqësore duke prishur kështu ekuilibrin natyror.

Kohët e fundit, rrëshqitja e dherave ka shkaktuar dëme të ndjeshme në bashki[63] dhe ka prekur kryesisht fshatrat e zonës kodrinore. Si pasojë e rrëshqitjeve masive të tokës ndër vite, ka patur dëmtime të një numri të konsiderueshëm banesash **(**tabela 7**)**, stallash të bagëtive etj. duke i detyruar banorët, banesat e të cilëve kanë rezultuar të pabanueshme, të ndërtojnë shtëpi të reja në zona të tjera ose duke u vendosur për të banuar në ambjente shtetërore[64]. Në të gjitha rastet kemi të bëjmë, ndër të tjera, me humbje të mëdha ekonomike, si për banorët të cilët detyrohen të fillojnë jetën e tyre nga e para, ashtu edhe për buxhetin e shtetit, pasi kështu detyrohet të sigurojë banesa për banorët e ndikuar nga rrëshqitjet.

Tabela 11. Rrëshqitjet e dherave në Bashkinë Lushnje në vitet e fundit

Viti	Fshatrat	Dëmtimet
2009	Allprenaj Peqin	18 banesa
2010	Hysgjokaj	25 banesa
	Ballagat	2 banesa
	Gjuzaj	2 banesa
	Jazxhias	4 banesa
	Manasufaj	2 banesa
	Xibrakë	1 banesë

Burimi: Emergjencat Civile dhe Njësitë Administrative të Bashkisë; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

- **Erozioni/Vatrat e Erozionit**

Erozioni mbetet një ndër problematikat kryesore pothuajse në të gjithë botën dhe, sigurisht, edhe në vendin tonë. Vetëm gjatë gjysmës së dytë të shekullit të XX është llogaritur se degradimi i tokës për shkak të erozionit ka përfshirë rreth 43% (ose 5 miliardë ha) të territorit në shkallë botërore[65]. Ndër shkaqet kryesore të këtij degradimi janë përdorimi i tokës nga njeriu për qëllime të ndryshme. Më konkretisht, faktorët që ndikojnë ndjeshën në rritjen e erozionit janë kryesisht i) reshjet (dhe sidomos shirat e rrëmbyeshme), intensiteti dhe shpërndarja e tyre luajnë një rol të rëndësishëm, ii) përbërja e tokës/shkëmbinjve (kapaciteti i infiltrimit dhe niveli i stabilitetit të strukturës së tokës), iii) pjerrësia (gjatësia dhe niveli i pjerrësisë), si dhe iv) bimësia ose shtresat bimore që mbulojnë tokën.

Edhe në Lushnje, erozioni është fenomen i pranishëm në territor. Sipas SHGJSH-së[66], ky fenomen është i përhapur në zonat kodrinore me përbërje litologjike flishore i cili, nga ana e tij, është ndihmuar në një masë shumë të madhe nga shpyllëzimet e shumta që u bënë gjatë viteve ’80-’90 të shekullit të kaluar, si dhe gjatë këtyre viteve të fundit. Ky erozion shfaqet në formën e dy tipeve kryesore: erozion sipërfaqësor dhe erozion fundor. *Erozioni sipërfaqësor* prek kryesisht zonat kodrinore, aty ku kemi dalje të fuqishme të formacioneve litologjike flishore (*fshatrat Hajdaraj, Gramsh fshat, Shegas, Hysgjokaj, Gjuzaj, Ballagat*) dhe në zonat argjilore fushore. Erozioni fundor shfaqet në brigjet e lumenjve, si në brigjet e *Lumit Seman* ku pothuajse mungon tërësisht brezi bimor mbrojtës gjatë gjithë shtrirjes së tij në territorin e Bashkisë (figura 33).

Figura 33. Erozioni në Bashkinë Lushnje



Burimi: SHGJSH 2014; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Është e rëndësishme të theksohet se shpyllëzimet e vazhdueshme dhe pa kriter gjatë viteve të fundit në territorin kodrinor të Bashkisë (nga vitet 1980 e deri më sot), si dhe praktika të papërtshtatshme të plugimit në zona fushore kanë luajtur një rol parësor në shtimin e fenomenit të erozionit në territor.

Në zonat kodrinore (kryesisht zonat pyjore ose kullosore), erozioni ka ardhur si pasojë e shpyllëzimeve, mbishfrytëzimit të pyjeve e kullotave, dëmtimit të bimësisë së ulët (nën-pullit) dhe plugimit të tokave të papërshtatshme. Është e rëndësishme të theksojmë se sekreti i pyjeve në mbrojtjen e tokës nga erozioni qëndron pikërisht në lënien e sipërfaqes së tokës të patrazuar. Kjo bën të mundur që bimësia, jo vetëm pyjet, të zhvillohet dhe të krijojë një mbulesë të të gjithë sipërfaqes. Ndryshe nga sa mendohet, nuk mjaftojnë vetëm drurët e lartë (pyjet) me rrënjët e tyre të thella që të mbrojnë pyjet nga erozioni. Është *tabani i tokës* (sipërfaqja) që mbron tokën nga erozioni. Në qoftë se sipërfaqja e tokës është e zbuluar, pikat e shiut, që bien nga gjethet e pemëve të larta, ushtrojnë presion të lartë mbi dherat e tokës duke e gërryer atë. Mbulesa e tokës me një shtresë bimore shërben si masë efikase për mbrojtjen e tokës nga erozioni. Për këtë arsye, bimësia e ulët nëpër pyje ka një ndikim të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e tokës nga erozioni.

Përveç shpyllëzimit e dëmtimit të bimësisë në pyje, shkak tjetër kryesor i erozionit është edhe hapja ose ndërtimi i rrugëve të reja, zhvillimi i verimtarive të ndryshme për shfrytëzimin e drurit (prerje, grumbullim, transporti me makina, shitje etj.) si dhe hapja e shtigjeve të ndryshme për aktivitetet argëtuese, të cilat nuk kanë munguar në vitet e fundit së bashku me rrugët për shfrytëzimin e minierave (guroreve). Hapja e rrugëve të reja në zona kodrinore pa marrë masat e duhura mund të shkaktojë humbjen e 100Mg/ha dhera të shkaktuara nga erozioni.[67]

Për sa i përket erozionit në tokat bujqësore të vendit tone, rreziku potencial i erozionit konsiderohet mesatar dhe i lartë ndërsa në Qarkun e Fierit, ku bën pjesë edhe Bashkia e Lushnjes, konsiderohet mesatar (tabela 12).[68]

Tabela 12. Vlerësim teorik për nivelin e erozionit në tokat bujqësore të Shqipërisë

		Indeksi i erodibilitetit				**Indeksi i rrezikut potencial të tokës**		
Rrethet	Sip (Ha)	Absol.	Rel.	Indeksi i erozionit të tokës	Indeksi i pjerrësisë	Absol.	Rel.	Vlerësimi
Lushnje	46,136	5.7	2	2	1.60	6.4	2	Mesatar
Fier	60,674	6.7	3	3	1.68	15.1	3	I larte

Burimi: AKM 2013; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Bashkia ka shumë fshatra, që gjenden në zonë kodriore, të cilat i përkasin Nja-ve Ballagat, Hysgjokaj dhe Karbunarë. Kultivimi i tokës së këtyre zonave krijon vetvetiu **erozion** të tokës nëse nuk përdoren praktika të mira bujqësore gjatë përdorimit të tyre për bujqësi.

Për sa i përket shkaqeve të erozionit në zonën fushore të Myzeqesë, ai lidhet ngushtë me plugimin e tokës (mungesën e praktikave të mira bujqësore të plugimit). Gjatë gjithë territorit të vendit dhe brenda territorit të bashkisë, në kohën e punimit të tokës, vihen re ngastra me tokë të punuar thellë dhe të zhveshur tërësisht nga bimësia (figura 35). Në tokat bujqësore veçanërisht, në vendin tonë, bujqit ose fermerët, gjatë punimit, ende vazhdojnë ta zhveshin tokën tërësisht nga të gjitha mbetjet bimore të të mbjellave të stinëve të mëparshme pa marrë parasysh se një gjë e tillë e varfëron tokën dhe e shndërron atë në tokë të ndjeshme ndaj erozionit në rastin më të parë të reshjeve me intensitet të lartë apo të stuhive të erës. Ndërkohë që vendet e tjera kanë futur tashmë praktika kultivimi të konsoliduara për shmangien ose zbutjen e erozionit (punimin i tokës, duke e trazuar atë sa më pak, ruajtjen e masës bimore të të mbjellave të mëparshme gjatë kultivimit, përdorimin i mbulesave bimore ndërmjet stinëve të kultivimit ose mbjelljen e foragjereve ndërmjet bimëve të kultivuara me rreshta si pemtaria, vreshtaria ose ullishtet, etj.) në vendin tonë mbetemi ende prapa.

Figura 34. Punimi i tokës me zhveshje të sipërfaqes



Burimi: Arkiva Co-PLAN, 2016

Për të kuptuar përmasat dhe shtrirjen e erozionit në territorin e Bashkisë, mjafton të analizojmë vëllimin e rezervuarëve dhe digave që ndodhen në Bashki. Nga një analizë e hollësishme e 9 rezervuarëve/digave të pranishme në Bashki, është vënë re se pothuajse të gjithë rezervuarët kanë pësuar zvogëlim të volumit të tyre për shkak të erozionit. Më problematike mbetet diga e GaruNjas, zvogëlimi i kapacitetit të së cilës arrin deri në 92%, e ndjekur nga Rezervuari i Thanës me 85% dhe Kasharaj dhe Pajalli me 22% dhe 17% përkatësisht.

Si rezultat i erozionit, mungesës së njohurisë se thelluar mbi tokën dhe praktikat e keqmenaxhimit, apo braktisjes, në territorin e bashkisë vihet re degradimi i tokës. Nuk

ka shifra lokale, por në rang vendi, vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014[69].

- **Përmbytjet**

Përmbytjet janë një fenomen i pranishëm dhe pothuajse "i zakonshëm" në territorin e Bashkisë së re të Lushnjes dhe ndodhin, si në zonën urbane, ashtu edhe rurale. Përmbytjet janë regjistruar në Lushnje kryesisht në rastet kur reshjet kanë qenë intensive e të vazhdueshme në një periudhë kohore relativisht të gjatë (praktikisht sa herë që reshjet tejkalojnë 80mm)[70]. Sipas të dhënave të marra nga Emergjencat Civile Lushnje, përmbytjet janë shpeshtuar ndjeshëm në dhjetë vitet e fundit[71]. Për shembull, vetëm në 8 vitet e fundit ka patur 3 përmbytje (në vitet 2009, 2015 dhe 2016 përkatësisht), të cilat kanë shkaktuar dëme të mëdha në ekonominë e banorëve vendas (Tabela 13). Përmbytja e vitit 2016 ka përmbytur 31 shtëpi kundrejt atyre të vitit 2009 dhe 2015, të cilat kanë përmbytur 29 dhe 26 shtëpi përkatësisht. Përveç banesave, përmbytja e vitit 2009 ka shkaktuar edhe përmbytje të tokave bujqësore (150) ndërsa ajo e vitit 2015 ka përmbytur rreth 57 sera të mbjella me perime dhe 250 dengje me bar që shërbenin si ushqim për blegtorinë. Me pak fjalë, përmbytjet në territorin e Bashkisë Lushnje, përveç se janë shpeshtuar, janë shoqëruar gjithnjë me humbje të mëdha ekonomike për banorët.

Tabela 13. Përmbytjet në territorin e Bashkisë Lushnje në 10 vitet e fundit

Viti	**Fshati/Qyteti**	**Objektet e përmbytura dhe dëmet e shkaktuara nga përmbytjet**			**Shkaqet**
		Shtëpi të përmbytura	Tokë bujqësore	Të tjera	
2009	Saravë, Saver, Karbunare	29	150 ha		Reshjet
10 Tetor 2015	Krutje, Ngurrëz, Kamçisht, Toshkëz Ndikimi negative edhe në NJA-të Fiershegan, Allkaj, Bubullimë, Kolonjë	26		-Ushqim për bagëtinë -250 dengje me bar -57 sera të mbjella me perime	Mosplotësim detyre e Bordit të Kullimit (moshapja në kohë e portave të komandimit në barazhin e Bitajt & mosfunksionimi i tyre teknik
7 Jan 2016	Thanasaj	31			Dalja nga shtrati e lumit Shkumbin

Burimi: Emergjencat Civile dhe Njësitë Administrative të Bashkisë,; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Për sa i përket pasojave që vuajnë banorët vendas nga përmbytjet, është e rëndësishme të theksohet se ato edhe mund të zbuten ose parandalohen pjesërisht. Në përgjithësi, niveli i ndikimit të përmbytjeve në ekonominë e banorëve vendas varet nga masat paraprake që merren nga institucionet përkatëse (p.sh. Bordi i Kullimit etj.) për zbutjen e ndikimit të përmbytjeve të tilla si: pastrim të kanaleve të kullimit, të shtratit të përrenjve kryesorë dhe të Lumit Shkumbin e Seman, ndërtim digash ose panelesh në disa vende specifike etj. Në të gjitha rastet që ka patur përmbytje, këto masa fatkeqësisht nuk janë marrë.

Nga të dhënat e mbledhura nga Emergjencat Civile së bashku me Bashkitë, origjina e përmbytjeve dhe rrëshqitjeve është ***natyrore***. Ndërsa ndikimi i këtyre fenomeneve në Bashki është i lartë për shkak të mosmarrjes së masave të duhura pregatitore për zbutjen e pasojave. Në të shumtën e rasteve, ndikimi i fenomeneve të tilla në mjedis dhe në jetën e banorëve mund të zbutet ndjeshëm, në rast se merren masa për mbrojtjen e tokës nga gërryerjet dhe rrësqitjet e dheut (të nevojshme në NjA 1 dhe

NjA 2), ose për zhbllokimin e shtretërve të lumenjve (NJA 5). Për më tepër, në disa raste, ndikimi i përmbytjeve mund të zbutet në rast se ndërtimi i veprave të ndryshme inxhinierike bëhet duke marrë parasysh ndikimin e tyre në mjedis dhe në jetën e banorëve në të ardhmen gjatë projektimit. Një rast i tillë është rasti i ndërtimit të KUB-it në Lushnje në territorin e Nja-së 4, në Lagjen Gafurr Muça, ku niveli i tij është më i lartë se ai i tokave të shtëpive përreth. Si rrjedhojë e ndërtimit të papërshtatshëm me natyrën të një vepre të tillë, në rast shirash të rrëmbyeshëm, shtëpitë e lagjes rrezikojnë përmbytjen. Aktualisht, zonat më problematike në Qytetin e Lushnjes, që mund të bëhen shkak për situata emergjence nga fatkeqësi natyrore, si dhe masat që duhen marrë për zbutjen e pasojave, janë paraqitur më poshtë:

Tabela 14. Rreziqet gjeologjike në Qytetin e Lushnjes (rrëshqitjet dhe përmbytjet)

NJA-të	**Objekti**	**Vend-ndodhja/shtrirja**	**Masat që duhen marrë/nevojat**	**Shkaqet**
NJA 1	Përroi i Qytetit	Segmenti nga rezervuari i Kasharit deri tek Kaptazhi (tek Çelët)	-Pastrim dhe sistemim shtrati në përgjithësi - Ndërhyrje për drejtimin e shtratit & betonimin e skarpatave të përroit të qytetit në segmentin përgjatë varrezave publike	Rrëshqitja e dherave (janar 2013)
	Rr. Shaqir Tare	E gjithë rruga	-Rehabilitim total i rrugës (në këtë moment është e pakalueshme)	Gërryerja e tokës ndër vite
NJA 2	Kanali i ujërave të larta	Segmenti nga rezervuari i "Xhafallarëve" deri tek Ura në Rr. "Vasil Prifti"	Pastrim dhe sistemim i skarpatave anësore. Në disa vende ka shembje	Shembje të tokës
	Lagja Xhevdet Nepravishta	Segmenti në Rr. "Vëllezërit Frashëri"	Bashkia ka përgatitur projektin për ndërhyrjet e duhura, por mungojnë fondet për zbatim të tij. Gjendja ende problematike	Rrëshqitje në përmasa 15x1.5 m & thellësi 3 m.
NJA 4	Lagja Gafurr Muça	Zona e banimit pranë pall.Nr.177 dhe pranë shtëpive private të fiseve Zaçe, Mejdani & Hasanbelliu	Studime për rikonstruksionin e KUB-it në këtë zonë, për shkak se zona në fjalë përmbytet në rast reshjesh me intensitet të lartë (arsyeja: niveli i KUB është më i lartë se niveli i tokës tek këto shtëpi)	Përmbytje në rast reshjesh me intensitet të lartë (niveli i KUB > se ai i tokës
NJA 5	LuNja Karbunarë	Segmenti i kanalit nga Ura e Begallarëve deri tek pika e Karburantit "Lloshi"	Pastrim dhe sistemim i shtratit të kanalit	Bllokim shtrati

Burimi: Emergjencat Civile në bashkëpunim me Njësitë Administrative të Bashkisë; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016


Rreziku nga përmbytjet e lumenjve kryesor në vend me rikthim 100 vjet:

Vendi ynë rrezikon dëmtime të mëdha në rast se përmbytjet janë për periudhë rikthimi 50 vjet dhe 100 vjet. Nga studimet e kryera nga PNUD, pasojat janë pothuajse të papërfillshme (me ndikim të kufizuar ose pa pasoja) në rastin e përmbytjeve me rikthim në 50 vjet. Kjo në rast se merren të gjitha masat për paradalimin e tyre (kur sistemi i pendave është i padëmtuar dhe instalimet e pompimit janë të gjitha në punë). Masa të tilla janë në gjendje të shmangin rreziqet që i kanosen Ultësirës Perëndimore.

Përmbytjet me rikthim në më shumë se 50 vjet duket se janë përmbytjet që kanë një ndikim më të fuqishëm në vend. Këto lloj përmbytjesh (të rikthimit me 100 vjet, p.sh.) mund të krijojnë të njëjtat kushte si përmbytja e vitit 1962/63. Shkalla e rrezikshmërisë nga këto përmbytje ndyshon nga zona në zonë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se rajonet me rrezikun më të ulët të përmbytjeve në periudhë rikthimi 100 vjet janë Ultësira Perëndimore, rajoni i Alpeve të Shqipërisë dhe Krahina Malore Juglindore.

Rrezikshmëria më e lartë e përmbytjeve paraqitet në pellgjet ujëmbledhëse të lumenjve Devoll dhe Osum, pjesën e poshtme të Shkumbinit, lumenjtë Drini i Zi, Mati, rajoni i Bregut të Detit dhe lumenjtë Kiri, Gjadri, Lesniqja, Gomisqja, Ishmi dhe lumenjtë e Krahinave Malore Jugore dhe Qëndrore të Shqipërisë, si Drinosi, Shushica etj. Në pjesët e tjera të vendit rreziku është më i ulët.

Figura 35. Rreziqet gjeologjike në Qytetin e Lushnjes (rrëshqitjet dhe përmbytjet)



Burimi: PNUD, 2003; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Siç shihet nga grafiku i mësipërm, në pjesën më të madhe të territorit, rreziku i përmbytjeve në vend me rikthim në 100 vjet është i mesëm në 11,433 km^2 (40.3%) i ndjekur nga ai i ulët (23.5%, e më tej i madh (20.7%), i lartë (10%) dhe i skajshëm (5.5%). Duhet theksuar se të tre kategoritë e fundit me rrezik të i lartë, të madh dhe të skajshëm, që kanë ndikimin më të fuqishëm në vend, përfshijnë 36.2% të territorit. Pra, Shqipëria është vend tejet i rrezikuar nga përmbytjet ku vetëm 23.5% e territorit nuk kërcënohet nga pasojat e rënda të përmbytjeve. Në pjesën tjetër, është tejet e rëndësishme që planifikimi i territorit të bëhet duke patur parasysh pasojat e mëdha në rast përmbytjesh me kthim 100 vjet.

- Rreziku nga përmbytjet e lumenjve kryesorë me rikthim 100 vjet në Bashki

Për sa i përket Bashkisë së Lushnjes, përmbytjet parashikohen të shkaktohen nga lumenjtë kryesorë që janë Semani dhe Shkumbini.

Siç u theksua më sipër, përmbytjet me rikthim në 50 vjet janë të parashikueshme dhe, vetëm duke marrë masat e duhura, mund të shmangen pasojat e tyre. Kjo është vërtetuar në vendin tonë pas përmbytjeve të vitit 1962-63 kur dhe janë marrë masa për

parandalimin e përmbytjeve të tilla duke dhënë rezultate të kënaqshme në parandalimin e pasojave të rënda në përmbytjen e viteve 1970-71. Sipas PNUD-it, pas vitit 1962-63, masat për parandalimin strukturor dhe kontrollin e përmbytjeve (duke përjashtuar digat) të ndërmarra në vend janë mbështetur në një periudhë rikthimi të ujërave nga përmbytjet prej 50 vjetësh. Këto masa përfshijnë rindërtimin dhe ngritjen e argjinaturave të reja në pjesën e poshtme të lumenjve kryesorë.

Ndërkohë, në vendin tonë nuk janë marrë masa për përmbytje me rikthim në 100 vjet. Për këtë arsye, vendi ynë dhe, rrjedhimisht edhe Bashkia Lushnje, nevojitet të planifikojnë zhvillimin e territorit duke patur parasysh ndikimet e përmbytjeve me rikthim në 100 vjet. Pasojat e përmbytjeve të këtij lloji të parashikuara nga PNUD-i për Bashkinë Lushnje janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme (tabela 37). Duhet theksuar se studimet janë kryer në nivel rrethi sipas ndarjes territoriale administrative përpara Reformës së re Territoriale).

Figura 36. Pasojat e përmbytjes së Ultësirës Perëndimore.


Lumi	**Qarku**	**Rrethi**	**Nr. i fshatrave**	**Nr. i komunave**	**Nr. i ndërtesave**	**Sip. e ndërtimit (m^2)**	**Popullsia**
L. SEMAN	Fier		90	30	15,516	1,147,540	83,829
		Lushnje	40	12	5,729	446,060	32,369
L. SHKUMBIN			30	14	6,599	513,420	38,052
		Lushnje	24	9	4,755	392,920	28,514
GJITHSEJ			64	21	10,484	838,980	60,883

Burimi : PNUD, 2003; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Sipas parashikimeve të PNUD-it, nevojat që do të lindnin nga përmbytjet me rikthim 100-vjet nga pellgjet e Semanit janë më të mëdhatë (figura 38). Në territorin e ish-rrethit të Lushnjes, vetëm nga një fenomen i tillë, parashikohet përmbytja e 40 fshatrave, 12 komunave, 5,729 ndërtesave, si dhe e 446,060 m^2 sipërfaqe toke. E gjithë kjo me pasoja të rënda për 32,369 banorë. Megjithatë, edhe përmbytjet nga lumi Shkumbin nuk janë të vogla edhe pse me ndikim më pak të theksuar se ato të Lumit Seman (392,920 banorë kundrejt 446,060 banorë nga përmbytjet e Semanit). Në total, nga përmbytjet e Semanit dhe Shkumbinit me kthim në 100 vjet në Bashkinë Lushnje (territorin e ish-Rrethit të Lushnjes) parashikohet të preken rreth 60,883 banorë dhe 10,484 banesa.

Ndërkohë, llogaritet se shifrat do të shumëfishoheshin në rast përmbytjesh të njëkohësishme nga disa pellgje.

Figura 37. Pasojat e përmbytjes së Ultësirës Perëndimore.



Burimi : PNUD, 2003

Si përfundim, duke parë se parashikimet rreth ndikimit të përmbytjeve në vend janë kryer në vitin 2003, dhe se gjatë këtij 13 vjeçari regjimi i reshjeve ka ndryshuar, duke çuar kështu në shpeshtimin e përmbytjeve dhe rritjen e ndikimit të tyre në territoret e bashkive, mendohet se pasojat e përmbytjeve me rikthim 50 ose 100 vjet të jenë edhe më të theksuara. Për këtë arsye, përveç marrjes së masave të duhura për parandalimin e përmbytjeve me rikthim 100 vjet, nevojiten edhe studime të reja më të përditësuara rreth përmbytjeve në vendin tonë.

4.2 Metabolizmi i territorit

Analiza e metabolizmit trajton flukset në territor/qytet urban. Sipas nenit 2 të VKM-së nr. 671 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", metabolizmi i territorit është një model që përdoret për identifikimin dhe analizën e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda territoreve të caktuara. Ky model u ofron studiuesve një kuadër nëpërmjet të cilit të studiojnë ndërveprimet e sistemeve natyrore dhe njerëzore në rajone të caktuara. Flukset e analizuara janë: fluksi i energjisë, fluksi i ujit, fluksi i ushqimit dhe fluksi i mbetjeve. Flukset analizohen nëpërmjet identifikimit të hyrjeve dhe daljeve për secilin fluks që merret në analizim. Hyrjet dhe daljet e secilit fluks krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionojë si një i tërë. Fluksi i energjisë dhe fluksi i ujit do të analizohen si fillim në nivel rajoni dhe më pas në nivel bashkie. Burimet e energjisë kanë ndikim dhe menaxhohen në rang kombëtar, pavarësisht territorit ku ndodhen. Uji që gjendet në një sistem urban vjen nëpërmjet burimeve nëntokësore (që nuk i përkasin territorit të një bashkie nga ana administrative) apo burimeve sipërfaqësore, duke kaluar në disa sisteme të ndryshme urbane. Në këtë rast, kur kalon në sisteme të ndryshme urbane (rasti i lumenjve), sjell me vete edhe ndotje që merr gjatë rrugës. Burimet ujore menaxhohen në nivel baseni ujëmbledhës dhe në nivel kombëtar.

- **Energjia në rajon**[72]


Rajoni që përbëhet nga bashkitë Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Lushnje, Peqin, Belsh, Cërrik, Patos, Mallakastër, Ura Vajgurore, Kuçovë, Berat, Gramsh, Elbasan, PërreNjas, Librazhd, Pogradec ka burime të shumta energjie. Pjesa kryesore e energjisë që përftohet nga hidrokarburet në Shqipëri është e përqendruar në këtë zonë. Kompanitë që operojnë në këtë territor për nxjerrjen e naftës janë: ***Bankers*** (Patos-Marinëz), ***TransAtlatic*** (Ballsh, Cakran, Gorisht, Delvinë), ***Sherëood*** (Kuçovë), ***Transoilgroup*** (Visokë); ***Phoenix*** (Amonicë). Energjia e hidrokarbureve zë pjesë të rëndësishme. Edhe energjia hidrike vazhdon të mbetet një nga burimet kryesore të energjisë.

Lumenjtë si Shkumbini, Osumi e Devolli përdoren për prodhimin e energjisë hidrike nëpërmjet hidrocentraleve të instaluara dhe atyre që po ndërtohen. Energjia hidrike vazhdon të mbetet burim kryesor energjie për konsumatorët familjarë, por edhe për bizneset, industritë apo institucionet.

Burimet alternative të energjisë si dielli, era, energjia gjeotermale shfrytëzohen shumë pak. Mundësitë që këto energji të përdoren janë të mëdha. Energjia e erës mund të përdoret në Ultësirën Perëndimore, Divjakë, Rrogozhinë dhe Fier (zona veriperëndimore) për prodhimin e energjisë. Energjia diellore është potencial thuajse në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë. Numri i lartë i ditëve me diell është i favorshëm për prodhimin e energjisë diellore. Energjia gjeotermale mund të shfrytëzohet nëpërmjet burimeve gjeotermale. Në Elbasan gjenden burime

gjeotermale, temperatura e të cilave arrin >80°C. Gjithashtu, në Fier puset gjeotermale mund të përdoren për prodhimin e energjisë.

Figura 38. Fluksi i energjisë në rajon




Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN[73], 2015

- **Uji në rajon**

Rajoni është i pasur më ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ky territor përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si Shkumbini, Semani, Devolli, Osumi, Vjosa dhe lumenj më të vegjël. Pasuritë e mëdha ujore bëjnë që shfrytëzimi i tyre të jetë i lartë. Në këtë zonë janë propozuar të ndërtohen pjesa më e madhe e HEC-eve.

Shtresat nëntokësore ujëmbajtëse, akuifere ndërkokrrizore me përcjellshmëri të lartë-shumë të lartë të ujit, të cilat dallohen për një cilësi të lartë të ujërave nëntokësore, gjenden kryesisht në pjesën verilindore të këtij territori. Këto shtresa shfrytëzohen nëpërmjet burimeve për ujë të pijshëm apo përdorimeve të tjera. Shtresat nëntokësore, akuifere me porozitet karst-çarje, me përcjellshmëri shumë të ndryshueshme shumë të lartë- të lartë të ujit, gjenden në zona të zhvilluara si qyteti i Elbasanit, qyteti i Kuçovës (zona urbane) në pjesën jugperëndimore të bashkisë Fier. Këto shtresa nëntokësore kanë një nivel më të ulët filtrimi, ndaj dhe mundësia për të përthithur ndotjen në zonat e zhvilluara është më e lartë. Puset e përqendruara kryesisht në akuiferet karst-çarje ndikojnë në përçimin e ndotjes në shtresat nëntokësore.

Figura 39. Fluksi i Ujit në Rajon



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN[74]

- **Analiza e metabolizmit të territorit të Lushnjes**

Analiza e metabolizmit të territorit në bashkinë e Lushnjes merr në konsideratë disa faktorë kryesorë që ndikojnë në flukset e energjisë, ujit, ushqimit dhe mbetjeve. LushNja ka një sipërfaqe prej 373 m²[75] dhe popullsi 84,921 banorë[76]. Flukset e analizuara në kuadër të analizës së metabolizmit janë: energjia, uji, ushqimi dhe mbetjet. Analizimi për secilën rrymë ndjek të njëjtën metodologji në parim, por për shkak të mungesës së informacioneve të caktuara analiza pëson modifikime nga fluksi në fluks. Për të analizuar flukset janë vëzhguar hyrjet dhe daljet për secilin fluks me qëllim të kuptuarin e problemeve mjedisore dhe humbjeve.

Fluksi i energjisë: Fluksi i energjisë tregon sasinë e prodhuar dhe konsumin e energjisë në territorin e bashkisë Lushnje. Ky fluks tregon edhe energjinë potenciale që mund të përdoret, duke minimizuar në këtë mënyrë disa burime energjie të cilat kanë konsum më të lartë, duke minimizuar në këtë mënyrë disa burime energjie të cilat janë të mbishfrytëzuara.

- Potencialet energjetike dhe prodhimi i energjisë në territorin e bashkisë Lushnje

Territori i Lushnjes shtrihet në një zonë me pasuri ujore sipërfaqësore. Aktualisht, në territorin e Lushnjes operon një hidrocentral, hidrocentrali i Thanës, me fuqi 1,4 MË

dhe energji 6,000 Mëh[77]. Janë parashikuar të ndërtohen edhe dy hidrocentrale të vogla me fuqi 0-1MË, përkatësisht në komunat Hysgjokaj dhe Ballagat[78].

Tabela 15. Energjia e shpenzuar për ngrohje, Lushnje

Njësia adminstrative	**Lumi/Përroi**	**Kuota e ndërtesës së centralit**	**Kuotat e veprës së marrjes**	**Hec-i**	**Fuqia**	**Energjia**
Fier-Shegan	Rezervuari i Thanës	21.76	31.26	Thanë	1,400	6,000,000

Burimi: INSTAT, Censusi 2011

Një burim alternativ energjie që ka potencial për t'u përdorur në territorin e Lushnjes është energjia diellore. LushNja ndodhet ndërmjet izoliNjave 1600-1550 këh/m² në vit. Shpërndarja e mesatares ditore për rrezatimin global në stacionin meterologjik të Lushnjes luhatet nga 1579 në muaj (dhjetor) deri në 6834 në muaj (korrik)[79]. Energjia diellore shfrytëzohet në nivel kombëtar 0.1% për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe në mënyrë individuale me panele fotovoltaike[80]. Energji tjetër potenciale në Lushnje mund të jetë energjia e erës. Në pjesën veriperëndimore të bashkisë Lushnje shpejtësia e erës arrin deri në 2.8m/s [81].

Konsumi i energjisë dhe lloji i energjisë së përdorur për ngrohje: Energjia elektrike është një nga burimet primare të energjisë në Shqipëri. Për të llogaritur konsumin e energjisë për familje/vit jemi mbështetur mbi të dhënat e INSTAT-it, Censusi 2011 (Grid). Duke iu referuar numrit të banorëve që gjenden për çdo km² në të gjithë territorin e bashkisë Lushnje[82] dhe duke marrë parasysh që konsumi total i energjisë elektrike në Shqipëri për vitin 2011 është 2,587,907 Mëh, mund të llogarisim sa energji elektrike konsumon mesatarisht një familje në vit.

Për vitin 2011, sipas INSTAT-it, numri mesatar i personave në një familje është përafërsisht 4 anëtarë. Numri total i njësive ekonomike familjare është **722, 600 familje** (Tabela 2)**.** Konsumi mesatar i energjisë elektrike për familje në një vit është: konsumi i energjisë elektrike nga familjet **(2,587,535)**/nr. i familjeve **(722, 600) =** energjia elektrike që konsumon një familje për një vit **(3.6 MWh).** Për të gjeneruar energjinë e konsumuar për çdo km², shumëzojmë nr. e familjeve në atë sipërfaqe me vlerën mesatare vjetore të konsumit të energjisë elektrike.

Tabela 16. Popullsia banuese, Shqipëri

Popullsia banuese gjithsej	**2 821 977**
Numri gjithsej i njësive ekonomike familjare	**722 600**


Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi) dhe përpunime të autorëve

Tabela 17. Bilanci i energjisë elektrike, Lushnje

Emërtimi	**Energjia (MËh)**
Energjia në dispozicion (burimet)	**7,532,055**
Prodhimi neto vendas	4,057,089
Termocentrale	0
Hidrocentrale	4,057,089
Importi bruto (energji në marrje)	3,474,966
Eksporti bruto (energji në dhënie)	300,544
Konsumi i energjisë elektrike	**7,210,731**
Humbjet në rrjet	2,179,157
Familjet	**2,587,907**
Të tjera	2,443,667

Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi)

Figura 40. Bilanci i energjisë për bashkinë e Lushnjes



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN[83]

Një sasi e konsiderueshme e energjisë së konsumuar shkon për ngrohje. Sipas të dhënave të INSTAT-it, burimi kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje në qarkun Fier nga njësi ekonomike familjare (NjEF) vazhdon të jetë energjia e përftuar nga drutë e zjarrit. 51.87% e NjEF-ve në qarkun Fier përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, ndjekur nga gazi (23.44%) dhe më pas nga energjia elektrike (12.71%)[84].

Tabela 18. Tipi energjisë përdorur në ngrohje dhe zonës urbane dhe rurale në Lushnje

Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje	**Zona urbane dhe rurale**		
	Gjithsej	**Urbane**	**Rurale**
Gjithsej	82,074	35,149	46,925
Dru	42,574	6,537	36,037
Energji elektrike nga rrjeti	10,434	8,653	1,781
Gaz	19,242	14,289	4,953
Lloj tjetër energjie (panel diellor, qymyr, naftë etj)	365	221	144
Pa ngrohje	9,459	5,449	4,010


Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi)

- **Fluksi i ujit**

Fluksi i ujit tregon bilancin e prodhimit të ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor në territorin e bashkisë Lushnje dhe sasinë e konsumit të tij. Uji përdoret nga banorët, bizneset, industritë, institucionet etj. për qëllime teknologjike, për pirje, *imbotilim (uji i mbushur në shishe)*, shpërndarje nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit. Për të bërë një llogaritje të përafërt të sasisë së ujit që ndodhet në organizmin urban (në këtë rast,

territorin e bashkisë Lushnje) mund të nxjerrim sasinë totale të ujërave në territor (ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe sasinë e përdorimit të ujërave. Sasia e ujërave nëntokësore llogaritet nga burimet që shfrytëzohen në territor[85]. Ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe prej 16,5 km² në të gjithë territorin e bashkisë Lushnje[86]. Pjesë të rëndësishme në territorin e Lushnjes, nga pikëpamja e ujërave sipërfaqësore, zënë kanalet ujitëse.

Figura 41. Harta e ujërave sipërfaqësore të bashkisë së Lushnjes



Burimi: Bashkia Lushnje, ValuADD dhe Co-PLAN[87]

Shtresat nëntokësore ujëmbajtëse, akuiferet me porozitet çarje-karst dhe përcjellshmëri të ndryshueshme shumë të lartë - të lartë të ujit, ndodhen në pjesën veriperëndimore të bashkisë Lushnje. Sasia e ujit që shfrytëzohet nga burimet ujore është 3.368 l/sek. (Harta hidrografike, SHGJSH)[88]. Këto ujëra nëntokësore përdoren për pirje, për t'u shpërndarë në sistemin e ujësjellësit, për qëllime teknologjike etj.

Nga të dhënat e marra nga ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve në bashkinë Lushnje rezulton se territori i bashkisë nuk ka mbulim të mirë me shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve. Zona e qytetit e merr shërbimin nga UK Lushnje[89], ish- komunat Dushk, Kolonjë, Bubullimë, Krujtë, Allkaj dhe Fier-Shegan e marrin shërbimin nga U Lushnje Fshat, ndërsa ish- komunat Golem, Ballagat, Hysgjokaj dhe Karbunarë nuk kanë mbulim me shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm nga UK Lushnje merr ujë nga ujëmbledhësi i Konjatit, ku sasia e ujit që prodhohet është 93 l/sek nga gjashtë puse. Ujëmbledhësi i Çermës ka pesë burime me sasi totale të prodhimit të ujit 35-67 l/sek. Sasia totale e ujit që shfrytëzohet për shërbimin e ujësjellësit në bashkinë Lushnje është 128-160 l/sek.

Për të llogaritur konsumin e ujit të pijshëm në nivel bashkie jemi mbështetur tek të dhënat e UK Lushnje dhe të dhënat e INSTAT-it, Censusi 2011 (Grid), për popullsinë dhe numrin e banorëve për çdo km² në të gjithë territorin e bashkisë Lushnje. Konsumi mesatar ditor i ujit të pijshëm për konsumatorët familjarë (banorë) është 100 litra/banorë/ditë[90].

- **Fluksi i ushqimit**

Fluksi i ushqimit analizon të dhënat për importin, prodhimin, përpunimin, konsumin, humbjen dhe eksportin e ushqimeve. Për sa i përket fluksit të ushqimit në bashkinë Lushnje do të analizojmë të dhënat bujqësore dhe blegtorale që prodhohen në këtë territor, pasi zënë një peshë kryesore në fluksin e ushqimit. Importet realizohen në nivel kombëtar dhe nuk ka shifra të sakta për përthithjen e tyre në nivel vendor. Të dhënat për përthithjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale janë në nivel qarku. Në këtë rast, për të llogaritur fluksin e ushqimit mund të fokusohemi më tepër tek të dhënat mbi produktet bujqësore dhe blegtorale, si dhe infrastrukturat ndihmëse, siç janë pikat e grumbullimit dhe të përpunimit të këtyre produkteve, sasia e produkteve që shkon në treg dhe sasia e produkteve që shkon për eksport. Sipas të dhënave nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), në territorin e Lushnjes prodhohet një sasi e lartë produktesh bujqësore dhe blegtorale, të cilat kanë ndikim në rang kombëtar e jo vetëm në territorin e kësaj bashkie.


Tabela 19. Fluksi i ushqimit, prodhimet bujqësore dhe blegtorale në Lushnje[91]

Përbërës Niveli i		**Përbërës Niveli II**	**Treguesit Prodhim**	**Njësia hapësinore**
Prodhimi bimor	Prodhimet e arave	Drithëra	25,954	Bashkia Lushnje
		Perime	98,139	Bashkia Lushnje
		Patate	7,374	Bashkia Lushnje
		Fasule	1,447	Bashkia Lushnje
		Bimë industriale	887	Bashkia Lushnje
		Foragjere	1,696,362	Bashkia Lushnje
	Prodhime në serra	Perime		Bashkia Lushnje
	Drufrutorë	Pemë frutore	9,132	Bashkia Lushnje
		Ullinj		Bashkia Lushnje
		Agrume		Bashkia Lushnje
		Rrush gjithsej		Bashkia Lushnje
Prodhimi blegtoral	Prodhim blegtoral	Qumësht	62,620	Bashkia Lushnje
		Mish	6,651	Bashkia Lushnje
		Lesh	102	Bashkia Lushnje
		Vezë	34,097	Bashkia Lushnje
		Mjaltë	48	Bashkia Lushnje

Burimi: Qendra e Transferimit Teknologjik Bujqësor; Përpunuar nga Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN, 2015

Sipërfaqja totale e tokave bujqësore në bashkinë Lushnje është 31572 ha, ndër të cilat 16626 ha është tokë arë e kultivuar[92]. Toka shumë e përshtatshme për kultivimin e kulturave bujqësore e ka bërë Lushnjen shumë të rëndësishme në nivel kombëtar për prodhimet bujqësore.

Figura 42. Fluksi i ushqimit, bashkia Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN[93]

Për të llogaritur fluksin e ushqimit janë përdorur të dhënat e QTTB Lushnje (prodhimet) dhe të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit dhe Administrimit të Ujërave (sasia që shkon në treg dhe eksport). Fluksi i ushqimit është realizuar vetëm për disa kultura, pasi të dhënat nuk janë të plota dhe nuk mund të kuptohen hyrjet dhe daljet. Siç mund të kuptojmë nga fluksi, hyrjet (prodhimet) janë më të larta se daljet (treg dhe eksport), sepse një pjesë e këtyre produkteve shkojnë për konsum vetjak, një sasi e caktuar është humbje dhe një pjesë tjetër shkon për shitje në mënyrë informale. Në disa raste vëmë re që sasia e produkteve që shkon në treg dhe eksport është shumë herë më e lartë se sasia që prodhohet, sepse burimi i të dhënave është i ndryshëm. Prodhimet janë përcaktuar nga QTTB-ja, ndërsa të dhënat për tregun dhe eksportin janë marrë nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.


Tabela 20. Prodhimi dhe konsumi në bashkinë Lushnje

			BASHKIA LUSHNJE	POTENCIALET PRODHUESE (Rrethi LUSHNJE)	
Përbërës niveli I		**Përbërës niveli II**	**Prodhim**	**Treg**	**Eksport**
Prodhim bimor	Prodhimet e arave	Drithëra (ton)	25,954		
		Perime (ton)	98,139	64,112	29,540
		Patate (ton)	7,374		
		Fasule (ton)	1,447		
		Bimë industriale (ton)	887		

		Foragjere (ton)	1,696,362		
	Prodhime në serra	Perime (ton)		31,540	7,420
	Drufrutorë	Pemë frutore (ton)	9,132	6,035	540
		Ullinj (ton)		4,830	-
		Agrume (ton)		1,780	130
		Rrush gjithsej (ton)		8,400	-
Prodhim blegtoral	Prodhim blegtoral	Qumësht (lopë, dele, dhie) (ton)	62,620	679,400	-
		Mish (ton)	6,651	28,800	-
		Lesh (ton)	102		
		Vezë (kokrra)	34,097	291,000,000	-
		Mjaltë (ton)	48	320	-


Burimi: MBZHRAU, 2014 (treg dhe eksporti) dhe QTTB (Prodhim), 2014; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN, 2015

Figura 43. Prodhimet bujqësore (në kton) në bashkinë Lushnje, 2014




Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN

Figura 44. Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në kton) në nivel qarku.




Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN

Figura 45. Prodhimet bujqësore në vitin 2014 (në kton) në nivel qarku.



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN

Figura 46. Prodhimet blegtorale në vitin 2014 (në kton).



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN

- **Fluksi i mbetjeve**


Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane ofrohet për territorin e qytetit (bashkia e Lushnjes para ndarjes territoriale). Në territorin e Lushnjes shërbimi ofrohet në nivelin 80-100%. Venddepozitimi i mbetjeve në Lushnje nuk është inxhinierik-sanitar, ndodhet pranë zonave të banuara, në distancë vetëm 130 m, dhe është i vendosur në tokë bujqësore. Diferencimi i mbetjeve në burim nuk kryhet dhe vjen si rezultat i mungesës së riciklimit apo përpunimit të mbetjeve. Tregues i mungesës së diferencimit të mbetjeve është edhe niveli i lartë i mbetjeve që importohen për t'u ricikluar nga kompanitë e riciklimit të vendosura në Shqipëri. Në vitin 2013 në Shqipëri janë importuar 207,690 ton mbetje dhe janë eksportuar vetëm 30,704 ton mbetje nga të cilat 35,055 ton janë mbetje të riciklueshme[94].

Sipas të dhënave të Ministrisë së Mjedisit (për lejet mjedisore), në territorin e bashkisë Lushnje operon vetëm një kompani riciklimi që riciklon vajra dhe nënprodukte të tyre.

Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve bashkiake në territorin e bashkisë Lushnje, jemi mbështetur sërish në metodologjinë e INSTAT-it për të dhënat e popullsisë për çdo km². Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.8 kg[95]. Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara, siç është qyteti i Lushnjes. Sasia e gjeneruar në qytetin e Lushnjes, në zonën urbane, arrin vlerën 1829-3080 ton/banorë për km².[96]

Riciklimi i mbetjeve bashkiake (organike, druri, letre, kartoni, LD plastike, HD plastike, qelqi, produkte kauçuku) në territorin e bashkisë Lushnje është përafërsisht 78.6 %, ndër të cilat peshën më të madhe e zënë mbetjet organike me 47%, mbetjet plastike 15% dhe letre 12%. Procesi i riciklimit është i komplikuar për arsye se mbetjet nuk ndahen që në burim dhe nuk ka stimuj për realizimin[97] e këtij procesi.

Figura 47. Fluksi i mbetjeve në bashkinë Lushnje




Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN[98]

4.3 Burimet ujore dhe basenet

4.3.1 Burimet sipërfaqësore

LushNja ka një rrjet të pasur hidrik me lumenj, rezervuarë të cilëve u shtohet edhe një rrjet i gjerë kanalesh vaditëse-kullimi. Territori i bashkisë së re përshkohet nga Lumi Seman në jug, preket nga pellgu ujëmbledhës i lumit Shkumbin në veri dhe ka një numër të konsiderueshëm rezervuarësh si ai i Kasharit dhe Liqeni i Lushnjes.

Figura 48. Burimet Ujore Lushnje



Burimi: SHGJSH; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Lumi Seman në pjesën jugore të bashkisë i cili shërben edhe si kufi administrativ ndërmjet Lushnjes dhe bashkive të Kuçovës, Urës Vajgurore dhe Roskovecit. Lumi Seman hyn në bashki në afërsi të rezervuarit të Murrizit në lindje dhe përshkon territorin e komunave Fiershegan, Allkaj, Krutje deri në Bubullimë në Jug, ku del nga territori i bashkisë në një gjatësi prej 14.5km. Lumi Seman krijohet nga bashkimi i dy degëzimet të tij kryesore që janë Devolli dhe Osumi. Lumi Devoll ka një pellg ujëmbledhës me sipërfaqe 3130 $km^{2.}$ Nga burimi deri në rrjedhën e tij të mesme, lumi Devoll përshkon shkëmbinj me përbërje të ndryshme gjeomorfologjike me lartësi mesatare 950m mbi nivelin e detit. Në burim të lumit, shkëmbinjtë janë ranorë (shtuf). Pas burimit, lumi vazhdon rrjedhën nëpër shkëmbinj flishorë (sedimentarë) më përshkueshmëri të ulët ujore [99]. Lumi Osum ka një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 2142 km dhe rrjedh gjithashtu nëpër shkëmbinj malorë me përbërje

ranore dhe flishore lartësia mesatare e të cilit arrin 825m mbi nivelin e detit[100]. Të dy lumenjtë, Osum e Devoll, bashkohen në Arrëz të bashkisë së Urës Vajgurore duke formuar lumin Seman. Gjatë rrjedhës së tij, Semanit i bashkohen edhe degë të tjera të rëndësishme si lumi i Gjanicës. Ky i fundit përshkon bashkinë e Fierit në drejtimin veri-jug dhe bashkohet me lumin Seman në Mbrostar të Bashkisë së Fierit. Pothuajse gjatë gjithë gjatësisë së tij në rrjedhën e poshtme në zonat fushore, lumi Seman kufizohet me fusha pjellore të kultivuara me kultura bujqësore.

Lumi Shkumbin: Në pjesën veriore, veçanërisht në fshatin Manasufaj, territori i bashkisë ndodhet pranë basenit të Lumit Shkumbin edhe pse ky i fundit nuk e përshkon territorin e bashkisë.

Rezervuarët: Bashkia e Lushnjes ka një numër të konsiderueshëm rezervuarësh të cilët përqëndrohen kryesisht në pjesën veri-lindore të territorit ndërmjet vendbanimeve Lushnje, Thanasaj, Dushk-Peqin dhe Manasufar në skajet më veriore dhe Hysgjokaj, Biçakaj dhe Kosovë e Vogël në skajin lindor. Ndër rezervuarët më të mëdhenj përmenden:

- *Rezervuari i Murrizit /Thanës*: ky rezervuar ndodhet në pjesën lindore të bashkisë dhe shërben si kufi me Bashkinë e Kuçovës. Rezervuari është i përbashkët me Bashkinë e re të Belshit.
- *Rezervuari i Kasharit* i cili ndodhet në lindje të qytetit të Lshnjës, i shtrirë në pjesën kodrinore të bashkisë.
- *Rezervuari/Liqeni i Lushnjes* i cili shtrihet në pjesën lindore të bashkisë së re dhe shërben si kufi ndarës me bashkinë e Belshit. Më konkretisht, ky rezervuar shtrihet ndërmjet fshatrave Kupaj në veri dhe Murriz-Peqin në jug.
- *Rezervuarë të tjerë:* rezervuarët e tjerë në territorin e bashkisë gjenden në afërsi të fshatit Gjyshaj, Shegas, Dushk-Peqin, Matjan, Manasufaj dhe ndërmjet fshatrave Kurtinë dhe Hysgjokaj.

Rrjeti i kanaleve vaditëse-kullimi: Bashkia bën pjesë në Ultësirën Perëndimore të vendit, e cila dallohet për nivel të barabartë lartësie me nivelin e detit si dhe për një sipërfaqe të konsiderueshme moçalore. Një pjesë e mirë e kësaj sipërfaqeje është tharë për t'u përdorur për bujqësi në vitet përpara '90-ës. Sot, tokat e nxjerra nga tharja e kënetave japin prodhime të larta bujqësore. Për përdorimin e tyre për bujqësi, janë hapur një numër i madh kanalesh për ujitje dhe kullim, të domosdoshëm për përdorimin e këtyre tokave për bujqësi. Me përjashtim të zonës veri-lindore, i gjithë territori i bashkisë së re mbulohet nga rrjeti i vaditës-kullimit. Ndër këto kanale mund të përmendim:

  - Kanali Ujitja (ose i Hoxharës) me grykëderdhje të drejtpërdrejtë në plazhin e Semanit i cili është ndër kanalet më të rëndësishme.
  - Kanali i Myzeqesë me degëzimet e tij në të dyja anët në fushën e Sheqit dhe me dalje të drejtpërdrejtë në detin Adriatik
- <u>Gjendja e burimeve ujore sipërfaqësore (problematikat)</u>

Në dy dhjetëvjeçart e fundit në vendin tonë, burimet ujore dhe kryesisht lumenjtë, janë shfrytëzuar për bujqësi, industri, për materialin e tyre inert dhe për sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe njëkohësisht, janë përdorur si kanale për derdhjen e ujërave të ndotura. Për më tepër, mungesa e planeve për mbrojtjen e lumenjve e shoqëruar me ndërhyrje pa kriter të njeriut në shfrytëzimin e tyre (shfrytëzimi i

inerteve në shtratin e lumenjve, punimi i brezave të gjelbër mbrojtës, etj.) ka përshpejtuar shumë procese natyrore gjeologjike në shtratin e lumenjve, siç janë gërryerja e shtratit, erozioni anësor dhe sipërfaqësor i brigjeve, rrështitjet e tyre etj. të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në përkeqësimin e gjendjes së tyre.[101] Si rrjedhojë, sot lumenjtë vuajnë pasojat e një keqmanaxhimi të gjatë që janë kryesisht *i) ndyshime në hidro-morfologjinë e lumenjve; ii) humbje të florës & faunës ujore, dhe iii) ndotje.*

Hidromorfologjia e lumenjve dhe ndryshimet e saj lidhen me tipare fizike të një lumi të cilat janë kryesisht[102]: *morfologjia e kanalit* dhe *lloji i rrjedhës* (natyrale ose e modifikuar); *përbërja litologjike e shtratit* (lloji, sasia e përbërjes shkëmbore in shtrat); *struktura dhe stabiliteti i brigjeve* – mjaft e rëndësishme sepse tregon ndikimin që do të ketë lumi në gërryerjen e brigjeve dhe, si rrjedhojë, në sasinë e sedimentit që do të përfundojë në lumë; *digat/pengesat* përgjatë rrjedhës, të cilat ndikojnë në ndryshimin e shpejtësisë së rrjedhës së lumit dhe largësinë e rrjedhjes së lirshme të ujit deri në largësinë në të cilën është në gjendje të trasportojë sedimentin; *bimësia në shtratin e lumit* (habitatet, biodiversiteti, bimët,etj); *brezi i bimësisë mbrojtëse përgjatë brigjeve, përdorimi i tokës në afërsi* (rreth 20 metra nga bregu) dhe *gjerësia e zonës me ndikim nga përmbytjet*.

Në vendin tonë, ndërhyrjet në lumenj janë të shumëllojshme, si në shtrat, ashtu edhe në ndryshimin ose zhvendosjen e mbulesës bimore; marrjen e materialeve inerte, rërë, zhavorr, gurë ose plisa; ndërtime afër lumenjve; hedhje apo depozitim i materialeve inerte që dalin nga prishja e objekteve ndërtimore; gërmime të ndryshme, si dhe veprimtari të tjera që prodhojnë mbetje; shkarkime të ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajtuara, veprimtari të cilat ndalohen me ligj.[103] Të gjitha këto kanë shkaktuar dëmtime të hidromorfologjisë së lumenjve që janë vërtetuar nga studime të ndryshme, ndër të cilat, edhe nga studimet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar rreth thellimit të shtratit të lumenjve. Një përshkrim i shkurtër i rezultateve të analizës në lumenjtë e Basenit Seman paraqitet më poshtë.

Me qëllim analizimin e gjendjes së lumenjve në vendin tonë dhe përcaktimin e shkallës së ndikimit të fenomeneve gjeologjike dhe ndërhyrjes së njeriut në shtratin e tyre, SHGJSH-ja ka monitoruar[104] basenet e lumenjve në vend, ndër të cilët edhe Basenin/Pellgun e Lumit Seman.


Pellgu i Lumit Seman është monitoruar në pesë pika/profile monitorimi për periudhën 2008-2016. Këto profile janë shpërndarë në Lumin Osum (dy pika) dhe në Lumin Seman (tre pika). Në lumin Devoll nuk ka profile të monitoruara. Megjithatë, duke qenë se në zonën fushore përpara bashkimit, lumenjtë Osum e Devoll paraqesin ngjashmëri hidromorfologjike, rezultatet e lumit Osum në dy pikat e monitorimit: Urë Vajgurore në Osum dhe Urë e Kuçit në Seman, në një farë mënyre janë tregues edhe të gjendjes së Lumit Devoll.

Tabela 21. Vendndodhja e profileve të monitorimit

Nr.	Lumi	Vendi i Profilit	Periudha e monitorimit
38	Seman	Ura e Re Berat	2008-15
39		Ura Vajgurore	2008-15
40		Ura e Kuçit	2009-15
41		Imësht	2009-16
42		Ura e Mbrostarit	2007-15

Burimi: SHGJSH, 2015; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Figura 49. Profilet e monitorimit të gjendjes së lumenjve në Basenin e L. Seman



Burimi: SHGJSH, 2016


Ndër problematikat kryesore të nxjerra në pah nga ky monitorim është prania e ***erozionit fundor*** në segmente të ndryshme të lumit, në forma dhe intensitete të ndryshme (Tabela 22, më poshtë). Në të gjitha pikat ka patur erozion të theksuar fundor i cili shfaqet me *ulje të shtratit të lumit*. Më i theksuar është vënë re në *Urë Vajgurore* në vitet 2008-2015 (43.2cm ulje), i ndjekur nga segmenti i lumit në Imësht (34.8cm), Ura e Mbrostarit (19.4cm) dhe Ura e Kuçit me 13cm (Figura 51 më poshtë).

Tabela 22. Erozioni fundor ndër vite në lumenjtë Osum dhe Seman

Nr.	Vendi i profilit të monitorimit	Periudha e monitorimit	Ndryshimi Total	Ecuria deri 2015			Trendi 2011-2015		
				Erozion	Neutral		E	N	A
38	Ura e Re Berat	2008-15	-16.8	+			+		
39	Ura Vajgurore	2008-16	-43.2	+			+		
40	Ura e Kuçit	2009-15	-13.0		+		+		
41	Imësht	2009-16	-34.8	+			+		
42	Ura e Mbrostarit	2007-15	-19.4	+				+	

Burimi: SHGJSH, 2016

Figura 50. Thellimi i shtratit të Semanit e Osumit për shkak të erozionit fundor



Burimi: SHGJSH; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Erozioni i brigjeve të lumit është i theksuar, në veçanti në brigjet anësore të Urës Vajgurore, i cili arrin deri në 250 metra në thellësi të terracës.

Ndërkohë, në lumë janë vënë re edhe ***ndërhyrje të gabuara për mbrojtjen e lumit*** nga erozioni në rastin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore Lushnje-Berat. Një shembull është argjinimi i meandrës i cili ka shkaktuar erozion. Shkurtimisht, problematikat kryesore që janë vënë re gjatë monitorimit janë[105]:

- Ulje të shtratit për shkak të erozionit fundor,
- Përmbytje në zonën e poshtme të Lumit Seman dhe në zona të caktuara të rrjedhës së tij,
- Ndotje të ujit (nga inertet, ndotje baktereologjike të ujit etj.),
- Dëmtim të florës dhe faunës së lumit,
- Dëmtim të peizazhit lumor,
- Erozion të tokës bujqësore në segmentet Berat-Urë-Vajgurore, Gostimë, Salcë-Kozarë, Çiflig, Arrëz, Ndërmenas, Marinzë, Jogodin, Mbrostar etj.,
- Rrezikime të objekteve inxhinierike (ura mbrojtëse, argjinatura etj.) në Vetrik, Vlashuk, Çipllak, Segmentet Berat-Urë Vajgurore, Gorican-Mbrostar etj.),
- Ulje e nivelit të ujërave nëntokësore në puset e ujit e stacione pompimi jashtë funksionit.

Dëmtimi i sistemit lumor nga HEC-et: Pellgu i Semanit (përfshirë Devoll e Osum) është shfrytëzuar gjerësisht për prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të HEC-ve. Në fakt, në pellgun e Semanit deri më tani janë ndërtuar 6 HEC-e, ndërkohë që 5 të tjerë janë në ndërtim dhe 66 janë planifikuar për t'u ndërtuar.

Tabela 23. HEC-et në Basenin e Lumit Seman

BASENI I SEMANIT			
Nr	Emërtimi i HEC	KapacitetI	Lumi
Në prodhim			
1	Gjanc	1-10MW	NN
2	Vithkuq	1-10MW	Treska
3	Bogova	1-10MW	NN
4	Ujanik	1-10MW	NN
5	Lenia	1-10MW	NN
6	Holta	1-10MW	NN
Në ndërtim			
7	Nice	1-10MW	Nice
8	Treska 1	1-10MW	Treska
9	Treska 2	1-10MW	Treska
10	Nishovë 1	0-1MW	Nishovë
11	Banjë	>50MW	Devoll
Planifikuar per t'u ndërtuar			
12	Gjerbes	0-1MW	Gjerbes
13	Darsi 1	0-1MW	Darsi
14	Darsi 2	0-1MW	Darsi


15	Darsi 3	0-1MW	Darsi
16	Mollas	0-1MW	Mollas
17	Arrëz	0-1MW	Arrëz
18	Vokopola	0-1MW	Vokopola
19	Bigas Veleshnjë	0-1MW	Begas-Veleshnjë
20	Vlasçuk	1-10MW	Devoll
21	Vertopi	1-10MW	Osum
22	Nishovë 2	0-1MW	Nishovë
23	**Ç**orovodë	0-1MW	**Ç**orovodë
24	Prishtë 1	0-1MW	Prishtë
25	Prishtë 2	0-1MW	Prishtë
26	Staravecka 1	0-1MW	Staravecka
27	Staravecka 2	0-1MW	Staravecka
28	Staravecka 3	0-1MW	Staravecka
29	Helmës 1	1-10MW	Helmës
30	Helmës 2	1-10MW	Helmës
31	Faqekuq 1	1-10MW	Faqekuq
32	Faqekuq 2	1-10MW	Faqekuq
33	Velushe	10-50MW	Osojë
34	Treska 3	1-10MW	Treska
35	Treska 4	1-10MW	Treska
36	Qytezë	0-1MW	Qytezë
37	Kozel 1,2	1-10MW	Osum
38	Belesova 1,2	1-10MW	NN
39	Holtë 2	1-10MW	Holtë
40	Kabash-Pukë	0-1MW	Kabash
41	Sotirë 1	1-10MW	Sotirë
42	Sotirë 2	1-10MW	Sotirë
43	Skënderbegas	>50MW	Toorricë
44	Kërpicë	1-10MW	Kërpicë
45	Dobrenjë-Tomorricë	0-1MW	Dobrenjë-Tomorricë
46	Kukur 1	1-10MW	Kukur
47	Kukur 2	1-10MW	Kukur
48	Kukur 3	1-10MW	Kukur
49	Kukur 4	1-10MW	Kukur
50	Kukur 5	10-50MW	Kukur
51	Bratila 1	>50MW	Devoll
52	Bratila 2	1-10MW	Devoll
53	Zerec 1	0-1MW	Zerec
54	Zerec 2	0-1MW	Zerec
55	Moglicë	>50MW	Devoll
56	Cemerica 1	1-10MW	Cemericë
57	Cemerica 2	1-10MW	Cemericë
58	Cemerica 3	1-10MW	Cemericë

59	Strelcë 1	0-1MW	Strelcë
60	Strelcë 2	0-1MW	Strelcë
61	Lozhan 1	0-1MW	Dolanit
62	Lozhan 2	0-1MW	Dolanit
63	Verba 1	0-1MW	Verba
64	Verba 2	0-1MW	Verba
65	Babjen	0-1MW	Babjen
66	Shpella poshtë 1	0-1MW	Poshtë
67	Shpella poshtë 2	0-1MW	Poshtë
68	Hoçisht	1-10MW	Devoll
69	Grapsht	1-10MW	Devoll
70	Vranisht	1-10MW	Devoll
71	Stropan	1-10MW	Devoll
72	Brecen Mnekula	1-10MW	Devoll
73	Kuk Menkulas	1-10MW	Devoll
74	Dobjan Menkulas	1-10MW	Devoll
75	Miras Menkulas	1-10MW	Devoll
76	Dardhë 1	0-1MW	Devoll
77	Dardhë 2	1-10MW	Devoll

Burimi: AKBN dhe Riverwatch.eu

HEC-et janë ndërtuar në dy furnizuesit kryesorë të lumit Seman (Devoll dhe Osum) si dhe në degë të nivelit të dytë (degë të degëve), të cilat shërbejnë si burim kryesor ushqyes për lumenjtë kryesorë Osum e Devoll, e si rrjedhojë, edhe Seman. Njëkohësisht, ata shërbejnë edhe si burim i materialit zhavorror për lumenjtë në fjalë.

Figura 51. HEC-et në Pellgun e Lumit Seman



Burimi: Riverwatch.eu; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Vetëm në lumin Devoll deri më tani është planifikuar ndërtimi i 15 HEC-eve, ndër të cilët HEC-i i Banjës është në ndërtim ndërsa të tjerët janë planifikuar për t'u ndërtuar. Deri në këtë moment nuk ka të dhëna rreth kohës kur është planifikuar ndërtimi i tyre.

Tabela 24. HEC-et në Lumin Devoll

Nr	Emërtimi i HEC-it	Gjendja	Kapaciteti	Lumi
Në ndërim				
1	Banjë	në ndërtim	>50MW	Devoll
Planifikuar per t'u ndërtuar				
2	Vlasçuk	i planifikuar	1-10MW	
3	Bratila 1	i planifikuar	>50MW	
4	Bratila 2	i planifikuar	1-10MW	
5	Moglicë	i planifikuar	>50MW	
6	Hohist	i planifikuar	1-10MW	
7	Grapsht	i planifikuar	1-10MW	
8	Vranisht	i planifikuar	1-10MW	
9	Stropan	i planifikuar	1-10MW	
10	Brecen Mnekula	i planifikuar	1-10MW	
11	Kuk Menkulas	i planifikuar	1-10MW	
12	Dobjan Menkulas	i planifikuar	1-10MW	
13	Miras Menkulas	i planifikuar	1-10MW	
14	Dardhë 1	i planifikuar	0-1MW	
15	Dardhë 2	i planifikuar	1-10MW	

Burimi: Riverwatch.eu

Lumenjtë janë shfrytëzuar për prodhimin e energjisë hidrike ndër vite. Në fakt, në vendin tonë energjia është pothuajse hidrike falë traditës që ka vazhduar në 50 vitet e fundit. Megjithatë, edhe pse HEC-et sjellin përfitime ekonomike dhe prodhim energjie, ato kanë ndikimet e tyre në mjedis dhe, në qoftë se nuk ndërtohen sipas parimit të përdorimit të integruar të burimeve ujore (që nënkupton përdorim i ujit duke patur parasysh edhe nevojat e sektorëve të tjerë të ekonomisë për ujë), rrezikojnë të shndërrohen në konflikte sociale.

HEC-et ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e një lumi. Ndër pasojat më të njohura renditen ndikimi i drejtpërdrejtë në karakteristikat fiziko-kimike dhe biologjike të tij. Konkretisht, mund të përmendim:

a. *trasformimin e rrjedhës së lumit në* pjesën e sipërme të digës nga një sistem natyror lumor në *sistem të një rezervuari artificial* me ujëra të ndenjura,

b. *bllokimin e qarkullimit të peshqve* ose specieve të tjera ujore,

c. *prishjen e ekuilibrave* e *proceseve fizike* dhe *habitateve* në rrjedhën pas digës. Zakonisht, HEC-et dhe pritat e tilla që nuk lejojnë kalimin e materialit zhavorror shkaktojnë prishjen e ekuilibrit të grykëderdhjeve, duke shkaktuar erosionin detar, ishujve, zonave pjellore të lumenjve dhe zona të tjera kënetore,

d. *ndryshimin e rrjedhës së lumit dhe të prurjeve të sedimentit zhavorror*, të trashë, në rrjedhën e poshtme të lumit me pasoja të rënda për deltat, florën e faunën, për faktin se jeta në lumë dhe përreth sistemit të lumit kushtëzohet dhe zhvillohet në varësi të rrjedhës dhe sedimentit,

e. *grumbullimin e sedimentit pas digës* që normalisht do të furnizonte ekosistemet në rrjedhën e poshtme. Kur një lumë nuk merr sedimente të mjaftueshme, zakonisht tenton ta zëvendësojë atë duke gërryer brigjet e lumit e shaktuar thellim të shtratit,

f. *thellimin e shtratit të lumit*, i cili ul edhe nivelin e ujit në akuifere.

Duke parë numrin e madh të HEC-eve që do të ndërtohen në Lumenjtë e Basenit të Semanit (kryesisht në Osum, Devoll dhe degët e tyre përkatëse), mendohet se ndikimi në mjedis dhe në bujqësi në zonat përreth mund të jetë i theksuar. HEC-et mund të sjellin zvogëlimin e rrjedhës së lumit, mjaft e rëndësishme për bujqësi në stinën e verës, ose pakësimin e sasisë së ujërave të disponueshme për ujë të pijshëm dhe sektorë të tjerë, edhe pse ky mbetet objekt studimi në të ardhmen. Vetëm një njohje e mirë e strukturës së digave dhe sasisë së ujërave të rrjedhës së lumit, që ato lënë me rrjedhje të lirë, mund të japë një pasqyrë të qartë të sasisë së ujit, që banorët do të mund të kenë në përdorim në rrjedhën e poshtme të digës (pas digës) në të ardhmen.

Është shumë e rëndësishme të theksohet se lumi Seman është jetik për zhvillimin e bujqësisë në Bashkinë Lushnje dhe në bashkitë e tjera nëpër të cilat kalon. Për këtë arsye, ndryshimi i rrjedhës së ujit apo pakësimi i sasisë së ujit që mund t'u shkojë fshatarëve për përdorim në periudhat e kultivimit nuk përbën më një problem vetëm mjedisor, por mbi të gjitha, një problem social që do të kërkonte zgjidhje të menjëhershme. Njëkohësisht, për Bashkinë Lushnje, me rëndësi është edhe Lumi Shkumbin duke qenë se shërben si burim ushqyes për Akuiferin e Lushnjes. Si rrjedhojë, pakësimi i rrjedhës së lumit Shkumbin për shkak të HEC-eve mund të çojë edhe në zvogëlimin e sasisë së ujërave të Akuiferit të Lushnjes, i cili ushqehet nga ky lumë. Ky akuifer shërben si burim për furnizimin me ujë të popullsisë së bashkive të ndryshme (shih seksionin e ujësjellësit në Bashkinë Lushnje). Me pak fjalë, digat e HEC-eve, në rast se nuk janë planifikuar dhe nuk menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të integruar që garantojnë mosndryshimin e rrjedhës së lumit dhe sasisë së ujit si dhe përdorimin e ujit edhe për bujqësi për popullsinë e zonave përreth, mund të shkaktojnë probleme të mëdha mjedisore dhe sociale në bashki në të ardhmen e afërt.

Dëmtime të zonës ripariane: Si rrjedhojë e mangësive në manaxhimin e lumit apo keqpërdorimit të brezit të tokave përgjatë tij, zona ripariane e Semanit, Osumit e Devollit ka pësuar dëmtime të theksuara (është ngushtuar, mungojnë brezat e bimësisë së nevojshme - bimët e ulëta deri tek ato të larta - ose nuk ekziston tërësisht). Duke qenë se rrjedha e mesme dhe e poshtme e tyre përshkon toka bujqësore të kultivuara, në të shumtën e rasteve zona ripariane është *kultivuar si tokë bujqësore*. Në rastin e Semanit, duke qenë se ai kalon në formacione tokash të gërryeshme dhe me veshje bimore të pakët, ujërat janë mjaft të turbullta dhe me sasi të larta aluvionesh pezull. Faktorë të tillë kanë ndikuar tek pamundësia për të mbrojtur tokën nga prurjet e lumit (përmbytjet), dhe mosndalimin e shkëmbimit të ndotjes mes tokave bujqësore e zonave të banimit kundrejt lumit nga njëra anë dhe ujërave sipërfaqësore dhe akuiferit nga ana tjetër. Gjithashtu, gjatë brigjeve të lumenjve vihet re shembja/dëmtimi i brigjeve ose gërryerja e tyre, që ka rezultuar në humbje të sipërfaqes së tokës (Figura 52). Dëmtime të zonës ripariane janë vënë re në të gjithë seksionin e lumit, i cili shtrihet përgjatë territorit jugor të Bashkisë Lushnje, ndërkohë pjesa veriore dhe veri-lindore e Lumit Seman ka një mungesë të theksuar të zonave ripariane.

Figura 52. Erozioni në brigjet e Lumit Seman





Burimi: Co-PLAN, 2016

Ndotja: Gjatë 25 viteve të fundit, në vendin tonë dhe në Bashkinë Lushnje, lumenjtë dhe kanalet janë përdorur edhe si burime pritëse të ujërave të ndotura krahas përdorimit të brigjeve të tyre si vend-depozitime të mbetjeve të ngurta. Në fakt, gjatë gjithë këtyre viteve, qytetet që përshkohen nga lumi Seman (dhe degët e tij Osum e Devoll) e kanë shfrytëzuar këtë lumë për derdhjen e drejtpërdrejtë të ujërave të të ndotura urbane dhe rurale të patrajtuara duke e ndotur atë. Përveç ujërave të të ndotura, Lumi Seman ka qenë vazhdimisht nën ndikimin e industrisë së naftës dhe industrive të tjera përgjatë brigjeve të tij përpara hyrjes në territorin e Bashkisë. Si rrjedhojë, cilësia e ujërave të lumit Seman është varfëruar ndër vite. Lumi është ndotur me produkte nafte, ujëra të të ndotura, produkte bujqësore etj.

Ndotja e monitoruar nga Co-PLAN/PLGP USAID-i: Duke patur si qëllim përcaktimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore në disa lumenj të Shqipërisë Qëndrore, dhe lidhjen e kësaj cilësie me përdorimin e tokës në territorin e bashkisë apo jashtë saj, Co-PLAN-i[106] kreu monitorimin e cilësisë së ujërave të basenit të Semanit (Osum, Devoll, Seman e Gjanicë). Pikat e monitorimit dhe disa parametra kimikë[107] janë të përbashkët me monitorimet e ujërave të lumenjve kryesorë të Basenit të Semanit të kryera nga AKM-ja në vitin 2013 [108] me përjashtim të pikës Mujalli [109] . Për interpretimin e rezultateve janë marrë parasysh direktiva të ndryshme të Bashkimit Europian.

Parametrat e monitoruar janë si më poshtë vijon:

- Parametra fiziko-kimikë*:* pH, tejdukshmeria, përçueshmeria elektrike, lënda e ngurtë pezull (TSS), lënda e ngurtë e tretur, oksigjeni i tretur, temperatura dhe nevoja biologjike për oksigjen,
- Ushqyesit: $N\text{-}NH_4$, $N\text{-}NO_3$, $N\text{-}NO_2$, Sulfidet,
- Bakteria: bakteria koliform,
- Metale të rënda: Plumb (Pb), Kadmium (Cd), Mangnez (Mn), Nikel (Ni), Zink (Zn), Bakër (Cu), Co, Krom (Cr), Mërkur (Hg), Arsenik (As), Barium (Ba), Brominë (Br)

Tabela 25. Pikat e monitorimit


Nr.	Lumenjtë	Vendndodhja e pikës së marrjes së mostrave të ujit
1	L. Seman	Lushnje (Para hyrjes në Patos Marinëz)
2		Ura e Mbrostarit në Fier (para bashkimit me L. Gjanica)
1	L. Gjanicë	Ballsh –Panahori (para kalimit në Ballsh)
2		Mbrostar (mbas landfillit Fier, para bashkimit me L. Seman, Ura e Rr. Teodor Muzaka)

1	L. Osum	Kanionet e Osumit: afër burimit, para Çorovodës
2		Uznovë (para bashkimit me L. Zagoria)
3		Ura e Gorices, Berat
4		Urë Vajgurore (në hyrje të Bashkisë Kuçovë tek Ura e rrugës SH-72)
5		Arrëz (para bashkimit me L. Devoll)
1	L. Devoll	Moglicë, Korçë
2		Arrëz (para bashkimit me L. Seman)

Burimi: PLGP dhe Co-PLAN, 2015

Pika e monitorimit ***Seman 1***, para hyrjes në Patos-Marinëz, ndodhet në kufi të territorit të Bashkisë së Lushnjes. Pikat e monitorimit dhe disa parametra kimikë të monitoruar janë të njëjtë me monitorimin e ujërave të lumenjve kryesorë të Basenit të Semanit të kryer nga AKM me përjashtim të pikës Mujalli në Seman. Për interpretimin e rezultateve (standardet) janë marrë parasysh direktiva të ndryshme të Bashkimit Europian.

Figura 53. Harta e marrjes së kampioneve për vlerësim në lumin Seman




Burimi: Burimi: SHGJSH; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Nga monitorimi i kryer në Seman, u vu re se ujërat e lumenjve Gjanicë dhe Seman, nga Ura e Mbrostarit deri në grykëderdhje, janë ***acidike*** (ph<7) ndërsa ujërat e lumenjve Osum e Devoll janë alkalinë (pH>7) në të gjitha pikat e monitorimit (Figura

54). Këto gjetje janë pjesërisht të ngjashme me rezultatet e raportuara nga AKM-ja, me përjashtim të disa pikave (Seman 1 dhe 2 dhe Gjanicë 1 dhe 2).

Figura 54. pH dhe Përçueshmëria elektrike në Basenin e Semanit



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 1	Dev. 2	Os. 1	Os. 2	Os. 3	Os. 4	Os. 5	Os. 6	Standard Rek
pH	6.1	6.2	6.2	6.5	8.65	8.44	8.4	8.2	8.4	8.4	8.07	8.1	7
Përçueshmëria elektrike (µS/cm)	27.3	30	29.9	28.2	19	20.6	16.5	14.8	14.4	14	17.8	17.7	22.7


Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Përçueshmëria elektrike ndryshon ndërmjet lumenjve, me vlera më të larta se standardet mjedisore[110] në lumenjtë me ujëra acidikë, Gjanicë e Seman në segmentin Ura e Mbrostarit-Grykëderdhje. Vlerat luhaten nga 601-661 µS/cm. Në lumenjtë e tjerë të pellgut të Semanit, vlerat janë brenda normës me vlera që ndryshojnë nga 309-454 µS/cm. Vlerat tregojnë qartë një lidhje të drejtpërdrejtë të përçuesmërisë elektrike me pH-in, ku ujërat bazikë kanë vlera brenda normave të lejuara mjedisore.

Në lumin Seman, ***thellësia e dëpërtimit të dritës*** është në nivele të pranueshme në pjesët e sipërme të rrjedhës, por depërtimi i dritës paraqet probleme më të theksuara në zonat me erozion të lartë, në Seman para hyrjes në Patos-Marinëz dhe në Urën e Mbrostarit.

Vlerat e Nevojës Biologjike për Oksigjen (***NBO_5***) janë brenda normave të lejuara[111] në të gjitha pikat e monitorimit, vlera këto të ndryshme nga vlerat e monitoruara nga AKM-ja. Megjithatë, duke patur parasysh ndotjen e vazhdueshme të lumit nga ujërat e të ndotura, këto vlera tregojnë qartë nevojën për të analizuar NBO_5 në lidhje me parametra të tjerë dhe me vendndodhjen e burimeve kryesore të ndotjes në lumë (industrisë, ujërave të të ndotura të zonave të banuara, praninë e metaleve të rënda përkundrejt ushqyesve, etj.). Prania e klorinës dhe metaleve të rënda në ujë zakonisht ngadalëson ose zvogëlon ndjeshëm NBO_5, sepse pengon aktivitetin e mikro-organizmave.

Figura 55. Vlerat e NBO5 dhe Oksigjenit të tretur në Basenin e Semanit




	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 1	Dev. 2	Os. 1	Os. 2	Os. 3	Os. 4	Os. 5	Os. 6	Standard
NBO5 (mg/L)	2.4	0.2	1.6	0.4	1.3	0.28	0.4	1.5	0.4	0.48	0.12	0.19	6
Oksigjeni i tretur (mg/l)	8.2	7.02	8.2	7.1	8.61	8.8	8.4	9.0	8.7	8.9	8.52	8.73	4

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Lënda e ngurtë pezull (TSS) është <2 mg/l në të gjitha pikat e monitorimit të Semanit dhe shumë më e ulët se vlerat mjedisore[112], me përjashtim të Lumit Gjanica, në afërsi

të Urës së Mbrostarit. Në këtë pikë, vlerat e lëndës pezull janë 49.8mg/l dhe shënojnë një rritje të theksuar në krahasim me pikat e tjera.

Figura 56. Lënda e ngurtë e tretur dhe pezull në Basenin e Semanit




	Sem .1	Sem .2	Gja n.1	Gja n.2	Dev .1	Dev .2	Os. 1	Os. 2	Os. 3	Os. 4	Os. 5	Os. 6	Standard
Lënda e ngurtë e tretur (mg/l)	312	343	342	322	216	235	187	167	162	159	202	200	500
Lënda e ngurtë pezull (mg/l)	2	2	2	49.8	2	2	2	2	2	2	2	2	25

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Ndërkohë, ***lënda e ngurtë e tretur*** (TDS) ka vlera më të larta krahasuar me TSS-në. Kjo lidhet me burimet e TDS-së që janë erozioni i tokës, mbetjet, ujërat e bardha, dhe gërryerja e brigjeve të lumit. Vlerat më të larta të TDS-së vihen re në Seman e Gjanicë.

Semani ka përmbajtje të lartë të disa përbërësve të azotit, veçanërisht të ***nitriteve*** ($N\text{-}NO_2$) dhe në disa pika, të ***amoniakut*** ($N\text{-}NH_4$). Përmbajtja e lartë e nitriteve dallohet kryesisht në lumin Osum në të gjitha pikat e monitorimit, si dhe në Seman tek Ura e Mbrostarit, dhe në Devoll përpara bashkimit me Osumin. Vlerat e amoniakut janë kryesisht brenda normave të lejuara me përjashtim të Gjanicës, pika afër Urës së Mbrostarit, ku përmbajtja e amoniakut rezulton të jetë e lartë. Vlerat janë pjesërisht të njëjta me monitorimin e AKM-së**,** ku përmbajtja e $N\text{-}NH_4$ është brenda normave të lejuara.

Figura 57. Nitratet, nitritet dhe amoniaku në Basenin e Semanit



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 1	Dev. 2	Os. 1	Os. 2	Os. 3	Os. 4	Os. 5	Os. 6	Standard
NO3 (mg/l)	0.6	0.42	0.32	0.15	1.2	0.25	0.24	0.337	0.33	0.39	0.37	0.42	6
NO2 (mg/l)	0.02	0.29	0.01	0.02	0.023	0.05	0.022	0.028	0.027	0.051	0.13	0.18	0.03
NH4 (mg/l)	0.09	0.13	0.026	1.645	0.16	0.27	0.08	0.22	0.06	0.17	0.03	0.44	1

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Për sa i përket ***nitratit*** ($N\text{-}NO_3$), përmbajtja e nitrateve është brenda normave të lejuara në të gjitha pikat e monitorimit, në të katër lumenjtë e monitoruar.


Në rast se përcaktimi i gjendjes së ujërave të lumit bëhet në bazë të standardeve të përdorura nga AKM-ja, vlerat e nitrateve, nitriteve dhe amoniakut në Seman janë të ngjashme me vlerat e monitorimit të AKM-së, brenda normave të lejuara në pothuajse të gjitha pikat e monitorimit. Rezultatet ndryshojnë vetëm në Urën Vajgurore (me përmbajtje më të lartë nitritesh) dhe në Urën e Mbrostarit (ku amoniaku i kalon vlerat e lejuara mjedisore të AKM-së).

Përbërësit e azotit janë ndër lëndët kryesore ushqyese për bimët dhe kafshët, por të mbipërdorur në bujqësi dhe për shkak se derdhjet industriale, ujërat e të ndotura e

gropat septike shkaktojnë ndotjen e lumenjve. Ndërkohë sulfatet në Seman janë në nivele të ulëta krahasuar me standardin[113] dhe më të larta hasen në Devoll 2 (para bashkimit me Osumin).

Nivele të larta të ndotjes në Seman hasen sa i përket bakterieve ***koliforme*** dhe metaleve të rënda.

Figura 58. Bakteria Koliform në Basenin e Semanit




	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 1	Dev. 2	Os. 1	Os. 2	Os. 3	Os. 4	Os. 5	Os. 6	Standard
Koliform (Cfu/100ml)	300	180	300	300	300	300	300	300	300	300	300	300	200

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015


Koliformet janë mbi vlerën e lejuar (200 Cfu/100ml) [114] në të gjitha pikat e monitorimit. Rezultatet e monitorimit janë tregues të nevojës së monitorimit të mëtejshëm të ujërave të Semanit për të përcaktuar nëse ujërat e tij janë të përshtatshme për ujitje dhe argëtim.

Metalet e rënda janë matur në dy pika për çdo lumë të basenit të Semanit[115]. Sipas rezultateve të analizave, ujërat janë të ndotura me plumb (Pb), cadmium (Cd), nikel (Ni), hekur (Fe), bakër (Cu) dhe krom (Cr). Kadmiumi është në vlera më të larta se sa plumbi. Ndërkohë, vlerat e manganezit (Mn) dhe zinkut (Zn) janë brenda parametrave mjedisorë.


Figura 59. Metalet e rënda në Basenin e Semanit



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 2	Os. 5	Os. 6	Standard
Pb (µg/l)	930	490	150	260	180	160	290	7.2
Cd (µg/l)	477	175	433	203	1070	1230	1140	0.09
Ni (µg/l)	1640	430	1440	700	310	180	510	20



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 2	Os. 5	Os. 6	Standard
Cu (mg/l)	0.37	0.32	0.08	0.11	0.13	0	0.11	0.04
Cr (mg/l)	0.06	0.11	0.07	0.05	0.06	0.05	0.05	0



	Sem. 1	Sem. 2	Gjan. 1	Gjan. 2	Dev. 2	Os. 5	Os. 6	Standard
Fe (mg/l)	34	16	16	15	9	20	36	0.3

Burimi: Co-PLAN dhe PLGP, 2015

Ndotja e ujërave të lumit me metale të rënda mund të ndikojë negativisht në përdorimin e këtij aseti të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në Lushnje. Një tjetër faktor, që vlen të studiohet për basenin e Semanit nga pikëpamja mjedisore dhe e zhvillimit të turizmit, është mundësia e ndërprerjes së rrjedhës së tyre nga barrierat fizike, kryesisht hidirocentralet (HEC-et). HEC-et që ndërpresin Semanin (në prodhim ose të ato të projektuara) ndodhen jashtë kufijve të bashkisë (p.sh. në Devoll që është në ndërtim). HEC-et mund të ndikojnë në shtimin e sedimentit dhe ushqyesve që stimulojnë rritjen e tepruar të algave, uljen e sedimentit të transportuar përgjatë rrjedhës dhe në grykëderdhje, pengimin e lëvizjes së peshqve dhe të emigrimit të faunës në rrjedhën e lumit mbas barrierës.

Si përfundim, rezultatet e monitorimit të ujit tregojnë se ujërat e lumenjve të Semanit janë të ndotura thellë me metale të rënda. Meqenëse ujërat e lumenjve të basenit të Semanit përdoren edhe në bujqësi, është e nevojshme që ujërat e këtij baseni të monitorohen më tej për të përcaktuar nëse janë të përshtatshëm për ujitje. Në rast të kundërt, përdorimi i ujërave për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujin e lumit gjatë kultivimit. Niveli i ndotjes me metale të rënda duket i lartë në Seman dhe Osum (Urë Vajgurore dhe përpara bashkimit me Devollin). Lumi më i ndotur është Semani, gjë që mund të shpjegohet me faktin se Semani grumbullon ndotjen e të dyja degëve të tij kryesore, Osum dhe Devolli Për më tepër, duke kaluar në një zonë bujqësore, Semani grumbullon plehrat kimike dhe kimikate të tjera të përdorura në bujqësi. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Semanit, nga një burim uji për bujqësinë, Semani mund të kthehet në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut.

Si rrjedhojë, projektet për shmangien e ndotjes nga lumi (p.sh. derdhjen e ujërave të të ndotura dhe mbetjeve ndustriale, si dhe plehrave kimike në tokën bujqësore) dhe për rehabilitimin e tij duhet të kenë përparësi për bashkinë, së bashku me projektet e bashkëpunimit me bashkitë e tjera që preken nga Baseni i Semanit për manaxhimin e integruar të këtij baseni.

- Burimet kryesore të ndotjes së ujërave sipërfaqësore

Urbanizimi i rajoneve të pozicionuara thuajse të gjitha mes brigjeve të lumenjve me ujë të bollshëm e të rrjedhshëm, zgjerimi i metropoleve, zhvillimi i hovshëm i industrisë, sektori i bujqësisë dhe shumë aktivitete të tjera prodhuese industruiale kanë shfrytëzuar ujërat e rrjedhshme sipërfaqësore si pritësin ideal të shkarkimeve.

Ndotja e lumenjve në Republikën e Shqipërisë mund të përkufizohet si ndër më primitivet dhe të pakontrolluarat duke qënë se edhe vetë entitetet shtetërore të cilat parashikojnë me ligj mbrojtjen e lumenjve, shkarkojnë pa kriter në këto sipërfaqe me ujëra të rrjedhshme. Në vendin tonë, mbrojtja e ujërave nëntokësore nga ndotja parashikohet në ligjin 111/2012[116] por zbatimi i tij në terren mbetet jo-efektiv. Si rrjedhojë, në 20 vitet e fundit, ndotja nga lumenjtë ka ardhur nga të gjitha burimet e mundshme duke përfshirë

Kontribuesit kryesore të ndotjes së lumenjve në Lushnje janë:

- Shkarkimi i drejtpërdrejtë i ujërave të ndotura urbane në sipërfaqe ujore *(pa iu nënshtruar proceseve të pastrimit në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura),*
- Ndotja nëpërmjet gropave septike

- Vend-depozitimi i mbetjeve të ngurta në afërsi të Qytetit *(depërtimi i shllameve, shpërndarja e mbetjeve në tokë, derdhje aksidentale të mbetjeve të ngurta në ujërat e rrjedhshme të lumit),*
- Shkarkimet e ujërave industriale
- Shfrytëzimi i shtretërve të lumenjve për materiale inerte
- Shkarkimet dhe infiltrimet e ujërave të përdorur në sektorin e bujqësisë
- Shkarkimet e ujërave të larta *(niveli i aciditetit në ujërat e shiut është gjithnjë e në rritje si edhe mikroorganizmat dhe mbetjet që mbartin si pasojë e shpëlarjes së pellgut ujëmbledhës)*

Secili prej burimeve të ndotjes ka një potencial specifik të ndotjes, i cili përshkon një shteg të caktuar gjatë shpërhapjes së tij në trupin ujor dhe, si përfundim, një mjedis pritës i cili bart këtë ndotje. Këtu vlen të theksohet se pritësit kryesor i ndotjes së lumenjve janë deti Adriatik dhe më pak deti Jon. Veçanërisht në deltat e lumenjve vërehen nivele të larta të ndotjes nga mbetjet e ngruta duke rrezikuar kështu florën dhe faunën e të gjithë bregdetit Adriatik dhe atë të lumit Seman e Vjosë.

Konkretisht, në Bashkinë Lushnje, ujërat sipërfaqësore të Lumit Seman në jug, të lumit Shkumbin në veri të bashkisë, apo edhe Kolektori i Myzeqesë së bashku me emisarët e shumtë të pranishëm në territor, mbartin sasi të mëdha të ujërave të ndotura urbane, të cilat shkarkohen sistematikisht të patrajtuara nga UK-ja Lushnje në kushtet e mungesës së një impianti trajtimi. Më poshtë paraqitet një përmbledhje e shurtër e burimeve kryesore të ndotjes në Bashki.

Ndotja nga shkarkimet e ujërave të ndotura urbane: Shërbimi i grumbullimit dhe kanalizimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet vetëm në qytetin e Lushnjes dhe thuajse aspak në Nja-të e saj. Shërbimi i ofruar është në nivele të pakënaqshme për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar si pasojë e vjetërsisë së tij si dhe ndërtimi i tubave prej betoni me lidhje me llaç ndërmjet seksioneve. Ky sistem është i kombinuar pasi mbledh shkarkimet e ujërave të ndotura së bashku me ujërat e larta. Në asnjë nivel nuk ofrohet trajtimi i këtyre ujërave të cilat shkarkohen drejtpërsëdrejti mbi trupat ujore sipërfaqësore më të afërta.

Shkarkimi dhe trajtimi i këtyre ujërave, si edhe i ujërave industriale është problemi më i madh sanitar që mund të paraqitet sot në Bashkinë Lushnje, për arsye se të gjithë kolektorët i shkarkojnë ujërat e ndotura të patrajtuara në sipërfaqe ujore sipërfaqësore.[117]

Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urban ka si qëllim primar të tij "rehabilitimin" e cilësisë së ujërave të ndotura me qëllim zbutjen e ndikimit të tyre në trupat ujore natyrorë pritës. Në Bashkinë Lushnje nuk ka një impiant të tillë. Aktualisht Bashkia po projekton ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të ndotura urbane në zonën midis fshatrave Plug dhe Savër (Fusha e Lushnjes), rreth 3 km në perëndim të qytetit Lushnje. Momentalisht, të gjithë elementët ndotës, që bartin këto ujëra, shkarkohen në lumenj dhe kanale të cilët më tej përfundojnë në akuifere ndërsa një pjesë lundrojnë me rrjedhën ujore drejt ujërave detare të kripura.

Ndotja nëpërmjet gropave septike: Gropat septike në vendin tonë përdoren gjerësisht nga njësi familjare dhe biznese, të cilat në mungesë të një sistemi të

mirëfilltë kanalizimesh, depozitojnë ujërat e ndotura urbane dhe materialet e përdorura të proceseve prodhuese të industrisë apo biznesit lokal.

Ndotja nga bujqësia: Zona e Lushnjes, edhe pse ka një aktivitet të theksuar të sektorit bujqësor, sipas lejeve të mjedisit të lëshuara nga Ministria e Mjedisit në vitin 2014, nuk specifikon një metodologji e cila të plotësojë kushtet teknike dhe higjieno-sanitare në të cilën të grumbullohen dhe përpunohen ujërat e prodhuara gjatë aktivitetit bujqësor së bashku me mbetjet e ngurta dhe ato organike. Si rrjedhojë, supozohet se një pjesë e nënprodukteve të mbetjeve nga sektori bujqësor kanë përfunduar sistematikisht në ujërat e lumit Seman, Shkumbin, apo edhe në kolektorin e Myzeqesë së bashku me emisarët, duke i ndotur ato me pesticide, kimikate dhe plehra kimike të përdorura në bujqësi.

Shkarkimet nga ndotja industriale: Në Lushnje janë tre pika të nxehta me mbetje industriale të trashëguara që paraqesin rrezik ndotjeje (për më shumë informacion, shih seksionin e vatrave të nxehta mjedisore). Në ish-qendrën sanitare janë trajtuar rreth 40 ton mbetje pesticide të skaduara, ndërsa një sasi tjetër pesticidesh mbetet e magazinuar në magazinat bujqësore. Rreth 1700 ton kimikate toksike gjenden në ish-Fabrikën e Plastikës.[118]

Duke qënë se mbetjet industriale të prodhuara në Shqipëri klasifikohen si mbetje të rrezikshme, trajtimi i tyre duhet realizohet nga vetë prodhuesi siç edhe tregohet në ligjin e manaxhimit të mbetjeve të rrezikshme. Megjithatë, në Lushnje mbetjet depozitohen në pika të paligjshme ose përzihen me mbetjet urbane, kjo pasi pavarësisht ligjit i cili kërkon vetmanaxhim, Bashkia Lushnje vjel Taksë Pastrimi mbi aktivitetet prodhuese e ndërtimore, duke marë kështu përsipër manaxhimin e mbetjeve të prodhuara prej tyre.[119]

Duhet theksuar se një pjesë e këtyre aktiviteteteve prodhojnë mbetje të rrezikshme dhe si të tillë janë subjekt i trajtimit të këtyre mbetjeve nëpërmjet Ligjit 10463 dt.22.09.2011, ku cilësohet se këto mbetje duhet rigorozisht të monitorohen, regjistrohen dhe transportohen, siç përshkruhet në ligj. Më poshtë paraqitet lista ekzistuese e aktiviteteve prodhuese të këtyre mbetjeve në Bashkinë Lushnje, të cilat janë të pajisura me Leje Mjedisore. Janë identifikuar rreth 20 aktivitete prodhuese të mbetjeve industriale të karaktereve si më poshtë (Tabela 26):

- Përpunim, magazinim, tregtim i lëndës djegëse: naftë dhe gaz
- Përpunim dhe riciklim i vajrave të përdorura
- Stalla për mbarështrim kafshësh dhe shpendësh
- Njësi të përpunimit dhe prodhimit të qumështit
- Njësi të përpunimit dhe prodhimit të produkteve bujqësore
- Njësi përpunuese dhe prodhuese plastike, alumini, druri etj.

Në funksion të gjeneruesëve të identifikuar, si edhe atyre potencialë nevojitet që të merren masa për trajtimin e mbetjeve me origjinë industriale, pra mbetjeve me potencial rreziku të lartë. Duke qënë detyrim ligjor i adresuar nga vetë prodhuesit, qoftë nga Ligji Nr. 9537, datë 18.5.2006 por edhe nga leja Mjedisore që ata posedojnë, Bashkia Lushnje dhe Inspektoriati Mjedisor, bashke me ARM-në, mund të asistojë në metodologjinë që do të përdoret për depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve të lëngshme, si edhe shkarkimin e tyre në sipërfaqet ujore.

Tabela 26. Lista e aktiviteteve që prodhojnë mbetje industriale në Bashkinë Lushnje

Aktivitete prodhuese të mbetjeve në Bashkinë Lushnje - sipas lejeve që zotërojnë							
	Aktiviteti	Vendndodh-ja	Subjekti	Kategori Katalogu	Tipi i mbetjeve te gjeneruara	Tipi i lejes	
1	Magazinim karburantesh	Lushnje	TOT - Traiding in Oil & Trasport	5	Mbetje të dala nga rafinimi i naftës, pastrimi i gazit natyror dhe trajtime pirolotike te karbonit.	B	
2	Magazinim & tregtim karburantesh	Lushnje	"Merida" sh.p.k.	5	Mbetje të dala nga rafinimi i naftes, pastrimi i gazit natyror dhe trajtime pirolotike te karbonit.	B	
3	Shpime pusesh / kerkimi nafte	Ardenice / Lushnje	"Bankers Petroleum Albania"	01 05	Mbetje te dala nga kerkimet e shfrytezimi i minierave, si edhe trajtimet fiziko-kimike te mineraleve	A	
4	Karrierë Lumore	Fier - Shegan	Deflor & Construction	1	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytezimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet fiziko-kimike te mineraleve	B	
5	Karrierë argjilore	Karbunarë	Volalba sh.p.k	1	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytezimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet fiziko-kimike te mineraleve.	B	
6	Prodhim asfalti & betoni	Lushnje	BI INVESTMENTS	1 , 16 , 17	Mbetje nga shfrytzimi karrierave, mbetje inerte & mbetje te paspecifikuara	B	
7	Fabrikë tullash	Virovë / Lushnje	Volalba sh.p.k	16 , 17	Mbetje inerte & mbetje te paspecifikuara	B	
8	Prodhim betoni & asfalto betoni	Lushnje	G.P.G Company	1 , 16 , 17	Mbetje nga shfrytëzimi i karrierave, mbetje inerte & mbetje te paspecifikuara	B	
9	Mag.& tregtim karburantesh	Golem / Lushnje	RDA Petrol	5	Mbetje të dala nga rafinimi i naftes, pastrimi i gazit natyror.	B	
10	Riciklim i vajrave te përdorur	Lushnje	AM-OIL	13	Mbetje vajrash dhe mbetje të karburanteve të lëngshme, përveç vajrave ushqimore	B	
11	Riciklim i mbetjeve vajore	Golem / Lushnje	TOT - Traiding in Oil & Trasport	13	Mbetje vajrash dhe mbetje të karburanteve të lëngshme, përveç vajrave ushqimore	A	
12	Grumbullim & përpunim skrapi metali	Dushk / Lushnje	PIU-ECO sh.p.k	11 & 12	Mbetje nga punimi siperfaqesor dhe formues i metaleve	B	
13	Impiant riciklimi i mbetjeve plastike, gome dhe vajrave	Golem / Lushnje	Ylli Petrol	13, 16, 20, 10	Mbetje vajrash dhe mbetje të karburanteve te lëngshme, përveç vajrave ushqimore. Mbetje të tjera te paspecifikuara, Mbetje Urbane, Mbetje nga procese termike.	B	
14	Prodhim profilesh alumini	Lushnje	Lluga	10 , 11	Mbetje nga proceset termike & mbetje nga trajtimi kimik i	B	

					siperfaqeve metalike		
15	Rritje dhe thertore lopësh	Lushnje	Maci 2003	16 03 05 & 18	Mbetje organike që përmbajnë substanca të rrezikshme & mbetje nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkime që lidhen me to	B	
16	Prodhim profilesh plastike	Golem / Lushnje	Telcom Albania	10 , 12	Mbetje nga proceset termike, mbetje që lidhen me trajtimin e materialeve plastike	B	
17	Impiant përpunimi qumështi	Kolonjë	SOAL	2 & 7	Mbetje nga industria agro-ushqimore & mbetjet nga proceset e trajtimit organik-kimik.	B	
18	Impiant përpunimi qumështi	Lushnje	ERMANDI	2 & 7	Mbetje nga industria agro-ushqimore & mbetjet nga proceset e trajtimit organik-kimik.	B	
19	Impiant përpunimi qumështi	Kolonjë	LUFRA	2 & 7	Mbetje nga industria agro-ushqimore & mbetjet nga proceset e trajtimit organik-kimik.	B	
20	Mbarshtrim derri	Lushnje	AB-GERSA	16 03 05 & 18	Mbetje organike që përmbajnë substanca të rrezikshme & mbetje nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkime që lidhen me to	B	
21	Pulari	Karbunarë / Lushnje	AGRI-ZOO	16 03 05 & 18	Mbetje organike që përmbajnë substanca të rrezikshme & Mbetje nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkime që lidhen me to	B	
22	Impiant përpunimi qumështi	Kolonjë	DELTA DON	2 & 7	Mbetje nga industria agro-ushqimore & mbetjet nga proceset e trajtimit organik-kimik.	B	
23	Tabak plastik për sera	Lushnje	AGRO-IMPUT	10, 15, 16	Mbetjet nga proceset termike, mbetje të plastikës dhe mbetje te paspecifikuara në listë	A	

Legjenda:	
	Shfrytëzim resursesh
	Shërbime
	Agro - Ushqime - Blegtori

Burimi:AKM; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Ndotja nga vendepozitimet e mbetjeve urbane:

Fusha e depozitimit të mbetjeve në Lagjen "18 Tetori" ndodhet shumë pranë banesave ekzistuese të kësaj zone dhe nga qendra e qytetit. Autostrada Lushnje-Fier dhe kanali vaditës janë përkatësisht $L_{Q.Q.}$ ~ 2km (vijë ajrore)[120] dhe $L_{Rr.}$ ~ 0,3km (vijë ajrore)[121]. Zgjerimi i sipërfaqes së vend-depozitimit vlerësohet paraprakisht në dyfishin e sipërfaqes që zinte gjatë vitit 2004 (Figura 60).

Figura 60. Ndryshimet të hapësirës së përdorur nga vend-depozitimi gjatë 2005-2010



Burimi: Bashkia Lushnje & Co-PLAN

Ky vend-depozitim shërben edhe si pikë vend grumbullimi për mbetjet inerte, elektronike dhe të tjera. Siç shihet, shfrytëzimi efiçent i hapësirës së caktuar si vend-depozitim nuk është respektuar si pasojë e manaxhimit jo të mirë. Gjithashtu, nuk është respektuar as funksioni i saj si pritës i mbetjeve, kur në bazë të ligjit nr. 10463, Datë 22.9.2011 dhe Ligjit nr. 9537, datë 18.5.2006 (të përditësuar) [122] mbetjet administrohen nga vetë prodhuesi dhe ndalohet rreptësisht përzierja e tyre me mbetjet urbane.

Vend-depozitimi i mbetjeve paraqet probleme të mëdha për sa i përket ndotjes së mjedisit dhe rrezikimit të shëndetit të banorëve për shkak të mungesës së kushteve bazike teknike dhe higjieno-sanitare. Ky vend-depozitim ndodhet buzë dy kanaleve ujore të hapura që përdoren gjërësisht nga aktiviteti bujqësor**,** duke ndotur vazhdimisht sipërfaqet e mbjella e për rrjedhojë, shëndetin e banorëve.

Fatmirësisht, pozicioni në të cilin ndodhet vend-depozitimi i Lushnjes është i përshtatshëm nga ana gjeologjike për shkak se ndodhet jo mbi akuifer. Poroziteti nuk është i theksuar, duke ulur kështu depërtimin e shllameve të vend-depozitimit në ujërat nëntokësore.

Ndotja nga ujërat e larta dhe sektori i bujqësisë:

Nga monitorimet e shumta të ujërave të lumenjve gjendet prania e nitrateve, fosporeve etj., elemente këto që përdoren gjerësisht si plehra kimike në bujqësi, sidomos në vitet e fundit. Për mungesë monitorimi, nuk përcaktohet prania dhe përmbajtja e pesticideve në burimet ujore sipërfaqësore.

Përdorimi i uëjrave të ëmbëla në bujqësi, ku ndodh edhe përzierja e tyre me kimikatet e përdorura në këtë sektor, krijon një nivel të konsiderueshëm ndotjeje, e cila përfundon në lumenj sa herë që manaxhimi dhe përdorimi i tyre nuk është bërë sipas standardeve, duke shkaktuar shqetësime në florë dhe faunë.

- Përfundime dhe rekomandime

LushNja dallohet për terrenin e ulët dhe klimën e butë të cilët kanë favorizuar zhvillimin e sektorit të bujqësisë ndër vite dhe e kanë shndërruar atë në një ndër territoret më të rëndësishme për prodhimin e drithërave në vendin tonë. Bujqësinë e ka favorizuar edhe rrjeti i gjerë i kanaleve vaditëse-kulluese i cili ka bërë të mundur kultivimin e bujqësisë intensive përgjatë gjithë vitit. Këtij rrjeti i shtohet edhe Baseni i Semanit, i cili përshkon territorin e bashkisë në pjesën jugore të saj.

Ndërsa nga njëra anë LushNja ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Semanit të cilat janë të rëndësishme edhe për Lushnjen, nxorri në pah problematikat e këtij lumi të cilat vijnë si pasojë e mungesës së politikave për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe lumenjve nga aktivitetet njerëzore. Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Semanit janë të ndotura thellë me metale të rënda. Meqenëse ujërat e lumenjve të basenit të Semanit përdoren edhe në bujqësi, është e nevojshme që ujërat e këtij baseni të monitorohen më tej për të përcaktuar nëse janë të përshtatshme për ujitje.

Përdorimi i ujërave për bujqësi rrezikon shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujin e lumit gjatë kultivimit. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Semanit, nga një burim uji për bujqësinë, Semani mund të kthehet në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut. Si rrjedhojë, është e nevojshme që Bashkia të ndërmarrë projekte që synojnë uljen e ndotjes në lumë si projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të të ndotura në lumë, të mbetjeve industriale, dhe të të gjitha aktiviteteve që ndikojnë në ndotjen e ujërave të tij, duke përfshirë edhe ndotjen e ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit efiçent të tyre. Përveç ndotjes, është e rëndësishme që Bashkia të planifikojë projekte më përparësi për rehabilitimin e lumit, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera që preken nga Baseni i Semanit për manaxhimin e integruar të këtij baseni.

4.3.2 Burimet ujore nëtokësore[123]


Territori i Bashkisë së re të Lushnjes është i pasur edhe me burime ujore nëntokësore (akuiferë). Akuiferët janë pellgje ujore nëntokësore të krijuara ndërmjet shkëmbinjve me përbërje të ndryshme gjeologjike. Akuiferët shtrihen në zona të ndryshme gjeologjike dhe si rrjedhojë kanë kapacitet të ndryshëm ujëmbajtës.

Akuiferët emërohen sipas mënyrës së qarkullimit të ujit nëpër pore. Sipas SHGJSH-së124 klasifikimi i akuiferëve (në të gjithë Qarkun e Fierit në të cilin bën pjesë edhe LushNja është bërë sipas mënyrës së qarkullimit të ujit nëntokësorë.

Vlerësimi i akuiferëve është bërë duke u mbështetur në hartografimin e akuiferëve dhe në vlerësimin e parametrave hidrodinamikë e hidrokimikë të ujërave nëntokësore. Në Qarkun e Fierit gjenden akuiferët me porozitet ndërkokrrizor, akuiferët me porozitet poro – çarje, akuiferët me porozitet çarje – karst, dhe zonat jo akuifer (pa ujëra nëntokësore). Akuiferët ndërkokrrizor dhe me çarje-karst dallohen për një kapacit të lartë ujëmbajtës dhe përbëjnë burimet kruesore të furnizimit me ujë të shumë qyteteve, të industrisë dhe bujqësisë në Qarkun e Fierit.

Akuiferi më i rëndësishëm për territorin e Lushnjes që shtrihet kryesisht në territorin e saj është Akuiferi me porozitet ndërkokrrizor në të cilin ndodhet Akuiferi i Lushnjes.


Figura 61. Akuiferët në Bashkinë Lushnje



Burimi: SHGJSH; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Akuiferët zënë një sipërfaqe të gjerë në territorin e Qarkut Fier dhe të Bashkisë edhe pse është e vështirë të përcaktohet përqindja e saktë territorit në të cilin shtrihen[125] (ujërat nëntokësore të Lushnjes janë studiuar në rangun e Qarkut Fier)[126].

Figura 62. Qarku Fier - Sipërfaqja e Akuiferëve sipas llojit (në %)



Burimi: SHGJSH, 2014, Grafiku: Co-PLAN

Më poshtë, paraqitet një përshkrim i shkurtër i llojit të akuiferëve dhe shtrirjes së tyre në sipërfaqe, në Qarkun e Fierit, si dhe një përshkrim më i hollësishëm i akuiferit të Lushnjes.

Akuiferi me porozitet ndërkokrrizor: Ky akuifer dallohet për pjesë të tij që janë me ujëpërcjellshmëri të lartë dhe pjesë me ujëpërcjellshmëri të mesme dhe të ulët dhe si rrjedhojë, shtrihet në dy zona:

Akuiferi me porozitet ndërkokrrizor me ujëpërcjellshmëri shumë të lartë - të lartë : Sipas SHGJSH-së, në qarkun e Fierit, ky akuifer shtrihet në dy zona të veçanta që janë: i) Pellgu i Lushnjes dhe ii) Pellgu i Vjosës. Pellgu i Lushnjes i njohur edhe si Akuiferi i Lushnjes është mjaft i rëndësishëm për zonën e Lushnjes sepse shërben si burim furnizimi me ujë të pijshëm për një pjesë të popullsisë së bashkisë (shihni seksionin e Problematikave të Burimeve Ujore Nëntokësore). Ky është akuifer

ndërkokrrizor me ujëpërcjellshmëri të lartë dhe ka një shtrirje të gjerë në territor që përkon me lumin Shkumbin në Veri dhe në afërsi të Semanit në jug, me gjatësi 26 km dhe gjerësi 6,5 km në pjesën veriore dhe 13 km në pjesën jugore të fshatrave Krutje. Akuiferi dallohet për ujëra të freskëta. Si burim kryesor ushqyes i tij shërbejnë ujërat e lumit Shkumbin. Megjithatë, si burim dytësor ushqyes shërben edhe akuiferi me poro-çarje (Suita Rrogozhina), në pjesët periferike dhe në pjesën qëndrore të fushës, në ish-Kënetën e Tërbufit, me mbulesë të hollë suargjilore nëpërmjet filtrimit vertikal, nga poshtë – lart (sektor me kuotë nën nivelin e detit - kriptodepresin). Lëvizja më intensive e ujërave bëhet kryesisht në gjysmën veriore të akuiferit[127]

Akuiferi me porozitet ndërkokrrizor me ujëpërcjellshmëri mesatare - të ulët: Në këtë akuifer përfshihen pjesa fundore e lumit Seman para derdhjes në det, që përfshin zonën në krahun e djathtë të lumit nga Kallmi në Mbrostar, zonën në krahun e majtë të lumit nga Sheqi deri në Grecalli si dhe zonën Ndërnenas – Metaj, zona e lumit Gjanica, zona e fushës së Cakran-Gorishovës, zona e fushës së Kutës dhe përroit të Pavlit në strukturën e Kremenarës.

Akuiferi me porozitet poro-çarje: Është një akuifer që ka shtrirje të madhe në Qarkun e Fierit. Edhe ky akuifer dallohet për dy zona të cilat kanë ujëpërcjellshmëri të ndryshueshme në varësi të zonave në të cilat shtrihet dhe janë:

Akuiferët me porozitet poro - çarje me ujëpërcjellshmëri mesatare: Ky akuifer ka dalje në sipërfaqe në rajonin e Divjakës, Ardenicës, Patosit, Roskovecit, Frakulles, Krapsit e Buzëmadhit.

Akuiferët me porozitet poro - çarje me ujëpërcjellshmëri të ulët: Këto depozitime zënë një sipërfaqe të konsiderueshme në qarkun e Fierit rreth 266.5 km2 (14 % të sipërfaqes së përgjithshme). Ndërtojnë pjesën jugore të monoklinalit të Patosit, nga kodrat e Krapsit, Visokë e deri në Ruzhdie, bërthamën e strukturës Stan Karbunarë, krahn lindor i antiklinalit të Ballagatit, muldën e Galushit, sinklinalin e Vrapit, në Visokë, Ngjeqar, Cukalat, Kutalli. Këto depozitime kanë përhapje të gjerë, si në sipërfaqe, ashtu dhe në thellësi.

Akuiferët me porozitet çarje – karst: Ky lloj akuiferi shtrihet në zona gëlqerore. Zona të tilla janë të kufizuara në qarkun e Fierit dhe shtrihen në një sipërfaqe prej 27.84 km2. Sipas SHGJSH-së, ky akuifer përfaqësohet nga antiklinali i Kremenarës, me shtrirje veriperëndim - juglindje që është vazhdimi i antiklinalit të Gribës. Në pjesën veriore të antiklinalit të Kremenarës nëpërmjet disa gungëzimeve të vogla, vazhdon antiklinali i Shëndëllisë. Trashësia e këtyre depozitimeve varion nga 150 m deri në 310 m. Ujëmbajtja e tyre është e konsiderueshme. Fenomeni i karstit është shumë i zhvilluar.

Jo akuiferë: kanë porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizor, nuk kanë çarje karst të zhvilluar nëpër të cilat uji nëntokësor qarkullon me vështirësi.

Depozitime detare, lagunore, kënetore kryesisht rëra, argjila, alevrite, torfa, mbetje organike në qarkun e Fierit shtrihen në pjesën perëndimore të kodrave të Kryekuqit e Ardenicës nga Shënepremtja, Divjaka në Karavasta, Ndërnenas e deri Topojë e Pojan. Ndërsa në pjesën lindore shtrihen në jugperëndim të qytetit të Lushnjes, si dhe në fushën e Semanit në të dy krahët e lumit nga Toshkëzi në Mbrostar, Arapaj e deri në Sheqisht në jug. Trashësia e këtyre depozitimeve është e madhe. Ajo luhatet nga 120 m në Toshkëz në 109 m në Topojë e deri 41 m në Gradisht. Ujërat e këtyre

depozitimeve nuk kanë rëndësi për pirje. Shpeshherë shfrytëzohen nga popullsia me puse me krahë, kryesisht për vaditje.

Evaporitet (gipse, anhidrite dhe kripëra). Në Qarkun e Fierit ndodhen edhe evaporitet (gipset) edhe pse me sipërfaqe tejet të kufizuar në pjesën perëndimore e depozitimeve evaporitike të Dumresë dhe në zonë përreth rezervuarit të **Thanës**. Këto zona dallohen për procesin e karstit që ndodh në to, duke krijuar gropa, shpella e hinka karstike. Si rrjedhojë e procesit të karstit, këto lloj depozitimesh dallohen për praninë e liqeneve, përrenjve, burimeve apo edhe puseve që shfrytëzohen nga banorët vendas.

- Problematikat e Pellgjeve Ujore Nëntokësore

Në 20 vitet e fundit, vendi ynë ka njohur një rritje të lartë të numrit të popullsisë, shtrirje të urbanizimit në zona dikur të pamundura, zhvillim të sektorit të bujqësisë dhe zhvillim e diversifikim të industrisë pothuajse në të gjithë territorin. Si rrjedhojë, kërkesa për ujë të pijshëm nga popullsia dhe për përdorim nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë (kryesisht bujqësia dhe industria) është shtuar duke ushtruar një presion të jashtëzakonshëm mbi lumenjtë dhe akuiferët[128].

Për më tepër, Ultësira Perëndimore e vendit tonë në të cilën bën pjesë edhe territori i Bashkisë së re të Lushnjes është zonë me industri të theksuar, me zhvillim bujqësor intensiv që dallohet për përdorim të theksuar të plehrave kimike, dhe zona të urbanizuara, që kanë çuar në ndotjen e lumenjve (Semanit, Vjosës e Shkumbinit). Ndotja e lumenjve ka sjellë si pasojë edhe ndotjen e burimeve ujore nëntokësore nëpërmjet dëpërtimit të ujërave të lumenjve në akuiferë. Më poshtë paraqiten një sërë problematikash që lidhen me ujërat nëntokësore të Lushnjes dhe, në të shumtën e rasteve, me Akuiferin Kuaternar të Lushnjes.

Mbishfrytëzimi i ujërave/mungesa e njohjes së kapacitet ujor të shfrytëzuar: Akuiferët ndërkokrrizorë dhe me çarje-karst dallohen për një kapacit të lartë ujëmbajtës. Për këtë arsye, akuiferët shfrytëzohen për furnizim me ujë të pijshëm, industri dhe bujqësi, në mënyrë të ligjshme dhe të paligjshme[129]. Në vitet e fundit, shfrytëzimi i ujit të këtyre akuiferëve është bërë pa u bazuar në një plan menaxhimi, gjë që do mundësonte shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre. Si rrjedhojë, ujërat e akuiferëve janë shfrytëzuar përtej kapacitetit furnizues. SHGJSH-ja[130] raporton se mbishfrytëzimi i akuiferëve në Qarkun e Fierit ka ardhur si rezultat i: i) shtimit të kërkesës për ujë të pijshëm, industri dhe bujqësi sidomos në në periudhën e thatë (qershor-shtator), kur burimet e ujërave nëntokësore janë në nivelet më minimale, ii) rritjes së numrit të shpimeve private ose ilegale për shfrytëzimin e ujit për bujqësi dhe industri, iii) shfrytëzimit pa kriter të shumë shpimeve të vjetra dhe të reja të kryera në akuiferë me presion dhe iv) ritmeve të larta të urbanizimit në zonën fushore, sidomos në dy dekadat e fundit.

Vetëm në Bashkinë e re të Lushnjes, sipas llogaritjeve të bëra kohët e fundit,[131] për plotësimin e nevojave të popullsisë së Bashkisë me ujë nëpërmjet pus-shpimeve, shfrytëzohet një sasi prej 830.4m^3 ujë/orë. Ndërkohë, sipas studimeve të kryera kohët e fundit, kërkesa aktuale për ujë është më e madhe (rreth 879m^3/orë). Sipas këtyre llogaritjeve, në vitet e ardhshme nevojitet rritja e sasisë së shfrytëzuar të ujit të akuiferëve me 57m^3/orë (rreth 7% të sasisë totale).[132]

Ndërkohë, rrjeti i furnizimit me ujë nuk shtrihet në të gjithë zonën rurale të bashkisë. Nga 104,253 banorë që jetojnë në zonën rurale të Lushnjes, *rreth 10,912 prej tyre*

(rreth 11%) nuk furnizohen me uje të pijshëm[133]. Shpërndarja e tyre në territorin e bashkisë sipas komunave përkatëse është[134]:

- Komuna Allkaj (fshatrat Lifaj i Ri dhe Çukas i Ri),
- Komuna Hysgjokaj (fshatrat Hysgjokaj (77%) dhe Kurtin (57%),
- Komuna Dushk (fshatrat Thanasaj, dhe pjeserisht Gramsh, Konjat e Zham Sektor),
- Komuna Karbunarë (fshatrat Kashtëbardhë, Stankarbunarë dhe Mollas),
- Komuna Ballagat (fshatrat Gjuzaj, Jazexhi dhe Manasufaj),
- Komuna Fier Shegan (fshati Jeta e Re),
- Komuna Kolonjë (Ardenicë dhe Bitaj).

Mungesa e shtrirjes së rrjetit të ujit të pijshëm i detyron banorët që të gjejnë zgjidhje vetjake të cilat janë kryesisht hapja e puseve ose përdorimi i burimeve më të afërta të mundshme[135]. Këto burime apo pus-shpime, përveç se hapen pa u bazuar në studime të mirëfillta hidrogjeologjike, e bëjnë të pamundur llogaritjen dhe kontrollin e sasisë së shfrytëzuar të ujit të akuiferëve[136].

Siç u theksua më sipër, përveç furnizimit me ujë të pijshëm, ujërat e akuiferëve ndërkokrrizorë dhe karstikë shfrytëzohen edhe për industri dhe bujqësi. Për fat të keq këto akuiferë shfrytëzohen gjerësisht edhe në mënyrë të paligjshme[137]. Sasia e ujit që shfrytëzohet për çdo akuifer nga industria, bujqësia dhe sektorët të tjerë të ekonomisë nuk njihet. Ndaj mbetet urgjente krijimi i një pasqyre ujore për akuiferet (hyrje dhe dalje të ujit) me qëllim shfrytëzimin e ujit të akuiferit në mënyrë të qëndrueshme.

Ndotja: Ndotja e Akuiferit ujëmbajtës zhavoror Kuaternar të Lushnjes ndodh për arsye të ndryshme duke filluar nga mungesa e zonave higjieno-sanitare përreth pus-shpimeve publike, private e industriale në zona të ndjeshme ndaj ndotjes, deri tek ndotja e ujit të lumit Shkumbin në ato segmente të tij ku ujërat sipërfaqësore komunikojnë drejtpërsëdrejti me ujërat nëntokësore për shkak të mungesës se mbulesës së papërshkueshme argjilore të shtresave ujëmbajtëse. Në Lushnje, Akuiferi i Lushnjes ka pësuar ndotje të ndjeshme në këto vitet e fundit. Nga monitorimet e raportuara nga AKM-ja[138] dhe të kryera nga SHGJSH-ja[139], mund të thuhet se Akuiferi i Lushnjes, përveç problemeve me tipologjinë e ujërave në përgjithësi (vihet re se ujërat janë alkalinë, pra të fortë), si dhe me vlera të ulëta oksigjeni, ka ndotje me përbërës të azotit ***(nitrite, nitrate dhe amoniak) dhe me Mg, Cl, dhe SO_4. Problemet paraqiten në të treja pus-shpimet e monitoruara nga SHGJSH që janë: pus-shpimi nr. 1D Divjakë, Çermë dhe Konjat. Monitorimi ka theksuar problematikat e mëposhtme:***

- ***pH***: ky parametër tregon se ujërat janë alkaline, me ujëra që luhaten nga brenda normës dhe deri mbi normë (luhatjet ndërmjet vlerave 8.2-8.6). Vlera të tilla të ngjashme janë vënë re edhe gjatë monitorimeve të viteve 2010-2014.
- ***Oksigjeni i tretur*** (O_2): përmbajtja luhatet nga nën normë deri në normë në Çermë[140]
- ***Fortësia e Përgjithshme*** **(**Fp): tregon se në stacionin nr. 1D Divjakë, ujërat kanë fortësi mesatare[141]. Në Çermë e Konjat uji është i fortë[142]

- ***Magnezi*** **(**Mg): është mbi normë deri mbi PML (Përmbajtjen Maksimale të Lejuar)[143] duke ndikuar kështu në rritjen e fortësisë së përgjithshme të ujit në shpimin nr. 286, Çermë.
- ***Amoniaku*** ($NH_{4)}$: gjendet i pranishëm në ujë në të gjitha fazat e monitorimit[144] në tre shpimet mbi normat e lejuara në dy faza monitorimi (nga tre në total). Në shpimin nr. 3 Konjat është vënë re një përmbajtje mbi normën e lejuar në fazën e parë e të tretë dhe në shpimin nr. 286 Çermë.
- ***Klori*** (Cl): në Çermë gjendet brenda normave të rekomanduara, ndërsa në shpimet nr. 3 Konjat e nr. 1D Divjakë është mbi normat e lejuara.
- ***Sulfatet*** (SO_4): Në shpimin nr. 286 Cermë e nr. 3 Konjat përmbajtja e sulfateve është mbi normën e rekomanduar (dhe nën PML).
- ***Nitritet*** (NO_2)**:** nitritet gjenden në ujë në të gjitha fazat e monitorimit.


Prania e azotit në akuiferin e Lushnjes tregon qartë edhe ndotje të ujërave nëntokësore nga bujqësia. Fatkeqësisht në Bashkinë e Lushnjes, të dy stacionet e pompimit të furnizimit me ujë të pijshëm (stacioni Konjat dhe stacioni Çermë[145] që furnizohen nga akuiferi ndërkokrrizor i Lushnjes)[146] ndodhen në zonë bujqësore të ulët të ndjeshme ndaj ndotjes sipërfaqësore. Bujqësia intensive e kultivuar në zonën e Lushnjes ka çuar edhe në rritjen e përdorimit të plehrave kimike të pasura me azot, fosfor, sulfate, etj. të cilat shpesh ndikojnë në ndotjen e drejtpërdrejtë të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore. Përbërësit e azotit dhe sidomos nitratet janë plehra kimikë që përfundojnë nëpër burime ujore si rrjedhojë e vetive të tyre lëvizëse të larta. Kështu, përdorimi i tyre në mënyrë të papërshtatshme (në kohë me shi apo në sasi më të mëdha se nevojat e bimëve) çon në rrëshqitjen e tyre nga toka në ujë duke shkaktuar ndotjen e burimeve sipërfaqësore dhe nëpërmjet tyre, edhe burimet nëntokësore. Të dy stacionet e pompimit raportohen të mos kenë zona higjieno-sanitare të aktivizuara.

Për më tepër, në zonën Konjat, raportohet se ka rrezik të lartë ndotjeje për shkak se kanali i shkarkimit të ujërave të përziera kalon pranë stacioneve të Konjatit. Uji i këtij kanali rezulton i ndotur me amoniak (NH_4) mbi parametrat maksimal te lejuar (PML) të ujit të pijshëm[147].

Sipas SHGJSH-së, ndotja lidhet drejtpërsëdrejti me moszbatimin e zonave të mbrojtjes sanitare dhe nga shfrytëzimi pa kriter i akuiferëve. Edhe pse nevojiten studime të tjera më të thella për të përcaktuar rrezikshmërinë që ky akuifer përbën për shëndetin e njeriut, është e rëndësishme të theksohet se prania e ndotjes është shqetësuese për popullsinë që furnizohet me ujë të pijshëm nga shpimet publike dhe private të kryera në këtë akuifer.

Njëkohësisht, ky akuifer ushqehet nga Lumi Shkumbin ujërat e të cilit janë ndikuar ndjeshëm (ndotur) nga aktivitetet e zonës industriale në Qytetin e Elbasanit. Duke parë se burimet e Akuiferit të Lushnjes përdoren për furnizim me ujë të pijshëm (Figura 63) dhe ujitje nga banorët vendas, është i domosdoshëm monitorimi i akuiferit për ndotje nga Zona Industriale e Elbasanit të trashëguar ndër vite, ujërat e ndotura dhe bujqësia.

Figura 63. Puset e ujësjellësit të Bashkisë Lushnje



Burimi: SHGJSH; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

- Burimet e ndotjes së Akuiferit të Lushnjes në zonën e Bashkisë Lushnje

Burimet e ndotjes së Akuiferit të Lushnjes janë të shumta. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes.

Mungesa e zonave higjieno-sanitare: SHGJSH-ja përcakton mungesën e zonave higjieno-sanitare përreth pus-shpimeve si një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së akuiferëve. Këto zona mungojnë, si përreth pus-shpimeve të ligjshme, ashtu edhe përreth pus-shpimeve të paligjshme. Pus-shpimet e ligjshme janë të shumta dhe përdoren nga ujësjellësit e Bashkisë për furnizim me ujë të popullsisë dhe nga industria. Pus-shpimet e paligjshme gjenden gjatë gjithë territorit, sidomos në zonat rurale që nuk janë të lidhura me rrjetin e furnizimit të ujë (rreth 11% e popullsisë së Lushnjes nuk furnizohet me ujë të pijshëm)[148]. Uji sigurohet kryesisht nga vetë banorët duke përdorur burimin më të afërt të mundshëm[149] ose nëpërmjet pus-shpimeve. Në Bashki ka edhe një numër pus-shpimesh industriale, për të cilat nuk ka të dhëna rreth zonave të tyre industriale.

Lidhur me ndikimin e industrisë në cilësinë e ujërave të Akuiferit, duhet theksuar se mungojnë të dhënat, në veçanti numri i pus-shpimeve, sasia e ujit që pompohet dhe gjendja e zonave higjieno-sanitare përreth pusshpimeve industriale, etj.

Shfrytëzim i ujërave nëntokësore në mënyrë jo profesionale, si dhe të pakontrolluar, si nga popullsia, ashtu edhe nga industria rrezikon: i) uljen e prurjeve në stacionet e

pompimit, si dhe ii) prishjen e cilësisë së ujërave të akuiferëve të Qarkut Fier duke rrezikuar seriozisht furnizimin me ujë të rrethit në tërësi.[150] Mbetet fakt se për asnjërin nga këto pusshpime (individuale, të ujësjellësve apo industrial) pavarësisht nëse janë të ligjshme apo jo, nuk dihet nëse është zbatuar zona e mbrojtjes higjieno-sanitare. Mungesa e zonave higjieno-sanitare krijon mundësinë e ndotjes së akuiferit në një kohë shumë të shkurtër duke qenë se puset janë të lidhura drejtpërsëdrejti me akuiferin.


Ndotja e akuiferit nëpërmjet Lumit Shkumbin: Siç është theksuar më sipër, lumi Shkumbin shërben si burim ushqyes për akuiferët e shtrirë përgjatë rrjedhës së tyre. Kjo ndodh në segmente të caktuara të lumenjve, kryesisht në zonat ku zhavorroret e akuiferëve dalin në sipërfaqe. Në zallishtoren e lumit Shkumbin *kjo ndodh nga Krasta në Vishas ose Bujqës, pranë zonës industriale*[151]. Për këtë arsye, ndotja e Shkumbinit mund të ketë pasoja të rënda për prishjen e cilësisë së ujërave të akuiferit. Mosmarrja e masave për mbrojtjen e lumit Shkumbin e Devoll nga ndotja në njëzet vitet e fundit (na bën të mendojmë se) mund të ketë shkaktuar ndotjen e këtij akuiferi.

Ndotja e shkaktuar nga mbishfrytëzimi i ujërave të akuiferit: Përveç mungesës së zonave higjieno-sanitare dhe ndotjes së lumit Shkumbin, SHGJSH-ja thekson se ndotja e ujërave të akuiferëve ndodh edhe për shkak të mbishfrytëzimit të ujërave të tyre. Ky mbishfrytëzim rrezikon të përkeqësojë cilësinë e këtij akuiferi për shkak se një veprim i tillë shton kripëzimin e ujit mbi normat e lejuara për pirje.

Ndotje nga industria e naftës: Zakonisht, një ndër rreziqet më të mëdha që i kanoset mjedisit nga industria e naftës është rreziku i ndotjes së akuiferëve. Fatkeqësisht, pastrimi i ujërave të akuiferëve është proces tejet i kushtueshëm, ose edhe i pamundur. Duke qenë se ujërat e akuiferëve lëvizin shumë ngadalë, atëherë duhen dhjetëvjeçarë përpara se një ndotës të pastrohet ose të migrojë në zona të tjera. Ky është rasti i nitrateve ose pesticideve e 1-2-3-Trichloropropane, të cilat edhe pse përdorimi i tyre është ndaluar që në vitin 1970, vazhdojnë të gjenden nëpër akuiferë[152].

Në Bashkinë e Lushnjes, industria e naftës është mjaft aktive dhe shtrihet në dy zona që janë Neogjeni Kolonjë dhe Murrizi. Neogjeni Kolonjë shfrytëzohet nga Kompania Bankers Petroleum Ltd. dhe është zonë shfrytëzimi që përfshin edhe Bashkinë e Fierit. Në Bashkinë e Lushnjes, kjo zonë shfrytëzimi përfshin Nja-në Bubullimë me fshatrat Eskaj, Gjonaj, Halilaj, Pirrë dhe Kamçisht dhe Nja-në Kolonjë me fshatrat Ardenicë, Rrapëz, etj. (Figura 64).

Figura 64. Vendburimi Patos-Marinëz (kufinjtë sipas zonës së kontratës)



Burimi: Albpetrol, 2016 (Kufinjtë sipas zonës së kontratës)

Ndërsa ndotja e ujërave sipërfaqësore nga nafta është e dukshme, ndotja e ujërave nëntokësore është vështirë që të përcaktohet, për shkak të mungesës së të dhënave ose të dhënave të pakta e jo të plota. Teorikisht, industria e naftës, për vetë natyrën e aktivitetit të saj, gjatë zhvillimit të aktiviteteteve të industrisë mund të ndotë akuiferët

në disa mënyra, në rast se nuk merren masat e duhura teknike për mbrojtjen e tyre. Më konkretisht, industria e naftës mund të ndotë nëpërmjet: i) pusshpimeve, ii) teknologjisë së përdorur, iii) puseve të ri-injektimit të ujërave shtresorë dhe iv) gropave ekologjike. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i mënyrave kryesore të ndotjes së ujërave nga industria e naftës.

a) Ndotja nëpërmjet pus-shpimeve

Me qëllim shmangien e ndotjes së tokës dhe ujërave, puset e naftës vishen me shtresa të ndryshme (cases), ndër të cilat edhe një shtresë që shërben për parandalimin e rrjedhjeve të pusit dhe depërtimin e tyre në rrethinat e tij (në tokë ose ujë) gjatë aktivitetit naftënxjerrës. Për të njëjtin qëllim, kur puset dalin jashtë funksionit, si në rastet kur kompania vendos se nuk janë me leverdi ekonomike, puset mbyllen dhe izolohen.

Në rastet *kur puset shpohen në thellësi në prani të një akuiferi, puset e naftës kalojnë nëpër akuifer duke e ndotur atë me ujë të kripëzuar (me kripëra /substance kimike të ndryshme), hidrokarbure dhe materiale të tjera toksike*. Deri më sot nuk ka të dhëna rreth ndikimit të puseve të industrisë së naftës në Akuiferin e Lushnjes ose në ujëra të tjera nëntokësore në vendin tonë. Megjithatë, ekziston mundësia që Akuiferi i Lushnjes me shtrirje në Konjat e Çermë, të ndotet nga industria e naftës nëpërmjet puseve në rast se nuk merren masa për mbrojtjen e tij.

Për më tepër, ***në vendin tonë mungon edhe legjislacioni i posaçëm që rregullon hapjen e puseve pranë ose në akuifer,*** gjë që mund t'i ketë stimuluar kompanitë të anashkalojnë rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore. Në vendin tonë, mbrojtja e ujërave nëntokësore nga ndotja parashikohet në ligjin nr. 111/2012[153] që përcakton Shërbimin Gjeologjik Shqiptar si autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e burimeve ujore deri në një nivel të caktuar. SHGJSH-ja përcakton masat për ruajtjen e rezervave ujore nëntokësore si dhe miraton dhënien e lejeve për pus-shpime në ujërat nëntokësore, me thellësi mbi 15 m nga sipërfaqja e tokës. Megjithatë, asnjë ligj nuk shprehet në lidhje me mbrojtjen e akuiferëve nga pus-shpime e tipit industrial (instalime të përhershme, siç janë puset e naftës), duke lënë kështu hapësirë për abuzime. E gjithë kjo ndodh në kundërshtim me ligjet dhe praktikat e vendeve më të zhvilluara. Në SHBA, për shembull, zakonisht përpara se një kompani të fillojë aktivitetin e saj për nxjerrjen e prodhimin e naftës, prodhimin e energjisë gjeotermale dhe nxjerrjen e mineraleve, kërkon leje për përjashtimin e akuiferit më të afërt nga lista e trupave ujorë të përdorur për furnizimin e popullsisë për ujë të pijshëm[154]. Në këtë mënyrë, industria, e ndërgjegjshme se veprimtaria e saj mund të shkaktojë ndotje të akuiferit dhe si rrjedhojë rrezik për shëndetin e banorëve që furnizohen me ujë nga ky akuifer, nuk ndiqet penalisht për dëmtimin e akuiferëve, dhe sigurisht nuk vepron në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Burimeve Ujore të Përdorura për Furnizim të Popullsisë me Ujë.[155] Mbetet fakti se akuiferi i përjashtuar nuk shërben më si burim ujor për pije.

b) Ndotja e akuiferit nëpërmjet *teknologjisë* së përdorur (shpimi *horizontal / puse me trungje horizontale, ose puse me drejtim të caktuar)*

Në Bashkinë e re të Lushnjes, akuiferët gjenden mbi zonën naftënxjerrëse (në zonën Gradishtë, Spolatë, Gradian, Shënkollë, Gërmenj i Madh, Çermë, Plug, deri në Lushnje) m shtrirje në toka bujqësore. Largësia nga zona e shpimit e bën këtë akuifer më pak të ndjeshëm ndaj ndotjes që rrjedh nga industria e naftës. Megjithatë, me

futjen e teknologjisë së re të shpimeve, lind nevoja të përcaktohet dhe të vlerësohet ndikimi i industrisë së naftës në akuifer

Industria e naftës shpesh është akuzuar për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore sidomos gjatë përdorimi të teknologjisë së quajtur *plasje e shkëmbinjve me* ujë,[156] e shoqëruar me teknika të reja të kohëve të fundit që janë kryesisht shpimi horizontal / puse me trungje horizontale, ose puse me drejtim të caktuar[157]. Sipas EPA në SHBA:


Procesi i plasjes me ujë krijon çarje në shtresën shkëmbore të cilat bëjnë të mundur daljen e naftës dhe gazit, duke rritur kështu volumin e naftës që mund të nxirret. Puset shpohen me trung vertikal nga 100 deri në mijëra metra nëntokë dhe mund të përfshijnë puse me trungje horizontale ose me drejtim të caktuar që shtrihen me mijëra metra. Çarjet krijohen duke hedhur sasi shumë të mëdha lënde të lëngshme me presion të lartë në vrimën e një pusi të shpuar enkas dhe në shkëmbinjtë ku ndodhet nafta. Lënda e lëngshme (ose uji siç quhet shpesh) përbëhet kryesisht nga ujë, propant dhe kimikate që përdoren për të hapur dhe zgjeruar plasjet e krijuara në shkëmb. Këto plasje mund të jenë me qindra metra të gjata. Propantët përfshijnë rërë, peletë qeramike, ose pjesëza të tjera të pashtypshme. Propantët shërbejnë për të mbajtur hapur (për të mos lejuar mbylljen)çarjet e krijuara. Pasi mbaron procesi i hedhjes së lëndës së lëngshme (ujit me kimikatet në pus), trysnia e brendshme e shtresës shkëmbore shtyn lëndën e lëngshme që të dalë në sipërfaqe nëpërmjet pusit të shpuar. Ky ujë që del njihet si ujë shtresor ose ujë i kthyer dhe në përbërjen e tij mund të gjenden edhe i) kimikatet e shtuara përpara injektimit, dhe ii) materialet që ndodhen natyrshëm në shtresën shkëmbore si kripëra të ndryshme, metale, hidrokarbone, rodionuklide, etj.

Uji shtresor ose uji i kthyer magazinohet në vend në kontenierë të mëdhenj ose në gropa ekologjike në pritje për tu trajtuar ose ricikluar. Në shumë raste, ky ujë shpesh ri-injektohet[158]. Në zonat ku ri-injektimi nuk është i mundur, uji i kthyer mund të trajtohet nga një impiant i trajtimit të ujërave dhe më tej të shkarkohet në ujëra sipërfaqësore.

Kjo teknikë është përdorur që në vitet 1940, dhe për më se 50 vjet është përdorur në puse me trungje vertikale në shtresa shkëmbore konvencionale. Sot, kjo teknikë përdoret përsëri në të njëjtat shtresa shkëmbore. Megjithatë, kohët e fundit teknika ka avancuar. Zhvillime të teknikave, si shpimi horizontal ose shpimi me drejtim të caktuar, kanë çuar në shpimin e shtresave shkëmbore të pazakonta për nxjerrjen e naftës të cilat nuk janë shfrytëzuara deri më sot. Pa këto teknika, kërkimi dhe shpimi për naftë në këto zona nuk do të ishte me fitim.

Kjo teknikë është futur në Bashkinë Lushnje nga Kompania Bankers Petroleum Ltd. në zonën e saj të shfrytëzimit (Figura 64)[159]. Bankers ka deklaruar se deri në vitin 2014 ka arritur të shpojë 536 puse.[160] Duke patur si qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarisë operacionale të shpimit, uljen e shpenzimeve dhe rritjen e kompanisë në të ardhmen, kompania ka futur edhe teknologji të reja të patestuara më parë në vendin tonë siç është teknologjia e shpimit horizontal për nxjerrjen e naftës (*primary horizontal drilling*) dhe ajo e plasjes me ujë dhe polimer (*water and polymer flooding)*. Në vitin 2015, Bankers planifikonte edhe hapjen e rreth 60 puseve horizontale të reja (*horizontal wells with a two-rig program*) si vazhdim i shfrytëzimit të fushës Patos-Marinëz (Figura 64)[161].

Figura 65. Zonat me shpim horizontal (majtas) dhe teknologjia e përmbytjes me polimer dhe ujë djathtas (Water and Polymer Flooding)



Burimi: Bankers Petroleum Ltd., (Printscreen 30 Mars 2016)[162]

Sipas kompanisë, *Shpimi me plasje me ujë dhe polimer* konsiston në hedhjen e ujit ose të një kimikati në rezervuarin e naftës i cili ka si qëllim ta shtyjë naftën drejt pusit. Kjo teknologji njihet si teknologji që bën të mundur rekuperimin efiçent të naftës në rezervuarët nëntokësorë. Zakonisht, kjo është një teknologji që përdoret pasi pjesa më e madhe e naftës është nxjerrë nga rezervuari.

Ndërsa teknika e plasjes së shtresës shkëmbore me ujë është vërtetuar të jetë tejet efikase për nxjerrjen e naftës dhe gazit edhe në zona dikur të pamundura[163]. Kjo teknologji është akuzuar edhe për *ndotjen e ujërave nëntokësore.* Në fakt, pas kërkimesh shumëvjeçare, Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit (EPA) në SHBA ka arritur në përfundimin se një teknikë e tillë përdor disa mekanizma "mbi tokë dhe nëntokë, nëpërmjet të cilëve nxjerrja e naftës me plasje me ujë mund të ndikojë në ndotjen e burimeve ujore të pirjes". Këto mekaniza përfshijnë:

- Rrjedhjen e lëndës së lëngshme dhe të *ujit shtresor* gjatë aktivitetit
- Plasjen e drejtpërdrejtë në burime ujore nëntokësore
- Migrimin nëntokësor të ujit shtresor dhe gazrave
- Përdorimin e ujit në kohëra (ose në zona) kur uji nuk është i bollshëm
- Trajtimin e papërshtatshëm të ujërave industriale dhe shkarkimeve të tyre në burime ujore.

Ndërkohë që EPA dhe agjenci të tjera nëpër botë vazhdojnë ta studiojnë këtë teknikë me qëllim shmangien e ndotjes së ujërave nëntokësore, në vendin tonë, një shqetësim i tillë ende nuk është ngritur. Si rrjedhojë, ende nuk ekzistojnë të dhëna rreth aktivitetit të naftës lidhur me këtë teknologji dhe ndikimit e saj në Bashkinë Lushnje dhe bashkitë e tjera ku vepron. Pra, deri më tani mungon: *një inventar i kompanive të naftës që përdorin një teknikë të tillë; një inventar i puseve që përdorin një teknikë të tillë, një regjistër i sasisë së ujërave të përdorura gjatë shpimit (ujit shtresor); një regjistër i puseve ku ri-injektohet uji shtresor dhe një studim nëse ri-injektimi është i mundshëm, në përputhje me ligjet për mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore, regjistrim i incidenteve që kanë bërë të mundur rrjedhjen e ujit shtresor në mjedis gjatë aktivitetit, regjistrim i puseve ku është plasur drejtpërdrejt në akuifer, evidentim i rasteve të migrimit të ujit shtresor dhe gazrave në mjedis, etj.*

Në të njëjtën kohë, problemit të ndotjes së ujërave nga industria e naftës nuk i kushtohet vëmendja e duhur. Kjo vërtetohet edhe nga mungesa e një legjislacioni dhe një institucioni specifik që ka si objektiv kryesor mbrojtjen e nëntokës, ose të ujërave nëntokësore nga industria e naftës[164]. Për këtë arsye, në mungesë të të dhënave të mësipërme, është e pamundur të përcaktohet qartë dhe në mënyrë sasiore rreziku që mund t'u kanoset banorëve që furnizohen me ujë nga ky akuifer.

c) Ndotja e ujërave nëntokësore nëpërmjet puseve të ri-injektimit të ujërave shtresorë.

Gjatë prodhimit të naftës dhe gazit, prodhohet një sasi e konsiderueshme ujërash të ndotura të cilat mund të përmbajnë edhe metale helmuese dhe lëndë radioaktive[165]. Shpesh, këto ujëra janë edhe më të kripura se ujërat e detit. Për këtë arsye, në qoftë se nuk manaxhohen siç duhet, përbëjnë rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut[166].

Duke filluar që në vitet 1930,[167] këto ujëra të ndotura zakonisht janë ri-injektuar në puse me qëllim shmangien e ndotjes së ujërave sipërfaqësorë. Ri-injektimi i tyre nënkupton rikthimin ose hedhjen e ujit të dalë nga puset e naftës (ujit shtresor) mbas shpimit ose gjatë prodhimit të naftës, përsëri në nëntokë. Ri-injektimi i ujërave të prodhuar nga industria e naftës është praktikë e ndjekur edhe sot.[168] Në Bashkinë Fier e Lushnje, ri-injektimi është konfirmuar të ndodhë si praktikë nga Kompania Bankers. Krahas shpimeve, në vitin 2015, Bankers kishte planifikuar edhe kalimin e 20% të puseve në puse për ri-injektim.

Për shkak të rrezikut që paraqet për ndotjen e ujërave nëntokësore, [169] ri-injektimi rregullohet me ligj.[170] Fatkeqësisht, në vendin tonë ri-injektimi nuk rregullohet me ligj. Për rrjedhojë, kompanitë nuk janë të detyruara të ndjekin rregulla specifike gjatë ri-injektimit përveç praktikave të mira të punës së kompanisë. Për këtë arsye, mund të thuhet se në Bashkinë e Lushnjes mbetet i panjohur, së paku për publikun dhe bashkinë: i) *lloji i teknologjisë që kompanitë e naftës përdorin për shpime dhe për nxjerrjen e naftës, ii) sasia e ujit që këto kompani shfrytëzojnë nga burimet ujore sipërfaqësore e nëntokësore, iii) sasia e ujit që prodhojnë gjatë aktivitetit, iii) fati/vendi i depozitimit të këtij uji të përdorur, iv) puset e ri-injektimit të ujërave të përdorura, numri dhe vendndodhja e tyre, nëse ka të tillë, v) gjendja dhe kushtet e puseve të ri-injektimit, vi) ndikimi i tyre në ujërat nëntokësore Lushnje/Fier, etj*

d) Ndotja nëpërmjet gropave ekologjike.

Gropat ekologjike/vaskat e naftës në vendin tonë janë *landfill*e specifike ku depozitohen materialet e përdorura gjatë aktivitetit të nxjerrjes së naftës. Zona e Lushnjes, sipas lejeve të mjedisit të lëshuara nga Ministria e Mjedisit në vitin 2014, nuk ka një gropë ekologjike në të cilën të grumbullohen ujërat e prodhuara gjatë aktivitetit të naftës së bashku me mbetjet e ngurta. Si rrjedhojë, supozohet se produktet e naftës janë hedhur së bashku me mbetjet urbane duke ndotur tokën dhe ujërat sipërfaqësore e nëntokësore.

- Përfundime dhe rekomandime

Akuiferi i Lushnjes është burimi kryesor nëntokësor në Bashkinë Lushnje i cili shërben për furnizimin me ujë të popullsisë së bashkisë dhe fshatrave të ndryshme. Megjithatë, ky akuifer rrezikon ndotjen nga bujqësia, industria e naftës, vend-depozitimi i mbetjeve dhe aktivite të tjera në Bashki.

Një faktor mjaft i rëndësishëm që duhet theksuar në lidhje me Akuiferin është *mungesa e monitorimit të ujërave të këtij akuiferi për ndotje nga industria e naftës ndër vite*. Industria e naftës ka vepruar në Lushnje për shumë vite. Duke parë se burimet e këtij akuiferi përdoren për furnizim me ujë të pijshëm dhe ujitje nga banorët vendas, është i domosdoshëm monitorimi i akuiferit për ndotje nga industria e naftës së trashëguar ndër vite. Ndotja e Akuiferit të Lushnjes nëpërmjet pus-shpimeve në vendburimin e naftës në Fier/Lushnje mund të përbëjë problem të jashtëzakonshëm për furnizimin me ujë të popullsisë në Bashkinë Lushnje me ujë nga ky akuifer. Me pak fjalë, në rast ndotjeje të Akuiferit të Lushnjes, Bashkia rrezikon të humbë burimin e saj më të rëndësishëm ujor që shërben për furnizimin me ujë të popullsisë.

Si përfundim, duke parë ndotjen e shkaktuar në Akuiferin e Lushnjes nga bujqësia, teknologjinë e vjetër dhe të papërshtatshme për mbrojtjen e burimeve ujore që industria e naftës ka përdorur në të shkuarën dhe teknologjinë e re që është futur për shpimin e puseve në vendin tonë këto vite, rekomandohet që Bashkia të marrë masa të menjëhershme për mbrojtjen e Akuiferit të Lushnjes nga një ndotje e mundshme, dhe për monitorimin e vazhdueshëm të ujërave të akuiferit.

4.4 Ajri

Ndotja e ajrit mbetet problem serioz në Shqipëri për shkak të rritjes së theksuar të numrit të makinave, numrit të mjeteve të vjetra të transportit, rritjes së trafikut në zonat urbane dhe ritmeve të shpejta të urbanizimit[171]. Ky i fundit ka çuar në një zhvillim me ritme tejet të shpejta edhe të sektorit të ndërtimeve dhe përkeqësimit të kushteve të rrugëve brenda zonave urbane.

Të dhënat rreth cilësisë së ajrit në Qytetin e Lushnjes mungojnë. Megjithatë, për arsyet e mësipërme, mendohet se të paktën në qytet, në afërsi të zonave me fluks trafiku të lartë, cilësia e ajrit ndryshon (përkeqësohet) nga ajo e zonave rurale, ku cilësia e ajrit është e mirë. Edhe pse nuk njihet përmbajtja e gazrave ndotës në ajër, është e mundur të arrihet një vlerësim i përafërt i rreziqeve që i shkaktohen shëndetit të njeriut nëpërmjet ndotjes së ajrit nga disa sektorë, veçanërisht ai i transportit.

Marrë si reference të dhënat nga Raporti i Gjendjes në Mjedis për Shqipërinë dhe veçanërisht RGJM-Fier 2015 të cilat tregojnë se ka tejkalim të normave të elementëve ndotës në ajër, mund të themi se faktor në këtë situatë, krahas shkarkimeve në atmosferë nga industritë, mjetet e transportit publik dhe privat si dhe nga ndërhyrjet infrastrukturore, është edhe mungesa e gjelbërimit dhe hapsirave për rekreacion të cilat kryejnë, ndër të tjera, edhe funksionin e filtrimit të ajrit të ndotur dhe prodhimin e sasive të vogla të O_2 me rëndësi në cilësinë e ajrit në qëndrat urbane.

Tabela 27. Bilanci i gjelbërimit publik në Bashkinë Lushnje

Zona e gjelbër	**Standardi**	**Vlera ekzistuese**		**Vlera e propozuar**	
	m^2/ban.	**m^2**	**m^2/banor**	**m^2**	**m^2/banor**
a) Gjelbërim në nivel njësie strukturore	**2.5**	214,334	2.5	241,980	3.37
b) Gjelbërim masiv, parqe e lulishte	**4**	14,843	0.17	532,018	7.42
c) Gjelbërim rrugor, sheshe, brigje ujore në zonë urbane	**2.5**	245,481	2.8	147,975	2
ç) a&b&c	**9**	474,658	5.58	921,973	12.8
d) Park periferik	**17**	0	0	328,618	12.35
dh) ç&d: Gjelbërim i përgjithshëm publik	**26**	474,658	5.58	1,250,591	17.4
e) Fidanishte	PA	0	0	0	0

ë) Zonë ripariane	PA	2,241,680	26.3	2,607,787	36.4
f) Kopsht zoologjik	PA	0	0	0	0
g) Kopsht botanik	PA	0	0	0	0
gj) Breza sanitarë, zona buferike, breza mbrojtës	PA	6,115,581	72	7,544,932	105.3
h) Pyje (pyllëzim)	PA	9,120,500	84	9,120,500	127.3
i) Zona të mbrojtura natyrore	PA	0	0	0	0
e-i) Gjelbërim i veçantë	PA	17,477,761	205	19,273,219	269

Burimi: Bashkia Lushnje, 2016

Hapësirat e gjelbra ose bimësia urbane, siç quhet shpesh në literaturë[172], ndikojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Konkretisht, bimësia urbane ndikon në uljen e ndotjes nëpërmjet thithjes së ndotësve në gjendje të gaztë nga gjethet e tyre. Krahas filtrimit të ajrit të ndotur, hapsirat e gjelbra shërbejnë dhe janë faktor në mbrojtejen e tokës dhe shëndetit publik.

Në tabelën e mësipërme (Tabela 27), sipërfaqa e gjelbër për banor në zonat urbane është brënda standardit por theksojmës se Bashkia ka hapsira të mjaftueshme për të arritur nivele mbi standardet e nevojshme të gjelbërimit të përgjithshëm publik dhe gjelbërimit të veçantë duke kontribuar direkt në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe cilësisë së jetësës për banorët e saj. Gjelbërimi në nivel njësie strukturore është 2.5 m^2/banorë kundrejt 2-2.5m^2 që është standardi.

- Burimet e ndotjes së ajrit


Siç u theksua më sipër, burimet e ndotjes së ajrit janë të ndryshme (urbanizimi, mjetet e transportit, industria, etj.). Megjithatë, në Bashkinë Lushnje, ndotja nga makinat mbetet burimi kryesor. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes së ajrit në Lushnje.

Ndotja nga mjetet e trasportit: Sipas RGJM-së[173] në Bashkinë Lushnje, ndikim të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në mjedis në territorin e Bashkisë kanë mjetet e trasportit të cilat shkarkojnë në ajër një numër të konsiderueshëm gazrash të dëmshme. Ndër gazrat kryesore renditen:

- monoksidi dhe dioksidi i karbonit (CO dhe CO_2 përkatësisht)
- substancat sulfurike (SOx),
- lënda e ngurtë pezull e përmasave të ndryshme (PM_{10} dhe $PM_{2.5,}$ kryesisht),
- THC (sasia totale e shkarkimeve në ajër të hidrokarbureve)
- përbërësit organikë të avullueshëm (VOC),

Sasia e ndotësve që makinat shkarkojnë në ajër është e konsiderueshme. Nga llogaritjet e Agjencisë Amerikane të Mjedisit, një makinë e tonazhit të vogël (makinat për transport njerëzish deri në 12-vendëshe) shkarkon rreth ***5 ton CO_2 në vit*** (4.7 metric tons)[174]. Kjo shifër vlen për makinat e prodhuara mbas vitit 2008 dhe me teknologji të përparuar. Nisur nga këto shifra, llogaritja e sasisë së ndotjes për 1 litër lëndë djegëse paraqitet si më poshtë (Figura 66. benzinë dhe naftë).

Figura 66. Sasia e CO2 që shkarkohet në ajër për çdo litër benzinë e naftë




Lënda djegëse	Gallon	g/Gallon	g/Liter
Benzinë	1	8,887	2,347.70
Naftë	1	10,180	2,689.27

Burimi: US EPA, 2016; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Sasia e ndotësve që shkarkohet në ajër nga një makinë e vogël individuale/pasagjerësh varet nga një sërë faktorësh që janë lloji dhe përmasat e makinës (makinë e vogël, autobuz urban, kamion etj.), mosha dhe kilometrazhi, lloji i lëndës djegëse që përdor, kushtet atmosferike (shi apo diell etj.), gjendja e makinës, mënyra e drejtimit të makinës, etj.[175] Në rast ndryshimesh të këtyre kushteve, shkarkimet në ajër shtohen. Por, duhet patur parasysh se llogaritjet e mësipërme janë bërë për makina me teknologji më të zhvilluar se një pjesë e mirë e automjeteve që përdoren në Shqipëri, dhe për cilësi më të mirë të lëndës djegëse (shih seksionin e mëposhtëm). Për rrjedhojë, sasia e gazrave të shkarkuara nga një makinë në Shqipëri mund të jetë më e lartë se shifrat e sjella më sipër.

Rritja e numrit të makinave: Numri i makinave ka ardhur duke u shtuar nga viti në vit në mënyrë të theksuar në rang vendi. Nëse në vitin 2000 numëroheshin rreth 55 makina /1,000 banorë, në vitin 2010 numri i makinave në Shqipëri arriti 120.8 makina për 1,000 banorë.[176] Ndërkohë, në Bashkinë Lushnje, numri i makinave i regjistruar është më i vogël se mesatarja kombëtare, 63 makina/1000 banorë (INSTAT 2011) ose një total prej 5,350 makina në nivel Bashkie dhe 1,989 makina në Qytetin e Lushnjes. Për vitet 2015-2016 mungojnë të dhënat për numri e makinave në Bashkinë e Lushnjes .


Figura 67. Numri i makinave në Shqipëri për 1,000 banorë ndër vite[177]



Burimi: Ministria e Mjedisit dhe UNDP, 2016[178]

Ndërsa numri i makinave për banorë ka ardhur duke u rritur në mënyrë të theksuar në vend, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me tren është ulur në mënyrë drastike. Nga statistikat e viteve 2005-2013,[179] ky numër ka pësuar rënie të ndjeshme.

Figura 68. Nr i pasagjerëve dhe tonazhi i mallrave të transportuara me tren në vënd




Burimi: Ministria e Mjedisit dhe UNDP, 2016[180]

Me rritjen e makinave, rritet edhe sasia e shkarkimeve në ajër të ndotësve. Në rastin e CO_2, në qoftë se do të marrim për bazë shifrën 5 ton CO_2 në vit/makinë, sasia e CO_2 e shkarkuar në ajër vetëm nga mjetet individuale të transportit (makinat familjare) ***në nivel bashkie është rreth 26,710 ton CO_2 /vit*** (5350 automjete x 5 ton CO_2/automjet ne vit = 26,750 ton/CO_2/vit) ndërsa në nivel ***qyteti 9,945 ton CO_2/vit***. Pra, 37% e sasisë së gazrave të dioksidit të karbonit shkarkohet vetëm në Qytetin e Lushnjes.

Në vitet në vijim, ekziston mundësia që ndotja nga mjetet e transportit të shtohet për arsye se numri i makinave dhe investimet e Qeverisë Shqiptare në ndërtimin e infrastrukturës rrugore (dhe jo në investime në zhvillimin e llojeve alternative si treni etj.) po shtohen. Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, rreth 55% e investimeve publike të Shtetit Shqiptar kanë shkuar në infrastrukturë rrugore[181]. Ndërkohë, trasporti hekurudhor është lënë pas dore edhe pse Shqipëria është angazhuar për përmirësimin e tij në vitet në vijim. Në vitin 2006, Shqipëria nënshkroi Aktin e Stabilizim-Asociimit, i cili nënkupton rindërtimin e hekurudhës sipas kodeve dhe standardeve të BE-së[182]. Megjithatë, fondet për zhvillimin e trasportit hekurudhor mendohet të përftohen nga donatorët.

Ndotja nga cilësia jo e mirë e lëndës djegëse: Në vendin tonë, lënda djegëse për mjetet e transportit nuk është e mirë dhe kjo është e dukshme edhe vizualisht. Për më tepër, është vërtetuar edhe nga Inspektorati Qëndror Teknik. Në periudhën janar-shtator 2014, Inspektorati Qendror Teknik (sipas të dhënave të publikuar nga AKM-ja) ka monitoruar cilësinë e lëndës djegëse në vend, konkretisht të *naftës*[183], *benzinës dhe solar-mazutit*. Mostrat e analizuara për vlerësimin e cilësisë së ajrit janë marrë para zhdoganimit të lëndës djegëse dhe pas hyrjes në tregun e brendshëm shqiptar. Në total, janë analizuar 164 mostra, të ndara në tre grupe, 122 për naftën, 31 mostra për benzinën dhe 11 për solar-mazutin (Figura 69).

Figura 69. Numri i mostrave të lëndës djegëse të analizuara



Burimi: AKM (Inspektorati Qëndror Teknik); Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016 [184]

Rezultatet e monitorimit të lëndës djegëse për naftën dhe benzinën janë paraqitur më poshtë:[185]

Tabela 28. Rezultatet e monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse në Shqipëri

Vlerat e Sulfurit	Lënda djegëse			
	Gazoil		Benzinë	
	Mostrat (numër)	Mostrat (%)	Mostrat (%)	Mostrat (numer)
11-15ppm	6	4.9	16.1	5
16-20ppm	2	1.6	19.4	6
20-50ppm	14	11.5	29.0	9
>50ppm	100	82.0	35.5	11
Totali	**122**			**31**


Burimi: AKM (Inspektorati Qëndror Teknik)[186]

Për naftën, nga 122 mostrat e analizuara, 82% e mostrave (100 mostra) përmbajnë mbi 50ppm sulfur, 11.5% e tyre (ose 14 mostra) përmbajnë nga 20-50ppm, ndërsa 6.5% e mostrave (8 mostra) përmbajnë nga 11-20ppm. Në rastin e benzinës, nga 31 mostrat e analizuara, 35.5% e mostrave (11 mostra) përmbajnë mbi 50ppm sulfur, 129% e tyre (ose 9 mostra) përmbajnë nga 20-50ppm, ndërsa 3.5% e mostrave (11 mostra) përmbajnë nga 11-20ppm.

Në bazë të standardit EN 590 për naftën dhe EN 228 për benzinën, vlera kufi e lejuar e përmbajtjes së squfurit në naftë është *10 ppm*. Nga analiza e mostrave të benzinës dhe naftës rezulton se përmbajtja e sulfurit është mbi vlerën e lejuar në të gjitha mostrat. Ndryshimi ndërmjet naftës dhe benzinës qëndron vetëm në vlerat më të larta të shkaktuara në ajër. Nafta ka numrin e mostrave me përmbajtje më të lartë të sulfurit (82% kundrejt 35.5%). Përmbajtja e sulfurit ndryshon tendencë në rastin e grupimit 20-50ppm. Në këtë rast është benzina që ka numrin e mostrave me përmbajtje më të lartë squfuri (29% të mostrave të benzinës kundrejt 11.5 të gazoilit).

Si përfundim, në bazë të rezultateve të mësipërme rrjedh se të dyja llojet e lëndës djegëse që përdoren në vendin tonë (nafta dhe benzina) kanë përmbajtje të lartë të squfurit. Ndryshimi i vetëm qëndron në faktin se përmbajtja e squfurit, në rastin e naftës, arrin kufinj më të lartë se sa në rastin e benzinës.

Figura 70. Përmbajtja e squfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %)



Burimi: AKM (IQT[187]), ; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016[188]


Testime janë bërë edhe për Solar-Mazutin[189]. Të 11 mostrat e monitoruara rezultojnë me përmbajtje më të lartë squfuri (mbi 3%). Në bazë të standardit S SH UNI 6579, për analizimin e lëndës diegëse (gazoil), vlera kufi e lejuar e përmbajtjes së squfurit në gazoil është < 3%. Mostrat e analizuara rezultojnë se përmbajtja e squfurit është mbi 3%. Si përfundim, mund të thuhet se lënda djegëse (nënproduktet e naftës) që shitet në tregun shqiptar është e një cilësie jo të mirë.[190]

Veç kësaj, në përgjithësi, në Shqipëri preferohet përdorimi i naftës përkundrejt benzinës, për shkak të kostove relativisht më të ulëta. Sipas të dhënave të publikuara në Manualin e Kontrollit, Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Së Automjeteve, pergatitur nga ECAT[191], në seksionin e shkarkimeve në ajër nga automjetet raportohet se *87% e automjeteve në vend përdorin si lëndë djegëse naftën* dhe *13% benzinën.*

Ndotja nga vjetërsia e mjeteve të transportit: Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, Shqipëria ka rreth 350,000 makina pjesa më e madhe e të cilave janë makina të përdorura[192]. Me rritjen dramatike të numrit të makinave dhe mbi të gjitha të numrit të makinave të vjetra, trafiku në zonat urbane është tashmë një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit.[193] Siç e theksuam edhe më parë, shkarkimet në ajër nga makinat shtohen edhe me rritjen e vjetërsisë së automjeteve për shkak se këto të fundit nuk arrijnë të bëjnë djegien e plotë të lëndës diegëse.

Sipas një studimi të kryer për automjetet në Tiranë, del se 36% e automjeteve me benzinë të prodhuara ***para*** vitit 1986 dhe 27% e atyre ***pas*** vitit 1986 shkarkojnë CO mbi normat e lejuara. Në rastin e automjeteve me naftë, pavarësisht nga viti i prodhimit, 39.7% e tyre i tejkalojnë normat e lejuara për koefiçentin K të tejdukshmërisë së lejuar, i cili është K 2.5[194].

Figura 71. Numri i makinave (në %) që shkarkojnë CO e HC mbi vlerat e lejuara në ajër, sipas vitit të prodhimit.



Burimi: ECAT 2008[195]; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, mjetet me benzinë çlirojnë sasi më të mëdha CO dhe HC në ajër në krahasim me mjetet me naftë. Nga ana tjetër, mjetet me naftë çlirojnë më shumë grimca prej karboni elementar, përbërës organikë të karburantit dhe vajra lubrifikante të motorit, sulfate të formuara nga squfuri i karbonit dhe gjurmë përbërjesh metalike. Përbërësit organikë, zakonisht përbëjnë 10-30% të grimcave totale. Por, në motorat e vjetër, përbëjnë deri në 90%. Ky është rasti tipik i Shqipërisë ku shumica e motorrave diezel janë prodhime të vjetra dhe pa pajisje të sistemeve mbrojtëse.[196]

Sektori industrial: Burim ndotës i ajrit në territorin e Bashkisë është edhe industria. Në Bashki ka aktivitete industriale të llojeve të ndryshme (Figura 29). Aktivitetet përfshijnë rafineri të përpunimit të naftës, prodhimin e asfalto-betonit, industri agro-përpunuese dhe fabrikat e riciklimit e të prodhimit të plastikës.

Tabela 29. Aktivitetet që shkarkojnë ndotje në ajër në territorin e Bashkisë Lushnje sipas lejeve që disponojnë

Aktiviteti	**Vendndodhja**	**Subjekti**	**Tipi i Lejes**
Magazinim karburantesh	Lushnje	TOT - Traiding in Oil & Trasport	B
Magazinim & tregtim karburantesh	Lushnje	"Merida" sh.p.k.	B
Shpime puse kërkimi nafte	Ardenicë / Lushnje	"Bankers Petroleum Albania"	A
Prodhim asfalti & betoni	Lushnje	BI INVESTMENTS	B
Fabrikë tullash	Virovë / Lushnje	Volalba sh.p.k	B
Prodhim betoni & asfalto-betoni	Lushnje	G.P.G Company	B
Magazinim & tregtim karburantesh	Golem / Lushnje	RDA Petrol	B
Riciklim i vajrave të përdorura / rafineri përpunimi për nënproduktet e naftës	Lushnjee	AM-OIL	B
Riciklim i mbetjeve vajore	Golem / Lushnje	TOT - Traiding in Oil & Trasport	A
Impiant riciklimi të mbetjeve plastike, gome dhe vajrave	Lushnje	Ylli Petrol	B
Impiant riciklimi të mbetjeve plastike, gome dhe vajrave	Golem / Lushnje	Ylli Petrol	B
Prodhim profilesh alumini	Lushnje	Lluga	B
Rritje dhe thertore lopesh	Lushnje	Maci 2003	B
Prodhim profilesh plastike	Golem / Lushnje	Telcom Albania	B
Impjant përpunimi qumështi	Kolonjë	SOAL	B
Impjant përpunimi qumështi	Lushnje	ERMANDI	B
Impjant përpunimi qumështi	Kolonjë	LUFRA	B
Mbarshtrim derri	Lushnje	AB-GERSA	B
Pulari	Karbunarë / Lushnje	AGRI-ZOO	B
Impiant përpunimi qumështi	Kolonjë	DELTA DON	B
Tabak plastik për sera	Lushnje	AGRO-IMPUT	A

Burimi: AKM 2015

Ndër industritë më ndikim më të madh në mjedis, sidomos në përkeqësimin e cilësisë së ajrit, janë zakonisht aktivitetet industriale që veprojnë me leje mjedisore A dhe B, në rast se nuk respektojnë rregullat për mbrojtjen e mjedisit (për shkarkimet e gazrave në ajër, aroma të pakëndëshme, ujërave industrialë në ujërat sipërfaqësorë etj.)

Aktivitet i këtij lloji në Lushnje është nxjerrja dhe përpunimi i naftës (rafineria ***e përpunimit të naftës bruto "AM-OIL"***, e pajisur me Miratim Paraprak nr. 2034/3, datë 8.10.2015, nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë). Rafineria e përpunimit të naftës është instaluar në ambientet e ish-Uzinës së Plastmasës. Kësaj shoqërie aksionere i është dhënë leje për 30 vjet, me të drejtë përsëritjeje. Rafineria ka kapacitet të përpunimit të naftës deri në 500 ton/24h, i cili konsiderohet relativisht i lartë. Kjo shoqëri është pajisur me leje mjedisore të tipit B, e cila shoqërohet me një sërë kërkesash për mbrojtjen e mjedisit (tokë, ajër, ujë), të cilat duhet të zbatohen nga shoqëria e përpunimit të naftës "AM OIL".

Gjatë nxjerrjes dhe përpunimit të naftës shkarkohen në ajër një shumëllojshmëri përbërësish organikë si metani (CH_4, një gaz i efektit serë i cili është 20 herë më i fuqishëm se dioksidi i karbonit CO_2), etani (C_2H_6), përbërësit organikë të avullueshëm (VOCs), një grup kimikatesh që kontribuojnë në formimin e ozonit të nivelit të tokës, smogut dhe ndotës organikë të rrezikshëm të ajrit (HAP)[197]. HAP-at më të zakonshme organike janë n-hekzan dhe përbërësit BTEË (benzene, toluene, etil-benzeni dhe ksileni). Sulfuri i hidrogjenit dhe SO_2 shkarkohet nga proceset e prodhimit dhe përpunimit, që merren dhe trajtojnë gazin e lëngshëm.

Siç u theksua më sipër, në Bashkinë e Lushnjes, duke qenë se aktiviteti i industrisë së naftës përqëndrohet në nxjerrjen dhe rafinimin e saj, shkarkohen në ajër një numër i konsiderueshëm gazrash të rrezikshme të përmendura më sipër. Ekspozimi ndaj këtyre shkarkimeve lidhet me një numër të lartë sëmundjesh përfshirë azmën në gjendje të rënduar dhe vdekje të parakohshme.

Të tjerë ndotës të ajrit relativisht të lartë janë ***2 impiantet e prodhimit të asfalto-betonit***[198] afër/në qytetin e Lushnjes dhe fabrika e përpunimit të mermerit në fshatin Katallar, të cilat shkarkojnë një gamë të gjerë grimcash dhe gazesh në atmosferë si CO, SO, PM_{10} dhe $PM_{2.5}$. Këto grimca kanë ndikim negativ në shëndetin e njeriut, kryesisht në aparatin e frymëmarrjes, sistemin nervor dhe atë kardiovaskular.

Ndotja nga sektori i ndërtimit: Sipas RGJM-së Lushnje[199], burim tjetër për ndotjen e ajrit janë edhe ndërtimet e reja në zona të ndryshme të qytetit, të cilat ndonëse janë të pajisura me VNM[200], ku përcaktohen qartë rregullat që duhet të ndjekin kantierët e ndërtimit, ndodh shpesh që punimet të kryhen pa marrë masat e nevojshme dhe koha e ndërtimit është më e gjatë se sa është planifikuar. Në shumë raste, zonat e banuara janë pre e pluhurit (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$) në ajër të shkaktuar nga kantieret e ndërtimit të ndërtesave dhe të ndërhyrjeve në infrastrukturë, si rehabilitimi i rruges Dushk – Sektor, rehabilitimi i rruges Dushk – Sektor, rehabilitimi i rrugës Kadiaj, (Nja Krutje) dhe rehabilitimi i rrugës së Imshtës dhe rikonstruksioni i ndërtesave dhe ndërtimet e reja (25 leje ndërtimi të aprovuara në Qarkun Fier për 2015[201]).

Ndotje nga burime të tjera: vend-depozitimet e mbetjeve, industria etj.: Vendepozitimi i mbetjeve është një burim i konsiderueshëm ndotës i ajrit, pasi nuk është në standardet e kërkuara teknike dhe higjieno-sanitare për depozitimin e mbetjeve. Depozitimi i mbetjeve kryesisht shkarkon në ajër gazin metan, i cili ka ka aromë të keqe dhe, në përqëndrim të lartë, është irritues dhe shkakton probleme në sistemin e frymëmarrjes dhe në sistemin nervor.

Sektori i bujqësisë: gjithashtu ka një kontribut të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në territorin e bashkisë, kryesisht në çlirimin e gazrave gjatë shpërbërjes së mbetjeve organike dhe plehut organik.

- Ndikimi i ndotjes në shëndetin e njeriut

Siç e pamë më sipër, makinat, industria etj. shkarkojnë në ajër një numër jo të vogël ndotësish me ndikim në shëndetin e njeriut. Ndër më kryesorët janë O_3, CO, CO_2, SO_x (SO_2), PM (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$), Pb, VOC dhe O_3. Më poshtë sillet një përmbledhje e rreziqeve që i kanosen shëndetit të njeriut nga çdo ndotës në veçanti. Vlen të theksohet se nuk është studiuar ndikimi në shëndetin e njeriut i efekteve që vijnë nga ndërveprimi i ndotësve së bashku (pasojat akumulative/grumbulluese).

Monoksidi i karbonit (CO)[202]: Ekspozimi ndaj përqëndrimeve të larta të monoksidit të karbonit mund të shkaktojë probleme akute me frymëmarrjen, helmim, humbjen e vetëdijes, vdekje, humbje ekulibri, dhimbje koke, dobësim të muskujve, të përziera dhe të vjella. Probleme kritike ndaj ekspozimit të monoksidit të karbonit kanë gratë shtatzëna tek të cilat mund të shkaktojë abort, të rrisë rrezikun e dëmtimit të fetusit, të lindjes së foshnjës nën peshë dhe të dëmtimit të sistemit nervor. Grupet më të ndjeshëme ndaj helmimit nga monoksidi i karbonit janë fëmijët e vegjël, gratë shatëzëna, të moshuarit, njerëzit me anemi, njerëzit që vuajnë nga sëmundjet e zemrës dhe mushkërisë dhe përdoruesit e duhanit. Në afate të gjata, ekspozimi ndaj monoksidit të karbonit me vlera të ulta, mund të shkaktojë lodhje, dhimbje gjoksi, humbje të kujtesës, sëmundje të zemrës, dëmtim të sistemit nervor, simptoma gripi dhe probleme me lëkurën në rastet kur mund të ketë kontakt me monoksidin e karbonit në formë të lëngshme.

Dioksidi i karbonit (CO_2)[203]: Dioksidi i Karbonit ne formë e tij të gaztë është asfiksues për arsye se vështirëson furnizimin normal të trupit oksigjen gjatë frymëmarrjes, sidomos në hapësira të mbyllura. Ekspozimi në një mjedis me përqëndrim të $CO_2 \geq 10\%$ mund të shkaktojë vdekje, humbje ndjeNjash, apo marrje mendsh. Gjithashtu ekspozimi ndaj një përqëndrimi të lartë të CO_2 mund të demtojë zhvillimin e fetusit. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj CO_2, në përqindje më të ulët se 10% mund të shkaktojë probleme me shikimin, bllokim të rrugëve të frymëmarrjes, dëmtim të sistemit nervor qëndror, kontraktim të muskujve, ngritje të tensionit të gjakut. Gjithashtu, ekspozimi mund të shkaktojë marrje mendsh, dhimbje të vazhdueshme koke, djersitje të vazhdueshme, lodhje, mpirje, humbje të kujtesës, të përziera, të vjella, depresion, probleme me lekurën, djegie të syve dhe zhurma në veshë.

SO_2[204]: Ekspozimi afatshkurtër ndaj niveleve të larta të SO_2 në ajër mund të jetë i rrezikshëm për jetën duke shkaktuar vështirësi në frymëmarrje dhe bllokim të rrugëve të frymëmarrjes, sidomos për njerëzit me sëmundje të mushkërive. Ekspozimi afatgjatë ndaj niveleve më të ulta të SO_2 mund të shkaktojë bronkit kronik, emfizemë, sëmundje të frymëmarrjes dhe mund të përkeqësojë sëmundjet ekzistuese të zemrës.

Kur dioksidi i squfurit reagon me kimikate të tjera në ajër, formon grimca të vogla sulfate. Këto grimca mund të mblidhen në mushkëri gjatë frymëmarrjes dhe të shkaktojë rritjen e problemeve të frymëmarrjes dhe vështirësi në frymëmarrje. Ekspozimi afatgjatë ndaj grimcave sulfate mund të shkaktojë sëmundje të frymëmarrjes, madje edhe vdekje të parakohshme.

Të sëmurët me astmë janë shumë të ndjeshëm ndaj ekspozimit të dioksidit të squfurit, por edhe të njerëzit të cilët vuajnë nga sëmundjet e zemrës mund të përkeqësohen gjatë ekspozimit ndaj SO_2

PM (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$)[205]: Është vërtetuar shkencërisht se përqëndrimet e larta të grimcave në ajër (PM_{10} dhe $PM_{2.5}$) paraqesin një kërcënim serioz për shëndetin e njeriut. Grimcat me diametër më të vogël në ajër shfaqin probleme të rënda në shëndet, pasi ato depozitohen në pjesët fundore të mushkërive dhe qëndrojnë aty për një kohë të gjatë ose depërtojnë në gjak. Ekspozimi në periudha të gjata ndaj lëndës së ngurtë në ajër shkakton rritjen e sëmundjeve të frymëmarrjes, ul funksionin e mushkërive, shkakton bronkit kronik, madje dhe vdekje të parakohshme për shkak të problemeve me frymëmarrjen. Grimcat e shkarkuara nga automjetet, që përdorin lëndë djegëse diezel, janë vertetuar të kenë ndikim në shtimin e mundësisë për t'u prekur nga kanceri.

Grupet e njerëzve më të prekur nga problemet shëndetësore që shkaktojnë grimcat janë fëmijët, të moshuarit dhe njerzit që vuajnë nga sëmundje të mushkërisë dhe zemrës.

Pb[206]: Sipas Agjencisë Amerikane të Mjedisit, plumbi mund të jetë lëndë kanceroze për shëndetin e njeriut. Plumbi përbën rrezik për shëndetin e fëmijëve, sepse mund të shkaktojë sistemin nervor në mënyrë të përhershme dhe të shkaktojë sëmundje në veshka, zemër, dhe në sistemin riprodhues. Niveli i plumbit në gjak konsiderohet si shumë i rrezikshëm pavarësisht nga sasia e tij. Plumbi gjendet në formë inorganike, si në lëndë djegëse, bojëra, kompjutera, bizhuteri, dhera, edhe produkte të tjera, në miniera, që është edhe forma më e përhapur sot. Plumbi në trup merret nëpërmjet të ushqyerit apo frymëmarrjes.

VOC[207]: Ekspozimi afatgjatë ndaj komponimeve organike të paqëndrueshme mund të shkaktojë dëmtimin e mëlçisë, veshkave dhe të sistemit nervor qëndror. Ndësa ekspozimi afatshkurtër mund të shkaktojnë probleme në sy, acarim të rugëve të frymëmarrjes, dhimbje koke, marrje mendsh, çrregullime vizuale, lodhje, reaksione alergjike të lëkurës, vjellje, dhe dëmtim të kujtesës.

O_3: Ekspozimi ndaj përqëndrimit të lartë të Ozonit (O_3) mund të shkaktojë dëmtim të përhershëm të mushkërive, sidomos tek fëmijët, mushkëritë e të cilëve janë në zhvillim. O_3 mund të shkaktojë probleme me lindshmërinë dhe probleme gjenetike, si dhe mund të rritë mundësinë e dëmtimit të fetusit. Ekspozimi ndaj këtij gazi mund të përkeqësojë sëmundjet kronike të mushkërive, të zvogëlojë sistemin imunitar, të përkeqësojë sëmundjet e astmës dhe ato të zemrës dhe shkaktojë depozitime të lëngëta në mushkëri, duke vështirësuar ndjeshëm frymëmarrjen. Simptomat fillestare të ndikimit të O_3 në shëndet fillojnë me irritimin e rrugëve të frymëmarrjes, shkaktimin e kollës si dhe ndjesi shqetësuese në fyt dhe në gjoks. Futja e O_3 në organizëm nëpërmjet frymëmarrjes shkakton gjithashtu dhimbje koke, dhimbje stomaku, si dhe lodhje dhe të vjella.

- <u>Përfundime dhe rekomandime</u>

Ndotja e ajrit në Bashkinë Lushnje ndihet kryesisht në zonat më të populluara urbane (në zonat qendrore të qytetit), aty ku dhe qarkullimi i automjeteve është më i lartë dhe trafiku më i ngarkuar. Në vitet në vijim, ekziston mundësia që ndotja nga mjetet e transportit të shtohet, për arsye se numri i makinave parashikohet të shtohet për arsye kulture dhe përparësie që Qeveria Shqiptare i ka dhënë ndërtimit të infrastrukturës rrugore.

Ndotja e cilësisë së ajrit në Bashkinë Lushnje shkaktohet kryesisht nga mjetet e transportit, cilësia jo e mirë e naftës, dhe aktivitete të sektorëve të ndryshëm të

ekonomisë si industria dhe ndërtimet. Megjithatë, transporti dhe, Rafineria e përpunimit të naftës, mendohet se do të mbeten ndër sektorët kryesorë të ndotjes në Bashki. Për këtë arsye rekomandohet që Bashkia të marrë masa për pastrimin e ajrit, si p.sh planifikimi i zhvillimit të territorit dhe sektorit të transportit duke e bazuar lëvizjen e qytetarëve të Bashkisë në transport publik alternativ dhe këmbësor, hartimi i politikave që synojnë uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane, shtimi e hapësirave të gjelbra, bashkëpunim me Inspektoriatin e Mjedisit për monitorimin e rregullt dhe rigoroz të shkarkimeve në ajër të aktiviteteve industriale të pajisura me leje mjedisore si dhe kufizimin e ndërtimeve në qytet jashtë standardeve për mbrojtjen e cilësisë së ajrit. Njëkohësisht, rekomandohet bashkëpunim me ARM/AKM-në dhe Institutin e Shëndetit Publik për krijimin e stacioneve të përhershme të monitorimit të cilësisë së ajrit në qytetin e Lushnjes gjatë gjithë vitit me qëllim krijimin e një pasqyre të qartë të cilësisë së ajrit dhe përcaktimin e zonave që kanë nevojë për plane të cilësisë së ajrit


4.5 Pyjet, peizazhi, zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti

4.5.1 Pyjet dhe kullotat

Në vitin 206, fondi pyjor dhe kullosor kaloi në pronësi të Bashkisë Lushnje, me përjashtim të sipërfaqes së fondit pyjor e kullosor që është pjesë e territorit të zonave të mbrojtura (VKM nr. 433, datë 8/6/2016 "Për transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë").

Sot, Bashkia Lushnje ka në pronësi të saj 485.62ha sipërfaqe pyjore, 99.50ha tokë djerr dhe 198.50ha sipërfaqe me bimë pyjore (figura 72). Sipërfaqe të konsiderueshmë zënë tokat improduktive dhe ato djerr, përkatësisht 5,094.48ha dhe 139,46ha.

Figura 72. Fondi pyjor sipas llojit



Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor, Lushnje, Përpunoi Co-PLAN, 2016.

Sipas të dhënave për shpërndarjen e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në territorin e NJA-ve të Bashkisë Lushnje, dallohet qartë që NJA-të me sipërfaqe më të madhë të fondit pyjor janë Karbunara e cila ka një sipërfaqe prej 153.57 ha dhe Golem me 96ha e ndjekur nga NJA-të Hysgjokaj, Ballagat dhe Allkaj. Duke analizuar me kujdes të dhënat vihet re që zona djerr me sipërfaqën më të madhe ndodhet në NJA-të Karbunarë dhe Ballagat (51.5 dhe 48 ha).

Tabela 30. Shpërndarja e fondit pyjor e kullosor sipas NJA-ve në Bashkinë Lushnje


Nr.	Ekonomia pyjore/Kullosore	Kategoria e përdorimit	Sip. (ha)	Totali
Nja ALLKAJ				
1	Argjinatura Seman	pyll	70	70
Nja KARBUNARË				
2	Balaj Mollas	pyll	153.57	346.07
		sipërfaqe bimësi pyjore	141	
		djerrë	51.5	

Nja FIRSHEGAN				
3	Balaj Mollas	pyll	11	11
Nja HYSGJOKAJ				
4	Gramitur Hysgjokaj	pyll	78.3	78.3
Nja BALLAGAT				
5	Gramitur Hysgjokaj	pyll	76.75	173.25
		sipërfaqe bimësi pyjore	48.5	
		djerrë	48	
Nja GOLEM				
6	Gramitur Hysgjokaj	pyll	96	144
		paraportuar	48	
TOTALI			**822.62**	

Burimi: Bashkia Lushnje

Siç vihet re në tabelën e mësipërme, sipërfaqja më e madhe e fondit pyjor është shpërndarë në NJA-të Karbunarë dhe Golem. Nga krahasimi në hartë i fondit pyjor të dokumentuar në hartat e 1984-1985 me ortofoton e vitit 2015 (*nga Google Imagery*) vërehet një tkurrje e konsiderueshme e sipërfaqeve pyjore në territorin e Bashkisë, rreth 34.3%, kryesisht në zonat ku është përqëndruar aktiviteti njerëzor.

Figura 73. Harta e fondit pyjor



Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor, Lushnje, Përpunoi Co-PLAN, 2016

Ndonëse analiza është kryer në GIS, vlen të merret parasysh ekzistenca e një marzhi të vogël gabimi pasi hartat e vjetra janë të një teknologjie të vjetër, lexueshmëria e legjendës dhe simbolikës është e vështirë si dhe mbivendosja/përshtatja me ortofoton e 2015, gjithashtu ka një marzh gabimi si pasojë e ndryshimeve në territor.

Vizitat e vazhdueshme në terren dhe konsultat mes specialistëve të pyjores dhe banorëve/pronarëve mund ta zgjidhin këtë ngërç dhe të saktësojnë informacionin/analizën e mëtejshme.

Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i gjendjes së pyjeve në disa NjA të Bashkisë Lushnje:

Njësia Administrative Kolonjë*:* Parcela e objektit Ardenicë, e mbjellë me pemë të llojit pishë mesdhetare dhe lis "*Dushkajat e Manastirit, Lushnje*" shfaqet në gjendje të mire dhe e parrezikuar nga aktiviteti natyror e njerëzor. Me sipërfaqe prej 10ha, ky pyll është shpallur Monument Natyre me VKM, nr. 676 të datës 20/12/2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur e monumenteve të natyrës shqiptare"

Njësia Administrative Allkaj*:* Plepi, shkurret dhe ferrat janë llojet e bimëve të cilat i përkasin sipërfaqeve pyjore të njësisë administrative Allkaj. Pjesa tjetër shfaqet e tjetërsuar ne foragjere (jonxhë).

Njësia Administrative Fiershegan*:* Në territorin e kësaj njësie administrative, fondin pyjor e dominojnë të mbjellat me pishë mesdhetare. Gjendja e saj ekzistuese është e mirë. Ndonëse në këtë parcelë janë ndërtuar dy antena telekomunikacioni.

Njësia Administrative Karbunarë: Lisi, pisha mesdhetare, pisha e butë, dafina dhe bimësia pyjore si ferra, muzhdakëra, gjineshtëra, ferra etj, janë llojet të cilat gjenden në fondin pyjor të kësaj njësie. Aktualisht pylli është në gjendje të mire me përjashtim të disa raste sporadike ku tjetërsimi vjen nga kultura bujqësore (serat) si në rastin konkret tek "*Rezervuari i Kasharajt*" ku sipërfaqja me pishë të butë është fragmentuar si pasojë e transformimint në aktivitet bujqësor (sera). Sipërfaqe të tjera të tjetërsuara si pasojë e degradimeve dhe kullotjes së jashtëligjshme janë sipërfaqet e mbjella me define, të cilat tashmë janë veçse sipërfaqe me bimësi pyjore ferra dhe fierishte. Tek "*Perroi i Derrit*" shfaqen pemë të reja lisi të cilat janë në gjendje pjesërisht të mire, pasi në këtë parcelë ka copëzom/fragmentim të sipërfaqes pyjore nga aktiviteti bujqësor.

Njësia Administrative Hyzgjokaj*:* Pisha mesdhetare, dafina dhe bimësia pyjore si ferra, muzhdakëra, etj. janë llojet të cilat gjenden në fondin pyjor të kësaj njësie. Sipërfaqet e mbjella me pishë mesdhetare aktualisht shfaqen si sipërfaqe me bimësi pyjore për shkak të zjarreve të rëna gjatë viteve të fundit, zënia dhe tjetërsimi i paligjshëm i fondit pyjor dhe nga mbjellja e ullinjve dhe kulturave të tjera bujqësore.

Njësia Administrative Ballagat: *Në* Fondin pyjor të kësaj njësie dallohen pisha mesdhetare, pisha e butë, bimësia pyjore dhe sipërfaqet djerrë. Pisha mesdhetare dhe ajo e butë aktualisht janë në gjendje të mirë, ndonëse territori ku ato shtrihen shfaqet i fragmentuar si pasojë e tjetërsimit të fondit pyjor në sipërfaqe bujqësore dhe mbjellje të drurëve frutor (ullinj). "*Teqa e Matjanit*" dhe "*Mali i Dardhës*" shfaqin më së miri këtë tjetërsim. Në këtë sipërfaqe janë mbjellë ullinj. Ndërkohë, po në këtë sipërfaqe pyjore ka edhe sipërfaqe me bimësi pyjore të tjetërsuara në pishë të butë dhe mesdhetare (viti 2008), ku aktualisht shfaqen në gjendje të mirë dhe vazhdon rritja normalisht.

Njësia Administrative Golem*: Në* Fondin pyjor të kësaj njësie dallohet pisha mesdhetare, e cila në pjesën më të madhe shfaqet në gjendje të mirë, duke përjashtuar rastin e sipërfaqes prej 13ha të mbjellë po me pishë mesdhetare, e cila nuk ekziston më pasojë e djegies nga zjarri. Kjo sipërfaqe tashmë shfaqet si sipërfaqe e tjetërsuar

në bimë pyjore si ferra, gjineshtër, murriskë dhe disa raste sporadike ku tjetërsimi vjen nga kultura bujqësore (jonxhë).

Njësia Administrative Dushk: Me një sipërfaqe prej 16ha, fondi pyjor i kësaj njësie përbëhet nga dafinë dhe blin, të cilët shfaqen në gjendje të mire, ndonëse fragmentimi/ndërhyrjet e viteve 1993-1998 kanë lënë gjurmën e tyre në territor.

- Problematikat kryesore të fondit pyjor

Problematikat e përgjithshme që hasën pothuajsë në të gjithë territorin e Bashkisë janë si më poshtë:

- **Mungesa e invetarizimit periodik të fondit pyjor e kullosor:** të dhënat rreth sipërfaqeve pyjore e kullosore në vendin tonë dhe në Bashkinë Lushnje bazohen në inventarin e fundit të këtij fondi i cili i përket viteve 1984-1985. Që nga regjistrimi i fundit, nuk ka patur përpjekje të reja për një inventar të përditësuar edhe pse me ligj parashikohet inventarizimi çdo dhjetëvjeçar. Si rrjedhojë, në vendin tonë dhe në Bashkinë Lushnje, të dhënat e inventarëve shpesh janë kontradiktore.
- **Humbje të sipërfaqes pyjore**: Një ndër problematikat kryesore të pyjeve në Bashki është humbja e sipërfaqes pyjore në dy dhjetëvjeçarët e fundit. Nga inventarizimi i fundit i pyjeve në vitin 1984-85 deri në vitin 2015, Bashkia Lushnje ka humbur ose tjetërsuar një sipërfaqe të konsiderueshme të fondit pyjor, rreth 160 ha sipas analizës së realizuar ne GIS.
- **Prerja e pyjeve:** Në territorin e Bashkisë janë vërejtur prerje të vazhdueshme të pyjeve për lëndë djegëse. Aktualisht prerja e pyjeve është e ndaluar (Moratoriumi 10 vjeçar i pyjeve), ndaj zbatimi i moratoriumit është jetik për mbarështimin e pyjeve.
- **Djegia e pyjeve:** Ashtu si në të gjithë vendin, edhe në Bashkinë Lushnje janë vënë re raste të djegies së pyjeve. Kryesisht djegiet janë të qëllimshmë për hapjen e tokave të reja bujqësore.
- **Tjetersimi i sipërfaqeve të fondit pyjor:** Tjetërsimi i fondit pyjor në kullotë është një fenomen i cili praktikohet gjërësisht në vend, në rastet më të shumta ndodh fenomeni i zjarr-vënies e, më pas, kthimi në kullotë për bagëtinë.

- Përfundime dhe rekomandime

Fondi Pyjor në Bashkinë Lushnje karakterizohet nga mbjellje artificiale pishe me përjashtim të lisit në Ardenicë, Balaj/Mollas si dhe cungishteve të rritura natyrshëm në sipërfaqen e fondit pyjor. Ndonëse sipërfaqja pyjore e Bashkisë Lushnje është relativisht e vogël, ajo shfaqet në gjendje të mirë në pjesën më të madhe të saj duke vepruar si një filter i padukshëm për këtë territor. Për të ruajtur dhe përforcuar shëndetin afatgjatë të fondit pyjor, pyjet duhet të ruhen nga zjarrëvëniet e qëllimshme, si dhe duhet përforcuar koordinimi mes drejtorive përgjegjegjëse për parandalim dhe ndëshkimin e shkelësve dhe tjetërsimeve të paligjshme të fondit pyjor. Gjithashtu, duhet një bashkërendim i mirë dhe gjithëpërfshirës mes institucioneve vendim-marrëse dhe organizative për administrimin dhe kontrollin e territorit ku shtrihet fondi pyjor.

Mirëadministrimi i Pyjeve dhe Kullotave nga Bashkia Lushnje, sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten

pikënisjet drejt suksesit për përmirësimin e gjendjes aktuale. Njësitë Administrative, nëpërmjet planeve të manaxhimit të pyjeve dhe kullotave mund t'i ofrojnë banorëve të tyre mundësi punësimi në periudha kur ka aktivitete të punimeve pyjore. Nja-të, nëpërmjet mbjelljes dhe rimbjelljes së drunjëve të lartë mund të përfitojnë më shumë të ardhura, mbështetje financiare në realizimin e projekteve, si dhe të ardhura të vazhdueshme e të sigurta nga shitja e kapaciteteve të lira të karbonit.


Për ruajtjen dhe mbarështimin e fondit pyjor e kullosor në territorin e Bashkisë së Lushnjes rekomandohet të merren një sërë masash, disa prej të cilave mund të jenë:

- Hartimi i një *Plani Veprimi për rehabilitimitimin e sipërfaqeve të djegura/degraduara* që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale dhe mbjelljen e tyre me pemë të cilat kanë qënë autoktone;
- Marrjen e *masave paraprake për parandalimin e fenomeneve të zjarreve*, si: ndërgjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënien para përgjegjësisë të të gjithë kundërvajtësve që shkaktojnë zjarret, shtrirjen e një sistemi lajmërimi zjarri (rol të rëndësishëm luajnë barinjt e zonës)
- *Mbajtjen nënkontroll të sëmundjeve dhe të dëmtuesve*, ku shkalla e prekjes është më e madhe se kufijtë kritikë të lejueshëm. Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet zonave me shtrirje të mëdha bimësie dhe ruajtjes së bimëve shmëvjeçare.

4.5.2 Peizazhi

Peizazhi është gjithçka që duket në territor mbi sipërfaqen e tokës dhe mund të studiohet në drejtimin estetik dhe dejtimin funksional që lidhet me shërbimet e ekosistemit. Të dyja këto drejtime janë të lidhura ngushtë me njëra-tjerën dhe në fakt, aspekti funksional ndikon atë estetik. Në territorin e Bashkisë Lushnje peizazhi ndahet në pesë fasha (tipologji) kryesore: ***urbane, industriale, rurale, natyrore*** dhe ***ujore.***


Figura 74. Harta e tipologjive të Peizazhit (Fashat)



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN, 2016.

Krijimi i fashave peizazhistike në territorin e Bashkisë lidhet ngushtë me formacionet territoriale, hidrogjeologjinë dhe hidrografinë, si dhe pjerrësitë e terrenit. Megjithëse këta komponentë kanë tipologji të ndryshme nga njeri-tjetri dhe gjenden në zona të ndryshme të territorit, parë në shkallë peizazhi ata përbëjnë një të vetëm, duke ofruar shumëllojshmëri peizazhistike brenda kufirit bashkiak.

Figura 75. Harta e tipologjive të peizazhit dhe fondipyjor



Burimi: Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Lushnje, Përpunoi Co-PLAN, 2016

Në këtë larmishmëri peizazhistike dallohet ***fasha natyrore,*** e cila është edhe fasha më e ndërlikuar në matricën peizazhistike. Kjo fashë karakterizohet nga sipërfaqe pyjore, fusha të hapura, korridore të gjelbëra apo ujore, zona tampon, zona ripariane, zemra e habitatit, ngastra, si dhe mozaikë. Po në këtë fashë përfshihet edhe sipërfaqja më e madhe e fondit pyjor dhe zonat e mbrojtura natyrore brenda territorit të Bashkisë. Gjithashtu lehtësisht e dallueshme është edhe ***fasha rurale*** e cila karakterizohet nga toka bujqësore, toka të hapura të pozicionuara në mënyrë "informale", grupime pemësh/shkurresh, pemë të mbjella në rresht (vijë tampon) të cilat herë duken të mbjella nga njeriu e herë vetvetiu nga natyra, trupa ujorë (lumenj, kanale, rezervuare, etj.)

Ndonëse një fashë komplekse dhe me diversitet të larmishëm biologjik, për shkak të zhvillimit njerëzor në tërësi dhe bujqësor në veçanti, fasha natyrore shfaqet e fragmentuar në tërësinë e vet.


Tipologji tjetër peizazh-krijuese në Bashkinë Lushnje është ***fasha/njolla urbane*** ku peizazhi shpaloset në zona banimi dhe shërbimesh me një karakter ***formal***. Këtu, peizazhi karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore, pemë apo grupime pemësh zbukuruese, parqe si dhe zona tampon.

Peizazhi industrial shfaqet i pa ndashëm nga fasha urbane, me përjashtim të pjesës qëndrore të territorit, specifikisht në Njësinë Administrative Lushnje(Sipërfaqe të vogla ish-industriale). Ky peizazh ka po ashtu karakter "***formal",*** ndonëse bimësia është më e rallë. Po ashtu, në krasitjen e paraqitjen e tyre i përkushtohet rëndësi dekorimit, më tepër se sa funksionit dhe shërbimit mjedisor. Si në rastin e pemëve në

peizazhin urban, edhe këtu ato preferohen të jenë vendase dhe me kurorë të gjerë për të hijëzuar hapësira parkimi, apo publike.

Fasha e fundit është ajo e ***sipërfaqeve ujore***, e cila karakterizohet nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë, duke përfshirë lumenjtë, rezervuaret, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale. Peizazhi ujor dominohet nga lumi Seman, Shkumbin e degët e tyre dhe rezervuarët në të gjithë territorin e Bashkisë.

Figura 76. Harta peizazhistike dhe rrugët



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN, 2016.

Ndonëse pjesë kryesore dhe e pandashme e peizazhit urban, ***rrugët*** ashtu si edhe sipërfaqet ujore, shtrihen në mbarë territorin e Bashkisë, duke krijuar "çarje" të tipologjive peizazhistike. Nga ana tjetër, ato krijojne edhe lidhje fizike e pamore mes tipologjive peizazhistike. Këto rrugë u përkasin kategorive të ndryshme nga madhësia, po ashtu edhe funksioni, por elementi i përbashkët dhe i pa ndryshuar mbetet peizazhi. Në hartën e peizazhit (figura 76), rrugët shfaqen si "kanale" lidhëse pa trashësi të përcaktuar, apo kategorizim funksional. Pra, në vend të funksionit e lidhjes që ato krijojnë mes zonave, në analizën peizazhistike, ato karakterizohen vetëm nëpermjet imazhit që secila përcjell në fashën peizazhistike ku kalon.

- Elementet përbërëse të peizazhit

Elementët e peizazhit natyror: Identifikimi i elementeve peizazhistike në fashën natyrore të territorit të Bashkisë Lushnje, ku pjesë e pandashme janë edhe sipërfaqet e Fondit Pyjor dhe të Zonave të Mbrojtura Natyrore, merr rëndësi të veçantë, pasi identifikimi dhe leximi i këtyre elementeve ndikon drejtpërsëdrejti në të kuptuarin e biodiversitetit lokal, potencialin e ekoturizmit si dhe gjendjen e fondit pyjor, përfshirë mbrojtjen e tij e të fashës natyrore në tërësi nga rreziqet natyrore dhe njerëzore. Elemente të peizazhit natyror që gjenden në territorin e Bashkisë Lushnje, si ***zonat ripariane***, ***korridoret***, ***kopshtet ujëmbajtëse*** etj., luajnë një rol të rëndësishëm edhe në krijimin e mikroklimës në zonat ku ato shtrihen. Zonat *ripariane,* të cilat natyrshëm

shtrihen përgjatë trupave ujore si lumenj, përrenj, kanale dhe rezervuare parandalojnë erozionin ujor, krijojnë strehë dhe ofrojnë ushqim për gjallesat e ndryshme ujore e tokësore që frekuentojnë këtë mjedis, krijojnë mikroklimë të vetën, ofrojnë habitatin e nevojshëm për mbarështimin e këtyre specieve dhe mbrojnë burimet ujore nga derdhja e nutrientëve (ushqyesve me tepricë), që rezultojnë nga përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve në tokë bujqësore.

Figura 77. Zonë ripariane e zhveshur nga bimësia si pasojë e zhvillimit të bujqësisë.



Burimi: Google Imagery, 2016

Rripat e gjelbër, korridoret dhe korridoret lidhës[208] marrin një rol po aq të rëndësishëm sa edhe zonat ripariane, pasi ato luajnë rolin e venave në peizazh duke ***lidhur*** parcelat, ngastrat, sipërfaqet ujore, apo matricat peizazhistike me njëra-tjetrën. Ato ofrojnë edhe ***vendkalime*** për specie të ndryshme, mbrojnë biodiversitetin lokal si dhe krijojnë ***barrierë*** natyrore për erën. Në territorin e Bashkisë Lushnje rripat e gjelbër, parcelat e lidhura dhe ato të ndara mbizotërojnë në peizazhin natyror. Ato ndahen në dy kategori; ***natyrore*** dhe ato ***të mbjella*** nga fermerët me bimë si robiNja (Robinia Pseudoacacia), rrapi (Platanus), shelgë (Salix) dhe plepi i bardhë (Populus Alba), të cilët në pjesën më të madhe shtrihen përgjatë tokave bujqësore si elemente ndarës pronësie por edhe si pasojë e kushteve të krijuara për rritjen dhe zhvillimin natyror të këtyre bimëve në këto rripa të gjelbër dhe koridore.

Figura 78. Rrip i gjelbër me bimësi të ulët përgjatë një kanali vaditës




Burimi: Google Imagery, 2016

Korridorët, krahas rëndësisë peizazhistike që mbratin, karakterizohen nga shërbime të shumta ekologjike në përgjithësi të përherëshme si strehimi, ushqimi e vendet e riprodhimit për jetën e egër, por edhe ato të përkohëshme si vendkalimet dhe ushqimi sezonal, ndërsa korridoret lidhës të cilët janë në shkallë më të vogël ofrojnë shërbime

ekologjike të përkohëshme ku shërbimi kryesor mbetet kalimi i jetës së egër nga një pikë në tjetrën. Korridoret (të mëdhenj dhe të vegjël, lidhës) shfaqen të copëzuar herë-herë në formë parcele apo ngastre.

Figura 79. Harta e Elementeve Peizazhistike



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN, 2016.

Elementët e Peizazhit Urban dhe Industrial: karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore ku llojet e tyre shfaqen të ndryshueshme sipas rrugës. Zgavrat ku këto pemë qëndrojnë gjithashtu të ndryshueshme nga një rrugë në tjetrën, disa janë me bordura të ngritura e disa pa bordura. Ndërkohë, pjesa më e madhe e përmasave të zgavrave të pemëve janë relativisht të vogla në raport me pemën. Grupime pemësh dekoruese apo në formë "ishulli" gjenden vetëm brenda hapësirave park apo lulishte dhe qëllimi është estetik e jo sipas funksionit dhe shërbimit mjedisor pasi "katet" e ndryshme të bimësisë mungojnë. Elementet urbane dhe industriale të forta/mbizotëruese apo edhe të padëshiruara shfaqen herë-herë në zona të ndryshme të qytetit. Zona tampon apo brezat e gjelbër pengues të erës dhe imazheve urbane apo industriale të padëshiruar ndodh në mënyrë spontane e të paplanifikuar. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve parkim shfaqet e ekspozuar ndaj diellit pasi bimë gjethore për hijëzimin e këtyre hapësirave mungojnë. Gardhet e muret ndarës të pronave në disa zona janë mbi 2 metra të lartë dhe estetikisht "ngushtojnë" hapësirën e përbashkët si dhe ndjesia që ngjallin është ajo e mungesës së sigurisë.

Elementët e peizazhit ujor në tërësi dhe në veçanti ai lumor shfaqet i "fshehur" nga peizazhi urban. Bimësia "ripariane" mungon në pjesën më të madhe ndërkohë në pjesën tjetër përbëhet nga bimë të llojit bar dhe shkurre të ulëta. Ndërkohë, kur trupi ujor përshkon fashën rurale dhe natyrore sërish humb një pjesë të konsiderueshme të zonës së tij ripariane si pasojë e tjetërsimit në tokë bujqësore dhe fenomenit gjeologjik

të përshpejtuar si pasojë e prerjes së bimësisë në këto zona. Pra peizazhi ujor shfaqet si lidhës mes peizazhit rural dhe atij natyror.

- Rreziku ndaj elementëve peizazhistik


Peizazhi në territorin e Bashkisë Lushnje paraqitet i ndryshëm, në varësi të territorit dhe zonave ku mbizotëron aktiviteti njerëzor. Problematikat kryesore që has peisazhi në territorin e bashkisë kanë të bëjnë kryesisht me fragmentimin/copëzimin e peizazhit natyror, dhe mos-futjen e elementëve të peizazhit natyror në zonat urbane dhe në zonat me aktivitet industrial. Krahas problemeve në shkallë të madhe, vlen për t'u theksuar prania e problemeve me peisazhin urban e atë industrial, të cilët deri më tani nuk kanë gjetur një rrugë të përbashkët ndërthurjeje me atë natyror. Në qytet mbetet problem krijimi i një peizazhi të mirëfilltë urban, duke përfshirë të gjithë elementët e gjelbërimit, arkitektonikës, kopshteve, monumenteve kulturor dhe historike, të cilët së bashku do të krijonin një peizazh të ndërthurur dhe të pëlqyeshëm për qytetarët. Shpesh, praktikat e mira të peizazhit nuk ndiqen, apo përcaktohen si dytësore. Këto praktika janë spontane, ku zonat urbane dhe industriale kanë përdorur elementë të peizazhit në mënyrë rastësore, apo duke patur një orientim të lehtë mbi çështjen e dizajnit të peizazhit. Kryesisht, rrugët dhe sheshet kanë qënë pjesë e futjes së dizajnit të peizazhit, me mbjellje pemësh në formë lineare, duke ndjekur liNja strikte, në rastet më të shpeshta, duke ndjekur konturet e infrastrukturës. Kjo është një mënyrë sigurisht jo universale në rregullimin dhe krijimin e peizazhit apo përdorimit të elementëve të tij në funksion të dekorit urban e më gjerë. Studimi i peizazhit në tërësi dhe elementëve të tij kërkon studime të thelluara duke analizuar të gjithë përbërësit e tij (planifikimi, arkitektuonika, historia, kultura, kultura bujqësore, natyra, bimësia lokale, e deri tek përbërësit më elementar si ndryshimi i ngjyrës së pemëve përgjatë sitinëve të vitit) dhe gjetjen e rrugëve të përbashkëta për ndërthurjen e pikave që mund të ndërthuren me njera-tjetrën për të krijuar një peizazh të pëlqyeshëm dhe funksional. Ndër rreziqet kryesore ndaj elementëve peizazhistike në territorin e Bashkisë Lushnje përmendim:

- Zhvillimi dhe zgjerimi i tokave bujqësore në tëresi të territorit dhe sidomos përgjatë trupave ujorë ka ngushtuar, copëzuar dhe zhveshur në mënyrë të theksuar zonat ripariane nga bimësia si në burime *Lentike* (liqenet dhe pellgjet) dhe *Lotike* (afër ujërave rrjedhëse, si lumenjtë dhe përrenjtë). Lumi Seman shfaq dukshëm këtë fenomen. Bimësia lokale në to karakterizohet me bimësi si kallami, robiNja (Robinia Pseudoacacia), rrapi (Platanus), shelgu (Salix), plepi i bardhë (Populus Alba) dhe shkurrja autoktone. Në sipërfaqet ku ka mbijetuar zona ripariane, shtresat përbërëse të saj si ajo e sipërme, e mesme dhe e mbulimit të tendës, rrallë gjenden të pandikuara nga aktiviteti njerëzor. Herë ka humbje të shtresës së mbulimit të terrenit në zonën e sipërme të tokës, e cila kryen filtrimin e ndotësve dhe të sedimenteve të derdhjeve sipërfaqsore dhe herë të shtresës së mesme të tendës në zonën bregore ku gjenden shkurret e larta dhe pemët të cilat nëpërmjet rrënjëve stabilizojnë anët e përroit. Si pasojë, nga një anë aktiviteti bujqësor ka dëmtuar zonën ripariane e, nga ana tjetër, erozioni lumor ka përparuar në dëm të tokave bujqësore duke gërryer brigjet, marrë tokë, shkaktuar përmbytje dhe shkarkuar sedimentet ujore mbi tokë.
- Përbërësit peizazh-formues si ai ***urban, industrial, rural, natyror*** dhe ***ujor*** të analizuar më sipër shfaqen në zona të ndryshme të territorit. Por, problematika mbetet e njëjtë si pasojë e ndërveprimit mes tyre. Në këtë kontekst vërehet një

mospërputhje e elementëve peizazhistike në territorin e Bashkisë, duke mos u përdorur elementët peizazhistik në funksion të përmirësimit të tij.

- Fragmentimi i zonave natyrorë ka cënuar peizazhin natyror, duke e cunguar dhe ndaluar vijushmërinë natyrore. Kjo shfaq probleme krahas fragmentimit të habitateve dhe fragmentit pamor.
- Zonat e ndotura (hot-spot) të cilat janë të pranishme në territorin e bashkisë luajnë një rol të rëndësishmë në përkeqësimin e cilësisë peizazhistike të territorit.

Figura 80. Harta e rrezikut ndaj elementeve peizazhistike



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN, 2016

Në hartën e rrezikut ndaj elementeve peizazhistike (figura 80) paraqiten të gjithë elementet e peizazhit të pranishme në territorin e Bashkisë Lushnje. Gjithashtu, në të njëjtën hartë paraqiten edhe rreziqet ndaj peizazhit në territor. Në hatë shikohet qartë zvogëlimi i zonës natyrore dhe fragmentimi i saj nga zhvillimi urban, industrial e bujqësor. Një element tjetër i rëndësishëm në këtë hartë janë edhe vatrat e nxehta mjedisore të cilat kanë ndikim negativ në zhvillimin e peizharit.

- <u>Përfundime dhe rekomandime</u>

Territori i Bashkisë së Lushnjes rezulton të ketë një larmishmëri peizazhistike, natyrore, ubrane, rurale, ujore, etj., duke u përkthyer kjo në një potencial të pashfrytëzuar për zhvillimin e turizmit. Larmishmëria e peizazhit është kushtëzuar nga territori dhe përdorimi i tokës. Kryesisht në pjesën e NJA-VE Ballagat, Hysgjokaj dhe Karbunarë mbizotëron peizazhi natyror, ndërsa në pjesë rreth qytetit të Lushnjes dhe NJA-ve Allkaj, Krutje, Kolonjë, Budullime dhe Dushk mbizotëron

peizazhi me tipologji rurale e bujqësore. Qyteti i Lushnjes është zona kryesore që formon tipologjinë urbane dhe industriale të peizazhit.

Në territorin e Bashkisë mbetet problematik fragmentimi i peizazhit natyror, i cili është dëmtuar nga zhvillimi urban, industrial e kryesisht ai bujqësor. Zonat e ndotura, kryesisht nga aktiviteti industrial dhe nga mbetjet urbane ndikojnë në përkeqësimin e peizhazhit dhe natyrës në përgjithësi. Ndërthurja e tipologjive të ndryshme të peizazhit në territor haset me vështirësi të mëdha, pasi gjatë zhvillimeve të ndryshme në territor nuk janë marrë parasysh elementët peizazhistikë dhe rëndësia e tyre. Kjo vazhdon të jetë një pengesë për përmirësimin e peizhazhit.

Me qëllim përmirësimin e peizhazhit dhe ndërthurjen e tipologjive të tij, duke përmirësuar aspektin pamor dhe ruajtur funksionalitetin, nevojitet të merren masa të cilat lidhen me: i) futjen e përbërësve natyrorë në brëndësi të zonave urbane dhe industriale, ii) mbjedhjen e pemëve të larta për të fshehur objektet industriale të padëshirueshme nga pikpamja vizuale/pamore, iii) ruajtjen dhe mbrojtjen e të gjithave tipologjive të peizhazhit në territorin e Bashkisë, iv) krijimin e zonave ripariane dhe korridoreve përgjatë tokave bujqësore dhe v) gjatë hartimit dhe zbatimit të planeve sektoriale, rekomandohet futja e elementit peizazhistik.

4.5.3 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese të cilat manaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore[209].

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ofrojnë. Këto zona mbrohen me ligj[210] dhe zënë rreth 16%[211] të territorit të vendit.

Një territor i caktuar duhet të plotësojë të paktën një nga këto kritere:[212] i) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve, ii) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve, iii) të ketë përfaqësueshmëri, iv) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit, v) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet, vi) të ketë vlera shkencore; vii) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme, viii) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike, ix) të mos rrezikohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore, dhe x) të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

Në vendin tonë, zonat e mbrojtura ndahen në 6 kategori (Tabela x) të cilat janë përshkruar shkurtimisht në tabelën e mëposhtme.

Tabela 31. Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave

Kategoria	**Emërtimi**	**Karakteristikat**
Kategoria I	Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor	Territore jo më të vogla se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta, të formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtësisht të ndryshueshme, që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, shpallen rezervë strikte natyrore.
Kategoria II	Park kombëtar	Territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative, shpallen park kombëtar.

Kategoria III	Monument natyror	Monumenti Natyrorë përfaqëson një formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë mineralesh ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, shpallet monument natyror[213].
Kategoria IV	Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror	Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i menaxhuar (zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve).
Kategoria V	Rezervat natyror i menaxhuar/ peizazh i mbrojtur	Territoret më të mëdha se 1000 ha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me reliev të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, me monumente historike, shpallen peizazh i mbrojtur.
Kategoria VI	Zonë e mbrojtur e burimeve të manaxhuara /zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë	Zonat që përfshijnë territore të gjëra e relativisht, të izoluara dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara.

Burimi: Ligji Nr 8906/.2002 Për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar me Ligjin Nr.9868/2008

- Manaxhimi i zonave të mbrojtura në vend

Kohët e fundit, shteti shqiptar ka bërë hapa të rëndësishëm përpara për zhvillimin e zonave të mbrojtura. Qeveria ka plotësuar më tej kudrin ligjor dhe institucional për manaxhimin e zonave të mbrojtura në vend. Shqipëria ka miratuar Ligjin Nr. 8906, dt. 06.06.2002, Për Zonat e Mbrojtura (i ndryshuar) i cili ka si qëllim kryesor shpalljen, ruajtjen, manaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre. Një hap shumë i rëndësishëm në drejtim të manaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në vend është edhe miratimi i VKM-së Nr. 102 i datës 12.02.2015, i cili krijoi dhe përcaktoi funksionet e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM). AKZM-ja dhe AdZM-ja kanë përgjegjësi të drejtëpërdrejtë në manaxhimin e zonave të mbrojtura në vend, mbështetjen që i japin Ministrisë për hartimin dhe zbatimin e politikave për zonat e mbrojtura, hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit dhe të veprimit, monitorimin, mbledhjen e informacionit dhe lajmërimin e organeve kopetente kur vërehen shkelje në zonat e mbrojtura.[214] Pas përpjekjeve të shtetit shqiptar për plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, mund të themi që manaxhimi dhe administrimi i zonave të mbrojtura është qartësuar në kontekstin e përgjegjësive institucionale.

Në këtë fazë, AKZM-ja[215] ka hartuar Programin Strategjik Afatshkurtër dhe Afatmesëm 2015-2020 për manaxhimin e zonave të mbrojtura në vend. Qëllimi kryesor i këtij plani është përmirësimi i manaxhimit të ZM-ve sipas standardeve të BE-së, duke ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore. Për më tepër, Qeveria ka marrë masa konkrete për zbatimin e ligjeve mbi zonat e mbrojtura dhe manaxhimin e tyre. AKZM-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, ka hartuar planet e manaxhimit për disa zona të mbrojtura (Plani i manaxhimit të Parkut kombëtar të Malit të Tomorrit, Divjakë-Karavasta etj) dhe është drejt përfundimit të hartimit të planeve të manaxhimit[216] për zona të tjera. AKZM-ja e shtrin aktivitetin e saj në çdo qark nëpërmjet degës së saj rajonale (AdZM-të e qarqeve). AdZM-të kanë në fokus të tyre zbatimin e planeve dhe monitorimin e zonave të mbrojtura në

territorin e tyre të kompetencës (të qarkut përkatës) dhe bashkëpunimin me AdZM-të e tjera përkatëse, kur zona e mbrojtur i kalon kufinjtë e qarkut. AdZM-të kanë një staf të caktuar në varësi të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura që ndodhen në territorin e administruar prej tyre (disa punonjës në rastet e manaxhimit të një parku komëtar që llogaritet të ketë një sipërfaqe të madhe që përfshijnë kryesisht specialistë monitorimi dhe disa roje).[217]

Me gjithë punën e mirë të bërë nga AKZM-ja, zbatueshmëria e ligjit për zhvillimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura ende has vështirësi. Mungesa e planeve të manaxhimit dhe mungesa e kapaciteteve për zbatimin e planeve të manaxhimit për disa zona mbetet ndër vështirësitë kryesore. Për kapërcimin e këtyre vështirësive, momentalisht AKZM-ja është duke bërë një punë të mirë në drejtim të rritjes së kapaciteteve lokale dhe plotësimit të stafit të nevojshëm për manaxhimin sa më të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.

- Zonat e mbrojtura në territorin e Bashkisë Lushnje

Territori i Bashkisë Lushnje shtrihet në reliev kryesisht fushor me kodra të buta deri në *250 mmnd* dhe ka një klimë tipike mesdhetare, me verë të nxehtë e të thatë dhe dimër të butë e me reshje.[218] Në territorin e Bashkisë, krahas bimëve të kultivuara, të cilat zënë përqindje të lartë, ka një numër të madh llojesh të faunës dhe florës. Brenda territorit të bashkisë ndodhen 5 monumente natyrore të mbrojtura, të cilat do të trajtohen gjerësisht në vijim.

Për sa i përket manaxhimit të monumenteve të natyrës, në territorin e Bashkisë Lushnje nuk ka të përcaktuar punonjës të AdZM-së Fier që merren me manaxhimin dhe monitorimin e tyre.[219] Në shkallë rrethi, në Lushnje janë 3 specialistë manaxhimi dhe 7 roje mjedisore, kryesisht në Parkun kombëtar Divjakë – Karavasta. Aktualisht nuk ka një plan manaxhimi për monumentet e natyrës, edhe pse vazhdimisht kryhet monitorimi i gjendjes së tyre dhe merren masa për përmirësimin dhe mbrojtjen e cilësisë së tyre. Duhet shtuar se edhe Bashkia e Lushnjes ka përgjegjësi për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit në territorin e saj. Prandaj lind nevoja që në të ardhmen, Bashkia të bashkëpunojë me AdZM-në Fier për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.[220]


Tabela 32. Zonat e mbrojtura në Bashkinë Lushnje

Emërtimi i ZM-së	**Kategoria**	**Përshkrim i shkurtër**	**Rëndësia**
Kategoria III - Monument natyrore			
Selvitë e Manastirit	III	Lartësia: 10-15m Diametri i trungut: 60-80cm Mosha:disa dhjetra-vjecare	Biologjike, estetike dhe fetare me rëndësi lokale
Dushkajat e Manastirit	III	Lartësia: 10m Diametri i trungut: 35-60cm Mosha: disa dhjetra-vjecare	Biologjike, estetike me rëndësi lokale
Rrapi i Zonjës	III	Lartësia: 4m Diametri: 2m Gjendja; i dëmtuar	Biologjike dhe estetike
Lisi i Konjatit	III	ndodhet në Nja-në Dushk, në fshatin Konjat	Estetike
Burimet termominerale të Karbunarës	III	Lartësia mnd: 50m Numri burimeve: 4-5 Gjatësia: 5m Gjerësia: 3m Thellësia: 30-35cm Përdoren nga banorët për	Shkencore (gjeologjike dhe hidrologjike), kulturore, turistike e didaktike

		banjo kurative	

Burimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

Figura 81. Zonat e mbrojtura në Bashkinë Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN, 2016

Parku natyror "Manastiri i Ardenicës": në park gjenden dy monumente natyre si Selvitë e Manastirit (Monument Natyre Kategoria III)[221] dhe Dushkajat e Manastirit (Monument Natyre Kategoria III)[222]. Manastiri ndodhet në afërsi të Nja-së Kolonjë e cila arrihet nga kryqëzimi i rrugës së Kolonjës nëpërmjet rrugës Lushnje-Fier. Selvitë e Manastirit të Ardenicës kanë një lartësi nga 10 në 15m, ndërsa diametri i trungut arrin 60-80 cm[223]. Këto drurë mendohet të jenë mbjellë aty me ndërtimin e Manastirit.

Krahas statusit të mbrojtur, banorët e zonës i cilësojnë këto dru si të shenjtë, gjë që i ka ruajtur ato nga veprimtari të ndryshme ekonomike. Disa pre tyre kanë dëmtime të lehta të shkaktuara nga shkarkimet atmosferike. Këto drurë kanë vlera biologjike, estetike dhe fetare me rëndësi lokale.

Gjithashtu, Dushkajat e Manastirit[224] shtrihen në afërsi të Manastirit, brenda Parkut natyror, në shpatin lindor të kodrës së Ardenicës, disa dhjetra metra pranë hyrjes së Manastirit. Lartësia e dushkajave është përafërsisht 10m[225] dhe diametri ndryshon nga 35 deri në 60cm. Kjo zonë ka vlera biologjike dhe estetike me rëndësi lokale.

Ky pyll me dushqe, krahas studimeve të tjera, është një tregues që kodrat e Ardenicës kanë qënë të veshura me pyll dushku. Në këtë pyll gjenden dhelpra, lepuj dhe shumë shpendë të ndryshëm.

Figura 82. Selvitë e Manastirit dhe Dushkajat



Burimi: AKZM, 2016

Rrapi i Zonjës:[226] ndodhet në veri të qendrës së fshatit Bubullimë, brenda një parcele toke bujqësore private. Para 20 vitesh, rrapi ka qënë në gjendje shumë të mirë. Me kalimin e kohës ai është dëmtuar rëndë kryesisht nga ndërhyrjet e njeriut dhe nga shkarkimet atmosferike (rrufetë).

Aktualisht, trungu ka mbetur vetëm 4 m i lartë dhe ka një gjerësi prej 2m. Filizat e rinj që kanë dalë arrijnë lartësinë deri në 5-6m. Ky rrap është dru i rrallë në këtë zonë dhe ka vlera biologjike dhe estetike.

Figura 83. Rrapi i Zonjës



Burimi: AKZM, 2016

Lisi i Konjatit:[227] është një tjetër monument natyre, i cili ndodhet në Nja-në Dushk, në fshatin Konjat.

Burimet termominerale të Karbunarës:[228] ndodhen në pjesën lindore të fshatit me të njëjtin emër, në rrëzë të një kodrine, 10m mbi shtratin e përroit që vjen nga Karbunara e Vogël, në lartësinë 50 m mbi nivelin e detit. Në rrëzen e shpatit të kësaj kodre dalin 4-5 burime të tilla, dy prej të cilëve janë më të mëdhenj. Uji ka përmbajtje të lartë gazi sulfidrik dhe del nga thellësia e nëntokës. Afër burimeve janë krijuar disa gropa të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e ujit të burimit. Dy gropat e paraqitura më poshtë, për shembull, të këtij burimi (Figura 84) kanë gjatësi 5m dhe gjerësi 3m dhe arrijë thellësinë 30-35 cm.[229] Banorët i kanë shfrytëzuar këto gropa vazhdimisht për banjo kurative. Burimet kanë vlera shkencore (gjeologjike dhe hidrologjike), kulturore, turistike e didaktike.

Figura 84. Burimi termominerar Karbunarë



Burimi: AKZM, 2016

Kohët e fundit Burimet e Karbunarës janë lënë në gjendje katastrofike[230], mes mbetjeve dhe bimësisë e shkurrishteve dhe me vaska të dala jashtë përdorimit. Aktualisht, vetëm një vaskë është në përdorim, ndërkohë që dalja e ujit është bllokuar. Përpara shumë vitesh, ky burim shfrytëzohej nga banorët ndërkohë që sot, për shkak të gjendjes së keqe në të cilën ndodhet, e ka humbur këtë funksion.

Figura 85. Burimet termominerale të Karbunarës



Burimi: AdZM Fier, 2016

Figura 86. Burimet termominerale të Karbunarës



Burimi: AdZM Fier, 2016

- Problematikat kryesore të ZM-ve

AKZM-ja dhe AdZM-ja janë duke bërë përpjekje serioze në drejtim të manaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në Bashkinë e Lushnjes. Megjithatë, problematikat mbeten ende të shumta, ndër të cilat përmendim:

Prerjen abzsive të pemëve në zonat e mbrojtura, apo të pemëve të caktuara, të cilat kanë status mbrojtës. Këtu përmendim Rrapin e Zonjës i cili ka statusin e Monumentit të Natyrës. Gjatë gjithë kohës, në këtë rrap është ushtruar presion me prerje dhe dëmtime të ndryshme (dhe si pasojë e shkarkimit të rrufesë). Aktualisht, trungu është vetëm 4 m i lartë.

Rrezikun e përhapjes së zjarreve i cili është i pranishëm pothuajse në të gjithë sezonin verore pasi territori i Bashkisë Lushnje përballet me kushte klimatike të nxehta dhe të thata gjatë gjithë verës.

Manaxhimin joefektiv të aktiviteteve turistike/fetare që kryhen në zonën e Ardenicës. Në përfundim të këtyre aktiviteteve, njerëzit lënë pas grumbuj mbetjesh të ngurta, të cilat shpërndahen në të gjithë zonën që vizitohet. Problemi theksohet edhe më shumë në kohëra me erë të fortë.

Kullotjen është një problem serioz për zonat e mbrojtura në të gjithë vendin. Në territorin e Bashkisë Lushnje nuk ka një studim që tregon kapacitetin kullotës të zonave të caktuara.

Erozionin është fenomen i pranishëm në zonat kodrinore malore, kryesisht erozioni i shpateve të zhveshura, apo në brigjet e përrenjve.

- Përfundime e rekomandime

Bashkia Lushnje është e pasur me monumente natyre të shumëllojshme të kategorisë III, të cilat përbëjnë një pasuri të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit në Bashki. Për më tepër, në Bashki gjendet edhe Rezervuari i Thanës/Murrizit, i cili përbën një habitat të rëndësishëm për biodiversitetin ujor në vend. Nëse ruhet dhe mirëmbahet, ky rezervuar mund të shndërrohet në motorin kryesor të zhvillimit ekonomik të

zonave përreth. Megjithatë, këto burime natyrore kanë pësuar dëmtime dhe kanë nevojë për manaxhim.

Duke patur parasysh, që monumentet e natyrës janë të rëndësishme, jo vetëm sepse mbartin në vetvete vlera biologjike dhe kulturore, por edhe sepse mund të favorizojnë zhvillimin e ekonomisë në Bashki nëpërmjet turizmit, rekomandohet që organet kompetente në Bashki të tregojnë një kujdes të veçantë, përpara se ato të humbin vlerat biologjike dhe peizazhistike që mbartin. Më konkretisht, rekomandohet bashkëpunimi i Bashkisë Lushnje me AdZM-në Fier për mbrojtjen dhe zhvillimin e monumenteve të natyrës nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve të manaxhimit për çdo monument, hartimin e planit të emergjencave për zjarre dhe rreziqe të tjera ,si dhe bashkëpunimin me universitetet të ndryshme me qëllim promovimin e vlerave shkencore, biologjike e kulturore të monumenteve të manaxhuara dhe zhvillimin e eko-turizmit dhe aktiviteteve të tjera që mundësojnë mbledhjen e të ardhurave financiare për manaxhimin e tyre. Njëkohësisht, rekomandohet edhe vlerësimi i Rezervuarit të Thanës dhe promovimi i vlerave të tij, si habitat i veçantë biodiversiteti ujor.

4.5.4 Biodiversiteti

Sipas Ligjit nr. 9587/2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit", me biodiversitet ose larmi biologjike nënkuptojmë shumëllojshmërinë e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë[231]. Ky term përfshin shumëllojshmërinë brenda dhe ndërmjet llojeve dhe shumëllojshmërinë e ekosistemeve.

Shqipëria është një vend i vogël. Megjithatë, ajo dallohet për larmi të peizazheve dhe larmi biologjike[232], duke u radhitur në vendet e Europës që shquhen për biodiversitet të lartë. Pjesa e Ultësirës Perëndimore është më e rëndësishme nga pikëpamja e biodiversitetit dhe larmishmërisë së tij, e cila shtrihet përgjatë zonës bregdetare nga qyteti i Vlorës në jug e deri tek liqeni i Shkodrës në veri. Përveç faktit që kjo është një zonë bregdetare, Ultësira përshkohet nga lumenjtë kryesorë të vendit të cilët rrjedhin nga lindja në perëndim. Vija bregdetare arrin gjatësinë 476km.[233] Zona veriore e vendit ka një reliev malor, ku karakterizohet nga diversitet i formacioneve shkëmborë, që nga koha e Paleozoikut. Klima në Shqipëri përbëhet nga katër zona klimatike dhe 13 nënzona, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në biodiversitetin e pasur që ka vendi.[234]

Shqipëria ka një shumëllojshmëri të ekosistemeve dhe habitateve. Në territorin e vendit gjenden ekosistemet detare, zonat bregdetare, lumenjtë, liqenet, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyjet halorë dhe fletore, kullotat alpine dhe subalpine, si dhe ekosistemet e larta malore. Larmia e ekosistemeve dhe habitateve në Shqipëri mundëson një larmi të lartë të llojeve të kafshëve dhe të bimëve që rriten në to. Në Shqipëri gjenden rreth ***7,233 taksone bimore***[235] (bashkë me fiernat, likenet, kërpudhat, myshqet dhe algat) dhe ***5,438 lloje kafshësh***[236] (përfshirë shpendë gjitarët, zvarranikët, insektet, peshqit, etj.). Bimët me lule dhe algat mikroskopike janë grupi përfaqësues më i larmishëm dhe i pasur i llojeve të rradha, relike dhe endemike. Kjo për shkak të elementeve floristike të rajoneve.

Pyjet zënë rreth 33% të territorit, ose 1,041,000 ha, ndërsa *kullotat* zënë rreth 15% të sipërfaqes së territorit (400,000 ha). Pyjet dhe kullotat kanë një larmi të llojeve dhe komuniteteve shtazore dhe atyre bimore.[237] Pyjet e larta strehojnë kryesisht gjitarët e

mëdhenj si ujku, rrëqebulli, ariu, dhia e egër, si dhe shpendë të ndryshëm të cilët janë të lidhur me jetesën në pyjet e virgjëra. *Liqenet* e mëdha të vendit dhe lagunat bregdetare janë vendbanimet më të rëndësishme për shpendët, veçanërisht për dimërimin e atyre migratorë. Në këto hapësira, prej vitesh numërohen rreth 70 lloje shpendësh uji, të cilët përbëjnë një popullsi që arrin deri në 180,000 individë gjatë dimrit.[238] Shqipëria është edhe një kryqëzim i rrugëve të rëndësishme për shpendët migratore dhe insektet.[239]

- Speciet e rrezikuara në rang vendi


Në territorin e vendit gjenden rreth *91 lloje të kërcënuara speciesh në nivel global*. Në këtë listë përfshihen pelikani kaçurrel (Crispus crispus), breshka shqiptare e ujit (Pelophylax shqipericus) dhe blini (Acipenser sturio), për të cilat Shqipëria është një vend i rëndësishëm.[240] Sipas IUCN,[241] 109 lloje kafshësh të grupeve të ndryshme taksonomike janë konsideruar si të kërcënuara. Lista e llojeve të bimëve të kërcënuara në vendin tonë e kalon atë të kafshëve, duke arritur shifrën 319 nga të cilat 76 janë të kërcënuara në formë kritike, 123 lloje konsiderohen në rrezik, dhe 120 lloje të përkeqësuara.

Tabela 33. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në Shqipëri

Kategoritë IUCN	Numri i llojeve të florës	Numri i llojeve të shpendëve
EX – të zhdukura	0	5
CR – të rrezikuara në mënyrë kritike	76	43
EN – të rrezikuara	123	56
VU – të pambrojtura	120	154
LR – rrezik i ulët	59	238
DD – mungojnë të dhëna	30	72
NE – të pavlerësuara	3	7

Burimi: Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2016[242].

Figura 87. Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në shkallë vendi



Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2016[243]. Punoi: Co-PLAN

Lista e Kuqe e faunës dhe florës së egër është miratuar në dhjetor 2013, me Urdhër të Ministrit Nr. 1280, datë 20.11.2013. Llojet e mbrojtura të florës janë 402 nga 361 që ishin në Listën e Kuqe paraprake të vitit 2007. Llojet e mbrojtura të faunës janë 575, i njëjti numër me listën e vitit 2007.

- Biodiversiteti në Bashkinë Lushnje

Bashkia Lushnje ndodhet në Ultësirën Perëndimore të Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 372.72 km^2. Relievi është kryesisht fushor me zona të kufizuara

kodrinore të pozicionuara në verilindje të bashkisë në lartësi 200-240 mbi nivelin e detit. Sistemi natyror në Bashkinë Lushnje që shërben si habitat për biodiversitetin zë 1/10 e sipërfaqes totale të kësaj Bashkie. Sistemet natyrore shtrihen kryesisht në lindje, në pjesën kodrinore të saj. Bashkia ka një sipërfaqe pyjore në pronësi me rreth 822.62 ha, e cila shërben si habitati kryesor për biodiversitetin.

Në Bashkinë Lushnje, numri i specieve floristike dhe faunistike që rriten në territor nuk njihet. Megjithatë, njihet me përafërsi numri i specieve të rrezikuara. Sipas Librit të Kuq të florës së Shqipërisë, në territorin e Bashkisë gjenden 55 specie të rrezikuara (Tabela 34) dhe i përkasin kryesisht familjes së fluturave dhe shpendëve. Ndër to dallohen Asteri Shqiptar *(Aster Albanicus)* dhe Salepi Shqiptar *(Orchis Albanica* që janë individë shumë të rrallë. Kryesisht, rreziku i humbjes së specieve vjen si rrjedhojë e aktiviteteve antropogjene ,gjë që ka çuar në humbjen e habitateve.

Tabela 34. Numri i specieve të rrezikuara të florës e faunës në Shqipëri dhe Lushnje.

Flora dhe fauna e rrezikuar				
Kategoritë Taksonomike	Nr. total i specieve në vend	Nr. specieve të rrezikuara në vend	Nr. specieve të rrezikuara Bashkia Lushnje	% specieve të rrezikuara Bashkia Lushnje
Kërpudha	800	16	**2**	12,5
Bimësi	3,228	363	**7**	1,9
Insekte	680	108	**15**	13,8
Peshq	311	61	**0**	-
Amfibë	15	15	**4**	26
Zvarranikë	37	37	**3**	8,1
Shpendë	330	120	**22**	18,3
Gjitarë	91	46	**2**	4,3
Totali	5,492	766	**55**	7,2

Burimi: Libri i kuq i florës dhe faunës shqiptare – 2007; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

- Fauna në Bashkinë Lushnje

Në territorin e Shqipërisë numërohen rreth 330 lloje shpendësh, ku një pjesë e tyre popullojnë zonën perëndimore të Bashkisë Lushnje. Numri i tyre i saktë nuk njihet megjithatë, në bashki rriten lloje të ndryshme si urithi, çakalli, nusja e lalës, dhelpra, thëllëza, sorra, si dhe disa lloje zvarranikësh. Bashkia Lushnje gjendet edhe pranë Lagunës së Karavastasë në Divjakë, e cila përbën habitatin kryesor të shpendëve në Shqipëri. Këtu veçohet shpendi më i madh në Europë (pelikanit kaçurrel – *Pelecanus Crispus*). Gjatësia e tij luhatet nga 1.6-1.8m dhe me hapjen e krahëve arrin rreth 2.7-3.2 m. Ky shpend folezon rregullisht në Divjakë-Karavasta. Ushqimi i tij kryesor mbeten peshqit.

Në vitet e fundit, fauna është rrezikuar nga ndërhyrje të ndryshme të njeriut në habitatet e tyre. Këto përfshijnë shndërrimin e vazhdueshëm të tokave natyrore në toka bujqësore, e cila ka ndikuar në zvogëlimin e sipërfaqes së habitateve dhe uljen e numrit të llojeve taksonomike në këtë territor. Problematike në të njëjtën kohë mbetet edhe plehërimi i tokave me kimikate të forta, i cili ndikon në cilësinë e ushqimit të shpendëve dhe në vetë bimësinë rajonale.

- Flora në Bashkinë Lushnje:

Zona e Bashkisë Lushnje karakterizohet edhe nga një larmishmëri shkurresh mesdhetare makje. Në nënkatin e shkurreve makje dallohen shkurret që qëndrojnë të gjelbëra gjatë gjithë vitit si marea, etj. Në këtë nënkat të bimësisë rriten edhe pemë të larta si pisha e butë dhe e egër, selvia dhe shqema, të cilat në disa raste formojnë zona të vogla pyjore.

- Problematikat e biodiversitetit në Bashkinë Lushnje

Për sa i përket gjendjes ekzistuese të biodiversitetit në Lushnje, kemi të bëjmë me një realitet jo të pëlqyeshëm pasi fokusi është i përqëndruar totalisht në Divjakë. Pjesa më e madhe e territorit të Bashkisë Lushnje shfrytëzoht për bujqësi. Numri i përgjithshëm i specieve të florës e faunës që popullojnë territorin e bashkisë nuk njihet, në një kohë kur 11.6% e territorit të saj është e përcaktuar si Sistem Natyror. Aktualisht, ndalimi i gjuetisë dhe prerjeve të pyjeve nëpërmjet miratimit të moratoriumit 5 dhe 10-vjeçar përkatësisht, mendohet së do të sjellë një ndikim pozitiv në mbrojtjen e biodiversitetit dhe shtimin e numrit të specieve brenda territorit të bashkisë.

Kërcënimet kryesore ndaj biodiversitetit në Shqipëri, në periudha të ndryshme kohore paraqiten të ndryshme por ndërhyrjet e njeriut janë kryesoret ndër më kryesoret renditen:

- Zhvillimi industrial dhe pasojat e ish-aktiviteteve industriale, kanë qënë kontribuesit kryesorë të ndotjes së ajrit dhe ujit. Aktualisht, gjendja paraqitet më e stabilizuar, pasi industritë në territorin e bashkisë kanë ulur kapacitetin e tyre prodhues ndjeshëm.
- Urbanizimi: kërkesa gjithnjë e në rritje për zona banimi, ku në dy dekadat e fundit kjo kërkesë është reflektuar në shtimin e zonave urbane informale dhe në shpërhapje të ndërtimeve përgjatë gjithë territorit duke zënë sipërfaqe të zonave natyrore e bujqësore.
- Fragmentimi i habitateve nga ndërtimi i infrastrukturës rrugore apo i veprave të ndryshme ka çuar në fragmentimin e habitateve ose ndërprerjen e vazhdueshmërisë së zonave natyrore që vjen si rrjedhojë e ndërtimit të infrastrukturës në toka bujqësore e natyrore, pa marrë parasysh parimet e mbrojtjes së mjedisit. Kjo vihet re edhe nga një analizë e thjeshtë e përdorimit të tokës në Territorin e Bashkisë Lushnje. Fragmentimi në vetvete sjell zvogëlimin e sipërfaqes së habitatit të florës e faunës dhe izolimin e tyre në njësi të vogla habitati, duke penguar lëvizjen e lirë të kafshëve të ndryshme. *Bypass*-i i Lushnjes apo rrugët rurale në kodër janë ndër veprat e tilla kryesore që kanë sjellë prerjen e zonës bujqësore dhe natyrore. Gjatë gjithë gjatësisë së autostradës nuk janë ndërtuar ura ekologjike ose mjete të tjera që shërbejnë për lëvizshmërinë e faunës nga njëra anë në tjetrën në raste të tilla.
- Mungesa e lidhjes së habitateve kryesore të vendit si Zona e Lagunës së Karavastasë me pjesën natyrore të Lushnjes. Fatkeqësisht, nuk ekziston asnjë korridor tokësor për faunën që të mund të komunikojë me këto zona. Të vetmet specie të cilat arrijnë të zhvillohen normalisht janë shpendët.

- Gjuetia e jashtëligjshme ka pasur një ndikim të ndjeshëm në biodiversitet, gjë që ndihet edhe sot, pas dy viteve të ndalimit të saj (moratoriumi i gjuetisë). Për fat të mirë, moratoriumi është zgjatur edhe për 5 vite të tjera.
- Zhvillimi i bujqësisë së shkallës: zhvillimi i bujqësisë, ka qenë kërcënimi kryesor ndaj biodiversitetit gjatë sistemit të kaluar (periudha e regjimit komunist), hapja e tokave të reja bujqësore, shpyllëzimi për këtë qëllim dhe përdorimi i kimikateve bujqësore. Aktualisht, ky mbetet një problem i trashëguar edhe pse disa nga tokat bujqësore të përftuara nga tarracimet masive të viteve 1980-90, të cilat nuk u përdorën më për funksione bujqësore, po rikthehen në gjendjen e mëparshme natyrore. Sot, bujqësia ndikon ndjeshëm në biodiversitet, kryesisht nëpërmjet përdorimit në mënyrë të pakontrolluar të pesticideve dhe plehrave kimike, duke u kthyer në sektor ndotës, kryesisht për rrjedhat ujore.
- Shpyllëzimi ka qënë dhe mbetet një problem kryesor i prishjes së habitateve. Në dy dekadat e kaluara, krahas prerjeve për lëndë drusore dhe djegëse, shpyllëzimeve masive ndodhnin për hapjen e tokave bujqësore. Aktualisht, qeveria shqiptare ka vendosur një moratorium 10-vjeçar me qëllim ripërtëritjen e fondit pyjor në vend.
- Kullotja e bagëtisë, në përgjithësi ka një ndikim negativ në zhvillimin e bimësisë, kryesisht në bimët dhe shkurret e ulëta të cilat shërbejnë si ushqim për bagëtinë. Në territorin e Lushnjes nuk ka një studim të mirëfilltë mbi kapacitetin mbajtës të kullotave. Si rrjedhojë, nuk dihet ndikimi i kullotjes në këtë zonë.
- Ndërhyrje të tjera si mbledhja për tregtimi, balsamimi, përdorimi si orendi shtëpiake, etj.

Tabela 35. Speciet ne rrezik zhdukjeje të faunës në Bashkinë Lushnje[244]

Emërtimi në Latinisht	**Emërtimi në shqip**	**Rreziku**	**Foto**
Helix Lucorum	Kërmilli i shkurreve	Tregtimi	
Erynnis Marloyi	Pikëbardha kafe	Prishja e habitatit, koleksionimi	
Pyrgus Armoricanus	Pirgusi i berturit	Prishja e habitatit, koleksionimi	

Danaus Chrysipus	Shtegëtarja Krisipus	Prishja e habitatit, koleksionimi	
Libythea Celtis	Caracja	Koleksionim dhe dëmtimi i habitatit	
Hipparchia Alcyone	Gurishtorja	Ndotja dhe prishja e habitatit	
Neohipparchia Statilinus	Statilinia	Dëmtimi dhe prishja e habitateve, koleksionimi	
Charaxes Jasius	Dybishtakja Jasius	Koleksionimi	
Azuritis Reducta	Admiralja njollëbardhë	Dëmtimi dhe prishja e habitateve, koleksionimi	
Nymphalis Polychloros	Shumëngjyrshja	Dëmtimi dhe prishja e habitateve, koleksionimi	
Santurnia Pyri	Sypalloi i madh i natës	Koleksionim intensiv	

Tyria Jacobaeae	Trashaluqja e gjakosur	Prishja e habitateve, specie të futura (invazive)	
Dorcus Parallelopipedus	Durkusi paralelopiped	Koleksionimi dhe prishja e habitatit, bujqësia e shkallës	
Meloë Proscarabeus	Proskarabeusi	Bujqësia e shkallës, plehrimi	
Rosalina Alpina	Rosalina	Prishja e habitatit	
Emys Orbicularis	Breshkuçja	Ndotja e habitateve, shqetësimi dhe dëmtimi	
Mauremys Clemus	Breshkuçja Klemus	Dëmtimi fizik dhe shqetësimet	
Crytodactylus Kotschyi	Gekonidi i Kotsiçit	Shqetësimet dhe dëmtimi i habitatit	
Nemachilus Barbatulus	Tufëza	Mbishfrytëzimi i baseneve të ëmbla, gjuetia në sezon riprodhimi/mbarëështimi	
Goblo Gobio Lepidolaemus	Barburiqi	Mbishfrytëzimi i baseneve të ëmbla, gjuetia në sezon riprodhimi/mbarëështimi	

Ablepharus Kitaibelii	Zhapiku këmbëvogël	Shqetësime fizike	
Ophisarus Apodus	Bullari	Shqetësime dhe dëmtime fizike	
Elaphe Quatrolineata	Bolla me 4 vija	Dëmtime nga frika	
Elaphe Situla	Gjarpri laraman	Shkatërrimi i habitatit, shqetësime dhe dëmtime fizike	
Phalacrocorax Pygmeus	Karabullaku i vogë	Gjuetia ilegale, shqetësimi nga njeriu	
Botarus Stellari	Gakthi	Gjuetia ilegale, shqetësimi nga njeriu	
Ardeola Ralloides	Çafka e verdhë	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vëndeve të folezimit, gjuetia	
Egretta Garzetta	Çafka e vogël e bardhë	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vëndeve të folezimit, gjuetia	

Ciconia Nigra	Lejleku i zi	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vëndeve të folezimit, gjuetia	
Buteu buteo	Huta	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vëndeve të folezimit, gjuetia	
Haliaeetus Albicila	ShqipoNja e detit	Dëmtimi i vendfolezimit	
Circateus Gallicus	ShqipoNja gjarpërngrënëse	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vëndeve të folezimit, gjuetia	
Accipiter Gentilis	Gjeraqina	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vëndeve të folezimit, gjuetia	
Aquila Heliaca	ShqipoNja perandorake	Pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vëndeve të folezimit, gjuetia	
Falco Peregrinus	Krahëthati	Gjuetia nga njeriu.	
Apus Apus	Dejka	Dëmtimi i folesë, shqetësimi human	
Tyto Alba	Kukuvajka mjekroshe	Balsamimi	

Apus Pallidus	Dajaka e zbehtë	Dëmtimi i folesë, shqetësimi human	
Merops Apiaster	Gargulli	Gjuetia për tregtim, shqetësimi	
Coracias Garrulous	Grifsha e detit	Dëmtimi i habitateve	
Upua Epops	Pupëza	Gjuetia për tregtim, shqetësimi	
Jynx Torquilla	Qafëdredhësi	Gjuetia sportive, shqetësimet nga njeriu	
Picus Canus	Qukapiku i përhimtë	Gjuetia për balcamim, shqetësim	
Picus Virdis	Qukapiku i gjelbër	Gjuetia dhe shqetësime humane	
Densdrocopos Leucotos	Qukapiku larosh	Shqetësime humane dhe gjuetia	

Parus Palustris	Trishtili i vogël	Dëmtimi dhe shqetësimi i habitateve	
Suncus Etruscus	Hundgjati i vogël	Nuk dihet shumë	
Mus Spicilegus abbotti	Miu i stepave	Njohuri të pamjaftueshme	
Canius Aureus	Çakalli	Zvogëlimi i habitateve	

Burimi: Libri i Kuq i Faunës Shqiptare; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Tabela 36. Speciet ne rrezik zhdukjeje të florës në Bashkinë Lushnje[245]

Ephedra Distachia	Gjunjëza	Aktiviteti antropoik	
Hypericum Perforatum	Lulebasani	Mbikullotja, bujqësia	
Juniperus Communis	DëlliNja e zezë	Shfrytëzimi pa kriter	
Juniperus Oxycedrus	DëlliNja e kuqe	Shfrytëzimi pa kriter	

Panctratium Maritimum	Zambaku i detit	Veprimtaria antropike	
Aster Albanicus	Asteri shqipëtar	Individ mjaft i rrallë	
Orchis Albanica	Salepi shqiptar	Individ i rrallë	
Clathrus Ruber	Kërpudha e kuqe	Dëmtim habitati	
Myriostoma Coliforme	Poç piperi	Dëmtim habitati	

Burimi: Libri i Kuq i Florës Shqiptare; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

- Përfundime dhe rekomandime

Bashkia Lushnje ka një reliev kryesisht fushor me zona të kufizuara kodrinore të pozicionuara në verilindje të bashkisë në lartësi 200-240 mbi nivelin e detit. Sistemi natyror në Bashkinë Lushnje, që shërben si habitat për biodiversitetin, zë 1/10 e sipërfaqes totale të kësaj Bashkie. Sistemet natyrore shtrihen kryesisht në lindje, në pjesën kodrinore të saj. Bashkia ka në pronësi një sipërfaqe pyjore me rreth 822.62 ha e cila shërben si habitati kryesor për biodiversitetin. Në territorin e Bashkisë rriten një numër i madh speciesh faunistike dhe floristike edhe pse numri i tyre i saktë nuk njihet. Megjithatë, Bashkia dallohet për shpendët duke qenë se gjendet edhe pranë Lagunës së Karavastasë. Në Bashki gjendet edhe një numër relativisht i lartë i specieve të rrezikuara (55).

Për fat të keq, gjatë dy dekadave të fundit, bimësia dhe bota shtazore janë dëmtuar si rezultat i ndërhyrjeve të njeriut (mosmanaxhimit të zonave natyrore, dëmtimit dhe fragmentimit të habitateve, gjuetisë dhe mbledhjes së bimëve mjeksore pa kriter, etj.) dhe faktorëve natyrorë (mungesës së masave specifike për mbrojtjen e biodiversitetit dhe mungesa e manaxhimit të zonave natyrore etj.). Si rrjedhojë, shumë shpezë e kafshë të egra po shkojnë drejt zhdukjes.


Me qëllim ruajtjen e biodiversitetit në këtë zonë, është e rëndësishme që të merren masa urgjente për mbrojtjen e biodiversitetit në përgjithësi dhe të kafshëve që rrezikojnë të zhduken në veçanti. Për këtë arsye, *rekomandohet që Bashkia të bashkëpunojë me Ministrinë e Mjedisit dhe të Bujqësisë i) për ruajtjen e biodiversitetit dhe për përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij, në nivel vendor, duke zbatuar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin, ii) për hartimin e planeve të veprimit për ruajtjen e llojeve veçanërisht të mbrojtura, të regjistruara me status ruajtjeje të pafavorshëm, iii) për hartimin e planeve dhe procedurave të veprimit për manaxhimin e rasteve të papritura nga veprimtaritë njerëzore. Gjithashtu, është e rëndësishme që Bashkia të hartojë një plan manaxhimi për mbojtjen e zonave natyrore brenda territorit të saj.*

4.6 Toka

4.6.1 Përdorimi i tokës[246]

Nga dixhitalizimi i kryer në kuadër të përgatitjes së PPV-së,[247] kategoria mbizotëruese e përdorimit të tokës është ajo ***bujqësore*** e cila zë rreth 77 % të territorit të bashkisë, ose 289 km^2.

Figura 88. Sistemet e territorit, Bashkia Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN

Zë i rëndësishëm në këtë analizë janë ***zonat natyrore*** me një sipërfaqe prej 43.7 km^2. Këto zona shtrihen përgjatë zonës kodrinore të Bashkisë Lushnje, në pjesën veriperëndimore të saj dhe karakterizohen nga zona me shkurre të dendura.

Kategoria ***banim*** renditet e katërta për nga sipërfaqja totale që zë në territor, me vetëm rreth 22 km^2, përfshirë këtu dhe kategoritë e përziera. Karakteristikë e zonave të banuara për Bashkinë Lushnje është shpërndarja e tyre në territor, kryesisht në zonën rurale, ku shpeshherë kanë fragmentarizuar tokën bujqësore. Gjendja duket më e konsoliduar në zonat urbane, ku dhe dendësia e banimit është më e lartë.

Zonat e ***shërbimit, argëtimit*** dhe ***institucionet*** gjenden përgjithësisht në qytetin e Lushnjes, në pjesën qendrore të tij, pranë arterieve kryesore të rrugëve. Objektet arsimore dhe shëndetësore janë shpërndarë thuajse në çdo zonë të banuar të bashkisë, duke ofruar në të njëjtën kohë një mbulim të mirë me këto shërbime[248].

Tabela 37. Shpërndarja në përqindje e sistemeve të territorit, Bashkia Lushnje

Sistemet	%
Sistemi urban	6.63
Sistemi bujqësor	77.27
Sistemi natyror	11.57
Sistemi infrastrukturor	2.25
Sistemi hidrografik	2.04

Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN

4.6.2 Toka Bujqësore dhe bujqësia

Territori i Bashkisë së Lushnjes është pjesë e ultësirës së Myzeqesë dhe ka rreth 289 km^2 tokë bujqësore.[3] Toka bujqësore[249] shfrytëzohet për prodhimin e drithërave, kryesisht grurë, misër dhe tërshërë, prodhimin e perimeve, patateve, fasuleve dhe foragjerëve, së bashku me drurët frutorë (pemët, ullinjtë, agrumet dhe vreshtat). Për nga sipërfaqja, në Bashki, foragjeret, gruri dhe ullinjtë zënë sipërfaqen më të madhe të territorit me përkatësisht 1,747 ha, 580 ha dhe 506 ha (Figura 26).


Tabela 38. Sipërfaqja e tokës së punuar dhe prodhimtaria në Lushnje

Kultura	Kulturat	Sipërfaqja (ha)	Prodhimi (ton)
Drithëra	Grurë	580	2,320
	Misër	220	1,585
	Tërshërë	50	120
Perime	Perime	95	4,420
	Patate	20	320
	Fasule	85	160
	Foragjere	1,747	66,890
Dru frutorë	Pemë	63	575
	Ullinj	506	510

	Agrume	9	144
	Vreshta	36	1,090
Totali Sipërfaqes (tokë e punuar)		3,418	78,134

Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN

Figura 89. Kulturat kryesore bujqësore në Bashkinë e Lushnjes (në ha)



Burimi : Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN

Në Bashkinë e Lushnjes banorët merren edhe me rritjen e gjësë së gjallë kryesisht lopë, dele dhe dhi. Për nga numri, lopët zënë vendin e parë me 1,005 krerë, të ndjekura nga dhitë me 450 krerë dhe delet me 430 krerë.

Bujqësia është mjaft e rëndësishme për pothuajse të gjithë territorin me përjashtim të zonës urbane (qytetit). Sipas klasifikimit të Censusit 2011, Bashkia e Lushnjes ka qytetin e Lushnjes si qendër rajonale, 6 njësi administrative (Nja) bujqësore fushore (Allkaj, Bubullimë, Hysgjokaj, Karbunarë, Ballagat) dhe 4 njësi administrative kodrinore (Golem, Dushk, Ballagat Hysgjokaj, Fiershegan)[250]të cilat mbajnë peshën kryesore të zhvillimit të bujqësisë në zonën e bashkisë (Tabela 39).

Tabela 39. Ndarja e bashkive sipas sektorit ekonomik dhe pjerrësisë së relievit

Nr.	Bashkia	Nr. Banore	% Banore	Tipologjia
1	Lushnje	31105	37	Qendër rajonale e aglomerateve (Qender aglomerati >20,000 banore)
2	Allkaj	4319	5	Njësi vendore bujqësore fushore (Bujqësia > 84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%)
3	Bubullimë	5548	7	Njësi vendore bujqësore fushore (Bujqësia > 84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%)
4	Hysgjokaj	2603	3	Njësi vendore bujqësore fushore (Bujqësia > 84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%)
5	Golem	5243	6	Njësi vendore bujqësore mikse fushore (Bujqësia midis 65-84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%)
6	Dushk	7872	9	Njësi vendore bujqësore mikse fushore (Bujqësia midis 65-84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%)
7	Karbunarë	4193	5	Njësi vendore bujqësore fushore (Bujqësia > 84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%)
8	Ballagat	2461	3	Njësi vendore bujqësore fushore (Bujqësia > 84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%)
9	Fier Shegan	7023	8	Njësi vendore bujqësore fushore (Bujqësia > 84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%)
10	Kolonjë	5728	7	Njësi vendore bujqësore mikse fushore (Bujqësia midis 65-84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%)

11	Krutje	7564	9	Njësi vendore bujqësore fushore (Bujqësia > 84%; Sipërfaqja e pjerrët < 45%)

Burimi: INSTAT, 2012; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Sipas tabelës së mësipërme, të paktën 62% e popullsisë ka si aktivitet bazë bujqësinë, por shifra mund të jetë edhe më e lartë, nëse llogaritjet kryhen sipas deklarimeve të punësimit e jo klasifikimit tipologjik të bashkisë.

Tokat bujqësore të Lushnjes karakterizohen nga cilësia e lartë e dheut dhe prodhueshmëria e lartë. Këtë e tregon edhe boniteti i tokave. Pothuajse të gjitha tokat e bashkisë bëjnë pjesë në kategorinë I-III me përjashtim të tokave të fshatrave Kupas e Mollas tokat të cilat klasifikohen si të kategorisë IV.[251] Produktet më të kultivuara janë perimet dhe frutat, të cilat kultivohen kryesisht në pjesën jug-perëndimore. Zona verilindore zihet kryesisht nga ullishtat dhe vreshtat. Bashkia e Lushnjes mbart edhe numrin më të madh të serave bujqësore në vende të shtrira në të gjithë territorin e bashkisë dhe kategorizohen si pjesë e përdorimit bujqësor të tokës.

- Problematikat e tokave bujqësore në Bashkinë Lushnje:

Erozioni i tokave bujqësore, shkarjet, shembjet: Ndërsa në vendin tonë rreziku potencial i erozionit konsiderohet mesatar dhe i lartë, në rrethin e Lushnjes fatmirësisht konsiderohet mesatar (Tabela 40).[252]

Tabela 40. Vlerësim teorik për nivelin e erozionit në tokat bujqësore të Shqipërisë.

Rrethet	Sip (Ha)	Indeksi i erodibilitetit				Indeksi i rrezikut potencial të tokës		
		Absol.	Rel.	Indeksi i erozionit të tokës	Indeksi i pjerrësisë	Absol.	Rel.	Vlerësimi
Lushnje	46,136	5.7	2	2	1.60	6.4	2	Mesatar
Fier	60,674	6.7	3	3	1.68	15.1	3	I lartë

Burimi: AKM, 2013

Edhe pse Fieri dhe LushNja renditen si zona me tregues të ulët erozioni vjetor, në muajt e reshjeve të shumta erozioni arrin në 10 ton/ha/vit. Ndër zonat e prekura nga erozioni dallohet fshati Lalar dhe në zona të tjera kodrinore të njësive administrative Mbrostar dhe Portëz, ku erozioni është rritur progresivisht në vitet e fundit[253].

Shkaqet e erozionit në tokat bujqësore të kultivuara në Bashkinë e Lushnjes janë natyrore dhe të shaktuara nga ndërhyrjet e papërshtatshme të njeriut gjatë përdorimit të tokës (mungesa e praktikave të mira bujqësore). Disa nga këto ndërhyrje mund të lidhen kryesisht me zhveshjen totale të tokës gjatë plugimit, djegien e mbetjeve të bimëve të kultivuara, si praktikë e thjeshtë për pastrimin e saj, por që shkatërron plehun organik dhe zhvesh tërësisht tokën nga bimësia që shërben si masë mbrojtëse për të, lënien e tokës zhveshur ndërmjet stinëve të kultivimit, moskombinimin e kulturave bujqësore në rastin e pemtarive, kultivimin e tokave me pjerrësi të mesme e të theksuar që rezulton në rrëshqitje, ndihmuar kjo dhe nga fenomene të motit në zonat kodrinore, kultivimin e tokës bujqësore kodrinore në të njëjtin drejtim me pjerrësinë dhe me zhveshje totale të tokës, tarracimin e papërshtatshëm të zonave kodrinore-malore me zhveshje të tokës etj. Në fakt, gjatë gjithë zonës fushore dhe


kodrinore brenda territorit të bashkisë, në kohën e punimit të tokës, vihen re ngastra me tokë të punuar thellë dhe të zhveshur tërësisht nga bimësia. Kjo sepse në tokat bujqësore në Bashkinë Lushnje dhe pothuajse në gjithë vendin tonë, bujqit ose fermerët vazhdojnë të përdorin praktika bujqësore të paqëndrueshme si zhveshja e tokës nga bimësia e stinëve të mëparshme gjatë plugimit pa marrë parasysh se një gjë e tillë e varfëron tokën dhe e shndërron atë në tokë të ndjeshme ndaj erozionit, në rastin më të parë të reshjeve me intensitet të lartë apo të stuhive të erës.

Si rezultat i erozionit, mungesës së njohurisë se thelluar mbi tokën dhe praktikave të keqmanaxhimit, një nga dukuritë që po vihet re është ai i degradimit të tokës. Nuk ka shifra në nivel vendor, por në rang vendi vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014[254].

Toka në Lushnje vuan edhe nga ***përmbytje*** të vazhdueshme të shkaktuara nga Semani edhe pse ndërtimi i paneleve mbrojtëse ka ndihmuar në përmirësimin e gjendjes[255]. Sipas AKM-së, Lumi Seman përmbytet në rrjedhën e poshtme dhe në zona të caktuara të rrjedhës së mesme[256]. Përmbytjet shoqërohen me depozitime të ngurta në tokat bujqësore, gërryerje të brigjeve në Lumin Seman për shkak të mungesës së zonave ripariane dhe manaxhimit të duhur të lumit. [257]

Sipërfaqe të ndryshme të tokës në Bashki janë ***toka të kripura***, moçalore ose aluvionale. Vetëm në fshatin Plug në Nja-në Golem, për shembull, sipërfaqja e tokave të kripura arrin në 12.17 ha (Figura 90).

Figura 90. Tokat e kripura në Plug (në ha) sipas numrit të parcelave



Burimi: NjA Golem; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016


Sipërfaqja do të ishte shumë herë më e madhe në rast se do të gjendeshin të dhënat rreth tokave të kripura në rang bashkie

Përdorimi konfliktual i tokës (Figura 91): Siç e pamë më sipër, përdorimi i tokës në Bashkinë Lushnje, edhe pse është i llojeve të ndryshme (industrial, bujqësor, pyjor, etj.), nuk është i zonuar, me parimin e përdorimeve të lejuara, të ndaluara dhe të kushtëzuara.

Kjo nënkupton se ka mjaft raste kur në tokë bujqësore apo në kufi të saj ndodhen përdorime industriale ndotëse dhe që nuk janë të pajisura me barriera apo breza mbrojtës.

Për rrjedhojë, tokat e kultivuara bujqësore bashkëjetojnë me aktivitetet të tjera, ose gjenden në kufi me aktivitete tejet ndotëse, pa marrë asnjë masë për mbrojtjen e saj. Një shembull i tillë janë tokat përreth landfillit të Lushnjes i cili rrethohet me banesa dhe toka bujqësore, tokat në afërsi të puseve të naftës etj.

Figura 91. Përdorim konfliktual i tokës



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN, 2016


Nga një analizë e kryer vihen re mbivendosje të përdorimeve të tokës të cilat kanë të bëjnë kryesisht me përdorimet[258] *banim-bujqësi-industri* që vihen re kryesisht në qytetin e Lushnjes dhe në zonën naftënxjerrëse Kolonjë e Murriz. Mbivendosja e përdorimeve banim-bujqësi është e përhapur pothuajse në të gjithë territorin e bashkisë së re. Urbanizimi i tokës bujqësore në formën e lagjeve dhe fshatrave është një dukuri mjaft e përhapur, raste në të cilat është e thjeshtë të bëhet ndarja mes Kategorisë A - Banim dhe B - Bujqësi. Por ka edhe raste të urbanizimit të tokës bujqësore në mënyrë të shpërhapur, për të cilat është përdorur kategoria e përzier Banim dhe Bujqësi.

Zvogëlimi i sipërfaqes së tokës nga ndërtimet/infrastrukturat: Gjatë 20-vjeçarit të fundit, vendi ynë ka njohur një shkallë të lartë *urbanizimi* i cili ka ecur në kundërshtim me parimin e ruajtjes së tokës bujqësore. Pjesa më e madhe e ndërtimeve, edhe pse nuk kemi shifra të sakta, është shtrirë në toka bujqësore ose përreth tokave bujqësore në kufi me qytetin e Lushnjes.

Humbje të tokës bujqësore parashikohet të ndodhin edhe me ndërtime veprash të mëdha, ndër të cilat përfshihen edhe *ndërtimi i linjës së Gazsjellësit TransAdriatik-Trans Adriatic Pipelines (TAP*) për transportimin e gazit. Me vendim të KKT nr. 1, datë 04.07.2013 u miratua plani kombëtar sektorial për gazsjellësin (Projekti TAP) i cili kushtëzon të gjitha autoritet planifikuese që ta marrin në konsideratë planin sektorial në hartimin e instrumenteve të planifikimit. Shoqëria Trans Adriatic Pipeline

(TAP) AG do të ndërtojë një segment tubacioni rreth *3.8 km* në të cilin ushtrohen tre zona sigurie. Në zonën e parë A, prej 8 m (4m në çdo anë), nuk do lejohet asnjë ndërtesë, as plugim i thellë dhe as pemë. Në zonën e dytë B, prej 40m (20 m në çdo anë), nuk do lejohen ndërtesa banimi. ZonA e tretë C, prej 400m (200 m në çdo anë), do të jetë në konsideratë të veçantë të autoriteteve të planifikimit, ku në bazë të standardeve të sigurisë për sistemin e gazit natyror me trysni të lartë mund ta kufizojnë numrin e ndërtesave në zonën e sigurisë.[259] . Krahas vënies në përdorim të një sasie të pronave shtetërore, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 803, datë 30.9.2015, në territorin administrativ të Bashkisë Lushnje do të vendosen në dispozicion të përhershëm të Shoqërisë TAP AG: *901m^2 tokë bujqësore* (arë), 821 m^2 rrugë automobilistike dhe prona shtetërore.

Figura 92. Gjurma e projektit TAP në territorin e Bashkisë



Burimi: TAP, Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN, 2016

Përveç TAP-it, përdorimi i tokës bujqësore për qëllime jobujqësore ndodh edhe në ***zonat industriale të naftës*** në Bubullimë. Përdorimi i tokës nga industria e naftës, përveç përfitimeve ekonomike që ka sjellë për vendin, ka ndikuar negativisht në ndotjen e tokës, për shkak të mbetjeve të dherave industriale të depozituara në vende të ndryshme.

Në bazë të kushteve të specifikuara në rregulloret e hartuara në përputhje me Ligjin nr. 7746, datë 28.7.1993 "Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)" i ndryshuar, një kontraktori mund t'i jepet e drejta për të hyrë dhe përdorur tokë publike, ose private për të kryer operacione hidrokarburesh nën marrëveshjen e hidrokarbureve, ku kontraktori është palë. Me pak fjalë, *industria e naftës ka të gjitha të drejtat që të marrë në përdorim tokat bujqësore që i nevojiten për veprimtarinë e saj*. Kjo tregon për nje konflikt të hapur mes përdorimeve të tokës, por edhe mes sektorëve ekonomikë të zhvillimit, ku në nivel politikash qeveria e përcakton bujqësinë si sektor kryesor të rritjes, dhe në nivel praktik e ka lënë të pambrojtur ndaj sektorit të naftës.

Ulja e rendimentit të tokave për shkak të përdorimit intensiv të saj. Sot, bujqësia në vendin tonë përballet me ndryshime të mëdha të sistemit bujqësor. Në zonat fushore, bujqësia po shndërrohet nga bujqësi familjare në bujqësi intensive (së paku për mënyrën e kultivimit dhe jo domosdoshmërisht për sipërfaqen e konsoliduar të tokës) që nënkupton i) kultivimin e tokës bujqësore përgjatë gjithë vitit me përdorimin e makinerive moderne e inputeve bujqësore të panjohura më parë si dhe ii) shtimin e kulturave bujqësore të reja. Disa tregues të zhvillimit të bujqësisë së shkallës në tokat bujqësore fushore në vend janë rritja e numrit të fermave të pluguara me traktor dhe rritja e numrit të serave.

Tabela 41. Rritja e numrit të fermave të pluguara me traktor

Rritja e nr. fermave të pluguara me traktor					
Me traktor				Totali	
2011	2011 (%)	2012 (%)	2012	2011	2012
17,987	39	41	19,330	46,374	46,660

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Nga viti 2011 në vitin 2012, pra në harkun kohor të një viti, në vendi tonë ka një rritje prej 3% të fermave të pluguara me traktor. Ndërkohë në vend është shtuar sasia e plehrave kimike të përdorura, kryesisht të uresë (nga 6.9 në 11.5%) dhe diamond superfosfatit (nga 1.9 në 8.2%) në në dhjetë vitet e fundit. Megjithatë, një fenomen që është vënë re në këto vite, është edhe ndryshimi i llojit të plehrave kimike të përdorura (kalimi nga superfosfati në diamond superfosfat), për të cilin nuk njihet arsyeja.

Tabela 42. Numri i fermave që përdorurin plehra kimike në vend

Numri i fermave që përdorurin plehra kimike në vend				
Emërtimi	1998		2013	
Fermat që plehërojnë	372,507	%	%	342,083
Ure	25,875	6.9	11.5	39,228
Nitrat amoni	48,674	13.1	10.6	36,220
Diamond superfosfat	7,075	1.9	8.2	27,904
Superfosfat	42,428	11.4	5.8	19,729
Të tjera	-	0.0	1.0	3,406

Burimi: Burimi i informacionit: Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Zhvillimi i bujqësisë së shkallës ka ardhur për shkak se në këtë mënyrë garantohet rritja e prodhimtarisë e, si rrjedhojë, edhe e përfitimeve ekonomike. Megjithatë, duhet

theksuar se bujqësia intensive kërkon njohje të thella të vetive fiziko-kimike të tokës të cilat ndihmojnë në përdorimin efiçent të saj (përdorimin e inputeve bujqësore, llogaritjen e përmbajtjes së metaleve të rënda, e depërtimit të ndotjes nga toka në shtresat ujore nëntokësore, llogaritjen e sasisë së ujit të përdorur për ujitje, e kohës e përdorimit etj.). Mungesa e njohjeve të tilla mund të çojë në degradimin e tokës dhe në ndotjen e mjedisit me kalimin e viteve, e sigurisht në rënien e prodhimit bujqësor, edhe të zhvillimit ekonomik nga bujqësia.

Ndotja e tokës: Në Bashkinë e Lushnjes ndotja e tokës ka ndodhur në seksione të caktuara të territorit, kryesisht në zonat industriale, në zonat e depozitimit të mbetjeve si dhe në zona të tjera. Zona industriale është kryesisht zona e naftës në Murriz dhe zona e Kolonjës. Përveç zonës së naftës, LushNja trashëgon një zonë industriale prej 15 ha e ndodhur në daljen jugore të qytetit që përbëhet nga hapësira magazinimi, shërbimi dhe fabrika të privatizuara të letrës dhe të plastikës. Në Lushnje ndodhet *Magazina e Pesticideve* në të cilën ruhen ende pesticide të skaduara dhe *Uzina e Plastmas*ës në të cilën ruhen 1,700 ton kimikate helmuese. Të dy këto objekte janë shpallur vatra të nxehta mjedisore.[260] Për fatë të keq, edhe pse ndikimi i të dy industrive në mjedis në të kaluarën ka qenë i theksuar, ende nuk dihet shtrirja e ndotjes (rrezja nga uzina dhe magazina drejt tokave përreth).

- <u>Përfundime dhe rekomandime</u>

Bashkia e Lushnjes shtrihet në një zonë me reliev fushor e kodrinor, tejet i përshtatshëm për bujqësi dhe aktivitete të tjera ekonomike. Problematikat që po hasen në zhvillimin e bujqësisë në Lushnje lidhen kryesisht me degradimin e tokave për shkak të mungesës së mirëmbajtjes së sistemit të kullimit dhe ujitjes (po të kemi parasysh se toka bujqësore në Lushnje dikur ka qenë kënetë), erozionit lumor, përmbytjeve të shkaktuara nga Semani, si dhe ndotjes së tokës nga mbetjet, industria dhe inputet bujqësore. Edhe pse erozioni në Lushnje është më pak i theksuar se në zona të tjera të vendit (Fieri dhe LushNja renditet si zonë me tregues të ulët erozioni vjetor), në muajt e reshjeve të shumta erozioni arrin në 10 ton/ha/vit. Duke qenë e shtrirë në Ultësirën Perëndimore, LushNja përballet edhe me nevojat e një rrjeti të përshtatshëm ujitës-kullues. Edhe pse në shumë njësi administrative (si në Bubullimë) kohët e fundit është investuar në mirëmbajtjen e kanaleve parësore dhe dytësore, rrjeti kullues nuk është funksional[261].

Në shumë njësi administrative, mungesa e vendgrumbullimit të mbetjeve (si Golemi apo në Bashkinë e Lushnjes) rrezikon ndotjen e tokave përreth. Në disa ish-komuna të Bashkisë së Lushnjes vepron edhe industria e naftës (Kolonjë, Bubullimë e Murriz). Përdorimi i tokës nga industria e naftës, përveç përfitimeve ekonomike që ka sjellë për vendin, mund të ndikojë në ndotjen e tokës, ajrit e ujit. (p.sh. banorët e fshatit Plug në të shkuarën janë ankuar për ndotjen nga liNja e përpunimit të naftës bruto[262] edhe pse niveli i ndotjes ende nuk është përcaktuar).

Për të rritur prodhimin bujqësor në territorin e Bashkisë pa cënuar qëndrueshmërinë e tokave, lipset që Bashkia të ofrojë shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore. Duke u ofruar informacionin e duhur bujqve, ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore edhe në toka kodrinore. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo bujqësore, nevojitet që Bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të

qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç është e përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së[263].

Njëkohësisht, rekomandohet që Bashkia të hartojë planin e zhvillimit territorial duke patur parasysh parimin e mbrojtjes së tokës bujqësore (shndërrimin e tokës bujqësore në truall vetëm në raste kur janë konsumuar të gjitha mundësitë e tjera). Me qëllim shmangien e rrezikut që mund t'u kanoset banorëve të Bashkisë nëpërmjet konsumit të produkteve ushqimore të kultivuara në toka të ndotura, rekomandohet që përreth dhe në brendësi të zonave të ndotura në territorin e Bashkisë, të kryhen studime që synojnë përcaktimin e nivelit dhe shtrirjes gjeografike të ndotjes dhe të merren masa të menjëhershme për rehabilitimin e tyre.

4.7 Shërbimet publike

4.7.1 Furnizimi me ujë

Aktualisht, sektori i furnizimit me ujë dhe i kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane operon nëpërmjet shoqërisë aksionere rajonale UK Lushnje sh.a., e cila ofron shërbimin në bashkinë Lushnje dhe Nja-të Kolonjë, Allkaj, Fier-Shegan, Bubullimë, Dushk dhe Krutje. Kjo ndërmarrje është duke ndjekur procesin e tranzicionit të sektorit sipas reformës territoriale, ku më parë shërbimi ofrohej nga dy shoqëri simotra UK Lushnje sh.a dhe UK Lushnje Fshat, e megjithatë Nja-të Karbunarë, Ballagat, Hysgjokaj e Golem konsideroheshin si "zona të bardha" në të cilat sistemi i furnizimit me ujë për konsum publik administrohet nga stafi i ish-komunës, ose kemi mungesë të infrastrukturës.

Bashkia Lushnjesiguron furnizimin e popullatës me ujë për konsum publik nga akuiferi i Lushnjes, ku rreth 12km në veriperëndim të qytetit ndodhen 7 pusshpime të ujit të pijshëm, të cilat pompojnë ujin nga një thellësi prej 25mnëpërmjet pompave zhytëse. Nga këto stacione pompimi (St.P) vetëm 6 janë aktualisht në gjendje pune që nga rehabilitimi i fundit i realizuar në 2009 nga KfW-ja. Kapaciteti i këtyre pompave vlerësohet se është 750m^3/orë[264]. Klorinimi ndodh në këtë St.P, i cili injektohet direkt në rrjetin e transmetimit.

Një burim tjetër i cili furnizon bashkinë Lushnje është edhe ujëmbledhësi i Çermës, i pozicionuar 15km në veriperëndim të qytetit. Ky akuifer shfrytëzohet nëpërmjet 5 puseve të thella rreth 50m e, megjithëse një St.P relativisht i ri, i ndërtuar në 1990, gjendja e tij paraqitet mjaft e amortizuar, ku edhe cilësia e ujit të prodhuar mendohet të jetë e ndikuar nga kjo gjendje.

Tabela 43. Prurja mesatare e burimeve të ujit në Bashkinë e Lushnjes


Burimi i ujit	**Prodhimi**	
	m³/ditë	*l/s*
Çerma	3,000 - 6,000	35 - 67
Konjat	8,000	93
Total	11,000 - 14,000	128 - 160

Burimi: ValueAdd, KfW – Projekti Teknik i Ujësjellës Lushnje; ; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Cilësia e ujit që përdoret për furnizimin e popullatës paraqitet mjaft e mirë, por në disa raste janë konstatuar ndotje të cilat shkaktohen kryesisht nga mungesa e zonave buferike dhe mbrojtjes higjieno-sanitare pranë pusshpimeve. Këto ujëra janë shfaqur tëndotura si pasojë e faktorëve të renditur më poshtë:

- Shkarkimet e ujërave të ndotura nga banorët e Nja-ve Dushk dhe Tërbuf pranë zonës së St.P dhe rëndom mbi këtë akuifer,
- Infiltrimi nga ujërat sipërfaqësore të zonëstëpërdorura në sektorin e bujqësisë,
- Mungesa e zonave higjieno-sanitare rreth puseve.

Figura 93. Skema e furnizmit me ujë nga U.K. Lushnje



Burimi: ValueAdd, KfW – Projekti Teknik i Ujësjellës Lushnje; ; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Rezervuari i parë, i cili mbledh ujin eprodhuar nga puset e Konjatit dhe Çermës, është reservuari i Konjatit. Kapaciteti stokues i ujit të pijshëm për popullatën e bashkisë Lushnje paraqitet nga tabela e mëposhtme:

Nga konstatimet e kryera rezulton se sistemi aktual, i cili po i nënshtrohet rehabilitimit dhe zgjerimit[265], ka një kapacitet stokues të ujit të pijshëm prej 4,850m^3. Pra, duke marrë parasysh normën ditore të konsumit të popullatës prej 120 l/banor/ditë, prej analizës na rezulton se qytetit të Lushnjes do t'i nevojiteshin vetëm 2,520m^3 kapacitet stokues, në një kohë kur ka afro dyfishin e kapacitetit.

Tabela 44. Të dhëna mbi situatën e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm në Lushnje

Nr	Nja	Popullsia aktuale	Kërkesa aktuale përujë *(l/sek)*	Kërkesa aktuale përujë *(m^3/orë)*	Sasia e ujit të prodhuar aktualisht	Bilanci	Kërkesapërrez.	Vol. i rez.	Bilanci i vol.tërez. me kërkesën
					(m^3/orë)	*(m^3/orë)*	*(m^3)*	*(m^3)*	
1	Lushnje	31,574	58	210	333	123	2,520	4,850	2,330
2	Allkaj	4,384	15.5	56		-5.4	672	200	-472
		Uj. Gajde	10	36	29	-7			
		Uj Biçakaj	4	13.5	21.6	8.1			

3	Bubullimë	5,632	18	65		-27	780	400	-280
		Uj. Gajde	13.8	49	22	-27			
		Uj. Gogolas	4.2	16	16	0			
4	Hysgjokaj	2,642	9.5	34	29	-5	408	300	-108
5	Golem	5,322	19.4	70	74.6	4.6	840	840	0
6	Dushk	7,991	29.4	106		-44.8	1,056	700	-356
		UK Lushnje	7.2	26	26	0	312	200	-112
		Uj. Dushk	13.3	48	36	-12	576	300	-276
		Uj. Gramsh	3.3	12	7.2	-4.8	144	200	56
7	Karbunarë	4,256	13.9	50	28	-22	600	300	-300
8	Ballagat	2,498	9.4	34	18	-16	408	300	-108
9	Fier-Shegan	Total 7,129	23.6	85		-26	1,020	470	-550
		Çinari	7.5	27	27	0	324	190	-134
		Gajde	13.6	49	32	-17	588	280	-308
10	Kolonjë	5,814	21	76	54	-22	912	400	-512
11	Krutje	7,678	25.8	93	77	-16	1,116	250	-866
Totali		84,921	243.5	879	830.4	-57	10,332	9,010	-1.322

Burimi: ValuAdd, KfW – Projekti Teknik i Ujësjellës Lushnje;

Duke qenë gjithnjë në gjendje pune, rezervuarët, stacionet e pompimit, klorifikatori dhe vetë sistemi i tubacioneve nuk i janë nënshtruar rregullisht proceseve mirëmbajtëse si pastrim-shpëlarjes dhe dezinfektimit. Gjithashtu, agjentët atmosferikë, si edhe në disa raste vegjetacioni kanë ndikuar negativisht në higjienën e këtyre elementeve. Siguria e tyre është një aspekt tjetër i cili nuk shfaq besueshmëri, duke marrë parasysh faktin se në këto elemente mund të kenë akses edhe persona të paautorizuar.

VKM-janr. 102, datë 16.3.1992, "Për normat e përdorimit dhe çmimin e ujit të pijshëm në qytet dhe në fshat",përcakton që normat e përdorimit të ujit të pijshëm për efekt pagese për përdoruesit familjarë të cilët nuk kanë matës të jetë 120 litra ujë në ditë për frymë. Është kryer llogaritja e kërkesës për ujë në qytetin e Lushnjes. Gjatë kësaj llogaritjejeanë marrë parasysh humbjet në rrjet, të cilat synohet të reduktohen deri në 35%. Norma e konsumit për popullatënvarionnga 90 deri në 120 litra ujë në ditë për frymë sipas kategorive (banesa, institucione, biznese).

Nja-të në bashkinë Lushnje, kanë në territorin e tyre infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e ujit të pijshëm e cila shërben mesatarisht 85% të popullatës së këtyre njësive administrative. Specifikisht, vetëm Nja-të Golem, Bubullimë dhe Krutje, ofrojnë këtë shërbim thuajse në masën 100%. Në këto zona uji sigurohet nëpërmjet puseve dhe burimeve ujore natyrore.

Tabela 45. Shërbimi i furnizimit me ujë për Nja-të dhe fshatrat në Bashkinë Lushnje

Nr.	**Njësitë**	**Fshatrat e Nja-ve**	**Pop.**

	administrative		
1	**Lushnje**	**Me rrjet:** Qyteti Lushnje, Karbunarë, Savër	*89%*
2	**Nja Allkaj**	**Me rrjet:**Toshkëz, Delisufaj, Biçakaj i Vjetër, Zhelizhan, Allkaj, Mazhaj	*85%*
		Pa rrjet: Lifaj i ri, Çukas i Ri	
3	**Nja Bubullimë**	**Me rrjet:** Bubullimë, Eskaj, Gjonas, Halilaj, Pirrë, Kamçishtë, Imsht	*99%*
		Pa rrjet:	
4	**Nja Hysgjokaj**	**Me rrjet:** Hysgjokaj, Kurtin, Çankaj, Kupaj, Lekaj	*51,5%*
		Pa rrjet: Hysgjokaj, Kurtin	
5	**Nja Golem**	**Me rrjet:** Golem i Madh, Allprenaj, Shegas, Hajdaraj, Plug, Golem i Vogël.	*98%*
		Pa rrjet:	
6	**Nja Dushk**	**Me rrjet:** Dushk Peqin, Konjat, Zham Fshat, Dushk i Madh, Gramsh, Zham Sektor, Konjat	*72,9%*
		Pa rrjet: Thanasaj, Gramsh, Konjat, Zham Sektor	
7	**Nja Karbunarë**	**Me rrjet:** Karbunarë e Sipërme, Kasharaj, Zgjanë, Balaj, Skilaj, Murriz- Peqin, Biçakaj	*70,2%*
		Pa rrjet: Kashtëbardhë, Stankarbunarë, Mollas	
8	**Nja Ballagat**	**Me rrjet:** Ballagat, GaruNjas, Xibrakë, Gjyshaj	*52,9%*
		Pa rrjet: Gjuzaj, Jazexhi, Manasufaj	
9	**Nja Fier-Shegan**	**Me rrjet:** Fier-Shegan, Barbullinjë, Çinar, Koçaj, Sejmenas, Thanë, Çukas i vjetër, Murriz- Kozarë, Qerret i Vjetër, Qerret i Ri, Biçakaj i Ri, Kosovë e Vogël.	*90,2%*
		Pa rrjet: Jeta e Re	
10	**Nja Kolonjë**	**Me rrjet:** Kolonjë, Gorre, Bishqethëm, Lumth, Rrapës Fshat, Shakuj, Rrapës Sektor	*80,8%*
		Pa rrjet: Ardenicë, Bitaj	
11	**Nja Krutje**	**Me rrjet:** Krutje e Sipërme, Krutje e Poshtme, Fier i Ri, Zhym, Rrupaj, Lifaj i Vjetër, Kadiaj, Ngurrës i Madh, Ngurrës i Vogël, Arrëz, Gjaz	*98%*
		Pa rrjet:	
Totali i popullsisë së shërbyer me infrastrukturën e furnizimit me ujë për konsum publik:			**85.5%**

Burimi: USAID/ValuAdd 2015, Përpunoi: Co-PLAN, 2016

- **Pusshpimet**

Për të përmbushur nevojat e përditshme për ujë të pijshëm dhe konsum sekondar, popullsia banuese në zonat e pashërbyera ka ndërmarrë në mënyrë të organizuar ose individuale iniciativën për të realizuar pusshpime.

Bashkia Lushnje dhe ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve mbështetet kryesisht tek puset e Konjatit dhe Çermës për furnizimin me ujë për konsum publik të banorëve në qytet dhe fshatrat fqinje. Në të njëjtën linjë operojnë edhe Nja-të e tjera, të cilat e kanë mbështetur shërbimin e furnizimit duke shfrytëzuar pusshpime brenda territorit të tyre dhe afër qendrave të banuara[266].

Tabela 46. Pusshpimet në Bashkinë e Lushnjes

Nr.	**Qyteti / Nja**	**Ujësjellësi**	**Qyteti / NjA - Fshati i furnizuar**	**Pusshpimet: vendndodhja**
1	Qyteti Lushnje	U.K. Lushnje	Qyteti i Lushnjes	Akuiferi i Lushnjes (13km në veri të qytetit Lushnje)
				Puset në zonën e Konjatit, 10km në veriperëndim të Lushnjes (7 puse 25m të

				thella), kapaciteti = 750m^3/orë. Puset në zonën e Çermës, 12km në veriperëndim të Lushnjes (5 puse 50m të thella), kapaciteti = 480m^3/orë
2	Nja Allkaj	Ujësjellësi Rajonal Gajde	Toshkëz, Zhelizhan, Mazhaj, Delisufaj	Pusshpim dhe STP në fshatin Gajde,kapaciteti = 45l/s, (pranë lumit Seman)
		Ujësjellësi Allkaj - Biçakaj	Çukas i Ri, Lifaj i Ri,	Pusshpim dhe STP për ngritje mekanike në qendër të fshatit Biçakaj, kapaciteti = 6l/s.
3	Nja Bubullimë	Ujësjellësi Rajonal Gajde	Bubullimë Fshat, Eskaj, Gjonaj, Halilaj, Imsht	Pusshpim dhe STP në fshatin Gajde,kapaciteti = 45l/s, (pranë lumit Seman)
		Ujësjellësi Gogolas	Pirre, Kamçisht	Nuk ka informacion mbi vendndodhjen. Prurja e deklaruar = 4.3l/s
4	Nja Hysgjokaj	Ujësjellësi Hysgjokaj	Hysgjokaj	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Hysgjokaj, me kapacitet = 1 l/s
		Ujësjellësi Kurtin	Kurtin	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Kurtin, pranë serrave diellore, me kapacitet = 1 l/s
		Ujësjellësi Çanakaj	Çanakaj	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Çanakaj, kapaciteti =1 l/s
		Ujësjellësi Kupaj	Kupaj	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Kupaj, kapaciteti = 1 l/s
		Ujësjellësi Lekaj	Lekaj	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Lekaj, kapaciteti = 4 l/s
5	Nja Golem	Ujësjellësi Shegas	Shegas	2 Pusshpime dhe STP pranë fshatit Shegas, kapaciteti = 2 l/s secili
		Ujësjellësi Hajdaraj	Hajdaraj	Pusshpim dhe STP 1.4 km nga qendra e fshatit, kapaciteti = 2 l/s.
		Ujësjellësi Lushnje -Qytet	Golem i Madh, Golem i Vogël, Plug	Puset në zonën e Konjatit, 10km në veriperëndim të Lushnjes (7 puse 25m të thella), kapaciteti= 750m^3/orë.
6	Nja Dushk	Ujësjellësi Dushk	Dushk i Madh, Dushk Peqin, Gramsh Fshat	Pusshpim dhe STP 2.2 km nga rruga automobilistike në drejtim të Grabianit, kapaciteti = 10 l/s.
		Ujësjellësi Gramsh	Gramsh Fshat	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Gramsh, kapaciteti =2 l/s
		Ujësjellësi Lushnje -Qytet	Zham Sektor, Zham Fshat, Konjat	Puset në zonën e Çermës, 12km në veriperëndim të Lushnjes (5 puse 50m të thella), kapaciteti= 480m^3/orë
7	Nja Karbunarë	Ujësjellësi Lushnje -Qytet	Karbunarë e Sipërme, Mollas, Kasharaj, Kashtëbardhë, Stankarbunarë, Zgjanë, Balaj, Skilaj, Murriz-Peqin, Biçakaj	Puset në zonën e Konjatit, 10km në veriperëndim të Lushnjes (7 puse 25m të thella), kapaciteti = 750m^3/orë, ngaku NjA Karbunarë merr rreth 8l/s për furnizimin e popullatës.
8	Nja Ballagat	Ujësjellësi Ballagat	Ballagat Fshat	Pusshpim dhe STP rreth 1.4km në veri të fshatit Ballagati, , kapaciteti =1 l/s
		Ujësjellësi GaruNjas	GaruNjas Fshat	Pusshpim dhe STP rreth 0.9km në juglindje të fshatit GaruNjas, kapaciteti =1 l/s
		Ujësjellësi Gjyshaj	Gjyshaj, GaruNjas	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Gjyshaj (Prroi i Madh), kapaciteti =1 l/s
		Ujësjellësi Xibrakë	Xibrakaj	Pusshpim dhe STP në jug të fshatit Xibrakaj (Prroi i Madh), kapaciteti =1 l/s

		Ujësjellësi Matjan	Matjan	Pusshpim dhe STP në verilindje të fshatit Matjan, kapaciteti =1 l/s
9	Nja Fier-Shegan	Ujësjellësi Çinar	Çinar. Sejmenas, Thanë, Kosovë e Vogël, Murriz-Kozarë	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Çinar, kapaciteti =8 l/s
		Ujësjellësi Gajde	Fier-Shegan, Koçaj, Barbullinjë, Çukas i Vjetër, Qerret i Vjetër, Qerret i Ri, Biçakaj	Pusshpim dhe STP në fshatin Gajde,kapaciteti = 45l/s, (pranë lumit Seman)
10	Nja Kolonjë	Ujësjellësi Gogolas	Gorre, Bishqethem, Lumth, Rrapëz Fshat, Rrapëz Sektor, Shakuj	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Gogolas,kapaciteti =10l/s
		Ujësjellësi Kolonjë	Kolonjë	Pusshpim dhe STP pranë fshatit Libofshë,kapaciteti =7l/s
11	Nja Krutje	Ujësjellësi Gajde	Krutje e Sipërme, Krutje e Poshtme, Fier i Ri, Zhym, Rrupaj, Lifaj i Vjetër, Kadiaj, Ngurrës, Arrëz, Gjaz	Pusshpim dhe STP në fshatin Gajde,kapaciteti = 45l/s, (pranë lumit Seman),nga ku NjA Krutje merr rreth 26l/s

Burimi: USAID/ValuAdd 2015; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016


Aktualisht po realizohen ndërhyrje në rrjetin e furnizimit me ujë të bashkisë Lushnje, ku po zbatohet projekti i hartuarr me mbështetjen e KfW-së, në të cilin është parashikuar të bëhet rehabilitimi i sistemit dytësor dhe kryesor të furnizimit me ujë dhe i lidhjeve me shtëpitë. Kështu, janë parashikuar të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Rehabilitimi i linjës magjistrale të transmetimit nga pusshpimet Konjat e Çermë në qytetin e Lushnjes,
- Masa parandaluese për kontaminimin dhe ndotjen e puseve në Konajt,
- Rrethimi i zonës së parashikuar për ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura,
- Rehabilitimi i zyrave qendrore të UK Lushnje dhe trajnime,
- Instalimi i sahatëve matës në shkallë të gjerë (rreth 800 copë), si edhe i pajisjeve të tjera.

Masat që duhen ndërmarrë për rritjen e efiçencës së këtij sistemi kanë të bëjnë kryesisht me kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sasisë së ujit të pijshëm të prodhuar dhe të faturuar.

Në vlerësimin tonë,për të qenë sa më miqësorë me mjedisin, është e nevojshme që të kontrollohen në mënyrë dinamike sasitë e ujit të prodhuar nga pusshpimet e Konjatit dhe Çermës (përfshirë edhe puset e shpërndara në Nja-të e bashkisë Lushnje), në varësi të kërkesës për konsum. Kjo realizohet me anë të sistemit SCADA[267], i cili në mënyrë automatike monitoron nivelin e ujit të stokuar në depozitat e lartpërmendura të ujit të pijshëm e më pas, po në mënyrë automatike,komandon pompat në Konjat e Çermë lidhur me sasinë e nevojshme të ujit për t'u pompuar nga thellësia.

Tabela 47. Zonat e shërbyera nga UK Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje & Co-PLAN, 2016

Ky sistem mbështetës kërkon një investim fillestar, por kontributi që ai jep në ruajtjen e ujërave natyrale është mjaft i rëndësishëm, duke ulur në të njëjtën kohë edhe humbjen e ujit që shkarkohet në tepërplotësat e depozitave pasi ato janë mbushur, por nuk janë komanduar për t'u mbyllur.

Gjithashtu, një masë tjetër, e cila shkon përkrah atyre që po ndërmerr aktualisht projekti në zbatim pranë bashkisë Lushnje për rritjen e efiçencës së sistemit, ka të bëjë me monitorimin e të gjithë linjës magjistrale, si edhe të niveleve kryesore e dytësore të rrjetit të shpërndarjes për konstatim dhe shkëputje të lidhjeve të paligjshme. Kjo masë do të ndikojë duke reduktuar ndjeshëm humbjet prej dëmtimeve në rrjet, si edhe do të ndihmojë që sasia e faturuar e ujit të jetë sa më pranë sasisë së prodhuar, duke rritur kështu edhe rentabilitetin e ndërmarrjes e duke i ulur humbjet sa më pranë nivelit të humbjeve hidraulike në projektim.

Krahas masave të lartpërmendura, duhet të theksojmë se njësitë administrative Ballagat, Karbunarë, Dushk, Fier-Shegan shfaqin mjaft probleme lidhur me mbulimin e tyre të plotë me këtë shërbim. Objektiv duhet të mbetet zgjerimi i sistemit edhe në këto NjA gjatë 5-vjeçarit të ardhshëm.

- <u>Problematikat në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm</u>

Për sa i përket problematikave që hasen në sektorin e furnizimit me ujë, ato janë të llojeve të ndryshme dhe përfshijnë kryesisht:

- Shtrirjen jo të plotë të sistemit të furnizimit me ujë për konsum publik në bashkinë Lushnje,
- Në zonat ku ofrohet furnizimi me ujë: vështirësitë për mbulimin e nevojave me ujë gjatë periudhës së verës, kur kërkesa për konsum rritet si pasojë edhe e përdorimit të këtyre ujërave për vaditje,

- Gjendjen jo të mirë të sistemit aktual për shkak të tubacioneve të vjetëruara ose të bllokuara.


Tabela 48. Gjendja e tubacioneve të rrjetit të furnizimit me ujë

Fusha e përdorimit	Gjatësia e tubacioneve (m)
Rrjet kryesor (DN 300-500)	19,200
Rrjet dytësor (DN 50-250)	28,060
Totali	47,260

Burimi: USAID/ValuAdd 2015; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

- Humbjet në sistem: aktualisht humbjet vlerësohen të jenë midis 40-65% (faktor i cili rrit kërkesën për ujë gjatë verës deri në 210-255 litra/ditë/banorë). Këto humbje në bazë të strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë të popullatës duhet të reduktohen deri në masën 30%.
- Gjendjen jo të mirë të depozitave. Mosha mesatare e këtyre depozitave vlerësohet të jetë mesatarisht 50-vjeçare.

Figura 94. Shtrirja e rrjetit të ujësjellësit në bashkinë e Lushnjes dhe qytet.



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN, 2016

4.7.2 Ujërat e ndotura

Shërbimi i grumbullimit dhe kanalizimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet vetëm në qytetin e Lushnjes dhe thuajse aspak në Nja-të e saj. Shërbimi i orfuar është në nivele të pakënaqshme, kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar si pasojë e vjetërsisë së tij, si edhe konstruksionittë tubove material betoni ku lidhja midis seksioneve është kryer me llaç. Ky sistem është i kombinuar dhe mbledh si shkarkimet e ujërave të ndotura, ashtu edhe ujërat e larta. Nuk ofrohet asnjë nivel trajtimi i këtyre ujërave dhe shkarkimet ndodhin mbi trupat ujorë sipërfaqësorë më të afërt.

Kompozimi i këtij sistemi për grumbullimin e ujërave të ndotura urbane është i tillë që njëkohësisht ai grumbullon ujërat e larta, si edhe shkarkimete ndryshme e të pakontrolluara që ndodhin në kolektorë, apo kanalet e hapura dedikuar këtij sistemi.

Zonat urbane: Sot, bashkia Lushnje mbulon me shërbimin e kanalizimit të ujërave të ndotura vetëm një pjesë të popullsisë së qytetit të Lushnjes, por nuk disponohet një

shifër përmbledhëse e saktë si pasojë e mungesës së dixhitalizimit të rrjetit të kanalizimeve në këtë bashki.

Zonat rurale: Në zonën rurale tëbashkisë Lushnje nuk ekziston ndonjë sistem i organizuar inxhinierik për mbledhjen dhe largimin e ujërave të ndotura.

Ujërat e ndotura të çdo shtëpie largohen në gropa individuale në oborret e shtëpive, të cilat nuk respektojnë standardet tekniko-sanitare të gropave septike me ose pa filtrim. Në mjaft raste largimi i tyre bëhet edhe në kanale të hapura kulluese që kalojnë pranë shtëpive të tyre e që gjithashtu nuk irespektojnë kushtet sanitare të largimit të tyre.

Sistemi i ujërave të ndotura për qytetin është i kombinuar, që do të thotë se ujërat e të ndotura mblidhen së bashku me ujërat e reshjeve (ujërat e bardha). Tubacionet e këtij sistemi janë të përmasave Ø200 - Ø1,000 prej betoni,të cilat, në gjatësi lineare, të kompozuaranë formën e rrjetit të grumbullimit të këtyre ujërave, arrijnë rreth 29km tubacione dhe kolektorë.

Shkarkimi dhe trajtimi i këtyre ujërave, si edhe i ujërave industrialeështë problemi më i madh sanitar që mund të paraqitet sot në bashkinë Lushnje, për arsye se të gjithë kolektorët i shkarkojnë ujërat e ndotura të patrajtuara në sipërfaqe ujore sipërfaqësore.[268]

Ky sistem është ndërtuar rreth viteve 1968 dhe 1980, vite këto që përkojnë me ndërtimin e banesave të reja. Pas viteve 1990 nuk është ndërhyrë më në këtë sistem. Si rrjedhojë, ndërtimet e pas-viteve 1990 janë të pakontrolluara dhe të paplanifikuara[269] në aspektin e ofrimit të infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe kanalizime.

- Problematikat:

Sikurse u pa më sipër, rrjeti i kanalizimeve në bashki është relativisht i amortizuar dhe nuk përmbush me efiçencë funksionin bazë. Përveç qytetit të Lushnjes, pjesa tjetër e bashkisë nuk mbulohet me rrjet kanalizimesh. Për më tepër, edhe në zonat ku ky rrjet shtrihet, hasen shumë probleme. Kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar ose i dëmtuar, pa llogaritur ndotjen e ujërave të lumit Seman dhe kanaleve kulluese e vaditëse, e cila shkaktohet nga derdhja e ujërave të ndotura të patrajtuara.

Si përfundim, mund të thuhet se në Bashkinë Lushnje:

- Kanalizimi i ujërave të ndotura është i pjesshëm edhe në vetë zonën urbane në Lushnje (ofrohet vetëm në qytetin e Lushnjes (85%)).
- Shërbimi i ofruar është në nivele të pakënaqshme pasi sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar, ose është shtrirë në mënyrë të pakontrolluar dhe jashtë standardeve higjieno-sanitare.
- Ujërat e ndotura urbane vazhdojnë të ndotin pjesën më të madhe të ujërave sipërfaqësore të kanaleve dhe emisarëve, si edhe kemi shkarkime direkt në ujërat e lumit Seman e Shkumbin.
- Zonat rurale nuk kanë rrjet kanalizimesh të ujërave të ndotura (largimi i ujërave bëhet nëpërmjet gropave septike, jashtë standardeve higjieno-sanitare ose nëpërmjet kanaleve të hapura kulluese që kalojnë fare pranë zonave të banuara).

- Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urbane duhet parashikuar të ndërtohet paralelisht me rehabilitimin apo ndërtimin e sistemit të ri të grumbullimit të ujërave të ndotura. Një studim përcjellës nevojitet për të përcaktuar karakteristikat dhe elementet kryesore ndotëse të ujërave në Lushnje në mënyrë që të përzgjidhet metodologjia dhe teknika më e përshtatshme trajtuese në impiant.

4.7.3 Mbetjet e ngurta

Bashkia e Lushnje ofron shërbimin e manaxhimit të mbetjeve të ngurta për 86%[270] të popullsisë së Bashkisë Lushnje (Nj.A Allkaj, Bubullimë, Krutje). Me manaxhim të mbetjeve nënkuptohet grumbullimi i mbetjeve të ngurta nga pikat e grumbullimit të mbetjeve të shpërndara në funksion të dendësisë së popullatës dhe të aktiviteteve private e shtetërore dhe, transportimi i tyre drejt vend-depozitimit si edhe stokimi i tyre përfundimtar.

Shërbimi i manaxhimit të mbetjeve nuk ofrohet rregullisht në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Lushnje. Shërbimi i mbetjeve në qytetin e Lushnjes ofrohet në rreth 86 % të territorit të saj, në të cilin janë shpërndarë 296 kontenierë, nga kompania private "Leal", e kontraktuar nga Bashkia Lushnje me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.19 Dt. 09/03/201610 Nj.A për 10 muaj. Firma private kryen grumbullimin dhe transportin e mbetjeve për në vend-depozitimin e qytetit, që ndodhet në Lagjen "18 Tetori", shumë pranë zonave të banuara dhe rrugës kombëtare Lushnje-Fier. Ky vend-depozitim është jashtë kushteve higjieno-sanitare dhe i tejmbushur me mbetje. Bashkia Lushnje ka hartuar një plan të manaxhimit të mbetjeve, ku po rishikohet dhe një herë mundësia e ngritjes së një landfilli dhe e sistemimit të pikave të grumbullimit. Sa i përket aspektit financiar, për ofrimin e këtij shërbimi Bashkia Lushnje aplikon tarifën e pastrimit, e cila mblidhet së bashku me taksat e tjera vendore.

Më poshtë, paraqitet një përshkrim i manaxhimit të mbetjeve urbane të ngurta, ku përfshihen dhe inertet, si dhe mbetjet e rrezikshme (mbetjet industriale, spitalore) në Bashkinë Lushnje.

- Mbetjet e ngurta urbane:

Gjatë vitit 2015, Bashkia Lushnje ka prodhuar rreth 14'600 ton mbetje/vit[271], me një sasi prodhimi prej *0.3 deri në 1.9*[272]*kg/banor/ditë (ndryshimi midis zonës urbane dhe asaj rurale).* Sasia e mbetjeve të prodhuara ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Nga një krahasim i bërë për periudhën kohore 2006-2015 rezulton se sasia e mbetjeve të prodhuara nga viti 2006 në vitin 2015 është shtuar me rreth 50% (0.134 ton/banor/vit në vitin 2006, kundrejt 0.3/ton/banor/vit në vitin 2015). Për më tepër, në vitin 2015, sasia e mbetjeve të prodhuara për banor në vit në Bashkinë Lushnje ka tejkaluar mesataren e sasisë së podhuar në rang vendi.

Tabela 49. Projeksion: Sasia e mbetjeve urbane të prodhuara në Bashkinë Lushnje dhe në rang vendi.

Mbetjet urbane Lushnje – Projeksion (ton/banor.vit)					
Viti	2006	2009	2012	2014	2015
Bashkia Lushnje	0.134	0.147	0.235	0.222	0.3
Sasia mesatare e mbetjeve të prodhuara në rang vendi.	0.241	0.292	0.392	0.253	0.235

Burimi: Instat dhe ARM Fier

Njësia administrative Allkaj ka të shpërndarë në territorin e saj rreth 30 kontenierë dhe ofron shërbimin e grumbullimit dhe transportimi nëpërmjet një firme private të kontraktuar nga ish-komuna. Vend-depozitimi është jashtë kushteve higjieno-sanitare, duke përbërë një burim rreziku për ndotjen e mjedisit.

Njësia administrative Bubullimë deklaron se në territorin e saj ka të shpërndarë 60 kontenierë dhe e ofron shërbimin e grumbullimit dhe transportimin e mbetjeve me anë të një firme private të kontraktuara nga ish-komuna, "Kond". Mbetjet transportohen për në vend-depozitimin e njësisë administrative, e cila ndodhet 500 m larg zonës së banuar dhe 1300 m larg depozitës së ujit të pijshëm. Ky vend-depozitim është jashtë kushteve higjieno-sanitare dhe shumë pranë me zonat e banuara dhe depozitën e ujit të pijshëm, prandaj ai paraqet një rrezik potencial për shëndetin e banorëve dhe për mjedisit. Lëngu i mbetjeve urbane (apo edhe lloje të tjera mbetjesh që gjeneron komuna) depërtojnë në shtresat e tokës e më pas në shtresat ujore. Ish-komuna aplikon një tarifë pastrimi për familjet me vlerën 1000 lek në vit, e cila, vitin e kaluar, u mblodh në nivelin 32%.

Njësia administrative Krutje deklaron se në territorin e saj ka të shpërndarë 72 kontenierë, ku vetë ish-komuna ofron shërbimin e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve. Mbetjet, pasi grumbullohen në pikat e grumbullimit të mbetjeve, depozitohen në vend-depozitim, i cili ndodhet në fshatin Krutje, rreth 2000 m larg zonave të banuara. Ky vend-depozitim është jashtë kushteve higjieno-sanitare, dhe prania e tij me zonat e banuara përbën një rrezik për shëndetin dhe mjedisin gjithashtu. Pavarësisht se deklarohet se ka një plan për manaxhimin e mbetjeve në territor, shërbimi i ofruar nga kjo ish-komunë nuk është sipas standardeve.

Në territorin e Lushnjes shërbimi ofrohet në nivelin 80-100%. Vend-depozitimi i mbetjeve në Lushnje nuk është higjieno-sanitar, ndodhet zonave të banuara, në distancë vetëm130 m, dhe vendoset në tokë bujqësore. Diferencimi i mbetjeve në burim nuk kryhet dhe rezulton të ketë mungesë të riciklimit, apo përpunimit të mbetjeve. Tregues i mungesës së diferencimit të mbetjeve është edhe niveli i lartë i mbetjeve që importohen për t'u ricikluar nga kompanitë e riciklimit të vendosura në Shqipëri. Në vitin 2013, në Shqipëri, janë importuar 207,690 ton mbetje dhe janë eksportuar vetëm 30,704 ton mbetje nga të cilat 35,055 ton janë mbetje të ricikluesshme[273].

Sipas të dhënave të Ministrisë së Mjedisit (për lejet mjedisore), në territorin e bashkisë Lushnje operon vetëm një kompani riciklimi që riciklon vajra dhe nënprodukte të tyre.

Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve bashkiake në territorin e Bashkisë Lushnje, jemi mbështetur sërish në metodologjinë e INSTAT për të dhënat e popullsisë në çdo km². Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.8 kg[274]. Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara siç është qyteti i Lushnjes. Sasia e gjeneruar në qytetin e Lushnjes, në zonën urbane, arrin vlera 1829-3080 ton/banorë për km².[275]

Fusha e depozitimit te mbetjeve ne Lagjen "18 Tetori" së pari ndodhet shumë pranë banesave ekzistuese të kësaj zonee por edhe distancat nga qëndra e qytetit, autostrada Lushnje-Fier & kanali vadites, janë respektivisht $L_{Q.Q.}$~ 2km (vijë ajrore)[276], $L_{Rr.}$~ 0,3km (vijë ajrore) [277] . Zgjerimi i sipërfaqes së vend-depozitimit vlerësohet paraprakisht në 2-fishin e sipërfaqes që zinte gjatë vitit 2004.

Figura 95. Ndryshimet të sipërfaqes së venddepozitimit në harkun kohor 2005-2010



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN

Ky vend-depozitim shërben edhe si pikë vend-grumbullimi për mbetjet inerte, elektronike dhe të tjera. Siç mund të kuptohet, shfrytëzimi efiçent i hapësirës së caktuar si vend-depozitim nuk është respektuar, kjo edhe si pasojë manaxhimit të dobët gjithashtu edhe funksionit të saj si pritës i mbetjeve, të cilat në bazë të ligjit Nr. 10463, Dt. 22.9.2011 & Nr. 9537, datë 18.5.2006 (të azhornuar)[278]duhen administruar nga vetë gjeneruesi dhe ndalohen rreptësisht të përzihen me mbetjet urbane.

Vend-depozitimi i mbetjeve paraqet probleme të mëdha për sa i përket ndotjes së mjedisit dhe rrezikimit të shëndetit të banorëve për arsye të ndryshme. Së pari, ai ndodhet buzë dy kanaleve ujore të hapura që përdoren gjërësisht nga aktiviteti bujqësor**,** duke ndotur vazhdimisht sipërfaqet e mbjella. Pozicioni në të cilin ndodhet vend-depozitimi i Lushnjes është i përshtatshëm nga ana gjeologjike për shkak se ndodhet jo mbi akuifer ku poroziteti nuk është i theksuar dhe infiltrimi i shllameve në ujërat nëntokësor vlerësohet të jetë minimal.

Ndër ndotjet që shkaktohen si rezultat i kushteve teknike nën të cilat operon ky vend-depozitim është edhe çlirimi i gazrave toksike (metani CH_4) si produkt i procesit të kompostimit të shtresave më të vjetra të mbetjeve organike dhe jo vetëm. Ky produkt kimik, në formën e tij të gaztë mund të kapej me anë të skemave të rikuperimit ku të përpunohej e të ofrohej si një LDG (Lëndë Djegëse Gaz) për të prodhuar enegji elektrike ose mekanike.

Në rastin e vend-depozitimit Lushnje, gazi metan, çlirohet i gjithi në atmosferë duke kontribuar si gaz i efektit serë e gjithashtu duke ndotur me aromën e tij të fortë,. Vend-depozitimi paraqet probleme edhe në lidhje me ndotjen e ajrit për shkak të djegies së mbetjeve plastike që kryhet në këtë zonë.

Ky vend-depozitim nuk ka status ligjor si landfill, prandaj edhe ndërhyrja urgjente për rehabilitimin e kësaj sipërfaqeje dhe ndalimin e aktivietit të depozitimit të mbetjeve paraqitet tepër urgjente. Një aspekt tjetër tejet i rëndësishëm është fakti se vend-depozitimi i Lushnjes ndodhet shumë pranë banesave ku ndikohen drejtpërdrejt mbi 30 familje.

Figura 96. Foto nga vend-depozitimi i mbetjeve Lushnje



Burimi: Arkiva Co-PLAN

Si përfundim, mund të thuhet se vend-depozitimi i Lushnjes duhet konsideruar një vatër e nxehtë mjedisore që rrezikon shëndetin e banorëve, si edhe ndotjen e tokave bujqësore dhe ajrit.

Për këtë arsye, lipset mbyllja ose ndërhyrja emergjente në të sipas kërkesave të përgjithshme të Aneksit 1 përcaktuar në VKM-në nr. 452, datë 11.07.2012, ku i kërkohet operatorëve të vend-depozitimeve, të pajisur apo jo me leje, që t'i mbyllin këto vend-depozitime brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi janë jashtë kushteve higjieno-sanitare ose të marrin masa për të realizuar ndërhyrjet e listuara në Aneksin 1 brenda 8 viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

- Mbetjet inerte (mbetjet nga ndërtimi dhe shkatërrimi)


LushNja, në rrang, qarku vlersohet të ketë një gjenerim prej 14,566 ton/vit mbetje inerte, dhe mund të themi se renditet e treta në vend pas Vlorës dhe Tiranës[279] për nga sasitë vjetore të krijuara nga ndërtimet, rikonstruksionet si dhe prishjet e objekteve pa leje. Deri më sot, Bashkia nuk ka një vend-depozitim të posaçëm për depozitimin e mbetjeve inerte.

Duke iu referuar listës se aktiviteteve të pajisura me leje mjedisore, të identifikuar si gjenerues të mbetjeve inerte në Bashkinë Lushnje kemi rreth 10 aktivitete në fushën e përpunimit të materialeve infrastrukturore dhe ndërtimore. Si gjenerues të mbetjeve inerte mund të identifikojmë edhe projekte zhvillimore si: rikonstruksioni i sheshit të qendrës së qytetit, zbatimi i projektit të Ujësjellës-Kanalizime Lushnje dhe punime të tjera më të lokalizuara.

Për të shmangur situatën e deritanishme, ku mbetjet inerte depozitohen në vend-depozitimin e mbetjeve urbane duke ndikuar negativisht në manaxhimin tërësor të mbetjeve, propozohet që të përcaktohet një stacion i përkohshëm depozitimi i mbetjeve inerte. Ky stacion mund të shërbejë për grumbullimin në një vend specifik të të gjithë sasisë së gjeneruar dhe më pas ky material mund të përdoret si mbushës për rehabilitimin e kanaleve vaditës dhe ato të kullimit, si edhe për krijimin e argjinaturave në seksionet problematike apo qoftë edhe të gjejë aplikime sipas nevojave të firmave ndërtuese.

Në vitin 2014, pjesa më e madhe e mbetjeve inerte është përdorur për të mbushur gropat e moçaleve të krijuara nga marrja e inerteve. Megjithatë, në të shumtën e rasteve, mbetjet inerte depozitohen në vend-depozitimin e mbetjeve urbane, qoftë si shtresë mbuluese apo të vendosura pirg në pjesën kufijtare të tij.

Figura 97. Sasia e mbetjeve inerte e prodhuar në Lushnje në vite



Burimi: INSTAT, Punoi: Co-PLAN

Zonë problematike në lidhje me mbetjet urbane dhe inerte në qytetin e Lushnjes është zona pranë Katellarës, ku aktivitete të përpunimit të materialeve inerte po gjenerojnë mbetje relativisht të mëdha të cilat janë stokuar në zonat përreth Katellarës dhe këtij subjekti.

Zona ripariane e anëve të lumit, dikur e mbjellë me pemë dhe vegjetacion mbrojtës, sot është thuajse tërësisht e zëvendësuar nga masive inertesh ose mure mbajtëse b/a. Këto ndërhyrje nuk e kanë ndaluar erozionin anësor të lumit, veçse e kanë zhvendsur atë në seksione të tjera më të ndjeshme[280].

- Mbetjet Spitalore

Mbetjet spitalore manaxhohen nga një kompani private Medi-Tel, subjektet i cili ka lidhur marrëdhënie kontraktuale për ofrimin e këtij shërbimi në Spitalin "Ihsan Çabej", të cilat i tërheqin mbetjet periodikisht për t'i trajtuar pranë impiantit të tyre. Kompania Medi-Tel ofron shërbimin e grumbullimit, diferencimit dhe evadimit të mbetjeve spitalore të paktën një herë në muaj. Kjo mënyrë e trajtimit të këtyre mbetjeve zvogëlon vëllimin e tyre me anë të shpërbërjes mekanike, për t'i administruar më pas mbetjet si urbane, jo të rrezikshme për komunitetin dhe mjedisin.

Sipas të dhënave të grumbulluara nga ARM & Bashkia Lushnje, sasia totale e mbetjeve spitalore të prodhuara vetëm në Spitalin e Lushnjes "Ihsan Çabej" për periudhën janar – maj është1263 kg[281], ndërkohë që sasia e vlerësuar për trajtim sipas kontratës në fuqi mes Spitalit dhe Subjektit trajtues vlerësohet të jetë 2980kg/vit[282].

Figura 98. Trajtimi i mbetjeve në Spitalin “Ihsan Çabej” Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje

Nga të gjitha Nj.A-të e Bashkisë Lushnje, Medi-Tel trajton mbetjet e Spitalit Rajonal Lushnje, ndërsa mbi mbetjet e gjeneruara nga njësitë e tjera shëndetësore (poliklinika, qëndra shëndetësore të Nj.A-së, laboratore, klinika etj.) nuk disponohet informacion mbi trajtimin e tyre.

Situata e manaxhimit të mbetjeve spitalore në Bashkinë Lushnje monitorohet vazhdimisht nga Agjencia Rajonale e Mjedisit.

Procesi në vetvete është efektiv dhe arrin të eleminojë këto mbetje të rrezikshme, megjithatë janë identifikuar edhe raste të izoluara ku këto mbetje digjen jashtë kushteve teknike (në qiell të hapur) dhe më pas groposen ose depozitohen në vendgrumbullimin e mbetjeve urbane.

- Mbetjet industriale

Në Lushnje janë evidentuar tre pika të nxehta, lidhur me rrezikun potencial që shfaqin mbetjet industriale, ku në ish-qendrën sanitare janë trajtuar rreth 40 ton mbetje pesticide të skaduara, ndërsa një sasi tjetër pesticidesh mbetet e stokuar në magazinat bujqësore si edhe rreth 1700 ton kimikate toksike gjenden në ish-Fabrikën e Plastikës.[283]

Duke qënë se kryesisht mbetjet industriale të gjeneruara në Shqipëri klasifikohen si mbetje të rrezikshme, trajtimi i tyre duhet realizohet nga vetë gjeneruesi siç edhe indikohet në ligjin e manaxhimit të mbetjeve të rrezikshme. Konkretisht, në Lushnje mbetjet depozitohen në pika të jashtëligjshme ose përzihen me mbetjet urbane, kjo pasi pavarësisht ligjit i cili kërkon vetmanaxhim, Bashkia Lushnje aplikon *Taksë Pastrimi* mbi aktivitetet prodhuese e ndërtimore duke marrë përsipër manaxhimin e mbetjeve të gjeneruara prej tyre.[284]

Duhet theksuar se një pjesë e këtyre aktiviteteve prodhojnë mbetje të rrezikshme dhe si të tillë janë subjekt i trajtimit të këtyre mbetjeve nëpërmjet Ligjit Nr.10463 dt. 22.09.2011, ku cilësohet se këto mbetje duhet rigorozisht të monitorohen, regjistrohen dhe transportohen siç përshkruhet në ligj. Më poshtë paraqitet lista ekzistuese e aktiviteteve gjeneruese të këtyre mbetjeve në Bashkinë Lushnje, të cilat janë të

pajisura me Leje Mjedisore. Janë identifikuar rreth 20 aktivitete gjeneruese të mbetjeve industriale të karaktereve:

- Përpunim, magazinim, tregtim të lëndës djegëse: naftë & gaz
- Përpunim dhe riciklim i vajrave të përdorura
- Stalla për mbarshtrim kafshësh dhe shpendësh
- Njësi të përpunimit dhe prodhimit të qumështit
- Njësi të përpunimit dhe prodhimit të produkteve bujqësore
- Njësi përpunuese & prodhuese plastike, alumini, druri etj..

Në funksion të gjeneruesëve të identifikuar si edhe atyre potencialë nevojitet që të merren masa për trajtimin e mbetjeve me origjinë industriale, pra mbetjeve me potencial rreziku të lartë. Duke qënë detyrim ligjor i adresuar nga vetë prodhuesit qoftë nga Ligji Nr. 9537, datë 18.5.2006, por edhe nga leja Mjedisore që ata posedojnë, Bashkia Lushnje mund të asistojë në përcaktimin e një pozicioni ku këto mbetje do të depozitohen dhe trajtohen të diferencuara.

Tabela 50. Aktivitetet Industriale që krijojnë mbetje

AKTIVITETE GJENERUESE TË MBETJEVE NË BASHKINË LUSHNJE - SIPAS LEJEVE QË POSEDOJNË							
	Aktiviteti	Vendndodhja	Subjekti	Kategori Katalogu	Tipi Mbetjeve te Gjeneruara	Tipi Lejes	
1	Magazinim karburantesh	Lushnje	**TOT - Traiding in Oil &Trasport**	5	Mbetje te dala nga rafinimi i naftës, pastrimi i gazit natyror dhe trajtime pirolotike të karbonit.	B	
2	Magazinim & tregtim karburantesh	Lushnje	**"Merida " sh.p.k.**	5	Mbetje të dala nga rafinimi i naftës, pastrimi i gazit natyror dhe trajtime pirolotike të karbonit.	B	
3	Shpime puse kërkimi nafte	Ardenicë / Lushnje	**"Bankers Petroleum Albania"**	01 05	Mbetje të dala nga kërkimet e shfrytëzimi i minierave, si edhe trajtimet fiziko-kimike të mineraleve	A	
4	Karrierë lumore	Fier - Shegan	**Deflor& Construction**	1	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytezimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet fiziko-kimike të mineraleve.	B	
5	Karrierë argjilore	Karbunarë	**Volalbas h.p.k**	1	Mbetje që dalin nga kërkimet e shfrytezimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet fiziko-kimike të mineraleve.	B	
6	Prodhim asfalti&betoni	Lushnje	**BI INVESTMENTS**	1 , 16 , 17	Mbetje nga shfrytëzim i karrierave, mbetje inerte & mbetje të paspecifikuara	B	
7	Fabrike tullash	Virovë / Lushnje	**Volalbas h.p.k**	16 , 17	Mbetje inerte & mbetje të paspecifikuara	B	
8	Prodhim betoni&asfalto betoni	Lushnje	**G.P.G Company**	1 , 16 , 17	Mbetje nga shfrytëzim i karrierave, mbetje inerte & mbetje të paspecifikuara	B	

9	Mag.&tregtim karburantesh	Golem / Lushnje	**RDA Petrol**	5	Mbetje të dala nga rafinimi i naftës, pastrimi i gazit natyror.	B	
10	Riciklim i vajrave të përdorur	Lushnje	**AM-OIL**	13	Mbetje vajrash dhe mbetje të karburanteve të lëngshme, përveç vajrave ushqimore	B	
11	Riciklim i mbetjeve vajore	Golem / Lushnje	**TOT - Traiding in Oil &Traspo rt**	13	Mbetje vajrash dhe mbetjet e karburanteve te lëngshme, përveç vajrave ushqimore	A	
12	Grumbullim&Perpu nim skrapi metali	Dushk / Lushnje	**PIU-ECO sh.p.k**	11 & 12	Mbetje nga punimi sipërfaqësor dhe formues i metaleve	B	
13	Impiant riciklimi të mbetjeve plastike, gomë dhe vajrave	Golem / Lushnje	**Ylli Petrol**	13, 16, 20, 10	Mbetje vajrash dhe mbetje të karburanteve të lëngshme, përveç vajrave ushqimore. Mbetje të tjera të paspecifikuara, Mbetje urbane, Mbetje nga procese termike.	B	
14	Prodhim profilesh alumini	Lushnje	**Lluga**	10 , 11	Mbetje nga proceset termike, Mbetje që lidhen me trajtimin e materialeve plastike	B	
15	Rritje dhe thertore lopësh	Lushnje	**Maci 2003**	16 03 05 & 18	Mbetje organike që përmbajnë substance të rrezikshme & mbetje nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkime që lidhen me to	B	
16	Prodhim profilesh plastike	Golem / Lushnje	**Telcom Albania**	10 , 12	Mbetje nga proceset termike, mbetje që lidhen me trajtimin e materialeve plastike	B	
17	Impiant përpunimi qumështi	Kolonjë	**SOAL**	2 & 7	Mbetje nga industria agro-ushqimore & mbetje nga proceset e trajtimit organik-kimik.	B	
18	Impiant përpunimi qumështi	Lushnje	**ERMAN DI**	2 & 7	Mbetje nga industria agro-ushqimore & mbetje nga proceset e trajtimit organik-kimik.	B	
19	Impiant përpunimi qumështi	Kolonjë	**LUFRA**	2 & 7	Mbetje nga industria agro-ushqimore & mbetje nga proceset e trajtimit organik-kimik..	B	
20	Mbarështrim derri	Lushnje	**AB-GERSA**	16 03 05 & 18	Mbetje organike që përmbajnë substanca të rrezikshme & mbetje nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkime që lidhen me to	B	
21	Pulari	Karbunare / Lushnje	**AGRI-ZOO**	16 03 05 & 18	Mbetje organike që përmbajnë substance të rrezikshme & Mbetje nga kujdesi shëndetësor njerëzor ose shtazor dhe kërkime që lidhen me to	B	
22	Impiant përpunimi qumështi	Kolonjë	**DELTA DON**	2 & 7	Mbetje nga industria agro-ushqimore & mbetje nga proceset e trajtimit organik-kimik.	B	
23	Tabak plastike për Sera	Lushnje	**AGRO-IMPUT**	10, 15, 16	Mbetje nga proceset termike, mbetjet elastike dhe mbetjet e paspecifikuara në listë	A	

Legjenda:	
	Shfrytezim burimesh
	Shërbime
	Agro - Ushqime - Blegtori

Burimi: AKM

- Vajrat e përdorura

Vajrat e përdorura përbëjnë elemente ndotjeje për mjedisin në rast se nuk manaxhohen siç duhet. Në Bashkinë Lushnje dhe në rang qarku, sasia e vajrave të përdorura nuk njihet për shkak se subjektet prodhuese nuk mbajnë regjistra për shitjen e vajrave, gjë që tregon se sasia vjetore e vajrave të përdorura nuk është e saktë.[285]

Megjithatë, sipas ARM-së në Lushnje, sasia e vajrave të gjeneruara është rreth 4,500 l/vit. Nga verifikimet në terren që janë bërë kohët e fundit, rezulton se subjektet e pajisura me leje mjedisi (7 të tilla), riciklojnë vajra të përdorura dhe kanë marrëdhënie kontraktuale me firma të liçencuara që bëjnë tërheqjen e vajrave në mënyrë periodike. Mbetet ende e pasaktësuar sasia e vajrave të përdorura që nuk riciklohet dhe që përfundon në mjedis.

- Manaxhimi i mbetjeve të tjera

Duke qënë një qytet i orientuar kryesisht drejt praktikave bujqësore, mund të themi se mbetjet elektronike apo të tjera të paspecifikuara zënë një zë shumë të vogël në tortën merceologjike të mbetjeve në Bashkinë Lushnje.

Skema të ndryshme te riciklimit të mbetjeve dhe reduktimit të tyre gjatë fazës së planifikimit të manaxhimit të mbetjeve duhen përfshirë dhe analizuar në detaj për të zotëruar një proces efikas të manaxhimit të mbetjeve. Kompostimi i mbetjeve me origjinë bujqësore organike mund të rezultojë në një skemë mjaft fitimprurëse për sa i përket produktit të kompostit, i cili mund të ripërdoret si pasurues i tokës bujqësore nga fermerë të ndryshëm.

- Riciklimi

Për sa i përket riciklimit të mbetjeve, në Bashkinë Lushnje nuk dihet sasia e saktë e ricikluar. Ish-Bashkia Lushnje raporton që komuniteti Rom është ndër operatorët kryesorë jo formalë për grumbullimin e mbetjeve të plastikës. Mbetjet e ricikluara janë zakonisht alumini, qelqi, hekuri dhe letra/kartoni.

Riciklimi ndodh shpesh nëpërmjet subjekteve private të cilat grumbullojnë në vend-depozitimin e mbetjeve në Lushnje.[286]Referuar strategjisë kombëtare të Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve krahas planit për riciklimin e mbetjeve të cilat klasifikohen si të lehtësisht të riciklueshme, Bashkia Lushnje duhet të hartojë një plan të dedikuar mbi manaxhimin dhe riciklimin e mbetjeve elektronike, inerte dhe industriale.

Krahas këtij detyrimi, si objektiv mbetet riciklimi mbetjeve organike, qelq, letër & plastikë në masën 75-80% përkundrejt totalit të gjeneruar, kjo për një periudhë kohore deri në 2018.

- Përfundime dhe rekomandime

Fillimisht Bashkia Lushnje ka nevojë për të përditësuar Planin e Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane, kjo si nevojë për një studim të plotë mbi shtrirjen e infrastrukturës së shërbimit të manaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë.

Vend-depozitimi në Lagjen 18-Tetori, duke u pozicionuar shumë pranë qendrave të banuara, e ka kthyer një një vatër të nxehtë mjedisore të gjithë zonën dhe impakti i saj reflektohet kryesisht në tokat bujqësore dhe cilësinë e ajrit. Problematikë emergjente paraqitet situata mbi:

- emetimet e gazrave CH_4 në atmosferë, NO, NH_4 si dhe dioksinat nga djegiet e ndryshme.
- shkarkimet e mbetjeve të ngurta mbi rrjedhën e lumit Osum
- infiltrimi i shllameve nga dekompozimi i mbetjeve në akuiferin e Lushnjes.

Depozitimi i mbetjeve inerte në pika të jashtëligjshme si edhe në disa pjesë të argjinaturave nuk ofron një zgjidhje teknikisht të qëndrueshme dhe afatgjatë. Nevojitet një plan për manaxhimin e këtyre mbetjeve dhe mbi të gjitha një pikë grumbullimi e miratuar nga Bashkia.

Mbetjet e klasifikuara si të rrezikshme (kryesisht spitalore & industriale) duhet të administrohen nga subjektet private të cilat i gjenerojnë, ku monitorimi i tyre në terren paraqet mangësi pasi janë identifikuar shkarkime industriale, si edhe ka patur prani të mbetjeve spitalore edhe në vend-depozitimin e mbetjeve[287].

Skema të ndryshme të 3R-ve (Reduktim – Riciklim – Ripërdorim) shihen pjesërisht të zbatuara në Bashkinë Lushnje. Po ashtu, faktor në procesin e ndarjes së mbetjeve mbetet komuniteti Rom & Egjiptian në Lushnje. Fushata dhe projekte pilot në fushën e reduktimit dhe ripërdorimit janë të pakta, ndaj edhe familjarizimi i popullatës me këto teknika është i ulët. Këtu veçojmë mbetjet organike të prodhuara nga bujqësia, të cilat me anë të skemave të kompostimit mund të prodhojnë pleh aktiv, i cili të ripërdoret sërish në bujqësi.

Plan-projekti për ndërtimin e Landfillit të Bashkisë Lushnje në fshatin Murriz-Peqin paraqet një iniciativë pozitive. Bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë – Investitorit dhe Sektorit të Bujqësisë duhet intensifikuar. Por sigurisht nevojitet një studim mbi fizibilitetin që paraqet kjo sipërmarrje.

4.8 Ndyshimet Klimatike dhe rreziqet

- Ndryshimet klimatike në Rajon

Në vendet e Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, pasojat e ndryshimeve klimatike do të shprehen në forma të ndryshme si:

- rritja e temperaturës me 1.7 – 3.5^{o}C deri në vitin 2100,
- ulja e sasisë së reshjeve dhe ndryshimi i regjimit të tyre (-3.84 deri në -18.13% deri në vitin 2100)[288].

Këto fenomene parashikohet të kenë pasoja të theksuara në zhvillimin e rajonit sepse kanë mundësi të shkaktojnë ngritjen e nivelit të detit duke krijuar erozion detar, përmbytje, pakësim të ujërave nëpër lumenj e liqene gjatë vitit dhe përmbytje në periudha të caktuara për shkak të shtimit të reshjeve me intensitet të lartë, të ndryshimeve në stinën e kultivimit në bujqësi, ndryshimeve të habitateve, paksimit të numrit dhe llojeve të specieve, shtimit të llojeve të huaja invazive së bashku me rritjen e sëmundjeve infektive.[289]

Gjithashtu, probleme të shumta do të hasen në komunitetet lokale dhe ato rajonale që varen nga shërbimet që ofron ekosistemi, uji i pijshëm, karburanti, materialet për ndërtim dhe të korrat, të gjitha së bashku do të kenë një ndikim të madh në mbajtjen e kushteve optimale të jetesës. Është fakt i rëndësishëm që disa rajone të Europës Juglindore shtrihen në fushën e Europës që është zonë më e ndjeshme nga ndryshimet klimatike. Ndër pasojat më të theksuara të ndryshimeve klimatike, që parashikohet të ndodhin në rajon, renditen më poshtë:[290]

- mungesa e ujit të pastër për shkak të uljes të sasisë së reshjeve dhe rritjes së temperaturave.
- në zonat malore ku rritja e temperatures do të shkaktojë shkrirjen e shpejtë të akujve dhe debores parashikohet fryrja e rrjedhave të lumit dhe ndikimet zinxhir që rrjedhin.
- zonat bregdetare do të përballen me pasojat që vijnë nga rritja e nivelit të detit kombinuar me rritjen e rrezikut nga fenomene klimatike si stuhitë apo reshjet intensive.

o Ndryshimet klimatike në Shqipëri

Siç u tha me lart, Shqipëria, duke qënë se shtrihet në Europën Juglindore, do të ketë pasoja të ndjeshme nga ndryshimet klimatike. Ndryshime kryesore që parashikohen janë[291]:

- rritja e temperaturave
- ulja e sasisë së reshjeve,
- shtimi i fenomeneve ekstreme të motit
- rritja e nivelit të detit[292].

Sipas të dhënave të nxjerra nga kërkimet e shumta në lidhje me ***ngrohjen globale*** dhe efektet e saj në territor, edhe për Bashkinë Lushnje sektorët që do të preken më shumë janë bujqësia, energjia, biodiversiteti, toka dhe ekosistemet ujore[293]. Bashkia Lushnje nuk është një territor bregdetar, por është fare pranë dhe tokat bujqësore janë në kuota shumë të ulta mbi nivelin e detit. Territori përshkohet në dy anët e tij nga lumi Shkumbin dhe ai Seman, të cilët në kushtet e rritjes së nivelit, do të dëmtojnë tokat bujqësore pranë rrjedhës së tij apo edhe vendbanimet e ndryshme. Për këtë arsye duhen marrë masa për fortifikimin e barrierave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më problematike, të cilat janë të prekura edhe nga erozioni lumor. Gjithashtu, duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës.

Rritja e temperaturave: Bazuar në të dhënat e paraqitura në komunikimin e tretë që Shqipëria ka bërë për ndryshimet klimatike në tre skenare të përgatitur, tregohet një rritje e mundshme e temperaturës mesatare vjetore përgjatë viteve 2030, 2050, 2080 dhe 2100. Si temperaturë referencë është marrë temperatura mesatare e vitit 1990.

Tabela 51. Skenaret e parashikimit të rritjes së temperatures (*Referuar Tem. Mes. 1990*)

Stinët		Vitet		
	2030	2050	2080	2100
Vjetor	1.0 (0.7 to 1.2)	1.7 (1.3 to 2.2)	2.8 (2.0 to 3.5)	3.2 (2.4 to 4.1)
Dimër	0.8 (0.7 to 0.9)	1.2 (1.1 to 1.4)	2.0 (1.7 to 2.3)	2.4 (1.9 to 2.7)
Pranverë	1.0 (0.8 to 1.12)	1.5 (1.3 to 1.8)	2.6 (2.2 to 3.0)	3.1 (2.6 to 3.6)
Verë	1.6 (0.5 to 1.8)	2.5 (2.1 to 2.8)	4.3 (3.8 to 4.9)	5.3 (4.6 to 6.0)
Vjeshtë	1.0 (1.0 to 1.1)	1.6 (1.5 to 1.8)	2.8 (2.7 to 3.0)	3.5 (3.2 to 3.7)


Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[294]; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Në skenaret e rritjes së temperaturës, në vitin 2050 parashikohet një rritje mesatare e temperaturës me 1.7^{o}C dhe skenari maksimal 2.2^{o}C. Ndërsa në vitin 2080 temperatura

mund të rritet me 2.8ºC, ndërsa vlera maksimale e vlerësuar mendohet të arrijë shifrën 3.5ºC. Në vitin 2100, temperatura mesatare vjetore parashikohet të rritet me 2.4-4.1ºC.

Duke vëzhguar vlerën e rritjes së temperaturës sipas stinëve të vitit, shqetësues është fakti që rritja më e madhe e temperaturës parashikohet të ndodhë në stinën e verës, duke e kthyer atë në një stinë akoma më të nxehtë e të thatë (Figura 99). Temperaturat mesatare vjetore për skenaret e përgatitur mund të rriten me 2.1-2.8ºC në vitin 2050 dhe një rritje me 4.6-6.0ºC në vitin 2100, referuar me temperaturat e vitit 1990. Temperaturat mesatare vjetore, sipas skenareve të hartuara, pritet të arrijnë në 25ºC në vitet 2050 dhe në 30ºC në vitin 2100.

Figura 99. Skenarët e parashikimit të rritjes së temperaturës



Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[295]; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Përveç rritjes së temperaturave në përgjithësi, parashikohet edhe shtimi i fenomeneve ekstreme të motit siç janë numri i ditëve me temperaturë >35°C pa ndërprerje, numri i ditëve me valë të nxehta, dhe numri i ditëve me temperaturë të ftohtë pa ndërprerje.

Tabela 52. Numri i fenomeneve ekstreme të parashikuara deri në vitin 2100 në rajonet bregdetare në vend

Nr. i fenomeneve ekstreme të motit	**Rajon**	**Vitet 1961-1990**	**Vitet**			
			2030	2050	2080	2100
Nr. i ditëve me Tmaks >35º C	Veri	1.7-5.8	5-10	7-14	8-20	10.0-24.0
	Qendër	6 - 4.9	2-9	2-12	3-18	4.0-21.0
	Jug	1.3	4	5	7	8
Nr. i ditëve me valë të nxehta	Veri	19-27	56-60	72-80	95-98	115-120
	Qendër	16	29	36	52	60
	Jug	7	13	16	20	25
Numri i ditëve me temperatura të ulëta	Veri	360	550	670	840	930
	Qendër	686	780	870	980	1100
	Jug	757	860	950	1050	1160

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[296]; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Duke iu referuar të dhënave të mësipërme (Tabela 52) përgjatë gjithë viteve të ardhshme, deri në vitin 2100, do të kemi një rritje të ditëve me temperatura maksimale mbi 35ºC, ku nga 1.7-5.8 në periudhën 61-1990, në vitin 2100 do të arrijnë 10-24 ditë me temperatura mbi 35ºC në veri, ndërsa në pjesën qëndrore dhe jugore kjo vlerë është më e ulët. Gjithashtu, numri i ditëve me valë të nxehta do të rritet përgjatë viteve të ardhshme, nga 19-27 ditë në periudhën 61-1990 në 115-120 në vitin 2100 në pjesën

veriore, ndërsa në atë qendrore dhe jugore vlerat paraqiten më të ulëta. Përsa i përket ditëve me temperaturë me të ulët se 0^{o}C të paraqitura në tabelën e mësipërme, parashikohet një rënie drastike deri në vitin 2100, krahasuar me vitin 1990, nga 10-27 ditë në periudhën 61-1990, në vitin 2100 këto ditë nuk do të jenë të pranishme fare në të gjithë zonën bregdetare. Gjithashtu, edhe ditët me valët e të ftohtit nuk do të jenë të pranishme në vitet 2100.

Tabela 53. Numri i ditëve me fenomene ekstreme të motit në vit: Parashikime

Nr. i fenomeneve ekstreme të motit	Rajon	Vitet 61-1990	Vitet			
			2030	2050	2080	2100
Ditë me T. min < 0^{o}C	Veri	10-27	4-15	0-10	0-3	0
	Qendër	7-32	3-18	0-11	0-5	0
	Jug	3	0	0	0	0
Ditë me valë të ftohta	Veri	30-48	10-15	6-7	0-6	0
	Qendër	32-46	20-32	12-23	6-8	0
	Jug	7	0	0	0	0
Ditë me valë të ngrohta	Veri	1450	1410	1390	1350	1335
	Qendër	1530	1495	1460	1420	1390
	Jug	1168	1130	1110	1090	10702

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[297]; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Si pasojë e rritjes së temperaturës dhe rritjes së numrit të ditëve me valë të nxehta, vendi do të përballet me thatësira të konsiderueshme dhe të nxehta. Ndikim i menjëhershëm do të shihet në rritjen e mesatares vjetore të vdekshmërisë, kryesisht për moshat e treta; në kërkesën në rritje për ujë të pastër; dhe në probleme me përshtatjen e kulturave bujqësore me klimën.

Ulja e sasisë së reshjeve: Një problem i rëndësishëm që pritet të vijë bashkë me ndryshimet klimatike, tashmë të vërtetuara shkencërisht, është ulja e sasisë së reshjeve vjetore dhe shpërndarja e tyre përgjatë vitit.

Tabela 54. Parashikimet e ndryshimit të regjimit të reshjeve (në %) për periudha të ndryshme në lidhje me vitin 1990

Vitet	2030	2050	2080	2100
Vjetor	-3.84 (-35.4 to 27.7)	-8.46 (-56.0 to 47.4)	-14.37 (-78.6 to 81.1)	-18.13 (-89.7 to 94.9)
Dimër	-5.96 (-15.9 to 4.0)	-10 (-27.9 to 7.7)	-14.3 (-44.6 to 16.1)	-18.1 (-55.8 to 19.6)
Pranverë	-2.45 (-11.9 to 7.0)	-7.26 (-25.3to 10.75)	-14.26 (-45.1to 16.6)	-17.7 (-55.3 to 19.8)
Verë	-10.4 (-12.8 to -7.9)	-19.7(-24.1 to -15.3)	-41.9 (-49.2 to -34.5)	-50.4 (-59.4 to -41.3)
Vjeshtë	0.5 (-10.1 to 11.1)	-2.5 (-21.3 to 16.3)	-6.9 (-38.1 to 25.2)	-9.5 (-48.1 to 29.1)

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016[298]; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Në vitet e ardhshme pritet që sasia e reshjeve të ulet rreth 14.37% në vitin 2080 dhe deri në mbi 18% në vitin 2010. Në vitet e ardhshme parashikohet që periudhat e thatësirës të shtohen së tepërmi, si pasojë e uljes së sasisë mesatare të reshjeve vjetore dhe shpërndarjes së tyre përgjatë vitit. Nga të dhënat e skenareve të parashikuara të shpërndarjes së reshjeve vjetore (Tabela 54), vihet re që stina e verës do të jetë mbi 50% më e thatë. Mungesa e reshjeve do të çojë në një verë shumë më të nxehtë dhë të

thatë, duke u kthyer në problem serioz për zhvillimin e bujqësisë, dhe do të nxjerrë në pah shumë probleme të tjera në sektorë të ndryshëm ekonomik.

Rritja e temperaturave në territorin e Bashkisë Lushnje do të ketë një sërë problemesh kryesisht në zhvillimin e bujqësisë dhe në biodiversitet. Zhvillimi bujqësor në territorin e bashkisë do të përballet më kushte klimatike më të thata, e si pasojë do të ketë një rritje të kërkesës për ujë për vaditje dhe nga ana tjetër një ulje në sasinë e reshjeve dhe rezervave ujore të përdorshme për bujqësinë. Shtimi i dëmtuesve (parazitë, mikrobe, insekte) do të jetë një problem ekzistent në rritjen e temperaturës mesatare vjetore. Biodiversiteti do të preket ndjeshëm nga kohëzgjatja e periudhave të nxehta gjatë vitit dhe mungesës së reshjeve, si pasojë dhe intensifikimi i zjarreve të cilët dëmtojnë specie dhe habitate në tërësi. Për zhvillimin sa më të qëndrueshëm të biodiversitetit duhen marrë masa në kohë sa më të hershme, për adoptimin e bujqësisë dhe gjetjen e mënyrave për plotësimin e nevojës me ujë për vaditje.

Rritja e temperaturave në territorin e Bashkisë Lushnje do të ketë një sërë problemesh në zhvillimin bujqësor, i cili është sektori me numrin më të madh të të punësuarve në territor. Zhvillimi bujqësor në territorin e bashkisë do të përballet me kushte klimatike më të thata, si pasojë do të ketë një rritje të kërkesës për ujë për vaditje dhe nga ana tjetër një ulje të sasisë së reshjeve dhe rezervave ujore të përdorshme për bujqësinë. Shtimi i dëmtuesve të bujqësisë (parazitë, mikrobe, insekte), do të jetë një problem ekzistent më rritjen e temperaturës mesatare vjetore. Për zhvillimin e sektorit bujqësor sa më të qëndrueshme duhen marrë masa në kohë sa më të hershme, për përshtatjen e bujqësisë dhe gjetjen e mënyrave për plotësimin e nevojës me ujë për vaditje.

Shtimi i fenomeneve ekstreme të motit: Përgjatë viteve, fenomenet ekstreme të motit si përmbytjet, valët e të nxehtit etj. kanë qënë të pranishme në vendin tonë. Përmbytjet kanë një ndikim të madh në aspektin e jetës së njerëzve, ekonomisë, bujqësisë dhe mjedisit. Pika kulminante e përmbytjes në vitin e fundit është regjistruar në vitin 2010, në të cilën humbjet arritën në rreth 0.15% të PBB-së së vendit. Në vitet që vijnë, fenomeni i përmbytjeve i ndihmuar nga shirat intensive që pritet të shtohen, parashikohet të shpeshtohet. Stina e verës do të pësojë ndryshime të theksuara duke krijuar kushte ekstreme si temperatura të larta dhe periudha të zgjatura të thata. Ndërsa në zonat bregdetare, me rritjen e temperaturave dhe intensifikimin e reshjeve, parashikohet të formohen stuhi, të cilat do të kenë një ndikim jo të vogël në ato zona.

Në të shkuarën, pjesë të territorit të Lushnjes janë bërë subjekt i përmbytjeve të vazhdueshme nga lumenjtë (kryesisht ai Seman), në vitet e fundit ky fenomen po kthehet i përvitshëm edhe pse në shkallë të ndryshme. Në skenarët e parashikimit të ndryshimit të klimës, theksohet shtimi i fenomeneve ekstreme të motit, kryesisht shtimi i shirave itensivë, të cilët janë tepër problematikë në fryrjen e menjëhershme të lumenjve dhe si pasojë përmbytjet do të jenë më të mëdha. Zonat breglumore, apo dhe zona përreth, do të jenë tepër të prekura nga përmbytjet që parashikohen në të ardhmen, ndaj duhen marrë masa të menjëhershme për përballimin e këtij fenomeni, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe të zonave urbane.

Rritja e nivelit të detit[299]: Niveli i detit Adriatik ka pësuar një rritje prej 15cm gjatë shekullit të shkuar, Në dekadat e ardhshme deri në vitin 2100, niveli i detit pritet të rritet me 40 cm. Rritja e konsiderueshme e nivelit të detit do të sjellë një sërë pasojash negative përgjatë vijës bregdetare, kryesisht në tokat bujqësore, habitatet bregdetare dhe mbi zonat turistike. Si rezultat i rritjes së nivelit të detit, deri në vitin 2050, rreth 1,082.45 km^2 (32% e zonës bregdetare, osë 3.76% e sipërfaqes së vendit) do të vuajë

pasoja të drejtpërdrejta nga përmbytjet. Pjesë të konsiderueshme të tokës bujqësore do të konsiderohen të humbura, apo të papërdorshme, për shkak të rritjes së nivelit të detit dhe kripëzimit. Shumica e habitateve bregdetare të tilla si dunat ranore, ligatinat me ujë të njelmët, lagunat, do të pësojnë ndryshime të konsiderueshme, disa prej tyre do kenë humbur totalisht funksionin dhe të tjera do të jenë të dëmtuara në shkallë relativisht të lartë.

Ne territorin e Bashkisë Lushnje rritja e nivelit të detit nuk ka një impakt dikrekt, pasi territori i kësaj Bashkie nuk është bregdetar. Mendohet që rritja e nivelit të detit të ndikojë në kripëzimin e ujërave nëntokësore dhe në kripëzimin e tokave bujqësore në një të ardhme më të largët.

- Sektorët ekonomikë më të prekur nga ndryshime klimatike

Bujqësia[300] **:** Sektori i bujqësisë është një nga drejtuesit kryesorë të ekonomisë shqiptare. Në vitin 2011 sektori i bujqësisë numëronte 54.6% të të punësuarve, dhe kontribuonte në 20% të PBB-së. Bujqësia është shumë e ndjeshme ndaj ndryshimeve afatshkurtra të motit, luhatjeve sezonale dhe vjetore. Ndryshimi i klimës dhe rritja e temperaturës kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në uljen e prodhimit, shtimin e dëmtuesve në bujqësi (insekteve, parazitëve etj.) Gjithashtu, ndryshimi i klimës do të sjellë ulje të sasisë së reshjeve, sidomos në periudhën e verës duke çuar në rritjen e kërkesës për ujë dhe uljen e mundësisë për të pasur ujë të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat gjithnjë e në rritje që ka bujqësia për ujë. Me rritjen e temperaturës, kulturat bujqësore do të hasin probleme me përshtatshmërinë e tyre rajonale. Kjo nënkupton që përgjatë dhjetëvjeçarëve të ardhshëm nevojitet të përshtatim llojin e të mbjellave me lloje më rezistente ndaj thatësirës dhe varietete që kërkojnë më pak ujë. Frutat dhe perimet do të jenë më të prekura nga ndryshimet klimatike, pasi rritja e temperatures shton stresin tek këto bimë, duke ulur prodhimtarine e tyre ose duke vështirësuar rritjen e tyre.

Në territorin e Bashkisë Lushnje, sektori i bujqësisë është shumë i rëndësishëm për ekonominë e zonës. Problemet që sjell ndryshimi i klimës do të shkaktonin një ndikim të madh negativ në zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme, si pasojë uljen e të ardhurave për banorët. Problemet kryesore në territorin e bashkisë mund të hasen në përshtatjen e kulturave me ndryshimin e klimës, plotësimi i kërkesës për ujë për vaditje dhe humbja apo kripëzimi i tokave bujqësore nga rritja e nivelit të detit.

Burimet ujore (energjitika, HEC-et dhe burimet ujore)[301]: përbërësit kryesorë të ciklit hidrologjik janë avullimi, transpirimi dhe reshjet. Ndryshimi i parametrave klimatikë, rrezatimi diellor, shpejtesia e erës, temperatura dhe lagështia ndikojnë drejtpërsëdrejti në fenomenin e avullimit. Ndryshimi i avullimit dhe reshjeve do të ndikojë në bilancin ujor në vend. Reshjet mesatare vjetore në dekadat e ardhshme priten të ulen rreth 18%, ndërsa rastet e shirave intensive parashikohen të jenë më të shpeshta, duke rritur shpeshtësinë e përmbytjeve. Duke patur parasysh që energjia elektrike në vend plotësohet nga HEC-et, rritja e temperturës do të shtojë mungesën e ujit për të plotësuar nevojat përgjatë gjithë vitit për energji. Zgjatimi i periudhës së thatë në stinën e verës, shkrirja e dëborës në male, dhe mungesa e reshjeve në periudha të caktuara të vitit do të jetë një problem madhor në plotësimin e nevojave me ujë për sektorë të ndryshëm si energji, bujqësi, etj. Prodhimi i energjisë pritet të paraqesë vështirësi në manaxhimin e situatave, duke qënë se ndarja e sasisë së reshjeve përgjatë vitit do të ketë diferenca të konsiderueshme. Rezervuarët e HEC-eve parashikohet të tejmbushen në periudha të caktuara dhe të vuajnë mungesën e sasisë së ujit në periudhën e verës. Megjithatë, edhe në rastin më të keq diferencat midis

prodhimit dhe nevojës së ujit mund të zbuten me çështje teknike dhe politika të ndryshme.

Përmbytjet nga rrjedhat e lumenjve do të jenë një problem serioz dhe me i shpeshtë në dekadat e ardhshme. Shirat e rrëmbyeshme që sjellin vërshimin maksimal të lumenjve në kohë të shkurtër parashikohet të jenë problemi kryesor i përmbytjeve në pjesën fushore të vendit. Periudha nëntor-mars kur sasia e reshvjeve është më e madhe (80-85% e sasisë vjetore) parashikohet periudha më problematike për përmbytjet.

Vlen të theksohet se rritja e temperaturës sjell edhe zgjatjen e harkut kohor brenda të cilit mund të kultivohet përgjatë vitit, gjë që mund të ketë ndikime pozitive në bujqësi. Mundësia e kultivimin në një periudhë më të gjatë kohore dhe mundësia e futjes së kulturave të reja në bujqësi mund të çojë në rritjen e prodhimtarisë.

Turizmi[302]: Kontributi i sektorit të turizmit për PBB-në është 7.6%, referuar vitit 2009. Ndryshimi i klimës është parashikuar të ketë një ndikim jo të vogël në sektorin e turizmit në vend, pozitiv dhe negativ. Deri në vitin 2030 parashikohet që periudha tetor-maj të jetë e papërshtatshme për turizëm ndërsa periudha tjetër do të jetë mëse e përshtatshme për zhvillimin e turizmit të diellit dhe detit. Të dhënat për vitin 2050 përcaktojnë prillin si muaj të pranueshëm për zhvillimin e turizmit bregdetar, ndërsa maj - tetor cilësohen muaj të shkëlqyer për zhvillimin e turizmit bregdetar. Parashikimet për vitin 2080 përcaktojnë vetëm muajt dhjetor, janar dhe shkurt si muaj të papërshtatshëm për turizëm diellor e detar, ndërsa muajt e tjerë janë mëse të përshtatshëm. Aktualisht, 80% e turistëve që hyjnë në Shqipëri janë të përqëndruar në zonën bregdetare. Me rritjen e temperaturave, ky numër pritet të rritet duke çuar kështu në rritjen e presionit ndaj mjedisit, ndotjes të zonave nga mbetjet, ndotjen e ajrit dhe ujit. Manaxhimi i mbetjeve, ujërave të ndotur urbane si dhe siguria për ujë të pastër është një nga sfidat kryesorë me të cilat do të përballet sektori i turizmit në vend.

Popullsia: Ndryshimi i klimës parashikohet të ndikojë në shëndetin e banorëve në zonën bregdetare dhe veprimtarinë e tyre ekonomike kryesore si turizmi dhe bujqësia. Krahas kësaj, do të ketë rreziqe kërcënuese të cilat do të ndikojnë në sigurinë e jetës (përmbytjet, zjarri, rritja e mikroveve dhe insekteve që transmetojnë sëmundje ngjitëse, ulja e rezervave të ujit të pijshëm, ushqimi, energjia, cilësia e mjedisit dhe peizazhit). Rritja e nivelit të detit dhe përmbytjet e lumenjve do të jenë një problem tepër shqetësues në zonat fushore, kënetat apo ish-kënetat të cilat janë në disnivel nga deti (deri në 2m). Në këto zona ka ardhur në rritje numri i popullsisë që nga viti 1950, kur toka bujqësore është përftuar nga bonifikimi i kënetave dhe shkripëzimi i tokave në afërsi të vijës bregdetare.

Përveç ndikimit mbi popullsinë, një numër i konsiderueshëm i banesave të ndërtuara gjatë 24 viteve të fundit pritet të dëmtohen nga përmbytjet. Rreth 41,625 banesa të ndërtuara deri në 0.5 m mbi nivelin e detit rrezikohen të përmbyten deri në vitin 2030, dhe 48,730 ndërtesa të cilat janë ndërtuar mbi nivelin e detit priten të preken nga përmbytjet pas vitit 2050. Lagështia e tepërt dhe përmbytjet do të kenë një ndikim të madh në popullsi pasi shumica e kateve të para të banesave nuk kanë hidro-izolim. Në vitet e ardhshme priten përmbytje (si ato të vitit 2010) dhe stuhi të cilat, krahas dëmeve materiale, mund të shkaktojnë dhe humbje në njerëz, ashtu si në shumë vende europiane dhe fqinje. Në zonat bregdetare, nga rritja e frekuences së përmbytjeve, pritet që ndikim të madh të ketë në infrastrukturë sipërfaqësore dhe nëntokësore si kanalizime, rrjet energjie, telefoni, interte, etj. [303]

- Përfundime dhe rekomandime

Ndryshimet klimatike tashmë janë një realitet. Ky ndryshim i klimës ka ndikim të madh në shumë fusha të zhvillimit të vendit, sidomos në atë bujqësor dhe energjitik. Vetëm sektori i bujqësisë ka rreth 50% të punësuarve në Shqipëri. Gjithashtu, kontributi i këtij sektori ne PPB arrin në 24%.[304] Në këtë kontekst shihet më se e rëndësishme të merren masa të rëndësishme për planifikimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe industrisë duke patur parasysh ndryshimet klimatike. Disa nga këto masa në bujqësi përfshijnë përshtatjen kulturave bujqësore me ndryshimet e klimës, manaxhimin e duhur të burimeve ujore, rritjen e kapaciteteve kulluese dhe ato ujitëse, masa për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve, mbrojtjen e tokës nga erozionit etj.


Popullsia në territorin e Bashkisë Lushnje do të përballet me jo pak probleme në të ardhmen për shkak të ndryshimeve klimatike. Ndër problemet kryesore që do të hasen në territorin e Bashkisë janë: shtimi i rasteve të zjarrit, thatësira të zgjatura, përmbytjet nga fryrja e rrjedhave të lumenjve dhe kërkesa në rritje për ujë në bujqësi dhe në uljen e sasisë së ujit të përdorshëm nga ky sektor. Popullsia në territorin e Bashkisë, në zonat të cilat janë në kuota të ulëta mbi nivelin e detit, do të pësojnë kripëzimin e ujit të pijshëm dhe kripëzimin e tokave bujqësore. Ndërsa zonat e banuara në afërsi të brigjeve të lumenjve do të preken së tepërmi nga përmbytjet, të cilat priten të shtohen si pasojë e shirave itensiv. Zhvillimi bujqësor do të sigurojë të ardhura më të pakta për banorët, pasi rritja e periudhës së thatësirave çon në rritjen e kërkesës për ujë dhe aktualisht kanalet ujitës nuk janë totalisht në funksion. Gjithashtu parazitët dhe shtimi i numrit të insekteve që transmetojnë sëmundje do të jetë një problem serioz në përhapjen e epidemive të ndryshme.

4.9 Trashëgimia historike dhe kulturore

- Ura në Përroin e Lungës në fshatin Karbunarë e Madhe, Karbunarë Lushnje, kategoria I, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës) 266/1, 16.02.1979
- Ura në Përroin e Kasharajt në Kasharaj, Karbunarë Lushnje, kategoria I, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës) 266/1, 16.02.1979
- Manastiri i Shën Mërisë në anën e djathtë të rrugës Lushnje-Fier, në kodrën me kuotë 202, godinë me komunoren me një largësi prej 5 m nga muret e kishës, Ardenicë, Kolonjë, Lushnje, i miratuar me ligjin nr. 609, datë 24.05.1948, 586 4874, 17.03.1948, 23.09.1971
- Kisha e Shën Marisë. Bishqethëm, Kolonjë Lushnje, kategoria I, Rektorati i Universitetit Shtetëror,nr. 6,15.01.1963
- Kisha e Shën Kollit në fshatin Toshkës, Allkaj Lushnje, kategoria I,Rektorati i Universitetit Shtetëror, nr. 6, 15.01.1963
- Kisha e Shën Kollit në fshatin Krutje e Sipërme, Krutje Lushnje, kategoria I,Rektorati i Universitetit Shtetëror,nr. 6, 15.01.1963
- Kisha e Shën Todhrit në fshatin Kadipashaj Lushnje, kategoria I,Rektorati i Universitetit Shtetëror,nr. 6, 15.01.1963
- Ndërtesa ku u mbajt Kongresi i Lushnjes në qytetin e Lushnjes, kategoria I, Rektorati i Universitetit Shtetëror,nr. 6, 15.01.1963

- Çezma e Kongresit në qytetin e Lushnjes. Çezma ndodhet pranë shtëpisë-muze "Kongresi i Lushnjes" dhe me mbishkrimin që përkujton datën historike të punimeve të këtij kongresi. Përveç vlerës përkujtimore, ajo përfaqëson një shembull interesant në traditën e çezmave të vendit tonë. Lushnje, Komiteti i Kulturës dhe Arteve, nr. 8, 18.12.1987

Figura 100. Rëndësia Kombëtare në territor, Bashkia Lushnje



Burimi: Bashkia Lushnje dhe Co-PLAN, 2016

4.10 Zonat e nxehta mjedisore dhe aktiviteti industrial

Kryesisht, në Republikën e Shqipërisë ndotjet më të mëdha janë trashëguar nga aktiviteti industrial i cili u zhvillua gjatë dekadave kur vendi udhëhiqej nga politikat e sistemit komunist. Të gjitha industritë e asaj kohe gjeneruan mjaftueshëm mbetje të cilat qëndruan të stokuara në nivele primitive të sigurisë teknike. Në vitin 1990, industria kontribuonte në më shumë se 37% të GDP-së në vënd. Ky indikator u ul në 12% në vitet 1999 ku edhe sot karakterizohet nga ulje-ngritje të cilat janë kryesisht produkt i politikave të paqëndrueshme të miratuara e të shfuqizuara në vendin tonë.

Problematikat lidhur me këto zona filluan të evidentoheshin me shkatërrimin e këtyre industrive dhe lënien pa mirëmbajtje e kontroll të këtyre depozitave të kimikateve dhe elementëve ndotës në mjedis, me afrimin e zonës urbane me ato industriale, gjithashtu edhe me papërgjegjshmërinë e individit, që e komplikuan mjaftueshëm situatën e këtyre vatrave.

Sot, numërohen të paktën 9-10 vatra të nxehta mjedisore në të gjithë vëndin, por lista mund të zgjatet nëse tregohemi të matur dhe realistë kur marrim në konsideratë ndotjet e vazhdueshme të gjeneruara nga ujërat e ndotura të zonave urbane dhe

industriale si edhe nëse vlerësojmë situatën e mbetjeve në të gjithë vendin e veçanërisht në vend-depozitime të cilat shpesh i gjejmë brigjeve të lumenjve apo në zona totalisht të papërshtatshme.

Konkretisht në Bashkinë Lushnje industria ka qënë mjaft aktive kohë më parë, e fokusuar në sektorin e prodhimit dhe përpunimit të plasmasës, e magazinimit të pesticideve të përdorura gjerësisht në bujqësi etj. Në Lushnje janë evidentuar tre pika të nxehta lidhur me rrezikun potencial që shfaqin mbetjet industriale, ku në ish-qendrën sanitare janë trajtuar rreth 40 ton mbetje pesticide të skaduara, ndërsa një sasi tjetër pesticidesh mbetet e stokuar në magazinat bujqësore si edhe rreth 250 ton kimikate toksike gjenden në ish-fabrikën e plastikës.[305]

- Ish-Uzina e Plasmasit

Në vitin 1994, kjo uzinë përfundoi ciklin e saj duke u mbyllur përfundimisht, ndërkohë që një pjesë e mirë e ambjenteve të saj u privatizuan dhe u përdorën nga subjekte private të cilat ushtrojnë aktivitete të ndryshme, potenciali ndotës i të cilave vlen të përcaktohet në kompleks.

Në një vlerësim paraprak, është konstatur se në këtë territor janë vendosur aktivitete të cilat emetojnë ndotje ende të paadresuar, por kemi edhe prani të aktivitetit bujqësor dhe hoteleve për turizëm ditor.

Nisur nga historiku i kësaj zone propozohet që Bashkia Lushnje së bashku me Inspektoriatin Mjedisor dhe ARM-Fier të realizojnë nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë sigurimin e implementimit të planit afatmesëm dhe afatgjatë për këtë zonë (afërsisht 50,5 ha) siç edhe paraqitet në figurë.

- Magazinat e mbetjeve të industrisë së plasmasës - Plug

Me përfundimin e ciklit të saj, Uzina e Plasmasës së Lushnjes në vitin 1994 u mbyll përfundimisht, ndërkohë që një pjesë e mirë e ambienteve të saj, siç ishin magazinat në Plug, u privatizuan dhe u përdorën nga subjekte private.

Magazinat e përdorura dikur nga Uzina e Plasmasës, sot bartin jashtë çdo kushti të sigurisë teknike, një sasi prej 250 ton substanca kimike.

Të ambalazhuara e të ndara në thasë, vendosur në pirgje mbi njëra-tjetrën, ato mbartin kimikate e toksina tepër helmuese për komunitetit i cili vazhdimisht ka ngritur shqetësime lidhur me aromën e rëndë që merr zona çdo mëngjes si edhe shqetësime të ndryshme shëndetësore.

Në bazë të vendimit Nr. 824, datë 11.12.2003 "*Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme*", klasifikimi i substancave dhe preparateve të rrezikshme bëhet sipas Sistemit Ndërkombëtar, i cili bazohet në vetitë fiziko-kimike, toksikologjike, efektet specifike në shëndetin e njeriut dhe efektet në ndotjen e mjedisit.

Klasifikimi i këtyre kimikateve përcakton njëkohësisht edhe mënyrën e ruajtjes së tyre dhe trajtimin në rast vendimi për transferim apo asimilim.

Figura 101. Zona e ish-Uzina e Plasmasit dhe depozitimet e mbetjeve te plasmasit Plug



Burimi: ASIG; Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

- Vend-depozitimi i mbetjeve urbane – Bashkia Lushnje

Fusha e depozitimit të mbetjeve në Lagjen "18 Tetori" së pari ndodhet shumë pranë banesave ekzistuese të kësaj zone por edhe distancat nga qendra e qytetit, autostrada Lushnje-Fier dhe kanali vadites, janë respektivisht $L_{Q.Q.}$ ~ 2km (vijë ajrore)[306], $L_{Rr.}$ ~ 0,3km (vijë ajrore) [307] . Zgjerimi i sipërfaqes së vend-depozitimit vlerësohet paraprakisht në 2-fishin e sipërfaqes që zinte gjatë vitit 2004.

Figura 102. Ndryshime të hapësirës së përdorur nga vend-depozitimi gjatë 2005-2010



Burimi: Bashkia Lushnje & Co-PLAN

Ky vend-depozitim shërben edhe si pikë vend-grumbullimi për mbetjet inerte, elektronike dhe të tjera. Siç mund të kuptohet, shfrytëzimi efiçent i hapësirës së caktuar si vend-depozitim nuk është respektuar, kjo edhe si pasojë manaxhimit të dobët gjithashtu edhe funksionit të saj si pritës i mbetjeve, të cilat në bazë të ligjit Nr. 10463, Dt. 22.9.2011 & Nr. 9537, datë 18.5.2006 (të përditësuar) [308] duhen administruar nga vetë gjeneruesi dhe ndalohet rreptësisht përzierja e tyre me mbetjet urbane.

Vend-depozitimi i mbetjeve paraqet probleme të mëdha për sa i përket ndotjes së mjedisit dhe rrezikimit të shëndetit të banorëve për arsye të ndryshme. Së pari, ai ndodhet buzë dy kanaleve ujore të hapura që përdoren gjerësisht nga aktiviteti bujqësor**,** duke ndotur vazhdimisht sipërfaqet e mbjella.

Pozicioni në të cilin ndodhet vend-depozitimi i Lushnjes është i përshtatshëm nga ana gjeologjike, për shkak se ndodhet jo mbi akuifer ku poroziteti nuk është i theksuar dhe infiltrimi i shllameve në ujërat nëntokësore vlerësohet të jetë minimal.

Ndër ndotjet që shkaktohen si rezultat i kushteve teknike nën të cilat operon ky vend-depozitim është edhe çlirimi i gazrave toksike (metani CH_4) si produkt i procesit të kompostimit të shtresave më të vjetra të mbetjeve organike dhe jo vetëm.

Ky produkt kimik, në formën e tij të gaztë mund të kapej me anë të skemave të rikuperimit ku të përpunohej e të ofrohej si një LDG (Lëndë Djegëse Gaz) për të prodhuar enegji elektrike ose mekanike.

Në rastin e vend-depozitimit Lushnje, gazi metan, çlirohet i gjithi në atmosferë duke kontribuar si gaz i efektit serë gjithashtu duke ndotur me aromën e tij të fortë. Vend-depozitimi paraqet probleme edhe në lidhje me ndotjen e ajrit për shkak të djegies së mbetjeve plastike që kryhet në këtë zonë.

Ky vend-depozitim nuk ka status ligjor si landfill ndaj edhe ndërhyrja urgjente për rehabilitimin e kësaj sipërfaqeje dhe ndalimin e aktivietit të depozitimit të mbetjeve paraqitet tepër urgjente.

Një aspekt tjetër tejet i rëndësishëm është fakti se vend-depozitimi i Lushnjes ndodhet shumë pranë banesave ku ndikohen drejtpërsëdrejti mbi 30 familje.

Si përfundim, mund të thuhet se vend-depozitimi i Lushnjes duhet konsideruar një vatër e nxehtë mjedisore që rrezikon shëndetin e banorëve, si edhe ndotjen e tokave bujqësore dhe ajrit.

Për këtë arsye, lipset mbyllja ose ndërhyrja emergjente në të sipas kërkesave të përgjithshme të Aneksit 1 përcaktuar në VKM-në nr. 452, datë 11.07.2012, ku i kërkon operatorëve të vend-depozitimeve, të pajisur apo jo me leje, që t'i mbyllin këto vend-depozitime brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi janë jashtë kushteve higjieno-sanitare ose të marrin masa për të realizuar ndërhyrjet e listuara në Aneksin 1 brenda 8 viteve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

- <u>Kanalet kullues e vaditës dhe trupat ujorë sipërfaqësorë</u>

Në mungesë të sistemit të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, qoftë për ujërat urbane edhe për ato industriale e bujqësore, zgjidhja më e shpejtë dhe më e përdorur është shkarkimi i tyre në kanale të hapura apo trupa ujorë sipërfaqësorë.

Shërbimi i grumbullimit dhe kanalizimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet vetëm në qytetin e Lushnjes dhe thuajse aspak në Nja-të e saj. Shërbimi i ofruar është në nivele të pakënaqshme, kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar si pasojë e vjetërsisë së tij si edhe si pasojë e konstruksionit të tubove prej materiali betoni ku lidhja midis seksioneve është kryer me llaç. Ky sistem është i kombinuar, mbledh si shkarkimet e ujërave të ndotura gjithashtu edhe ujërat e larta. Nuk ofrohet asnjë nivel trajtimi i këtyre ujërave dhe shkarkimet ndodhin mbi trupat ujorë sipërfaqësore më të afërta.

Kompozimi i këtij sistemi për grumbullimin e ujërave të ndotura urbane është i tillë që njëkohësisht ai grumbullon ujërat e larta, si edhe shkarkime të ndryshme e të pakontrolluara, që ndodhin në kolektorë, apo kanalet e hapura dedikuar këtij sistemi.

<u>Zonat Urbane:</u> Bashkia Lushnje mbulon me shërbimin e kanalizimit të ujërave të ndotura vetëm një pjesë të popullsisë së qytetit të Lushnjes, por nuk disponohet një shifër përmbledhëse e saktë si pasojë e mungesës së dixhitalizimit të rrjetit të kanalizimeve në këtë Bashki.

Zonat Rurale: Në zonën rurale të Bashkisë Lushnje nuk ekziston ndonjë sistem i organizuar inxhinierik i mbledhjes dhe largimit të ujërave te ndotura.

Uëjrat e ndotura të çdo shtëpie largohen në gropa individuale në oborret e shtëpive të cilat nuk respektojnë standardet tekniko-sanitare të gropave septike me ose pa filtrim. Në mjaft raste largimi i tyre bëhet edhe në kanale të hapura kulluese që kalojne pranë shtëpive të tyre e që gjithashtu janë në kundërshtim me respektimin e kushteve sanitare te largimit te tyre.

Shkarkimi dhe trajtimi i këtyre ujërave, si edhe i ujërave industriale është problemi më i madh sanitar që mund të paraqitet sot në Bashkinë Lushnje, për arsye se të gjithë kolektorët i shkarkojnë ujërat e ndotura të patrajtuara në sipërfaqe ujore sipërfaqësore.[309]

Ky sistem është ndërtuar rreth viteve 1968 dhe 1980, vite këto që përkojnë me ndërtimin e banesave të reja. Pas viteve 1990, nuk është ndërhyrë më në këtë sistem. Si rrjedhojë, ndërtimet e pas-viteve 1990 janë të pakontrolluara dhe të paplanifikuara[310] në aspektin e ofrimit të infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe kanalizime.

- Industria e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës:

Sipas Albpetrolit[311], në territorin e Bashkisë Lushnje perfshihen dy vendburime të naftës që janë Neogjeni Kolonjë (suita Bubullima) ku perfshihet zona e Kolonjës dhe Murrizi.

Tabela 55. Rezervat e llogaritura të naftës dhe gazit në Lushnje

Rezervat e Naftës		
Emërtimi i vendburimit		Rezevat e llogaritura të naftës (ton)
Neogjeni Kolonjë (suita Bubullima)		144,700
Murrizi		Nuk ka rezerva te llogaritura veçmas për objektin e Murrizit
Rezervat e Gazit		
Emërtimi		Rezevat e llogaritura të gazit natyror (Nm^3)
Vendurimi i Gazit Divjakë	Tortonian	1,614,000,000
	Pliocen	489,000,000
TOTALI		**2,103,000,000**


Burimi: Albpetrol, 2016

Puset ndodhen në zonën e Bubullimës dhe Kolonjës në Bashki. Kjo zonë është zonë shfrytëzimi që shtrihet në territorin e Bashkisë Lushnje dhe atë të Fierit. Zona naftëmbajtëse e Fierit e Lushnjes shfrytëzohet nga Kompania private *Sherwood Petroleum Ltd. (Degë e Bankers Petroleum Ltd.)*. [312] Bankers Petroleum Ltd. (Sherwood International Petroleum Ltd.) ka lidhur një marrëveshje[313] me Kompaninë Albpetrol në vitin 2007 për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në vendburimin e Fierit. Zona e kontrates [314] e shfrytëzuar nga Bankers Petroleum Ltd. shtrihet në Fier dhe Lushnje, në të dy anët e Lumit Seman në zonën e Kallmit dhe paraqitet si më poshtë.

Në vitin 2015, kompania Bankers ka prodhuar rreth 2,688 ton naftë.[315] Numri i puseve të shpuara deri në vitin 2014 të raportuar nga vetë kompania ka qenë 536.[316] Duke patur si qëllim rritjen e efikasitetit të veprimtarisë operacionale të shpimit dhe uljen e kostos/shpenzimeve dhe rritjen e kompanisë në të ardhmen, kompania ka futur edhe teknologji të reja të patestuara më parë në vendin tonë, siç janë shpime horizontale për

nxjerrjen e naftës (*primary horizontal drilling*) dhe plasje me ujë dhe kimikate (*Water and Polymer Flooding)* si teknologji për rekuperimin e naftës (Figura 103).

Figura 103. Zonat me shpim horizontal (majtas) dhe teknologjia e përmbytjes me polimer dhe ujë (djathtas: Water and Polymer Flooding)



Burimi: Bankers Petroleum Ltd. (30 Mars 2016, print-screen)[317]

Rreth viteve 2000, falë investimeve të kompanisë Bankers, fusha e naftës Patos-Marinzës u shndërrua sërish në fitimprurëse duke e ringjallur kështu këtë sektor të prodhimtarisë së naftës në vend. Në vitin 2015, Bankers planifikonte hapjen e rreth 60 puseve horizontale të reja (*horizontal wells with a two-rig program*) si vazhdim i shfrytëzimit të fushës Patos-Marinëz.

- <u>Ndotje e mjedisit nga industria e naftës në Lushnje:</u>

Industria e naftës ka operuar për më se 50 vjet. Në zonat e shfrytëzuara në të shkuarën dhe që ende vazhdojnë të shfrytëzohen nga Albpetrol, ndotja është e tokës përreth puseve dhe e burimeve ujore përreth tyre është e dukshme (Figura 103 më sipër), për shkak të përdorimit të puseve me teknologji të vjetër. Kjo ndodh kryesisht në zonën e Murrizit. Në zonën e shfrytëzimit, me reshjet e shiut, ndotja përfundon në burimet ujore më të afërta. Është e rëndësishme të theksohet se nga vëzhgimet në terren, ndryshe nga puset e Albpetrolit të cilët përdorin teknologji të vjetër, në puset me teknologji të re të kompanisë Sherwood International Petroleum Ltd., sipërfaqja e tokës përreth puseve nuk paraqet sheNja ndotjeje.

Në Bashki, industria e naftës ka operuar ndër vite. Megjithatë, në rastin e këtyre kompanive të naftës, mbetet ende i panjohur ndikimi i tyre në mjedis pwr shkak tw mungesës së të dhënave dhe monitorimeve të vazhdueshme të mjedisit.

Lidhur me ***ndotjen e ajrit,*** në Bashki dhe në zonat e naftës nuk ka sisteme monitorimi të përhershme të ajrit për të përcaktuar më përafërsi ndikimin e industrisë së naftës. Të dhënat që ekzistojnë janë të dhëna të monitorimit të ajrit nga vetë kompanitë që opërojnë në zonë.

- <u>Industria e naftës dhe sfidat kryesore mjedisore për Bashkinë në të ardhmen</u>

Sektori i naftës, për vetë llojin e aktivitetit, paraqet sfida të mëdha mjedisore, veçanërisht në vende në zhvillim si Shqipëria të cilët ende nuk kanë një kuadër ligjor dhe procedurial të plotë për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të banorëve nga industria e rëndë.

Në vendin tonë mungon një kuadër legjislativ i plotë ose programe të posaçme që garantojnë mbrojtjen e plotë të mjedisit (dhe kryesisht ujit, ajrit, tokës) nga industria

e rëndë ku përfshihet edhe industria e naftës. Konkretisht, legjislacioni shqiptar rregullon mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjeve të shumta (Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit për Lejet e Mjedisit, e shumë ligje të tjera). Megjithatë, Shqipëria nuk ka ligje të posaçme ose programe që rregullojnë disa procese (shpimin, operimin, ri-injektimin, etj.) të industrisë gjatë aktivitetit të saj. Në përgjithësi, në Shqipëri mungojnë ligje dhe programe që përcaktojnë:

- llojin e teknologjisë së shpimit të puseve të naftës që i përshtatet çdo zonë që shfrytëzohet nga industria e naftës;
- llojin e teknologjisë që industria e naftës duhet të përdorë për veshjen e puseve të naftës;
- procedurat/teknikat/teknologjitë për izolimin e puseve të naftës kur dalin jashtë funksionit dhe monitorimin e tyre;
- mbulimin e shpenzimeve për izolimin e puseve jashtë funksionit dhe rihabilitimin e zonave naftënxjerrëse në rast falimentimi të kompanisë;
- zonimin e territorit për efekt të ri-injektimit (zona ku lejohet dhe zonat ku ky proces mund të shkaktojë ndotje të mjedisit) si dhe
- programe që rregullojnë ri-injektimin e ujërave të ndotura. Ri-injektimi është thjesht një mënyrë për të ricikluar ose futur në vend-depozitim përfundimtar ujërat e ndotura nga industria e naftës. Për këtë arsye, shteti duhet të hartojë një program në të cilin të përcaktohen të paktën disa kërkesa minimale që parandalojnë ndotjen e burimeve ujore nëntokësore dhe mbrojnë shëndetin e njeriut.
- ligje e programe që rregullojnë shpimet për naftë në afërsi (dhe në akuifer) të një akuiferi uji i të cilit përdoret për furnizim me ujë të popullsisë në të sotmen dhe në të ardhmen;
- ligje e programe që rregullojnë shfrytëzimin e burimeve ujore e nëntokësore nga industria e rëndë (dhe ajo e naftës në veçanti në Bashkinë Kuçovë) duke patur parasysh se kjo industri përdor sasi tepër të mëdha uji gjatë aktivitetit të saj;
- ligje e programe që rregullojnë shfrytëzimin e ujërave nëntokësore të thella (mbi 200 m thellësi) me qëllim shmangien e uljes së relievit të tokës, si dhe përcaktimin e zonave të ndjeshme ndaj uljes së relievit (tabanit) të tokës nga mbishfrytëzimi i ujërave nëntokësore ose i mineraleve

Për këtë arsye, mund të thuhet se në mungesë të një kuadri legjislativ të plotë dhe të programeve të posaçme që rregullojnë mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore dhe të nëntokës nga industria e naftës, për disa aspekte që u përmendën më sipër dhe që do të shtjellohen shkurtimisht më poshtë, mbrojtja e burimeve ujore është në varësi të kompanive të naftës dhe jo e garantuar me ligj. Kjo nuk përjashton faktin se disa kompani në vend operojnë sipas praktikave më të mira ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit (Kompania Bankers, p.sh.).

- Përfundime dhe rekomandime për naftën

Zona naftëmbajtëse e Lushnjes vazhdon të shfrytëzohet nga dy kompani nafte të cilat veprojnë me teknologji të ndryshme. Veprimtaria e tyre ndryshon lidhur me ndikimin e industrisë në tokë. Megjithatë, në të dyja rastet mbeten ende shume të panjohura si

ndikimi i industrisë në cilësinë e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, masat e marra për vend-depozitimin e mbetjeve të prodhuara gjatë aktivitetit, burimi i ujit të përdorur dhe sa ndikon kjo në burimet ujore të Bashkisë, masat e marra për parandalimin dhe kontrollin e rrjedhjeve të naftës gjatë aktivitetit, ndikimi i aktivitetit të kompanive në cilësinë e ujërave të Akuiferit të Lushnjes e Semanit, sasia e ujit (baltës/ujit të prodhuar dhe ujit shtresor) që prodhojnë gjatë aktivitetit, vendi i depozitimit të këtij uji të përdorur, puset e ri-injektimit të ujërave të përdorura, numri dhe vendndodhja e tyre, nëse ka të

tilla, gjendja dhe kushtet e puseve të ri-injektimit, ndikimi i tyre në Akuiferin e Semanit, tërmetet e mundshme nga ri-injektimi etj.

Në shumë vende të botës, shumë procese të industrisë së naftës si hapja e puseve, mundësia e hapjes së puseve në rast se afër puseve gjendet një akuifer, lloji i reshjeve të puseve me qëllim mbrojtjen e mjedisit, ri-injektimi, vend-depozitimi i mbetjeve etj. janë rregulluar me ligj. Në vendin tonë, kuadri ligjor për mbrojtjen e burimeve ujore nga industria e naftës në veçanti ka boshllëqe, duke lejuar që kompanitë të përcaktojnë vetë rregullat e mbrojtjes së mjedisit. Për këtë arsye, rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për disiplinimin me ligj të aktivitetit naftënxjerrës, në mënyrë që të shmanget ndotja e mjedisit deri në një pikë të pakthyeshme

- <u>Përfundime dhe rekomandime për zonat e tjera të nxehta</u>

Duke marrë në konsideratë këtë situatë brenda territorit të Bashkisë Lushnje, por edhe nga ndotja e cila akumulohet si rezultat i së njëjtës veprimtari nga Bashkitë e tjera të cilat shkallën e shtrirjes së ndotjes së tyre e kanë deri në Lushnje e më pas drejt detit Adriatik, mund të themi se trupat ujorë sipërfaqësore apo edhe kanalet kulluese janë bartës të një shporte të gjerë me elementë ndotës qoftë organikë apo edhe inorganikë.

Deri më tani, janë kryer studimet e Verësimit të Ndikimit në Mjedis dhe planet e veprimit për rehabilitimin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për Magazinën e Pesticideve dhe Fabrikën e Plasmasës, ndërkohë që asnjë studim apo plan veprimi nuk është ndërmarrë në lidhje me spitalin e Lushnjes.

Duke patur parasysh rreziqet që vatrat e nxehta mjedisore paraqesin për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, nevojitet që të merren masa për pastrimin dhe rehabilitimin e tyre.

5. Vlerësimi mjedisor i ndikimit të PPV-së

5.1 Detyrimet ligjore e institucionale

Tabela 56. Detyrimet ligjore e institucionale

Ligji	Neni	Detyrimet Ligjore/Institucionale për Bashkitë
Vetëqeverisja Vendore		
Ligj nr. **139/2015** **"**Për Vetëqeverisjen Vendore"	Neni 26 Pika 1	Bashkia *siguron*, në nivel vendor, *masat për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja*.
Ajri		
Ligj nr. **162/2014** "Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis"	Neni 4 Pika 3	Bashkia (njësia e qeverisjes vendore) *merr masat për ruajtjen ose përmirësimin e cilësisë së ajrit.*
	Neni 7 Pika 8	Bashkia përgatit (dhe miratohet nga këshilli Bashkiak) *Planin e Aglomeratit dhe Planin e Zonës.*
	Neni 7 Pika 12	Bashkia përgatit, ndryshon ose rishikon një *Plan të Cilësisë së Ajrit.* (në bashkëpunim me ministritë e linjës, AKM-në, ARM-të dhe ISHMPU-në. Ministritë e linjës, AKM-ja, ARM-të dhe ISHMPU-ja sigurojnë të gjithë informacionin përkatës, që disponojnë).
	Neni 8 Pika 3	Bashkia përgatit dhe zbaton/*zbatojnë një Plan Veprimi Afatshkurtër* për një zonë apo aglomerat kur ka rrezik të kapërcehet pragu i alarmit *për Ozonin***.** Në këto raste planet afatshkurtra mbajnë parasysh edhe kërkesat që lidhen me *arsenikun, kadmiumin, nikelin dhe benzo(a)pirenin.*
	Neni 8 Pika 4	Bashkia përgatit dhe zbaton/zbatojnë *një Plan Veprimi Afatshkurtër*, kur ekziston rreziku që të kapërcehen *një ose më shumë vlera kufi* apo vlera të synuara.
Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore		
Ligji Nr. **139/2015** Për Vetëqeverisjen Vendore	Neni 23	Bashkia ngarkohet me detyrën për *prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm*.
Ligj Nr. 156/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. **111/2012** "Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"	Neni 7	Këshillat e Baseneve Ujore dhe Agjencitë e Baseneve Ujore janë organet vendore për manaxhimin e integruar të burimeve ujore.
	Neni 31	Njësia e qeverisjes vendore (Bashkia) dhe çdo institucion tjetër që ka sistemin e tij të furnizimit me ujë, detyrohet të *marrë masa për një kontroll të rregullt të cilësisë së ujit të furnizuar.*
	Neni 61	Bashkia, gjatë hartimit të planeve dhe studimeve të rregullimit të territorit, *merr në konsideratë planet e manaxhimit të burimeve ujore.*
	Neni 72	Organet e qeverisjes vendore (Bashkia) *mbikqyr e detyron subjektet, persona fizikë apo juridikë, për instalimin e pajisjeve për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit në tokë private.*
Ligji Nr. **111/2015** "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar"	Neni 6	Pushteti vendor (Bashkia) *mban bazën e të dhënave të bilancës së rezervave ujore nëntokësore* (dhe gjeologjinë, bilancën e rezervave të mineraleve të dobishme dhe rreziqet gjeologjike) e cila i vihet në dispozicion nga SHGJSH-ja.
	Neni 8	Për kryerjen e shpimeve për ujëra nëntokësore me thellësi mbi 15m nga sipërfaqja e tokës *merret miratim nga SHGJSH-ja përpara se të dorëzohet projekti hidrogjeologjik tek Këshilli i Basenit.*

VKM Nr. **342**, datë 04.05.**2016** "Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre"		*Drejtues të Bashkisë janë anëtarë të strukturës së Këshillit të Basenit Ujor* për zbatimin e manaxhimit të integruar të burimeve ujore (të Basenit përkatës).
VKM Nr. **177** datë 31.03.**2005** "Për Normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"	Pika 7	*Këshilli i Basenit Ujor* (në bashkëpunim me ARM-në, çdo dy vjet) përgatit dhe publikon programet për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së mjediseve ujore pritëse nën juridiksionin e tyre, nga shkarkimet e lëngëta.
Ligji Nr 34/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. **9115**, datë 24.07.**2003** "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura"	Neni 2	*Bashkia bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit për përcaktimin e teknikave, teknologjive dhe metodave më të mira të mundshme për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe të përdorura.* (në përputhje me llojin e natyrën e tyre, hartimin e planeve për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura, krijimin e kuadrit ligjor bashkëkohor, përsosjen e kuadrit ligjor, sigurimin e përdorimit të frytshëm të burimeve finaciare dhe kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarive që shkaktojnë ndotje të ujërave).
Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit, **2013-2020** Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit, **2013-2020**	Kapitulli 2	Kërkohet: *-zvogëlimi i lejeve të shfrytëzimit* me 100% deri më 31.5.2014 -lejimi i shfrytëzimit të inerteve lumore *vetëm për nevojat e ndërtimit* të rrugëve kombëtare deri në vitin 2020.
VKM Nr. **1**, datë 21**.06.2006** "Për Reduktimin e shfrytëzimit të zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve"	Pika 2	Shfrytëzimi i zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve *lejohet vetëm kur ka depozitime të mjaftueshme dhe vetëm në segmente të caktuara*.
	Pika 3	*Periudha e shfrytëzimit të inerteve lumore është 1 qershor-31 tetor.*
	Pika 4	Thellësia e shfrytëzimit të inerteve *lejohet deri në 0.5m mbi nivelin minimal të pasqyrës së ujërave nëntokësore*.
	Pika 5	Sasia e materialit që merret nga çdo subjekt nuk duhet të jetë më shumë se *50% e prurjeve të ngurta vjetore* të zonës e miratuar për shfrytëzim.
	Pika 8	Brenda 2006 në argjinaturat dhe në shtretërit e lumenjve *duhet të hiqen të gjitha impiantet e përpunimit të inerteve dhe materialet e grumbulluara*.
Pyjet & Kullotat		
Ligji Nr 48/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9385, datë 04.05.**2005** "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar"	Neni 4	Bashkia bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit për *hartimin dhe përpunimin e Programit të Zhvillimit të Sektorit të Pyjeve.*
	Neni 5	Këshilli i Bashkisë, në bashkëpunim me shërbimin pyjor, *miraton Planet e mbarështimit të pyjeve Bashkiake dhe private*.
	Neni 7	Bashkia *ngre strukturën për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullosor*.

		Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në Bashki ka aftësi teknike, manaxhuese e këshilluese, e cila (Neni 11) kryen shërbime teknike e publike në fondin pyjor vendor dhe ka këto detyra: -qeverisjen tërësore të pyjeve dhe të tokave pyjore; -mbledh të dhëna për zhvillimin e pyjeve publike dhe private; -ruan ekuilibrin biologjik në fondin pyjor vendor; -mban e administron të gjitha dokumentet për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit të fondit pyjor privat; -mban të dhëna të sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve në pyjet e kullotat e bashkisë; -përgatit projekte për investimet në pyje e kullota; -drejton dhe mbikëqyr punën për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e gërryerjeve, të rrëshqitjeve e të ortekëve brenda territorit të bashkisë; -ndjek, bashkëpunon, harmonizon dhe kryen veprimtari kërkimore; -mbikëqyr zhvillimin e florës e faunës së egër dhe propozimin e metodave për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara, të rralla ose në rrezik; -siguron mbështetje teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të komunitetit; -organizon trajnime e shërbime këshillimore për pronarët privatë; -kontrollon marrjen në dorëzim të punimeve të kryera në pyje e kullota; - mirëmban infrastrukturën në fondin pyjor Bashkiak; -harton zbatimin e një programi për trajnimin e punonjësve të shërbimit pyjor dhe aftësimin e tyre profesional; -mbështet zhvillimin e agropylltarisë.
	Neni 23	-Bashkia: *-administron dhe zhvillon pyjet vendore apo pjesë të tyre sipas planeve të mbarështimit;* - krijohen njësitë tekniko-administrative për një administrim të qëndrueshëm e shumëfunksional të fondit pyjor vendor, për rregullimin e përdorimit e të shfrytëzimit të pyjeve, të kullotave dhe të burimeve të tjera pyjore e jopyjore, për mbrojtjen nga zjarri dhe dëmtuesit; -merr masa *dhe planifikon fonde për investimet në pyjet* brenda territorit, për përmirësimin dhe planifikimin e mbledhjes e të promovimit të pajisjeve të reja të përpunimit dhe të tregtimit të prodhimeve pyjore, si dhe krijon sektorin e agropylltarisë; - *planifikon fonde për ruajtjen, mirëmbajtjen, kryerjen e punimeve silvikulturore* dhe përgjigjet për trajtimin shkencor të tyre; - *merr nisma për shtimin e sipërfaqeve pyjore*, për ripyllëzimin e tokave të braktisura, të zhveshura, të shpyllëzuara dhe të gërryera, në pronësi të tyre. -Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Pyjor ndihmojnë, kontrollojnë, këshillojnë dhe sigurojnë mbështetjen teknike për *njësitë tekniko-administrative* dhe për shoqatat e përdoruesve të pyjeve.
Ligji Nr 49/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. **9693**, datë 19.03.**2007** "Për Fondin	Neni 7	Bashkia dhe pronarët privatë të kullotave e livadheve *i japin ministrisë përgjegjëse të dhëna për inventarizimin e kullotave që zotërojnë*.
	Neni 14	- Strukturat përkatëse të pyjeve dhe kullotave ne njësitë e qeverisjes vendore (Bashki) *hartojnë Planet e Mbarështimit*.

Kullosor", i ndryshuar		-Bashkia *merr pjesë në komisionin teknin që shqyrton Planet e Mbarështimit të Kullotave para se të miratohet* (Planet e Mbarështimit të Kullotave, para se të miratohen, shqyrtohen nga një komision teknik, në përbërje të të cilit është edhe një përfaqësues i Bashkisë).
	Neni 26	Bashkia (dhe pronarët privatë, që zotërojnë kullota dhe livadhe): - *ruan, administron dhe përdor kullotat dhe livadhet;* -harton Planet e Mbarështimit; -merr masa për parandalimin e zjarreve dhe për shuarjen e tyre; -raporton në ministrinë përgjegjëse të dhënat për inventarizimin dhe regjistrimin e fondit kullosor; -njofton ministrinë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet për infeksionet dhe dëmtuesit që shfaqen në kullota e livadhe.
VKM Nr.436, datë 8.6.2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.**1374**, datë 10.10.**2008** "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor"	Pika 2	Bashkia *paraqet në Ministrinë e Mjedisit kërkesën për heqjen e sipërfaqes nga fondi kullosor*.
Ligji nr. **5/2016**, "Për shpalljen e memorandumit në pyje në Republikën e Shqipërisë"	Neni 7	Bashkia *zbaton moratoriumin 10 vjeçar të pyjeve.*
Udhëzim Nr. **1**, datë 09.06.**2016** "Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për Dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik"	Pika 1	Bashkia *jep në përdorim me kontratë qiraje ,nëpërmjet procedurës së konkurimit publik, sipërfaqe të fondit pyjor/kullosor në pronësi*.
Zonat e mbrojtura		
Ligji Nr 9868, datë 4.2.2008 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. **8906**, Datë 6.6.**2002** "Për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar"	Neni 13	Bashkia *merr pjesë në vendosjen e statusit të një zone si zonë e mbrojtur* (Ministria shpall zonat e mbrojtura pas konsultimit me organet e qeverisjes vendore. Zonat e mbrojtura shpallen ato territore që janë pronë publike, Bashkiake, komunale dhe në raste të veçanta pronë private).
	Neni 15	Bashkia *bashkëpunon* me Ministrinë e Mjedisit dhe organet e tjera shtetërore dhe/ose me të tretët, *për hartimin e Planene të Manaxhimit për secilën zonë të mbrojtur*.
	Neni 19	Bashkia, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe atë ndërtimore, *ndalon zbatimin e projekteve që bien ndesh me planin e manaxhimit të zonës.*
	Neni 22	Bashkia *merr pjesë në heqjen e statusit të një zone të mbrojtur*.

	Neni 25	Bashkia *nxit dhe përkrah nisma, projekte, programe e veprimtari, që synojnë përmirësimin e treguesve ekologjike e natyrorë* të një zone të mbrojtur.
Biodiversiteti		
Ligji Nr. **139/2015** "Për Vetëqeverisjen Vendore"	Neni 27	Bashkia *mbron natyrën dhe biodiversitetin*.
Ligji Nr 68/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. **9587**, Datë 20.07.**2006**, "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit", i ndryshuar	Neni 7	Bashkia (dhe organet shtetërore, qëndrore) *administron dhe mbron burimet natyrore* përbërës të biodiversitetit.
	Neni 8	Bashkia *merr pjesë në hartimin dhe rinovimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Biodiversitetit.* (ky plan hartohet nga Ministria e Mjedisit me pjesëmarrjen e organeve shtetërore, qëndrore dhe vendore, komunitetit shkencor dhe shoqërisë civile).
	Neni 19	Bashkia *përfshin ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të llojeve dhe habitateve të specieve tokësore, ujore dhe detare në politikat, planet, programet dhe në vendimmarrje.*
	Neni 26	Bashkia *bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit* për hartimin e Planit të Veprimit për Ruajtjen e Llojeve Veçanërisht të Mbrojtura. Bashkia përfshin Planin e Veprimit për Ruajtjen e Llojeve Veçanërisht të Mbrojtura në strategjitë, planet, programet dhe në vendimmarrjet shtetërore, në nivel kombëtar dhe vendor.
	Neni 29	Bashkia *përfshin ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të racave dhe varieteteve autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet në nivel vendor*.
	Neni 46	Bashkia: -*siguron mbështetjen e publikut* për të ruajtur diversitetin biologjik dhe për t'i përdorur përbërësit e tij në mënyrë të qëndrueshme -*boton* të dhëna dhe programe ndërgjegjësimi dhe edukimi për diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij
Ligji Nr.9386, datë 04.05.**2005** "Për Muzetë"	Neni 8	*Administron* (drejton) muzetë vendorë.
	Neni 12	*Miraton strukturën* dhe organikën e muzeve tipologjike dhe vendore.
Ligji Nr 41/2013 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.**10006**, datë 23.10.**2008** "Për Mbrojtjen e Faunës së Egër", i ndryshuar	Neni 40	-Bashkia *mbron faunën e egër*, brenda hapësirës në pronësi të Bashkisë. -Bashkia, Policia Pyjore dhe Inspektorati i Peshkimit bashkëpunojnë me veterinerin zyrtar dhe inspektorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për të bërë më të efektshëm kontrollet.
VKM Nr.**84**, datë 27.01.**2009** "Për Caktimin e Kritereve Për Ngritjen e Rrjetit Të Inventarizimit dhe Të Monitorimit Të Biodiversitetit"	Pika 3	Bashkia *bën pjesë në Rrjetin e Informatizimit dhe Monitorimit të Biodiversitetit*, i cili ngrihet nga AKM-ja. Rrjeti ka këto detyra: -monitorim afatgjatë; -të sigurojë zbatimin e legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e biodiversitetit; -të mundësojë sistemimin e të dhënave të përdorshme për vendimmarrësit; -të informojë për biodiversitetin dhe për ndërgjegjësimin e publikut për ruajtjen e tij; -të ndërtojë një sistem inventarizimi dhe monitorimi; -të krijojë një sistem informacioni për mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave.
	Pika 5	Bashkia *bashkëpunon* me Ministrinë e Mjedisit *për hartimin e Projektprogramit të Monitorimit të Biodiversitetin* për

		vitin pasardhës
Ligji Nr 43/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. **10253**, datë 11.03.**2010** "Për gjuetinë"	Neni 12	Bashkia *merr pjesë aktive në propozimin e zonave të gjuetisë,* kur zona ndodhet brenda territorit të saj.
	Neni 56	Bashkia *ndihmon në monitorimin dhe kontrollin e zonave të gjuetisë* për zbatimin e ligjit.
Toka dhe Bujqësia		
Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"	Neni 26	Bashkia *merr masa për mbrojtjen e cilësisë së tokës* nga ndotja.
	Neni 27	Bashkia *administron shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.*
Ligji Nr 131/2014 Për ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9244, datë 17.06.2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore"	Neni 8	Komisioni i Mbrojtjes së Tokës (KMT), në përbërje të të cilit është kryetari i Bashkisë dhe kryetarët e Nja-ve, *kontrollon dhe studion çështje të veçanta për masat mbrojtëse për tokën bujqësore*.
	Neni 10	Këshilli Bashkiak *merr vendime në funksion të ruajtjes së tokës,* bashkërendimit të veprimtarive për mbrojtjen e tokës me bashkitë e tjera dhe shqyrtimit të ankesave që vijnë nga qytetarët apo institucionet e tjera.
Ligji Nr. **7501**, datë 19.07.**1991** "Për Tokën", i ndryshuar	Neni 21	Bashkia *ndalon çdo zënie ose përdorim të paligjshëm të tokës.*
VKM Nr. **121**, datë 17.02.**2011** "Për Mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga DAMT-i në qarqe dhe ZMMT-ja në komuna dhe/ose Bashki"	Kapitulli 4	ZMMT-ja: -manaxhon dhe mbron tokën bujqësore shtetërore dhe private, si dhe kategori të tjera të burimeve; -grumbullon dhe sistemon dokumentacionin e ri kadastral për tokën bujqësore; -evidenton tokat bujqësore të pakultivuara.
	Kapitulli 5	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) dhe ZMMT-ja *kanë për detyrë ndryshimin e kategorisë së tokës bujqësore vetëm kur mbi të kanë vepruar fenomene natyrore të mëdha* si tërmetet, vullkanet, rrëshqitjet e tokës, përmbytjet, zjarret masivë etj.
VKM Nr. **410**, datë 27.06.**2012** "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës"	Kapitulli 2	Komisioni i ndryshimit të kategorive të burimeve, i Bashkisë ose NJA-ve *shqyrton kërkesën për ndryshimin e tokës nga burim pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh në kategorinë e burimit tokë bujqësore* brenda afateve të përcaktuara dhe merr vendimin përkatës.
Udhëzim Nr. **1**, datë 18.7.**2012** "Për Procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara"	Pika 5	Kryetari i Bashkisë : -shqyrton kërkesat dhe merr vendimet për marrjen me qira të tokës sipas kërkesave të paraqitura; -organizon procedurën e garës kur për të njëjtën tokë bujqësore është paraqitur më shumë se një kërkesë për qiramarrje; - lidh kontratën tip me subjektin e përzgjedhur; -verifikon dhe respekton kushtet e përcaktuara në kontratën tip gjatë të gjithë kohëzgjatjes së saj.
	Kapitulli V	Bashkia ose komuna (Nja-të) *mbledh qeranë për dhënien me qera të tokave bujqësore të pandara.* (Pavarësisht se cili është autoriteti qiradhënës, pagesa e qirasë bëhet për llogari të komunës ose bashkisë, e cila ka në përdorim tokën, objekt i qirasë.)
VKM Nr. **283**, datë 01.04.**2015** "Për përcaktimin e tipave,	Kapitulli III	Bashkia (Njësia e qeverisjes vendore) *jep leje ndërtimi për ndërtimin e objekteve me qëllime bujqësore në tokë bujqësore*, në përputhje me dokumentin e planifikimit

rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore"		vendor.
Vendim Nr.956, datë 25.11.2015 Për një ndryshim në vendimin Nr. **127**, datë 11.02.**2015** "Për Kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura"	Kreu IV	Bashkia merr informacion nga përdoruesi i llumrave për vendndodhjen e tokës ku do të përdoren llumrat.
Zhurmat		
Ligji Nr 39/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr. **9774**, datë 12.07.**2007** "Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis"	Neni 8	Bashkia: *-harton dhe zbaton Planin Vendor të Veprimit për Zhurmën* një vit pas miratimit të planit kombëtar të veprimit, (miratohet nga këshillat e bashkive/komunave); *-kryen hartëzimin e zhurmës*, në përputhje me Planin Vendor të Veprimit, sipas udhëzimeve të ministrit (Neni 21); *-shpall zona të qeta*, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendos kufizime të tjera për zhurmën, në përputhje me Planin Vendor të Veprimit; *-kërkon marrjen e masave parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës* nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari apo përdorin impiante dhe instalime që shkaktojnë zhurmë; *-u kërkon organeve të kontrollit të ushtrojnë kontroll, të bëjnë matje dhe të pezullojnë apo të mbyllin veprimtari*, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji.
	Neni 15/1	*-Verifikon zbatimin e kërkesave për zbatimin e nivelit të zhurmave* brenda nivelit kufi në rastet e shfrytëzimit të banesave, me përjashtim të banesave vetjake.
	Neni 17	*Miraton zhvillimin e veprimtarive argëtuese, të veprimtarive me grumbullime, manifestime*, me kohë të kufizuar, në mjedise të jashtme apo të mbyllura, të cilat mund të bëhen burim shqetësimi për banorët.
	Neni 29 dhe neni 30	Bashkia, në rast shkelje të Ligjit: *-cakton masat dhe detyrat për rregullimin e gjendjes*, *-ndëshkon me gjobë kundërvajtjet administrative* sipas rastit, *-vendos mbylljen, ndalimin apo ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të veprimtarisë*, *-merr masa urgjente* në përputhje me ligjin për inspektimin, sipas nevojave të rastit.
VKM Nr. **587** datë 07.07. **2010** "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike"	Pikat 3 dhe 5	Bashkia *jep leje për lokalet e ndryshme sipas këtij përcaktimi*: - <u>Për ambientet e hapura</u>: ➢ për ditën e premte dhe të shtunë, orari i lejimit të aktivitetit do jetë nga ora 19.00 deri në orën 24.00, ➢ për ditët e tjera të javës, orari i lejimit të aktivitetit do të jetë nga ora 19.00 deri në orën 23.00 në përputhje me normat e lejuara të zhurmës. - <u>Për ambientet e mbyllura</u>, aktiviteti do lejohet pa

		kufizime orari, duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës. Bashkia, së bashku me Strukturat Vendore të Policisë së Shtetit, *ndjek zbatimin e vendimit të marrë nga ana e Inspektoriatit të Mjedisit* pa praninë e tyre, në subjektet që gjenerojnë zhurmë në kundërshtim me ligjin.
Ndryshimet klimatike		
Draft-Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit, **2015-2020**	Kapitulli 1	Bashkia duhet: *-të forcojë kapacitetet në institucionet përkatëse* dhe të bashkëpunimit ndërinstitucional *për adresimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike,* *-të përfshijë ndryshimet klimatike gjatë planifikimit në strategjitë sektoriale,* *-të mbështesë strategjitë që përmirësojnë aftësitë ripërtëritëse të shëndetit*, pronës dhe funksioneve prodhuese të ekosistemeve nga ndryshimet e klimës, *-të rritë ndërgjegjësimin publik* për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, *-të krijojë partneritet rajonal* për të përmirësuar teknologjinë, politikat dhe strategjitë e zbutjes së gazrave serë në të gjithë sektorët.
	Kapitulli 2	Bashkia duhet: *-të zbatojë Planin e Veprimit për Efiçiencën e Energjisë,* *-të përfshijë objektivat e përshtatjes dhe uljes së gazrave serrë në planifikimin urban, manaxhimin e ujërave dhe tokës duke përfshirë bujqësine, pyjet dhe ruajtjen e natyrës,* *-të ulë me 8% shkarkimin e gazrave serrë krahasuar me skenarin bazë dhe uljen e sasisë së HCFCve me 40%.*
Shërbimet publike		
Ligj Nr. **139/2015** "Për Vetëqeverisjen Vendore"	Neni 3	Bashkia bën zgjedhjen e llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore dhe realizimin e shërbimeve.
	Neni 23	Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, Bashkia është përgjegjëse për: *- prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm;* *-mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura;* *-mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut*; *-mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara;* *-mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake;* *-planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit;* *-ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore* dhe siNjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore; *-ndriçimin* e mjediseve publike; *-transportin* publik vendor; *-ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike*, si dhe *garantimin e shërbimit publik të varrimit;* -shërbimin e *dekorit publik;* *-parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.*
Ligji Nr 156/2013 Për disa ndryshime në ligjin Nr.**10 463**, datë 22.09.**2011** "Për Menaxhimin e Integruar të	Neni 12	Bashkia ka përgjegjësi ligjore: *- të hartojë Planin e Integruar të Manaxhimit të Mbetjeve;* -të përcaktojë *rregullore për manaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve*; *-t'i raportojë Këshillit të Qarkut* mbi ecurinë e zbatimit të planit të menaxhimit të mbetjeve.

Mbetjeve", i ndryshuar		
VKM Nr. **379**, datë 25.05.**2016** "Për Miratimin e Rregullores Cilësia e Ujit të Pijshëm"	Neni 5	Bashkia ka përgjegjësi: *-të sigurojë ujin e përshtatshëm* për përdorim në pikën e ofrimit të tij; *-të parashikojë masat për sigurimin e furnizimit në rast emergjence* me ujë të pijshëm për sasinë dhe periudhën minimale të nevojshme për të përballuar nevojat lokale; *-të përshtasë planet e ndërhyrjes për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijshëm* në bashkëpunim me Agjencinë e Ujit të Basenit (AUB) përkatës.
Ligji Nr 34/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.**9115**, datë 24.07.**2003** "Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave Të Ndotura"	Neni 4	Bashkia bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit për: *-përcaktimin e teknikave*, teknologjive dhe metodave më të mira të mundshme *për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura;* *-hartimin e Planit për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura* në mënyrë të integruar; *-krijimin e kuadrit ligjor bashkëkohor, për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura*; *-kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarive që shkaktojnë ndotje të ujërave*, si dhe të subjekteve që angazhohen në trajtimin dhe pastrimin e tyre.
Ligji Nr 10/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. **8308**, datë 18.03.**1998** "Për Transportet Rrugore"	Neni 14	Këshilli Bashkiak *përcakton liNjat, organizon, financon dhe vendos për transportin qytetas.*
	Neni 21/1	Këshilli Bashkiak *përcakton vendin e terminalit të autobuzëve*.
	Neni 22	Këshilli Bashkiak *përcakton vendet e nisjes dhe mbërritjes së autobusëve* dhe të agjencive të transportit të udhëtarëve.
Ligji Nr 45/2013 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. **7643** datë 02.12.**1992** "Për shëndetin publik dhe inspektoriatin sanitar shtetëror" i ndryshuar	Neni 19	Bashkia *ushtron kontrolle* për zbatimin e ligjit brenda juridiksionit të saj dhe në bashkërendim me institucionet përkatëse.
Ligji Nr.9915, datë 12.5.2008 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. **8102 /1999** "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura"	Neni 23	Bashkitë, pronare të sistemeve te furnizimit me ujë dhe të largimit e përpunimit te ujërave të ndotura, *kontrollojnë subjektet e liçensuara për zbatimin e këtij ligji*, për respektimin prej tyre të kushteve të licensës dhe përdorimin e tarifave të ujit për konsum publik, të vendosura nga Enti Rregullator.
VKM Nr. **145** datë 26.02.**1998** "Për miratimin e rregullores higjieniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të		Bashkia ka të drejtë *të kontraktojë një kompani private* për ofrimin e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve. Bashkia dhe ndërmarrja e UK-së *shpall zonat e mbrojtura sanitare* të burimit sipërfaqësor ose nëntokësor të ujit. *-Brezi i rreptësisë*, i cili rrethohet në *distancë 20 m*, rreptësisht i pakalueshëm, përfshin puset e ujit, depot e ujit dhe stacionin e pompimit. Në këtë zonë ndalohet çdo ndërtim, përveç atyre të domosdoshëm për nevojat e ujësjellësit. Zona e mbrojtur Nr.1 përfshin mbrojtjen e pellgut ujëmbajtës në një distancë 200m. Në këtë zonë lejohen vetëm aktivitete me baze organike dhe duhet të eleminohet çdo aktivitet industrial ose aktivitete bujqësore te cilat përdorin pesticide

pijshëm”		apo plehra të tjera kimike. Zona e mbrojtur Nr. 2 rrethon pellgun ujëmbajtës në një distancë 1,500 m. Në këtë zone nuk lejohet të ketë zona të ndotura nga ujërat e ndotura apo nga depozitime mbeturinash të ndryshme duke perfshirë këtu dhe ato kimike. Impianti i trajtimit të ujit të ndotur urban duhet të parashikohet jashtë kësaj zone. Gjithashtu nuk lejohet ndërtimi i banesave në këtë sipërfaqe/zonë të mbrojtur. Zona e mbrojtur Nr. 3 zhvillohet në biefin e sipërm të burimit. Rregullat e përmendura për zonën Nr.2 duhet të zbatohen edhe për këtë zonë. Zona e mbrojtur Nr. 4. Çdo ndërtim që do të bëhet brenda në këtë zonë duhet të kërkojë detyrimisht leje nga Bashkia ose nga Organe të tjera të autorizuara duke përfshirë këtu dhe mendimin e një hidrogjeologu. -Çdo burim që shfrytëzohet për qëllime pirje nga shoqëri të licencuara publike ose private duhet të jetë i pajisur me një leje nga autoriteti i basenit ujor në nivel vendor.

Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

5.2 Vlerësimi i planit të zhvillimit të territorit

5.2.1 Procesi i vlerësimit

Vlerësimi i ndikimit të projekteve kalon në dy faza të cilat janë përshkruar më poshtë:

Faza 1: Vlerësimi i ndikimit:

Kjo është faza kur vlerësohet ndikimi që çdo projekt i Planit ka në mjedis. Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, “ndikimi” në vetvete është zbërthyer në ***6 elementë*** (kritere, përbërës) të tij, të cilët janë:

1. Shfaqja (e ndikimit): element i cili shqyrton mundësinë e shfaqjes së ndikimit mjedisor të një projekti specifik në një objektiv mjedisor,
2. Kohëzgjatja (e ndikimit): vlerëson shtrirjen kohore të ndërhyrjes në mjedis që është parashikuar për një projekt,
3. Ndikimi (i projektit): shpreh me vlerë numerike shkallën e ndikimit të një projekti të Planit për çdo objektiv mjedisor (ujë, ajër, tokë, etj.),
4. Rikthimi (i ndikimit): ky tregues shpreh mundësinë e rikthimit të ndikimit në mjedis të një projekti mbas zbatimit të tij,
5. Kumulativ (ndikim): potenciali që bart ndërhyrja në mjedis gjatë realizimit të projektit për të shtuar dhe prodhuar ndotje të akumuluar në fazën e operimit dhe shfrytëzimit,
6. Shtrirja (e ndikimit): tregon hapësirën fizike (sipërfaqen) në të cilën shtrihet ndikimi në mjedis i një projekti.

Për sa i përket mjedisit, në kontekstin e vlerësimit mjedisor të PPV-së, mjedisi është zbërthyer në *10 elementë* që supozohet se janë pësuesit e pasojave që vijnë nga ndërhyrjet në mjedis gjatë zbatimit të projekteve. Këto 10 elementë janë *uji, toka, biodiversiteti, pyjet, peizazhi, klima, kultura, shëndeti dhe socio-ekonomia* të cilët gjatë gjithë procesit të vlerësimit në mjedis janë quajtur objektiva mjedisorë ose OM. Pra, çdo element i mjedisit që është marrë për bazë për vlerësimin e ndikimit të projekteve në mjedis, përbën një objektiv mjedisor më vete. Për shembull, ajri është objektivi mjedisor numër 1, uji është objektivi mjedisor numër 2 e kështu me rradhë.

Numri i objektivit mjedisor ka thjesht funksion renditës dhe nuk ndikon në vlerësimin e projektit.

Tabela 57. Objektivat mjedisorë dhe numrat e tyre

Objektivat Mjedisorë	Kodifikimi i tyre
Ajri	OM 1
Uji	OM 2
Toka	OM 3
Biodiversiteti	OM 4
Pyjet	OM 5
Peizazhi	OM 6
Klima	OM 7
Kultura	OM 8
Cilësia e jetës (Shëndeti Socio-ekonomia)	OM 9

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Objektivat mjedisore të marrë si bazë për vlerësimin mjedisor të projekteve të PPV-së janë përcaktuar në Ligjin 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", objektivat e përcaktuara në SKZHI II dhe Direktivën 2001/42/KE, të cilat janë të rëndësishme për të vlerësuar politikat dhe projektet që parashikon Plani i Përgjithshëm Vendor për të arritur objektivat e tij. Për vlerësimin e ndikimit të çdo elementi (kriteri) të *ndikimit* në një OM janë përdorur vlerat numerike ndërmjet [0-10] ku është ndjekur llogjika e mëposhtme:

- Vlera numerike 0: është përdorur për të shënuar projekte dhe objektiva ndikimi i të cilëve në mjedis nuk është i matshëm dhe i vlerësueshëm,
- Vlerat numerike 0.1-10: janë vlerat numerike që i jepen projekteve në varësi të ndikimit të tyre specifik në objektivat e mjedisit. Në parim, madhësia e ndikimit të një projekti në mjedis dhe vlerësimi numerik lidhen ndërmjet tyre në përpjestim të zhdrejtë. Sa më i lartë që të jetë numri i pikëve që merren në vlerësim, aq më i ulët është ndikimi i një projekti në mjedis dhe anasjelltas. Për shembull, vlera "1" tregon ndikim të lartë të projektit në mjedis ndërsa vlera numerike "10" tregon mungesë ndikimi ose ndikim të papërfillshëm. *Kjo vlen si në nivel elementi të ndikimit (kriteri),* ashtu edhe *në nivel projekti*.

Për vlerësimin e ndikimit ndiqet procesi i mëposhtëm:

1 *Vlerësimi me vlera numerike i ndikimit në një OM*:

Fillimisht kryhet *vlerësimi në pikë* i ndikimit të çdo elementi/kriteri të ndikimit në një OM.

2 *Llogaritja e peshës specifike të një kriteri të vlerësimit në raport me totalin*:

Si hap i dytë llogaritet pesha specifike e elemnteve/kritereve të ndikimit në raport me totalin. Për çdo element (kriter) të *vlerësimit*, është përcaktuar pesha specifike (e shprehur me %) që ky element ka në raport me ndikimin total të projektit në mjedis. Për shembull, Pesha e "kohëzgjatjes së ndikimit" është 20% në raport me shumën totale të ndikimit që është 100%.

Tabela 58. Pesha specifike e elementëve/kritereve të vlerësimit

	Elementët / Kriteret e vlerësimit	Pesha %	Pikët e vlerësimit (në varësi të nivelit të ndikimit)		
1	Mundësia e shfaqjes	10%	PO	JO	E pasigurt
	Pikët		0	10	0.1-9.9
2	Kohëzgjatja	20%	E menjëhershme & qëndrueshme	E vogël, e papërfillshme	Afatshkurtër, ose afatgjatë
	Pikët		0	10	0.1-9.9
3	Natyra e ndikimit	20%	Shkatërron habitatin	Neutrale	Dëmton shërbime të caktuara të ekosistemit
	Pikët		0	10	0.1-9.9
4	Mundësia e riaftësimit të ndikimit	10%	Kthim i plotë	Nuk ka kthim të ndikimit	E pjesshme
	Pikët		0	10	0.1-9.9
5	Natyra kumulative	20%	PO	JO	E pasigurt
	Pikët		0	10	0.1-9.9
6	Madhësia/Shtrirja	20%	Sipërfaqe e madhe & popullsi	Pikësore, e kufizuar dhe jo popullsi	E ndërmjetme
	Pikët		**0**	**10**	**0.1-9.9**

Punoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Më poshtë paraqitet një shembull konkret i vlerësimit të ndikimit të elementëve të vlerësimit në OM ajër. Një rast hipotetik i vlerësimit për Objektivin Mjedisor – Ajër për zbatimin e një projekti 'Ndërtimi i Ujësjellës Kanalizime Fshat': Paraqitet vlerësimi me nota dhe llogaritja e mesatares së vlerësimit duke integruar peshën e secilit kriter vlerësues.

Tabela 59. Shembull: Pikët e grumbulluara nga 6 elementët/kriteret e për OM1 (Ajër)

Pesha %	Kriteri i vlerësimit	Shpërndarja e pikëve të vlerësimit për çdo element të ndikimit		
		Vlerësimi numerik	Pesha specifike	Totali i pikëve
10	Mundësia e shfaqjes	*7*	10 %	*0,7*
20	Kohëzgjatja	*6*	*20%*	*1,2*
20	Natyra e ndikimit	*8*	*20%*	*1,6*
10	Mundësia e riaftësimit të ndikimit	*7,5*	*10%*	*0,75*
20	Natyra kumulative	*5,5*	*20%*	*1,1*
20	Madhësia/Shtrirja	*6*	*20%*	*1,2*
Totali (Vlerësimi numerik x Pehë specifike = Totalin e pikëve të ndikimit)				6.55
Shuma e pikëve të grumbulluara për vlerësimin e elementëve të ndikimit për një OM: = **6.55** pikë				

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Në këtë tabelë, 6.55 është numri i pikëve që shpreh ndikimin e projektit në fjalë vetëm për një OM që në këtë rast është AJRI. E njëjta procedurë kryhet për çdo OM.

3 Konvertimi i pikëve në vlerësim simbolik e cilësor:

Në varësi të pikëve që grumbullon secili projekt, jepet vlerësimi përfundimtar sipas tabelës (matricës) së vlerësimit të ndikimit në mjedis të paraqitur si në vijim. Për këtë qëllim, pikët e grumbulluara përkthehen në sheNja konvencionale, dhe në vlerësim

cilësor që shprehet në vlerësim të papërfillshëm, të ulët, mesatar, të lartë dhe të paaplikueshëm.

Tabela 60. Vlerësimi sasior, konvencional e cilësor i ndikimit në mjedis

Pikët e Vlerësimit	Simbolika e matrices së vlerësimit dhe kuptimi përkatës	
0.1 – 3 pikë		Ndikim i lartë/shumë i lartë (shkatërrues mbi shëndetin dhe mjedisin)
3.1 – 6 pikë		Ndikim mesatar (pa garanci për shëndetin dhe mjedisin, pavarësisht masave zbutëse)
6.1 – 8.5 pikë		Ndikim i ulët (në rast se masat zbutëse dhe parandaluese rrespektohen)
8.6 – 10 pikë		Ndikim i papërfillshëm (nëse zbatohen masat, dhe nuk cënohet ekuilibri natyror)
Vlerësimi i Pa Aplikueshëm		Ndikim neutral ose pa ndikim (ndikime të mundshme janë të përkohshme, afatshkurtra dhe mjedisi vetripërtërihet pa ndërhyrje)

Punoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Vlerësimi numerik (sasior) tregon ndikimin e projektit në mjedis në rastin kur parashikohet marrja e masave që zbutin ndikimin e projekteve në mjedis, domethënë në skenarin kur realizohen ndërhyrje mjedisore përmirësuese.

Faza 2: Vlerësimi i përputhshmërisë

Përputhshmëria e objektivave të Planit është vlerësuar duke i kombinuar ato me objektivat mjedisorë. Gjatë vlerësimit të këtij treguesi janë ndjekur disa hapa të cilët janë shtjelluar më tej. Konvertimi pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

1. *Konvertimi i vlerave numerike të ndikimit të projekteve në systemin numerik konvencional të përputhshmërisë*

Tabela 61. Konvertimi i pikëve të ndikimit të projektit në pikë përputhshmërie

Pikët e vlerësimit të ndikimit	Pikët e vlerësimit të përputhshmërisë
8.6 – 10 pikë	3
6.1 – 8.5 pike	2
3.1 – 6 pikë	1
0 pikë	0
0.1 – 3 pikë	-1

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

2. *Vlerësimi mesatar i përputhshmërisë së një projekti*

Vlerësimi i përputhshmërisë kryhet duke u bazuar në vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve. Pikët e grumbulluara nga vlerësimi i 6 kritereve të ndikimit për çdo OM, mblidhen dhe më tej pjesëtohen me numrin e OM-ve (që në rastin në fjalë është 9) me qëllim llogaritjen e *vlerësit mesatar* të përputhshmërisë i cili jepet vetëm *në rang projekti* dhe ndihmon për të kuptuar shkallën që objektivat e një plani përputhen me objektivat mjedisorë.

Përputhshmëria e Objektivave të Planit me Objektivat Mjedisorë është shprehur në 5 nivele. Çdo nivel përputhshmërie shprehet me vlerat numerike të caktuara në tabelën e mësipërme dhe me nivel përputhshmërie cilësore.

Tabela 62. Përputhshmëria e shprehur në vlera numerike dhe vlerësimi përkatës.

Pikët e vlerësimit të përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë	Përshkrimi
2.51 – 3	Përputhen plotësisht	Objektivat/ programet/ projektet përputhen plotësisht me OM-të
1.50 – 2.49	Përputhen pjesërisht	Objektivat/ programet/ projektet përputhen pjesërisht me OM-të: Përputhja është e pjesshme edhe pse zbatohen masa mjedisore
0.01 – 1.49	Lidhja/ përputhshmëria është e zbehtë	Përputhshmëria është e dobët, edhe pse realizohen masat mjedisore. Kjo nënkupton që ndikimi neutralizohet pjesërisht ose minimalisht
0	Nuk ka lidhje (neutrale)	Objektivat, programet, projektet nuk tregojnë përputhje në pamje të parë, por njëkohësisht, nuk tregojnë as përplasje. Pra nuk nuk kanë ndikim negativ të ndërsjelltë e, veçanërisht, objektivat e Planit në objektivat e VSM-së.
Negativ	Nuk përputhen	Objektivat/ programet/ projektet nuk përputhen me OM-të: janë në kundërshtim të plotë, pavarësisht masave zbutëse që mund të merren

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

3. *Llogaritja e përputhshmërisë së Objektivave të projektit me objektivat mjedisorë* (secilin OM më vete)

Ky vlerësim arrihet nëpërmjet vlerësimit të përqindjes (%) së objektivave të planit që përputhet me objektivat mjedisorë në nivel projektesh dhe nivel OP-je. Në këtë mënyrë matim jo vetëm përputhshmërinë e çdo projekti me të gjitha objektivat njëherësh, por kuptojmë,për çdo projekt, se në cilat OM dhe në çfarë mase (e matur në % ndaj totalit prej 9 OM-ve) arrihet, ose cënohet përputhshmëria e lartë. Për ta thjeshtëzuar, ky lloj vlerësimi është ilustruar në tabelën e mëposhtme (tabela 63).

Tabela 63. Shembull i vlerësimit të përputhshmërisë së OP-ve me OM-të

Bashkia LUSHNJE: Përputhshmëria					
Objektivat Mjedisore	% e OM me PL/Projekt	% e OM me PP/projekt	% e OM me PZ/projekt	% e OM me PN/projekt	% e OM me PG/projekt
O1: Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor	42,8%	47,3%	9,9%	0,0%	0,0%

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Vlerësimi i përputhshmërisë me objektivat mjedisorë (OM) të objektivës 1 (O1) të PPV-së "Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor" (tab. 63), e cila përmbledh në vetëvetë një grup prej 17 projektesh rezulton se:

- 42.8% e të gjithë projekteve kanë përputhshmëri të lartë me OM, thënë ndryshe, në qoftë së ndiqen masat e nevojshme ndikimi në mjedis është i papërfillshëm.
- 47.3% e projekteve kanë përputhshmëri të pjesshme me OM të cilët me marrjen e masave të duhura do të kenë një ndikim shumë të ulët në mjedis.
- 9.9% e projekteve kanë përputhshmëri të zbehtë që edhe pasi të jenë marrë masat e nevojshme gjurma e ndikomit do të jetë e dukshme.

Vlen të përmendet që anjë projekt në këtë grup (projektet e O.1) nuk është pa përputhshmëri me objektivat mjedisor, pra këto projekte do të kenë një ndikim relativisht të ulët në mjedis.

5.2.2 Vlerësimi i ndikimit në mjedis i propozimeve të Planit territorial

Projektet e parashikuara në Planin e Përgjitshëm Vendor për zhvillimin e territorit të Bashkisë Lushnje kanë synuar zhvillimin e përgjithshëm të tij dhe në veçanti arritjen e katër objektivave specifike (O-ve) që janë renditur më poshtë:

Tabela 64. Objektivat e programet e Planit

Grupi i projekteve	Objektivat e Planit
O.1	Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor
O.2	Zhvillimi i ekoturizmit
O.3	Zhvillimi i planifikuar e kontrolli i territorit
O.4	Mbrojtja e burimeve natyrore

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Në vazhdim, paraqitet vlerësimi i ndikimit në mjedis i çdo projekti të PPV-së. Vlerësimi i ndikimit në vetvete është kryer në nivel projekti, objektivi specifik (O-je) dhe Plani. Për lehtësi vlerësimi, siç edhe u theksua më sipër, projektet janë grupuar sipas Objektivave të Planit (O-ve).

Vlerësimi i projekteve të O.1: Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor

Ky objektiv përfshin 17 projekte që synojnë kryesisht zhvillimin e politikave nxitëse dhe mbështetjen infrastrukturore për rritjen e performancës së zonave bujqësore të bashkisë, rritjen e performancës së sektorëve ekonomikë në Bashkinë Lushnje (shërbime, bujqësi dhe tregti të produkteve bujqësore), nxitjen e procesit të zgjerimit dhe densifikimit për të gjithë qendrat e njësive administrative, si dhe për disa fshatra me potencial urbanizimi, etj.

Vlerësimi i ndikimit të projekteve të këtij Objektivi të parë të Planit paraqitet më poshtë (tabela 65): me qëllim thjeshtëzimin e të kuptuarit të rezultateve, për çdo objektiv mjedisor, shkalla e ndikimit të projektit është paraqitur me vlera numerike dhe me shenja konvencionale.

Tabela 65. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të O.1: Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor

Bashkia LUSHNJE: Ndikimi										
Objektivat Mjedisore	**OM1**	**OM2**	**OM3**	**OM4**	**OM5**	**OM6**	**OM7**	**OM8**	**OM9**	
Objektivat/Projektet e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Shëndet	Social-ekonomik
O1: Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor										
Pr1: Hapja e qendrave të informimit bujqësor pranë 11 njësive administrative të Bashkisë Lushnje	↗ 7,65	↗ 8,20	↗ 7,30	↗ 7,00	↗ 8,25	↗ 8,50	↑ 8,60	↑ 9,30	↑ 9,30	↑ 9,35
Pr2: Nxitja e konsolidimit të fermave bujqësore përmes skemave mbështetëse vendore dhe qendrore	↗ 7,30	↗ 6,95	↗ 8,20	↗ 6,95	↗ 7,80	↗ 8,30	↗ 7,55	↑ 9,40	↑ 9,25	↗ 8,30
Pr3: Ngritja e qendrës së grumbullimit me kapanone frigoriferike pranë Tregut të Shitjes me shumicë të fruta-perimeve, Lushnje	↗ 6,45	↗ 7,00	⇨ 5,90	⇨ 4,70	↗ 7,00	↗ 7,30	↗ 7,15	↑ 9,60	↑ 9,05	↗ 8,40
Pr4: Ngritja e një qendre grumbullimi në Hysgjokaj	↗ 7,35	↗ 7,20	⇨ 5,40	⇨ 4,60	↗ 7,80	↗ 7,80	↗ 7,00	↑ 9,80	↑ 9,30	↑ 9,00
Pr5: Rehabilitimi i magazinave ish industriale në Njësinë Administrative Golem, dhe kthimi i tyre në pika magazinimi	↗ 7,05	↗ 7,90	↗ 7,20	⇨ 4,50	↗ 8,00	↗ 8,10	↗ 7,00	↑ 9,50	↑ 8,75	↑ 8,90
Pr6: Sistemimi i stacionit të pompave ujitëse në Bitaj dhe Ardenicë	↗ 8,05	↑ 8,70	↗ 7,90	⇨ 5,75	↗ 8,30	↗ 8,30	↗ 7,50	↑ 9,10	↑ 9,30	↑ 9,25
Pr7: Pastrimi i kanaleve të para dhe të dyta nga mbetjet dhe aluvionet e grumbulluara në 11 njësitë administrative	↗ 8,20	↗ 6,40	↗ 7,00	⇨ 5,10	↗ 8,45	⇨ 5,80	↗ 7,70	↑ 9,60	↑ 9,05	↑ 8,90
Pr8: Ndërtimi i sistemit të ujitjes në Linjat e Krutjes dhe Tërbufit	↗ 6,50	↗ 6,75	↗ 6,95	↗ 7,15	↗ 7,85	↗ 8,30	↗ 8,00	↑ 9,40	↑ 9,25	↑ 9,25
Pr9: Ndërtimi i Centralit të Energjisë Diellore, në parcelat me tokë të kripur në fshatin Plug	↗ 8,05	↗ 8,40	↗ 6,70	↗ 6,50	↗ 8,30	⇨ 5,90	↗ 8,10	↑ 9,25	↑ 9,05	↑ 9,25
Pr10: Zgjerimi i sipërfaqes dhe kapacitetit magazinues të Tregut të Fruta-Perimeve në Lushnje	↗ 7,10	↗ 6,30	↗ 6,20	↗ 6,45	⇨ 5,95	⇨ 5,85	↗ 8,05	↑ 8,90	↑ 8,95	↑ 8,95
Pr11: Ndërtimi i tregur të produkteve bujqësore në Fier-Shegan dhe Krutje	↗ 6,10	⇨ 6,05	⇨ 5,30	⇨ 4,35	↗ 7,80	↗ 8,30	↗ 6,90	↑ 9,30	↑ 9,15	↑ 9,05
Pr12: Rehabilitimi i tregjeve të fruta-perimeve në të gjitha njësitë administrative të bashkisë	↗ 6,70	↗ 7,00	↗ 6,75	↗ 6,40	↗ 7,60	↗ 7,70	↗ 6,95	↗ 8,40	↑ 8,70	↑ 9,05
Pr13: Rehabilitimi i dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale në Zonën ekonomike e Plastmasit	⇨ 4,95	⇨ 5,80	↗ 6,75	↗ 6,40	↗ 7,75	↗ 7,85	↗ 7,75	↑ 8,95	↑ 8,60	↑ 8,90
Pr14: Rehabilitimi i dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale të Bashkisë në të cilin përfshihen: Zona ish-Industriale në fshatin Plug, Zona ekonomike e ish fabrikës së dyshekëve	⇨ 4,95	⇨ 5,80	⇨ 5,40	⇨ 5,40	↗ 7,10	↑ 9,05	⇨ 5,90	↑ 9,30	↑ 9,20	↑ 9,10
Pr15: Ngritja e qendrës logjistike të mallrave pranë zonës ekonomike të Plastmasit	↗ 7,00	↗ 7,40	⇨ 5,75	↗ 6,55	↗ 8,50	↗ 7,70	↗ 7,40	↑ 9,35	↑ 8,85	↗ 8,10
Pr16: Kualifikimi i forcës punëtore të sektorit bujqësor	↑ 9,00	↑ 9,00	↑ 9,00	↑ 8,80	↑ 9,10	↑ 9,20	↑ 9,10	↑ 9,40	↑ 9,10	↑ 9,20
Pr17: Marketimi i produkteve bujqësore të rajonit brenda dhe jashtë vendit	↗ 8,40	↑ 8,60	↑ 9,25	↑ 9,20	↑ 9,70	↑ 9,30	↑ 9,25	↑ 8,90	↑ 8,90	↑ 9,20

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Në bazë të vlerësimit të projekteve të O.1, nga 17 projektet e listuara më poshtë rezulton se:

- Ndikimi i projektit në **ajër** është i ulët. Nga 17 projekte, 1 projekt ka ndikim të papërfillshëm, 14 projekte kanë ndikim të ulët dhe vetëm 2 projekte kanë ndikim mesatar.
- Ndikimi në **ujë** është i ulët. Bëjnë përjashtim 3 projekte që nuk kanë ndikim në mjedis dhe 3 projekte të tjera që kanë ndikim mesatar.
- Ndikimi në **tokë** është mesatarisht i ulët, me vetëm 6 projekte që kanë ndikim mesatar. Ndërkohë, një projekt nuk ka ndikim në mjedis.
- OM-ja në të cilën projektet do të kenë ndikim më të lartë, pra ndikim mesatar, mbetet **biodiversiteti** me 7 projekte që do të kenë ndikim mesatar.
- Ndikimi në **pyje** është mesatar. Përjashtim bën vetëm projekti numër 10 i cili ka ndikim mesatar.
- Ndikimi më i ulët vihet re në **klimë**, **kulturë**, **shëndet** dhe **socio-ekonomi.**

Si përfundim, në bazë të vlerësimit të 17 projekteve të O.1, rezulton se ndikim të ulët projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë në përbërësit e ajrit, ujit, pyjeve dhe klimës, ndërsa lexohet një ndikim mesatar në përbërësit e tokës,biodiversitetit dhe peizazhit. Ndikimi i prjekteve është i papërfillshëm në klimë, kulturë, shëndet dhe socio-ekonomi.

Vlerësimi i projekteve O.2: Zhvillimi i eko-turizmit

Ky seksion përfshin 5 projekte që synojnë zhvillimi i infrastrukturës për përmirësimin e lëvizshmërisë në boshtet kryesore të rajonit dhe në itineraret turistike, mbështetjen dhe nxitjen e promovimit e turizmit, integrimin e Bashkisë Lushnje në tërësinë e itinerareve të gjelbra rajonale, nëpërmjet infrastrukturës së lehtë, turistike. Rikonstruksionin e rrugëve me vlera historiko-kulturore, zhvillimin dhe nxitjen e turizmit nëpërmjet ndërtimit të eko-fermave, etj.

Vlerësimi i ndikimit të projekteve të këtij Objektivi të dytë të Planit paraqitet më poshtë (tabela 66): Siç u veprua më sipër, , për çdo objektiv mjedisor, shkalla e ndikimit të projektit është paraqitur me vlera numerike dhe me sheNja konvencionale.

Tabela 66. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të O.2: Zhvillimi i eko-turizmit

Bashkia LUSHNJE: Ndikimi										
Objektivat Mjedisore	**OM1**	**OM2**	**OM3**	**OM4**	**OM5**	**OM6**	**OM7**	**OM8**	**OM9**	
Objektivat/Projektet e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Shëndet	Social-ekonomik
O2: Zhvillimi i [eko]turizmit										
Pr1: Rikonstruktimi i rrugëve peizazhistike vernakolare dhe pajisja me sinjalistikën dhe ndricimin rrugor të domosdoshëm në të gjithë territorin e Bashkisë Lushnje	↗ 7,00	↗ 7,05	→ 5,00	→ 3,40	↗ 6,75	↗ 7,85	↗ 6,50	↑ 9,20	↗ 8,50	↑ 9,30
Pr2: Hartimi dhe marketimi i paketave turistike për promovimin e turizmit në bashkëpunim me aktorë privatë dhe NGO	↑ 8,90	↑ 8,70	↗ 8,40	↗ 8,40	↑ 8,70	↑ 8,80	↑ 8,70	↑ 9,20	↑ 9,20	↑ 8,90
Pr3: Rikonstruksioni i rrugës historiko-kulturore të Manastirit të Ardenicës dhe pajisja me korsinë e dedikuar të bicikletave	↗ 7,25	↗ 6,65	↗ 6,35	↓ 2,55	↗ 6,95	↗ 7,55	→ 5,97	↑ 9,00	↑ 8,95	↑ 8,95
Pr4: Pajisja e rrugëve urbane kryesore dhe dytësore me korsi të dedikuar për biciklet në të gjithë territorin e Bashkisë Lushnje	↗ 8,00	↗ 7,80	↗ 7,70	↗ 7,70	↗ 7,60	↗ 7,70	↑ 8,94	↑ 9,20	↑ 9,80	↑ 9,75
Pr5: Nxitja e zhvillimit të eko-fermave turistike në Njësitë administrative të Hysgjokaj dhe Ballagat	↑ 8,60	↗ 8,45	↗ 7,90	↗ 8,40	↗ 8,20	↑ 9,00	↑ 8,90	↑ 8,70	↑ 9,00	↑ 8,95

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Sipas vlerësimit të 5 projekteve në lidhje me O.2 rezulton se :

- Ndikimi i projekteve në **ajër** është i ulët. Nga 5 projekte, 2 projekte kanë ndikim të papërfillshëm ndërsa 3 projekte të tjera kanë ndikim të ulët. Përsëritet situata e ngjashme dhe tek vlerësimi i ndikimit në **peizazh**.
- Ndikimi në **ujë** është i ulët**.** Bën përjashtim 1 projekt që ka ndikim të papërfillshëm në mjedis. E njëjta situatë paraqitet dhe në vlerësimin e ndikimit në **pyje**.
- Ndikimi në **tokë** është i ulët. Bën përjashtim 1 projekt i cili do të ketë një ndikim mesatar në tokë.
- Situata paraqitet e komplikuar për OM-në e **biodiversitetit**. Nga 5 projekte, 3 projekte kanë ndikim të ulët, 1 projekt ka ndikim të papërfillshëm dhe 1 projekt ka ndikim shumë të lartë në mjedis.
- Ndikimi shfaqet i papërfillshëm në **kulturë** ,**shëndet** dhe **socio-ekonomi.**

Si përfundim, në bazë të vlerësimit të 5 projekteve të O.2, rezulton se ndikim të ulët projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë në përbërësit e ajrit, ujit, tokës, pyjeve dhe peizazhit ndërsa lexohet një ndikim mesatar në biodiversitetit. Ndikimi i projekteve është i papërfillshëm në klimë, shëndet dhe socio-ekonomi.

Vlerësimi i projekteve të O.3: Zhvillimi i planifikuar e kontrolli i territorit

Ky objektiv i Planit përfshin 10 projekte që kanë si qëllim sigurimin e përmirësimit të infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve urbane dhe bujqësore, përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe të infrastrukturës së transportit publik, rikostruktimin e objekteve arsimore, shëndetësore dhe argëtuese si dhe krijimin e hapësirave të gjelbërta, etj.

Karakteristikë kryesore e këtij objektivi do të jetë ndërhyrja e theksuar në favor të krijimit të një mjedisi i cili zhvillohet mbi qëndrueshmërinë dhe harmonizimin e aktivitetit njerëzor duke përmbushur nevojat e tij për shfrytëzimin e burimeve në mënyrë të tillë që ekuilibrat natyrorë të mbeten të pacënuar.

Tabela 67. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i O.3: Zhvillimi i planifikuar e kontrrolli i territorit

Bashkia LUSHNJE: Ndikimi																		
Objektivat Mjedisore	**OM1**		**OM2**		**OM3**		**OM4**		**OM5**		**OM6**		**OM7**		**OM8**		**OM9**	
Objektivat/Projektet e Programet e Planit	Ajri		Uji		Toka		Biodiversiteti		Pyjet		Peizazhi		Klima		Kultura		Shëndet	Social-ekonomik
O3: Zhvillimi i planifikuar e kontrolli i territorit																		
Pr1: Ndërtimi i parkut periferik të qytetit të Lushnjes	↗	8,55	↗	8,30	↗	8,50	↑	9,00	↑	9,90	↑	9,35	↑	10,00	↑	9,20	↑	9,35	↑	9,05
Pr2: Kthimi i ndërtesave të ish komunave në qendra multifunksionale për të rinjtë, të moshuarit dhe përsona me aftësi të kufizuara	↗	7,70	↗	8,20	↗	8,00	→	5,55	↑	8,90	↑	9,25	↗	7,80	↑	9,05	↑	9,25	↑	9,70
Pr3: Ndërtimi i parqeve këndeve të lojrave dhe lulishteve në Njësitë administrative të Kolonjës, Krutjes, Fier-sheganit, Dushkut, Hysgjokaj	↑	8,60	↗	8,00	↗	8,25	→	4,85	↑	9,35	↑	8,85	↑	9,30	↑	9,60	↑	9,45	↑	8,60
Pr4: Rikonstrusioni dhe zgjerimi i të gjithë infrastrukturës rrugore sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor, duke përmirësuar cilësinë e ndricimit rrugor dhe pajisjen me pemë në të dyja anët e rrugëve	→	3,20	→	3,70	→	4,25	↓	2,50	→	5,20	→	4,70	→	4,60	↗	8,00	↑	9,25	↑	8,65
Pr5: Ndërtimi i stacionit multimodal në qendër të qytetit të Lushnjes	→	3,90	→	3,60	→	5,50	→	3,30	→	5,35	→	4,85	↗	6,50	↗	8,00	↑	9,20	↑	8,65
Pr6: Ndërtimi i Terminalit të autobusëve ndër dhe rreth qytetas në hyrje të qytetit të Lushnjes	→	3,90	→	3,40	→	5,50	→	3,40	→	5,40	→	5,40	↗	7,10	↗	8,00	↑	9,00	↑	8,60
Pr7: Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në tokat e kripura pranë By-Passit të Lushnjes	↗	7,10	↗	8,05	↗	7,25	→	5,60	↗	8,25	↗	8,05	↑	8,75	↑	8,90	↑	9,30	↑	9,20
Pr8: Ndërtimi i pompave të ujit për përmirësimin e sistemit të ujësjellësit	↗	8,35	↑	9,00	↑	8,85	↗	7,90	↑	8,85	↗	8,40	↑	8,90	↑	9,20	↑	9,20	↑	8,80
Pr9: Rikonstruksioni i ndërtesave të shkollave dhe arsimit parashkollor në 11 njësitë administrative të Bashkisë Lushnje	↗	7,40	↗	6,70	↗	8,25	↗	6,95	↗	8,25	↑	8,60	↑	9,15	↑	9,25	↑	9,05	↑	9,20
Pr10: Ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore në fshatin Shegas dhe Allprenaj	↗	7,30	↗	7,75	↗	7,55	↗	7,40	↗	8,10	↗	7,65	↑	9,20	↑	9,10	↑	9,15	↑	9,20

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Në bazë të vlerësimit të projekteve të O.3, nga 10 projektet e listuara më sipër rezulton se:

- Ndikimi i projektit në **ajër** është i ulët. Nga 10 projekte, 1 projekt ka ndikim të papërfillshëm, 6 projekte kanë ndikim të ulët dhe vetëm 3 projekte kanë ndikim mesatar.
- Ndikimi në **ujë** është i ulët. Bëjnë përjashtim 3 projekte që kanë ndikim mesatar në mjedis dhe 1 projekt që ka ndikim të papërfillshëm.
- Ndikimi në **tokë** është mesatarisht i ulët, me vetëm 3 projekte që kanë ndikim mesatar. Ndërkohë, një projekt ka ndikim të papërfillshëm në mjedis.
- OM-ja në të cilën ndikimi është më i lartë, pra ndikim mesatar, mbetet **biodiversiteti** me 5 projekte që do të kenë ndikim mesatar, 3 projekte do të kenë ndikim të ulët, 1 projekt do të ketë ndikim të papërfillshëm dhe 1 projekt do të ketë ndikim shumë të lartë.
- Ndikimi në **pyje** është deri diku mesatar dhe deri diku i papërfillshëm, kjo varet nga pozicioni gjeografik ku do të kryhet projekti. 4 projekte shfaqin ndikim të papërfillshëm në mjedis, 3 projekte do të shfaqin ndikim mesatar dhe i njëjti numër projektesh do të shfaqë ndikim të ulët në mjedis. I njëjti rezultat paraqitet edhe në vlerësimin e ndikimit në **peizazh**.
- Ndikimi i papërfillshëm vihet re në **klimë**, **kulturë**, **shëndet** dhe **socio-ekonomi.**

Si përfundim, në bazë të vlerësimit të 10 projekteve të O.3-it, rezulton se projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë ndikim të ulët në përbërësit e ajrit, ujit dhe në tokë. Lexohet një ndikim mesatar në biodiversitet, pyje dhe peizazh. Ndikimi i prjekteve është i papërfillshëm në klimë, kulturë, shëndet dhe socio-ekonomi.

Vlerësimi i projekteve të O.4: Mbrojtja e burimeve natyrore

Ky objektiv përfshin 12 projekte që synojnë kryesisht rehabilitimin dhe sistemimin e burimeve natyrore si sistemimin e zonave ripariane të lumenjve, pyllëzimin e zonave të dëmtura dhe të shpyllëzuara, ndërtimin e objekteve sportive dhe edukuese dhe ngritjen e e strukturave për menaxhimin e mbetjeve organike dhe të ngurta, etj.

Vlerësimi i ndikimit të projekteve të këtij Objektivi të katërt të Planit paraqitet më poshtë (tabela 68). Me qëllim thjeshtëzimin e të kuptuarit të rezultateve, për çdo objektiv mjedisor, shkalla e ndikimit të projektit është paraqitur me vlera numerike dhe me sheNja konvencionale, siç u paraqit edhe në objektivat e mëparshëm.

Tabela 68. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të O.4: Mbrojtja e burimeve natyrore

Bashkia LUSHNJE: Ndikimi										
Objektivat Mjedisore	**OM1**	**OM2**	**OM3**	**OM4**	**OM5**	**OM6**	**OM7**	**OM8**	**OM9**	
Objektivat/Projektet e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Shëndet	Social-ekonomik
O4: Mbrojtja e burimeve natyrore										
Pr1: Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman	↗ 8,25	↗ 7,20	↗ 7,50	⇨ 4,80	↑ 9,25	↑ 9,40	↑ 9,20	↑ 9,00	↑ 9,15	↑ 9,00
Pr2: Rehabilitimi i Përroit të Lushnjes	↗ 8,35	↗ 6,20	↗ 8,05	⇨ 5,15	↑ 9,05	↑ 8,90	↑ 9,10	↑ 8,80	↑ 9,20	↗ 8,00
Pr3: Krijimi i korridoreve vegjetative në tokën bujqësore	↗ 7,30	↗ 7,85	↗ 7,60	⇨ 5,40	↗ 8,55	↑ 9,00	↑ 8,75	↑ 9,30	↗ 8,45	↗ 8,00
Pr4: Rehabilitimi i fushës së mbetjeve dhe kthimi i saj në zonë të gjelbër	⇨ 4,95	⇨ 4,95	↗ 8,40	↗ 6,20	↑ 8,70	↑ 8,65	↑ 9,15	↑ 9,25	↑ 8,60	↑ 9,10
Pr5: Ndërtimi i Impiantit të Kompostimit të mbetjeve në fshatin Murriz-Peqin	↗ 6,10	↗ 6,50	↗ 6,90	⇨ 5,45	↗ 8,25	↑ 9,05	↑ 9,20	↑ 9,10	↑ 9,40	↗ 8,40
Pr6: Ndërtimi i stacionit të transferimit të mbetjeve në tokat e kripura në Plug	⇨ 5,25	↗ 6,20	↗ 7,60	⇨ 5,95	↑ 8,75	↗ 7,85	↗ 8,45	↗ 8,50	↑ 9,10	↗ 8,00
Pr7: Pastrimi i tre vatrave të nxehta mjedisore në qytetin e Lushnjes	⇨ 4,85	⇨ 4,80	↗ 8,30	↗ 7,00	↗ 8,05	↑ 8,95	↑ 8,60	↗ 8,00	↑ 9,20	↗ 8,50
Pr8: Rehabilitimi i Kodrës së Lushnjes nëpërmjet metodës së ripyllëzimit	↗ 8,05	↗ 7,15	↗ 8,40	↗ 6,85	↑ 9,25	↑ 8,90	↑ 8,85	↗ 8,50	↑ 8,70	↗ 8,00
Pr9: Rikonstruksioni i shkollave dhe ambjenteve të arsimit parashkollor	↗ 6,60	↗ 7,25	↗ 8,35	↗ 7,15	↗ 8,20	↑ 8,75	↑ 8,75	↑ 8,85	↑ 9,05	↑ 9,00
Pr10: Përmirësimi i infrastrukturës fizike të Spitalit dhe Maternitetit të Lushnjes	↗ 8,10	↗ 7,80	↗ 8,50	↗ 6,30	↗ 8,50	↑ 8,85	↑ 9,15	↑ 9,25	↑ 9,20	↑ 9,00
Pr11: Ndërtimi i Pallatit të sportit në Lushnje, në afërsi të Stadiumit 'Roza Haxhiu"	⇨ 4,50	↗ 6,15	↗ 7,10	⇨ 5,95	↗ 8,00	↗ 8,50	↑ 8,90	↑ 9,10	↑ 8,80	↑ 9,00
Pr12: Ndërtimi i fushave të sportit në njësitë administrative Kolonjë, Krutje, Fier-Shegan	↗ 6,50	↗ 6,95	↗ 6,35	↗ 6,50	↗ 8,50	↑ 9,05	↗ 8,30	↑ 8,85	↗ 6,95	↑ 9,00

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Në bazë të vlerësimit të projekteve të O.4, nga 12 projektet e listuara më sipër rezulton se:

- Ndikimi i projekteve në **ajër** është i ulët. Nga 12 projekte, 4 projekte kanë ndikim mesatar ndërsa 8 projektet e tjera kanë ndikim të ulët.
- Ndikimi në **ujë** është i ulët. Bëjnë përjashtim 2 projekte që kanë ndikim mesatar në mjedis.
- Ndikimi në **tokë** është i ulët. Të gjitha projektet do kenë të njëjtin ndikim të ulët në mjedis.
- 50% e projektve kanë ndikim të ulët në **biodiversitet** ndërsa 50% e projekteve të tjera të Planit kanë ndikim mesatar në këtë objektiv mjedisor. E njëjta situatë paraqitet edhe në vlerësimin e ndikimit në **socio-ekonomi**.
- OM-ja në të cilën ndikimi i projekteve do të jetë i papërfillshëm mbetet **peizazhi,** me 10 projekte që vlerësohen me ndikim të papërfillshëm dhe 2 projekte që do të kenë ndikim të ulët.
- Ndikimi në **pyje** është i ulët. Përjashtim bëjnë 5 projekte të cilat kanë ndikim të papërfillshëm.
- Ndikimi shfaqet i papërfillshëm në **klimë**, **kulturë** dhe **shëndet.**

Si përfundim, në bazë të vlerësimit të 12 projekteve të O.4, rezulton se projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë ndikim të ulët në përbërësit e ajrit, ujit, tokës dhe pyjeve ndërsa lexohet një ndikim mesatar në përbërësit e biodiversitetit dhe në socio-ekonomi. Ndikimi i projekteve është i papërfillshëm në klimë, kulturë dhe shëndet.

5.2.3 Vlerësimi i përputhshmërisë së propozimeve të PPV

Përputhshmëria është tregues i shkallës së përputhshmërisë së objektivave të Planit me objektivat mjedisorë që ndikohen gjatë fazës së zbatimit të projekteve dhe në një kohë afatgjatë. Siç është shpjeguar në seksionet e mësipërme, vlerësimi numerik i nivelit të përputhshmërisë është bazuar në vlerat numerike të nxjerra nga vlerësimi i

ndikimit të projekteve në mjedis. Vlerësimi i përputhshmërisë është bëre njëkohësisht edhe duke përdorur përafrimin standard në formë matrice.

Më poshtë paraqitet vlerësimi i përputhshmërisë së projekteve të planit me objektivat mjedisorë (tabela 69). Nëpërmjet përputhshmërisë matim jo vetëm përputhshmërinë e çdo projekti me të gjitha objektivat njëherësh, por edhe kuptojmë, për çdo projekt, se në cilat OM dhe në çfarë mase (e matur në % ndaj totalit prej 9 OM-ve) arrihet, ose cënohet përputhshmëria e lartë.

Tabela 69. Përputhshmëra e objektivave mjedisore me projektet strategjike.

Bashkia LUSHNJE: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	Vlerësimi mesatar
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Cilësia e jetës	
O1: Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor	2,15	2,15	2,04	1,96	2,19	2,07	2,41	3,00	3,00	2,33
O1P1: Cilësia e produkteve bujqësore	2,00	2,00	2,00	2,00	2,00	2,00	3,00	3,00	3,00	2,33
Pr1: Hapja e qendrave të informimit bujqësor pranë 11 njësive administrative të Bashkisë Lushnje	2	2	2	2	2	2	3	3	3	2,33
O1P2: Nxitja e konsolidimit të fermave bujqësore përmes skemave mbështetëse vendore dhe qendrore	2,00	2,00	2,00	2,00	2,00	2,00	2,00	3,00	3,00	2,22
O1P3: Shtimi i pikave të grumbullimit	2,00	2,00	1,33	1,00	2,00	2,00	2,00	3,00	3,00	2,04
Pr3: Ngritja e qendrës së grumbullimit me kapanone frigoriferike pranë Tregut të Shitjes me shumicë të fruta-perimeve, Lushnje	2	2	1	1	2	2	2	3	3	2,00
Pr4: Ngritja e një qendre grumbullimi në Hysgjokaj	2	2	1	1	2	2	2	3	3	2,00
Pr5: Rehabilitimi i magazinave ish industriale në Njësinë Administrative Golem, dhe kthimi i tyre në pika magazinimi	2	2	2	1	2	2	2	3	3	2,11
O1P4: Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kullimit e vaditjes	2,00	2,33	2,00	1,33	2,00	1,67	2,00	3,00	3,00	2,15
Pr6: Sistemimi i stacionit të pompave ujitëse në Bitaj dhe Ardenicë	2	3	2	1	2	2	2	3	3	2,22
Pr7: Pastrimi i kanaleve të para dhe të dyta nga mbetjet dhe aluvionet e grumbulluara në 11 njësitë administrative	2	2	2	1	2	1	2	3	3	2,00

Pr8: Ndërtimi i sistemit të ujitjes në LiNjat e Krutjes dhe Tërbufit	2	2	2	2	2	2	2	3	3	2,22
O1P5: Energjitë e rinovueshme në bujqësi	3,00	2,00	2,00	2,00	2,00	1,00	3,00	3,00	3,00	2,33
Pr9: Ndërtimi i Centralit të Energjisë Diellore, në parcelat me tokë të kripur në fshatin Plug	3	2	2	2	2	1	3	3	3	2,33
O1P6: Rritja e numrit të tregjeve	2,00	1,67	1,67	1,67	1,67	1,67	2,00	3,00	3,00	2,04
Pr10: Zgjerimi i sipërfaqes dhe kapacitetit magazinues të Tregut të Fruta-Perimeve në Lushnje	2	2	2	2	1	1	2	3	3	2,00
Pr11: Ndërtimi i tregur të produkteve bujqësore në Fier-Shegan dhe Krutje	2	1	1	1	2	2	2	3	3	1,89
Pr12: Rehabilitimi i tregjeve të fruta-perimeve në të gjitha njësitë administrative të bashkisë	2	2	2	2	2	2	2	3	3	2,22
O1P7: Industri përpunimi dhe agropërpunimi	1,33	1,33	1,33	1,67	2,00	2,33	1,67	3,00	3,00	1,96
Pr13: Rehabilitimi i dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale në Zonën ekonomike e Plastmasit	1	1	2	2	2	2	2	3	3	2,00
Pr14: Rehabilitimi i dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale të Bashkisë në të cilin përfshihen: Zona ish-Industriale në fshatin Plug, Zona ekonomike e ish fabrikës së dyshekëve	1	1	1	1	2	3	1	3	3	1,78
Pr15: Ngritja e qendrës logjistike të mallrave pranë zonës ekonomike të Plastmasit	2	2	1	2	2	2	2	3	3	2,11
O1P8: Kualifikimi i forcës punëtore të sektorit bujqësor	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00
O1P9: Marketim i produkteve bujqësore të rajonit brenda dhe jashtë vendit	2,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	2,89
O2: Zhvillimi i [eko]turizmit	2,50	2,25	1,75	1,38	2,25	2,50	2,75	3,00	3,00	2,38
O2P1:Hartëzim itinerare turistike	2,00	2,00	1,00	1,00	2,00	2,00	3,00	3,00	3,00	2,11
Pr1: Rikonstruktimi i rrugëve peizazhistike vernakolare dhe pajisja me siNjalistikën dhe ndriçimin rrugor të domosdoshëm në të gjithë territorin e Bashkisë Lushnje	2	2	1	1	2	2	3	3	3	2,11
O2P2: Funksionimi i itinerareve	3,00	3,00	2,00	2,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	2,78
Pr2: Hartimi dhe marketimi i paketave turistike për promovimin e turizmit në bashkëpunim me aktorë privatë	3	3	2	2	3	3	3	3	3	2,78

dhe NGO										
O2P3: Mbështetja me infrastrukturë të gjelbër e korridoreve turistike dhe peizazhistike	2,00	2,00	2,00	0,50	2,00	2,00	2,00	3,00	3,00	2,06
Pr3: Rikonstruksioni i rrugës historiko-kulturore të Manastirit të Ardenicës dhe pajisja me korsinë e dedikuar të bicikletave	2	2	2	-1	2	2	1	3	3	1,78
Pr4: Pajisja e rrugëve urbane kryesore dhe dytësore me korsi të dedikuar për biciklet në të gjithë territorin e Bashkisë Lushnje	2	2	2	2	2	2	3	3	3	2,33
O2P4: Ekofermat dhe ekoturizmi	3,00	2,00	2,00	2,00	2,00	3,00	3,00	3,00	3,00	2,56
Pr5: Nxitja e zhvillimit të eko-fermave turistike në Njësitë administrative të Hysgjokaj dhe Ballagat	3	2	2	2	2	3	3	3	3	2,56
O3: Zhvillimi i planifikuar e kontrolli i territorit	1,83	1,88	1,88	1,38	2,13	2,13	2,58	2,83	3,00	2,18
O3P1: Hartimi e zbatimi i instrumenteve të menaxhimit të tokës në funksion të bujqësisë	2,33	2,00	2,00	1,67	3,00	3,00	2,67	3,00	3,00	2,52
Pr1: Ndërtimi i parkut periferik të qytetit të Lushnjes dhe parku i Kasharaj	2	2	2	3	3	3	3	3	3	2,67
Pr2: Kthimi i ndërtesave të ish komunave në qendra multifunksionale për të rinjtë, të moshuarit dhe përsona me aftësi të kufizuara	2	2	2	1	3	3	2	3	3	2,33
Pr3: Ndërtimi i parqeve këndeve të lojrave dhe lulishteve në Njësitë administrative të Kolonjës, Krutjes, Fier-sheganit, Dushkut, Hysgjokaj	3	2	2	1	3	3	3	3	3	2,56
O3P2: Aksesi për çdo njësi administrative përmes infrastrukturës rrugore	1,00	1,00	1,00	0,33	1,00	1,00	1,67	2,33	3,00	1,37
Pr4: Rikonstrusioni dhe zgjerimi i të gjithë infrastrukturës rrugore sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor, duke përmirësuar cilësinë e ndricimit rrugor dhe pajisjen me pemë në të dyja anët e rrugëve	1	1	1	-1	1	1	1	2	3	1,11
Pr5: Ndërtimi i stacionit multimodal në qendër të qytetit të Lushnjes dhe zhvillimi i zonës përreth	1	1	1	1	1	1	2	2	3	1,44
Pr6: Ndërtimi i Terminalit të autobusëve ndër dhe rreth	1	1	1	1	1	1	2	3	3	1,56

qytetas në hyrje të qytetit të Lushnjes										
O3P3: Infrastruktura e ujit dhe energjisë	2,00	2,50	2,50	1,50	2,50	2,00	3,00	3,00	3,00	2,44
Pr7: Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në tokat e kripura pranë By-Passit të Lushnjes	2	2	2	1	2	2	3	3	3	2,22
Pr8: Ndërtimi i pompave të ujit për përmirësimin e sistemit të ujësjellësit	2	3	3	2	3	2	3	3	3	2,67
O3P4: Ripërtëritje e qendrave admininstrative	2,00	2,00	2,00	2,00	2,00	2,50	3,00	3,00	3,00	2,39
Pr9: Rikonstruksioni i ndërtesave të shkollave dhe arsimit parashkollor në 11 njësitë administrative të Bashkisë Lushnje	2	2	2	2	2	3	3	3	3	2,44
Pr10: Ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore në fshatin Shegas dhe Allprenaj	2	2	2	2	2	2	3	3	3	2,33
O4: Mbrojtja e burimeve natyrore	1,87	1,96	2,11	1,65	2,52	2,91	2,80	3,00	3,00	2,42
O4P1: Fashat ripariane ujore	2,00	2,00	2,00	1,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	2,44
Pr1: Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman	2	2	2	1	3	3	3	3	3	2,44
Pr2: Rehabilitimi i Përroit të Lushnjes	2	2	2	1	3	3	3	3	3	2,44
O4P2: Mbrojtja e akuifereve nga ndotja	2,00	2,00	2,00	1,00	2,00	3,00	3,00	3,00	3,00	2,33
Pr3: Krijimi i korridoreve vegjetative në tokën bujqësore	2	2	2	1	2	3	3	3	3	2,33
O4P3: Sistemi menaxhimit të mbetjeve	1,33	1,67	2,00	1,33	2,67	2,67	2,67	3,00	3,00	2,26
Pr4: Rehabilitimi i fushës së mbetjeve dhe kthimi i saj në zonë të gjelbër	1	1	2	2	3	3	3	3	3	2,33
Pr5: Ndërtimi i impiantit të kompostimit të mbetjeve në fshatin Murriz-Peqin	2	2	2	1	2	3	3	3	3	2,33
Pr6: Ndërtimi i stacionit të transferimit të mbetjeve në tokat e kripura në Plug	1	2	2	1	3	2	2	3	3	2,11
O4P4: Vatrat e nxehta mjedisore	1,00	1,00	2,00	2,00	3,00	3,00	2,00	3,00	3,00	2,22
Pr7: Pastrimi i tre vatrave të nxehta mjedisore në qytetin e Lushnjes	1	1	2	2	3	3	2	3	3	2,22
O4P5: Erozioni dhe mbrojtja e kodrave	2,00	2,00	2,00	2,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	2,56
Pr8: Rehabilitimi i Kodrës së Lushnjes nëpërmjet metodës së ripyllëzimit dhe ristrukturimit infrastrukturor për rritje të qëndrueshmërisë e sigurisë	2	2	2	2	3	3	3	3	3	2,56
O4P6: Mbrojtja nga efektet e erozionit detar përmes	3,00	3,00	3,00	2,00	3,00	3,00	3,00	3,00	3,00	2,89

bashkëpunimit me bashkitë fqinjë										
O4P7: Infrastruktura arsimore	2,00	2,00	2,00	2,00	2,00	3,00	3,00	3,00	3,00	2,44
Pr9: Rikonstruksioni i shkollave dhe mjediseve të arsimit parashkollor	2	2	2	2	2	3	3	3	3	2,44
O4P8: Infrastruktura shëndetësore	2,00	2,00	2,00	2,00	2,00	3,00	3,00	3,00	3,00	2,44
Pr10: Përmirësimi i infrastrukturës fizike të Spitalit dhe Maternitetit të Lushnjes	2	2	2	2	2	3	3	3	3	2,44
O4P9: Aktiviteti kulturor e social	1,50	2,00	2,00	1,50	2,00	2,50	2,50	3,00	3,00	2,22
Pr11: Ndërtimi i Pallatit të sportit në Lushnje, në afërsi të Stadiumit 'Roza Haxhiu"	1	2	2	1	2	2	3	3	3	2,11
Pr12: Ndërtimi i fushave të sportit në njësitë administrative Kolonjë, Krutje, Fier-Shegan	2	2	2	2	2	3	2	3	3	2,33

Burimi : Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Në përgjithësi, në këndvështrimin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore, objektivat dhe politikat e Planit, janë si më poshtë :

Objektivat Mjedisorë të PPV-së për Bashkinë Lushnje paraqiten:

- me përputhshmëri të lartë mjedisore: në masën 18.18%
- me përputhshmëri të pjesshme: në masën 77.27%,
- me ndikim të theksuar në mjedis; 4.55% e ndërhyrjeve të parashikuara

Në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një përputhshmërisë e pjesshme e parë në kontekstin e përgjithshëm ku sipas fushave përkatëse mjedisore, intensitetin më të madh të ndikimeve në mjedis e marrin ndërhyrjet e forta në terren siç janë ato të zhvillimit të infrastrukturës urbane dhe rurale.

Duke qënë se mesatarja e përgjithshme e përputhshmërisë nga vlerësohet me 2.33, mund të përcaktojmë se Objektivat/ programet/ projektet përputhen pjesërisht me OM-të.

Pra, në tërësi, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Lushnje mund të zbatohet plotësisht në terren dhe të jetë miqësor me mjedisin vetëm duke respektuar standardet, kushtet dhe masat specifike mjedisore që do të rrjedhin nga vlerësimi specifik i secilit projekt.

Në tabelat e mëposhtme (tabela 70), përputhshmëria është sjellë në nivel objektivash e planesh të Programit.

Tabela 70. Përputhshmëria e objektivave dhe progameve të planit me OM-të

Bashkia LUSHNJE: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	**OM1**	**OM2**	**OM3**	**OM4**	**OM5**	**OM6**	**OM7**	**OM8**	**OM9**	**Vlerësimi mesatar**
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Cilësia e jetës	
O1: Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor	2,15	2,15	2,04	1,96	2,19	2,07	2,41	3,00	3,00	2,33
O2: Zhvillimi i [eko]turizmit	2,50	2,25	1,75	1,38	2,25	2,50	2,75	3,00	3,00	2,38
O3: Zhvillimi i planifikuar e kontrolli i territorit	1,83	1,88	1,88	1,38	2,13	2,13	2,58	2,83	3,00	2,18
O4: Mbrojtja e burimeve natyrore	1,87	1,96	2,11	1,65	2,52	2,91	2,80	3,00	3,00	2,42
Perputhshmeria Totale e Projekteve	2,09	2,06	1,94	1,59	2,27	2,40	2,63	2,96	3,00	2,33

Burim : Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Sipas të dhënave të kësaj tabele, vërehet se shkalla më e ulët e përputhshmërisë vihet re tek objektivi mjedisor i biodiversitetit, ajrit, ujit dhe, deri në një farë mase, tokës të cilat janë edhe elementët mjedisorë më të ndjeshëm nga projektet zhvillimore të parashikuara në PPV.

Përputhshmëria është sjellë edhe në nivel Plani e shprehur me përqindje (%) e cila na ndihmon të kuptojmë shpërndarjen e saj në nivel objektiv të Planit (tabela 71).

Tabela 71. Përputhshmëria e objektivave (në %)

Bashkia LUSHNJE: Përputhshmëria					
Objektivat Mjedisore Objektivat e Programet e Planit	**% e OM me P.Lartë**	**% e OM me P.Pjesshme**	**% e OM me P.Zbehtë**	**% e OM me P.Neutrale**	**% e OM me P.Mungon**
O1: Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor	42,8%	47,3%	9,9%	0,0%	0,0%
O2: Zhvillimi i [eko]turizmit	48,6%	43,1%	6,9%	0,0%	1,4%
O3: Zhvillimi i planifikuar e kontrolli i territorit	40,7%	38,4%	19,9%	0,0%	0,9%
O4: Mbrojtja e burimeve natyrore	50,6%	41,2%	8,2%	0,0%	0,0%
Perputhshmeria Totale e Projekteve	45,7%	42,5%	11,2%	0,0%	0,6%

Burimi : Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Si përfundim, duke u bazuar në tabelën e mësipërme, Objektivat I, II, III dhe IV të PPV për Bashkinë Lushnje paraqiten me përputhshmëri të lartë mjedisore në masën 45.7% dhe me përputhshmëri të pjesshme në masën 42.5%. Vetëm 0.6% e ndërhyrjeve të parashikuara rezulton me përputhshmëri të munguar ndërsa 11.2% e ndërhyrjeve kanë përputhshmëri të zbehtë.

5.2.4 Vlerësimi i projekteve të veçanta të PPV-së

Në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lushnje janë përcaktuar projekte specifike për çdo objektiv. Të gjitha projektet janë të ndryshme për nga lloji dhe ndikimi që ata kanë në mjedis.

Në tërësinë e projekteve të propozuara në PPV është bërë përzgjedhja e 4 projekteve për t'u trajtuar në bazë të 4 kritereve: i) shkalla e ndikimit në mjedis gjatë zbatimit, ii) shkalla e ndërhyrjes në territor, iii) niveli i përputhshmërisë me objektivat mjedisorë dhe iv) shkalla e ndikimit afatgjatë (gjatë operimit). Projektet e përzgjedhura dhe të konsideruara si elemetë të veçantë janë:

1. Rikonstruksioni dhe zgjerimi i infrastrukturës rrugore sipas PPV-së duke synuar përmirësuar ndriçimin e rrugëve dhe duke i pajisur me pemë,
2. Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN)
3. Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman dhe Rehabilitimi i Përroit të Lushnjes
4. Rehabilitimi i zonave të nxehta

Në vazhdim trajtohet në mënyrë të veçantë çdo projekt, duke analizuar kryesisht ndikimet negative në mjedis dhe rekomandimin e disa masave specifike për uljen e ndikimit dhe rritjen e nivelit të përputhshmërisë me objektivat mjedisorë (OM).

- *Vlerësimi i projektit: Rikonstruksioni dhe zgjerimi i infrastrukturës rrugore sipas PPV-së duke përmirësuar ndriçimin dhe pajisjen me pemë*

Nisur nga analiza e ndikimit në mjedis të projekteve të PPV-së të Bashkisë Lushnje, rezulton se një numër i caktuar projektesh ka ndikim të lartë në mjedis krahasuar me projektet e tjera. Një ndër projektet që rezulton të ketë ndikim relativisht të lartë në mjedis është rikonstruksioni dhe zgjerimi i infrastrukturës rrugore sipas PPV-së, duke përmirësuar ndriçimin dhe pajisjen me pemë *(*Tabela 72*).*

Tabela 72. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i projektit

Bashkia LUSHNJE: Ndikimi										
Objektivat Mjedisore	**OM1**	**OM2**	**OM3**	**OM4**	**OM5**	**OM6**	**OM7**	**OM8**	**OM9**	
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Shëndet	Social-ekonomik
O3: Zhvillimi i planifikuar e kontrolli i territorit										
Pr4: Rikonstrusioni dhe zgjerimi i të gjithë infrastrukturës rrugore sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor, duke përmirësuar cilësinë e ndricimit rrugor dhe pajisjen me pemë në të dyja anët e rrugëve	⇨ 3,20	⇨ 3,70	⇨ 4,25	⇩ 2,50	⇨ 5,20	⇨ 4,70	⇨ 4,60	⇗ 8,00	⇧ 9,25	⇧ 8,65

Burimi : Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Sipas të dhënave të pararaqitura në tabelën e mësipërme, ndikimi i këtij projekti në ajër, ujë, tokë, pyje, peizazh dhe klimë rezulton mesatar. Siç ndodh në projekte të tilla, ndikimi në ajër është i lartë, kryesisht gjatë fazës së ndërtimit, kur shkarkimet e lëndës së ngurtë pezull (LNP) dhe ndotësve të tjerë të gaztë në atmosferë gjatë punimeve (gërmimet, ndërtimet dhe djegia e lëndës djegëse nga makinerite etj.) do të jenë në nivele të konsiderueshme. Numri i lartë i makinave të tonazhit të rëndë në sipërfaqe të kufizuar brenda territorit të projektit në lëvizje të vazhdueshme (në shesh ndërtim) krijon një ndotje të përkohshme në ajër. Ndotja theksohet edhe më tej në rastin e vendit tonë ku cilësia e lëndës djegëse për makinat ka rezultuar të jetë e një cilësie jo të mirë (shihni seksionin e ajrit).

Vlerësimi i përputhshmërisë ndërmjet objektivave, programeve dhe projekteve të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lushnje dhe objektivave mjedisore të VSM-së paraqitet si më poshtë (tabela 73).

Tabela 73. Përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore

Bashkia LUSHNJE: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	Vlerësimi mesatar
	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Cilësia e jetës	
Pr4: Rikonstrusioni dhe zgjerimi i të gjithë infrastrukturës rrugore sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor, duke përmirësuar cilësinë e ndricimit rrugor dhe pajisjen me pemë në të dyja anët e rrugëve	1	1	1	-1	1	1	1	2	3	1,11

Burimi : Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Nga tabela vihet re se projekti i propozuar nga PPV-ja ka një përputhshmëri të zbehtë me objektivat mjedisore të VSM-së. Lidhja midis projektit me objektivin mjedisor të cilësisë së jetës ka një përputhshmëri të plotë, ndërsa me objektivin mjedisor të kulturës përputhet pjesërisht.

Sa i përket përputhshmërisë së projektit me OM-të ajër, ujë, tokë, pyje, peizazh, dhe klimë rezulton të jetë e zbehtë. Ndërsa projekti nuk ka përputhshmëri me objektivin mjedisor të biodiversitetit. Në këtë situatë shihet i domosdoshëm zbatimi i masave paraprake gjatë zbatimit dhe operimit të projektit, me qëllim rritjen e përputhshmërisë me OM-të.

Në përgjithësi, ndërtimi i infrastrukturës rrugore zakonisht sjell rritjen e trafikut në zonat ku më parë ishte i kufizuar, dhe si pasojë, edhe numrin e makinave në qarkullim, duke shtuar kështu sasinë e gazrave të dëmshme që shkarkohen në ajër nga djegia e lëndës djegëse. Për këtë arsye, mendohet se pas ndërtimit të rrugëve, efekti do të jetë krahasimisht i konsiderueshëm për shkak të numrit më të madh të volumit të transportit rrugor.

Krahas ndikimeve në ajër e tokë, ndërtimi i infrastrukturës rrugore sjell edhe copëtimin e sipërfaqes natyrore që shërben si habitat për faunën e zonave të prekura. Në këto raste, fauna mendohet se do të hasë vështirësi në përdorimin e të gjithë habitatit të mëparshëm, apo dhe humbjen e pjesëve të tij. Kryesisht, ndikimi më i madh do të ndihet tek gjitarët e mëdhenj, pasi këto specie kërkojnë sipërfaqë të gjera të pafragmentuara për t'u zhvilluar normalisht. Ndaj, në raste të tilla, si masë zbutëse është parë ndërtimi i urave ekologjike në mënyrë që fauna ta përdorë si korridor për t'u lidhur me pjesën tjetër të habitatit.

Në projektet e ndërtimit dhe zgjerimit të rrugëve ndodh edhe krijimi i sasirave të mëdha të mbetjeve gjatë gërrmimeve, ndërtimeve, shtrimeve, etj. për shkak të numrit të lartë të makinerive që përdoren në raste të tilla. Megjithatë, një problematikë e tillë mund edhe të shmanget në rast se merren masa për parandalimin e tyre. Në këto raste, masa të tilla mund të përfshijnë grumbullimin e dherave të gërrmuara në venddepozitime të përshtatshme dhe mbulimin e dherave me mjete të posaçme për shmangien e erozionit nga shirat dhe dherat. Njëkohësisht, ndikimi në mjedis mund të zbutet kur mbetjet e krijuara grumbullohen e trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

Ndikim të ulët të këtyre projekteve pritet të ketë në kulturë, ndërsa në shëndet dhe në socio-ekonomi, këto projekte do të kenë ndikim të papërfillshëm.

- *Vlerësimi i projektit: Ndërtimi i Impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura*

Ndërtimi i Impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura konsiderohet si një projekt mjaft i rëndësishëm, me ndërtimin e të cilit është planifikuar të realizohet trajtimi i ujërave të ndotura urbane të Bashkisë Fier duke shmangur përfundimisht derdhjen e tyre në lumin Seman. Ky projekt është domethënës për ndikimin e tij në mjedis si gjatë fazës së ndërtimit ashtu edhe gjatë fazës së operimit.

Tabela 74.Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i Pr.7

Bashkia LUSHNJE: Ndikimi										
Objektivat Mjedisore	**OM1**	**OM2**	**OM3**	**OM4**	**OM5**	**OM6**	**OM7**	**OM8**	**OM9**	
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Shëndet	Social-ekonomik
O3: Zhvillimi i planifikuar e kontrolli i territorit										
Pr7: Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në tokat e kripura pranë By-Passit të Lushnjes	↗ 7,10	↗ 8,05	↗ 7,25	⇨ 5,60	↗ 8,25	↗ 8,05	⇧ 8,75	⇧ 8,90	⇧ 9,30	⇧ 9,20

Përgatiti: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Nga vlerësimi në mjedis ka rezultuar se projekti do të ketë ndikim të ulët ose mesatar në mjedis (në objektivat mjedisore të ajrit, ujit, tokës, pyjeve dhe biodiversitetit) në rast se merren masat e nevojshme mjedisore. Megjithatë, impiante të tilla paraqesin sfida të mëdha gjatë ndërtimit dhe menaxhimit gjatë kohës së funksionimit.

Në rast se do analizojmë përputhshmërinë midis objektivave të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Lushnje dhe objektivave mjedisorë për projektin e *Ndërtimit të Impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura* do të vlerësohej si më poshtë :

Tabela 75. Përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore

Bashkia LUSHNJE: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	**OM1**	**OM2**	**OM3**	**OM4**	**OM5**	**OM6**	**OM7**	**OM8**	**OM9**	**Vlerësimi mesatar**
	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Cilësia e jetës	
Pr7: Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në tokat e kripura pranë By-Passit të Lushnjes	2	2	2	1	2	2	3	3	3	2,22

Përgatiti: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Vlerësimi mesatar i përputhshmërisë së objektivave mjedisorë me objektivin e projektit për *Zhvillimin e planifikur të kontrollit të territorit* vlerësohet të jetë i pjesshëm. Nga analiza e përbërësve të mjedisit të marrë më vete, vihet re se objektivi

mjedisor për biodiversitetin përputhet në mënyrë të zbehtë me projektin e PPV-së, për ndërtimin e ITUN. *Kjo gjë n*uk ndodh me klimën, kulturën dhe cilësinë e jetës ku përputhshmëria është e plotë. Për objektivat mjedisorë të ajrit, ujit, tokës, pyjeve dhe peizazhit përputhshmëria vlerësohet të jetë e pjesshme me objektivat e Planit.

Projekti për ndërtimin e Impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura ka përputhshmëri të pjesshme me objektivat mjedisorë (OM) në përgjithësi. Për objektivat mjedisore të ujit, ajrit, tokës, biodiversitetit, pyjeve dhe peizazhit, përputhshmëria është e pjesshme me objektivat e Planit të Përgjithshëm vendor. Ndërsa objektivat e Planit përputhen plotësisht me objektivat mjedisore të klimës, kulturës dhe cilësisë së jetës.

Në përgjithësi, impiante të tilla paraqesin sfida të mëdha mjedisore gjatë ndërtimit dhe menaxhimit të tyre gjatë kohës së funksionimit. Që në fazën fillestare të ndërtimit të impianteve të tilla ndihen ndikimet në tokë. Kjo për arsyen se ndërtimi i impianteve të tilla kryhet në sipërfaqe të konsiderueshme toke e cila i hiqet fondit të tokave bujqësore (edhe pse tokat ku është planifikuar të ndërtohet nuk janë klasifikuar si toka pjellore). Sipërfaqja ku do të ndërtohet rrjedhimisht ndryshon përdorimin e saj. Nga sipërfaqe bujqësore shndërrohet në sipërfaqe të betonizuar. Në rastet kur ndërtohet një impiant i tillë, tokë e humbur bujqësore llogaritet jo vetëm sipërfaqa e planifikuar për ndërtimin e impiantit, por edhe zona përreth. Për më tepër, gjatë ndërtimit, në sipërfaqen e përcaktuar për sipërfaqen e landfillit, kryhet edhe heqja e bimësisë në mënyrë që të bëhen gërmimet e nevojshme. Si pasojë, në këto sipërfaqe, edhe pse afatshkurtër, ndodh zhvillimi i dukurisë së erozionit gjatë ndërtimit të tij.

Ndikime afatgjatë përveç humbjes së sipërfaqes së tokës, parashikohet të ndodhin në burimet ujore ku këto impiante kanë planifikuar të derdhin ujërat që dalin nga impianti, pas trajtimit (në rastin tonë, në kanalin e afërt kullues). Ndikimi është i lartë në ujë në rast se impianti nuk funksionon sipas standardeve duke shkaktuar trajtim jo cilësorë të ujërave. Si pasojë, shkarkimi i këtyre ujërave në lumin Seman do të shkaktonte ndotje mikrobiologjike (e. Coli, etj) dhe kimike të tij me pasoja të rënda për shëndetin e banorëve. Shëndeti i banorëve rrezikohet edhe më tepër gjatë stinë së verës kur kanali kullues në të cilin shkarkohen këto ujëra dhe më tej në lumenj përdoret për ujitje nga banorët vendas dhe për argëtim (larje).

Dëme të konsiderueshmë do të hasen edhe gjatë periudhave me shira të shumtë, në rast përmbytjesh. Në raste të tilla, kur sasia e ujit të ardhur në impiant është e lartë, ndotja e përqëndruar në ujë do të zvogëlohet dhe pastrimi i ujit nuk do të ndodhë cilësisht.

Gjithashtu, në të njëjtn situatë kur ndodhin përmbytjet, ujërat e futura në impiant për trajtim do të përziheshin me ujërat e shiut dhe do të përmbysnin tokat bujqësore përreth. Në të dyja rastet, ndodh shkarkimi i ujërave të ndotura me bakterie të ndryshme, të cilat përbëjnë rrezik për florën, faunën dhe për shëndetin e njeriut.

Për më tepër, një problematikë që shfaqet në zonat ku vendosen impiantet janë aromërat e pakëndshme që çlirohen. Kjo varet nga teknologjia e përzgjedhur për ndërtimin e impiantit. Në impiantet e trajtimit me filtër biologjik, për shembull, ndjehet më tepër aroma e pakëndshme. Kjo ndodh si pasojë e shpërpërjes së përbërësve organikë në ujë. Banimi në zona të tilla është i parehatshëm.

Ky projekt është vlerësuar të ketë ndikim mesatar edhe në biodiversitet. Gjatë fazës së ndërtimit kryhen punime duke prishur ekuilibrin natyror dhe duke ulur numrin e florës

dhe faunës në këtë zonë. Edhe gjatë fazës së funksionimit të impiantit, në zonat përreth shkaktohen aromëra të pakëndshme duke krijuar shqetësime për faunën.

Objektivat e Planit kanë përputhje të plotë me objektivat mjedisorë të klimës, kulutrës, shëndetit dhe në aspektin social-ekonomik.

- *Vlerësimi i projektit: Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman dhe Rehabilitimi i Përroit të Lushnjes*

Projekti i rehabilitimit mjedisor dhe kthimit në zona rekreative të zonës ripariane të lumenjve konsiston në mbjelljen e pemëve për të plotësuar fashën e gjelbër përgjatë lumenjëve, e cila ka funksion të shumfishtë në mbrojtjen e tokës, mbrojtjen e ujërave të lumit nga ndotja, krijimin e një korridori të gjelbër për faunën si dhe përmirësimin e cilësisë së peizazhit dhe krijimin e zonave shlodhëse për popullsinë.

Tabela 76.Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i projektit

Bashkia LUSHNJE: Ndikimi										
Objektivat Mjedisore	**OM1**	**OM2**	**OM3**	**OM4**	**OM5**	**OM6**	**OM7**	**OM8**	**OM9**	
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Shëndet	Social-ekonomik
O4: Mbrojtja e burimeve natyrore										
Pr1: Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman	↗ 8,25	↗ 7,20	↗ 7,50	⇨ 4,80	⇧ 9,25	⇧ 9,40	⇧ 9,20	⇧ 9,00	⇧ 9,15	⇧ 9,00
Pr2: Rehabilitimi i Përroit të Lushnjes	↗ 8,35	↗ 6,20	↗ 8,05	⇨ 5,15	⇧ 9,05	⇧ 8,90	⇧ 9,10	⇧ 8,80	⇧ 9,20	↗ 8,00

Përgatit: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Siç shohim dhe nga tabela e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, projekti ka ndikim të papërfillshëm në pyje, peizazh, klimë, kulturë dhe shëndet. Vlerësimi paraqitet pozitiv sepse parashikon sistemimin dhe pyllëzimin e zonave ripariane përgjatë lumenjve.

Ndërsa në ajër, ujë dhe tokë ndikimi është i pjesshëm në rast se zbatohen masat zbutëse dhe parandaluese në lidhje me këto objektiva. Në këto objektiva do të ketë më tepër ndikim gjatë kohës së punimeve.

Me përmirësimin e argjinaturës së lumenjve pritet ndikim më i vogël në tokë duke eleminuar fenomenin e erozionit të brigjeve dhe gërryerjen e shtratit të lumit. Ndërsa në ujë do të ulet turbullira dhe sasia e infiltrimeve nga toka bujqësore për në lumë.

Duke ndërhyrë në shtratin e lumenjve gjatë fazës së punimeve për rehabilitimin e tyre, parashikohen problematika të ndryshme si erozion të tokës, sedimentim të lumenjve duke shkaktuar kështu turbullira në ujërat e tyre me pasoja të rënda për faunën, zhurma të shkaktuara nga makineritë gjatë punimeve që kryhen për pastrimin e shtratit të lumit, presion i ushtruar në tokë nga makineritë ose ngjeshje të tokës, etj.

Projekti i rehabilitimit të zonave ripariane është një projekt i cili do të ketë ndikime të lehta afatshkurtër (në fazën e zbatimit), ndërsa në plan afatgjatë, projekti do të ketë ndikim pozitiv në mbrojtjen e tokës nga gërryerja në brigjet e lumit, mbrojtjen e lumenjve nga ndotja me inpute bujqësore, përmirësimin e regjimit të shtretërve të lumenjëve, krijimin e një korridori të gjelbër për florën e faunën, si dhe krijimin e një mjedisi çlodhës e argëtues për banorët e zonave përreth.

Në lidhje me përputhshmërinë e objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore ky projekt është vlerësuar si më poshtë:

Tabela 77. Përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore

Bashkia LUSHNJE: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	**OM1** Ajri	**OM2** Uji	**OM3** Toka	**OM4** Biodiversiteti	**OM5** Pyjet	**OM6** Peizazhi	**OM7** Klima	**OM8** Kultura	**OM9** Cilësia e jetës	**Vlerësimi mesatar**
Pr1: Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman	2	2	2	1	3	3	3	3	3	2,44
Pr2: Rehabilitimi i Përroit të Lushnjes	2	2	2	1	3	3	3	3	3	2,44

Burimi : Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Projekti për rehabilitimin e fashave të gjelbëra (zonave ripariane) përgjatë lumenjëve dhe përrenjëve në territorin e Bashkisë rezulton të ketë përputhsshmëri të pjesshmë me objektivat mjedisorë të VSM-së. Projekti ka përputhshmëri të zbehtë me OM-në Biodiversitet dhe të pjesshme me OM-të ajër, ujë, tokë, ndërsa me OM-të e tjera projekti përputhet plotësisht.

- *Vlerësimi i projekti : Rehabilitimi i zonave të nxehta*

Në shqyrtim të projekteve për *Pastrimin e tre vatrave të nxehta mjedisore në qytetin e Lushnjes* do të shohim se Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i këtij projekti paraqitet si në tabelën e mëposhtme.

Tabela 78.Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis i projekteve

Bashkia LUSHNJE: Ndikimi										
Objektivat Mjedisore	**OM1**	**OM2**	**OM3**	**OM4**	**OM5**	**OM6**	**OM7**	**OM8**	**OM9**	
Objektivat e Programet e Planit	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Shëndet	Social-ekonomik
O4: Mbrojtja e burimeve natyrore										
Pr7: Pastrimi i tre vatrave të nxehta mjedisore në qytetin e Lushnjes	⇨ 4,85	⇨ 4,80	↗ 8,30	↗ 7,00	↗ 8,05	↑ 8,95	↑ 8,60	↗ 8,00	↑ 9,20	↗ 8,50

Përgatiti: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Nga vlerësimi i bërë për projektin e pastrimit të tre vatrave të nxehta mjedisore rezulton se ka ndikim mesatar në objektivat mjedisore të ajrit dhe të ujit. Për shkak të aktivitetit që do të zhvillohet gjatë pastrimit të vatrave do të shkaktohet ndotje në ajër dhe në ujë. Gjithashtu vlerësohet ndikim i ulët në tokë, biodiversitet, pyje, kulturë dhe social-ekonomik.

Projekti i rehabilitimi mjedisor dhe ristrukturimi i ish-zonave industriale konsiston në pastrimin mjedisor të zonës dhe kthimin në zonë të gjelbër dhe rekreative. Ndërhyrjet që përcakton ky projekt janë të përqëndruara në pastrimin fizik të mbetjeve dhe tokës së ndotur dhe mbjelljen e fidaneve dhe ndërtimin e një zonë rekreative.

Ndikimi negativ që ka projekti konsiston në fazën e zbatimit të tij, kryesisht nga shqetësimi i tokës, krijimi i erozionit të tokës e ngjeshes së saj, riaktivizimi i elementeve ndotës gjatë trazimit të dherave për heqjen e tyre, dëmtimi i biodiversitetit në këtë zonë nga heqja e sipërfaqeve të ndotjes dhe gjithashtu do të ketë ndikim në shpërndarjen e ndotësve në ajër dhe ujërat sipërvaqësore/nëntokësore gjatë kryerjes së punimeve.

Përveç shqetësimit të tokës së ndotur, gjatë zbatimit të projektit krijohet edhe një sasi e kosiderueshme mbetjesh të rrezikshme (dherat e ndotur) për depozitimin e të cilave nevojitet të përcaktohet një venddepozitim i posaçëm (mundësisht një venddepozitim për mbetjet e rrezikshme), për të shmangur ndotjen e burimeve ujore sipërfqësore dhe nëntokësore. Ndikimi në tokë lidhet dhe me biodiversitetin pasi me zhvendosjen e një sipërfaqe toke do të ulej numri i florës dhe faunës, që rritet në atë zonë.

Vlen të theksohet që projekti do të ketë një ndikim negativ afatshkurtë në OM-të (vetëm gjatë fazës së zbatimit), pasi ky projekt synon përmirësimin e mjedisit në këtë zonë, duke mbjellë pëmë dhe duke e kthyer atë në një zonë të gjelbër, e cila të dë ndikojë pozitivisht në të gjithë OM-t.

Gjatë fazës së zbatimit të projektit është i rëndësishëm zbatimi i masave parandaluese, ndjekja e praktikave të cilët nuk shpërndajnë ndotjen në sipërfaqe më të gjerë (përdorimi i kamionëve të cilët nuk krijojnë rrjedhje gjatë transportimit) dhe përfundimi i punimeve në afatin e paracaktuar, në mënyrë që kohëzgjatja e ndikimit gjatë kësaj fazë të jetë sa më e shkurtër.

Sa i përket përputhshmërisë së projektit me objektivavat mjedisore të VSM-së, rezulton përputhshmëri e pjesshme midis tyre.

Tabela 79. Përputhshmëria e projekteve me objektivat mjedisore

Bashkia LUSHNJE: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	**OM1**	**OM2**	**OM3**	**OM4**	**OM5**	**OM6**	**OM7**	**OM8**	**OM9**	**Vlerësimi mesatar**
	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Klima	Kultura	Cilësia e jetës	
Pr7: Pastrimi i tre vatrave të nxehta mjedisore në qytetin e Lushnjes	1	1	2	2	3	3	2	3	3	2,22

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Vlerësimi mesatar i përputhshmërisë së projektit me objektivat mjedisore vlerësohet i pjesshëm. Në mënyrë specifike, me objektivin mjedisor të ajrit dhe ujit përputhen në nivel të ulët, ndërsa me OM-në e tokës, biodiversitetit dhe klimës përputhen në mënyrë të pjesshme. Nuk mund të themi të njëjtën gjë për pyjet, peizazhet, kulturën dhe cilësinë e jetës pasi me këto OM projekti përputhet plotësisht.

5.2.5 Ndikimi i përgjithshëm i Planit sipas OM-ve

Ndikimet më të mëdha në mjedis vijnë si pasojë ndërhyrjeve në territor. Projektet e propozuara për përmirësimin e infrastrukturës publike janë ato që shkaktojnë ndryshimet më të mëdha mjedisore, ndikime që janë pasqyruar dhe në tabelën ku janë vlerësuar projektet sipas objektivave mjedisore. Më poshtë do të paraqitet vlerësimi i indikatorëve mjedisor nën impaktin e projekteve parashikuara në PPV-në e Bashkisë Lushnje.

- *Ndikimi i përgjithshëm i Planit në tokë*

Gjatë fazës së ndërtimit për zhvillimin e infrastrukturës ndikimi në mjedis parashikohet të jetë i lartë. Zbatimi i projekte në ato sipërfaqe toke ku do të ndërtohet

do të ketë kthim të sipërfaqes natyrore në infrastrukturore. Ky ndryshim do të ndryshojë përdorimin e tokës dhe do të çojë në zvogëlimin e sipërfaqes së tokës natyrore ose bujqësore dhe betonizimin e saj duke shkaktuar dhe fragmentrizim të habitatit natyror.

Gjatë fazës së ndërtimit, në zbatimin e projekteve të Planit të Bashkisë Lushnje, të cilat kanë punime për ndërtime të reja, ka ndikime të kthyeshme sidomos në zonën e ndërtimit. Këto ndërtime shkaktojnë dëmtimin e tokës duke shkaktuar fenomene të tilla si erozioni, shqetësime të faunës, rritja e prurjeve të sedimenteve në rast shirash të rrëmbyeshëm, rritjen e sasisë së grimcave pezull në ajër si rezultat i veprimit të erës në tokën ku do ndërtohet.

Ndërtimet e reja ose rindërtimet e infrastrukturës janë burim i prodhimit të volumeve të mëdha të mbetjeve. Ato gjithashtu krijojnë presione mbi përdorimin e burimeve natyrore. Mbetjet gjenerohen si gjatë fazës së ndërtimit ashtu dhe gjatë fazës së funksionimit. Ndikimi nga gjenerimi i mbetjeve llogaritet të jetë i përhershëm dhe i pakthyeshëm. Ndaj mendohet se duhet të merren masa për menaxhimin e mbetjeve në mënyrë që ndikimi në mjedisit të ulet.

Sasitë e mbetjeve të gjeneruara nga infrastruktura në veçanti, konsiderohen të volumeve të mëdha. Ndërtimi i veprave kombëtare dhe rajonale gjeneron sasitë më të mëdha të mbetjeve, ndërsa ndërtimi i veprave lokale ka si rezultat sasi më të vogël mbetjesh. Këto mbetje të gjeneruara mund të ripërdoren në infrastruktura të ngjashme si materiale mbushës. Zakonisht përzierjet e materialeve të dala nga ndërtimet shpesh kanë karakteristika më të mira funksionale në krahasim me ato konvencionale.

Në mënyrë që të bëhet një administrim ekonomik i burimeve natyrore përveç masave specifike që jepen në PPV e Bashkisë Lushnje, duhet të merren dhe masa të përgjithshme shtesë me qëllim uljen e ndotjes së tokës, të tilla si përdorimim i materialeve të riciklueshme në ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës për çdo sektor.

Të gjithë projektet të cilat kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e projekteve në mënyrë institucionale dhe organizative nuk kanë ndikim në mjedis.

- *Ndikimi i përgjithshëm i Planit në ajër*

Ndikimi kryesor në ajër në lidhje me zbatimin e projekteve të Planit të Bashkisë Lushnje do të vijë si rrjedhojë e zhvillimit të transportit. Shkarkimet në ajër të gjeneruara gjatë fazës së ndërtimit ose rindertimit të infrastrukturës, do të kenë ndikim afatshkurtër ose të kthyeshëm. Ndotja në ajër si pasojë e shkarkimeve do të shfaqet dhe si pasojë e një numri të madh aktivitetesh.

Në lidhje me transportin pritet që të kenë ndikime pozitive si rezultat i zbatimit të projekteve që synojnë fuqizimin e transportit publik dhe atij alternativ, zbatimin e projekteve që synojnë ndalimin e qarkullimit të automjeteve në zona me cilësi jo të mirë të ajrit apo shtimi i zonave të gjelbra në hapësirat e Bashkisë Lushnje.

Ndikimet pozitive për shkarkimet në ajër priten dhe nga marrja e masave nga sektorë të tjerë ekonomik që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda Bashkisë Lushnje duke marr në konsideratë kontrrollin e shkarkimeve në ajër, marrjen e masave për pakësimin e ndotjes së shkarkuar në ajër dhe përdorimi i energjive të gjelbra (për shembull. energjia diellore).

Sfidat kryesore dhe prioritetet e zbatimit të projekte të Planit synojnë konsolidimin e Sistemit Kombëtar të Monitorimit sipas standardeve Eurpiane, përshtatja e legjistlacionit tonë dhe zbatimi me standardet Europiane sa i përket cilësisë së ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër dhe hartimi dhe zbatimi i planeve të veprimit në përmirësimin e cilësisë së ajrit në nivel lokal dhe Qëndror.

Nivelet e shkarkimeve të grimcave pezull në ajër do të rriten në zonat ku do të ketë ndërtime dhe rindërtime të infrastrukturës. Këto grimca janë shkaktarë të një sërë sëmundjesh tek njeriu, të tilla si astma, arteroskleroza, sëmundje që kanë lidhje me sistemin e frymëmarrjes deri në kancer. Njerëzit, që punojnë dhe jetojnë në zonat ku ndërtohet ose rindërtohet janë të ekspozuara ndaj këtyre grimcave dhe rreziku për tu prekur prej sëmundjeve është i madh. Ndaj gjatë zhvillimit të projekteve duhet të zbatohen masat në mënyrë që të pakësohet shkarkimi i grimcave në gjendje pezull nga sheshet e ndërtimit.

Pritet që zbatimi i masave të PPV-së të Bashkisë Lushnje të minimizojë shkarkimet ndotëse në ajër. Kjo mund të vijë si rrjedhojë e uljes së bllokimeve të trafikut, menaxhimit më të mire të sipërfaqeve rrugore dhe përdorimit të mjeteve me efiçencë energjie.

- *Ndikimi i përgjithshëm i Planit në ujë*

Ndikimi në ujë (sipërfaqësor dhe nëntokësor) nga zbatimi i projekteve do të ndjehet shumë sidomos nga sektorët që shkokatojnë ndotje më të mëdha. Problematike pritet të jetë situata nga zhvillimi i industrisë së naftës, ujësjellës/kanalizimet, vaditja dhe bujqësia e blegtoria në përgjithësi, industria ushqimore dhe shërbimet në Bashkinë Lushnje.

Gjatë peridhës së ndërtimit/rindërtimit dhe funksionimit të infrastrukturës ndikimi në ujëra pritet të jetë në funksion të përdorimit. Në shumicën e rasteve ndikimi është i kthyeshëm ndërsa në raste të tjera ndikimi mund të shtrihet në nivel rajonal dhe deri në ndërkufitar dhe ngarkesat ndotëse janë të niveleve të larta. Ndikimi në ujë është i lidhur ngushtë me përdorimin e ujit dhe me trupin ujorë që do të presë shkarkimet e këtij uji të përdorur.

Pas fazës së ndërtimit, ndikimet mund të jenë të pakthyeshme si pasojë e ndikimit në morfologjinë e ujërave natyrorë, si në cilësinë e tyre, mosrespektimin e zonve mbrojtëse duke shkaktuar ndryshim të cilësive biologjike,fizike dhe kimike.

Disa nga veprimtaritë që ndikojnë në cilësinë e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore janë pozicionimi i veprave të ndërtuara në zonat e akuiferëve me ndjeshmëri të lartë dhe shumë të lartë dhe në zonat e mbrojtura të burimeve ujore. Ndikimet në ujë mund të jenë të përhershme ose të përkohshme, gjithashtu ndikimi klasifikohet dhe si i drejtpërdrejtë ose në largësi. Ndikime të tilla shkaktojnë ndryshim të morfologjisë së ujërave, ndikim i cili shkaktohet nga rrjedhjet e substancave të rrezikshme nga burimet ndotëse (impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe industriale, pozicioni i venddepozitimit të mbetjeve), derdhjet e sustancave të rrezikshme si pasojë e ngjarjeve të jashtëzakonshme si dhe rreziku i lartë nga përmbytjet.

Në legjislacionin shqiptarë në fuqi është përcaktuar se në ujë dhe në tokat anash burimeve ujore mund të kryhen vetëm ato veprimtari, të cilat bazohen në planet e zhvillimit hapësinor dhe nuk mund të pozicionohen diku tjetër pa prodhuar kosto të lartë disproporcionale. Pozicionimi i tyre mund të ndikojë thellësisht mbi statusin ekologjik të rrjedhave ujore që përshkojnë Bashkinë e Lushnje.

- *Ndikimi i përgjithshëm i Planit në biodiversitet*

Ndikimi më i madh në biodiversitet ndodh gjatë fazës së ndërtimit dhe rindërtimit të veprave ndërtimore, ndikime të cilat konsiderohen afatshkurtër për Bashkinë e Lushnjes. Ndikime të tilla shkaktohen nga zhurmat në sheshndërtim apo prishje e habitatit natyror. Ndikikimet afatgjatë dhe të pakthyeshme gjatë fazës së ndërtimit shkaktohen si rezultat i ndryshimit të përdorimit të tokës dhe ndërprerjes së rrugëve të migrimit të kafshëve. Ky ndikim mbartet dhe në vazhdim, gjatë fazës së funksionimit.

Ndërtimi i strukturave të reja dhe rindertimi i infrastruktures ekzistuese mund të rezultojë në humbje të florës dhe faunës, fragmentim të habitatit dhe ndërprerjen e rrugëve migruese të llojeve të veçanta ose jo. Dëmtime të biodiversitetit shkaktohen si rrjedhojë e mungesës së përkujdesjes për të mos shkëputur komunikimin me habitatin (shembull. ndërtimi i urave të gjelbërta), konfliktualitet midis ndërtimeve dhe rindërtimeve me faunën, krijimit të zhurmës duke krijuar shqetësim tek shpendët dhe gjitarët, ndriçimit të strukturave të ndryshme të infrastrukturave mund të krijojë shqetësim direkt tek kafshët që kryejnë aktivitetin e tyre jetësor në mbrëmje dhe natën, pozicioni që kanë aktivitetet në ujë ose në tokën pranë vijave ujore.

Sfidat kryesore të SKZHI II për mbrojtjen e mjedisit janë krijimi i rrjetit ekologjik Natura 2000 për Shqipërinë dhe Komunitetin Evropian, forcimin e strukturave që merren me menaxhimin e zonave të mbrojtura, zbatimi i planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe i planeve të veprimit për llojet e veçanta.

- *Ndikimi i përgjithshëm i Planit në peizazh*

Peizazhi në Bashkin Lushnje më tepër do të ndikohet nga zbatimi i projekteve që kanë shtrirje në hapësirë. Ndikimi i këtyre projekteve evidentohet lehtësisht për shkak të shtrirjes në një zonë të hapur. Ndikimet në peizazh përcaktohen nga ndryshimi i veçorive pamore të zonës dhe i elementëve karakteristik të hapësirës ku shtrihet hapësira e peizazhit të prekur. Ndikimi konsiderohet i lartë në zona me peizazh të jashtëzakonshëm, zona të mbrojtura ose në zona me tipare simbolike.

Impaktet mbi veçoritë peizazhistike të zonave mund të përkufizohen si direkte, kumulative, indirekte dhe të dobëta. Ndërhyrjet që parashikohen të bëhen në PPV-në e Bashkisë Kuçovë synojnë që të realizojnë përmirësimin e peizazhit, krahas fragmentarizimit të peizazhit dhe ndryshimit përfundimtar të përdorimit të tokës. Projekte të tilla janë ndërhyrjet që do të bëhen për ndërtimin e rrugëve peizazhistike, hatimi i paketave turistike, krijimi i intenerareve të gjelbra si dhe reahabilitimi i pyjeve të dëmtuara dhe gjelbërimi dekorativ në zonat urbane.

- *Ndikimi i përgjithshëm i Planit në klimë*

Projektet e propozuara në PPV-në e Bashkisë Lushnje do të kenë ndikime të kthyeshme pavarsisht se do të ndikojnë në emetimin e gazeve të efektit serë dhe rritjen e sasisë së grimcave në gjendje pezull në ajër duke shkaktuar kështu krijimin e një mikroklime në zonën ku do të aplikohen. Zbatimi i projekteve me ndikime të kthyeshme por shkaktarë të krijimit të mikroklimës, kanë të bëjnë më përmirësimin infrastrukturor.

Shkaktar kryesor mbi ndryshimin e klimës renditet transporti, si pasojë e cilësisë së ulët të karburantit që përdoret. Karburantet çlirojnë gaze të efektit serë kur digjen ndaj dhe transporti klasifikohet si një ndër sektorët problematikë. Transporti ngelet sektori

kyç në arritjen e objektivave kombëtare mbi masat për ndryshimet klimatike duke u ndjekur nga bujqësia dhe përdorimi i tokës.

Objektivi kryesor i vendimit 406/2009/EC për vendet anëtare te EU është reduktimi i shkarkimeve të gazeve të efektit serë për periudhën nga 2013 në 2020. Republika e Shqiperisë ka planifikuar që deri në vitin 2018 të përshtasë dhe të zbatojë objektivat e këtij vendimi. Me qëllim përmbushjen e objektivave të këtij vendimi parashikohet që me zbatimin e SKZH II të arrihet reduktimi me 8% te sasisë së GHG së emetuar dhe me 40% të sasisë së HCFC-ve.

Transporti, bujqësia dhe sektori i prodhimit të energjisë mbeten sektorët kryesorë të ekonomisë që ndikojnë ndjeshëm në prodhimin e gazeve te efektit serë dhe HCFC-ve. Për eleminimin e këtyre ndikimeve duhet të merren masa specifike për të eleminuar shkarkimet në ajër. Arritja e këtyre objektivave realizohet duke stimuluar zhvillimin dhe përmirësimin e e transportit publik, duke informuar bujqërit rreth metodave të reja bujqësore të punimit të tokës dhe stimulimin e përdorimit të energjive të rinovueshme për prodhim energjie.

5.3 Përmbledhje e vlerësimit të propozimeve të PPV-së

Projektet e propozuara në Planin e Bashkisë Lushnje janë hartuar duke patur parasysh njëkohësisht gjendjen e mjedisit në territorin e Bashkisë dhe problematikat e ndryshme që kanë të bëjnë me shërbimet që Bashkia i ofron qytetarëve të saj. Projektet synojnë arritjen e katër objektivave specifike të Planit që janë:

5. Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor
6. Zhvillimi i eko-turizmit
7. Zhvillimi i planifikuar i territorit
8. Mbrojtja e burimeve natyrore

Zbatimi i projekteve së bashku me projektet që parashikohen në Planet e Detajuara Vendore pritet të ketë ndikim konkret në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe gjendjes së mjedisit. Ndërkohë, ndikimi i tyre gjatë fazës së zbatimit mund të shkaktojë përkeqësimin e përkohshëm të gjendjes mjedisore të Bashkisë Lushnje.

Duke qenë se projektet mbulojnë fusha të ndryshme, ata janë të ndryshëm për nga lloji dhe ndikimi që ata kanë në mjedis. Me qëllimin përcaktimin e ndikimeve të mundshme të projekteve në mjedis gjatë fazës së zbatimit dhe në një periudhë kohore afatgjatë, si dhe përcaktimin e natyrës së ndikimeve dhe masave zbutëse, u bë vlerësimi i ndikimit në mjedis të projekteve të Planit të Bashkisë Lushnje. Vlerësimi i ndikimit në vetvete është kryer në nivel projekti, objektivi specifik dhe Plani.

Në bazë të analizës së ndikimit, rezultoi se projektet do të kenë kryesisht ndikim të ulët në mjedis, me disa përjashtime për projekte specifike. Konkretisht, në nivel objektivi të planit, rezultatet paraqiten si më poshtë:

e. Projektet e *O.1: Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor:* nga 17 projektet e këtij objektivi, projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë ndikim të ulët në objektivat mjedisorë ajër, ujë, pyje dhe klimë. Ndikimi është mesatar në tokë, biodiversitet dhe peizazh, ndërsa ndikimi është i papërfillshëm në klimë, kulturë, shëndet dhe socio-ekonomi.

f. *Projektet e O.2: Zhvillimi i eko-turizmit:* nga 5 projekte të përfshira në këtë objektiv, rezulton se projektet do të kenë ndikim ulët në përbërësit e mjedisit si

ajër, ujë, tokë, pyje dhe peizazh, ndërsa në biodiversitet ndikimi është mesatar. Projektet do të kenë ndikim pothuajse të papërfillshëm në klimë, shëndet dhe socio-ekonomi.

g. *Projektet e O.3: Zhvillimi i planifikuar e kontrolli i territorit:* nga analiza rezulton se të 10 projektet e përfshira në këtë objektiv të Planit do të kenë ndikim të ulët në ajër, ujë dhe tokë, ndërsa në biodiversitet, pyje dhe peizazh ndikimi do të jetë mesatar. Në përbërësit e klimës, kulturës, shëndetit dhe socio-ekonomisë, ndikimi ka rezultuar pothuajse i papërfillshëm.

h. *Projektet e O.4: Mbrojtja e burimeve natyrore:* nga një total prej 12 projektesh, rezulton se ndikimi i projekteve është i ulët në ajër, ujë tokë dhe në pyjë, ndërsa në biodiversitet dhe socio-ekonomi ndikimi do të jetë mesatar. Përjashtim bëjnë përbërësit e klimës, kulturës dhe shëndetit.

Vlerësimi numerik (sasior) i ndikimit në mjedis është bërë duke patur parasysh se gjatë zbatimit të projekteve do të merren masat teknike për zbutjen e ndikimit, pra në skenarin kur realizohen ndërhyrje mjedisore përmirësuese.

Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit të ndikimit, është vlerësuar edhe përputhshmëria ndërmjet objektivave, programeve e projekteve të Planit të Bashkisë Lushnje me objektivat e VSM-së. Duke qenë se projektet formojnë programe dhe programet formojnë objektiva, vlerësimi është kryer fillimisht në nivel projekti dhe ka përfunduar në nivel objektivash. Për vlerësimin e përputhshmërisë janë paraqitur 5 nivele të cilat janë:

6. Objektivat/ programet/ projektet përputhen plotësisht me OM-të: Ky rast merr vlerësim maksimal të barabartë me 3. Ka raste që projekte të caktuara mund të mos kenë përputhje të plotë, por marrja e masave mjedisore i bën të përputhshëm.
7. Objektivat/ programet/ projektet përputhen pjesërisht me OM-të: Përputhja është e pjesshme edhe pse zbatohen masa mjedisore, pra realizohet me kushte.
8. Lidhja/ përputhshmëria është e zbehtë: Përputhshmëria është e dobët, edhe pse realizohen masat mjedisore. Kjo nënkupton që ndikimi neutralizohet pjesërisht, ose minimalisht.
9. Nuk ka lidhje (përputhshmëria neutrale): Objektivat, programet, projektet nuk tregojnë përputhje në pamje të parë, por as përplasje. Pra nuk nuk kanë ndikim negativ të ndërsjellë e veçanërisht ato të planit në objektivat e VSM-së.
10. Objektivat/ programet/ projektet nuk përputhen me OM-të: janë në kundërshtim të plotë, pavarësisht masave zbutëse që mund të merren.

Rezultatet e analizës së përputhshmërisë në nivel Plani të Bashkisë Lushnje janë paraqitur më poshtë:

Tabela 80. Përputhshmëria përfundimtare e Planit me Objektivat Mjedisorë.

Bashkia LUSHNJE: Përputhshmëria										
Objektivat Mjedisore	OM1 Ajri	OM2 Uji	OM3 Toka	OM4 Biodiversiteti	OM5 Pyjet	OM6 Peizazhi	OM7 Klima	OM8 Kultura	OM9 Cilësia e jetës	Vlerësimi mesatar
Përputhshmëria Totale e Projekteve	2,09	2,06	1,94	1,59	2,27	2,40	2,63	2,96	3,00	2,33

Përgatitit: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Bashkia Lushnje, nga procesi i vlerësimit të Përputhshmërisë, ka rezultuar se Plani ka përputhshmëri të pjesshme me objektivat mjedisorë. Ky tregues mund të interpretohet në mënyrë të përmbledhur duke theksuar se ndikimet në mjedis nga zbatimi i programeve dhe projekteve të PPV-së do të jenë konkrete dhe të matshme. Këto ndikime janë referuar në seksionin e mësipërm (5.2.1) dhe në bazë të tyre janë hartuar masa shoqëruese (referuar në seksionin 6) të cilat nëse respektohen nga zbatuesit dhe monitorohen me përpikmëri nga institucionet përgjegjëse (të referuara në seksionin 5.1), mund të zbutin ndikimin në mjedis në nivele më të ulta edhe pse nuk mund ta eleminojnë fenomenin plotësisht.

Duke iu referuar tabelës përmbledhëse të Përputhshmërisë në nivel PPV-je, është vlerësuar se Objektivi Mjedisor i Biodiversitetit është në kufinjtë e kategorizimit me përputhshmëri të zbehtë. Për këtë arsye, edhe masat e referuara për këtë element nevojitet që të trajtohen me rreptësi.

Plani është vlerësuar të ketë përputhshmëri mesatare për OM-të ajër, ujë ,tokë, pyje dhe peizazh, ku ndikimet në tokë janë vlerësuar të jenë konkrete dhe për këtë arsye nevojitet që të hartohen masa specifike për zbutjen e ndikimit dhe të rrespektohen gjatë fazës së zbatimit të projekteve. Problematikat me këto dy objektiva janë shumë të prekshme ende pa filluar zbatimi i planit ndaj edhe projektet e reflektuara synojnë rehabilitimin e zonave të dëmtuara si dhe shtrëngimin e rregullave për moscënimin e mëtejshëm të territoreve natyrore dhë përmirësimin e gjendjes së tyre.

Klima, kultura dhe cilësia e jetës janë tre përbërës mbi të cilët është punuar veçanërisht për të krijuar një harmoni natyrore dhe përmirësim të vlerave qoftë natyrore, të shëndetit publik dhe trashegimisë kulturore e historike duke identifikuar vlerat thebësore dhe identitetin e kësaj Bashkie.

Në tabelën e mëposhtme reflektohen Projektet e Planit të PPV-së të shpërndara në % në bazë të niveleve të përputhshmërisë që ato kanë ndaj Objektivave Mjedisorë.

Tabela 81. Përputhshmëria përfundimtare e Planit me Objektivat Mjedisorë.

Bashkia LUSHNJE: Përputhshmëria					
Objektivat Mjedisore / Objektivat e Programet e Planit	% e OM me PL/Projekt	% e OM me PP/projekt	% e OM me PZ/projekt	% e OM me PN/projekt	% e OM me PG/projekt
Perputhshmeria Totale e Projekteve	45,7%	42,5%	11,2%	0,0%	0,6%

Përgatitit: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Përgjithësisht, shumica e përputhshmërive në nivel mesatar dhe të ulët lidhet më tepër me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka veçori të theksuara nga ana natyrore, kulturore dhe peizazhi që mund të ndikohen ndjeshëm nga zhvillimet e infrastrukturës, veçanërisht nga projektet me shtrirje të gjere sipërfaqësore dhe sektorë të ndryshëm si energji, ujë, etj.

Nga rezultatet e mësipërme rezulton se:

6. Në total, nga 44 projekte të PPV-së, 45.7% e tyre kanë përputhshmëri të lartë me objektivat mjedisorë. Pra, ndikimi që këto projekte do të kenë në mjedis do të jetë i papërfillshëm dhe në disa raste ato janë hartuar si një domosdoshmëri e rehabilitimit të gjendjes mjedisore për Bashkinë Lushnje.
7. Rreth 42.5% e fondit të projekteve kan përputhshmëri mesatare, çka nënkupton se ndikimi i tyre do të jetë i ulët dhe mund të zbutet ndjeshëm me marrjen e masave të parashikuara në legjislacionin shqiptar (masat përcaktohen gjatë hartimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis) gjatë fazës së zbatimit. Monitorimi i këtyre masave është element kyç në ruajtjen e nivelit të përputhshmërisë edhe gjatë fazës së operimit të këtyre projekteve.
8. Vetëm 11.2% e projekte nga 44 që janë propozuar në Planin e Bashkisë Lushnje kanë përputhshmëri të zbehtë. Në këtë rast qoftë respektimi qoftë monitorimi i përpiktë i masave shtrënguese mjedisore nuk do të sillte neutralizim të plotë të ndikimeve, por thjeshtë do të kufizohej me zbutjen e ndikimit të projekteve tek objektivat mjedisorë.
9. Projektet e vlerësuara me përputhshmëri neutrale kanë të bëjnë kryesisht me hartime planesh, studime, investime dhe ngritje kapacitetesh njerëzore. Pra projekte dhe ndërhyrje të cilat mbartin një ndikim mjedisor me peshë fare të vogël krahasuar me ndërhyrjet fizike. Ndaj edhe vlerësimi i tyre është faktorizuar si neutral. Në PPV-në e Bashkisë Lushnje nuk ka asnjë plan me ndikim neutral.
10. Nuk ka asnjë projekt, nga i gjithë fondi me pëputhshmëri negative me Objektivat Mjedisorë. Megjithatë, Plani përfshin edhe projekte që parashikojnë ndërhyrje të fuqishme fizike në territor. Si rrjedhojë, ndikimi i tyre në përbërës specifikë të mjedisit si ajër, ujë, zhurma, etj. parashikohet të jetë mjaft shqetësues dhe në disa raste me ndikim shkatërrues.

Ndikimet që rrjedhin nga ky Plan i Përgjithshëm Vendor janë vlerësuar kryesisht të kenë intensitet të ulët dhe në disa raste rehabilitues e të domosdoshëm për të sistemuar dhe përmirësuar cilësinë e jetës dhe të mjedisit në Bashkinë Lushnje. Ndikimet pozitive afatgjatë identifikohen kryesisht në përmirësimin e cilësisës së jetës dhe

nivelit kulturor të shoqërisë. Kjo si rezultat i përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike të parashikuara në këtë PPV. Ndikimi që paraqitet në fushën e ndryshimeve klimatike do të jetë relativisht i ulët ku si kontribues kryesor do vazhdojë të mbetet industria dhe sektori i bujqësisë.

Ndikimet pozitive në popullatë dhe pasuri materiale do të vijnë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës rrugore dhe të shërbimeve në përgjithësi, gjë që do të çojë në përmirësimin e lëvizjes së banorëve brenda dhe jashtë Bashkisë duke shkurtuar kohën e udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

6. Masat për mbrojtjen e mjedisit

6.1 Masa për parandalimin/zbutjen e ndikimeve mjedisore të propozimeve të PPV-së

Në Kapitullin 5 është vlerësuar ndikimi i projekteve të PPV-së gjatë fazës së zbatimit dhe afatgjatë. Siç është shtjelluar në këtë kapitull, në bazë të analizës së ndikimit, ka rezultuar se projektet do të kenë kryesisht ndikim të ulët në mjedis, me disa përjashtime për projekte specifike. Ndikimi, edhe pse në shkallë të ndryshme, do të jetë kryesisht në tokë, burime ujore, pyje, ajër, biodiversitet, etj. Ndikimi parashikohet të jetë specifik për çdo projekt më vete.

Marrja e masave për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të një projekti dhe në rastin tonë të projekteve të PPV-së së bashkisë është kompetencë e një numri të caktuar institutesh publike dhe e zhvilluesit të projektit. Institutet publike sigurohen që për çdo projekt, zhvilluesit e projekteve parashikojnë dëmtimet e mundshme të mjedisit gjatë fazës së zbatimit dhe, përpara fillimit të zbatimiti të projektit, marrin masat teknike të nevojshme për parandalimin dhe zbutjen e tyre. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet zbatimit të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i cili përcakton kushtet e zbatimit të një projekti në rrespekt me mjedisin.

Sipas Ligjit nr. 10440, projektet, përpara zbatimit do t'i nënshtrohen "procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis" ose "procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis" sipas Ligjit nr. 10440, datë 7.7. 2011. Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre. Sipas nenit 4 të të njëjtit ligji, vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit. *Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin vlerësimin e ndikimit të projektit gjatë fazës së zbatimit dhe gjithashtu dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin* e zonës në gjendjen e mëparshme, funksionimin normal edhe mundësinë për aksidente. Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, edhe propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Autoriteti vendimmarrës për hartimin e VSM-së është Agjencia Kombëtare e Mjedisit e cila vendos nëse një projekt i nënshtrohet VNM-së paraprake apo duhet t'i nënshtrohet edhe procedurës së thelluar të VNM-së. Hartimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM-së) të një projekti mbetet detyrë e zhvilluesit të projektit (neni 11 i Ligjit nr. 10440). Hartimi i VSM-së është proces që përfshin institucionet shtetërore (Ministrinë e Mjedisit dhe AKM-në), zhvilluesin e projektit, pushtetin lokal ku zhvillohet projekti dhe palët e tjera të interesuara si publiku dhe organizatat jofitimprurëse, etj. Zhvilluesi, për projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të VNM-së, informon dhe konsultohet me publikun e interesuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis të veprimtarisë së tij (Neni 14 i Ligjit nr. 10440).

Një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të një projekti luan edhe autoriteti i planifikimit ose autoritete të tjera përgjegjëse për liçencimin e veprimtarive (zbatimin e projekteve). Ligji nr. 10440 i kërkon autoriteteve në fjalë që, përpara

vendimit për dhënien e lejes së zhvillimit apo liçencës përkatëse për një projekt të propozuar, të sigurohet që projekti t'i jetë nënshtruar kërkesave të këtij ligji dhe, në varësi të projektit, të jetë pajisur me vendim apo deklaratë. Vendimi apo deklarata për projektin e propozuar është i vlefshëm për aq kohë sa është e vlefshme dhe leja e zhvillimit/licenca përkatëse për projektin (Neni 20 i Ligjit nr. 10440).

Mbas marrjes së lejes për zbatimin e projektit, zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë (Neni 20 i Ligjit nr. 10440).

Një vëmendje të veçantë si objekt mbrojtjeje i kushtohet zonave të mbrojtura ose zonave veçanarisht të mbrojtura (neni 21 i Ligjit nr. 10440). Në këtë rast, dispozitat e ligjit nr. 10440 zbatohen edhe në rastet kur veprimtaria e propozuar nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë apo nuk është e nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që, veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera, mund të shkaktojë efekte të rëndësishme mbi atë zonë.

Kur AKM-ja apo ministria, në përfundim të procedurës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti, shprehet se veprimtaria e propozuar, veçmas apo në bashkëveprim me veprimtari ose plane dhe projekte të tjera, të realizuara apo të propozuara, mund të ketë ndikim negativ të rëndësishëm mbi integritetin e një zone veçanërisht të mbrojtur, atëherë autoriteti përgjegjës që mbulon fushën e projektit, nuk lejon zhvillimin e tij. Bëjnë përjashtim vetëm rastet kur i) nuk ka zgjidhje tjetër alternative; ii) veprimtaria e propozuar duhet të zbatohet për arsye urgjente të interesave madhorë të publikut, përfshirë edhe ata me natyrë shoqërore apo ekonomike (arsye urgjente të interesave madhorë të publikut që merren në konsideratë, kur zona veçanërisht e mbrojtur përmban lloje habitatesh natyrore prioritare dhe/ose specie prioritare, janë vetëm ato që kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut apo sigurinë e publikut, ose që sjellin ndikime të rëndësishme pozitive për mjedisin); iii) duhen marrë të gjitha masat kompensuese për të siguruar zbatimin e kërkesave të "Natyra 2000".

Si përfundim, mund të thuhet se masat për mbrojtjen e mjedisit gjatë fazës së zbatimit të projekteve të PPV-së përcaktohen në VNM-të përkatëse të çdo projekti. Rolin kryesor të mbrojtjes së mjedisit në këtë rast e luajnë Ministria e Mjedisit me institucionet vartëse që miratojnë VNM-të e projekteve, autoriteti i planifikimit ose autoritete të tjera përgjegjëse për licencimin e veprimtarive të cilat kërkojnë që projekti të jetë pajisur me vendim apo deklaratë mjedisore, zhvilluesit e projekteve të cilët përcaktojnë masat që merren gjatë fazës së zbatimit dhe autoritetet inspektuese gjatë fazës së zbatimit. Një rol tejet të veçantë dhe të rëndësishëm pritet që të luhet nga publiku në fazën e hartimit të VSM-ve dhe për ndërgjegjësimin e qeverisë lokale (bashkisë) për rëndësinë e respektimit të ligjit nr. 10440 gjatë fazës së zbatimit të projekteve të PPV-së dhe në të ardhmen.

6.2 Masa për mbrojtjen e burimeve ujore në Bashkinë Lushnje

6.2.1 Masa për mbrojtjen e burimeve ujore sipërfaqësore

Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore është detyrim ligjor për Bashkinë i cili rrjedh nga Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë për të ruajtur mjedisin dhe ofruar një mjedis cilësor për qytetarët në territorin e saj, Ligji nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" si dhe ligje të tjera që synojnë mbrojtjen e mjedisit apo përbërësve specifikë të tij.

Lushnja ka një rrjet të pasur hidrik me lumenj, rezervuarë të cilëve u shtohet edhe një rrjet i gjerë kanalesh vaditëse/kulluese. Territori i bashkisë së re përshkohet nga Lumi Seman në jug, preket nga pellgu ujëmbledhës i lumit Shkumbin në veri dhe ka një numër të konsiderueshëm rezervuarësh si ai i Kasharajt dhe Liqeni i Lushnjes.

Nga analiza e thelluar e territorit ka rezultuar se trupat ujorë kanë problematika të ndryshme si shkarkimi në to i ujërave të ndotura urbane e industriale dhe hedhja e mbetjeve të ngurta urbane dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjëve, ndërsa për kanalet ujitëse dhe kulluese, problem mbetet pastrimi i tyre dhe ndotja nga shpëlarja e tokës bujqësore, që përdorin kimikate të ndryshme për zhvillimin e bujqësisë.

Me qëllim mbrojtjen e burimeve ujore sipërfaqësore, në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi, Bashkia Lushnje ka hartuar disa projekte specifike, të cilat përqendrohen në *përmirësimin e hidro-morfoligjisë të lumenjve të Semanit dhe Shkumbinit, mbrojten e burimeve ujore nga ndotja e shkaktuar nga keqmenaxhimi i mbetjeve* në të shkuarën si dhe *uljen e ndotjes nga industria e rëndë*. Projektet janë kryesisht me fokus i) rehabilitimin mjedisor dhe kthimin në zona për argëtim të zonave ripariane të Lumit Seman, ii) hartimin e Planit Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve sipas ligjit Nr. 10463, datë 229.2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve" Neni 12. Në plan përfshihen propozime për ndërtimin e stacionit të transferimit të mbetjeve (Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 23), ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të ndotura, rehabilitimin e fushës së mbetjeve dhe kthimi i saj në zonë të gjelbër dhe krijimin e sistemit për administrimin e ujërave të ndotura urbane dhe ujërat e shiut duke e shtrirë këtë sistem në të gjithë territorin e Bashkisë. Megjithatë, krahas masave të propozuara në PPV, për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në territorin e Bashkisë rekomandohet edhe marrja e masave që janë:

Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter të inerteve lumore në Shkumbin dhe Seman: Lumenjtë e Basenit të Semanit dhe Shkumbinit janë shfrytëzuar për inerte në rrjedhën e mesme dhe të poshtme. Me qëllim mbrojtjen e lumit, ruajtjen e cilësisë së ujërave të tyre dhe mbrojtjen e cilësisë së ujërave nëntokësore, rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me Këshillin e Basenit Ujor të Semanit dhe atë të Shkumbinit:

- Të ndalojë urgjentisht shfrytëzimin e inerteve lumore përgjatë gjithë rrjedhjes së Lumenjve Seman dhe Shkumbin brenda territorit të saj (në bashkëpunim me ABU Seman, ARM Fier dhe Ministrinë e Mjedisit). Bazuar në VKM Nr.1, datë 21.6.2006 "Për Reduktimin e shfrytëzimit të zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve", Bashkisë Lushnje i rekomandohet që *për shfrytëzimn e zhavorreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve të japë leje vetëm në rastet kur ka depozitime të mjaftueshme dhe vetëm në segmente të caktuara*. Pra, marrja e inerteve, në rastet kur është e pashmangshme për arsye ekonomike, *të shoqërohet me studime specifike të posaçme për çdo rast* me qëllim shmangien e dëmtimit të trupit lumor. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) ka kryer studime të hollësishme rreth shfrytëzimit të inerteve të lumenjve dhe ndikimit të tyre në mjedis. Për këtë arsye, rekomandohet *bashkëpunimi me SHGJSH për shqyrtimin e çdo lejeje,*
- Të bashkëpunojë me Bashkinë Elbasan me qëllim largimin e menjëhershëm të impianteve të prodhimit të inerteve nga brigjet ose shtrati i Shkumbinit në segmentin e lumit që shërben si dritare hidrogjeologjike (Krastë-Vidhas),

- Të rehabilitojë shtratin e lumit në zonat e dëmtuara përgjatë lumit të Semanit dhe Shkumbinit, me qëllim mbrojtjen e tokës bujqësore dhe veprave inxhinierike (ura, rrugë, etj.) (Ndërtimin e pritave anësore e tërthore me qëllim shmangien e erozionit të brigjeve, mbrojtjen e urave, pastrimin e brigjeve të lumit të mbushura me inerte, krijimin e pyjeve artificiale në terracën e shtratit apo në terracën e parë me qëllim shmangien ose uljen e veprimtarisë gërryese të rrjedhës).[318]

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane: Me riformimin e bashkisë së rë të Lushnjes, lind nevoja për të rishikuar Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane. Njëkohësisht, gjatë rishikimit të planit duhen marrë masa të menjëhershme si:

- Rehabilitimi i venddepozitimit të mbetjeve aktuale, i cili nuk është sanitar dhe shllami shkarkohet në trupat ujorë sipërfaqësorë dhe më tej depërton në ujërat nëntokësore.
- Pastrimi i venddepozitimeve të paligjshme të mbetjeve të ngurta urbane përgjatë shtretërve të lumenjëve, përrenjëve dhe ushtrimi i një kontrolli të vazhdueshëm për parandalimin e depozitimit të tyre në vazhdim.

Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme*:* Bashkia Lushnje nuk ka një plan për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme. Si rrjedhojë, menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme shtepiake, që është kompetencë e bashkisë, mbetet ende një sfidë. Me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen e lumenjve nga ndotja e shkaktuar nga mbetjet e rrezikshme në Bashkinë Lushnje, rekomandohet hartimi i një plani bashkiak për menaxhimin e tyre. Më konkretisht, rekomandohet që:

- Për mbetjet e rrezikshme industriale (të krijuara nga operatorët e pajisur me leje mjedisi A dhe B): të bashkëpunojë me institucionet e linjës për menaxhimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve të rrezikshme, të cilat ndodhen apo krijohen brenda territorit të bashkisë.
- Për mbetjet e rrezikshme shtëpiake dhe ato të krijuara nga opëratorët e pajisur me leje mjedisi të tipit C: të hartojë një Plan Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve të Rrezikshme Shtëpiake ku të përcaktojë mënyrat e mundshme të trajtimit të tyre dhe një venddepozitim përfundimtar.
- Mbetje të rrezikshme spitalore: të hartojë një plan për përcaktimin dhe miratimin e venddepozitimit të mbetjeve spitalore jo të rrezikshme dhe të monitorojë administrimin e mbetjeve sipas kompetencave të saj.
- Riciklimi i mbetjeve: të hartojë një plan për riciklimin e rrymave të ndryshme të mbetjeve të riciklueshme: Planet dhe projektet që do të hartohen / zhvillohen në funksion të menaxhimit të mbetjeve industriale, nevojitet që të marrin në konsideratë edhe mundësinë e zvogëlimit të sasisë së krijuar të mbetjeve që në burim dhe uljen e mundësisë së ndotjes së mjedisit nga industria.

Kontrolli i shkarkimeve industriale në ujë: Në këtë kontekst rekomandohet që Bashkia:

- të hartojë plane për kontrrollin e zbatueshmërisë së Lejeve të Mjedisit (në bashkëpunim me ARM Fier, AKM) për subjekete që shkarkojnë mbetje të cilat dëmtojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (Subjektet e përpunimit të qumështit kryesisht në Nja-të Lushnje dhe Kolonjë, riciklim i

plastikës, vajrave të përdorur, etj.). Zbatimi i këtyre masave rrjedh si detyrim ligjor për Bashkinë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligje të tjera për mbrojtjen e mjedisit dhe specifikisht për mbrojtjen dhe menaxhimin e ujërave.

Hartimi i një Plan Veprimi për Praktikat e Mira Bujqësore: Problem për burimet ujore mbetet edhe ndotja e burimeve ujore nga kimikatet dhe pesticidet që përdoren në bujqësi. Rekomandohet që bashkia të hartojë një Plan Veprimi për Praktikat bujqësore që duhet të ndiqen në mënyrë që të minimizohen përdorimet e këtyre kimikateve.

Hartimi dhe zbatimi i një plani vendor dhe një plani ndërbashkiak për menaxhimin e lumit Seman dhe Shkumbin

Semani dhe Shkumbini janë lumenjë që përshkojnë territorin e bashkive të ndryshme. Si rrjedhojë, mbrojtja e tyre kërkon bashkërendimin e përpjekjeve të të gjitha bashkive përkatëse dhe me Agjencitë e Basenit Ujor (ABU) të Semanit e Shkumbinit. Bashkëpunimi mund të kryhet nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve e planeve ndërbashkiake ose për hartimin e Planit të Menaxhimit të Basenit të Semanit dhe Shkumbinit. Ky plan duhet të përcaktojë angazhimet përkatëse për çdo bashki në fushat e mëposhtme:

- përdorimin e qëndrueshëm të ujërave të lumenjëve Seman dhe Shkumbin nga të gjitha bashkitë (bashkëpunim në dhënien e lejeve për shfrytëzimin e ujit për qëllime të ndryshme si për pije, bujqësi, industri, etj.) pa penalizuar bashkitë në rrjedhën e mesme e të poshtme të lumit,
- koordinim për ruajtjen e mirëmbajtjen e lumenjëve (pastrimin e shtratit të lumenjve, krijimin e fashës së gjelbërt, ndalimin e shfrytëzimit të inerteve në lumë)
- parandalimin e ndotjes së lumenjve në këto bashki (ndalimin e hedhjes së mbetjeve në lumë/burime ujore sipërfaqësore) në mënyrë që bashkitë në rrjedhën e poshtme të mos marrin të gjitha ujërat e ndotura të bashkive në rrjedhën e sipërme dhe të mesme,
- përcaktimin e pasojave që ndërtimi i HEC-eve në degët e Shkumbinit dhe Semanit mund të ketë në cilësinë e ujit të lumenjve, në prurje, biodiversitet dhe deri në plazhe.
- pyllëzimin e pellgut ujëmbledhës të lumit Seman dhe Shkumbin e degëve të tjera të tyre, me qëllim shmangien e përmbytjeve dhe erozionit,

Ndërgjegjësimi i qytetarëve rreth mbrojtjes së mjedisit ujor: rekomandohet që Bashkia të hartojë një program për ndërgjegjësimin e popullsisë për rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore ku theksi të vihet tek mospërdorimi i lumenjve si vende për depozitimin e mbetjeve, etj.

Shtimi i numrit të stacioneve të monitorimit të lumenjve, i shpeshtësisë së monitorimit dhe i parametrave të monitoruar në varësi të aktiviteteve ekonomike (industriale, bujqësore, etj.) të pranishme në territor. Semani dhe Shkumbini përshkojnë territore të gjera me aktivitete të ndryshme bujqësore dhe industriale. Për fat të keq, këta lumenj monitorohen nga një numër i kufizuar stacionesh monitorimi. Duke parë rëndësinë që kanë për bujqësinë dhe si burim ushqyes për Akuiferët (në rastin konkret Akuiferi i Lushnjes), rekomandohet:

- Monitorimi mujor ose mundësisht ditor i cilësisë së ujërave të lumit Seman dhe Shkumbin dhe degëve kryesore te tij nga ARM Fier gjatë gjithë vitit. Monitorimi i lumenjve deri më tani kryhet nga AKM. Është e udhës që monitorime të kryhen edhe nga ARM Fier. Duke qenë e pranishme në territor, ARM Fier arrin të monitorojë ujërat e lumenjve në brendësi të territorit (Lumi Seman dhe Shkumbin) në kohën e duhur dhe në rastet kur ka derdhje të rastësishme abuzive të lëndëve të ndryshm në lumë. ARM Fier duhet të paktën të ketë përgjegjësinë e monitorimit të herëpashershëm të lumit sipas një Plani Monitorimi Vendor si dhe të pajiset me laborator teknik të akredituar për kryerjen e analizave të ujit.
- Shtimin e stacioneve të reja të monitorimit të lumenjve në zonat më problematike (në afërsi të zonave më të banuara, në zonën me aktivitet. Për këtë nevojitet bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencinë Rajonale Fier
- Shtimin e parametrave të monitoruara dhe përshtatjen e parametrave që duhen monitoruar për ndotjen e lumenjve në varësi të aktivitetit industrial të pranishëm në territor. Sot, përveç përcaktimit të ndotjes, është e rëndësishme që të përcaktohet edhe burimi i ndotjes. Vetëm në këtë mënyrë mundësohet zbatimi i parimit "ndotësi paguan".

Tabela 82. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e cilësisë së ujit

Qëllimi	**Masa**	**Projekti**
Përmirësime në hidro-morfoligjinë e lumit	Krijimi i zonave ripariane	- Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman, - Rehabilitimi i Përroit të Lushnjes, - Sistemimi i stacionit të pompave ujitëse në Bitaj dhe Ardenicë - Pastrimi i kanaleve të para dhe të dyta nga mbetjet dhe aluvionet e grumbulluara në 11 njësitë administrative, - Ndërtimi i sistemit të ujitjes në LiNjat e Krutjes dhe Tërbufit, - Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në tokat e kripura pranë By-Passit të Lushnjes, - Rehabilitimi i fushës së mbetjeve dhe kthimi i saj në zonë të gjelbër, - Ndërtimi i pompave të ujit për përmirësimin e sistemit të ujësjellësit, - Ndërtimi i Impiantit të Kompostimit të mbetjeve në fshatin Murriz-Peqin, - Ndërtimi i stacionit të transferimit të mbetjeve në tokat e kripura në Plug,
	Mbrojtja e brigjeve të lumenjve nëpërmjet ndërtimit të infrastrukturave të ndryshme	
Mbrojten e burimeve ujore nga ndotja nga mbetjet e ngurta e të lëngta	Menaxhimi i integruar i mbetjeve të ngurta / lëngëta	
Përdorim i qëndrueshëm i ujërave	Sistemim kanalizimesh dhe sistemit ujësjellës	

Burnimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

6.2.2 Masa për mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore (akuiferët)

Akuiferi më i rëndësishëm për Bashkinë e Lushnjes, që shtrihet pjesërisht në territorin e saj është akuiferi me porozitet ndërkokrrizor i njohur si Akuiferi i Lushnjes. Duke u mbështetur në studimet e kryera nga SHGJSH rreth problematikave të ndryshme të akuiferëve në Qarkun e Fierit, lind nevoja të merren disa masa të rëndësishme për mbrojtjen e tyre. Disa nga këto masa renditen më poshtë.

- Për mbrojtjen e shëndetit të popullsisë:

Zbatimi i zonave higjeno-sanitare përreth pus-shpimeve: Në Bashkinë e re të Lushnjes, qyteti furnizohet me ujë nga 1) zona e puseve Konjat dhe ii) zona e puseve Çermë[319]. Ujërat nëntokësore nxirren nga një thellësi afërsisht 25 metra. Të dy stacionet e pompimit ndodhen në zona bujqësore të ulëta[320] dhe marrin ujë nga Akuiferi Ndërkokrrizor i Lushnjes,[321] Për shkak të shtresës së hollë zhavorrore, kjo zonë është e ndjeshme ndaj ndotjes sipërfaqësore. Si rrjedhojë, mosmbrojtja e akuiferëve supozohet të shkaktojë ndotjen e tyre. Nga studimet e kryera mbi furnizimin me ujë të Lushnjes rekomandohet edhe ruajtja e ndotjes së akuiferëve nga bujqësia dhe burime të ndryshme ndotjeje në zonat e pus-shpimeve[322]. Për këtë arsye, rekomandohet përcaktimi dhe mbrojtja e zonave higjeno-sanitare përreth pus-shpimeve në përputhje me Ligjin 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore". Më konkretisht, në territorin e bashkisë rekomandohet:

- Krijimi i zonave higjeno-sanitare përreth pus-shpimeve në zbatim të Ligjit 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" dhe VKM nr.145, datë 26.2.1998 " Për miratimin e rregullores higjeniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm".
- Krijimi i një regjistri ku të regjistrohen pus-shpimet e ligjshme e të paligjshme në territor, vendodhja e tyre, niveli i rrezikshmërisë që paraqet çdo pus-shpim për ndotjen e ujërave nëntokësore me qëllim ushrimin e kontrollit të tyre të herë pas hershëm.
- Përcaktimi i ndikimit të çdo pus-shpimi në Akuiferin e Lushnjes në territorin e Bashkisë (të lartë, të mesëm, të ulët).
    - Zonimi i territorit sipas ndikimit që përdorimi i tokës mund të ketë në akuifer. Kjo nënkupton i) përcaktimin e zonave ku nuk lejohen aktivitete të caktuara ekonomike (si zhvillimi i industrisë së rëndë, shpimet për shfrytëzim të ujit për qëllime industriale, etj.) sepse përbëjnë rrezik ndotje për Akuiferin e Lushnjes dhe ii) përcaktimin e zonave ku lejohen aktivitete industriale sepse nuk përbëjnë rrezik ndotjeje për Akuiferin e Lushnjes.

Zbatimi i zonave higjeno-sanitare përreth pus-shpimeve në *zonat rurale:* Në zonat rurale të Bashkise së re të Lushnjes, nga një total prej 104,253 banorësh, 10,912 prej tyre (rreth 11%) nuk furnizohen me uje të pijshëm[323]. Uji i pijshëm sigurohet kryesisht nga vetë banorët duke përdorur burimin më të afërt të mundshëm ose puset[324]. Njësitë e qeverisjes vendore që nuk furnizohen me ujë të pijshëm janë[325]:

- Komuna Allkaj (fshatrat Lifaj i Ri dhe Çukas i Ri),
- Komuna Hysgjokaj (fshatrat Hysgjokaj (77%) dhe Kurtin (57%),
- Komuna Dushk (fshatrat Thanasaj, dhe pjeserisht Gramsh, Konjat e Zham Sektor),
- Komuna Karbunare (fshatrat Kashtëbardhë, Stankarbunarë dhe Mollas),
- Komuna Ballagat (fshatrat Gjuzaj, Jazexhi dhe Manasufaj),
- Komuna Fier Shegan (fshati Jeta e Re),
- Komuna Kolonje (Ardenicë dhe Bitaj).

Mosfurnizimi me ujë të pijshëm i popullsisë rurale krijon hapësira për ndotjen e ujërave nëntokësore në rastet kur banorët furnizohen me puse dhe këto të fundit ndodhen në akuiferë me porozitet ndërkokrrizor si ai i Lushnjes ose në akuiferë me porozitet çarje-karst si në zonën e Thanës. Për këtë arsye, *është i nevojshëm inventarizimi i pus-shpimeve private që kanë nevojë për zona higjeno sanitare përreth tyre dhe përcaktimi dhe ruajtja e këtyre zonave*.

Krijimi i zonave të mbrojtura me status të veçantë (Dritaret hidrogjeologjike): Ujërat e Lumit Shkumbin në disa segmente të tij ushqejnë Akuiferin e Lushnjes.[326] Të tilla segmente nevojitet që të mbrohen nga ndotja me qëllim mbrojtjen e Akuiferit të Lushnjes nga ndotja. Për këtë arsye, këto segmente të Shkumbinit duhen konsideruar si Zona të Mbrojtura me status të veçantë.[327] Për segmentet e lumit Shkumbin që ushqejnë me ujë Akuiferin e Lushnjes një zonë e tillë është zona nga Zona Labinot-Fushë deri në Vidhas-Papër[328]. Me qëllim mbrojtjen e Akuiferit nga ndotja, nevojitet që Bashkia Lushnje të marrë disa hapa si:

- Të bashkëpunojë ngushtë me Bashkinë e Elbasanit dhe me ABU Shkumbin për përcaktimin dhe mbrojtjen e dritareve hidrologjike duke qenë se zona e ushqimit të Akuiferit të Lushnjes ndodhet në segmentin e lumit Shkumbin brenda territorit të Bashkisë Elbasan,
- Në zonat e quajtura dritare hidrogjeologjike, të ndalohet dhënia e lejeve për pus-shpime/aktivitete ndotëse[329] ose të ndërpritet leja e aktiviteteve aktuale që shkaktojnë ndotje në mjedis. Rekomandohet që të vendosen kushte të rrepta që garantojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore gjatë dhënies së lejeve për aktivitete të ndryshme në këto zona.
- Në zonat me status Dritare Hidrogjeologjike, rekomandohet që toka të përdoret për aktivitetet që nuk shkaktojnë ndotje në mjedis

Ndalimi i shfrytëzimit të inerteve/zhavorreve në lumin Shkumbin: Rreth 7 kompani shfrytëzojnë inertet lumore vetëm në Bashkinë e Elbasanit në dëm të lumenjve dhe Akuiferit të Lushnjes. Duke patur parasysh se një sërë shpimesh ndodhen në tarracat lumore dhe se ujërat sipërfaqësore të Shkumbinit kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ujërat e Akuiferit të Lushnjes, rekomandohet që:

- Bashkia e Lushnjes të bashkëpunojë me Bashkinë e Elbasanit dhe ABU Shkumbin me qëllim ndalimin e shfrytëzimit të zhavorroreve në shtratin e lumit Shkumbin dhe degëve të tij me qëllim ruajtjen e ekuilibrave hidrodinamike e hidrokimikë të ushqimit të akuiferit ujëmbajtës[330],
- Të ndalojë dhënien e lejeve të shfrytëzimit të inerteve lumore në zonat e ndjeshme (zona në afërsi të Rrogozhinës e në Bashkinë Elbasan), me qëllim ruajtjen e ekulibrave hidrodinamikë të akuiferit. Ky rekomandim vjen edhe në zbatim të VKM Nr.1, datë 21.6.2006 "Për Reduktimin e shfrytëzimit të zhavoreve dhe rërave në shtretërit e lumenjve", dhe
- Të ndalojë shfrytëzimit të inerteve dhe ujit të lumit në mënyrë të paligjshme.

Ndalimi i menjëhershëm i shkarkimit të ujërave të ndotura (të të ndotura, të bardha dhe industriale) në Shkumbin: Burim ndotjeje për Akuiferin quaternar të Lushnjes mbetet vetë lumi Shkumbin nga i cili ushqehet. Ky i fundit ndotet nga shumë burime të ndryshme ndër të cilat dhe nga derdhja e ujërave të ndotur të papërpunuara në të. Ujërat e ndotura dhe të bardha të qytetit të Elbasanit derdhen në

lumin Shkumbin nëpërmjet 10 kolektorëve. 7 nga 10 kolektorët e qytetit shkarkojnë ujërat e ndotura drejtpërsëdrejti në lumin Shkumbin ndërsa 3 në Perroin e Zaranikes, i cili me tej i derdh ato në Lumin Shkumbin. Të gjitha ujërat e përdorura shkarkohen në lumë pa asnjë trajtim paraprak. Edhe ujërat e ndotura të zonave rurale të Bashkisë së Elbasnait përfundojnë në Lumin Shkumbin në të gjitha zonat që e lejon relievi[331] në mungesë të sistemit të grumbullimit të ujërave të ndotura në këto zona. Zakonisht, shtëpitë e banimit kanë gropa septike në oborret e shtëpiave të cilat nuk kanë asnjë standard tekniko-sanitar. Në rastet kur është e mundur, ujërat e ndotura largohen nga shtëpitë në kanale të hapura kulluese pranë shtëpive të tyre, në shkelje të ligjit për mbrojtjen e burimeve ujore dhe mjedisit[332]. Deri më sot nuk dihet se cilat nga këto kanale kanë lidhje të drejtpërdrejtë me lumin Shkumbin dhe sa ndikojnë ujërat e ndotura të zonave rurale në ndotjen e ujërave të Akuiferit të Lushnjes.

Pra, duke qenë se ujërat e lumit Shkumbin shërbejnë si burim për Akuiferin Quaternar të Lushnjes, dhe se rreziku i ndotjes së Akuiferit kuaternar të Lushnjes me shtrirje përgjatë lumit Shkumbin është i lartë si pasojë e mungesës pothuajse të plotë të mbulesës ekranizuese të shtresave ujëmbajtëse, sidomos në Krastën e Madhe dhe të Vogël[333], derdhja e ujërave të ndotura në Shkumbin përbën element ndotjeje të Akuiferit të Elbasanit dhe Akuiferit të Lushnjes. Për këtë arsye rekomandohet që Bashkia e Lushnjes:

- <u>të bashkëpunojë me Bashkinë e Elbasanit dhe Bashkitë e tjera me ndikim në Shkumbin për ndalimin e derdhjes së ujërave të të ndotura, të bardha dhe ujërave industriale të papërpunuara në lumë</u> me qëllim shmangien e ndotjes së lumit Shkumbin dhe degëve të tij që shërbejnë si burim ushqimor për Akuiferin e Lushnjes.
- <u>të bashkëpunojë ngushtë me ABU Shkumbin dhe bashkitë e tjera përkatëse për mbrojtjen e lumit Shkumbin nga ndotja</u> e shkaktuar përtej kufinjve të saj.

Shtimi i pikave të monitorimit të ujërave nëntokësore dhe i parametrave të monitoruar në varësi të aktivitetetve ekonomike në zonë: AKM në bashkëpunim me SHGJSH monitoron gjendjen e burimeve ujore nëntokësore rregullisht me bazë vjetore. Megjithatë, vihet re se numri i pikave të monitorimit për përcaktimin e cilësisë së ujërave nëntokësore në çdo basen e akuifer është i ulët, ndërkohë që zonat me ndjeshmëri të lartë ndotjeje janë të larta. Me qëllim monitorimin e hollësishëm të cilësisë së ujërave të akuiferëve nën Bashknë Lushnje, rekomandohet shtimi i pikave të monitorimit të akuiferëve dhe shtimi i parametrave të monitoruar. Në Bashkitë si LushNja rekomandohet monitorimi i parametrave që tregojnë edhe ndotjen nga industria e rëndë.

Monitorimi i menjëhershëm i Akuiferit të Lushnjes për ndotje nga nga zona industriale në Qytetin e Elbasanit: Zona industriale e qytetit të Elbasanit kufizohet me lumin Shkumbin. Për vite të tëra, mbetjet industriale janë grumbulluar në brigjet e lumit Shkumbin duke e ndotur atë dhe si rrjedhojë krijon mundësinë e ndotjes së akuiferëve që ushqehen nga Shkumbini (Akuiferi Kuaternar i Elbasanit dhe Akuiferi i Lushnjes) në një zonë ku ujërat sipërfaqësore kanë lidhje të mira hidraulike me ujërat e akuiferit. Si rrjedhojë, mundësia e ndotjes së Akuiferit të Lushnjes (dhe Elbasanit) nga mbetjet industriale të zonës industriale në Elbasan mbetet e lartë. Duke patur parasysh se ndjeshmëria e ujërave të akuiferit të Lushnjes ndaj ndotjes është e lartë, rekomandohet:

- monitorimi i ujërave të Akuiferit të Lushnjes me qëllim që të përcaktohet nëse ndotja industriale në zonën e Kombinatit Metalurgjik ka ndikuar në prishjen e cilësisë së ujërave të Akuiferit të Lushnjes. Kjo nënkupton monitorimin e parametrave që tregojnë nësë uji i akuiferit është ndotur nga mbetjet e grumbulluara në brigjet e Shkumbinit (metalet e rënda ne veçanti).

Studime/Monitorim i thellë i ujërave të Akuiferit të Lushnjes për të përcaktuar nëse ujërat e tij janë të përshtatshme për pije, sidomos në pus-shpimet Konjat: Sipas studimeve të SHGJSH-së, Akuiferi i Lushnjes ka shenja ndotjeje me nitrite dhe nitrate si dhe rrezikon mineralizimin e ujërave të tij. Duke patur parasysh mundësinë e ndotjes së ujërave nëntokësore nga inputet e ndryshme bujqësore dhe kalimin e kanaleve me ujëra jo të pastra në akërsi të pus-shpimeve të Konjatit, rekomandohet ndërmarrja e studimeve të thella për të përcaktuar nëse uji i Akuiferit të Lushnjes i marrë nga pus-shpimet e stacionit të Konjatit është i një cilësie të pranueshme për pije (brenda standardeve evropiane).

Ndërprerja e dhënies së lejeve për shpime të reja hidrogjeologjike pranë stacionit të Konjatit: Akuiferi i Lushnjes, sidomos zona që përkon me pjesën jugore të akuiferit rrezikon minelalizimin e tij për shkak të mbishfrytëzimit të ujit. Si rrjedhojë, SHGJSH rekomandon ndërprerjen e lejeve për shpime hidrogjeologjike në Akuiferin e Lushnjes[334].

Marrja e masave për mbrojtjen e akuiferëve nga Industria e rëndë: Duke marrë parasysh që në territorin e Bashkisë Lushnje kryhen veprimtaritë naftënxjerrëse (Kolonjë dhe Bubullime) shikohet e nevojshme që në zbatim të ligjit për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, nevojitet një direktivë specifike që trajton mbrojtjen e akuiferëve që shërbejnë për furnizimin me ujë të popullsisë nga ndotja industriale, sidmomos nga industria e naftës, nxjerrja e mineraleve dhe prodhimi i energjisë gjeotermale. Siç ndodh në vendet më të shvilluara si SHBA[335], direktiva/programi duhet:

- Të përcaktojë nëse lejohet shpimi i puseve të naftës në akuiferë që përdoren për furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm. Të përcaktohen zona të ndjeshme ndaj ndotjes në të cilat duhen shmangur aktivitetet ekonomike, që shkaktojnë ndotje (mundësisht aktivitete industriale që pajisen me leje mjedisore A dhe B). Është me rëndësi të përcaktohet edhe largësia nga akuiferi (një zonë mbrojtjeje) brenda së cilës nuk lejohet shpimi i puseve industriale.
- Të hartojë një program për mbrojtjen e akuiferëve nga veprimtaria industriale dhe e naftës. Ky program duhet:
  - Të përcaktojë akuiferët që duhen ruajtur (ku përjashtohet çfarëdolloj veprimtarie industriale) sepse me rëndësi jetike për furnizimin me ujë të popullsisë. Këto akuiferë nuk mund të preken nga pus-shpime të ndryshme industriale.
  - Të përcaktojë akuiferët, ujërat e të cilëve janë tashmë të ndotur dhe mund të përdoren vetëm për qëllime industriale.
  - Të përcaktojë trupat ujorë nëntokësorë të cekët dhe të thellë ujërat të cilët lejohet të shfrytëzohen nga industria në përgjithësi dhe industria e naftës në veçanti si dhe të caktohet kuota e lejuar për shfrytëzim me qëllim që të shmanget rënia e nivelit të sipërfaqes së tokës.

- Të përcaktohet nëse lejohet ri-injektimi (venddepozitimi) i ujërave të përdorura e të ndotura të industrisë së naftës
- Në qoftë se lejohet ri-injektimi, të përcaktohen zonat ku ri-injektimi lejohet me ligj dhe zonat në të cilat përjashtohen. Gjithashtu, në këtë rast, nevojitet që të përcaktohen me ligj kushtet teknike nën të cilat mund të kryhet ri-injektimi.
- Të përcaktohen standardet që kompanitë e naftës duhet të zbatojnë për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e puseve të ri-injektimit

Hartimi i një Plan Veprimi për Praktikat e Mira Bujqësore: Problem për burimet ujore mbetet edhe ndotaja e tyre me kimikatet dhe pesticidet që përdoren në bujqësi. Rekomandohet që bashkia të hartojë një Plan Veprimi për Praktikat bujqësore që duhet të ndiqen në mënyrë që të ulet sa më shumë përdorimi i tyre.

Monitorimi në mënyrë të herë pas hershme i Akuiferëve që përdoren për marrjen e ujit të pishëm për furnizimin e banorëve (Akuiferi i Lushnjes). Monitorimi duhet të ketë si qëllim vlerësimin e cilësisë së ujërave dhe gjetjen e shkaqeve të ndotjes së tyre. Duke patur parasysh që në territorin e bashkisë zhvillohen një sërë aktivitetesh (industria në përgjithësi dhe industria e naftës në veçanti, bujqësia, etj.), të cilët shpesh ndotin ujërat nëntokësor është e nevojshmë të vlerësohen dhe të ruhen ujërat nëntokësor, që përdoren për furnizimin e qytetarëve me ujë të pishëm.

- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve ujore të akuiferëve

Pajisja me një pasqyrë të rezervave vjetore të ujërave nëntokësore në akuiferë. Pasqyra të kihet parasysh gjatë dhënies së lejeve për shfrytëzimin e ujërave të akuiferëve me qëllim shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre. Rritja e kërkesës për ujë për nevoja familjare dhe veprimtari të ndryshme ekonomike ka rritur trysninë mbi akuiferët duke çuar në mbishfrytëzimin e tyre, kryesisht të Akuiferit të Lushnjes. Rol kryesor në menaxhimin e akuiferëve kanë SHGJSH-ja, Agjencia e Menaxhimit të Basenit të Semanit (ABU Seman) së bashku me Bashkinë e Lushnjes dhe bashkitë e tjera përkatëse, që shfrytëzojnë akuiferët. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujorë rrjedh si pasojë e zbatimit të ligjit nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"

Të analizohen akuiferët në thellësi mbi 200m: deri më sot, SHGJSH ka kryer studime përreth akuiferëve të cekët (nën 200m thellësi). Duke qenë se industria e rëndë shfrytëzon edhe ujërat e akuiferëve në thellësi mbi 200m (të paktën industria e naftës), kërkohet që këto akuiferë të pasqyrohen në inventarin e burimeve ujore në mënyrë që të përcaktohet ndikimi i industrisë në këto akuiferë dhe pasojat që mbishfrytëzimi i tyre mund të ketë në sipërfaqe (ulje të nivelit të tokës).

Monitorimi i sasisë së ujit që shfrytëzohet nga akuiferët në Bashkinë e Lushnjes dhe në bashkitë e Qarkut të Fierit: Sipas ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", Bashkisë së Lushnës në bashkëpunim me AKM, ARM dhe Këshillin dhe Agjencinë e Basenit Ujor të Semanit dhe Shkumbinit i del për detyrë të mbikqyrë dhe të detyrojë subjektet dhe individët të instalojnë pajisje për mbajtjen nën kontrroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit në tokë private për të eleminuar lidhjet e paligjshme dhe shfrytëzimin e pakontrolluar të akuferit ujëmbajtës.

6.3 Masa për mbrojtjen e peizazhit, biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura

6.3.1 Masa për mbrojtjen e peizazhit

Peizazhi në territorin e Bashkisë Lushnje paraqitet i ndryshëm, në varësi të territorit dhe zonave ku dominon aktiviteti njerëzor (Shih seksionin e Peizazhit). Problematikat kryesore që has peizazhi në territorin e bashkisë kanë të bëjnë kryesisht me fragmentimin/copëtimin e peizazhit natyror, dhe mos futjen e elementëve të peizazhit natyror në zonat urbane dhe në zonat me aktivitet bujqësor e industrial. Krahas problemeve në shkallë të madhe, vlejnë për t'u theksuar problemet me peizazhin urban e atë industrial (ish-zonat industriale), të cilët deri më tani nuk kanë gjetur një rrugë të përbashkët ndërthurjeje me atë natyror. Në qytet mbetet problem krijimi i një peizazhi të mirëfilltë urban, duke përfshirë të gjithë elementët e gjelbërimit, arkitektonikës, kopshteve, monumenteve kulturor dhe historik, të cilët së bashku do të krijonin një peizazh të ndërthurur dhe të pëlqyeshëm për qytetarët. Shpesh praktikat e mira të peizazhit nuk ndiqen, ato përcaktohen si dytësore. Këto praktika janë spontane, ku zonat urbane dhe industriale kanë përdorur elementë të peizazhit në mënyrë rastësore, apo duke patur një orientim të lehtë mbi çështjen e dizajnit të peizazhit. Kryesisht, rrugët dhe sheshet kanë qënë pjesë e futjes së dizajnit të peizazhit, me mbjellje pemësh formë lineare, duke ndjekur linja strikte, në rastet dominuese duke ndjekur konturet e infrastrukturës. Kjo është një mënyrë, sigurisht jo universale në rregullimin dhe krijimin e peizazhit, apo përdorimit elementëve të tij në funksion të dekorit urban e më gjerë. Studimi i peizazhit në tërësi dhe elementëve të tij kërkon studime të thelluara duke analizuar të gjithë komponentët që e formojnë atë (planifikimi, arkitektonika, historia, kultura, kultura bujqësore, natyra, bimët lokale, e deri tek komponentet më elementar si ndryshimi i ngjyrës së pemëve përgjatë sitinëve të vitit) dhe gjetjen e rrugëve të përbashkëta për ndërthurjen e pikave që mund të kombinohen me njeri tjetrin për të krijuar një peizazh të pëlqyeshëm dhe funksional.

Me qëllim mbrojtjen e përbërësve të mjedisit dhe peizazhit, në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) i cili është në fazë miratimi, Bashkia Lushnje ka parashikuar marrjen e disa masave të cilat përqendrohen në shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytetin e Lushnjes dhe në zonat industriale, krijimin e zonave ripariane përgjatë lumenjve (Seman, Shkumbin dhe Përroi i Lushnjes) dhe krijimin e parqeve urbane. Konkretisht për përmirësimin e peizazhit, në PPV, Bashkia ka propozuar rehabilitimin mjedisor dhe ristrukturimin e ish-zonës industriale të Plastmasit dhe të zonave të tjera përreth, rehabilitimin e venddepozitimit të mbetjeve aktuale dhe kthimin e saj në zonë të gjelbër, krijimin e një parku rajonal në zonën periferike të Qytetit të Lushnjes dhe krijimin e këndëve të lodrave në qytet dhe mbjelljen e pemëve në zonat urbane, etj.

Megjithtë, në funksion të përmirësimit të peizazhit, krahas masave të propozuara në PPV, në territorin e Bashkisë Lushnje rekomandohet:

Peizazhi Urban: Futja dhe ndërthurja e përbërësve të peizazhit natyror në brendësi të zonave urbane (sipërfaqe të gjelbra, peme, shkurre, sipërfaqe ujore). Kjo kërkon studime të hollësishme për zona specifike dhe në shkallë qyteti (Qyteti i Lushnjes), në mënyrë që peizazhi urban të ndëthuret me atë natyror dhe ky i fundit të mund të shërbejë, krahas të mirave mjedisore, si dekor urban. Masa specifike për përmirësimin e peizazhit urban në territorin e bashkisë janë:

- Ruajtja e strukturës së ***pemëve përgjatë rrugëve***, pra nëse aksi rrugor karakterizohet nga pemë kumbulle të kuqe, që ka rezistuar në kohë dhe i është përshtatur klimës dhe tokës, rekomandohet që të ruhet kjo lloj bimësie, si dhe

mundësisht të së njejtës madhësi dhe distancë nga njëra-tjetra, deri në fund të aksit për të ruajtur "*formalitetin*" që karakterizon këtë peizazh. Zgavrat e bordurat ku pema qëndron duhet të jenë të së njejtës madhësi, ngjyre dhe materiali mbules. Kjo e fundit duhet të ketë çarje të mjaftueshme për të lejuar depërtimin e ujit në rrënjë, por të mos penguar ecjen mbi to. Gjithashtu duhet të jetë e lëvizshme për qëllime mirëmbajtjeje. Mirë është që të përdoren mbulesat dhe zgavrat të mos lihen të çara e me bordurë sepse, veçanërisht në rrugët me trotuare të ngushta (1-2 m), pemët kthehen në pengesë serioze për ecjen e kalimtarëve.

- Përzgjedhja e bimëve përgjatë akseve rrugorë urban duhet të jetë ose të të njëjtit lloj, ose me një kombinim 2-4 llojesh por sipas një tendence të përsëritur, që krijon elementin estetik dhe të rregullsisë në dizajnin e peizazhit rrugor. Si parim, diversiteti në ngjyrë, formë dhe lloj mund të arrihet në akset e tjera, por brenda të njëjtit aks bimët, forma, distanca dhe lloji i tyre rekomandohet të qëndrojnë të pa ndryshuara, ose në formacione të projektuara paraprakisht.
- Në zonat park e hapësira të tjera publike ku do të mbillen pemë, karakteri formal i ketij peizazhi mund të thyhet nga pemë të mbjella rresht e të të njëjtit lloj, me pemë të së njejtës familje (gjethore, halore, shkurre), por të mbjella në grupime, pra grupe me nga 3 apo 5 pemë në varësi të hapësirës. Gjithsesi, në zonat park, projektuesit e peizazhit kanë liri në përzgjedhjen e formacioneve, për sa kohë që: zgjedhin bimë vendase apo të përshtatura për një kohë shumë të gjatë në territorin e qytetit/bashkisë së Lushnjes, i vendosin në mënyrë të tillë që të garantojnë hije në verë dhe depërtim të dritës së diellit në dimër; bëjnë të mundur krijimin e zonave me bar dhe jo vetëm lule ose tokë nën hije ku nuk mund të rriten bimët; krijojnë mikroklima të ndryshme brenda parkut, sjellin shumëllojshmëri bimësh që ofron informacion shkencor bazik edhe për përdoruesit e parkut, garantojnë që bimësia e përzgjedhur përmirëson cilësinë e tokës dhe rrit aftësinë filtruese e infiltruese të saj.
- Ti kushtohet vëmendje "*Xhepave Urbanë*", ose thënë ndryshe hapësirat boshe, të patrajtuara mes pallateve apo ndërtesave të ndryshme të qytetit, të cilat fshehin një potencial të madh në trjtimin e peizazhit urban. Këto hapësira vërtetojnë se peizazhi nuk ka përmasë standarde dhe se është vetë elementi i përdorur në të, i cili nëpërmjet funksionit që ofron edhe në një hapësirë relativisht të vogël, sërisht ofron një shumëllojshmëri aktivitetesh e mjedisesh. Si hapësirat e tjera park edhe këto xhepa ofrojnë tipologji të ndryshme sipas vendndodhjes. Pra këto xhepa mund të trajtohen sipas neovojave të komunitetit.
- Bimët e rekomanduara për përdorim në territorin e Bashkisë Lushnje (jo të vetmet) janë: Lofata *(Cercis siliquastrum),* Lagestromia *(Lagerstroemia indica),* Kumbulla e Kuqe (*Prunus cerasifera*), Ulliri i egër (*Olea europaea*), Rrapi (Platanus occidentalis), Pisha e Butë (*Pinus Pinea*), Dafina *(Laurus Nobilis) dhe* Ginko *(Ginkgo Biloba),* të cilat janë bimë (pemë) me tipare tërheqëse, rezistente ndaj ndotjes, të përshtatshme me zonën.

Peizazhi industrial: Të merren masa në drejtim të uljes së ndikimit negativ pamor të zonave ish-industriale dhe industriale. Kjo kërkon studime specifike në mënyrë që futja e elementëve të gjelbërimit me pemë dhe shkurre të shërbejë si

përmirësues i peizazhit dhe fshehjen e zonave/objekteve të cilat nuk janë të përshtatshëm nga pikëpamja vizuale. Gjatë hartimit të këtyre projekteve dhe zbatimit të tyre duhet pasur parasysh që funksionet industriale dhe gjelbërimi, apo përbërësit e peizazhit të balancohen dhe të plotësojnë njeri-tjetrin duke krijuar një dizajn të pëlqyeshëm dhe njëkohësisht duke garantuar ruajtjen e funksionalitetit. Masa specifike për përmirësimin e peizazhit industrial janë:

- Të shtohen sipërfaqet e pyllëzuara në zonat industriale, kryesisht zona e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës në NjA-të Bubullimë dhe Kolonjë. Pyllëzimi i këtyre zonave do të përmirësonte pamjen vizuale të zonës industriale dhe do të sillte një sërë përfitimesh mjedisore, si mbrojtjen e tokës, shtimin e oksigjenit në ajër dhe zbutjen e klimës, etj.
- Në zonat ish – industriale janë propozuar një sërë projektesh në PPV, ndaj duhet të merren parasysh këto projekte dhe të përzgjidhen bimë të cilat janë të përshtatshme. Karahas rregullimit të peizazhit, rekomandohet mbjellja e pemëve, që përshtaten me tokën dhe mund të zhvillohen në mjedise relativisht të ndotura. Për mbjelljen e pemëve në zonat industriale rekomandohen bimët si: Pisha e Butë *(Pinus Pinea*), Rrapi *(Platanus orientalis),* Plepi *(Populus alba),* Shelgu *(Salix species),* Eukalipti *(Eucalyptus)* etj**.**

Peizazhi natyror: Të synohet mbrojtja dhe përmirësimi i peizazhit natyror nëpërmjet shtimit të zonave të pyllëzuara dhe uljes së fragmentimit të zonave natyrore. Masa specifike për përmirësimin dhe mbrojtjen e peizazhit natyror mund të jenë:

- Të ruhen dhe ndërtohen aty ku mungojnë, zonat ripariane të lumenjëve**,** të cilat janë përbërës të rëndësishëm të plotësimit të peizazhit të territorit të Bashkisë. Ruajtja dhe përmirësimi i zonave ripariane luajnë rol të shumëfishtë, kanë funksion mbrojtës të tokës nga erozioni, njëkohësisht luajnë rolin e brezit buferik (zbutës) të ndalimit të ndotjes nga sipërfaqet bujqësore në drejtim të lumit, kanë një rol të rëndësishëm si korridor lidhës për habitatet, për strehimin dhe levizjen e specieve të ndryshme, gjithashtu dhe ndikimet positive në përmirësimin e cilësisë së ajrit, zbutjen e klimës, etj.
- Ripyllëzimi i zonave të shpyllëzuara dhe të degraduara nga shkaqe të ndryshme do të silltë një ndikim pozitiv në ruajtjen e njëtrajtshmërisë dhe të bashkimit të pjesëve të copëtuara të pyjeve, duke krijuar një peizazh pyjor të vazhdueshëm. Gjatë kësaj ndërhyrje duhet treguar kujdes i veçantë që pemët e përzgjedhura të jenë të njëjtit lloj që kanë qenë më parë ose të përshtaten pemë të tjera, gjithmonë duke përdorur pemë të cilat janë karakteristikë për zonë dhe që e kanë këtë territor habitatin e tyre.
- Të mbillen pëmë të cilat, karahas rregullimit të peizazhit, përshtaten me tokën dhe që mund të shërbejnë si mbrojtëse të tokës nga erozioni dhe që nuk përbëjnë rrezik për të prishur balancat me bimët e tjera (nuk janë invazive), ndër të tjera rekomandohen: Shelgu *(Salix species),* Plepi (*Populus alba),* Akacia *(Acacia),* Eukualipti*(Eucalyptus).*

Peizazhi rural: Mbrojtja e peizazhit rural dhe përmirësimi i cilësisë së tij, duke e konsideruar si pjesë të pandashme të peizazhit natyror. Kjo do të arrihet nëpërmjet marrjes së masave specifike për rregullimin e elementëve të caktuar, disa prej këtyre masave mund të jenë:

- Gjatë hartimeve të planeve të zhvillimit të bujqësisë të kihen parasysh elementët e peizazhit, në mënyrë që, aty ku është e mundur, sektori i bujqësisë të përshtatet me përbërësit e tjerë të peizazhit apo të krijojë një peizazh, i cili nuk fragmenton në vijushmërinë pamore (edhe fizike aty ku është e mundur) të peizazhit.
- Ruajtja mirëmbajtja e kanaleve vaditës/kullues dhe mbjellja e brigjeve të tyre me gjelbërim, duke krijuar "damar" të gjelbër përgjatë parcelave bujqësore (kryesisht bimësi e ulët, barishtore dhe shkurre te vogla).
- Të krijohen breza buferik (zbutës) me pemë të larta dhe të ulëta në pjesët fundore të tokave bujqësore, me qëllim krijimin e një zone të gjelbër dhe parandalimin e shpërdarjes së ndotësve në sipërfaqe të gjera (nëqoftëse në pjesën fundore të parcelave bujqësore ndodhet një lum, ky brez i gjelbër do të ul ndjeshëm depërtimin e ndotesve, si pasojë e shpëlarjes së tokës bujëesore nga vaditja).
- Të mbillen pemë/bimë të cilat, karahas rregullimit të peizazhit, përshtaten me tokën dhe që mund krijojnë konflikt me zhvillimin bujqësor. Për mbjelljen e pemëve në zonat industriale rekomandohen bimët si: Pisha e Butë (*Pinus Pinea*), Rrapi *(Platanus orientalis)*, Plepi *(Populus alba)*, Shelgu *(Salix species)*, Eukalipti *(Eucalyptus)*.

Masa të tjera të përgjithshme, për mbrojtjen e peizazhit dhe ndërthurjen e tij me të gjithë përbrësit e peizazhit në harmoni të plotë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ndjeshmërisë emocionale të qytetarëve mund të jenë **rujtja dhe konservimi i peizazhit natyror dhe artificial**: Kjo merr një rëndësi të veçantë për banorët që jetojnë, apo që kthehen në vendin e orgjinës, nga pikëpamja emocionale dhe e qetësisë që i ofron identiteti i vendlindjes/banimit të tyre.

Përfitime të tjera nga ruajtja e peizazhit: Ruajtja dhe konservimi i peizazhit natyror gjithashtu ka një sërë përfitimesh mjedisore, kryesisht në mbrojtjen e tokës, uljen e ndotjes, habitatit për specie e deri tek përfitimet ekonomik të drejtpërdrejta. Bashkia Lushnje në PPV e hartuar në 2016, ka hartuar një sërë projekte të ndryshme infrastrukturorë në territorin e bashkisë duke marrë në konsideratë të gjithë përbërësit e peizazhit duke mbrojtur dhe përmirësuar aty ku është e mundur. *Ndaj rekomandohet që gjatë zbatimit të projekteve nga PPV të merren në konsideratë të gjithë masat që janë dhënë në të për ruajtjen e peizazhit dhe përmirësimit të tijë.*

Tabela 83. Projektet e planifikuara në PPV që synojnë përmirësimin e peizazhit

Qëllimi	**Masa**	**Projekti**
Përmirësimi i peizazhit në territorin e Bashkisë Lushnje, nëpërmjet shtimit të sipërfaqeve të gjelbra	Shtimi i gjelbërimit përgjatë lumenjëve	- Ndërtimi i parkut periferik të qytetit të Lushnjes - Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman - Krijimi i korridoreve vegjetative në tokën bujqësore - Rehabilitimi i Kodrës së Lushnjes nëpërmjet metodës së ripyllëzimit - Ndërtimi i parqeve këndeve të lojrave dhe lulishteve në Njësitë administrative të Kolonjës, Krutjes, Fier-sheganit, Dushkut, Hysgjokaj - Rehabilitimi i dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale në Zonën ekonomike e Plastmasit - Rehabilitimi i dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale të Bashkisë në të cilin përfshihen: Zona ish-Industriale në fshatin Plug, Zona ekonomike e ish fabrikës
	Rehabilitimi i vatrave të nxehta mjedisore (ish-zonat industriale)	
	Krijimi i parqeve	

	urbane/rajonale	së dyshekëve - Rehabilitimi i fushës së mbetjeve dhe kthimi i saj në zonë të gjelbër - Rikonstruktimi i rrugëve peizazhistike vernakolare dhe pajisja me siNjalistikën dhe ndricimin rrugor të domosdoshëm në të gjithë territorin e Bashkisë Lushnje

Burnimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

6.3.2 Masa për mbrojtjen e biodiversiteti

Territori i Bashkisë Lushnje ka një biodiversitet relativisht të pasur dhe të larmishëm (shih seksionin e Biodiversitetit), si nga pikëpamja faunistike ashtu edhe floristike. Megjithatë, qëndrueshmëria e biodiversitetit has në një sërë vërshtirësish, të cilat lidhen kryesisht më problemet e shkaktuara nga aktiviteti njerëzor në territor. Zhvillimi bujqësor, industrial, urban dhe ai infrastrukturor janë procese që kanë patur ndikim të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e biodiversitetit. Hapja e tokave bujqësore (vitet e shkuara) ka çuar në tkurrje dhe fragmentim e habitateve natyrore, gjithashtu zhvillimi urban dhe infrastrukturor ka copëtuar habitatet, duke vështirësuar apo penguar plotësisht vijueshmërinë e tyre. Si pasojë, shumë specie mbeten të izoluara në habitate të vogla të copëtuara.

Në këtë situatë, hartimi i PPV-së ka synuar Planifikimin e Zhvillimit të Territorit në mënyrë të tillë që të sigurojë mbrojtjen e biodiversitetit në territorin e Bashkisë. Në PPV, Bashkia ka marrë disa masa specifike (ka hartuar projekte) për përmirësimin e gjendjes dhe krijimin e mundësinë për një biodiversitet sa më të qëndrueshëm. Këto masa janë përkthyer në projekte specifike të cilat synojnë shtimin e sipërfaqeve të gjelbra natyrore që shërbejnë si habitat për florën e faunën dhe rehabilitimin e zonave ripariane të lumenjve.

Në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të mëtejshëm të biodiversitetit, krahas masave të propozuara në PPV, rekomandohet edhe:

Hartimi i Planit të Menaxhimit/Veprimit të Biodiversitetit dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij në brendësi të territorit të bashkisë, kryesisht për zonat të cilat shihen prioritare për ruajtjen e specieve të mbrojtura. Në këtë rast, Bashkisë i nevojitet bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe institucione të tjera lokale e qëndrore (AKM, ARM, etj.). Ky rekomandim vjen edhe si detyrim ligjor në zbatim të ligjit Nr.587, datë 20.7.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit".

Inventarizimi i specieve dhe përditësimi i tij i vazhdueshëm për territorin e bashkisë (në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet të tjera vendore dhe qëndrore, AKM, ARM-Fier, AKZM, AdZM Fier). Inventarizimi përbën bazën mbi të cilën duhet hartuar plani i menaxhimit të biodiversitetit, përcaktohen zonat që spikaten për larmishmëri flore dhe faune dhe zonat që strehojnë speciet e rrezikuara. Inventarizimi i shërben Bashkisë për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit nga ndërhyrjet e njeriut dhe nga elementet natyrore, detyrim ky që rrjedh nga Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe VKM Nr. 84, datë 27.1.2009 "Për Caktimin e kritereve për ngritjen e rrjetit të inventarizimit dhe të monitorimit të biodiversitetit".

Hartimi i Planit të Mbarështimit të Fondit Kullosor, në mënyrë që të dihet kapaciteti i territorit për kullotje dhe shfrytëzim të pyjeve, të ndërmerren masa për ndalimin e kullotjes/shfrytëzimit aty ku vlerësohet e nevojshme**.**

Hartimi i Planit të Mbarështimit të Bimeve Mjekëore dhe Aromatike, në mënyrë që të njihet kapaciteti i lejuar i shfrytëzimit të këtyre bimeve duke ruajtur balancat e tyre (në bashkëpunim me institucionet vendore dhe qëndrore, Ministrinë e Mjedisit, Ministritë e linjës, ARM, AKM, etj.)**.**

Bashkëpunimi me fermerët e zonës për mbarështimin dhe ruajtjen e biodiversitetit e specieve bujqësore dhe blektorale lokale dhe vendase të cilat janë cilësuar si të rrezikuara nga lista e specieve të rrezikuara në shkallë vendi (në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Mjedisit).

Kontrolli i zbatimit të moratoriumit të ndalimit të gjuetisë dhe prerjeve të pyjeve (duhet theksuar që për zbatimin e moratoriumit të pyjeve Bashkia është e ngarkuar drejtpërsëdrejti për kontrollin dhe zbatimin e tij, ndërsa për atë të gjuetisë bashkisë i lind detyrim nga ligji për mbrojtjen e faunës dhe ligji për mbrojtjen e biodiversitetit) është masa kryesore që do të përmirësonte situatën e biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tij. Kontrolli i zbatimit të moratoriumeve të gjuetisë dhe pyjeve, kërkon:

- Bashkëpunim me institucionet lokale dhe qëndrore për të koordinuar punën dhe për të kryer veprimtari të përbashkëta, të cilat cilësohen më efikase në bashkëpunim ndërinstitucional (institucionet që duhet të lidhen ura bashkëpunimi janë Bashkitë fqinje, Ministria e Mjedisit, ARM, AKM, Policinë e shtetit, etj.)
- Ngritjen e sistemeve të informimit në terren, në mënyrë që të raportohen në kohë dëmet dhe të dalin para përgjegjësisë shkelësit (sistemi duhet të jetë formal, krahas punonjëve të lidhen marrdhënie të mira me banorët e zonës dhe kryesisht me barinjtë).
- Hartimin e planeve të kontrollit dhe inspektimeve në terren, në mënyrë që të gjitha kontrollet të jenë të koordinuara dhe të kenë efikasitet në veprimtarinë e tyre.
- Organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit të qytetarëve për rëndësinë që ka ndalimi i gjuetisë dhe prerjes së pyjeve për një afat të paracaktuar, përkatësisht 5 vjet për ndalimin e gjuetise dhe 10 vjet për ndalimin e shfrytëzimit të pyjeve.


Marrja e masave paraprake për uljen e ndikimeve negative në habitate nga ndërtimi/zgjerimi i infrastrukturës rrugore (kryesisht rrugët lidhëse të fshatrave 6-8m gjerësi). Në pikat ku vlerësohet që ndarja e habitateve krijon probleme në biodiversitetin e zonës, të ndërtohen ura/nënkalime ekologjikë për të lidhur habitatet e copëtuara. Rrugët lidhese ekzistuese dhe të propozuara në të gjitha zonat natyrore të Bashkisë duhet të kenë parasysh ndërtimin e urave ekologjike, pasi këto rrugë kanë ndikim të konsiderueshmëm në habitat (copëtojnë habitatin).

Mbrojtja e Rezervuarit të Thanës/Murrizit: Në afërsi të territorit të Bashkisë Lushnje ndodhet zona e mbrojtur natyrore (Park Kombëtar) e Divjakë – Karavastasë, një nga zonat më të pasura me shpendët e ujit në Shqipëri. Karakteristikë për këtë zonë të mbrojtur është edhe parania e shpendit më të madh në Europë, Pelikani Kaçurrel *(Pelecanus crispus),* i cili ka prej kohësh e përdor këtë habitat për t'u ushqyer dhe riprodhuar. Pelikani, krahas zonës së Parkut të Divjakë – Karavastasë përdor, kryesisht si burime me ujë të embël, disa rezervuar që ndodhen në territorin e Bashkisë Lushnje, ndër më të rëndësishmit janë Rezervuari i Murrizit dhe i Kasharajt.

Duke patur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së këtij shpendi dhe duke ditur rëndësinë nevojës për ujë të ëmbël që kërkon ky shpend rekomandohet që:

- në Rezervuarin e Murrizit (Thanës) të krijohet një zonë buferike (50 m), kryesisht me bimë të ulëta, përgjatë gjithë bregut në mënyrë që Pelikani Kaçurrel, të kryejë i qetë aktivitetin e tij në këtë liqen (nga informacionet e disponueshme ky liqen përdoret nga Pelikani për ushqim dhe ujë) (figura 104),
- Të merren masa për parandalimin e dëmtimeve të rezervuarit dhe të parandalohet gjuetia e paligjshme në Rezervuarin e Murrizit dhe të Kasharajt, si dy pikat më të pasura me larmi biologjike në territorin e bashkisë (kryesisht në këta dy rezervuarë ka lloje të shumta shpendësh dhe në veçanti është prania e pelikanit Kaçurrel).

Figura 104. Habitati i Pelikanit Kaçurrel (Pelecanus crispus)



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Tabela 84. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e biodiversitetit

Qëllimi	Masa	Projekti
Zhvillimi i qëndrueshëm i biodiversitetit	Rehabilitim i zonave të degraduara dhe pyllëzim	- Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman - Krijimi i korridoreve vegjetative në tokën bujqësore - Rehabilitimi i Kodrës së Lushnjes nëpërmjet metodës së ripyllëzimit - Rehabilitimi i Përroit të Lushnjes - Ndërtimi i parkut periferik të qytetit të Lushnjes - Rehabilitimi i fushës së mbetjeve dhe kthimi i saj në zonë të gjelbër
	Krijimi i parqeve	
	Krijimi i koridoreve lidhës për habitatet	

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

6.3.3 Masa për menaxhimin e Zonave të Mbrojtura

Në territorin e Bashkisë, krahas bimëve të kultivuara, të cilat zënë përqindje të lartë, ka një numër të madh llojesh të faunës dhe florës. Brenda territorit të bashkisë ndodhen 5 monumente natyrore të mbrojtura, të cilat janë të gjitha Monumente Natyre (Shih seksionin e Zonave të mbrojtura dhe biodiversitetit). Me qëllim përmirësimin e situatës dhe menaxhimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura rekomandohet që:

- Bashkia, në bashkëpunim më AdZM Fier, të hartojnë një Plan të Përgjithshëm për Menaxhimin e Zonave të Mbrojtura në territorin e bashkisë, me qëllim që të

lidhen ura bashkëpunimi të forta dhe të koordinojnë veprimtaritë e tyre për mënaxhimin dhe ruajtjen e këtyre zonave.

- Ngritja e një sistemi lajmërimi (sinjalizimi) formal për parandalimin e dëmtimeve në zonat e mbrojtura, duke punësuar individë që banojnë pranë këtyre zonave. Gjithashtu, nevojitet që të krijohen marrëdhënie bashkëpunimi me barinjtë e zonës për informimin e incidenteve të mundshme në zonat e mbrojtura dhe zonat natyrore në përgjithësi.
- Të merren fushata promovuese për zonat e mbrojtura dhe Monumentet Natyrore në territorin e Bashkisë, me qëllim zhvillimin e turizmit miqësor me natyrën (Ekoturizmi).
- Të hartohen programe për ndërgjegjësimin e popullsisë për mbrojtjen e burimeve natyrore.
- Të ruhet karakteri natyror i rrugëve në zonat natyrore gjatë ndërtimit e përmirësimit të infrastrukturës rrugore të parashikuar në PPV.
- Të zbatohet shkalla e mbrojtjes së zonave të mbrojtura sipas ligjit në fuqi (Të gjitha shkallët e mbrojtjes së ZM-ve në Lushnje paraqiten në tabelën në vijim).
- Të propozohet dhënia e statusit të mbrojtur të Liqenit të Thanës, pasi konsiderohet një zonë e rëndësishme për ushqim të shpendëve ujorë, në veçanti përmendim praninë e Pelikanit Kaçurrel, i cili i përdor ujërat e këtij liqëni për tu ushqyer.

Tabela 85. Shkalla e mbrojtjes dhe domethënia (veprimtaritë e ndaluara)

Kategoria	Shkalla e mbrojtjes	Veprimtaritë e ndaluara
Kategoria III	Shkalla e oarë (I)	Aktivitetet që janë të ndaluara: a)prerja e drurëve dhe e shkurreve; b)përdorimi i kimikateve dhe i plehrave kimike; c) ndërtime të çdo lloji; ç) nxjerrja e mineraleve dhe e torfave; gjuetia dhe peshkimi; dh) ndezja e zjarreve; . e) kullotja, kalimi i kafshëve shtëpiake dhe ndërtimi i objekteve për mbajtjen e tyre; ë) ngritja e objekteve çlodhëse, argëtuese dhe sportive; f) kalimi nëpër shtigje, me përjashtim të pronarit ose të përdoruesit të tokës; g) lëvizja me mjete motorike të çdo lloji, me përjashtim të makinave të administratës së ruajtjes së rezervatit dhe të zjarrfikësve; gj) vozitja me barka, kanoe dhe mjete të tjera lundrimi; h) riprodhimi intensiv i kafshëve të gjahut.

Burimi: Ligji nr.9868, datë 4.2.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura"

6.4 Masa për mbrojtjen e cilësisë së ajrit

Mbrojtja e cilësisë së ajrit është detyrim ligjor për Bashkinë i cili rrjedh nga Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 26, pika 1. Ky ligj ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë për të ofruar një mjedis cilësor për qytetarët në territorin e saj. Ligji 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis" është ligji kryesor që ngarkon Bashkinë me përgjegjësinë specifike të përmirësimit të cilësisë së ajrit së bashku me ligje të tjera që synojnë mbrojtjen e mjedisit apo përbërësve specifikë të tij.

Gjatë analizës së thelluar të gjendjes së mjedisit në territor, është vënë re se cilësia e ajrit në Bashkinë Lushnje nuk është e mirë, kryesisht në zonat naftënxjerrëse. Burimet e ndotësve të cilësisë së ajrit janë kryesisht industria e rëndë, mjetet e transportit (në zonat urbane), cilësia jo e mirë e naftës së përdorur nga mjetet e transportit, si dhe sektorë të tjerë të ekonomisë, si ndërtimi. Në analizë u vu re mungesa e një monitorimi të vazhdueshëm të cilësisë së ajrit gjatë gjithë vitit (monitorimi në një numër shumë të kufizuar ditësh gjatë vitit dhe mungesa e një rrjeti monitorimi me pajisje fikse në pika të caktuara në Bashki për monitorimin e përhershëm ose ditor të cilësisë së ajrit).

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Lushnje ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor të cilat parashikojnë uljen e ndotjes nga mjetet e trasnportit. Këto projekte parashikojnë uljen e numrit të makinave në qarkullim nëpërmjet fuqizimit të transportit publik dhe nxitjes së transportit alternativ (siç është transporti me biçikleta), dhe uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane, shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytet, hartimin e planeve për uljen e shkarkimeve në ajër nga industria e rëndë, si dhe planifikimin efiçent të territorit.

Duke patur parasysh që në territorin e Bashkisë Lushnje vepron industria e rëndë e cila shkarkon në ajër një numër të lartë ndotësish, lind nevoja që Bashkia të ndërmarrë disa masa konkrete të cilat janë renditur më poshtë:

- Hartimi i një plani për uljen e ndotjes së ajrit nga industria naftënxjerrëse. Nevojitet që pushteti qendror, pushteti lokal (Bashki) dhe përfaqësues të industrisë së naftës të identifikojnë praktikat dhe teknikat më të mira të mundshme, që mund të zbutin ndotjen e ajrit nga kjo industri.
- të shikohet bashkëfinancimi Bashki - Qeveri qendrore - Industri Nafte për zbatimin e planit për uljen e ndotjes së ajrit nga nafta në zonat naftënxjerrëse. Në bazë të parimit "ndotësi paguan" është detyrë e kompanisë së naftës që të financojë futjen e teknikave më të mira të mundshme për uljen e ndotjes së shkarkimeve në ajër në zonën e operimit. Megjithatë, me qëllim që të mos penalizohet popullsia vendase për shkak të mungesës së mundshme të kapacitetit financiar të kompanisë, rekomandohet që të shikohet edhe mundësia e bashkëfinancimit Qeveri qendrore – kompani nafte për uljen e ndotjes së ajrit nga nafta në zonat naftënxjerrëse.
- Hartimin e Planit të Veprimit Afatshkurtër për PM_{10}, NO_2 dhe Benzenin, në zbatim të Ligjit 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit", neni 8 pika 4. Nga analiza e cilësinë së ajrit në territorin e Bashkisë Lushnje, përmbajtja e PM_{10}, NO_2 dhe Benzenit në ajër është më e lartë së vlerat kufi të përcaktuara me ligj. Hartimi i planeve të tilla është kërkesë ligjore për Bashkinë duke qenë se përmbajtja e substancave të mësipërme në ajër i kalon kufinjtë e caktuar me ligj.
- Përfshirjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Planet Sektoriale të Bashkisë (planin e zhvillimit të transportit publik, transportit rrugor, zhvillimit urban, industrial, të pyjeve, etj.)
- Bashkëpunimin me Inspektoriatin e Mjedisit për zbatimin e normave të shkarkimeve në ajër nga sektori i industrisë (i naftës në veçanti), i ndërtimeve, etj.

- Ndërmarrja e nismave të herëpashershme për kontrollin e zbatueshmërisë së kushteve të lejeve mjedisore (të tipit A, B dhe C) dhe të ligjit në tërësi si dhe pjesëmarrja aktive në dhënien e Lejeve Mjedisore (në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse) të këtyre subjekteve.
- Hartimi i projekteve në të ardhmen duke e bazuar lëvizjen e qytetarëve të Bashkisë në transport publik dhe transport alternativ (këmbësor, bicikleta, etj.). Në PPV, është parashikuar ulja e numrit të makinave në qarkullim me qëllim uljen e ndotjes nga mjetet e transportit. për të njëjtën arsye rekomandohet hartimi i PDV-ve duke ndjekur shembullin e PPV-së, e cila ka hartur projekte që kanë si synim fuqizimin e transportit publik, favorizimin e këmbësorëve dhe nxitjen e përdorimit të mjeteve të transportit alternativ (biçikleta ose motorrë, të paktën në zonat urbane), zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra, kufizimin e numrit të makinave në qarkullim në qendra urbane, shtimin dhe zgjerimin e trotuarve në rrugët më të përodura nga qytetarët, fuqizimin e mëtejshëm të transportit publik dhe shtimin e korsive të biçikletave përgjatë akseve të rrugëve në qendra dhe nëpërmjet rrugëve që lidhin NjA-të e afërta në largësi, zhvillimin territorial të qendrave të NjA-ve ose urbane në parimin e përdorimit të tokës/truallit në mënyrë efiçente dhe të përqendruar dhe jo të shpërhapur (përdorime mikse të zonave që nënkuptojnë biznese, banime dhe shërbime në të njëjtën zonë), me qëllim uljen e kilometrave, që qytetarët nevojitet të përshkojnë me makinë, për plotësimin e nevojave të tyre (blerjet, udhëtime për në institute, shkolla, qendra spitalore) në jetën e përditshme.
- Menaxhimi i mbetjeve sipas parimeve të mbrojtjes së mjedisit (duke shmangur dhe parandaluar djegien e tyre si dhe duke parashikuar kapjen e gazrave që lëshojnë mbetjet gjatë shpërbërjes së tyre jashtë dhë brenda venddepozitimit të mbetjeve. Rekomandohet që venddepozitimet që parashikohen të ndërtohen në të ardhmen të pajisen me sistemin e kapjes së gazeve, që çlirohen nga shpërbërja e mbetjeve në mënyrë që të mos shkarkohen të pakontrolluara në atmosferë.

Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ajrit në Bashki: për këtë synim, rekomandohet që Bashkia të ndërmarrë disa masa si:

- Krijimi i stacioneve të përhershme të monitorimit të ajrit me qëllim monitorimin ditor dhe mundësisht orar (24/7) të cilësisë së ajrit në zonat me aktivitet të lartë naftënxjerrës dhe në zonat urbane (në Qytetin e Lushnjes dhe në zonën naftënxjerrëse të Bubullimës dhe Kolonjës). Monitorimi orar shërben për të njoftuar qytetarët në përgjithësi dhe pjesën më të ndjeshme të popullsisë (fëmijët, të moshuarit, gratë shtatzanë, etj.) që të qëndrojnë brenda shtëpisë sa herë që cilësia e ajrit nuk është e mirë. Në këtë mënyrë shmangen shumë rreziqe që i kanosen shëndetit të popullsisë së Bashkisë. Për këtë lipset bashkëpunimi me autoritetet përgjegjëse (AKM, ARM Berat dhe Instituti i Shëndetit Publik).
- Shtimi i parametrave të monitoruar. Duke qenë se Bashkia e Lushnjes është zonë me industri naftënxjerrëse dhe me një numër të lartë makinash në qarkullim në zonën urbane, lipset që monitorimi i cilësisë së ajrit të përfshijë parametra që tregojnë ndotjen nga nafta dhe mjetet e qarkullimit. Është mjaft e rëndësishme që pëveç benzenit dhe disa parametrave të tjerë që

monitorohen nga AKM-ja, të përfshihen edhe Përbërësit Organikë të Avullueshëm (VOCs).

- Monitorimi i përditshëm i treguesve problematikë të ajrit (P_{M10}, NO_2 dhe Benzenin) në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse (AKM e ARM Berat) deri në uljen e përqëndrimit të tyre në ajër brenda parametrave të lejuar me ligj.

Tabela 86. Projektet e planifikuara në PPV për përmirësimin e cilësisë së ajrit

Qëllimi	**Masat**	**Projekti specific i parashikuar në PPV**
Ulja e numrit të makinave në qarkullim	Fuqizimi i transportit publik	- Rikonstruksioni i rrugës historiko-kulturore të Manastirit të Ardenicës dhe pajisja me korsinë e dedikuar të bicikletave , - Pajisja e rrugëve urbane kryesore dhe dytësore me korsi të dedikuar për bicikleta në të gjithë territorin e Bashkisë Lushnje, - Ndërtimi i parkut periferik të qytetit të Lushnjes, - Ndërtimi i parqeve këndeve të lojrave dhe lulishteve në Njësitë administrative të Kolonjës, Krutjes, Fier-sheganit, Dushkut, Hysgjokaj, - Rikonstrusioni dhe zgjerimi i të gjithë infrastrukturës rrugore sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor, duke përmirësuar cilësinë e ndricimit rrugor dhe pajisjen me pemë në të dyja anët e rrugëve, - Ndërtimi i stacionit multimodal në qendër të qytetit të Lushnjes, - Ndërtimi i Terminalit të autobusëve ndër dhe rreth qytetas në hyrje të qytetit të Lushnjes, - Rehabilitimi i fushës së mbetjeve dhe kthimi i saj në zonë të gjelbër.
	Nxitja e transporteve alternativë	
	Planifikimi efiçent i territorit	
	Kufizimi i makinave në qendrat urbane	
Përmirësimi i cilësisë së ajrit	Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra në qytet	
Menaxhimi i integruar i mbetjeve	Rehabilitim i vend depozitimeve të mbetjeve	

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

6.5 Masa për mbrojtjen e tokës

6.5.1 Masat për mbrojtjen e tokës/territorit

Problemet kryesore që hasen në territorin e Bashkisë, ashtu si në të gjithë vendin, janë kryesisht erozioni i tokës dhe, në masë të kufizuar, edhe rrëshqitjet e saj. Me qëllim përmirësimin e cilësisë së tokës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Lushnje ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Megjithatë, për mbrojtjen e tokës nga fenomene të rrezikut gjeologjik (erozion, përmbytje, etj.) dhe nga ndërhyrjet e njeriut, krahas masave të propozuara në PPV-në e Bashkisë Lushnje, rekomandohet edhe marrja e masave shtesë si:

Studime të mirëfillta mbi erozionin duke përdorur modele bashkëkohore për parashikimin e erozionit të shkaktuar nga uji ose nga era (përdorimi i ekuacionit universal për humbjen e dherave-USLE ose parashikimi i erozionit nga shiu-WEPP[336]) në të gjithë sipërfaqen e bashkisë me qëllim përcaktimin e shkallës/shtrirjes së erozionit në të gjithë territorin. Kjo ndihmon i) për planifikim më të mirë të menaxhimit të tokës, ii) për një vlerësim të pasojave që vijnë nga mënyrat e ndryshme të punimit të tokës (me përmbysje të dheut në 100% të sipërfaqes së tokës, pa shkulje të bimësisë së kultivuar në stinët e mëparshme me qëllim mbrojtjen e tokës, etj.), iii) për përcaktimin e standardeve për mbrojtjen e tokës e mjedisit, iv) për zhvillimin e planeve për kontrollin e sedimentit në projekte ndërtimi si rezervuare, si dhe v) për llogaritjen e kohës (viteve) që nevojiten për mbushjen e kanaleve dhe digave me sediment.

- Kufizimi i sipërfaqeve që kalojnë nga tokë pyjore në tokë bujqësore ose urbane, fenomen ky që krijon rrëshqitje të dheut duke tjetërsuar kështu morfologjinë e tokës në të cilën ndodh. Rekomandohet që Bashkia të mos miratojë kërkesa për kalimin e tokës pyjore në tokë bujqësore në zonat ku shihet dukshëm krijimi i fenomenit të erozionit e rrëshqitjeve, kryesisht ne zonat e NjA-ve Golem, Hysgjokaj dhe Ballagat.
- Hartimi dhe zbatimi i Planit për Shtimin e Sipërfaqeve Pyjore për përmirësimin e sipërfaqeve të tokave të gërryera, të braktisura, të zhveshura dhe të shpyllëzuara. Bashkisë së Lushnje i del si detyrë hartimi dhe zbatimi i këtij plani në zbatim të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar" Neni 7, nëpërmjet të cilit synohet shtimi i sipërfaqeve pyjore dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve në zonat e braktisura, të zhveshura, të shpyllëzuara dhe të gërryera.
- Hartimi i Planit të Mbarështrimit të Pyjeve: Për fenomenin e erozionit dhe rrëshqitjes së dheut në Bashki rekomandohet Hartimi i Planit të Mbarështimit të Zonave Pyjore i cili duhet të parashikojë:
    - pyllëzim dhe, aty ku vlerësohet e nevojshme, ndërhyrje me vepra inxhinierike për mbrojtjen e tokës nga erozioni në NjA-të Ballagat dhe Hysgjokaj,
    - Ripërtëritje të bimësisë së ulët (nënpyllit)në zonat e dëmtuara,
    - Ngritja e një sistemi për parandalimin e prerjes së drurëve në mënyrë të paligjshme
    - Pyllëzimi i zonave ripariane në brigjet e lumenjve Shkumbin dhe Seman dhe degët e tyre. Emergjente janë edhe përrenjtë që zbresin nga kodrat. Këtu përmendim Përroin e Lushnjes të cilët kanë nevojë emergjente për pyllëzim për mbrojtjen e brigjeve nga erozioni,
    - Ruajtja e gjerësisë bimore në kanalet e ujërave në zonat pyjore (zakonisht gjerësia duhet të jetë rreth 1.5 herë më e madhe se gjatësia e pemës më të lartë të pyllit[337]). Kjo bimësi përveç se mbron tokën nga erozioni, mbron edhe burimin ujor nga ngrohja e panevojshme nga dielli.
    - Marrja e masave për stabilizimin e zonave nën ndikimin e erozionit në sipërfaqe të sheshta dhe të erozionit të shkaktuar nga shiu të cilat kanë krijuar kanalizime të parregullta për ujin në zonat pyjore,
    - Menaxhim dhe ndërtim rrugësh duke patur parasysh ndikimin e madh që këto kanë në shtimin e erozionit. Kjo nënkupton ushtrimin e kontrollit të duhur në rastet kur ndërtohen rrugë të reja me qëllim që të respektohen standardet për mbrojtjen e tokës (gjatë ndërtimit të rrugëve për shfrytëzimin e lëndës drusore, për rekreacion, etj, për aktivitete minierave që zakonisht ndodhen në zona pyjore).
    - Përkujdesje gjatë ndërtimit të rrugëve për shfrytëzimin e materialit drusor për ngrohje.
    - Ruajtja e prodhimtarisë së tokave në menaxhimin e agro-bujqësisë ose bujqësisë

Hartimi i Planit për Menaxhimin e zonave kullosore (në zonat kodrinore): Kullotat (bimësia barishtore) garantojnë nivel më të lartë mbrojtjeje se vetë shkurret. Për këtë arsye, në rast dëmtimi të kullotave që vjen shpesh nga mbikullotja, ndodh përkeqësimi i gjendjes së barit ose rrallimi i barit/bimësisë nëpër zonat kullosore, duke e lënë kështu tokën të zhveshur e si rrjedhojë, të ndjeshme ndaj erozionit. *Duke parë se erozioni është i lartë në bashki dhe në zona malore*, është e rëndësishme që bashkia të marrë masatë menjëhershme për rregullimin e përdorimit të kullotave. Kjo nënkupton:

- Disiplinimin e kullotave në bashki nëpërmjet rregullave që garantojnë përdorimin e tyre të qëndrueshëm. Rekomandohet që rregullat të kenë parasysh i) sigurimin e ushqimit të gjësë së gjallë ose bagëtisë dhe njëkohësisht ii) mbrojtjen e kullotave nga erozioni. Pra mbrojtja e kullotave është një ndër masat kryesore për mbrojtjen e tokës nga erozioni,
- Parandalimin e zjarreve nëpër kullota,
- Mmbjelljen e bimëve kullosore në zonat e dëmtuara,
- Mirëmbajtjen e tokës dhe ruajtjen e stabilitetit të tokës në ekonomitë kullosore
- Kontrollimin e rrugëve, që ndërtohen në zona kullosore dhe të aktivitetiteve të ndryshme ,si minierat apo guroret.
- Ndërtimin e strukturave fizike, që kanë si qëllim drejtimin dhe ngadalësimin e shpejtësisë së rrjedhës së ujërave. Kjo nevojitet në zona me pjerrësi të theksuar ose me pjerrësi të vazhdueshme për një largësi të theksuar

Përmirësimi i sistemit ujitës dhe kullues: Zonat fushore të Bashkisë Lushnje përshkohen nga një rrjet i dendur sistemi ujor, që nga kanalet vaditëse dhe kulluese deri tek përrenjtë dhe lumenjtë e Shkumbinit dhe Semanit, duke shkaktuar përmbytje të herëpashershme të tokave përreth në rast shirash. Si një problematikë e rëndësishme rekomandohet:

- Mirëmbajtja e sistemit ujitës dhe kullues duke pastruar vazhdimisht kanalet.
- Përmirësimi i zonave riparane përgjatë lumit Seman dhe Shkumbin me qëllim parandalimin e përmbytjes së tokave përreth lumenjve e kanaleve.

Përmbytjet: Rreziku i përmbytjes me rikthim 100-vjeçar në Bashkinë e Lushnje parashikohet të shkaktohet nga lumi i Semanit dhe Shkumbinit ndaj dhe rekomandohet që Bashkia:

- *të përditësojë Planin e Menaxhimit* të *Përmbytjeve* me rikthim 50-vjeçar. Planet e sotme janë të vitit 2003 dhe nuk marrin parasysh ndryshimet e regjimit të reshjeve dhe fenomeneve të tjera klimatike në dhjetëvjeçarin e fundit.
- të hartohet një plan menaxhimi në rast përmbytjesh me rikthim 100-vjeçar. Fillimisht rekomandohet të bëhen studime për të përditësuar përmbytjet në Bashki.
- Të hartoje dhe zbatojë Plane Veprimi për kontrollin teknik të digave dhe pastrimin e tyre nga materialet e depozituara në liqene me qëllim shmangien e përmbytjeve dhe shtimin e kapacitetit ujëmbajtës të tyre.
- Marrja e masave specifike të mëposhtme të identifikuara nga Emergjencat Civile Lushnje (Tabela 87):

Tabela 87. Masat kundër rrëshqitjeve dhe përmbytjeve

NJA-të	Objekti	Vend-ndodhja/shtrirja	Masat që duhen marrë/nevojat	Shkaqet
NJA 1	Përroi i Qytetit	Segmenti nga rezervuari i Kasharit deri tek Kaptazhi (tek Çelët)	-Pastrim dhe sistemim shtrati në përgjithësi - Ndërhyrje për drejtimin e shtratit & betonimin e skarpatave të përroit të qytetit në segmentin përgjatë varrezave publike	Rrëshqitja e dherave (janar 2013)
	Rr. Shaqir Tare	E gjithë rruga	-Rehabilitim total i rrugës (në këtë moment është e pakalueshme)	Gërryerja e tokës ndër vite
NJA 2	Kanali i ujërave të larta	Segmenti nga rezervuari i "Xhafallarëve" deri tek Ura në Rr. "Vasil Prifti"	Pastrim dhe sistemim i skarpatave anësore. Në disa vende ka shembje	Shembje të tokës
	Lagja Xhevdet Nepravishta	Segmenti në Rr. "Vëllezërit Frashëri"	Bashkia ka përgatitur projektin për ndërhyrjet e duhura, por mungojnë fondet për zbatim të tij. Gjendja ende problematike	Rrëshqitje në përmasa 15x1.5 m & thellësi 3 m.
NJA 4	Lagja Gafurr Muça	Zona e banimit pranë pall.Nr.177 dhe pranë shtëpive private të fiseve Zaçe, Mejdani & Hasanbelliu	Studime për rikonstruksionin e KUB-it në këtë zonë, për shkak se zona në fjalë përmbytet në rast reshjesh me intensitet të lartë (arsyeja: niveli i KUB është më i lartë se niveli i tokës tek këto shtëpi)	Përmbytje në rast reshjesh me intensitet të lartë (niveli i KUB > se ai i tokës
NJA 5	LuNja Karbunarë	Segmenti i kanalit nga Ura e Begallarëve deri tek pika e Karburantit "Lloshi"	Pastrim dhe sistemim i shtratit të kanalit	Bllokim shtrati

Burimi: Emergjencat Civile dhe Njësitë Administrative të Bashkisë, Përpunoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

<u>Zonat me ndikim nga përmbytjet e rrëshqitjet në zona jashtë Qytetit Lushnjë dhe masat afatshkurtër që duhen marrë :</u>

Zonat që preken nga përmbytjet dhe rrëshqitja e dherave në zonën rurale të Bashkisë së Re të Lushnjës janë të shumta dhe përfshijë disa NjA, konkretisht NjA-të Golem, Dushk, Ballagat, Kolonjë, Krutje, Bubullimë, Fiershegan, dhe Allkaj. Siç u tha më sipër, ashtu si edhe në zonën urbane, shkaqet e përmbytjeve janë reshjet e vazhdueshme me intensitet të lartë. Për sa i përket shkaktrëve, që ndikojnë në thellimin e pasojave nga përmbytjet dhe rrëshqitjet e dherave, ato janë të llojeve të ndryshme dhe mund t'i përmbledhim si më poshtë:

- <u>Mungesa e mirëmbajtjes së kanaleve kulluese dhe kanaleve të ujërave të larta</u> shkakton ngushtimin dhe bllokimin nga dherat që grumbullohen gjatë reshjeve. Raste të tilla janë vënë re në fshatrat Allprenaj, Golem i Madh/ i Vogël, Thanasaj, Krutje e Sipërme, Arrëz, Ardenicë, Bubullimë, Fshati Jeta e Re, Sejmens, Thanë, Fiershegan-Toshkëz, Fshati Lifaj i Ri dhe Allkaj.

- Mungesa e pastrimit të shtratit të lumenjve e përrenjve në raste të veçanta janë bllokuar nga dherat ose nga rritja e pakontrolluar e bimësisë (Lumi Shkumbin)
- Mosfunksionimi i stacioneve të pompave të largimit të ujrave të bardha e të ndotura, stacione këto mjaft të rëndësishme në territore me pjerrësi të ulët, si ai i territorit të Bashkisë Lushnjë, ku rrjedha e ujit nuk ndikohet nga forca e gravitetit (Fshati Plyk).
- Mungesë asfaltimi rrugësh në zonat e ndjeshme ndaj shëmbjes së dherave (fshati Shegas, Rrugët për në fshatrat Gjyshaj, Xibrak, Manasufaj)
- Mungesë kanalesh kulluese (Rrapëz Sektor dhe Rrapëz fshat)
- Ndërhyrje të gabuara nga banorët në diga apo rezervuarë duke përdorur sipërfaqen e tokës ku ndodhen këto diga si tokë bujqësore ose ullishte (siç është rasti i Digës së Rezervuarit Gramsh, që është mbjellë me ullinj)
- Ndërtimi i urave nga banorët mbi kanal për të hyrë në banesa (Fshati Bitaj)
- Mungesa e rehabilitimit dje mirëmbajtjes së veprave inxhinjerike (urave) sepse rrezikojnë të shemben për shkak të gërryerjeve (dy urat në fshatin Bitaj, Argjinatura e Lumit Seman në fshatin Toshkëz, Zhelizhan, etj.)
- Nevoja për ndërtimin e veprave të reja inxhinjerike/paneleve (shembull. ndërtimi i dy paneleve në fshatin Zhelizhan, etj.)

Më poshtë janë paraqitur problematikat kryesore të shkaktuara nga përmbytjet dhe rrëshqitjet në zonën rurale të Lushnjes, së bashku me masat që duhen marrë për parandalimin ose zbutjen e ndikimit të tyre në mjedis dhe në jetën e banorëve

Tabela 88. Rreziqet gjeologjike në Zonën Rurale të Lushnjës (rrëshqitjet dhe përmbytjet)dhe masat që duhen marrë

NjA-të	Fshati	Vend-ndodhja/Shtrirja	Masat që duhen marrë/Nevojat	Shkaqet
NjA Golem	Fshati Allprenaj	Përroi i Virovës në Lagjjen Virovë (Përroi fillon nga fshati Shegas, kalon tek fabrika e tullave dhe derdhet tek kanali i ujrave të larta afër ish-kompleksit të Derrit në Virovë)	Pastrimi i Përroit të Virovës mbasi përroi ka mbi 10 vjet pa u pastruar. Si rrjedhojë, në rast reshjesh mbi 80mm, ky përrua shkakton përmbytje të zonave përreth në Lagjen me të njëjtin emër.	Përmbytet kur reshjet kalojnë 80 mm shi. Mospastrim kanali mbi 10 vjet
	Fshati Golem i Madh/ i Vogël	Kanali i ujrave të larta	Pastrim e mirëmbajtje të vazhdueshme të kanalit të ujërave të larta sepse rrezikon të përmbytet në rast mospastrimi çdo 3-4 vjet	Përmbytet në rast mospastrimi të kanalit të ujrave të larta
	Fshati Pluk		Vënia në funksion e Stacionit të pompave të largimit të ujrave të bardha e të zeza. Fshati rrezikon të përmbytet sepse ky stacion i pompave të largimit të ujrave të bardha e të zeza nuk është në funksion (dëmtuar që në vitin 1997)	Rrezikon të përmbytët në mbi 50% të banesave nëse rreshjet tejkalojnë 80 mm shi. Stacioni i pompave të

				largimit të ujrave të bardha e të zeza jashtë funksioni
	Fshati Shegas	Përgjatë rrugës që të çon në këtë fshat (në anën perëndimore)	Asfaltimi i rrugës që lidh fshatrat Shegas - Golem i Vogël – Golem i Madh në rrugën nacionale për arsye se në rast reshjesh intensive e të vazhdueshme, shkaktohen rrëshqitje dheu dhe si rrjedhojë, ndodh bllokimi i kësaj rruge	Bllokim kanali nga rrëshqitjet e tokës kur reshjet janë intensive
NjA Dushk	Fshati Thanasaj	Kanali përgjatë lumit Shkumbin që fillon tek Shkolla 9-vjecare dhe përfundon tek kantieri i inerteve (në gjatësi rreth 400 ml)	Pastrim dhe thellimin të kanalit të Lumit Shkumbin mbasi fshati rrezikon përmbytjen e 40 banesave sa herë që Lumi del nga Shtrati	Bllokimi i kanalit përgjatë lumit Shkumbin
		Kanali nga ish pompa rrëzë Hekurudhës dëri poshtë autostradës (rreth 1 km gjatësi)	Pastrim Kanali nga ish-pompa rrëzë Hekurudhes deri poshtë autostradës (rreth 1 km gjatësi). Mospastrimi i kanalit rrezikon përmbytjen e rreth 70 ha toke bujqësore.	Bllokimi i kanalit nga mospastrimi
	Fshati Gramsh	Diga e Rezervuarit Gramsh	Pastrimi i Digës së Rezervuarit Gramsh mbasi kjo digë është mbjellë me ullinj nga banorët në të gjithë gjatësinë e saj (200ml)	Mbjellje e digës me ullinj
Ballagat		Rrugët për në fshatrat Gjyshaj, Xibrak, Manasufaj	Rehabilitim të rrugëve meqenëse rrugët janë të pakalueshme për automjetet	Gërryerja e dheut për Shkaqe natyrore
Krutjë	Fshati Krutje e Sipërme	Delli i fshatit Krutje e Sipërme i cili fillon nga Fieri i Ri, përshkon Krutjen dhe mbaron tek kolektori i Gjazës	Pastrim dhe mirëmbajtje e Dellit të fshatit Krutje e Sipërme. Ky fillon nga Fieri i Ri, përshkon Krutjen dhe mbaron tek kolektori i Gjazës	Bllokim
	Fshati Arrëz	Kanali nga ura e Nushajve deri tek tokat e Mondi Gjatës (rreth 1 km gjatësi)	Pastrim dhe thellim të kanalit (rreth 1 km gjatësi)	Bllokim
Kolonjë	Fshati Bitaj	Kanali i ujrave të larta	Rehabilimin e kanalit për shkak se bllokohet sa herë që bien shira me intensitet të lartë. Si rrjedhojë, kanali i bllokuar shkakton përmbytje banesash dhe toke bujqësore	Rrëshqitja e dheut si dhe nga ndërtimi i urave nga banorët për të hyrë në banesë
		Dy ura po në fshatin Bitaj	Rihabilitim të urave mbasi rrezikojnë të shemben për shkak të gërryerjeve	Gërryerje të dheut
	Rrapëz (Sektor) dhe Rrapëz (fshat)		Studim për hapjen e kanalizimeve të reja për zonën urbane pasi ka disnivel toke dhe, në ditë me rreshje, ndodhin përmbytje banesash si dhe pellgje me ujë në qëndër të fshatit për	Mungesë kanalizimesh

			arsye se mungojnë kanalizimet.	
	Fshati Ardenicë	.	Zhbllokim i kanalit të ujërave të larta për shkak se rrezikohen shtëpitë e banorëve nga rrëshqitja e dherave	Bllokim kanali nga rrëshqitja e dherave
Bubulli më	Fshati Bubullimë	Në hyrje të fshatit në kolektorin kryesor që vjen nga Gjaza, i cili tek rrethrrotullimi i Kolonjës është i ngushtuar para urës së autostradës Lushnjë- Fier.	Zgjerimi dhe thellimi i këtij kanali në gjatësi rreth 30 ml për shkak se rrezikojnë të përbyten sipërfaqe të mëdha toke si rezultat i ngritjes së nivelit të ujit në këtë kolektor	Ngushtim i kolektorit kryesor
		Në të njëjtin kolektor (kolektorin kryesor), rreth 600 ml nga Ura e Bubullimës	Heqja e blloqeve të betonit me vinç sepse ngushtojnë seksionin e tij dhe e bllokojnë	Ngushtim seksioni nga rënia e disa blloqeve të betonit
Fiershegan	Fshati Jeta e Re	Lugu (urë kanal) që kalon mbi degën ujitëse	Riparim i lugut mbasi është dëmtuar	
		Përroi që kalon në Fshatin Jeta e Re	Pastrim dhe thellim të Përroit mbasi është i mbushur me ledh. Në këtë mënyrë, përroi do të kalojë sërish në rrjedhën e vet	Mungesë pastrimi
	Fshatrat Sejmens Thanë, Barbullinjë etj.	Kanalet kulluese të dyta e të treta	Pastrim të kanaleve kulluese të dyta e të treta mbasi ndodhin vazhdimisht përmbytje të tokave bujqësore	Mospastrim të kanaleve
Allkaj	Fiershegan-Toshkëz	kanali kryesor që kalon përgjatë rrugës Fiershegan-Toshkëz	Pastrim sistematik të kanalit (1 herë në 3 vjet). Mungesa e pastrimit të këtij kanali shkakton përmbytjn e shtëpivë në fshatin Çukas i Ri si dhe një numër të konsiderueshëm serash në fshatin Toshkëz.	Nevojë për mirëmbajtje (pastrim) të vazhdueshme
	Fshati Lifaj i Ri	Kanali që përshkon këtë fshat (gjatësi 1.2 km)	Pastrim kanali mbasi mospastrimi i kanalit që përshkon këtë fshat me gjatësi 1.2 km përmbyt shumë shtëpi të këtij fshati.	Nevojë për mirëmbajtje (pastrim) të rregullt
	Fshati Allkaj	Kanali kryesor kullues që përshkon këtë fshat (në gjatësi 2.6 km)	Pastrim kanali mbasi mospastrimi i kanalit kryesor kullues në këtë fshat (në gjatësi 2.6 km) shkakton përmbytje të tokave bujqësore në sipërfaqe të mëdha.	Nevojë për mirëmbajtje (pastrim) të rregullt
	Argjinatura e Lumit Seman	Në kufi më fshatin Toshkëz	Studimi për ndërtimin e një paneli në kufi me fshatin Toshkëz për shkak se është dëmtuar	Dëmtim i panelit të Lumit Shkumbin, në kufi më fshatin Toshkëz
		Fshati Zhelizhan	Ndërtimi i dy paneleve në këtë fshat si dhe rikonstruksioni i dy paneleve ekzistuese	Mungesë panelesh e dëmtimi i paneleve egzistuese
		Në gjithë	Pastrim sistematik nga ferrat dhe	Mbipopullim i

		argjinaturën e Lumit Seman	shkurret.	ferrave e shkurreve

Burimi: Sektori i Emergjencave Civile Lushnjë në Bashkëpunim me NJA-të Lushnjë

Siç vihet re nga tabela e mësipërme, nëse pasojat e përmbytjeve nuk mund të shmangen tërësisht, ato mund të zbuten ndjeshëm në rast se do të merren masa serioze për mirëmbajtjen e sistemit të kanaleve të kullimit, menaxhimin e duhur të lumit Shkumbin, Seman dhe të përrenjve kryesorë në Bashkinë Lushnjë dhe bashkitë përreth dhe për ndërtimin e paneleve mbrojtëse në rastet kur është e nevojshme.

6.5.2 Masa për mbrojtjen e tokës bujqësore

Duke parë rëndësinë e veçantë që ka sektori i bujqësisë në Bashki, është e rëndësishme që të investohet për mbrojtjen e tokën në përgjithësi dhe tokës bujqësore në veçanti. Në këtë rast, krahas masave të propozuara në PPV-në e Bashkisë Lushnje, rekomandohet që Bashkia të marrë një sërë masash të tjera të cilat janë renditur më poshtë:

- Ruajtja ose mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimet: Bashkia e Lushnjes është përgjegjëse për nxjerrjen e vendimeve të detyrueshme në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore. Veprimtari të tilla si ndërtimi mbi tokë bujqësore ndalohen me ligj (Nenet 10 dhe 14 i Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore").
- Ndalimin e çdo zënie ose përdorimi të paligjshëm të tokës në territorin e bashkisë në zbatim të Ligjit nr. 7501 "Për Tokën" i ndryshuar, Neni 21. Për këtë arsye, rekomandohet që Bashkia e Lushnjes të marrë masa për kontrollin e vazhdueshëm për parandalimin e ndërtimeve të paligjshme në tokat bujqësore.
- Studime të mirëfillta mbi erozionin duke përdorur modele bashkëkohore për parashikimin e erozionit të shkaktuar nga uji (përdorimi i ekuacionit universal për humbjen e dherave-USLE ose parashikimi i erozionit nga shiu-WEPP[338]) ose nga era në të gjithë sipërfaqen e bashkisë me qëllim përcaktimin e shkallës/shtrirjes së erozionit në të gjithë territorin. Kjo ndihmon i) për të planifikuar më mirë menaxhimin e tokës, ii) për të vlerësuar më mirë pasojat që vijnë nga mënyrat e ndryshme të punimit të tokës (me përmbysje të dheut në 100% të sipërfaqes së tokës, pa shkulje të bimësisë së kultivuar në stinët e mëparshme me qëllim mbrojtjen e tokës, etj.), iii) për të përcaktuar respektimin e standardeve për mbrojtjen e mjedisit, iv) për të zhvilluar plane për kontrollin e sedimentit në projekte ndërtimi, v) si dhe për të llogaritur vitet që nevojiten për mbushjen e kanaleve dhe digave me sediment.
- Hartimin e një Plani Veprimi për Informimin e Bujqërve për praktikat e mira bujqësore me qëllim uljen e erozionit në toka bujqësore dhe rritjen e prodhueshmërisë së tokave. Praktika të tilla synojnë:
  - Punimin e tokës, duke e trazuar sa më pak atë (ku gjatë punimit të tokës më shumë se gjysma e mbetjeve bimore të kultivimeve të mëparshme lihen të paprekura në vend, që të kalben).
  - Shmangien e lënies së tokës të zhveshur ose pa bimësi ndërmjet të mbjellave ose gjatë stinës së kultivimit. Kjo mund të arrihet nëpërmjet mbjelljes së bimëve me funksion veshjen/mbulimin e sipërfaqes së tokës. Një shembull është mbjellja e bimëve foragjere / legumeve

(ose bimë të tjera me funksion mbulimin e tokës) ndërmjet rreshtave të vreshtave, pemëve, ulishtave ose të gjitha atyre kulturave ku bimët mbillen në rresht si kultura e misrit, etj. Këto bimë mund të mbillen jo vetëm ndërmjet rreshtave gjatë stinës së kultivimit por edhe ndërmjet stinëve të kultivimit. Në të dyja rastet, këto bimë garantojnë mbulimin e tokës e, si rrjedhojë, shmangien e erozionit.

› Mbulimin e sipërfaqes së tokës me një shtresë të hollë copash të grimcuara bimësh ose druri në rast se nuk kultivohet. Kjo ndosh në rastet kur mbjellja e dy ose më shumë kulturave njëkohësisht nuk është mënyrë e përshtatshme. Shtresa mbuluese, duke qenë me bazë bimore, shërben jo vetëm për ruajtjen e tokës nga erozioni por edhe për rritjen e prodhimtarisë së tokës, përmirësimin e shëndetit dhe ndalimin e rritjes së bimëve të egra në të.

› Mbështetjen e fermerëve për mbjelljen e kulturave që shërbejnë edhe për mbrojtjen e tokës (kalimi nga kultura bujqësore në foragjere/bar ose lënia e tokës pyll) sa herë që paraqitet nevoja, kryesisht në zonat kodrinore me rrezikshmëri të lartë erozioni. Sigurisht që ky ndryshim përdorimi i tokës kërkon investime nga shteti për kompensimin e fermerëve.

› Stabilizimin e zonave nën ndikimin e erozionit në sipërfaqe të sheshta dhe të erozionit të shkaktuar nga shiu, të cilat kanë krijuar kanalizime të parregullta për ujin në tokat e punuara.

› Në zonat kodrinore: Trajnimin e fermerëve për futjen e mënyrave të kultivimit të tokës që e mbrojnë atë nga erozioni dhe që në të njëjtën kohë, ruajnë lagështinë e tokës. Disa nga këto mënyra përfshijnë tarracimin e kodrave, kultimin e zonave kodrinore me drejtim përreth kodrës dhe jo nga lart-posht e anasjelltas dhe krijimin e kanaleve të veshura me bar[339].

Figura 105. kultivimi i kodrave me drejtim përreth kodrave



Source: FAO[340]

- Investime në bujqësi që synojnë mbrojtjen e mjedisit, sipas standardeve të BE-së. Investimet në bujqësi duhet të synojnë edhe mbrojtjen e tokave të brishta /të pjerrëta *ndaj erozionit, gërryerjes, etj*. Në shumë fshatra ose zona kodrinore, popullsia është e detyruar të kultivojë tokat e brishta në pronësi të saj për arsye ekonomike. Kultivimi kryhet edhe në rastet kur tokat janë tejet të

ndjeshme ndaj erozionit e gërryerjes (për shkak të shiut dhe erës). Me qëllim shmangien e degradimit të këtyre tokave nga kultivimi, rekomandohet që Bashkia të investojë në bujqësi dhe në veçanti të nxitë pronarët e tokave të ndjeshme, që të mos i punojnë ato në këmbim të kompensimit të tyre.

- Mbikqyrja e punës për përmirësimn e zonave të gërryera në tokat bujqësore: Për problemet me erozionin në toka bujqësore, rekomandohet që Bashkia të drejtojë dhe të mbikqyrë punën për përmirësimn e zonave të gërryera në tokat bujqësore, në zbatim të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor, i ndryshuar" Neni 7.

Tabela 89. Projektet e planifikuara në PPV për mbrojtjen e tokës

Qëllimi	Masa	Projektet
Masa kundër degradimit të tokës	Rihabilitimi i sistemit ujitës-kullues	- Hapja e qendrave të informimit bujqësor pranë 11 njësive administrative të Bashkisë Lushnje - Nxitja e konsolidimit të fermave bujqësore përmes skemave mbështetëse vendore dhe qendrore - Pastrimi i kanaleve të para dhe të dyta nga mbetjet dhe aluvionet e grumbulluara në 11 njësitë administrative - Ndërtimi i sistemit të ujitjes në LiNjat e Krutjes dhe Tërbufit - Rehabilitimi i dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale në Zonën ekonomike e Plastmasit - Rehabilitimi i dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale të Bashkisë në të cilin përfshihen: Zona ish-Industriale në fshatin Plug, Zona ekonomike e ish fabrikës së dyshekëve - Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në tokat e kripura pranë By-Passit të Lushnjes - Ndërtimi i Impiantit të Kompostimit të mbetjeve në fshatin Murriz-Peqin - Ndërtimi i stacionit të transferimit të mbetjeve në tokat e kripura në Plug - Rehabilitimi i Kodrës së Lushnjes nëpërmjet metodës së ripyllëzimit
	Lufta kundër erozionit	
	Pastrimi nga ndotja	

Burnimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

6.6 Masa për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave

Mirëadministrimi i pyjeve dhe kullotave nga Bashkia Lushnje, sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejtë suksesit për përmirësimin e gjendjes aktuale në sipërfaqen e fondit pyjor e kullosor.

Me qëllim mbarështimin dhe përmirësimin e zonave pyjore e kullosore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Lushnje ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor i cili është në fazë miratimi. Masat për mbarështimin e pyjeve në territorin e Bashkisë përfshijnë krijimin e parqeve rajonale e urbane dhe rihabilitimin e zonave riparianë përgjatë gjatësive të lumenjëve në territorin e Bashkisë.

Në funksion të mbarështimit dhe qëndrueshmërisë së sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, krahas masave të propozuara në PPV, në territorin e Bashkisë Lushnje rekomandohet:

- Inventarizimi i fondit pyjor e kullosor në mënyrë që të dihet sipërfaqja aktuale. Siç është theksuar më parë, të dhënat zyrtare rreth fondit pyjor e kullosor janë të vitit 1984-1985 kur është kryer inventari i fundit i këtij fondi.
- Hartimi i Planit të Mbarshtimit të pyjeve e kullotave i cilë është detyrim ligjor për Bashkinë, që buron nga ligji nr. 9385/2005"Për pyjet dhe shërbimin pyjor". Duke qënë se në territorin e Bashkisë Lushnje nuk njihen mirë kapacitetet që kanë kullotat për t'u shfrytëzuar, lind nevoja edhe për hartimin e Planit të Mbarështimit të Kullotave, i cili do të mundësojë njohjen e kapaciteteve të kullotjes në territorin e bashkisë dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre.
- Hartimi i Planit të monitorimit & kontrollit të pyjeve dhe kullotave me qëllim zbatimin e ligjit dhe shmangjen e demtimeve në territor.
- Përmirësimin e infrastrukturës rrugore të pyjeve dhe kullotave (rrugë aksesi), të cilat janë jetike për ndërhyrje në rastet e rënies së zjarrit në pyje, kryesisht në NjA-në Hysgjokaj dhe Karbunarë.
- Zgjidhja e konfliktit Pyje –Bujqësi. Ky konflikt është theksuar vitet e fundit për shkak se pemtaria është shndërruar në sektor fitimprurës për banorët. Në këtë rast rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me popullsinë, të përcaktojë se deri në cilën shkallë lejohet zhvillimi i pemtarisë në dëm të sipërfaqeve pyjore.
- Monitorimi dhe zbatimi i moratoriumit të shfrytëzimit të pyjeve.
- Masa të tjera: në sipërfaqet e fondit pyjor është e nevojshme të ndërmerren disa hapa për përmirësimin e gjendjes së pyjeve dhe kullotave. Të tilla mund të jenë:
    - Kryerja e një studimi të hollësishëm me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë shkaktuar tharjen e llojeve të bimësisë në seksione të ndryshme në territor.
    - Studim i hollësishëm për përcaktimin e mundësisë së rehabilitimit të sipërfaqeve të djegura, që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale.
    - Mbajtja nën kontroll e sëmundjeve (koncesionares) dhe dëmtuesve, ku shkalla e prekjes është më e madhe se kufinjt kritikë të lejueshëm.
    - Marrja e masave për parandalimin e zjarreve, si krijimi i një rrjeti për njoftimin e rënies së zjarreve (barinjtë mund të luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në këtë rast), ndërgjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënien përpara përgjegjësisë të gjithë kundravajtësve që shkaktojnë zjaret, etj.

Tabela 90. Projektet e planifikuara në PPV për shtimin e zonave pyjore

Qëllimi	Masa	Projektet
Marshtimi i pyje	Krijimi i parqeve	- Hartimi dhe marketimi i paketave turistike për promovimin e turizmit në bashkëpunim me aktorë privatë dhe NGO - Ndërtimi i parkut periferik të qytetit të Lushnjes - Rehabilitimi dhe pyllëzimi i brezit mbrojtës të argjinaturës së Lumit Seman - Krijimi i korridoreve vegjetative në tokën bujqësore - Rehabilitimi i Kodrës së Lushnjes nëpërmjet metodës së ripyllëzimit
	Rehabilitim i zonave ripariane	

Burnimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

6.7 Masa për rihabilitimin e zonave të nxehta mjedisore

Në territorin e Bashkisë Lushnje hasen disa pika të nxehta mjedisore, të cilat përbëjnë një rrezik për ndotjen e mjedisot dhe për qytetarët që jetojnë në afërsi të këtyre zonave (Shih seksionin e zonave të nxehta mjedisore). Ndër më problematiket të evidentuara është venddepozitimi i mbetjeve urbane, zona e pus-shpimeve të naftës dhe zonat ish industriale në territorin e bashkisë të cilat kanë stok më elementë kimik, të cilët paraqiten një rrezik për mjedisin dhe për qytetarët. Në këtë situatë shihet e nevojshme marrja e disa masave, disa prej tyre mund të jenë:

Me qëllim përmirësimin e vatrave të nxehta mjedisore dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të saj, Bashkia Lushnje ka parashikuar marrjen e disa masave në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) i cili është në fazë miratimi. Masat për për rehabilitimin e vatrave të nxehta mjedisore në territorin e Bashkisë përfshijnë (Tabela 91) rehabilitimin e ish-zonave industriale, trajtimin e ujërave të ndotur dhe rehabilitimin e fushës së mbetjeve.

Në funksion të uljes së ndikimit negativ mjedisor të vatrave të nxehta mjedisore dhe rehabilitimin e tyre, krahas masave të propozuara në PPV rekomandohen edhe masa të tjera, si:

- Rihabilitimi i venddepozitimit të vjetër me qëllim shmangien e ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësorë nëpërmjet shllamit që krijohet nga shpërbërja e mbetjeve.
- Hartimi i një plani për venddepozitimin / trajtimin e mbetjeve të rrezikshme që planifikohet të grumbullohen nga rihabilitimi i vatrave të nxehta (zona ish-industriale në fshatin Plug). Mbetjet e depozituara në këto vatra të nxehta mjedisore janë kryesisht të krijuara nga hidrokarburet. Rrjedhimisht, marrja e masave paraprake për trajtimin dhe depozitimin e tyre përfundimtar është e pashmangshme, në mënyrë që mos të krijohet një tjetër vatër e nxhehtë mjedisore (kjo nisëm realizohet në bashkëpunim me organet e pushtetit qendror, për arsye se mbetjet industriale nuk menaxhohen nga Bashkia).
- Ndërtimi i një stacioni trasferimi për mbetjet industriale, kryesisht mbetjet e krijuara nga industria e naftës, deri në një moment të dytë, kur institucionet përkatëse të japin një zgjidhje përfundimtare për depozitimin e tyre përfundimtar.
- Marrja e masave për parandalimin e ndotjes së mjedisit gjatë rehabilitimit të zonave të mbrojtura. Më konkretisht, rekomandohet transportimi i dheut të hequr pa u depozituar fillimisht në zonat përreth duke shmangur kështu

ndotjen e zonës, përdorimin e makinerive të përshtatshme, shmangien e incidenteve, që mund të ndodhin nga grumbullimi i mundshëm i gazit në shtresat e poshtme të mbetjeve të depozituara, etj.

- Hartimi i një programi për shfrytëzimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (veçanërisht ato nëntokësoer) që përdoren në proceset e shpimit të puseve nga industria naftë-nxjerrëse**.** Hartimi i programit mundëson pasjen e një pasqyre të qartë mbi pikat e shfrytëzimit të ujërave dhe llogaritjen e bilancit të tyre, me qëllim shmangien e ndikimeve të padëshirueshme në të ardhmen në NjA Bubullime dhe Kolonjë (mungesë të rezervave ujore, probleme me uljen e tabanit të tokës, etj.)
- Të hartohen rregullore dhe të vlersohen specifikisht (për çdo pus) ri-injektimi i ujërave të "prodhuar" (ujërat e nxjerra nga puset e naftës, të cilat përdoren gjatë proceseve të ndryshme). Ri-injektimi është një depozitim përfundimtar i ujërave të prodhuar nga puset e naftës, mos studimi apo studimi i cekët i këtij procesi çon në dëmtimin (ndotjen) e trupave ujore nëntokësore.
- Të rehabilitohen dhe të mirëmbahen puset që nuk shfrytëzohen, të hartohen rregullore për mënyrën e izolimit të puseve që nuk shfrytëzohen dhe të respektohet distanca e zonës sanitare të tyre.

Tabela 91. Projektet e planifikuara në PPV për rehabilitimin e vatrave të nxehta mjedisore

Qëllimi	**Masa**	**Projektet**
Rehabilitimi i vatrave të nxehta mjedisore	Rehabilitimin e ish-zonave industriale	- Rehabilitimi i dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale në Zonën ekonomike e Plastmasit - Rehabilitimi i dhe krijimi i rrjetit të qendrave ekonomike/industriale të Bashkisë në të cilin përfshihen: Zona ish-Industriale në fshatin Plug, Zona ekonomike e ish fabrikës së dyshekëve - Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në tokat e kripura pranë By-Passit të Lushnjes - Rehabilitimi i fushës së mbetjeve dhe kthimi i saj në zonë të gjelbër - Pastrimi i tre vatrave të nxehta mjedisore në qytetin e Lushnjes
	Pastrimin e vatrave të nxehta	
	Trajtimi i ujërave të ndotura	
	Rehabilitimi i fushes së mbetjeve	

Burnimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

6.8 Masat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe historike

Në Bashkinë e Lushnjes në kategorinë e monumenteve të kulturës përfshihen dy monumente të një rëndësie të veçantë kulturore, Manastiri i Ardenicës dhe banesa e Kongresit të Lushnjes. Për të gjitha objektet, pasuri historike dhe kulturore rekomandohet që Bashkia Lushnje të marrë disa masa për mbrojtjen e tyre, si më poshtë:

- Hartimi i rregullores për zonën e mbrojtur Manastiri i Ardenicës, në mënyrë që të mbrohet nga ndërtimet, që mund t'i afrohen jashtë kontekstit mesjetar që ky objekt mbart.
- Restaurimi dhe rikonceptim i Banesës së Kongresit të Lushnjes për shkak të veçorive të saj historike dhe vendndodhjes në krahasim me qytetin e Lushnjes. Duhet të vendoset zona mbrojtëse, e cila do e ruajë këtë ndërtesë nga fenomenet e ndërtimit apo shtesave ndërtimore në ndërtesat pranë saj.

- Vlerësimi arkeologjik për zonat me rëndësi arkeologjike (Qyteza e Babunjës) në mënyrë që të hartëzohet zona e mbrojtur arkeologjike bazuar në ligjin e trashëgimisë.
- Miratimi i sipërfaqeve mbrojtëse rreth ndërtimeve të kultit dhe urave antike, që gjenden në Bashkinë e Lushnjes, në mënyrë që të ndalohet ndërtimi i objekteve pranë tyre duke krijuar kështu dhe mbrojtjen peizazhistike.

7. Plani i veprimit për zbatimin e masave mbrojtëse mjedisore

7.1 Plani i veprimit: monitorimi, treguesit e vlerësimit e institucionet e monitorimit

Plani i Përgjithshëm Vendor përbëhet nga projekte specifike nëpërmjet të cilave synohet disiplinimi i tipologjisë së funksionimit hapsinor dhe plotësimi i nevojave të Bashkisë Lushnje me të gjithë përbërësit fizikë, infrastrukturorë dhe natyrorë. Duke iu referuar Ligjit nr. 10431të datës 09/06/2011"Për Mbrojtjen e Mjedisit", në rastet kur janë parashikuar ndërhyrje fizike në territor, PPV-ja shoqërohet edhe me Planin e Monitorimit të Mjedisit, i cili siguron respektimin dhe realizimin e Objektivave të Mbrojtjes së Mjedisit që janë kryesisht:

- Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes në ujë, ajër, tokë dhe e ndotjeve të tjera të çdo lloji,
- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe biodiversitetit,
- Planifikimi i përdorimit të pasurive natyrore me synim zhvillimin e qëndrueshëm dhe të ekuilibruar,
- Përdorimi i qëndrueshëm dhe i zgjuar i burimeve natyrore,
- Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore, estetike, peizazhistike dhe natyrore,
- Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit publik.

Me ***Monitorim Mjedisor*** nënkuptohet "Programi i matjeve sistematike, vëzhgimit dhe raportimit të treguesëve mjedisorë". Plani i monitorimit të mjedisit hartohet si dokument themeltar i bazuar në detyrimet ligjore që kanë për synim mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit në një nivel të lartë, me qëllim parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

Monitorimi i mjedisit në vendin tonë bazohet në Ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 "për mbrojtjen e mjedisit", neni 19 "Mbrojtja e natyrës"; neni 41 "Monitorimi i gjendjes së mjedisit"; neni 45 "Qëllimi dhe funksionimi i sistemit të informacionit mjedisor dhe, nenit 60 mbi "Funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit". Proçedurat dhe rregullat e monitorimit përcaktohen në VKM nr.1189 të datës 18/11/2009 "Për rregullat dhe proçedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" dhe në Planin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, 2015. Monitorimi kryhet edhe në kuadër të detyrimeve që i lindin vendit tonë si rrjedhojë e marrjes së statusit të vendit kandidat në Bashkimin Europian, konkretisht, zbatimit të nenit 108 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) për "Zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër degradimit mjedisor" në zbatim të të cilit, Ministria e Mjedisit ka krijuar Sistemin e Integruar të Monitorimit të Mjedisit (SIMM). Mbështetur në elementët e këtij sistemi është hartuar edhe Plani Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit.

Plani i Monitorimit të zbatimit të PPV-së përcakton treguesit mjedisor mbi të cilët do të bazohet monitorimi, shpeshtësia e monitorimit sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe institutet përgjegjëse për monitorimin e gjendjes në mjedis. Sipas legjislacionit në fuqi, ***treguesit mjedisorë*** janë "ndryshorja që jep në mënyrë të përmbledhur dhe të

thjeshtë, të dhëna për një dukuri mjedisore duke e bërë atë të perceptueshme nëpëmjet vlerësimit numerik nga matjet përkatëse". Dukuritë mjedisore lidhen me cilësinë e mjedisit, konkretisht të përbërësve të tij, shkarkimet në mjedis, ndotjen aktive, shkallën e dëmtimit dhe ruajtjes apo edhe masave të marra. Monitorimi/Matja e treguesve të mjedisit është proces shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për të patur një pasqyrë të qartë të gjendjes së mjedisit me qëllim përcaktimin e shkaqeve/origjinës së problematikave dhe zgjidhjen e tyre. Monitorimi i treguesve të mjedisit kryhet veçanërisht gjatë zbatimit të projekteve të parashikuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

Plani i Monitorimit të zbatimit të PPV-së ka përcaktuar edhe institucionet përgjegjëse të cilat do të duhet të monitorojnë treguesit mjedisorë për vlerësimin dhe zbatimin e masave të parashikuara në VSM sipas fushave të përgjegjësisë përkatëse. ***Institucionet përgjegjëse*** përfshijnë "institutet, laboratorët e qëndrat kërkimore-shkencore private e publik të kontraktuar nga Ministria e Mjedisit për të kryer monitorimin e treguesëve konkretë të dukurive natyrore të cilësisë". Insitucionet shtetërore, qoftë në nivel kombëtar apo edhe rajonal si Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Rajonale e Mjedisit, Inspektoritati Mjedisor, Drejtoria e Mjedisit në Bashkinë Lushnje do të nevojitet të bashkërendojnë punën në mënyrë që të realizojnë inspektimet në terren për mbarëvajtjen dhe rrespektimin e kushteve të pëlqimeve apo lejeve mjedisore të projekteve.

Më poshtë është paraqitur Plani i veprimit, monitorimi dhe treguesit e vlerësimit për PPV-në e Bashkisë Lushnje.

Tabela 92. Programi i monitorimit të mjedisit gjatë zbatimit të projekteve të PPV-së

Nr.	Objektivi Mjedisor	Treguesi Mjedisor	Autoriteti Monitorues	Parametrat Fizik	Frekuenca e Monitorimit
1.	Toka	▪ Pjelloria (ushqyesit e tokës) ▪ Ndotja (metalet e rënda dhe përbërsëit organikë). ▪ Sipërfaqja bujqësore/natyrore/kullosore e humbur nga fondi bujqësor, për shkak të ndryshimit të përdorimit të saj (për ndërtime, infrastrukturë, etj. ▪ Sipërfaqa e tokës së trazuar/degraduar (gërryer, rrëshqitur). ▪ Sasia mujore e tokës së humbur nga erozioni. ▪ Sipërfaqa e tokës e përdorur si venddepozitim i përkohshëm gjatë punimeve. ▪ Lloji dhe kohëzgjatja e teknologjisë së përdorur për mbrojtjen e dheut të depozituar në venddepozitimin e përkohshëm nga erozioni i shkaktuar nga era dhe shiu. ▪ Gjatësia e burimeve ujore që preken drejtpërsëdrejti nga erozioni i tokës ku zbatohet një projekt. ▪ Lloji i teknologjisë që përdoret për parandalimin e erozionit në burime ujore. ▪ Shkarkimet industriale në tokë nga mjetet e rënda. ▪ Rivitalizimi tokave djerr.	▪ Instituti i Shëndetit Publik ▪ Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit ▪ Inspektoriati i Mjedisit ▪ SHGJSH ▪ Dr. Rajonale e Bujqësisë ▪ Minitria e Bujqësisë ▪ Min. e Transporteve ▪ Bashkia (Dep. Mjedisit) ▪ AKM dhe ARM ▪ Roja e Gjelbër ▪ Policia Bashkiake/ Policia e Shtetit ▪ Bashkia Lushnje ▪ Ministria e Mbrojtjes ▪ Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti Politeknik – Inxhinieria e Mjedisit, Fakulteti i Gjeologji – Minieriave ▪ Instituti i Fizikës Bërthamore ▪ IGJEUM	▪ Na, Cl, SO_4, trashësia humusore, raporti Mg/Cl, aciditeti, raporti N/C, metalet e rënda ▪ Sasia e tokës së humbur (ton/km^2) ▪ Sasia e naftës në mjedis ▪ Nr. dhe lloji i fragmentimit ▪ Vlera e tokës djerr ▪ Përqëndrimi i kimikateve dhe pesticideve në tokat bujqësore ▪ Sipërfaqet e dëmtuara nga shkarkimet të ndryshme dhe depozitime të mbetjeve urbane e industriale ▪ Shkalla e pjelloris në raport me të dhënat kombëtare	▪ 10 vende, 2 herë /vit ▪ Raportim 12 herë / vit ▪ Analizat bilogjike dhe kimike të tokës, 4 herë / vit
2.	Uji	▪ Cilësia ujërave sipërfaqësore ▪ Cilësia e ujërave nëntokësore ▪ Cilësia e ujërave për ujitje ▪ Pikat e shkarkimit të ujërave të ndotura industriale. ▪ Pikat e shkarkimit të ujërave të ndotura	▪ Autoriteti i Menaxhimit të Baseneve Ujore ▪ Instituti i Hidrometrologjisë ▪ Instituti i Kërkimeve Biologjike ▪ Fakulteti i Shkencave të	▪ NBO_5 ▪ NKO ▪ Metalet e rënda (Pb, Zn, Cu, Ni, Co, Cr, Cd, etj.) ▪ Aciditeti ▪ Pehashi (pH)	▪ Ngritja e 4 stacioneve të monitorimit (2 për lumin Osum dhe 2 për Devollin)

		urbane ▪ Cilësia e ujit për konsum publik ▪ Koefiçenti i shfrytëzimit të ujit ▪ Niveli i trajtimit të ujërave të ndotura ▪ Popullsia e lidhur me sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura ▪ Disiplinimi i ujërave të larta	Natyrës ▪ Këshilli Teknik i Ujit ▪ Agjencia Kombëtare e Mjedisit ▪ Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ▪ Instituti i Shëndetit Publik ▪ Instituti i Gjeoshkencave Enegjisë, Ujërave dhe Mjedisit ▪ Ministira e Bujqësisë dhe Administrimit të Ujërave ▪ Ministria e Mjedisit	▪ Koefiçenti i shfrytëzimit të ujërave të ëmbla ▪ Temperatura ▪ Mineralizimi ▪ Fortësia ▪ Mbetjet e thata ▪ Përmbajtja e natriumit, kalciumit, natriumit, magnezit, amoniakut, klorit, sulfateve ▪ Përmbajtja e nitriteve dhe nitrateve ▪ Përmbajtja e pesticideve ▪ Niveli statik dhe dinamik i ujërave nëntokësore ▪ Përcjellshmëria ▪ HCO_3 dhe CO_3	▪ Monitorim 2 herë në muaj të rezervuarëve të ujërave të ëmbla ▪ Monitorim 2 herë në muaj për depot e ujit të pijshëm dhe pusshpimeve. ▪ 12 herë në vit për ujërat nëntokësore ▪ 4 herë në vit mbi cilësinë e ujërave për bujqësi
3.	Ajri	▪ Sasitë vjetore të shkarkimeve në qëndrat urbane ▪ Shpërndarja e shkarkimeve (trëndafili i erës) ▪ Sasia vjetore e elementëve të rëndë ▪ Vëllimi vjetor i reshjeve ▪ Niveli i grimcave PM në ajër ▪ Niveli i gazit sulfurik në ajër ▪ Cilësia e ajrit në 5 pikat kryesore të qytetit ▪ Cilësia e ajrit në qëndrat e NjA-ve ▪ Shkarkimet nga transporti ▪ Rregjistër i shkarkimeve nga industria ▪ Gjëndja e filtrave dhe sistemeve të shkarkimit nga industria e rëndëdhe sektori privat. ▪ Ditët nën trysni nga shkarkimet industriale dhe nga transporti ▪ Krijimi i inventarit të shkarkimeve	▪ Agjencia Kombëtare e Mjedisit ▪ Agjencia Rajonale e Mjedisit ▪ Drejtoria e Mjedisit në Bashki ▪ Ojf-të ▪ Ministria e Mjedisit ▪ Inspektoriati i Mjedisit ▪ Fakulteti i Shkencave të Natyrës ▪ Universiteti Politeknik – Inxhinieria e Mjedisit ▪ Fakulteti i Gjeologji – Minieriave ▪ Instituti i Fizikës Bërthamore ▪ IGJEUM	▪ $PM_{2.5}$ dhe PM_{10} ▪ SO_X ▪ NO_X ▪ GHG ▪ Pb ▪ CO dhe CO_2 ▪ CFCs ▪ Vizibiliteti ▪ Shkalla e errësimit ▪ Dioksina dhe furanet ▪ Benzenet C_6H_6 ▪ Ozoni O_3	▪ Ngritja e stacioneve të përhershme të monitorimit. ▪ Monitorim në kohë reale i cilësisë së ajrit

4.	Pyjet	▪ Përcaktimi i taksonometrisë ekzistuese. ▪ Realizimi i inventarit ▪ Rritja vjetore sipas llojeve ▪ Sasia vjetore e vjelur ndarë në lëndë për përpunim dhe dru zjarri ▪ Sasia e biomasës ▪ Sipërfaqet e dëmtuara nga zjarri e stuhia, etj. ▪ Llojet e rrezikuara ▪ Pyje të shëndetshme/sëmura ▪ Identifikimi i tipologjisë dhe origjinës së sëmundjes ▪ Mirëmbajtja në Zona Natyrore ▪ Kullotat ▪ Ripyllëzim i zonave të dëmtuara ▪ Gjendja e tokës në sipërfaqet e fondit pyjor	▪ Drejtoria e Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë ▪ Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve ▪ Roja e Gjelbër ▪ Njësitë Administrative ▪ Universiteti Bujqësor ▪ Bashkia ▪ Ministria e Mjedisit ▪ Ojf-të	▪ Niveli i riprodhimit ▪ Tipet e pemëve ▪ Nr. total / Mosha / Statusi ▪ Tipi i sëmundjes ▪ Sipërfaqe për mbushje ▪ Sipërfaqe për riprërëritje ▪ Plan Menaxhimi ▪ Ton/Vit – përpunim ▪ Ton/Vit – Dru zjarri ▪ Raporti C/N, kapaciteti i këmbimit, pehashi,	Inventarizimi, proces që zgjat në varësi të madhësisë së fondit pyjor dhe kullusor. Dixhitalizimi. Monitorimi 12 herë / vit
5.	Biodiversiteti	▪ Identifikimi i habitateve ▪ Larmia e ekosistemeve ▪ Identifikimi i specieve në territorin e Bashkisë ▪ Xhepat natyrorë në sipërfaqet ujore ▪ Shtigjet natyrore ▪ Inventarizimi (të gjitha kategoritë) ▪ Specfikimi i standardeve sipas trajtimit të BE-së ▪ Identifikimi i specive të rrezikuara, të kërcënuara dhe të zhdukura ▪ Shqetësimi nga zhurmat	▪ Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ▪ Administrata e Zonave të Mbrojtura ▪ Drejtoria e Zhvillimit Rajonal dhe Integrimit. ▪ Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve ▪ Ojf-të ▪ Ministria e Mjedisit	▪ Sipërfaqja e zonave të mbrojtura ▪ Sipërfaqja e mbuluar me bimësi natyrore dhe pyje. ▪ Numri i habitateve të identifikuara ▪ Rregjistri i specieve në rrezik dhe atyre endemike të rralla. ▪ Habitate të reja ▪ Statusi i shtigjeve natyrore ▪ Makrofitet ▪ Gjitarë, zogj, zvarranik, amfib ▪ Jovertebrorë ▪ Kërpudhat ▪ Likenet	▪ Çdo muaj 12 herë / vit
6.	Peizazhi	▪ Sipërfaqet e gjelbërta urbane	▪ Inspektoriati Kombëtar i	▪ Sip e gjelbër për banorë	▪ Monitorimi në

		▪ Gjendja e parqeve të bashkisë ▪ Sip. me gjelbërim të infrastrukturës Rrugore ▪ Ripyllëzimi i hapsirave të parashikuara në PPV. ▪ Mbushja e kodrës me pemë prodhuese (Ullishte/Frutorë) ▪ Zonat ripariane përgjatë brigjeve të Lumenjve Osum Devoll e Seman ▪ Korsitë e biçikletave dhe shtigjet e gjelbërta ▪ Dëmtimet nga karrierat dhe guroret ▪ Demtimet nga erozioni, zjarret, shpyllëtzimet ▪	Mbrojtjes së Territorit ▪ Inspektoriati i Mjedisit ▪ Dr. e Urbanistikës ▪ Minitria e Infrastrukturës dhe Transportit si edhe Ministria e Mjedisit ▪ Bashkia (Dep. Mjedisit) ▪ ARM ▪ Drejtoria e Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë ▪ Ojf-të ▪ Roja e Gjelbër ▪ Policia Bashkiake/ Policia e Shtetit	në qytet ▪ Sip e pyllëzuar/park për banorë në Bashki ▪ Sipërfaqet e dëmtuara nga guroret dhe karrierat ▪ Eleminimi i puseve jashtë funksionit dhe rehabilitimi i kullave metalike ▪ Siperfaqet e rehabilituara të zonave ripariane ▪ Brezat e gjelbërimit përgjatë infrastrukturës rrugore ▪ Inventarizimi i problemeve peizazhistike	terren, i vazhdueshëm dhe i përditshëm ▪ Raportimi 4 herë në muaj
7.	Klima	▪ Shkarkimet e gazrave serë. ▪ Shkarkimet sipas burimit të shprehura në njësi matëse dhe % ▪ Energjia e përdorur në territorin e Bashkisë (Konsumi i elektricitetit, gazit, naftës, biomasës, të rinovueshme) ▪ Rregjistri i temperaturës shprehur në cikël 24orë ▪ Rregjistri i rreshejve atmosferike shprehur në mm/ditë ▪ Rrezatimi mesatar diellor ▪ Shpejtësia mesatare e erës km/orë (në ditë) ▪ Niveli i gazit karbonik në atmosferë.	▪ Ministria Mjedisit ▪ Ministria e Ekonomisë dhe Turizmit ▪ Ministria e Energjitikës ▪ Ministria e Bujqësisë dhe Administrimit të Ujërave ▪ ARM – AKM ▪ Fakulteti i Shkencave të Natyrës ▪ Universiteti Politeknik – Inxhinieria e Mjedisit ▪ Fakulteti i Gjeologji – Minieriave ▪ Institui i Fizikës Bërthamore ▪ IGJEUM ▪ Drejtoria e Shërbimit Pyjor – pranë Bashkisë ▪ IKMT ▪ Inspektoriati i Mjedisit	▪ Sasia e gazrave serë çlirar në atmosfer(referuar për çdo sektor) ▪ Konsumi në Këë i energjisë nga elektrike, BER, biomas, naftë dhe gaz. ▪ Të dhënat meteorologjike për Bashkinë Lushnje. ▪ Sasia e reshjeve atmosferike ▪ Temperaturat ditore / mujore / vjetore. Rregjisti ndryshimeve klimatike.	▪Ngritja e stacionit të matjeve metorologjike për Bashkinë Lushnje. ▪Analizimi laboratorik 6 herë në vit i shkarkimeve të gazrave serë në mjedis ▪Monitorim mujor i konsumit të energjisë elektrike ▪Raportim 3-mujor ▪Buletin mujor mbi klimën

			▪ Dr. e Urbanistikës ▪ Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve		
8.	Kultura	▪ Objektet e kultit fetar ▪ Objektet e trashëgimisë kulturore ▪ Objektet e trashëgimisë historike ▪ Pasuritë arkeologjike ▪ Sitet arkeologjike ▪ Trashëgimia arkitektonike dhe mjedisore ▪ Muzeu arkeologjik dhe aulturor ▪ Muzeu industrial ▪ Godina dhe vepra me vlera të larta historike e arkitektektonike.	▪ Ministria e Kulturës ▪ Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë ▪ Shërbimi Arkeologjik Shqiptar ▪ Drejtoria Rajonale e Kulturës ▪ IKMT ▪ Bashkia Lushnje ▪ Instituti i Monumenteve të Kulturës.	▪ Gjendja e objekteve të kultit ▪ Gjendja e objekteve dhe vendeve të trashgimisë historike e kulturore ▪ Inventarizimi i elementëve përbërës, pjesë e trashgimisë kulturore dhe historike ▪ Numri i vizitorëve në këto objekte	▪ Monitorim mujor ▪ Raportim 4 herë në vit
9.	Shëndeti	▪ Jetëgjatësia mesatare e popullsisë ▪ Përmbajtja e hidrokarbureve në ajër ▪ Niveli i zhurmave ▪ Aksidentet në punë dhe në rrugë ▪ Rregjistri i sëmundjeve kardiovaskulare ▪ Rregjistri i sëmundjeve të aparatit të frymëmarrjes ▪ Rregjistri i vdekjeve jonatyrale ▪ Familjet nën minimumin jetik ▪ Disponueshmëria e shërmbimit shëndetësor ▪ Niveli i trajtimit të urgjencave ▪ Disponueshmëria e ilaçeve farmaceutike ▪ Shkalla e ekspozimit të popullsisë ndaj ujërave të ndotura, tokës së ndotur dhe ndotjeve mikrobiologjike	▪ Ministria e Shëndetësisë ▪ Instituti i Shëndetit Publik ▪ Inspektoriati Mjedisor ▪ Inspektoriati i Punës ▪ AKM-ARM ▪ Bashkia Lushnje	▪ Mosha mesatare vjet/muaj/ditë ▪ Nr. i aksidenteve ▪ Nr. i të Sëmurëve (kardio-respirator-toksik) ▪ Statusi dhe niveli i Shërbimit shëndetësor ▪ Mjekimet e munguara ▪ Përbërja mercologjike e ndotjes në Bashki	▪ Monitorim mujor ▪ Raportim 4 herë në vit
10	Socio-Ekonomia	▪ Niveli Arsimit të popullatës ▪ Gjimnazet, shkollat, kopshtet, çerdhet ▪ Shërbimet publike ▪ Të ardhurat mesatare për frymë ▪ Niveli i papunësisë	▪ Ministria e Ekonomisë ▪ INSTAT ▪ Bashkia Lushnje ▪ Prefektura Fier ▪ Zyra e Punsimit	▪ Profesionistët ▪ Teknikët ▪ Zanatçinjtë ▪ Qëndrat e edukimit ▪ Pagat dhe të ardhurat	▪ Monitorim mujor ▪ Raportim 4 herë në vit

Punoi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

7.2 Çështje institucionale, ligjore dhe instrumente që lidhen me monitorimin e mjedisit

Hartimi i Planit të Monitorimit të Mjedisit gjatë zbatimit të projekteve të PPV-së është bazuar në Vendimin Numër 1189, datë 18 nëntor 2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" dhe "Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit për vitin 2015". Ky program parashikon monitorimin e ajrit, zhurmave, ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, tokës, pyjeve e biodiversitetit[341].

Ajri monitorohet në 51 stacione monitorimit të vendosura në 14 qytete, duke përfshirë Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Vlorë, Fier dhe Korçë. Në Bashkinë e Lushnjes nuk ka stacione monitorimi fikse. Monitorimi ndodh rutinë në qytetet me stacione të përhershme dhe në qytetet kryesore ku janë vërejtur tejkalime (Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë, Durrës, dhe Elbasan). Në Bashkinë Lushnje nuk parashikohen monitorime të tilla. Gjithashtu, monitorimi nënkupton edhe shqyrtimin paraprak të niveleve të ndotjes në qytete që nuk mbulohen nga monitorimi sistematik deri më tani (Berat, Lushnje, Gjirokastër, Pogradec, Krujë, Lezhë dhe Sarandë, Laç dhe Kavaje). Parametrat që synohet të monitorohen gjatë viti 2016 sipas Panit të Monitorimit të Mjedisit 2015 (PMM) janë SO_2, NO_2 (NOx), CO, O_3, Benzene, PM_{10} ($PM_{2.5}$) dhe metalet e rënda.

Monitorimi i Ujërave sipërfaqësore (duke përfshirë edhe bio-cilësinë) është parashikuar të kryhet në 54 pika për lumenjtë, 13 për liqenet, 17 për lagunat, 44 për sedimentet dhe 19/81 për ujërat bregdetare (81 stacione për treguesit bakteriologjikë). Parametrat që janë parashikuar të maten përfshijnë parametrat meteorologjike, parametrat hidrologjike, pH, O_2 , kripësia, TOC, PM, lëndë ushqyese (N dhe P), metalet e rënda dhe parametrat organikë bazë. Lidhur me shpeshtësinë e monitorimit, në lumë parashikohet 4 herë në vit për ushqyesit e ujit, 1 herë në vit për kampionët dhe parametrat e tjerë dhe 1 në 3 vite për sedimentet.

Lidhur me ujërat nëntokësore, monitorimi i tyre konsiderohet me përparësi të lartë dhe parametrat që janë parashikuar për matje janë pH, temperatura, TOC, PD, ushqyesit (N dhe P), metalet e rënda, parametrat organikë bazë dhe mikrobiologjikë. Ndërkohë nuk monitorohen parametra me bazë *përbërjet klorure* dhe *PCB*, si dhe *pesticidet* dhe *PAHs* për shkak të mungesës së kapaciteteve të laboratoreve për matjen e parametrave të tillë.

Monitorimi i tokës përfshin 19 vënde. Ushqyesit maten minimumi çdo dy vjet, ndërsa metalet mund të monitorohen në frekuencë të ulët në varësi të kushteve lokale. Parametrat që janë planifikuar për t'u monitoruar janë parametrat fizike, ushqyesit (N dhe P), metalet e rënda dhe organike.

Në PPM është përfshirë edhe monitorimi i pyjeve dhe biodiversitetit. Sipas PPM-së, për vitin 2015, procesi i monitorimit të pyjeve parashikon tregues të kritereve Pan - Europiane C2 dhe C4 dhe në rast mbështetje financiare për treguesin C4.2 ndërsa monitorimi i biodiversitetit përfshin 50 stacione monitorimi.

Institucionet që ngarkohen nga VKM Nr. 1189, Datë 18.11.2009 Për Zbatimin e PKM-së janë Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Trasportit dhe Infrastrukturës, dhe Ministria e Mjedisit.

- Çështje ligjore dhe institucionale me ndikim në monitorimin e mjedisit:

Vitet e fundit, vendi ynë ka bërë hapa të rëndësishëm për monitorimin e mjedisit . Me hartimin e Planit Kombëtar të monitorimin i jep rëndësi identifikimit të problematikave të përbërësve fizikë të mjedisit, me qëllim përmirësimin e gjendjes së tij. Kjo është përkthyer në monitorime me një frekuencë të caktuar kryesisht vjetore në bazë të të cilave pregatitet edhe Raporti i Gjendjes në Mjedis. Sot, ky raport është instrumenti kryesor që paraqet gjendjen reale të mjedisit.

Gjatë zbatimit të PPV-së së Bashkisë Lushnje, do të jetë monitorimi i mjedisit, që do të pasqyrojë ndikimin në shkallë të gjerë të zbatimit të PPV-së në mjedis. Megjithatë, duke patur parasysh se monitorimi i mjedisit ka kufizimet e tij, supozohet që matja e ndikimit real të projekteve të PPV-së në territor gjatë fazës së zbatimit, mund të mos jetë e plotë. Kjo për arsye të ndryshme, të cilat janë shtjelluar më poshtë së bashku me masat që rekomandohet të merren për *përmirësimin e monitorimit të gjendjes në mjedis* në të ardhmen:

Mospajisja me laboratorë e institucioneve të monitorimit të mjedisit: Institucionet përgjegjëse për monitorimin e medisit në vendin tonë janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Trasportit dhe Infrastrukturës si dhe Ministria e Mjedisit (VKM nr. 1189, datë 18.11.2009). Një mangësi që vihet re është fakti se institucionet e ngarkuara me ligj për monitorimin e mjedisit nuk janë të pajisura me laboratorë. Zakonisht, monitorimi i treguesve të dukurive natyrore të cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe të biodiversitetit kryhet nga institucione monitoruese të specializuara, të cilat lidhin marrëdhënie kontraktuale me institutet e monitorimit. Pra, institucionet shtetërore nuk monitorojnë drejtpërsëdrejti gjendjen e mjedisit natyral duke lënë kështu hapësira për vonesa apo mangësi të ndryshme në monitorimin e mjedisit për shkak të procedurave të tenderimit, që nevojitet të ndiqen në rastet e kontraktimit.

Mungesa e laboratoreve me kapacitete për monitorimin e përbërjeve klorure, PCB-ve, pesticideve dhe PAHs: parametra të tillë janë të pranishëm në vendet ku vepron industria e rëndë e cila është e pranishme pothuajse në të gjitha qytetet ose rajonet kryesore të vendit dhe mbi të gjitha në Bashkinë Lushnje. Si rrjedhojë, lind nevoja e monitorimit të vazhdueshëm, sidomos në ujërat nëntokësore, për të patur një pasqyrë të gjendjes së tyre si dhe për të kuptuar ndikimin e ndotësve në shëndetin e njeriut. Duke qenë se shumë nga këto ndotës janë të rrezikshëm për shëndetin e njeriut, monitorimi i tyre është i domosdoshëm. Megjithatë, me gjithë rëndësinë që parametrat në fjalë kanë si tregues të gjendjes së ujërave nëntokësore, nuk monitorohen për shkak të mungesës së kapaciteteve të laboratoreve për të kryer matje të tilla. Në këtë mënyrë, është pothuajse e pamundur të kuptohet se cili është ndikimi i shumë industrive që shkarkojnë ndotës të tillë në shëndetin e popullsisë të zonave përreth.

Numri i kufizuar i pikave të monitorimit: kjo vihet re në monitorimin e pothuajse të gjithë përbërësve fizik mjedisorë si ajri, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, toka, etj. Për shembull, në rastin e ujërave sipërfaqësore, Baseni i lumit Seman i cili përbëhet nga 4 lumenj të rëndësishëm (Seman, Gjanicë, Osum e Devoll) monitorohet vetëm në 10 pika, Baseni i Lumit Shkumbin vetëm në 6 pika ndërsa Baseni i Vjosës (Vjosa dhe Drinosi) vetëm në 8 pika. Ndërkohë, të tre basenet kryqëzojnë vendin tonë nga lindja deri në perëndim. Duke qenë se kalojnë zona të ndryshme me aktivitete të

shumëllojshme, numri i pikave duket i pamjaftueshëm për paraqitjen e gjendjes reale të lumenjve.

Frekuenca e monitorimit të ujërave është e pamjaftueshme: sipas PKM-së, ujërat e lumenjve monitorohen zakonisht 4 herë në vit për ushqyesit e ujit, 1 herë në vit për kampionët dhe parametrat e tjerë, dhe 2 herë në tre vite për sedimente. Duke patur parasysh gjendjen jo të mirë në të cilën ndodhen lumenjtë tanë, shpeshtësia e monitorimit të parametrave të përbërësve fizikë të mjedisit duket e pamjaftueshme. Në vendin tonë, në shumë qytete si i Lushnjes me aktivitet të lartë industrial (nxjerrje dhe rafinim të naftës), monitorimi i ujit nevojitet të bëhet javor ose minimalisht mujor.

Vetëmonitorimi i aktiviteteve të pajisura me leje A dhe B shpesh joreal: sipas Planit të Monitorimit të Mjedisit, personat fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve janë subjekt i lejes mjedisore, monitorojnë treguesit mjedisorë të paraqitur në programet e tyre të vetmonitorimit , në nivel individual. Aktualisht vlen të theksohet se standardet e përdorura për realizimin e monitorimit mjedisor janë relativisht të ulëta, duke konstatuar këtu se shumica e projekteve apo operatorëve të pajisur me një leje mjedisi, realizojnë proçese periodike të vetëmonitorimit, nëpërmjet kontraktimit të laboratorëve të akredituar për realizimin e monitorimit. Këto raporte vetëmonitorimi dërgohen në ARM dhe AKM për shqyrtim dhe thuajse në të gjitha rastet, deklarimet e kryera në këto raporte tregojnë se shkarkimet dhe dëmtimet në mjedis janë gjithnjë minimale dhe brenda normave e standarteve të lejuara.

Mungesa e kompetencave të ARM-së Fier për monitorimin e mjedisit: deri më tani, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 47, datë 29 janar 2014 "Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit e të agjencive rajonale të mjedisit", funksionet e ARM-ve janë të kufizuara kryesisht në *i) dhënien e lejeve të mjedisit të tipit "C"*, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10431, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" dhe *ii) në mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit me të dhëna për instalimet e kategorisë "C",* që ndodhen brenda territorit ku shtrihet fusha e kompetencave të tyre (Kreu V). Me qëllim monitorimin e duhur të mjedisit duke patur parasysh se ARM-të janë të pranishme në territor, sygjerohet dhënia e kompetencave ARM-së Fier për monitorimin e mjedisit. Kjo nënkupton:

- ndryshimet e bazës ligjore për shtimin e kompetencave të ARM-së
- pajisjen e ARM-së me laboratorë të çertifikuar për monitorimin e parametrave të ndryshëm përfshirë edhe parametrat që nuk monitorohen për mungesë kompetencash laboratorike,
- dhënien e fondeve financiare, që bëjnë të mundur një gjë të tillë
- Integrimi i sitstemit GIS për hedhjen e të dhënave në kohë reale dhe pasurimin e arkivës elektronike me të dhëna rreth situatës mjedisore në Bashki dhe historikun e ndotjeve në të.
- Organizimi i trajnimeve me qëllim ngritjen e kapaciteteve monitoruese si edhe shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira.
- Mbajtja e Rregjistrit vjetor të Monitorimeve Mjedisore, Shkarkimet në Mjedis të të gjitha tipeve të lejeve (A, B, dhe C).

Mungesa e bazës ligjore/procedurave e programeve për mbrojtjen e duhur të ujërave nëntokësore: Në vendin tonë mungon një kuadër legjislativ i plotë ose

programe të posaçme që garantojnë mbrojtjen e plotë të mjedisit (dhe kryesisht ujit, ajrit, tokës) nga industria e rëndë ku përfshihet edhe industria e naftës. Konkretisht, legjislacioni shqiptar rregullon mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjeve të shumta (Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit për Lejet e Mjedisit, e shumë ligje të tjera). Megjithatë, Shqipëria nuk ka ligje të posaçme ose programe që rregullojnë disa procese (shpimin, operimin, ri-injektimin, etj.), të industrisë gjatë aktivitetit të saj. Në përgjithësi, në Shqipëri mungojnë ligje dhe programe që përcaktojnë:

- llojin e teknologjisë së shpimit të puseve (të naftës në rastin e Lushnjës e Fierit) që i përshtatet çdo zonë që shfrytëzohet nga industria e naftës,
- llojin e teknologjisë që industria e naftës duhet të përdorë për veshjen e puseve të naftës,
- procedurat/teknikat/teknologjitë për izolimin e puseve të naftës kur dalin jashtë funksionit dhe monitorimin e tyre,
- mbulimin e shpenzimeve për izolimin e puseve jashtë funksionit dhe rihabilitimin e zonave naftënxjerrëse në rast mbylljes së veprimtarisë të kompanisë,
- zonimin e territorit për efekt të ri-injektimit (zona ku lejohet dhe zonat ku ky proces mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit),
- programe që rregullojnë ri-injektimin e ujërave të ndotura. Ri-injektimi është thjesht një mënyrë për të ricikluar ose futur në venddepozitim përfundimtar ujërat e ndotura nga industria e naftës. Për këtë arsye nevojtet që shteti të hartojë një program në të cilin të përcaktohen të paktën disa kërkesa minimale që parandalojnë ndotjen e burimeve ujore nëntokësore dhe mbrojnë shëndetin e njeriut,
- ligje e programe që rregullojnë shpimet për naftën në afërsi (dhe në akuifer) të një akuiferi, uji i të cilit përdoret për furnizim me ujë të popullsisë në ditët e sotme dhe në të ardhmen,
- ligje e programe që rregullojnë shfrytëzimin e burimeve ujore e nëntokësore nga industria e rëndë (dhe ajo e naftës në veçanti në Bashkinë e Lushnjës, zona e shfrytëzimit Lushnjë-Fier) duke patur parasysh se kjo industri përdor sasi tepër të mëdha uji gjatë aktivitetit të saj,
- ligje e programe që rregullojnë shfrytëzimin e ujërave nëntokësore me thellësi mbi 200 m me qëllim shmangien e uljes së relievit të tokës, si dhe
- ligje që përcaktojnë zonat e ndjeshme ndaj uljes së relievit (tabanit) të tokës nga mbishfrytëzimi i ujërave nëntokësore ose i mineraleve.

Për këtë arsye, mund të thuhet se në mungesë të një kuadri legjislativ të plotë dhe të programeve të posaçme që rregullojnë mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore dhe të nëntokës nga industria e naftës, akuiferët mbeten të pambrojtur.

Me qëllim përmirësimin e monitorimit të mjedisit në vend, gjë që do të kontribonte në kapjen e problematikave dhe mosrespektimin e standardeve për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të projekteve të PPV-së dhe projekteve të tjera që zbatohen në Bashki, më poshtë është dhënë një tabelë me rekomandime për përmirësimin e monitorimit të mjedisit

Tabela 93. Rekomandime për përmirësimin e monitorimit mjedisor

Çështje ligjore, institucionale, proceduriale për monitorimin e mjedisit	**Masa**	**Instrumenti**
Mospajisja me laboratorë e institucioneve të monitorimit të mjedisit	Pajisja me laborator	Numër laboratori të çertifikuar në pronësi të institucioneve
Mungesa e laboratoreve që kanë kapacitet të monitorojnë parametra si përbërjet klorure dhe PCB si dhe pesticidet dhe PAHs	Pajisja me laboratorë të specializuar	Rritja e kapacitetit për matjen e përbërjeve klorure, PCB-ve, pesticideve dhe PAHs
Monitorimi i mjedisit bazuar në numër të kufizuar treguesish mjedisorë (parametrat)	Krijimi i bazës ligjore për shtimin e parametrave që nevojitet të maten për monitorimin e duhur të treguesve fizikë të mjedisit (ajrit, tokës, ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, biodiversitetit, pyjeve)	Parametra /ndotës që shkarkohen nga industria e rëndë
Numri i kufizuar i pikave të monitorimit	Shtimi i pikave	Numri i pikave
Shpeshtësia e monitorimit të ujërave e pamjaftueshme	Shtimi i frekuencës	Numër i lartë matjesh/vit
Vetë-monitorimi i aktiviteteve të pajisura me leje A dhe B joreal	Kalimi i monitorimit të shkarkimeve të indsutrisë së pajisur me leje mjedisore (A dhe B) nën kompetencat e ARM-Fier	Monitorim mujor i parametrave
Mungesa e kompetencave të ARM-së Fier për monitorimin e mjedisit	Shtimi i kompetencave	Monitorimi parametrave
Mungesa e bazës ligjore/procedurave e programeve për mbrojtjen e ujërave nëntokësore	Krijimi i programeve të posaçme për mbrojtjen e akuiferëve nga industria e rëndë dhe industria e naftës	Numri i programeve në mbrojtje të akuiferëve

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Shtojca 1: Lista e Institucioneve/Bashkëpunëtorëve të kontaktuar.

Tabela 94. Lista e institucioneve dhe takimeve të kryera

Takimet e kryera në kuadër ta hartimit të PPV- Bashkia Lushnje			
Personat/ Institucioni/	**Data e takimit**	**Vendi i takimit**	**Qëllimi i takimit**
Sami Tabaku	26/04/2016 01/06/2016	Bashkia Lushnje	Grumbullim informacioni mbi fondin pyjor (Hartat e vitit 84-85')
Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile		Tiranë	Marrje informacioni mbi zonat e përmbytjes, zonat e rrezikuara nga tërmetet, zjarret etj.
Emergjencat Civile Rajonale - Fier	26/02/2016	Bashkia Fier	Marrje informacioni mbi zonat e përmbytjes, zonat e rrezikuara nga tërmetet, zjarret etj.
Autoriteti Rrugor Shqipëtar (ARrSh)	26/10/2015	Tiranë	
AlbPetrol	07/03/2016	Patos	Mbi vendburimin e gazrave dhe zonave të kontratës për Bashkinë Lushnje
Ministria e Bujqësisë, Drejtoria e Administrimit të Tokës Bujqësore		Tiranë	Marrje informacioni dhe harta për bonitetin e tokave, kanalet ujitëse dhe vaditëse
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB)		Fushë-Krujë	Marrje e hartave dhe informacionit mbi bonitetin e tokave
INSTAT		Tiranë	Të dhënat mbi popullsine
SHGJSH		Tiranë	
ALUIZNI	11/04/2016	Tiranë	Marrje informacioni mbi zonat info-rmale dhe zonat në process legalizimi
ARM Fier Edvin Bixha (Drejtor) Drejtoria Rajonale Mjedisit – Fier Valbona Grema /Specialiste	18/08/2016	Fier	Shkëmbim informacioni dhe diskutime mbi VSM-në, Zonat Nxehta Mjedisore, Monitorimet, Problemet Mjedisore dhe projektet e propozuara për Bashkinë Lushnje
AdZM Fier Ardian Koçi, Drejtor i AdZM Enea Zenuni, Shef Menaxhimi	18/08/2016 19/08/2016	Divjakë - Karavasta	Shkëmbim informacioni dhe diskutime mbi VSM-në, Zonat e Mbrojtura, Monitorimet, Problemet Mjedisore dhe projektet e propozuara për Bashkinë Lushnje
Bankers Petroleum Ltd. Tim Kemp, Senior HSE Manager, Rubensa Sanka Ing.Mjedisi	27/08/2016	Zyra e Kompanisë Bankers Fier	Diskutime rreth mundësisë së ndikimeve në mjedis nga industria e naftës dhe Kompania Bankers
Bordi I Kullimit	11/09/2015	Tiranë	Kërkesë për të dhëna mbi investimet e vitit 2016 të cilat pritet të financohen nga Banka Botërore
QTTB-Lushnje	15/10/2015	Lushnje	Kërkesë për të dhëna mbi prodhimin, nr. e fermerëve, fermave bujqësore, tokat etj.

Agjencia e Shërbimit Arkeologjik	11/09/2015	Tiranë	Të dhëna mbi vendodhjen e zonave me potencial arkeologjik
Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Paurive Kulturore	11/09/2015	Tiranë	Marrja e listës së plotë të monumenteve të kulturës
Drejtoria Rajonale e Mjedisit	11/09/2015	Fier	Marrja e informacionit mbi lejet mjedisore dhe subjektet operuese për Qarkun Fier
Drejtoria e Shërbimit Pyjor	11/09/2015	Fier	Marrja e informacionit mbi sipërfaqet pyjore në pronësi të Bashkisë Lushnje
Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARrSh)	11/09/205	Tiranë	Lista e objekteve ne ndertim (2013, 2014, 2015) + Harta e sistemit rrugor dhe hekurudhor të Shqipërisë.
Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	06/10/2015	Tiranë	Mbi lejet minerare në Bashkinë Lushnje
Qendra Kombëtare e Regjistrimit		Tiranë	Raporti Vjetor I Regjistrit Tregtar, 2015
Trans Adriatic Pipeline (TAP)	18/12/2016	Tiranë	Për gjurmën e projektit TAP dhe rrugëve të kalimit
MBZHRAU	06/04/2016	Tiranëe	Të dhënat lidhur me aktivitetin e akuakulturës në lumenj, liqene, rezervuare

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Shtojca 2: Përmbledhje Dëgjesave me Publikun në kuadër të VSM-së

Dëgjesë Publike mbi gjetjet e Vlerësimit Strategjik Mjedisor – Bashkia Lushnje.

Përfaqësues nga Co-Plan: Fiona Imami *(Planifikues Urban)*
Arta Alla *(Eksperte Mjedisi)*
Silvi Jano *(Planifikues Urban)*
Rodion Gjoka *(Ekspert Mjedisi)*

Në mbledhje morën pjesë përfaqësues nga: Bashkia Lushnje, Inspektoriati Mjedisit, Drejtoria Rajonale Mjedisit, AKPT, Agronom, Profesion i lirë, Shoqëri Civile, Media, etj.

Nuk kishin ardhur përfaqësues nga: Organizata Mjedisore, Bizensi, Shërbimet Publike etj.

Prezantimi nisi në orën **10:[13]** am

Fjala hapjes: Z. Moza Hoxha

Përshëndetje e shkurtër të gjithë pjesmarrësve, prezantohet axhenda e dëgjesë mbi gjetjet e VSM. Vihet theksi në shkëmbimin e informacionit dhe thellimin e bashkëpunimit. *(2min)*

Hyrje në prezantim: Fiona Imami

Prezantim i përgjithshëm i këtij projekti duke trajtuar fazat që tanimë janë konsumuar, fazën aktualen si edhe fazat e ardhshme deri në mbyllje të proçesit. U theksua sërish se ky takim i sotëm në nivel ekspertësh realizohet me qëllim shkëmbimin më intensiv të informacioneve si edhe saktësimin e gjetjeve të realizuara deri më tani. Disa fjalë mbi vizionin e Bashkisë Lushnjë si edhe më konkretisht shpalosja e objektivave strategjik për "Zhvillimin e Qëndrueshëm në sektorët e Bujqësisë, Agroturizmit, Ekoturizmit & Ruajtjes së Burimeve Natyore"*(4min)*

Prezantimi VSM: Arta Alla

U përshkrua objektivi i VSM si edhe proçeset që janë ndjekur në kuadër të hartimit të VSM-së për Bashkinë Lushnje.

Në prezantim u trajtuan në mënyrë të detajuar temat si më poshtë:

- Kuadri Ligjor & Institucional
- Territori & Tokat Bujqësore

  Ndarja natyrale e territorit të Bashkisë Lushnje në zonë fushore & kodrinore i jep mjaft lehtësi menaxhimit të truallit. Lartësia mbi nivelin e detit është relativisht e vogël, ku mbizotëron zona fushore çka ka sjell edhe zhvillimin primar të bujqësis për këtë zonë. Sa i përket rreziqeve nga erozioni është evidentuar zona e Ballagatit, rrezik natyror paraqesin edhe ndotja e përmbytja e fushave nga fryrja e lumenjve.
- Ndotja

  Nga monitorimi i ndotjes në ujrat sipërfaqsor u evidentua p.H acid i Lumit Seman në vlera mesatare 6.2, ku dyshohet se kontribues kryesor i kësaj ndotjeje është përdorimi i pesticideve në bujqësi.

- Ujrat Nëntokësore

  Kryesisht në Lushnje banesat nuk janë të vendosura mbi akuifer, por nga konstatimet tona rezulton se këto ujra janë alkaline me p.H = 8.3 si edhe bartin ndotje me metale të rënda.

- Mbetjet

  Problematike shfaqet situata lidhur me Vend-Depozitimin aktual, shllamet e të cilave dekantojnë në kolektorin kryesor vaditës. Mungojnë të dhëna mbi mbetjet e rrezikshme.

- Ajri
- Fondi Pyjor & Kullusor
- Biodiversiteti: 7,2% e specieve të rrezikuara në R.Shqipërisë gjenden edhe në Lushnje.

Siç edhe u përmënd më parë, kjo fazë e II e Dëgjesës së VSM trajton gjetjet e deritanishme si edhe fokusohet në zgjerimin dhe saktësimin e njohurive dhe fakteve. Ndërkohë që në fazën e III të Dëgjesës së VSM do të trajtohen impaktet në mjedis të ndërhyrjeve që do të propozohen nga P.P.V

Mbyllje e prezantimit, falenderime dhe ftesa për diskutim! *(45min)*

Prezantimi përfundoi në orën **11:^{04}** am

Diskutime & Shënime:

Z.Taçi (Ing.Hidroteknik) Merr fjalën i pari dhe shpreh se në këtë prezantim munguan zgjidhjet konkrete të problematikave. Shtron pyetjet nëse VSM do të jap zgjidhje konkrete dhe të përcaktoj objektiva. A do të ketë monitorim të vazhdueshëm mjedisor për Bashkinë Lushnje. Duhet trajtuar ndotja që vjen nga Lumi Osum dhe niveli i hidrokarbureve që shkarkohen në ujrat e tij. Nuk u trajtua problemi i Ujrave të zeza të cilat kalojnë në qiell të hapur nëpë kolektorin kryesor i cili përdoret për vaditjen e tokave. Duhet të studiohet një propozim për ri-pozicionimin e Vend-depozitimit të mbetjeve urbane dhe rehabilitimin e ekzistuesit. Varrezat rrezikohen nga erozioni. Rekomandimet duhet të jenë konkrete dhe të adresuara për secilin sektor. Sygjerohet që të përfshihet në diskutim rimëkëmbja e kuadrit teknik.

Silvi Jano (Co-Plan): Kjo fazë siç edhe e përmëndëm konsiston në paraqitjen e gjetjeve dhe shkëmbimin e njohurive pra të arrihet të pasqyrohet sa më mirë situata ekzistuese. Është faza e III ajo në të cilën do të trajtohen propozimet dhe masat konkrete.

Arta Alla (Co-Plan): Falenderon Z.Taçi për ndërhyrjet dhe evidentimet e kryera dhe sqaron se studimet e detajuara si edhe propozimet konkrete janë në proçes dhe kërkojnë shumë mund e kohë.

Z.Taçi (Ing.Hidroteknik): Këtu u trajtuan lumenjt kufijtar të Bashkisë Lushnjë ndërkohë që ne shqetësohemi për gjëndjen e kolektorit të Myzeqes që ka një nivel të lart ndotjeje dhe gjatë verës shfrytëzohet masivisht për vaditje. Rezervuarët e Murrizit e Thanës kanë një hapsirë të madhe vaditëse (mbi 50% të tokave bujqësore të Bashkisë) ndaj duhet parandaluar ndotja e tyre. Aktualisht një degë e cila furnizon rez. Thanës sjell ndotjen e shkarkuar nga një fabrik përpunimi vajrash dhe nga disa njësi të cilat derdhin mbetjet e hidrokarbureve. Sa i përket mbetjeve inerte, është aktualisht

një gjenerues masiv në Katellare, fabrikë përpunimi mermeri i cili po zapton hapsira të mëdha me këto mbetje.

Bledi Dimo (Ing.Mjedisi – AKPT): Ndryshimet klimaterike nuk ishin përfshire, është me interes që të trajtohen në një seksion të veçant. Propozoj thellimin e studimit sa i përket ndotjes që vjen nga përdorimi i pesticideve dhe gjenerimi i mbetjeve organike në bujqësi.

Avni Hida (Inspektoriati Mjedisit): Mbetjet Spitalore trajtohen sipas rregullores dhe trajtohen nga një kompani private. Kjo kompani trajton të gjitha subjektet shëndetësore në Bashkinë Lushnje, ne i disponojmë kontratat. AKM disponon sasitë e gjeneruara dhe të gjitha të dhënat e tjera. Grykderdhja në det e kolektorit, prrenjve dhe lumenjve sjell ndotje të madhe. Mbetjet e rrezikshme nuk duhet të jenë subjekt i trajtimit në PPV & VSM.

Koment: Ballagati dikur ka qënë i gjithi i pyllëzuar, tani vuan nga erozioni ndaj kërkohet një zgjidhje e këtij problemi sidomos në Garunjas.

Z.Taçi (Ing.Hidroteknik): Lushnja aktualisht rrethohet nga 3 fabrika prodhimi Asfalto-Beton të cilat shkaktojnë ndotje masive në ajër. Të kontrollohet rryma aspiratore e luginës së shkumbinit dhe si vjen ndotja në ajër në Lushnje.

Koment: (Sek.Agronomisë): Rezervuari i Kasharaj duhet të shkoj në nivlein në të cilin ka qënë projektuar për të qënë mëse efiçent. Thana furnizohet nga degë e lumit që kalon nëpër Kuçovë dhe shkarkon ujra me mbetje hidrokarburesh. Strategjia të shtrihet më gjerë se Bashkia Lushnje duke trajtuar problematikën në nivle (Burim – Shteg – Pritës)

Koment: (Nj.A Kolonjë nuk ka fond pyjor. Rezervuarë po prishen nga erozioni, ka humbje rreth 50-70ha tokë. Në kolektor shkarkohen masivisht pesticide të skaduara.Tokat jo produktive në bujqësi të mbillen me pemë.


Takimi & Diskutimi përfundoi në orën **11:**[40] am

Figura 106. Foto nga dëgjesa e parë me publikun.



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Figura 107: Lista e pjesmarrësve në dëgjesën e parë publike, VSM Bashkia Lushnje.



USAID | ALBANIA
FROM THE AMERICAN PEOPLE

PLANNING AND LOCAL GOVERNANCE PROJECT (PLGP) IN ALBANIA
PROJEKTI I PLANIFIKIMIT DHE QEVERISJES VENDORE NE SHQIPERI

Activity / Aktiviteti DEGJESA PUBLIKE PER VSM (1)
Date 26 04 2016

Signing Sheet / Liste Pjesemarrjeje

	Name Surname / Emer Mbiemer	Institution / Institucioni	Title / Funksioni	Contact Number / Numer kontakti	Email / Email	Signature / Firma
1	Robion Gjoza	Co-PLAN	Ekspert Mjedisi	0692186702	robion.gjoza@co-plan.org	
2	Marsela Malo	Bashkia Lushnje	Jurist	0686555885	marsela.malo@yahoo.it	
3	Saimira Anapi	Bashkia Lushnje	Arkitekte	0693650309	saimira.anapi@gmail.com	
4	Dalip Peno	Bashkia Lushnje	Agronom	0682306011		
5	Arges Hoxha	Bashkia Lushnje	Jurist	0693043007	arges-hoxha@hotmail.com	
6	Agim Gaqo	Njesia Bazaj	Administrator	0682458760	—	
7	Afrim Sadiu	Njesia Divjake	Administrator	0682087977	afrim.sadiu@yahoo.com	
8	Bezir Sulejmani	Njesi Adm. Gole	Administrator	0684633879		
9	Redjon Greca	Njesia Adm. 5	Inspektor	0692436455	redjon.greca@yahoo.com	
10	Violeta Daniaj	Njesia Adm 1/3	Administrator	0682172573	violetadaniaj@hotmail.com	
11	Olsiye Ramaj	Sanitare 201	Sanitar	06P5682885		
12	Mly Linda Bose	Njesi 01	Inspektore	0692282416	—	
13	Fatmir Selmanaj	5	—	0695881556		
14	Dorina Veizi	Muzeu	SNL	0692320519		
15	Anisa Zeneli	Muzeu	Ciceron	0695255382		
16	Daniel Kambera	Grupin QKLS		0674820058	daniel.kambera@hotmail.com	
17	Agim Dema	—	Agronom	06Pdo85262	—	
18						

	Name Surname / Emer Mbiemer	Institution / Institucioni	Title / Funksioni	Contact Number / Numer kontakti	Email / Email	Signature / Firma
19	Shpresa Meço	Bashkia Shijak	Drejtore	0684027074	shpresameco@yahoo.com	
20	Zamira Agaj	Bashkia Cërrik	Drejtore	0694072179	zamira.agaj@bashkiacerrik.com	
21	Kristaq Tarapuli	Kryetar	Rajon Nr. 03	0692441683	kristaqtarapuli@yahoo.com	
22	Xhelal Canaj	Rajoni Nr. 3	Administrator	06P5162156	—	
23	Nazi Daniaj	Rrëshen Nr. 2	Inspektor	0692890038		
24	Ayaz Hida	ISHMP	Inspektor	0682390888	ayaz.hida@gmail.com	
25	Fatmir Begiri	Kashtelltar	Kështjellitar	06P4082846	—	
26	Besim Hyka	Qendra Fier	Pjesyre	0696150401	besimhyka@hotmail.com	
27	Sabri Asqerbeyli	Njesia V. Kolonje	Agronom	-	-	
28	Ilir Xhaja	Kryetar Bashkia	Kryetar	0689912784		
29	Andrea Galli	Kryetar Bashkia	Administrator	0692116177		
30	Besnik Gega	K.K.P.O.V	Kryetar	0694746999		
31	Ergent Prishka	Bashkia Lushnje	SNL per IT	0696244259	egpentr@live.com	
32	Mirjeta Cela	Bashkia Lushnje	Drejtoria Plan.	0695876659	mirjeta.cela@yahoo.com	
33	Mirvasa Hasani	Bashkia Lushnje	Drejtore	06F2651021	mirvasa.hasani@gmail.com	
34	Dimo.hyka@gmail.com					
35	Sherafi Bajrami	AKPT	Specialist	0695246768	sherafibajrami@yahoo.com	
36	Bledi Dino	AKPT	Drejt. Sekt.	0672886195	bledi.dino@plan-pik.gov.al	
37	Fiona Imami	Co-Plan	Plan. Urbane	0696524280	fiona.imami@co-plan.org	
38	Arta Alla	Co-PLAN	Exp. Mjedisi		arta.alla@co-plan.org	
39	Silvi Jano	Co-PLAN	Plan Urban		silvi.jano@co-plan.org	
40						

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Dëgjesa e dytë me publikun: Vlerësimi Strategjik Mjedisor për PPV – Bashkia Lushnje

Përfaqësues nga Co-PLAN: Arta Alla *(Eksperte Mjedisi)*
Rodion Gjoka *(Ekspert Mjedisi)*
Fiona Imami *(Planifikues Urban)*
Krist Bashmili *(Menaxhim Mjedisi)*

Në mbledhje morën pjesë përfaqësues nga: Bashkia Lushnje, Prefektura, ARM-Fier, AKPT, Drejtoria Administrimit & Menaxhimit të Tokave, Profesion i lirë, Shoqëri Civile, OJF, Shërbimet Publike, Auditi, Ujësjellësi, Bankers Petrolium, Policia, Këshilltarë Bashkiak, Kryetarë të NjA-ve, Përfaqësues nga sektori i Agronomisë dhe Bujqësisë, Profesione të lira, etj.

Prezantimi nisi në orën **11:^{05}** am

Fjala hapjes: Z. Fatos Tushe *(Kryetar i Bashkisë)*

Proçesi i hartimi dhe konsultimit të PPV-së për Bashkinë Lushnje ka organizuar deri në këtë momenti 6 (gjashtë) degjesa me publikun, ndërkohë sot realizojmë dëgjesën e 7 (shtatë) dedikuar Vlerësimit Strategjik Mjedisor e cila është edhe dëgjesa përmbyllëse për këtë proçes. Këtu do të paraqiten impaktet dhe ndikimet e vlerësuara të projekteve dhe ndërhyrjeve që parashikon Plani si edhe do të prezantohen masat konkrete. Bashkia, nga dëgjesa e sotme pret dhe jemi të interesuar që të merrnim mendime dhe qëndrime lidhur me çeshtjet mjedisore që do të trajtohen në këtë dëgjesë. Të gjitha materialet e referuara sot do të vihen në dispozicion të palëve të interesuara në adresën zyrtare të Bashkisë Lushnje, ku edhe komentet zyrtare priten me shkrim në këtë adresë, përgjatë 7 ditëve në vijim.

Në këtë proçes, po asistohemi nga partneri ynë USAID, përmes Projektit për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP), si një nga 5 Bashkitë model në Republikën e Shqipërisë, në kuadër të planifikimit të territorit.

Falenderoj ekspertët e Co-PLAN për bashkëpunimin dhe punën e tyre cilësore, i ftoj të paraqesin vlerësimet e tyre. *(10 min)*

Prezantim, Pjesa I: Arta Alla *(Eksperte Mjedis)*

Prezantimi nis me spejgimin e proçesit nëpër të cilin kalon hartimi i VSM-së si edhe legjilslacionit ku bazohet hapat e ndërmarra për krijimin e dokumentit të VSM-së, po ashtu edhe detyrimet e metodologjinë e ndjekur. Qartësohen proçeset e ndejkura duke vënë theksin në fazat që tanimë janë konsumuar, fazën aktualen si edhe fazat e ardhshme deri në mbyllje të proçesit.

Pjesa e parë e dëgjesës u përqëndrua në paraqitjen e rezultateve gjeneruar nga analizat mjedisore kryer pët të gjithë trerritorin e Bashkisë Lushnje. Elementët e trajtuar në këto analiza (Toka, Ndotja, Mbetjet, Akuiferi, Ujrat Sipërfaqësorë, Sistemi Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime, Pyjet, Erozioni, Ajri, Zhurmat, Infrastruktura etj. *(15 min)*

Prezantim, Pjesa II: Rodion Gjoka *(Ekspert Mjedisi)*

Në këtë pjesë të dytë të dëgjesës u trajtua vlerësimi i ndikimit që do të ketë në mjedis nga zbatimi i të gjithë fondit me projekte parashkikuar në PPV. Ky seksion u prezantua fillimisht duke spjeguar metodën e Vlerësimit të Ndikimit dhe konceptin e Përputhshmërisë, për tu ndalur më pas tek vlerësimi i secilit prej projekteve dhe rezultatet e tyre përmbledhëse.

Fondi projekteve të PPV-së për Bashkinë Lushnje është strukturuar/grupuar në Objektiva të Planit, si rrjedhoj nga vlerësimi i ndikimit në nivel projektesh specifik dhe përputhshmërisë në nivel plani, u konkludua se:

Ndikimi në mjedis nga zbatimi i PPV-Bashkia Lushnje do të jetë i ulët nëse rrespektohen masat e parashikuara, ky ndikim kompleks mund të minimizohet dhe mjedisi mund të ripërtërihet normalisht duke adresuar si duhet masat për çdo objektiv mjedisor si edhe duke ushtruar në mënyrë profesionale monitorimin e indikatorëve që do të referohen në lejet mjedisroe të secilit projekt.

Lidhur me përputhshmërinë, PPV – Bashkisë Lushnje, është vlerësuar të këtë përputhshmëri mesatare me orientim në të lartë lidhur me Objektivat Kombëtare Mjedisor (Ajri, Uji, Toka, Pyjet, Biodiversitete, Kultura, Klima etj.) *(15 min)*

Prezantim, Pjesa III: Arta Alla *(Eksperte Mjedis)*

Pjesa e tretë dhe e fundit e prezantimit konsitsoi në paraqitjen e masave konkrete për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet që do të rrejdhin si rezultat i implementimit të projekteve të parashikuara nga PPV. Krahas masava konkrete mjedisore u paraqiten edhe projekte specifike të cilat kanë karakter rehabilitim të zonave të nxehta mjedisore si dhe ndërhyrje për seksione dhe terrene me probleme të theksuara në këtë Bashki (Rehabilitimi Zonës Industriale, Zona ripariane e lumit Osum, Rehabilitimi i zonës së ndotur nga uzina Baterive, etj) *(14 min)*

Prezantimi përfundoi në orën **12:^{00}** pm

Diskutime & Shënime:

Në vijim janë përfshirë komentet dhe diskutimet e realizuara gjatë dëgjesës:

1. Z. Konstandin Puka: Ndihem shumë i vlerësuar që jam këtu i ftuar, kam marre pjesë edhe në dëgjesat e mëhershme. Shtroj shqetësimin se përse këto materiale na vinë me vonesë, duhet të mernim më tepër kohë për ti lexuar e studiuar, për të hedhur mendimet tona ose për një korrektim të mundshem.

   Drejtimi i erërave në qytetin e Lushnjes dhe në Bashkine e re do duhet të përcaktoj dhe zonën industriale sepse drejtimi i erërave largon ndotjen në atmosferë, rrezikon dhe jeten e njerezve nëse ndotja shkon drejt zonave urbane.

   Në material nuk përmendet ndikimi i antenave të celularëve, ky është një shqetesim edhe ketu në godinën e Bashkisë, antena ndodhet vetem 90m larg. Rrotull kullave jane 132 familje që marrin ndikimin nga rrezet kancerogjene.

Gjithashtu nuk përmëndet masakra ndaj lumenjve qe rrethojnë Lushnjen dhe Fierin, kam patur fatin të kaloj mbi keto zona të Semanit, Skumbinit vihet re fenomeni erozionit, abrazionit. Si ndikojne keto ne jetën e njerëzve dhe në të njëjtën kohë kam parë sesi penelat e vjetra (prita gjatësore dhe tërthore që bien në shtratin e lumenjve për te evituar gërryerjen e tyre) janë shkatërruar tërësisht.

Unë dua që mjedisi të marrë në konsideratë ngritjen e rezervuarit dhe studimin e seksionit hidrometrik, seksioni që percjell ujin në lumenj, të percaktohen nivele të reja të argjinaturave.

Përgjigjie Arta Alla: Bordet kulluese, Ministria e Bujqesise dhe instanca të tjera, janë kontaktuar të gjitha nëpërmjet Bashkisë. Nuk duhet te harrojme qe nje pjese e mire e studimeve nuk ekzistojnë sepse 20 vitet e fundit nuk ka studime prandaj nëse prezantimi duket i pjeshshem është edhe për shkak se në disa raste mungojnë studimet e në raste të tjera nuk vihen në dispozicion. Përsa i perket lumenjeve u shprehët se i kemi prekur përciptazi ndërkohë që në studimin qe kemi bere, kemi kryer analiza dhe kemi referuar me kompetencë përfundime si: lumenjte nuk jane menaxhuar ne 25 vitet e fundit ne e thame shume te permbledhur dhe shkurtismisht qe lumenjte kane demtime hidromorfologjike qe do te thote nga shtrati deri te brezi, deri te rrjedha nga mbishfrytezimi i inerteve etj.

Kemi trajtuar arsyet e zhdukjes së florës dhe faunës, burimet e ndotjes dhe më tepër se kaq kemi ofruar masa konkrete.

Lidhur me rezervuaret, faktikisht MB na ka derguar te gjithë informacionin që posedon, kemi arritur të analizojmë se nga erozini rezervuaret kanë humbur kapacitetin e tyre të meparshëm ujitës për të cilën janë projektuar. Në VSM duhet të rekomandojmë që duhet ndërhyrë ose sesi do të nderhyjmë në mirëmbajtjen e tyre por janë planet sektoriale specifike që percaktojne se cilat janë shkaqet kryesore që duhet nderhyrë dhe më specifikisht në ç'seksion nevojitet ndërhyrja.

Lidhur me rrezatimin nga antenat e shërbimit telefonik, vetem ne vendin tone antenat na bejne shoqeri sikur mos te ekzsistonte asje rrezik , ligji ne fuqi nuk lejon mbrojtjen e duhur te shendetit tone sepse percakton nje sasi rrezatimi per 10 wat/m^2 , nderkohe qe demtimet e shendetit sipas studimeve te ndryshme arrijne ne 2 w/m^2 pra eshte ne nivel qendror. Bashkite qe duhen te luajne nje rol te rendesishem qe te pakten te heqin antenat nga qendrat e banuara ,shkollat dhe spitalet.

2. Fatbardh Rustemi – Përgjithësisht ne jemi një brez që e duam atdheun kur flitet për patriotizem, por realisht koha po tregon që ta duash atdheun duhen të gjitha ato që ju i parashtruat në prezantim. Nëse natyra shndërrohet në element dekorativ atehere ky do të jetë fataliteti më i madh që ne i bëjm natyrës por edhe vetes.

Vemendje ishte kushtuar mbi shtimin e pyjeve, pylli ruan tokën dhe ajo që mua më terhoqi vëmendjen këtu ishte se të gjitha problematikat që ne hasim ishin trajtuar si duhet.

Lumenjt që tanimë shfaqen agresiv në grykderdhjen e tyre, thjesht sepse ne jemi treguar agresive ndaj tij.

Të gjithe ata që studiojnë problematikat e të ardhmes thonë që në të ardhmen problem do të behet aksesi ndaj ujit, jo nafta, ne kemi 33 rezervuare dhe të tëra në kompleks janë pasuri shume te madhe, ndaj lipset të vihen urgjentisht në qëndër të vëmëndjes.

Ishit mjaft serioz në relatimin e çeshtjeve mjedisore por mendoj se duhet të theksojmë prioritet. Shprehem sinqerisht kur shoh te rinj qe prezantojne kshu më shtohet besimi .

Përgjigjie, Arta Alla: Është realizuar një trjatim prioritar i problematikave më akute në Bashkinë Lushnje, VSM-ja në rastin e hartimit të planeve na kërkon që të analizojmë çdo fushë dhe të marrim rekomandime që supozohet të merren parasysh në hartimin e planeve sektoriale.

Për rezervuaret apo burimet ujore shumë e drejte, uji do te behet me e shtrenjte se nafta ,per kete arsye ne duhet ti kushtjome nje vëmëndje të veçantë si ujerave nëntokësorë ashtu edhe ujërave sipërfaqësorë.

Për lumin Shkumbin nuk kalon por e prek shumë pak bashkinë, rëndësia që i kemi dhënë qëndron në faktin se ky lum shërben si burimi kryesor i akiuferit të Lushnjes për furnizimin me ujë të pijshëm.

3. Rrapi Bico – Baseni i Shkumbinit në të cilin furnizohet me ujë Bashkia e Divjakes dhe Lushnjes nuk konstatova të ishte trajtuar se çfarë është bërë këto 10 vitet e fundit apo çdo të bëhet në të ardhmen, a monitorohet. Mendoj se monitorimi i pus shpimeve duhet mbajtur në kontroll të vazhdueshem, në qytet ka shume zona industriale reparte boje etj, a është menduar që të spostohen jashtë qendres

   Problem tjeter në lidhje me pesticidet që perdoren gjeresisht, këto ndotin dhe ajrin dhe ujerat, zhurmat në katet e fundit të pallateve ku janë ndertuar lokale mendoj se duhet të trajtohet më gjerë, ju falemidnerit .

Përgjigjie, Arta Alla & Rodion Gjoka: Per sa i perket Shkumbinit ne nuk kemi plan menaxhimi të lumenjve e të baseneve, lajm i mirë është që Ministria e Mjedisit së bashku me agjensitë e baseneve ujore si të Shkumbinit ashtu dhe të Semanit po hartojne planet e menaxhimit të baseneve. Kemi sygjeruar që gjatë hartimit të këtij plani të merren parasysh ndotjet e ujerave nentokesore .

4. Albert Divjaka - Ju më parë përmëndët pjesen e ndotur të Shkumbinit, shprehja se Shkumbini është i ndotur me metale të rënda mendoj se është e ekzagjeruar, a ka pasur një studim të mirëfilltë sepse studimet qe jane bëre para 10 vjetesh në pusshpime.

Përgjigjie, Arta Alla: Është realizuar nje monitorim i ujerave i cili u krye me mbështetjen e USAID rreth një vit më parë, ku Shkumbini rezulton i

ndotur me metale të renda. Megjithate për përcaktimin e saktë të monitorimit të ujerave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë duhen monitorime 2 vjeçare.

Rodion Gjoka – Sa i takon ujrave të akuiferit të Shkumbinit do të shprehesha së nivelet e ndotjes jane për tu patur në kosideratë dhe për të ngritur shqetësimin pasi kemi mbi 6 bashki të cilat shkarkojnë çdo ditë ujrat e ndotura urbane në rrjedhën e lumit, pa llogaritur këtu edhe shkarkimet industriale.

5. Perfaqesues i Agjensisë së Zonave të Mbrojtura: Lushnja është një ndër bashkitë të cilat brenda territorit tyre kanë siperfaqe minimale të zonave të mbrojtura. Konkretisht kemi 5 monumente natyre që sipas statusit jane kategoria e 3-të e zonave të mbrojtura dhe pjeserisht nga vlera e tyre kalojne ne shkallen e pare te mbrojtjes. Deri tani nga vezhgimet që kemi patur janë në gjendje të mirë.

   Degjova që siperfaqa natyrore është relativisht e vogel, rreth 12%. Është mëse e vërtetë ajo që reflektuat se fondi pyjor e kullusor sa vjen e pakësohet, problemi i binomit bujqesi – pemtari.

   Në lidhje me biodervistetitin, që ka të bëjë shumë me rezervuaret dhe u debatua shumë, aty gjendet nje pasuri e madhe e flores dhe faunes ku ju deri diku i kishit trajtuar, kishit nxjerre në pah elementet element të rëndësishëm. Sygjeroj të shtohet fondi i dedikuar per parqe rajonale, zona të mbrojtura duke patur në konsideratë se me amrrjen e statusit këto zona nuk jane hermetike e te mbyllura, perkundrazi këto zona bëhen më tërheqëse dhe ndihmojnë më tepër Bashkinë.

Përgjigjie, Arta Alla dhe Rodion Gjoka: Duam tju falenderojmë, ashtu siç edhe ju e cituat, kemi një larmi të biodiversitetit më konkretisht në hapsirat e rezervuarit të Thanës. I kemi trajtuar imtësisht dhe i kemi identifikuar monumentet e natyres në mënyrë që të rrisim interesin dhe qasjen ndaj vlerave dhe historisë që ato bartin.

Takimi & Diskutimi përfundoi në orën **13:**[25]pm

Figura 108. Foto nga dëgjesa publike VSM – Bashkia Lushnje




Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Figura 109. Foto nga dëgjesa e dytë publike mbi VSM-në Bashkia Lushnje.



Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Figura 110. Foto nga dëgjesa e dytë publike mbi VSM-në Bashkia Lushnje.



USAID | ALBANIA

PLANNING AND LOCAL GOVERNANCE PROJECT (PLGP) IN ALBANIA

PROJEKTI I PLANIFIKIMIT DHE QEVERISJES VENDORE NE SHQIPERI

Activity / Aktiviteti DËGJESË ME PUBLIKUM "VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR për PPV-Bashkia LUSHNJE

Date 15/Shtator/2016

Signing Sheet / Liste Pjesemarrjeje

	Name Surname / Emer Mbiemer	Institution / Institucioni	Title / Funksioni	Contact Number / Numer kontakti	Email / Email	Signature / Firma
1	Rodion Gjoka	USAID/Co-PLAN	Ekspert Mjedisi	0692186702	rodion_gjoka@co-plan.org	
2	Nimroza Hoxhaj	Bashkia Lu	Drejtor Drejtori	0672051021	nimroza.hoxhaj@yahoo.com	
3	Hysen Agaraj	DEKL-LEZHE	Përdorues	0672657480	-	
4	Fatbardh Kujtim	Bashkia Lu	Përg. Kërkimit	0673120028	fatbardhkujtim@yahoo.com	
5	Medin Ahmeti	Bashkia Lu	Administrator	0682035[illegible]	[illegible]	
6	Elton Koreshi	B. Lushnje	Dr. Tatimeve	0684341853	elton.koreshi@gmail.com	
7	Bedri Hida	B. Lushnje	Dr. Juridike	0682150401	bedrihida@gmail.com	
8	Ramone Veliu	Spitali Lushnje	Drejtore	0672017304	ramonaveliu@hotmail.com	
9	Evaldo Sefa	B. Lushnje	Drejtor Financiar	0686271784	evaldosefa@shqiperia.al	
10	Maksim Qirko	B. Lushnje	Përg. Arsimit	0695139678	maksim.scuka@yahoo.com	
11	Ismail Braçi	AKPT	Koordinator Urban	0683777506	ismailbraci@gmail.com	
12	Klodiana Hoxha	Bashkia Lushnje	Dr. Juridike	0692505916	klodi_xhafa@yahoo.it	
13	Erjona Jalaj	Bashkia Lushnje	Dr. Juridike	0698188475	jalaj0991@gmail.com	
14	ALBI LLAZI	LLAZO	Inxhinier	0672060901	albi.llazi@hotmail.com	
15	Gres Zonumi	AKZM FIER	Përg. Sekretarisë	0697036169	gm.-cs@hotmail.com	
16	Mentor Hoxha	Qarkoja	FIER	0682755201		
17	Sulejman Xhafa	AKZM	Shef Mekanik	0665334134	xhafa.sulejman@yahoo.it	
18	Valbona Grabovi	DRM-Fier	Sp. Monitorimi	0693500428	valbonagrabovi@yahoo.com	

	Name Surname / Emer Mbiemer	Institution / Institucioni	Title / Funksioni	Contact Number / Numer kontakti	Email / Email	Signature / Firma
19	Rubensa Sanka	BPAL	Drejtore Degës	069 4024469	rsanka@bankalbania.com	
20	T. emp	ASPAZ				
21	Fiona Imami	Co-Plan	Plan Urbane	0693652820	fiona.imami@co-plan.org	
22	Kristi Bashkurti	Co-Plan	[illegible]	0696643580		

Burimi: Bashkia Lushnje dhe PLGP/Co-PLAN, 2016

Shënime dhe referenca

[1] Ky ligj është përafruar plotësisht me Direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara"Numri CELEX: 32001L0042, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 197, datë 21.7.2001, faqe 30 – 37.

[2] Klasifikimi i klimës sipas Köppen-it është një klasifikim klime nga më të përdorurit në sistemet e klasifikimit të klimës. U publikua për herë të parë në 1884 nga klimatologu ruso-gjerman Ëladimir Köppen. Më vonë klimatologu gjerman Rudolf Geiger bashkëpunoi me Köppen-in për ndryshimin e sistemit të klasifikimit, i cili tashmë njihet me emrin Köppen–Geiger. Ky klasifikim lidhet me tipat e vegjetacionit dhe si reagojnë ata ndaj klimës.

[3] Klasifikimi Csa- klima e grupit C- klima mesatare që ndodhin zakonisht në anën perëndimore të kontinenteve ndërmjet gjerësive 30° dhe 50°. Csa- është klima me verë të thatë ose, ndryshe, klima mesdhetare.

[4] Agjencia Kombëtare e Energjisë (sot AKBN) dhe Co-PLAN, Shqipëria, Harta e shpërndarjes së sasisë vjetore të orëve me diell

[5] Agjencia Kombëtare e Energjisë (sot AKBN) dhe Co-PLAN, Shqipëria, Harta e shpejtësisë mesatare të erës (m/s)

[6] World Trade Press, Albania Precipitation

[7] SHGJSH, Harta hidrogjeologjike e qarkut Fier, shkalla 1:100,000, 2014

[8] "Akuiferi ose ujëmbajtësi është një formacion nëntokësor shkëmbi të përshkueshëm apo materiali të copëzuar i cili mund të prodhojë sasi të përdorshme uji dhe të merret qoftë nga burimet (natyrale), qoftë nga puset (artificiale)" cit: Vezir Muharremaj, "Shkenca e tokës II", 2014

[9] SHGJSH, "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë - qarku Fier", fq. 91, 2014

[10] SHGJSH, "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë - qarku Fier", fq. 96, 2014

[11] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003

[12] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003

[13] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016

[14] Cit. Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura" (i ndryshuar)

[15] Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura" (i ndryshuar)

[16] AKZM 2016

[17] Ligji Nr 8906, datë 06.06.2002 Për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar me Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008

[18] SZHT Bashkia Lushnje, 2016

[19] Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, 2016

[20] Ligj Nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore

[21] Ligji Nr 9587, datë 20.7.2006 'Për Mbrojtjen e Biodiversitet'

[22] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

[23] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

[24] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

[25] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

[26] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

[27] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

[28] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

[29] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[30] Strategjia
[31] Strategjia
[32] Për shërbimin shëndetësor dhe arsimor analizohet në mënyrë më të detajuar në pikën 1.4.2 në po të njëjtin dokument.
[33] Të dhënat janë marrë nga konsultimet me Bashkinë Lushnje dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Fier, Seksioni i Administrimit Pyjeve dhe Shërbimit Këshillimor Lushnje.
[34] CENSUS 2011.
[35] Bashkia Lushnje
[36]Burimi ValuAdd &KfW Design Report - Lushnje
[37] Plani Rajonal Bashkia Lushnje
[38] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[39] The World Bank, Looking Beyond the Horizon
[40] ECN 2008
[41] UNDP Project on Identification and Prioritization od Environmental Hotspots in Albania
[42] Bashkia Lushnje
[43] Ky ligj është përafruar plotësisht me Direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara"Numri CELEX: 32001L0042, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 197, datë 21.7.2001, faqe 30 – 37.
[44]Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë – qarku i Fierit", Tiranë.
[45] INSTAT 2012
[46] Shih analizën e periferialitetit tek Plani
[47] *Closed Circuit Tele-Vision* - Video inspektim i seksionti të tubacionit për dëmtime apo ndërhyrje të paligjshme.
[48] Nevoja Biokimike për Oksigjen - NBO.
[49] Klasifikimi i klimës sipas Köppen-it është një klasifikim klime nga më të përdorurit në sistemet e klasifikimit të klimës. U publikua për herë të parë në 1884 nga klimatologu ruso-gjerman Ëladimir Köppen. Më vonë klimatologu gjerman Rudolf Geiger bashkëpunoi me Köppen-in për ndryshimin e sistemit të klasifikimit, i cili tashmë njihet me emrin Köppen–Geiger. Ky klasifikim lidhet me tipat e vegjetacionit dhe si reagojnë ata ndaj klimës.
[50] Klasifikimi Csa- klima e grupit C- klima mesatare që ndodhin zakonisht në anën perëndimore të kontinenteve ndërmjet gjerësive 30° dhe 50°. Csa- është klima me verë të thatë ose, ndryshe, klima mesdhetare.
[51] Agjencia Kombëtare e Energjisë (sot AKBN) dhe Co-PLAN, Shqipëria, Harta e shpërndarjes së sasisë vjetore të orëve me diell
[52] Agjencia Kombëtare e Energjisë (sot AKBN) dhe Co-PLAN, Shqipëria, Harta e shpejtësisë mesatare të erës (m/s)
[53] World Trade Press, Albania Precipitation
[54] Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
[55] SHGJSH, Harta hidrogjeologjike e qarkut Fier, shkalla 1:100,000, 2014
[56] "Akuiferi ose ujëmbajtësi është një formacion nëntokësor shkëmbi të përshkueshëm apo materiali të copëzuar i cili mund të prodhojë sasi të përdorshme uji dhe të merret qoftë nga burimet (natyrale), qoftë nga puset (artificiale)" cit: Vezir Muharremaj, "Shkenca e tokës II", 2014
[57] SHGJSH, "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë - qarku Fier", fq. 91, 2014
[58] SHGJSH, "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë - qarku Fier", fq. 96, 2014
[59] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003
[60] Programi i Kombeve të Bashkuara, Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri, Raporti Përmbledhës i Studimit, 2003
[61] PNUD, Vlerësimi i rreziqeve në Shqipëri, 2003
[62] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Beart, 2014
[63] Sektori i Emergjencave Civile Lushnje në Bashkëpunim me NJA-të Lushnje, Maj 2016
[64] Sektori i Emergjencave Civile Lushnje në Bashkëpunim me NJA-të Lushnje, Maj 2016

[65] Nyle C. Brady, Ray R. Weil, Elements of the nature and properties of the soils, Third edition, 2010
[66] SHGJSH 2014
[67] Nyle C. Brady, Ray R. Weil, Elements of the nature and properties of the soils, Third edition, 2010
[68] Agjencia Kombëtare e Mjedisit, *Raporti mbi Gjendjen e Mjedisit*, 2013
[69] Agim Binaj, Pirro Veizi, Enkeleida Beqiraj, Fran Gjoka, Elian Kasa, *Economic losses from soil degradation in agricultural areas in Albania*, Agric. Econ. – Czech, 60, 2014 (6): 287–293
[70] Sektori i Emergjencave Civile Lushnje në Bashkëpunim me Nja-të Lushnje, maj 2016
[71] Sektori për Emergjencat Civile në Lushnje së bashku me Njësitë Administrative të Bashkisë ka përcaktuar zonat brenda territorit të bashkisë të cilat rrezikojnë përmbytje, dëmtime nga rrëshqitjet e dheut dhe fenomene të tjera si dhe masat përkatëse që duhen marrë për shmangien e tyre.
[72] *Përzgjedhja e kësaj zone si rajon është bërë vetëm për arsye studimi. Në këtë territor kalojnë/gjenden burime të shumta ujore, janë përqendruar një pjesë e madhe e HEC-eve dhe terreni është i larmishëm, duke përfshirë zona fushore e bregdetare deri tek ajo malore. Pra, nga ana e analizës së metabolizmit ajo i përmban të gjitha elementet e nevojshme për analizim.*
[73] Informacioni për përgatitjen e hartave të metabolizmit është marrë nga Bashkia Fier, SHGJSH, Ministria e Mjedisit, www.riverwatch.eu, AKBN, INSTAT, Ministria e Bujqësisë dhe ASIG.
[74] Informacioni për përgatitjen e hartave të metabolizmit është marrë nga Bashkia Fier, SHGJSH, Ministria e Mjedisit, www.riverwatch.eu, AKBN, INSTAT, Ministria e Bujqësisë dhe ASIG.
[75] Sipërfaqja e matur nga harta GIS (61_bashki)
[76] Gjetje të analizës demografike përgatitur nga grupi i punës pranë Co-PLAN dhe PLGP.
[77] AKBN, 2015 (info e marrë në përgjigje të shkresës zyrtare nr. 17777 prot., datë 16.10.2015).
[78] HEC-et nga River Watch: http://riverwatch.eu/en/interactive-map.
[79] Energji të rinovueshme, energjia diellore, AKBN
[80] Strategjia Kombëtare e Energjisë 2013
[81] Energji të rinovueshme, energjia e erës, AKBN
[82] INSTAT, Censusi 2011 (Grid)
[83] Burimi i të dhënave për hartën e fluksit të energjisë në bashkinë Lushnje është Ministria e Mjedisit (zonat e mbrojtura), www.riverwatch.eu (HEC-et) dhe Co-PLAN (zonat industriale dhe sipërfaqet ujore nga analiza e përdorimit të tokës)
[84] INSTAT, Censusi 2011
[85] Harta hidrologjike, SHGJSH (2014)
[86] Sipërfaqe e matur në GIS (përdorimi i tokës)
[87] Burimi i të dhënave për hartën e fluksit të ujit në bashkinë Lushnje është Bashkia e Lushnjes dhe Valu ADD (sistemi i ujësjellësit dhe zona e mbulimit me shërbim), www.riverwatch.eu (HEC-et) dhe Co-PLAN (sipërfaqet ujore)
[88] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, "Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë, qarku i Fierit", Tiranë 2014.
[89] Ujësjellës-Kanalizime Lushnje, ndërmarrja që ofron shërbimin në territorin e Lushnjes
[90] Të dhënat për ujësjellës – kanalizime janë përpunuar nga Valu ADD në kuadër të hartimit të planit të përgjithshëm vendor për Lushnjen.
[91] Të dhënat e QTTB-së për prodhimet bujqësore dhe blektorale në bashkinë Lushnje, 2015
[92] Sipas të dhënave të CORINE (sip. e matur nga harta GIS)
[93] Të dhënat për hartën e fluksit të ushqimit janë marrë nga Corine (llojet e tokave), Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Urban dhe Administrimit të Ujërave (pikat e grumbullimit dhe magazinimit) dhe Co-PLAN (sipërfaqet ujore)
[94] INSTAT (2013)
[95] Sipas Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve në Shqipëri
[96] Harta e metabolizmit, Fluksi i mbetjeve, Lushnje.
[97] Vendim i KM nr.175, datë 19.1.2011, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve"
[98] Burimi i të dhënave për hartën e fluksit të mbetjeve në bashkinë Lushnje është Ministria e Zhvillimit Urban (venddepozitimet), Ministria e Mjedisit (kompanitë ricikluese), si dhe Co-PLAN (zonat industriale dhe sipërfaqet ujore nga analiza e përdorimit të tokës)
[99] Miriam Bogdani Ndini, Institute of Energy, Water and Environment, University of Polytechnics, Journal of Environmental Science and Engineering, Formerly part of Journal of Environmental Science and Engineering, *Analysis of Surface and Ground Water Exchange in Two Different Watersheds*, Tirana, 2012
[100] Miriam Bogdani Ndini

[101] SHGJSH, Drejtoria e Hidrogjeologjisë, Sektori i Monitorimit të Rrjetit Lumor, *Monitorimi i dinamikës së shtratit në lumenjtë e Shqipërisë në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të rrjedhës dhe propozimi i masave për stabilizimin e gjendjes*, Shkurt, 2016
[102] Kriteret mund te ndryshojne nga vendi ne vend
[103] Ligji Nr. 111/2012 Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore
[104] Instituti kompetent për studimin dhe monitorimin e gjendjes së shtretërve të lumenjve është SHGJSH-ja, siç përcaktuar me Ligjin Nr. 111/2015 *Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar* .
[105] SHGJSH, Drejtoria e Hidrogjeologjisë, Sektori i Monitorimit të Rrjetit Lumor, *Monitorimi i dinamikës së shtratit në lumenjtë e Shqipërisë në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të rrjedhës dhe propozimi i masave për stabilizimin e gjendjes*, Shkurt, 2016
[106] Ky monitorim i cilësisë së ujërave sipërfaqësore u krye për lumenjtë: Osum, Devoll, Seman, Shkumbin, Gjanicë dhe Vjosë. Monitorimi u krye në periudhën qershor-korrik, nga Co-PLAN, në kuadër të zbatimit të projektit të USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore. Në pellgun e Lumit Seman, marrja e mostrave të ujit për analizë u bë në 11 pika, 6 nga të cilat në Osum. Në të gjitha pikat u analizuan në laborator 13 parametra fiziko dhe bio-kimikë (pH, Light Transparency, Electric Conductivity, Total Suspended Solids (TSS), Total Dissolved Solids (TDS), Dissolved Oxygen (DO), Temperature, Biochemical Oxygen Demand (BOD), $N\text{-}NH_4$, $N\text{-}NO_3$, $N\text{-}NO_2$, sulfidet dhe Total Coliform). Ndërkohë në 7 Nga mostrat e mbledhura, disa mostra u analizuan edhe për praninë e metaleve të rënda (Pb, Cd, Mn, Ni, Zn, Cu, Co, Cr, Hg, As, Ba, Br)
[107] Parametrat e përbashkët të monitoruar nga Co-PLAN/PLGP dhe AKM janë pH, Oksigjeni i tretur, BOD_5, N-NH4, N-NO2 dhe N-NH4.
[108] Pikat e monitorimit për lumenjtë kryesorë të Basenit të Semanit (Gjanicë, Seman, Osum dhe Devoll) janë të njëjta me përjashtim të pikës së Mujallisë në Seman e cila është monitoruar vetëm nga AKM. Pikat e monitorimit të AKM-së në Osum janë Uznovë dhe Urë Vajgurore. Monitorimi Co-PLAN/PLGP në Seman është kryer në 12 pika kundrejt 6 pikave të monitoruara nga AKM-ja, ndërsa në Osum në 6 pika kundrejt 2 pikave të monitoruara nga AKM-ja.
[109] Kjo pikë është monitoruar vetëm nga AKM-ja.
[110] Standardet janë marrë nga Agjencia Amerikane për Mbrojtjen e Mjedisit (US EPA, reccomandation considered safe for fish to conduct a healthy life)
[111] Standardet e NBO_5 janë marrë nga *DIRECTIVE 2006/44/EC of 15 February 2006 concerning the management of bathing water quality and repealing Directive 78/659/EEC*
[112] Vlerat e TSS janë marrë nga *DIRECTIVE 2006/44/EC of 15 February 2006 concerning the management of bathing water quality and repealing Directive 78/659/EEC*
[113] Standardet për sulfatet janë marrë nga Directive 75/440/EEC
[114] Standardet për bakterien koliform janë marrë nga NIVA - Instituti per Studimet e Ujërave të Norvegjisë
[115] Standardet për metalet e rënda janë marrë nga *DIRECTIVE 2008/105/EC) e traspozuar në VKM 246/2014 "Per Përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë*" si dhe nga NIVA - Instituti per Studimet e Ujërave të Norvegjisë
[116] Ligji 11/2016 "Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"
[117] Bashkia Lushnje
[118] UNDP Project on Identification and Prioritization od Environmental Hotspots in Albania
[119] http://www.bashkialushnje.gov.al/sq-al/Services/Bizneset/Pages/Informimi-per-qytetarin.aspx
[120] Largësia nga Qëndra e Qytetit
[121] Largësia nga Rruga
[122] Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve & Ligji për administrimin e mbetjeve të rrezikshme
[123] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier*, 2014
[124] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier*, 2014
[125] Studimet e mëparshme të bëra rreth burimeve ujore nëntokësore bazoheshin në sipërfaqen e qarkut të Fierit sipas ndarjes së vjetër të territorit. Ende nuk ka një studim që përcakton sipërfaqen e akuiferëve për çdo bashki sipas ndarjes së re administrative të vitit 2014.
[126] Studimet mbi ujërat nëntokësore janë kryer nga SHGJSH
[127] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier*, 2014
[128] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier*, 2014

[129] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier*, 2014
[130] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier*, 2014
[131] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[132] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier*, 2014
[133] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[134] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[135] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[136] SHGJSH: Deri më sot ende nuk janë kryer studime që përcaktojnë sasinë e ujit të shfrytëzuar nga puse të tilla
[137] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier*, 2014
[138] AKM, 2014. Sipas AKM-së, në vitin 2014, ky akuifer është monitorur nga AKM për parametrat pH, fortësia e përgjithshme, mineralizimi i përgjithshëm, Na, mbetje e thatë, Ca, Mg, Fe, NH_4, Cl, SO_4, NO_3, NO_2, dhe O_2. Monitorimi i përbërjes kimike të UN të akuiferëve ujëmbajtëse është bërë me frekuence 3 here ne vit ne qershor, shtator dhe nëntor
[139] AKM, 2014
[140] AKM raporton se përmbajtja e O_2 në tre fazat e monitorimit varion 1.35-10.23 mg/l, në vitin 2013 luhatet ndërmjet vlerave 1.5-8.01mg/l. Norma STASH është jo më pak se 8mg O_2/l).
[141] Fortësia e Përgjithshme në tre fazat e monitorimit varion Fp = 13. 66 - 13. 72 ^{o}gj
[142] Në shpimet nr.3 Konjat e nr. 286 Çermë fortësia e përgjithshme në fazat e monitorimit luhatet ndërmjet vlerave 19.32-264^{o}gj. Norma e ujit të pijshëm është 10-20^{o}gj dhe maksimale e lejuar 25^{o}gj.
[143] Përmbajtja e Magnezit Mg në tre fazat e monitorimit luhatet 55.72-104.32 mg/l. Ndryshimet në fazat e monitorimit janë të vogla që variojnë 0.15-2.3mg/l. Përmbajtja mesatare varion 55.74-102.1mg/l.
[144] Përmbajtja e amoniakut gjendet në sasinë 0.01-0.83 mg/l. Takohet përmbajtje amoniaku në shpimin nr. 1D në sasinë 0.46-0.01-0.83 mg/l, përkatësisht në tre fazat e monitorimit, përmbajtja është mbi normë në fazën e parë dhe të tretë. Në shpimin nr. 3 Konjat takohet në sasinë 0. 63 - 0. 036- 0. 83 mg/l, përmbajtje mbi normën e lejuar në fazën e parë e të tretë (kufiri max i lejuar 0.05mg/l). Në shpimin nr. 286 Cerme takohet në sasinë 0. 03 - 0. 06 - 0. 03 mg/l. Ndotja lidhet me moszbatimin e zonave të mbrojtjes sanitare afër stacioneve.
[145] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[146] SHGJSH, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit*, Tiranë 2014
[147] AKM 2014
[148] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[149] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[150] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier*, 2014
[151] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Fier*, 2014
[152] Matthew Heberger and Kristina Donnelly , *Oil, Food, and Water: Challenges and Opportunities for California Agriculture*, Pacific Institute, December 2015
[153] Ligji Nr. 11/2016 "Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"

[154] US EPA, //www.epa.gov/uic/aquifer-exemptions-underground-injection-control-program
[155] http://www.epa.gov/uic/aquifer-exemptions-underground-injection-control-program
[156] Hydraulic fracturin
[157] *horizontal drilling*
[158] Futet sërish në pusin e shpuar
[159] Bankers ndërpret aktivitetin e saj në vendin tonë ne fund të vitit 2016.
[160] http://www.bankerspetroleum.com/albania/bankers-albania (March 30, 2016)
[161] http://www.bankerspetroleum.com/albania/bankers-albania (March 30, 2016)
[162] http://ëëë.bankerspetroleum.com/operations/three-part-operational-strategy
[163] EPA, http://www2.epa.gov/hfstudy/executive-summary-hydraulic-fracturing-study-draft-assessment-2015
[164] Deri më tani, ujërat nëntokësore mbulohen nga Ligji 111/2012[164] për manaxhimin e integruar të ujërave ndërsa mungon legjislacioni për mbrojtjen e nëntokës.
[165] Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit në SHBA (Environmental Protection Agency in USA). http://www.epa.gov/uic/general-information-about-injection-wells
[166] Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit në SHBA (Environmental Protection Agency in USA). http://www.epa.gov/uic/general-information-about-injection-wells
[167] Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit në SHBA (Environmental Protection Agency in USA). http://www.epa.gov/uic/general-information-about-injection-wells
[168] Ri-injektimi kryhet *kryesisht për ri-injektimin e CO2, mbetjeve, përmirësimin e prodhimit të naftës, minierat, si dhe për parandalimin e depërtimit të ujit të kripur.[168] Një praktikë e tillë është parë si një mënyrë e sigurt dhe me pak shpenzime për depozitimin e mbetjeve të padëshiruara dhe kryesisht të mbetjeve të rrezikshme industrial dhe nënprodukteve të tyre.* http://www.epa.gov/uic/general-information-about-injection-wells
[169] "Ndikimet mbi mjedis të industrisë nxjerrëse të naftës, vlerësimi i mjedisit në vendburimin e visokës dhe rrugët që duhet të ndiqen për rehabilitimin e tij"**,** Nevton Kodhelaj, Nevina Koja, Fatjona Levani,
[170] Në SHBA, kongresi ka kaluar ligjin për Mbrojtjen e burime ujore (*the Safe Drinking Water Act - SDWA*) në vitin 1974 i cili parashikon mbrojtjen e burimeve ujore që furnizojnë popullsinë me ujë të pijshëm. Në kuadër të këtij ligji, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit ka hartuar programin e Kontrollit të Lëndëve të ri-injektuara Nëntokë (*Underground Injection Program Control*) i cili përcakton kushtet kur ri-injektimi lejohet me ligj
[171] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
[172] David J. Nowak, USDA Forest Service, Syracuse, NY, *The Effects of Urban Trees on Air Quality***,** 2002
[173] Raporti i Gjendjes së Mjedisit, Lushnje
[174] US EPA, https://www.epa.gov/greenvehicles/greenhouse-gas-emissions-typical-passenger-vehicle-0
[175] US EPA (United States Environmental Protection Agency), Average Annual Emissions and Fuel Consumption for Gasoline-Fueled Passenger Cars and Light Trucks, 2008
[176] INSTAT, 2010
[177] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Thirsd National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
[178] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Thirsd National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
[179] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Thirsd National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
[180] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Thirsd National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
[181] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Thirsd National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
[182] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Thirsd National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March
[183] Bëhet fjalë për naftën që përdoret për makina.
[184] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
[185] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
[186] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
[187] Inspektoriati Qëndror Teknik
[188] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.

[189] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
[190] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
[191] Environmental Center for Administration and Technology, Tirana 2008
[192] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
[193] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
194 Sipas studimit të ECAT në vitin 2008. Nga fushata pilot mbi shkarkimet e gazrave nga marmitat e makinave zhvilluar në qytetin e Tiranës në vitin 2008, është studiuar sasia e shkarkimeve në ajër nga makinat me moshë të ndryshme. Studimi ka testuar 1,036 automjete me vite prodhimi të ndryshme. 880 makina përdornin si lëndë djegëse naftën dhe 156 benzinën.
[195] ECAT, Kontrolli - mirëmbajtja dhe siguria e automjeteve, Tiranë 2008
[196] ECAT, Kontrolli - mirëmbajtja dhe siguria e automjeteve, Tiranë 2008
[197] United States Environmental Protection Agency, *Oil and Natural Gas Sector: Standards of Performance for Crude Oil and Natural Gas Production, Transmission, and Distribution*", https://ëëë.epa.gov/airquality/oilandgas/tech.html
[198] AKM 2015
[199] Raporti i Gjendjes së Mjedisit, Lushnje, Bashkia Lushnje
[200] VNM - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
[201] INSTAT 2015
[202]US National Library of Medicine, Korrik 2016, https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6
[203] US National Library of Medicine, Korrik 2016, https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6
[204] US National Library of Medicine, Korrik 2016, https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6
[205] US National Library of Medicine, Korrik 2016, https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6
[206] US National Library of Medicine, Korrik 2016, https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6
[207] US National Library of Medicine, Korrik 2016, https://toxtown.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6
[208] Korridor konsiderohet një fashë e gjelbër e cila ka sipërfaqe relativisht të madhe dhe, krahas funksionit për kalimin e jetës së egër, mund të shërbejë edhe si habitat për jetën e egër. Koridor lidhës është një rrip në sipërfaqe të vogël i cili kryen vetëm funksionin e kalimit të jetës së egër dhe nuk ka hapësirë për t'u konsideruar një habitat për të zhvilluar jetën e egër.
[209] Cit. Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura" (i ndryshuar)
[210] Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura" (i ndryshuar)
[211] AKZM 2016
[212] Ligji Nr 8906, datë 06.06.2002 Për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar me Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
[213] VKM Nr.31, datë 20.01.2016 për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit
[214] VKM Nr. 102, dt. 12.02.2015. Për Krijimin dhe Funksionimin e AKZM-së dhe AdZM-së.
[215] Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
[216] Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, 2016
[217] Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, 2016
[218] SZHT Bashkia Lushnje, 2016
[219] Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, 2016
[220] Ligj Nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore
[221]Monument Natyre, Kategoria IV
[222]Monument Natyre, Kategoria IV
[223]AKZM, Harta e Zonave të Mbrojtura, Resurset Natyrore, Qarku Fier, 2016
[224]AKZM, 2016
[225]AKZM, 2016
[226]AKZM, 2016
[227] AKZM, 2016
[228] AKZM, 2016

[229] AKZM, 2016
[230] AdZM Fier
[231] Ligji Nr 9587, datë 20.7.2006 'Për Mbrojtjen e Biodiversitet'
[232] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[233] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[234] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[235] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[236] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[237] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[238] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[239] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[240] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[241] Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
[242] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[243] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
[244] Libri i Kuq i Faunës Shqipëtare, 2007
[245] Libri i Kuq i Faunës Shqipëtare, 2007
[246] Strategjia
[247] Strategjia
[248] Për shërbimin shëndetësor dhe arsimor analizohet në mënyrë më të detajuar në pikën 1.4.2 në po të njëjtin dokument.
[249] Të dhënat janë marrë nga konsultimet me Bashkinë Lushnje dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor Fier, Seksioni i Administrimit Pyjeve dhe Shërbimit Këshillimor Lushnje.
[250] CENSUS 2011.
[251] Bashkia Lushnje
[252] Agjencia Kombëtare e Mjedisit, *Raporti mbi Gjendjen e Mjedisit*, 2013
[253] Plani Ndërvendor i Përgjithshëm, Bashkia Patos, Bashkia Roskovec, Komunat Bubullimë, Mbrostar, Zharrëz, Kuman dhe Portëz
[254] Agim Binaj, Pirro Veizi, Enkeleida Beqiraj, Fran Gjoka, Elian Kasa, *Economic losses from soil degradation in agricultural areas in Albania*, Agric. Econ. – Czech, 60, 2014 (6): 287–293
[255] Komuna Qendër, Relacion *për projekt idenë e zhvillimit urbanistik e hapësinor të planit rregullues të përgjithshëm të Komunës Qendër*, Mars 2012
[256] AKM, 2014
[257] Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), *Raporti i Gjendjes në Mjedis*, 2014
[258] Strategjia
[259] TAP AG 2015, Udhëzues për Blerjen dhe Qiranë e Tokës në Shqipëri, http://www. tap-ag. al/assets/03.land_access/albanian/GLAC_FINAL_PRINT. Pdf referuar më 19.11.2015
[260]United Nations Economic Commission for Europe, Albania Environmental Performance Reviews, Second Review, United Nations, New York and Geneva, 2012.
[261] Plani i Pergjithshëm Vendor Bashkia Lushnje, Komuna Bubullimë.
[262] Plani i Pergjithshëm Vendor Bashkia Lushnje, Komuna Golem.
[263] EU Commission, *Overview of CAP Reform 2014-2020*, Agricultural Policy Perspectives Brief, N°5* / December 2013
[264]Burimi ValuAdd &KfW Design Report - Lushnje
[265]Projekti përpiluar prej KfW
[266]PLGP/USAID/ValueAdd dhe KfW Design Report - Lushnje
[267] SCADA - Supervisory Control and Data Acquisition

[268]Bashkia Lushnje
[269]PLGP/USAID/VALU ADD, 2015
[270] Plani Rajonal Bashkia Lushnje
[271]Plani Rajonal Bashkia Lushnje – Raporti Mjedisor, fq. 68
[272]Raporti Gjendjes në Mjedis - AKM
[273]INSTAT (2013).
[274]Sipas Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Integruar të Manaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.
[275]Harta e Metabolizmit, Fluksi i Mbetjeve, Lushnje.
[276]Largësia nga Qendra e Qytetit
[277]Largësia nga Rruga
[278]Ligji për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve & Ligji për administrimin e mbetjeve të rrezikshme
[279]Raporti Gjendjes në Mjedis - 2014
[280]Mbetjet në këtë pjesë të lumit janë vënë re gjatë vizitave në terren të ekspertëve të Co-PLAN gjatë 2015-2016.
[281] Korespondenca zyrtare Drejtoria Spitalit 'Ihsan Çabej' Lushnje & Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
[282]Kontrata mes Spitalit 'Ihsan Çabej' Lushnje dhe Subjektit Medi-Tel
[283]UNDP Project on Identification and Prioritization od Environmental Hotspots in Albania
[284] http://www.bashkialushnje.gov.al/sq-al/Services/Bizneset/Pages/Informimi-per-qytetarin.aspxP.F2015
[285]ARM Lushnje
[286]Raporti Gjendjes në Mjedsi 2015
[287]Raporti Gjendjes në Mjedsi – Lushnje 2015
[288] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[289] The World Bank, Looking Beyond the Horizon
[290] ECN 2008
[291] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[292] The World Bank, Looking Beyond the Horizon
[293] SZHT Bashkia Lushnje, 2016
[294] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[295] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[296] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[297] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[298] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[299] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[300] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[301] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[302] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[303] Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
[304] The World Bank, Reducing the Vulnerability of Albania's Agricultural Systems to Climate Change
[305] UNDP Project on Identification and Prioritization od Environmental Hotspots in Albania
[306] Largësia nga Qendra e Qytetit
[307] Largësia nga Rruga
[308] Ligji për Manaxhimin e Integruar të Mbetjeve & Ligji për administrimin e mbetjeve të rrezikshme
[309] Bashkia Lushnje
[310] PLGP/USAID/VALU ADD, 2015

[311] Albpetrol sh.a 2016
[312] Në momentin e shkrimit të këtij artikulli, Bankers është në proces negocimi për shitjen e kompanisë.
[313] Këto ditë flitet se International Petroleum Ltd. ka shitur aktivitetin e saj. Mbetet ende e panjohur kompania që do të shfrytëzojë këtë zone, në vend të kompanisë Sherwood Petroleum Ltd. Sipas Bankers Petroleum Ltd. Kuçova ka 12 milion naftë fuçi rezervë (rreth 7.1% të rezervave kombëtare)[313]
[314] ANEKSI A, VENDIM Nr.686, date 19.10.2007
[315] Të dhënat janë marrë nga Bashkia e Lushnjës
[316] http://www.bankerspetroleum.com/albania/bankers-albania (March 30, 2016)
[317] http://www.bankerspetroleum.com/operations/three-part-operational-strategy
[318] SHGJSH, 2016
[319] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[320] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[321] SHGJSH, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Fierit*, Tiranë 2014
[322] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[323] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[324] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[325] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[326] SHGJSH
[327] SHGJSH
[328] SHGJSH
[329] SHGJSH
[330] SHGJSH
[331] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[332] USAID, Projekti "Planifikimi dhe Qeverisja Vendore (PLGP) në Shqipëri", *Infrastruktura e Ujësjellës - Kanalizimeve të Ujërave të Ndotura në Planin e Zhvillimit Urban të Bashkisë Lushnje pas Ndarjes Administrative Territoriale, 2014*
[333] SHGJSH
[334] SHGJSH
[335] http://www.epa.gov/uic/class-ii-oil-and-gas-related-injection-wells#dw_protect
[336] Water Erosion Prediction Project
[337] Nyle C. Brady, Ray R. Ëeil, Elements of the nature and properties of the soils, Third edition, 2010
[338] Water Erosion Prediction Project
[339] Optimizing soil moisture for plant production: The significance of soil porosity, FAO SOILS BULLETIN 79
http://www.fao.org/docrep/006/y4690e/y4690e09.htm
[340] Optimizing soil moisture for plant production: The significance of soil porosity, FAO SOILS BULLETIN 79,
http://www.fao.org/docrep/006/y4690e/y4690e09.htm
[341] Agjencia Kombëtare e Mjedisit, 2014, " Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit për Vitin 2015**,**